



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMIT

“MBI PËRPUTHSHMËRINË”

01.01.2019-31.12.2019

Tetor 2020

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përshkrim i shkurtër i Auditimit

Përshkrim i gjetjeve kryesore

Konkluzione dhe Opinioni i Auditimit

II. HYRJA

Objektivat dhe qëllimi

Identifikimi i çështjes

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Përgjegjësitë e audituesve

Kriteret e vlerësimit

Standardet e auditimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Drejtimi 1: *Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore dhe krahasimi i treguesve.*

Drejtimi 2: *Auditim i zbatimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare për vitin 2019.*

Drejtimi 3: *Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Drejtimi 4: *Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi*

Drejtimi 5: *Vlerësimi i funksionimit të sistemeve menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Përputhshmëria ligjore, analiza dhe vlerësimi i auditimit të brendshëm.*

Drejtimi 6: *Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.*

IV. GJETJE REKOMANDIME

V. ANEKSE

VI. DOKUMENTE SHOQËRUESE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i auditimit

Në përputhje me programin e auditimit të miratuar me nr.333/1 prot. Datë 15.04.2020, KLSH ka kryer një auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Objekt i këtij angazhimi është auditimi i përputhshmërisë të veprimtarisë së subjektit “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, përgjatë vitit 2019. Qëllimi i auditimit në DPT ka qenë vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si dhe shfrytëzimin me efencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 4000 dhe ISSAI 1315), dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Fushëveprimi i auditimit ka qenë auditimi i veprimtarisë së këtij institucioni sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e auditimit si dhe çështjeve të tjera të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i gjykon të rëndësishme për tu bërë publike. Sipas këtyre drejtimeve fushëveprimi përfshin verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna sipas fushave përkatëse, përputhshmëria në vendimmarrje nga organet drejtuese të DPT me aktet ligjore në fuqi, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, rregullshmëria e zbatimit të kuadrit ligjor për mirëmenaxhimin e skemës së rimbursimit, analiza dhe vlerësimi i procedurave të prokurimeve, vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, administrimi i burimeve njerëzore etj. Gjithashtu një vëmendje e posaçme nga ana jonë i është kushtuar transparencës me tatimpaguesit dhe me publikun në tërësi.

I.2 Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhja e gjetjes	Referenca me RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	Metodologjia aktuale që DPT përdor për shpërndarjen e planit të të ardhurave, bën një ndarje mekanike të tij, bazuar vetëm në historikun e peshës specifike të secilës DRT, pa përfshirë faktorë të tillë si: struktura e tatimpaguesve sipas llojit, ndryshimet në statusin e tyre, problematikat në lidhje me mbledhjen e të ardhurave dhe borxhit tatimor që këto drejtori mbartin, në raport kjo dhe me kapacitetet në dispozicion të secilës DRT	B.1	E lartë	Komiteti i Përmbyshjes, në përputhje me parimet e administrimit tatimor për arritjen e efijencës dhe efektivitetit të duhur, nëpërmjet strukturave përgjegjëse në DPT, të vlerësojë metodologjinë e shpërndarjes së planit të të ardhurave tatimore dhe kontributeve për çdo Drejtori Rajonale Tatimore, me qëllim përmirësimin e saj në funksion të një shpërndarje të drejtë të planit dhe në raport me mjedisin e biznesit ku DRT-re operojnë, ndryshimet që ato pësojnë si dhe burimeve njerëzore që këto drejtori kanë në dispozicion
2.	Disa ndryshime të legjislacionit tatimor janë bërë jo në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale	B.1	E lartë	MFE dhe DPT, të marri masa për të respektuar afatet ligjore të parashikuara në lidhje me ndryshimet

	të parashikuara në Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ndryshuar, duke mos i dhënë kohën e duhur për informim dhe sqarim tatimpaguesve që preken nga këto ndryshime, për të siguruar në vijim vlefshmërinë dhe saktësinë e deklarimeve.			në legjislacionin tatimor të cilat parashikohen se do të kenë një efekt në arkëtimin e të ardhurave buxhetore për vitin pasardhës. Këto në funksion të informimit në kohë të tatimpaguesve si dhe të një vlerësimi sa më të drejtë të impaktit të këtyre ndryshimeve në planin e të ardhurave tatimore. Në vijim, për çdo ndryshim ligjor DPT duhet të përgatisë jo vetëm njoftimet informuese por edhe dokumente sqaruese për tatimpaguesit me qëllim zbatimin e saktë të këtyre ndryshimeve nga ana e tyre.
3	Mungesë e kontrolleve dhe masave eficiente për monitorimin DRT-ve në aplikimin e gjobave në mënyrë të plotë dhe barabartë për të gjithë tatimpaguesit debitorë për kështet e parapagimit të tatim fitimit në kundërshtim me nenin 12 dhe 30 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.	B.3	E lartë	Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT duhet menjëherë të evidentojë për çdo DRT rastet në numër dhe vlerë gjobash të pa aplikuar, duke identifikuar inspektorët përgjegjës për çdo rast si dhe të vendosi sistemet e nevojshme të kontrollit për evidentimin dhe raportimin periodik me qëllim shmangien në të ardhmen të shkeljes së konstatuar. Titullari i DPT të urdhërojë ngritjen e një grupi pune për identifikimin dhe evidentimin e procedurave që ekzekutohen manualisht në sistemin C@TS, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së kontrolleve të aplikacionit në formën e njoftimeve automatike sinjalizuese dhe raporteve të posaçme, plotësimin e gjurmës së auditimit si dhe çdo masë tjetër të nevojshme për sigurimin e zbatimit të ligjit në përputhje me parimet e shprehura në të “ <i>për zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore</i> ”;
4	Në sistemin C@TS, detyrimet e 158 subjekteve që janë ende në proces gjyqësor u konstatuan 62 subjekte, gjendja debitorë në kohë reale (Korrik 2019) e të cilëve nuk pasqyron detyrimet	B.3	E lartë	DPT me strukturat e saj përgjegjëse: Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike të urdhërojë menjëherë verifikimin për identifikimin e plotë të numrit të subjekteve në proces gjyqësor dhe vlerën e detyrimit respektiv të

	për të cilat subjekti është ende në proces gjyqësor ¹ .			regjistruar në C@TS nga inspektorët e kontrollit por të kundërshtuar nga subjekti.
5	Nga auditimi i të dhënave për tatimpagues të cilët kanë nivelin më të lartë të pagesave me këste, u konstatuan vlera të pasakta të deklarimit të stokut si dhe mos deklarim i shumës së TVSH së miratuar, aprovuar për kompensim, shumë që mbetet për tu përdorur në periudhat e ardhshme. Bazuar sa më lart, vlera e stokut të deklaruar nga DPT në shumën 11,251,390 mijë lekë është e nënvlerësuar me të paktën 3,526,472 mijë lekë duke sjellë kështu një vlerësim të stokut të TVSH-së së rimbursueshme në datën 31.12.2019 në rreth 14,777,862 mijë lekë.		E lartë	Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, të marri masa të menjëhershme për përmirësimin e Rregullores së TVSH-së ku të pasqyrohen dhe saktësohen hapat procedural te mbajtjes së detyrimeve te papaguara dhe të krijuara rishtazi për evidentimin e stokut të TVSH-së si dhe formatin standard i miratuar mbi raportimin e tij, duke përfshirë të gjithë elementët e procesit të rimbursimit të TVSH-së deri në miratimin për pagesë. Deri në përmirësimin e rregullores, për të gjitha kërkesat e pranuar, DRTVSH të dërgojë çdo muaj pranë Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit në DPT, evidencë analitike mbi detyrimet e prapambetura dhe/ose të krijuara rishtazi për shumatat e miratuara të papaguara plotësisht ose pjesërisht të paguara si dhe për shumën e kërkuar ende të pa miratuar nga organi tatimor për rimbursimin e kërkuar.
6	Gjendja kreditore në sistemin C@TS në 31.12.2019 është 14,150,843 mijë lekë, tepriçë që i takon rreth 12,400 subjekteve. Teprica kreditore për tatim fitimin vazhdon të mbetet e lartë dhe gjatë vitit 2019 edhe pse rezultoi të ketë ndryshuar me vetëm 1 miliard lekë (pakësim) krahasuar me fund vitin 2018. Për tatimin mbi fitimin, kompensimi duhet të bëhet brenda muajit të parë që pason muajin në të cilin personi i tatueshëm rezultoi me kredi	B.3	E lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me strukturat e saj përgjegjëse të kryej menjëherë verifikimin e procedurave të ndjekura për rastet e rimbursimit të shumave kreditore të tatimit mbi fitimin, për vlerësimin e vlefshmërisë dhe saktësisë së shumës së rimbursuar subjektit.

¹ Referuar data bazës së çështjeve gjyqësore në proces në shkallën e parë apo të dytë vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore në DPT.

	tatimore por nga të dhënat nuk rezulton që një procedure e tillë të ndodh automatikisht në C@TS.			
7	<p>Plotësimi i deklaratës së tatimit mbi të ardhurat në burim mbart shumë gabime, jo vetëm në klasifikimin e llojit të të ardhurave në rubrikat e gabuara. Kështu janë evidentuar shumë raste të deklarimit të tatimit në burim për qiranë plotësuar në rubrikën “dividend” dhe rrjedhimisht të raportuar në kodin buxhetor të gabuar 7009100.</p> <p>Mungojnë sistemet e kontrollit për verifikimin e saktësisë së deklaratave lidhur me shkallën e duhur tatimore të aplikuar si dhe periudhën tatimore të cilit ky deklarim i përket.</p>	B.4	E lartë	Drejtoria tekniko-ligjore të publikojë një material sqarues në vijim të Udhëzimit nr.12 datë 15.03.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar për të shpjeguar dhe ilustruar plotësimin deklaratës për të ardhurat në burim. DPT në bashkëpunim me MFE të marrë në konsideratë propozimin për ndryshimin e deklaratës për të ardhurat në burim për të shtuar rubrikën “ të ardhura nga veprime me aksionet” për të shmangur kështu raportime të gabuara në llogarinë 7009100
8	<p>Evidencat e raportimit të borxhit janë tepër sintetike dhe mbi to nuk mund të kryhen analiza mbi ecurinë e borxhit dhe efektivitetin e masave në nivel DRT-je. Aq më tepër nuk jepet informacion për borxhin jashtë sistemit², si monitorohet dhe pse shtohet. Nga DMF raportohet se numri i çështjeve në proces gjyqësorë është 1525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen se aktualisht janë 416 çështje gjyqësore në proces, me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë.</p>	B.3	E lartë	DPT me strukturat e saj përgjegjëse, të urdhërojë ngritjen e një grupi pune me objektiv rakordimin e të dhënave për borxhin tatimor të raportuar, konsideruar këtu të gjitha problematikat e trajtuara në këtë auditim në lidhje me saktësinë e detyrimeve të subjekteve të lindura nga aktet administrative, procedurat e anulimeve/sistemeve, vlerën e borxhit të pritshëm nga proceset gjyqësore në proces si dhe evidencat e borxhit të cilësuar “jashtë sistemit”.
9	Konstatohet se detyrimet për vendime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna,	C.1	E lartë	Ekipi i Menaxhimit të programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” dhe Drejtoria e Buxhetit

²Borxhi ekzistues para implementimit të sistemit C@TS në vitin 2015

	<p>në fund të vitit 2018 janë në vlerën 287,615 mijë lekë. Shpenzimet në zërin “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, në Projekt Buxhet janë planifikuar në vlerën 946,790 mijë lekë, duke u rritur më shumë në vlerën 770,000 mijë lekë ose 520% më shumë se planifikimi në fazën e parë të PBA-së. Zëri “Mallra dhe shërbime të tjera në Projekt Buxhet është planifikuar në vlerën 421,741 mijë lekë, duke u zvogëluar me vlerën 271,759 mijë lekë ose 39.2% krahasuar me planifikimin fillestar.</p>			<p>dhe Financës, duhet të marrin masa për identifikimin e drejtë të objektivave dhe produkteve të programit si në kuadër të buxhetimit afatmesëm ashtu dhe në atë të buxhetimit vjetor, me qëllim programimin real të shpenzimeve buxhetore sipas nevojave reale të institucionit, duke orientuar përdorimin e shpenzimet publike drejt efijencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit.</p>
10	<p>Në pasqyrat financiare të konsoliduar të DPT-së, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në shumën 404,781 mijë lekë dhe pasqyron vlerën e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna si dhe detyrimet e prapambetura në vlerën 140 mijë lekë të raportuara nga DRT Vlorë. Nga auditimi është konstatuar se vlera e paraqitur në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk është e saktë dhe e plotë, pasi në të nuk mungojnë minimalisht vendimet gjyqësore të formës së prerë për tatimpaguesit të cilët nuk janë kontabilizuar si dhe stoku i rimbursimit të TVSH-së, i cili është klasifikuar në llogari 467.</p>	C.2.3	E lartë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa të menjëhershme për raportimin e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të detyrime të prapambetura, të cilat lidhen me detyrimet për vendime gjyqësore përfshirë detyrimet për vendimet gjyqësore për subjektet tatimpaguese, stokun e rimbursimit të TVSH-së si dhe detyrime të tjera të institucionit.</p>
11	<p>Gjatë vitit kalendarik nga kontrolli operacional janë kryer vlerësime për detyrime tatimore për 2,041 kontrole në shumën 9,259,180 mijë lekë duke ulur forcën zbuluese për më pak në shumën 1,332,068 mijë lekë ose rënie 13 %, krahasuar me vitin</p>	B.6	E lartë	<p>Drejtoria e Kontrollit në DPT të rrisë forcën zbuluese duke bërë identifikimin e gabimeve në vlerësimin nga kontrolli tatimor bazuar në vetë deklarinin e tatimpaguesit duke rritur forcën zbuluese në vlerësim të detyrimeve tatimore dhe arkëtimin e tyre duke</p>

	<p>2018 ku zbulueshmëria ishte në shumën 10,591,249 mijë lekë. Rezultati i ri kontrolleve tatimore të ushtruara nga drejtoritë rajone në 15 raste rezultojnë me zero vlerësim tatimor, rezultat që nuk mbështet analizën e fakteve dhe arsyen e ri kontrollit. Në planin sektorial projekti “Bar & Restorante” nga 100 kontrolle planifikuara janë realizuar 48 kontrolle ose 48% e totalit me vlerësim tatimor në shumën 26.349 mijë lekë, duke mbetur pa realizuar 52 subjekte tatimor ose 52% e kontrolleve me risk të moderuar. Nga auditimi rezulton se rezultati pas kontrollit për TVSH-në, në shumë raste vlerësimi tatimor është në shuma minimale, e cila bie ndesh me kriteret e thyera sipas analizës së riskut nga DMR baza e përzgjedhjes se tatimpaguesit për kontroll tatimor.</p>			<p>kontribuar në zbatimin e drejtë të ligjit me qëllim rritjen ardhurave tatimore dhe uljen në maksimum të evazionit dhe të shmangies tatimore, sipas kërkesave të Manualit të Kontrollit tatimor dhe Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19 datë 22.02.2017 nenet 116 të tij.</p>
12	<p>Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në DPT ka shfaqur probleme në drejtim të: mungesës së harmonizimit të akteve dhe dispozitave që rregullojnë kryerjen e aktivitetit të njësisë (rregullores dhe strukturës së miratuar); mos hartimit të dokumenteve që vlerësojnë cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme (Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm); mos hartimit dhe mos dokumentimit të gjurmëve të auditimit si instrumente menaxhimi.</p>	F.1	E lartë	<p>Titullari i Institucionit të marrë masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar, vendosjen e rregullave dhe procedurave të qarta dhe efektive, zhvillimin e dedikuar profesional të stafit menaxhues, në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe menaxhimit të sistemit buxhetor, duke synuar eliminimin e dobësive të shfaqura në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.</p>
	<p>Veprimtaria e kryer nga Drejtoria e Auditimit të</p>	F.2	E lartë	<p>Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masat që, nëpërmjet</p>

	Brendshëm gjatë vitit 2019 për sa i përket rolit dhe misionit për të cilin është krijuar dhe funksionon kjo drejtori, rezulton jo në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 5 të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,			planifikimit vjetor dhe strategjik, të orientojë veprimtarinë e DAB në përputhje me rolin dhe misionin për të cilin është krijuar dhe funksionon kjo strukturë dhe nëpërmjet veprimtarisë audituese të vlerësojë dhe të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit e riskut dhe proceset e kontrollit duke përdorur një qasje sistematike dhe të disiplinuar
13	Nga auditimi rezulton se, në fund të vitit 2019, debitorët për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në fund të vitit 2019 rezultojnë në total në shumën 18.7 miliard lekë, prej të cilave 4.2 miliard lekë është debia e vitit 2019, pra 22% e debisë është krijuar gjatë vitit 2019. Në totalin e debisë prej 18,7 miliard lekë rreth 4% e zënë entet publike, me shumën 0.7 miliard lekë dhe 96% e zënë entet private, në shumën 18 miliard lekë.	B.2	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me MFE të iniciojë procesin e hartimit të një strategjie të mirë studiuar, për të mundësuar arkëtimin e borxhit prej 18.7 miliard lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga rreth 422 ente publike dhe rreth 64,000 ente private, duke mbajtur parasysh faktin që, një numër i konsiderueshëm entesh publike kanë pushuar juridikisht së funksionuari (Komunat apo Reparte Ushtarake etj.) dhe ende rezultojnë debitorë ndaj kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
14	Përgjatë vitit 2019, DPT ka kaluar në 2 procese Ristrukturimi, të cilat kanë përfunduar jashtë afateve të përcaktuara ligjore dhe vendimmarrja për transferimet/ri sistemimet e punonjësve nuk është kryer duke u bazuar në kritere të paracaktuara. Në Drejtoritë Rajonale Tatimore konstatohen se disa prej punonjësve nuk kanë kaluar në AKSH edhe pse kanë qenë të strukturave të IT-s, por janë sistemuar në pozicione të tjera brenda strukturave të DRT-ve. Nga 28 punonjës të strukturave të IT-s në Drejtori Rajonale Tatimore, 21 prej tyre kanë kaluar në strukturat e AKSH-it dhe 7 prej tyre janë ri	E.2	E lartë	Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të analizojnë shkaqet e ristrukturimeve të shpeshta me qëllim shmangien e tyre. Të merren masa për krijimin e një strukture organizative të qëndrueshme që garanton mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë në lidhje me pozicionet e punës. 2. Strukturat drejtuese të DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masat për ndërprerjen e delegimeve për pozicionet vakante dhe plotësimin e pozicioneve vakante me vendime emërimi

	<p>pozicionuar në pozicione të tjera brenda Drejtorive, duke ruajtur statusin e nëpunësit civil. <i>Ky është tregues i trajtimeve të favorizuara të punonjësve që janë ri pozicionuar brenda strukturave tatimore dhe atyre që kanë kaluar në strukturat e AKSH-it me kod pune.</i></p> <p>Delegimi kompetencave është një instrument ligjor i parashikuar për t'u përdorur për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për tu përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndërruar në një mekanizëm të përhershëm</p>			
15	<p>Gjatë vitit 2019 janë paguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve shpenzime gjyqësore për ish punonjës, në vlerën 140,101 mijë lekë, vlerë e cilësuar si efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.</p>	E.2,3	E lartë	
16	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2019 mbi planifikimin dhe zbatimin e kontratave të zhvilluara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për llogari të DPT, u konstatua se janë shkaktuar efekte financiare negative në buxhetin e shtetit në vlerën 10,499,400 lekë, për arsye se është zhvilluar procedurë prokurimi mbi nevojat e planifikuara dhe pa fonde buxhetore, mungon planifikimi në Programin Buxhetor Afatmesëm edhe në Ligj Buxheti, si edhe urdhër prokurimet janë të pa vulosura nga dega e thesarit,</p>	D	E lartë	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë të gjitha masat e nevojshme për nxjerrjen e përgjegjëseve, dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës, me qëllim eliminimin dhe parandalimin e problematikave në lidhje me planifikimin buxhetor dhe iniciimin e procedurave të prokurimit të pa mbështetura në fonde buxhetore të cilat kanë shkaktuar efekte financiare negative për buxhetin e shtetit</p>

17	Në 14 raste punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 për periudhën nga data e emërimit të tyre deri në datë 31.12.2019, duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 1,552,000 lekë (prej së cilës 405,000 lekë në vitin 2019), pasi informacioni i dhënë nga ana e DBNJ për DBF, nuk ka rezultuar i plotë dhe i hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. 2. Nga auditimi konstatohet se në 6 raste, dy punonjës (K.M & B.B) janë paguar në total në shumën 110,900 lekë për shërbimet e kryera mbi 100 km jashtë qendrës së punës pa marrë më parë autorizim nga Titullari i Institucionit, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit.	E.1	E lartë	DPT të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 1,552,000 lekë, sa përfituar padrejtësisht nga 14 punonjës, në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes 2 të VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, etj.” 2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 110,900 lekë, përfituar nga punonjësit e sipërcituar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.
----	--	-----	---------	---

I.3 Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Nga auditimi i ushtruar në drejtorinë e përgjithshme të tatimeve në zbatim të programit 333/1 prot. datë 15.04.2020, me objekt “mbi përputhshmërinë” e aktivitetit për periudhën e audituar 01.01.2019-31.12.2019, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, mbi të cilat realizohet veprimtaria, për vitin 2019 janë konstatuar mangësi të sistemeve të kontrollit të brendshëm në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara në misionin e DPT, thyerje të radhës dhe afateve të rimbursimit të TVSH, mos evidentim dhe raportim i plotë i stokut të detyrimeve për TVSH e miratuar, mangësi në funksionin e kontrollit tatimor nga DRT, në plotësimin e vendeve vakante, në zbatimin e vendimeve të gjykatës për rikthimet në punë, delegimet e kompetencave, aktet rregullative të ndryshuara por edhe në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore lidhur me detyrat funksionale të punonjësve të DPT.

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Auditimi është realizuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë

Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Opinion i Grupit të Auditimit mbi përputhshmërinë

Në gjykimin tonë si auditues të jashtëm, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, të identifikuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit janë materiale dhe të përhapura në disa prej strukturave kyçe të kësaj administrate, duke treguar qartë që veprimtaria e DPT nuk garanton plotësisht përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucionit në tërësi. *Si konkluzion*, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një *opinionit të kundërt të përputhshmërisë*³.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000⁴).

Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁵, i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve të vendosura, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), për vitin 2019 janë konstatuar mangësi të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara në misionin e DPT, ka shfaqur problematika në drejtim të mungesës së harmonizimit të akteve dhe dispozitave që rregullojnë kryerjen e aktivitetit të njësisë (rregullores dhe strukturës së miratuar); mos hartimit të dokumenteve që vlerësojnë cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme si dhe në administrimin e të dhënave në sistemin C@TS, këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Struktura e auditimit të brendshëm, përmes aktivitetit të saj nuk ka kontribuar në përmirësimin e mirëqeverisjes, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e proceseve të menaxhimit të riskut dhe mbajtjen e kontroleve të brendshme efektive, duke i vlerësuar në vijimësi ato me qëllim nxitjen e përmirësimit të tyre të vazhdueshëm. Në raportet e auditimit evidentohen mungesa në dhënien e opinionit mbi 5 komponentët e kontroleve të brendshme sipas modelit COSO, si dhe një opinion të përgjithshëm vlerësues mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, këto në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Në lidhje me përputhshmërinë e procesit të rimbursimit të TVSH-së konstatohen mosrespektim të radhës dhe afateve të rimbursimit në 6-mujorin e parë të vitit 2019, në kundërshtim me Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar. Gjithashtu konstatohet se mungon një regjistër i standardizuar i kërkesave për rimbursim në pritje për pagesë, me qëllim

⁴ISSAI 4000 – Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë.

⁵Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

³Opinion i Kundërt, jepet në rastet kur konstatohen anomali materiale dhe të përhapura.

raportimin e saktë dhe të plotë të stokut të TVSH-së, i cili vlerësohet të jetë në rreth 14.77 miliard lekë. Ky regjistër konsiderohet një domosdoshmëri në kushtet kur “pagesat me këste” nuk janë formalizuar në akt-marrëveshje edhe gjatë vitit 2019.

Konstatohet se detyrimet e prapambetura përfshirë detyrimin për TVSH-në e rimbursueshme në shumën 11.25 miliard lekë nuk raportohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në kundërshtim kjo me Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

Debitorët për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në fund të vitit 2019 rezultojnë, në shumën 18.7 miliard lekë, ndërkohë që, gjatë vitit 2019 është krijuar një detyrim i ri në shumën 4.2 miliard lekë, ose sa 22% e totalit të debisë.

Në drejtim të administrimit të burimeve njerëzore konstatohen parregullsi në plotësimin e vendeve vakante prej një kohe të gjatë, delegimet e kompetencave, rishikimet e akteve rregullative por edhe në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore lidhur me detyrat funksionale të punonjësve të DPT. Konstatohet moszbatim i vendimeve gjyqësore për kthimet në vendin e punës me pasoja të konsiderueshme në buxhetin e shtetit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të lidhura me të. Detyrimi i prapambetur në 31.12.2019 për shpenzime të gjyq fitueseve me vendim të formës së prerë për largime të padrejta nga puna është 404,442 mijë lekë.

Konstatohen pamjaftueshmëri e kontrolleve të cilat kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zërin paga, në shumën 1,552,000 lekë (nga e cila 405,000 lekë në vitin 2019) në kundërshtim me VKM-në nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, etj.”, si dhe në zërin shpenzime udhëtim e dieta në shumën 110,900 lekë në kundërshtim me VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Konstatohen mangësi në funksionin e kontrollit tatimor dhe në mbulimin me kontroll nga DRT me një numër kontrollesh tatimore të pakryera dhe mangësi kontrollesh dhe marrjen e masave eficiente nga ana DPT me qëllim sigurimin e saktësisë së raportimeve të njoftim vlerësimeve dhe veprimeve të kryera në C@TS, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar.

Në lidhje me të ardhurat tatimore, mungon një metodologji koherente për shpërndarjen e planit vjetor në Drejtoritë Rajonale Tatimore, mungojnë analizat e mirëfillta me bazë risku të të ardhurave tatimore të realizuara me përfshirjen e të gjithë faktorëve ndikues.

Ndryshimet e shpeshta të titullarëve dhe drejtuesve funksionale si dhe fakti që ndryshimet në strukturën organizative janë finalizuar në Nëntor 2019, kanë bërë që disa iniciativa për përmirësimin e punës të zgjaten në kohë duke mos dhënë efektet e pritura gjatë vitit 2019, vit i cili u mbyll në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, ndër të cilat përmenden: Ligji për procedurat tatimore Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm. Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të regjistrimit, ekzekutimit dhe raportimit në sistemin e thesarit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, më poshtë e emërtuar DPT, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 333/1prot., datë 15.04.2020, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2019 deri në 31.12.2019, me afat auditimi nga data 15.04.2020 deri më

24.07.2020, dhe lloj auditimi “Auditim Përputhshmërie”, i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. V. G, Përgjegjës Grupi,
2. E. K,
3. H. S,
4. B. J,
5. E. H,
6. Xh. Xh

Titulli: Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Marrësi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional dhe i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi; vlerësimin dhe evidentimin e shkeljeve të parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar për miradministrimin e pasurisë shtetërore dhe fondeve publike.

Objekti i auditimit:

Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe kuadrit mbështetës në fuqi për mbledhjen e të ardhurave tatimore si dhe realizimin e aktivitetit në përmbushje të misionit që ka struktura e DPT lidhur me realizimin e këtyre të ardhurave, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2019 deri më 31.12.2019, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive të veçanta në DPT të cilat monitorojnë ecurinë e aktivitetit të drejtorive përkatëse në rajone, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore, shpërndarja e tyre në Drejtoritë Rajonale, hartimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor për vitin 2019, transaksionet ekonomike, planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike, monitorimi i masave të marra për mbledhjen e detyrimit tatimor, efektiviteti i strukturave të veçanta si, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria për Rimbursimin e TVSH-së, etj., si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit si delegimi i kompetencave, zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për punonjësit, plotësimi i vendeve vakante, apo përmirësime ligjore të nevojshme, etj.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-Drejtori i Përgjithshëm si (*Nëpunësi autorizues*) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale .

-Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare të aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500, ISA 300*).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI*-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe *ISSAI* 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar,
- Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar;
- Ligji nr.25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareve”;
- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligj nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të

pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore”.

▪ Akte të tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.107, datë 08.09.2017, i ndryshuar referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve dhe akt-verifikimeve të mbajtura si dhe observacioneve të paraqitura për këto akte u përgatit dhe u dërgua në subjekt ky Projekt Raporti i Auditimit.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit me bazë risku të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1. *Kontroll aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

1. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në auditimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

2. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

4-*Intervistimi i personelit* që ka pasur role specifike në subjektin që u auditua.

5-Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

6-Pyetësorë për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është pjesë e Administratës Tatimore Qendrore dhe ndodhet në varësi të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Administrata Tatimore Qendrore është i vetmi autoritet që pranon deklaratat tatimore për tatimet dhe taksat kombëtare, përfshirë deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, veç atyre që parashikohen në ligje të veçanta, vlerëson detyrimet tatimore, kontrollon saktësinë e deklarimit dhe, mbi këto baze, përcakton detyrimet tatimore shtese të një tatimpaguesi, si dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve të paguara tepër, nëse ka të tilla.

DPT drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili ka në varësi të tij tre Zëvendësdyrektorët e Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën, me qëllim realizimin e objektivave të programuara nga Qeveria, duke mbikëqyrur menaxhimin e funksioneve të veçanta në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

Zëvendësdyrektorët e Përgjithshëm mbikëqyrin dhe kanë në varësi aktivitetin e drejtorive si vijon:

1. Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve ka në varësi të tij:

- Drejtorinë e Administratës dhe Prokurimeve;
- Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
- Drejtorinë Ligjore dhe Teknike;
- Drejtorinë e Marrëdhënieve të Koordinimit dhe Nderinstitucionale;
- Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit.

2. Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve ka në varësinë e tij:

- Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut
- Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve;
- Drejtorinë e Kontrollit Tatimor; - Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë.
- Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së.

3. Zv/Drejtori i Përgjithshëm Territorial ka në varësi të tij:

- Drejtorinë e Hetimit Tatimor;
- Drejtorinë Rajonale;
- Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj;
- Qendrën e Pagesave;
- Qendrën e Thirrjeve.

Përgjegjësitë dhe funksionet e DPT pasqyrohen qartë në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.24 datë 02.09.2008, përkatësisht pika 14.2 “Administrimi Tatimor”, ndërsa detyrat përkatëse sipas funksioneve në DPT përcaktohen në Rregulloren “Për funksionimin”, miratuar së fundi me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19 datë 22.02.2017.

Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1,569 punonjës, duke e renditur Administratën Tatimore si një nga institucionet ligjzbatuese më të rëndësishme në vend.

Funksionet kryesore të punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë si më poshtë:

1. Administron detyrimet tatimore në Republikën e Shqipërisë në nivel qendror për llojet e tatimeve dhe taksave të përcaktuara në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të përcaktuara me ligjin nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Përgatit dhe miraton planin strategjik të objektivave dhe synimeve kryesore të administratës tatimore qëndrore për një periudhë afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë si edhe monitoron zbatimin rigoroz të tij nga të gjitha drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nga të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore.
3. Evidenton nevojat për ndryshime dhe paraqet propozimet përkatëse në Ministrinë e Financave, lidhur me ndryshimet në ligjet tatimore, në aktet nën-ligjore të nxjerra në zbatim të tyre, në procedurat tatimore dhe gjithë elementët e tjerë që kanë të bëjnë me administrimin e tatimeve.
4. Përgatit dhe miraton procedura standarte pune operative. Në këtë drejtim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sigurohet se këto procedura promovojnë transparencën e duhur në marrëdhëniet e administratës tatimore me tatimpaguesit, krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë tatimpaguesit dhe reduktojnë subjektivitetin e punonjësve tatimorë.
5. Ofron asistencë për të siguruar zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor, akteve nën-ligjore në zbatim të tij dhe manualeve operationale në Drejtoritë Rajonale Tatimore.
6. Përcakton, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil, masa uniforme për matjen e performancës së punonjësve të administratës tatimore dhe krijon raporte standarte për të kontrolluar vlerësimin e performancës në nivel kombëtar, si dhe për çdo Drejtori Rajonale Tatimore. Ndjek zbatimin e kërkesave të Kodit të Etikës për Administratën Tatimore Qëndrore.
7. Siguron shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore në çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
8. Bashkëpunon me të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, për të përgatitur plane vjetore pune, bazuar në numrin e personelit që është përcaktuar për çdo drejtori dhe në objektivat funksionale të performancës për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
9. Harton dhe zbaton një program vjetor të vizitave të punës në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, për të ofruar asistencë dhe për të kryer vlerësime, lidhur me efikasitetin dhe cilësinë e punës së kryer.
10. Përgatit raporte të vlerësimit të punës për secilën Drejtori Rajonale Tatimore.
11. Miraton planin vjetor të punës dhe planin e të ardhurave tatimore për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
12. Përcakton planin e buxhetit të çdo Drejtorie Rajonale Tatimore dhe kontrollon zbatimin e tij.
13. Përgatit marrëveshje të përbashkëta për të koordinuar punën me shoqatat e biznesit dhe me autoritete të tjera shtetërore, të tilla si: Doganat, Thesari, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, njësitë e qeverisjes vendore, etj., lidhur me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, në interes të administrimit tatimor.
14. Koordinon marrëdhëniet ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me administratat tatimore të shteteve të tjera.
15. Zbaton një politikë rekrutimi të punonjësve tatimorë në zbatim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligjin nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, në përputhje me strukturat e miratuara.
16. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Kodit të Etikës për punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me rregullat e etikës së administratës publike.

17. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore për parandalimin e konfliktit të interesit të nëpunësit të Administratës Tatimore qendrore.

DREJTIMI B: Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore dhe krahasimi i treguesve

B1. Programimi i të ardhurave tatimore të vitit 2019, detajimi i planit fillestar, ndryshimet dhe cikli i miratimit të tyre, nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore dhe nënligjore.

Për periudhën objekt auditimi, në lidhje me programimin e të ardhurave tatimore për vitin 2019, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit ku konstatohet se plani i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, të mbledhshme në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është përcjellë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) në nivel vjetor dhe mujor, në referencë të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 5; Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, neni 39 dhe Ligjit nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për Buxhetin e Vitit 2019”, me shkresat:

- “Plani i të ardhurave për administratën tatimore për vitin 2019” me nr.1577 prot., datë 30.01.2019, protokolluar në DPT me nr.2359 prot., datë 31.01.2019
- “Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” me nr.1584 prot., datë 30.01.2019, protokolluar ne DPT me nr.2378 prot., datë 01.02.2019
- “Mbi taksën nacionale të tjera” për vitin 2019 me nr.1586 prot., datë 30.01.2019, protokolluar në DPT me nr.2379 prot.(mungon data).

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe intervistat me drejtues të DPT, rezulton se në asnjë ndryshim nga vitet e kaluara, ky plan ndërtohet dhe propozohet nga MFE-Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, e cila disponon dhe ndjek një metodologji të caktuar për planifikimin e të ardhurave tatimore dhe doganore. Në këto kushte, në gjykimin e audituesit u shqyrtua relacioni i Projekt-Ligjit për Buxhetin e vitit 2019⁶ ku referohet se metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të programimit, të sugjeruara dhe aplikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë dhe tatim. Modelet bazë të përdorura janë: *Parashikimet makroekonomike*; *Modeli bazuar në analizën e 60-grup produkteve kryesore në import dhe Analizën e Serive Kohore*; *Modeli bazuar në koeficientin e elasticitetit “Buoyancy” dhe “Effective Tax Rate” për çdo taksë*. Specifikisht për Buxhetin e vitit 2019, **programimi bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin.**Faktorët e marrë në konsideratë, krahas kuadrit makroekonomik, të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2019 janë efektet e politikave fiskale si:

⁶ [ëëë.financave.gov.al/buxheti](http://www.financave.gov.al/buxheti)

Politika fiskale e parashikuar	Efekti i parashikuar	Referenca ligjore
Propozohet reduktim i normës së dividendit nga 15% në 8% , që vlerësohet të ketë impakt pozitiv, kjo i ofrimit të incentivës për zbatimin e kësaj norme të reduktuar edhe për fitimet e pashpërndara por të akumuluar apo të kapitalizuara të viteve të kaluara.	4.50 miliard lekë	1) AN nr.10, datë 18.12.2019 Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar (të huajt) 2) AN nr.5, datë 30.11.2019 Për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar (donacionet) 3) Udhëzim nr.12, datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar (formulari i deklarimit të tatim fitimit) 4) Udhëzim nr.4 datë 21.2.2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.5 datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar (burimi i të ardhurave)
Propozohet ulje e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, nga 130.000 lekë/muaj në 150.000 lekë/muaj , që taten me normën 13%. Nëpërmjet kësaj mase synohet të ulet barra tatimore për rreth 15.400 punëmarrës.	-0.30 miliard lekë	
Ndryshime në Ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” vlerësohet të sjellin një efekt prej -0.3 miliard lekë në të ardhurat e buxhetit të shtetit, por që parashikohet të sjellin efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që preken.	-0.30 miliard lekë.	1) Vendim nr.12 datë 9.1.2019 ndryshim në VKM nr.953 dt. 29.12.2014 “Për TVSH në RSH” (përfshijet makineritë bujqësore). 2) AN nr.4, datë 30.11.2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “për TVSH në RSH”, të ndryshuar (përfshijet). 3) UDHËZIM Nr. 5, datë 22.2.2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, të ndryshuar (ulet shkalla tatimore) 4) Udhëzim nr.34 datë 05.12.2019 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “Për TVSH në RSH”, i ndryshuar (rimbursimi i TVSH për OJF)

Efektet direkte të këtyre politikave fiskale në total vlerësohen rreth 4miliard lekë ose 0.2% e të ardhurave faktike të realizuara në vitin paraardhës 2018. Ndërkohë, rritja e të ardhurave tatimore (bruto) është parashikuar në nivel prej 7.82% krahasuar me faktin e vitit 2018. Me konkretisht, me miratimin e Ligjit nr.99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”, plani i të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore total (bruto) është 265,871,000 mijë lekë ose 19,294,258 mijë lekë më shumë (+7.82%) se fakti i vitit 2018 ose 18,858,000 mijë lekë më shumë (7.63%) se planifikimi i vitit 2018. Nga të cilat, të ardhurat tatimore janë parashikuar të rriten me 8.56% dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore me 6.53%. Ky nivel rritje, duket të jetë në pothuaj të njëjtin trend të një viti më parë ku rritja vjetore e parashikuar (Plan 2018 vs. Fakti 2017) ishte 8.1%. Detajimi i planit të vitit 2019 sipas llojit të të ardhurave tatimore paraqitet në tabelën në vijim:

Në mijë lekë

	Lloji i te ardhurave	Fakt 2017	PLANI 2018	Rritja 2018 vs. 2017	Fakt 2018	PLANI 2019	Plan2019 vs. Fakt2018		Plan2019 vs. Plan2018	
							+/-	%	+/-	%
A	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	228,577,581	247,013,000	8.1%	246,576,742	265,871,000	19,294,258	7.82%	18,858,000	7.6%
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	145,760,105	159,113,000	9.2%	157,798,662	171,300,000	13,001,338	8.56%	11,687,000	7.6%
	<i>Nga te cilat:</i>									
1	Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	48,935,239	53,160,000	8.6%	50,903,912	57,500,000	6,596,088	12.96%	4,340,000	8.1%
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	35,044,454	38,160,000	8.9%	36,507,129	38,500,000	1,992,871	5.46%	340,000	0.8%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	13,890,786	15,000,000	8.0%	14,396,783	19,000,000	4,603,217	31.97%	4,000,000	26.6%
2	Tatim mbi Fitimin	31,599,398	33,823,000	7.0%	34,413,962	33,500,000	(913,962)	-2.66%	(323,000)	-0.9%
3	Të Ardhura Personale	32,144,054	36,800,000	14.5%	36,575,099	41,900,000	5,324,901	14.56%	5,100,000	13.8%

4	Taksat Nacionale	12,418,438	13,080,000	5.3%	12,654,138	15,400,000	2,745,862	21.70%	2,320,000	17.74%
5	Taksa Qarkullimi Rrugor	15,155,586	16,450,000	8.5%	18,347,259	21,000,000	2,652,741	14.46%	4,550,000	14.46%
6	Lojrat e Fatit	5,349,807	5,800,000	8.4%	4,614,389	2,000,000	(2,614,389)	-56.66%	(3,800,000)	-65.52%
8	Denimet Administrative	157,582	0		289,902	0				
C	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	131,869,319	144,113,000	9.3%	143,401,879	152,300,000	8,398,121	6.21%	7,687,000	5.68%
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	82,817,476	87,900,000	6.1%	88,778,080	94,571,000	5,792,920	6.53%	6,671,000	7.59%
	- Tarifa jo Tatimore				3,811,476	0	302,618	7.94%		
E	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	214,686,795	232,013,000	8.1%	232,179,959	246,871,000	14,691,041	6.33%	14,858,000	6.40%

Burimi: DPT-Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit

Të analizuara sipas zërave struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

- TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore me 30% të totalit të ardhurave tatimore edhe pse me një rënie prej 2% nga viti 2018 (32%).
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale përbën 28% të totalit të ardhurave tatimore ose 5% më shumë se viti 2018 (23%) përfshirë këtu dhe impaktin e lehtësimit fiskal për të ardhurat nga dividendi.
- Tatimi mbi Fitimin zë 22% të të ardhurave tatimore me asnjë ndryshim nga viti 2018 (22%).
- Taksa e qarkullimit rrugor me 12% të të ardhurave tatimore ose 10% më pak se viti 2018(22%).

Analizuar sipas zërave të të ardhurave, trendi rritës i parashikuar duket të jetë mbështetur në:

-Parashikimin në rritje të të ardhurave nga TVSH në shumën 57.5 miliardë lekë ose 6.5 miliard lekë ose +12.96% mbi faktin e vitit 2018, parashikim ky optimist konsideruar që ky zë rezultoi me mosrealizim në vitin 2018 (51 miliard lekë nga 53 miliard lekë të parashikuar). Sipas relacionit të projekt buxhetit kjo rritje është parashikuar me *arsyetimin e rritjes ekonomike dhe përmirësimit të luftës ndaj informalitetit*, por që realizimi faktik prej 49.4 miliard lekë, në vlera edhe më të ulta se fakti i vitit 2018 nuk e mbështet këtë arsyetim.

-Tatimi mbi të ardhurat personale me një parashikim prej 5.3 miliard lekë ose +14.56% në të njëjtin trend me vitin 2018 ku vetëm nga ndryshimi (lehtësimi) i shkallës tatimore mbi dividendin për fitimit e pashpërndarë ndër vite do të arkëtoheshin rreth 4.5 miliard lekë.

-Impakti negativ prej 3.8 miliard lekë ose -65.52% i të ardhurave tatimore nga lojrat e fatit, kompensuar me një parashikim në rritje mbi trendin rritës të zërit:

-taksave kombëtare me +17.74% rritje krahasuar me 5.3% rritje në vitin 2018,

-taksës së qarkullimit rrugor 14.46% rritje krahasuar me 8.5% rritje në vitin 2018.

Gjatë vitit 2019, ka pasur vetëm një rishikim plani buxhetor me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019 përcjellë nga MFE me shkresën nr.19183/2 datë 22.11.2019 protokolluar në DPT me nr.21474 dt.25.11.2019. Ky ndryshim konsiston në uljen e të ardhurave tatimore në zërin “Tatimi vlerës së shtuar (bruto)” nga 57,500,000 mijë lekë në 57,000,000 mijë lekë ose 500,000 mijë lekë më pak. Edhe pse deri në këtë moment, sipas të dhënave të realizimit të të ardhurave tatimore për 9- muhorin ky zë ishte me mosrealizim 6.8 miliard lekë, po ashtu edhe të ardhurat nga taksat nacionale dhe taksat e qarkullimit rrugor raportoheshin me mosrealizim prej 3.8 miliard lekë:

Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	Fakt 9m-2018	Fakt 9m- 2019	Plan 9m-2019	Diferenca
	116,987,830	127,506,000	124,597,468	(2,908,532)
Nga te cilat:				

Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	37,797,100	42,709,000	35,902,797	(6,806,203)
Tatim mbi Fitimin	24,327,957	24,649,000	27,110,833	2,461,833
Ardhura Personale	28,053,969	31,531,000	37,439,747	5,908,747
Taksat dhe Tarifa Nacionale	9,399,397	11,374,000	9,387,457	(1,986,543)
Taksa Qarkullimi Rrugor	13,343,613	15,750,000	13,907,325	(1,842,675)
Lojrat e Fatit	3,853,629	1,493,000	682,416	(810,584)
Denimet Administrative	212,165	0	166,894	166,894

Gjetja	Kontributi i DPT në planifikimin e të ardhurave tatimore konsiston vetëm në paraqitjen e statistikave mbi të ardhurat tatimore të realizuara të cilat përgatiten në formate standarde, në nivel tepër sintetik, të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin apo mosrealizimin të ardhurave tatimore, në zbatim të misionit të saj si dhe burimeve të vëna në dispozicion.
Situata	<p>Për Buxhetin e vitit 2019, programimi i të ardhurave tatimore bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin. Faktorët e marrë në konsideratë, krahas kuadrit makroekonomik, të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2019 janë efektet direkt të disa politikave fiskale të cilat vlerësohen rreth 4 miliard lekë ose 0.2% e të ardhurave faktike të realizuara në vitin 2018. Bazuar në këta tregues, me miratimin e Ligjit nr.99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”, plani i të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore total (bruto) është 265,871,000 mijë lekë ose 19,294,258 mijë lekë më shumë (+7.82%) se fakti i vitit 2018 ose 18,858,000 mijë lekë më shumë (+7.63%) se planifikimi i vitit 2018, nga të cilat, të ardhurat tatimore janë parashikuar të rriten me 8.56% dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve rriten me 6.53%. Ky nivel rritje, duket të jetë në pothuaj të njëjtin trend të një viti më parë ku rritja vjetore e parashikuar ishte 8.1%. Analiza e strukturës së planit të të ardhurave tatimore tregon se TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore me 30% të totalit të ardhurave tatimore; Tatimi mbi të Ardhurat Personale përbën 28% të totalit të ardhurave tatimore parashikuar me një rritje prej 5% se viti 2018 (23%) përfshirë këtu dhe impaktin e lehtësimit fiskal për të ardhurat nga dividendi me impakt në arkëtime prej rreth +4.5 miliard lekë. Një nga zërat që është parashikuar në ulje në krahasim me planin e një viti më parë por edhe me të ardhurat faktike të realizuara, është zëri “të ardhura nga tatim fitimi” me 33.5 miliard lekë krahasuar me 34.4 miliard lekë realizuar në vitin 2018. Në relacion nuk gjejmë bazë për një planifikim në ulje të këtij zëri. Ky planifikim rezulton të jetë më i ulët edhe nga parashikimet e arkëtimeve të vetë Drejtorive Tatimore Rajonale parashikuar me rreth 35 miliard lekë. Gjatë vitit 2019, ka patur vetëm një rishikim plani buxhetor me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019 përcjellë nga MFE me shkresën nr.19183/2 datë 22.11.2019 protokolluar në DPT me nr.21474 dt.25.11.2019. Ky ndryshim konsiston në uljen e të ardhurave të tatimore në zërin “Tatimi vlerës së shtuar (bruto)” nga 57,500,000 mijë lekë në 57,000,000 lekë ose 500,000 mijë lekë më pak. Edhe pse deri në këtë moment, sipas të dhënave</p>

	<p>të realizimit të të ardhurave tatimore për 9- mujorin ky zë ishte me mosrealizim 6.8 miliard lekë, po ashtu edhe të ardhurat nga taksat nacionale dhe taksat e qarkullimit rrugor raportoheshin me mosrealizim prej 3.8 miliard lekë. Në vijim, në muajt Nëntor dhe Dhjetor 2019 të ardhurat nuk janë rishikuar për të marrë parasysh ndonjë efekt negativ të mundshëm për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpallur më 27.11.2019, të ardhurat tatimore dhe kontributet gjatë këtyre dy muajve u realizuan 3.2 miliard më pak se plani dhe impaktet negative të pritshme u menaxhuan me kontroll dhe limitim të shpenzimeve buxhetore referuar urdhrin të Ministres së Financave dhe Ekonomisë nr.21920 datë 03.12.2019. Gjithashtu, në të njëjtën periudhë nuk rezulton që të jetë përcjellë nga MFE ndryshime të planit të TVSH së rimbursueshme e cila në muajin dhjetor rezulton me një tejkalim prej 5 miliard lekë. Në konkluzion, në lidhje me programimin e të ardhurave tatimore vjetore, pavarësisht se ky proces është i centralizuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nuk mund të mos ketë dhe një kontribut nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si një palë aktive e procesit të planifikimit të të ardhurave tatimore dhe diskutimit të politikave fiskale që ndikojnë në to. Kontributi i DPT-së, si një strukturë e ngarkuar për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, nuk mund të konsistojë vetëm në përgatitjen e evidencave statistikore të cilat përgatiten dhe paraqiten në nivel tepër sintetik.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar. Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”; Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.37 datë 19.12.2019 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit 2019”; Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël” i ndryshuar; Udhëzim nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar; Udhëzim nr.4 datë 21.2.2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.5 datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar; Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Udhëzim nr.10, datë 15.3.2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, të ndryshuar;</p>

	Akti Normativ nr.2 datë 02.10.2019, “Për disa ndryshime Ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Planifikim më i drejtë i të ardhurave tatimore bazuar në analizë faktorësh, në korrelacion me burimet njerëzore dhe strategjitë për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe bazuar në parimet e administrimit tatimor ⁷
Rëndësia	I Lartë

B.1.2 Plani i të ardhurave sipas Drejtorive Rajonale Tatimore

Plani i miratuar për të ardhurat tatimore për vitin 2019 detajohet dhe miratohet nga Komiteti i Përbushjes i krijuar në zbatim të urdhërit nr.16 datë 02.03.2018 “Për ngritjen e komiteteve të menaxhimit të drejtimit të DPT” i cili me vendimin nr.21 Datë 21.02.2019(firmosur me delegim vetëm nga ish-zv/drejtori z.C) ka miratuar dhe planin e të ardhurave tatimore për vitin 2019 për cdo Drejtori Rajonale Tatimore, përcjellë me shkresën nr.2259/1 datë 01.03.2019. **Nga auditimi konstatohet se për shpërndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie është zbatuar e njëjta metodologji, mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT dhe peshën specifike të secilës drejtori në totalin e të ardhurave tatimore. Më konkretisht, plani i ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shpërndahet bazuar në Metodologjinë e shpërndarjes së planit në nivel DRT vënë në dispozicion nga Drejtoria e Analizës dhe Statistikës, bazuar në përqindjet historike që zenë të ardhurat e realizuara në raport me totalin e arkëtimeve të tre viteve të fundit, për secilin zë të të ardhurave. Arkëtimet faktike të Drejtorive Rajonale korrigjohen me listën analitike të tatimpaguesve që transferohen nga DRT te DTM dhe anasjelltas si dy DRT me peshë më të lartë në numrin dhe madhësinë e subjekteve që kanë nën administrim dhe rrjedhimisht me kontributin më të lartë në totalin e të ardhurave tatimore. Më pas, projektplanin dërgohet për shqyrtim, ndryshim dhe miratim në mbledhjen e Komitetit të Përbushjes dhe më tej për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm, procedurë kjo e ndjekur ndër vite nga DPT.**


Pesha specifike e cdo DRT në arkëtimin e të ardhurave tatimore, sipas të dhënave të vëna në dispozicion, paraqitet në tabelën në vijim ku DRT e Tiranës dhe ajo e Tatimpaguesve të Mëdhenj zënë përkatësisht 36.3% dhe 43.4% të të ardhurave të vitit 2019. Duke qenë se pesha specifike e çdo drejtorie rajonale shërben më pas edhe si tregues bazë në shpërndarjen e të ardhurave vjetore të miratuara nga Komiteti i Përbushjes në DPT, u analizuan dhe realizimet faktike të çdo DRT-je, dhe pesha specifike për tre vitet e fundit 2016-2018, paraqitur në tabelën në vijim:

	v.2016 %	v.2017	Pesha specifi ke %	v.2018	Pesh aspe cifik e %	v.2019	Pesh aspec ifike %	Rritja/Ulj a
D.P.T TOTAL (bruto)		228,577,580		246,576,742		259,461,414		
D.R. Tatimore Berat	1.5%	3,349,008	1.5%	3,461,022	1.4%	3,835,215	1.5%	0.1%
D.R. Tatimore Dibra	1.3%	3,185,687	1.4%	3,622,235	1.5%	3,422,034	1.3%	-0.2%
D.R. Tatimore Durresi	5.5%	12,637,135	5.5%	14,361,273	5.8%	15,415,772	5.9%	0.1%
D.R. Tatimore Elbasani	2.7%	6,158,086	2.7%	6,341,982	2.6%	7,016,795	2.7%	0.1%
D.R. Tatimore Fieri	3.1%	7,221,348	3.2%	9,800,359	4.0%	9,237,979	3.6%	-0.4%

⁷Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 12

D.R. Gjirokastra	Tatimore	1.1%	2,478,656	1.1%	2,687,574	1.1%	2,861,006	1.1%	0.0%
D.R. Tatimore Korca		2.3%	5,144,981	2.3%	5,458,978	2.2%	5,919,050	2.3%	0.1%
D.R. Tatimore Kukesi		0.8%	1,840,929	0.8%	2,004,154	0.8%	2,165,657	0.8%	0.0%
D.R. Tatimore Lezha		1.5%	3,252,721	1.4%	3,533,696	1.4%	3,894,640	1.5%	0.1%
D.R. Tatimore Saranda		0.7%	1,580,661	0.7%	1,942,900	0.8%	2,265,716	0.9%	0.1%
D.R. Tatimore Shkodra		2.3%	5,350,411	2.3%	5,771,421	2.3%	5,992,155	2.3%	0.0%
D.R. Tatimore Vlora		2.1%	4,700,141	2.1%	5,134,027	2.1%	5,535,106	2.1%	0.1%
D.R. Tatimore Tirana		43.3%	83,153,576	36.4%	88,097,485	35.7%	96,635,051	37.2%	1.5%
D. T.M		31.9%	88,524,240	38.7%	94,359,636	38.3%	95,265,237	36.7%	-1.6%

Nga tabela rezulton se ndryshime në trendin kontribues kemi midis DRT Tiranë dhe DT Mëdhenj konkretisht për DRT nga 43.3% në vitin 2016 në 37.2% në vitin 2019 dhe për DTM nga 31.9% në 36.7% të totalit të arkëtimeve. Gjithashtu, edhe DRT Durrës paraqitet me një trend rritës në të ardhurat e arkëtuara nga viti në vit. Përsa i përket Drejtorive të tjera rajonale, vetëm DRT Fier dhe DRT Dibër rezultojnë me një trend të ndryshëm ndër vite ndërsa të gjitha drejtoritë e tjera rezultojnë me një peshë specifike (kontribut) pothuaj konstant ndër vite 2016-2019.




Analizuar sipas numrit të tatimpaguesve aktiv që këto drejtori administrojnë konstatohet se të gjitha drejtoritë kanë ndryshime +/- në numër subjektsh por që jo gjithmonë këto ndryshime reflektohen në uljen apo rritjen e të ardhurave. Numri i tatimpaguesve për cdo DRT⁸ dhe arkëtimet bruto ndër vite paraqiten në tabelën në vijim:

DRT	Viti 2017		Viti 2018		2018/2017		Viti 2019		2019/2018	
	Nr.	Arketim e në mil lekë	2018	Arketim e në mil lekë	Ndryshim i ne nr.	Ndryshim e ne arketime	2019	Arketim e në mil lekë	Ndryshim i ne nr.	Ndryshim e ne arketime
BERAT	4165	3,349	4054	3,461	-111	3%	4044	3,835	-10	11%
DIBER	2281	3,186	2229	3,622	-52	14%	2222	3,422	-7	-6%
DURRES	12794	12,637	12811	14,361	17	14%	13081	15,416	270	7%
ELBASAN	8108	6,158	7857	6,342	-251	3%	7725	7,017	-132	11%
FIER	10099	7,221	9813	9,800	-286	36%	9655	9,238	-158	-6%
GJIROKASTER	2732	2,479	2578	2,688	-154	8%	2548	2,861	-30	6%
KORCE	6256	5,145	6034	5,459	-222	6%	6158	5,919	124	8%
KUKES	1233	1,841	1196	2,004	-37	9%	1236	2,166	40	8%

⁸Sipas Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve

LEZHE	3963	3,253	3954	3,534	-9	9%	3997	3,895	43	10%
SARANDE	2353	1,581	2339	1,943	-14	23%	2598	2,266	259	17%
SHKODER	6410	5,350	6094	5,771	-316	8%	6215	5,992	121	4%
VLORE	5799	4,700	5680	5,134	-119	9%	5875	5,535	195	8%
TIRANE	44484	83,154	45398	88,097	914	6%	47776	96,635	2378	10%
DTM	689	88,524	679	94,360	-10	7%	699	95,265	20	1%
TOTAL	111366	228,578	110716	246,577	110716	8%	113829	259,461	3113	5%

Pavarësisht se ndryshimet në numrin e tatimpaguesve do të kërkonin një analizë më të detajuar duke përfshirë dhe llojin e tatimpaguesit (forma ligjore, sektori i ekonomisë etj.), nga të dhënat rezulton se gjatë vitit 2019 ka një rritje në numrin e tatimpaguesve të regjistruar me 3113 subjekte në rang kombëtar nga të cilat 2378 janë të regjistruar në DRT Tiranë. DRT Dibër, Elbasan, Fier dhe Gjirokastrë vazhdojnë në trend rënës përse i përket numrit të tatimpaguesve që administrojnë, megjithatë në korrelacion me arkëtimet bruto, jo për të gjitha këto drejtori me rënie në numër kanë patur ndikim rënës në të ardhurat e arkëtuara. Grafiku më poshtë:




Referuar metodologjisë së shpërndarjes së planit sipas drejtorive rajonale, u kërkuar parashikimet e arkëtimeve nga cdo Drejtori Rajonale dërguar nga DRT në DPT si dhe nga Drejtoria e Shërbimit të tatimpaguesve është kërkuar numri i tatimpaguesve aktiv sipas llojit të biznesit, i cili rezulton të jetë 113,829 nga të cilët 87,708 biznes i vogël, 23066 biznese të mëdha dhe 3,055 të tjerë.

Sipas propozimeve rezulton se **DRT parashikojnë një nivel arkëtimi prej 254,302,896 mijë lekë ose një mosrealizim prej 11.7 miliard lekë ose 4.35% më pak se të ardhurat e miratuara në total nga MFE**. Në nivel DRT-je, parashikimet e arkëtimeve variojnë nga **-0.9% në +46.4%** ku DRT me parashikimin më optimist janë DRT Durrës me **10.43%** rritje të arkëtimeve krahasuar me faktin e një viti më parë dhe DRT Fier me 46.4 % rritje ndërsa parashikimi më pesimist vjen nga DRT Tiranë me **+2%** dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me **-0.9%**.

Megjithatë, pavarësisht propozimeve të DRT, vendimi final është i Komitetit të Përbushjes i cili ka miratuar “korrigjimet” në parashikimet e pothuaj të gjithë DRT-të (me përjashtim vetëm të propozimit të DRT Sarandë), ngarkon diferencën në arkëtime në planin e DRT Tiranë dhe DTM. Tabela në vijim paraqet parashikimet e cdo DRT, planet e miratuara nga Komiteti i Përbushjes si dhe realizimet faktike të vitit 2019:

Drejtoritë Rajonale	Parashikimi DRT në miliard lekë	Plani miratuar nga Komiteti	Ndryshimet e Komitetit	Realizimi 2019 në miliard lekë	Varianca Plan/Fakt 2019	% specifike	Nr. Punonjësve
Berat	3.42	3.82	+	3.84	+	1.5%	36
Dibër	3.59	3.52	-	3.42	-	1.3%	28
Durrës	15.09	14.51	-	15.42	+	5.9%	90
Elbasan	6.39	6.71	+	7.02	+	2.7%	52
Fier	10.83	9.20	-	9.24	+	3.6%	124
Gjirokastrë	2.88	2.85	-	2.86	+	1.1%	31
Korcë	5.73	6.05	+	5.92	-	2.3%	59
Kukës	2.02	2.21	+	2.17	-	0.8%	18
Lezhë	3.74	3.86	+	3.89	+	1.5%	36
Sarandë	2.00	2.00	0	2.27	+	0.9%	32
Shkodër	6.04	6.09	+	5.99	-	2.3%	93
Vlorë	5.35	5.30	-	5.54	+	2.1%	42
Total rrethet	67.07	66.12	-0.95	67.56	+1.44	26.1%	1105
Tiranë	95.07	103.07	+	96.64	-6.44	37.2%	352
DMT	92.16	96.68	+	95.27	-1.41	36.7%	112
Total Tirana+VIP	187.23	199.75	+12.52	191.90	-7.85	73.9%	464
Total	254.30	265.87	11.57	259.46	-6.41	100%	1569
Deviacioni nga plani	-4.35%			-2.4%			


Në mënyrë grafike, parashikimet e arkëtimeve nga DRT kundrejt planit të miratuar nga Komiteti i Përmbushjes dhe realizimit faktik paraqiten në vijim:



Pavarësisht nga “korrigjimi” i parashikimit të DRT-ve në përputhje me planin total të dërguar nga MFE, plan i të ardhurave tatimore për tu realizuar nga rrethet zë vetëm 25% të planit në rang kombëtar. Nga shifrat e të ardhurave faktike të arkëtuara, rezulton që plani të jetë realizuar pa deviacione të mëdha nga plani i miratuar me përjashtim të DRT Tiranë, DTM dhe DRT Dibër. Vecanërisht, duke qënë se kontributin më të rëndësishëm e ka DRT Tiranë dhe DTM, plani i miratuar për to do të kërkonte një analizë më të thellë faktoriale nga ana e DPT-së jo vetëm duke marrë parasysh numrin e subjekteve të transferuara në fund të periudhës⁹. Nga të dhënat e vëna

⁹Sic, përshkruhet dhe në metodologji, arkëtimet faktike të Drejtorive Rajonale korrigjohen me listën analitike të tatimpaguesve që transferohen nga DRT te DTM dhe anasjelltas.

në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor, bazuar në statusin dhe deklaratimet e muajit Janarit 2019 (për Dhjetorin 2018) dhe Dhjetor 2019, rezultojnë këto lëvizje të subjekteve: nga DRT Tiranë transferohen për te DTM 228 subjekte me qarkullim të deklaruar => se 500 milion lekë (2018) dhe subjektet që merren hidrokaruret, nga DTM në DRT Tiranë 192 subjekte me status aktiv përfshirë këtu dhe subjektet me aktivitet 9271-“lojrat e rastit, llotaria, loja me lekë etj.”. Faktikisht, grup i transferuar në DTM ka deklaruar 40% më pak të ardhura nga viti 2018, ku rreth 60 nga të cilët kanë deklaruar të ardhura nën 500 milion lekë.



Gjetja	Metodologjia aktuale që DPT përdor për shpërndarjen e planit të të ardhurave, bën një ndarje mekanike të tij, bazuar vetëm në historikun e peshës specifike të secilës DRT, pa përfshirë faktorë të tillë si: struktura e tatimpaguesve sipas llojit, ndryshimet në statusin e tyre, problematikat në lidhje me mbledhjen e të ardhurave dhe borxhit tatimor që këto drejtori mbartin, në raport kjo dhe me kapacitetet në dispozicion të secilës DRT
Situata	Nga auditimi konstatohet se për shpërndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie është zbatuar e njëjta metodologji mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT, dhe peshën specifike të secilës drejtori në totalin e të ardhurave tatimore. Paraprakisht DPT kërkon nga DRT-re të dërgojnë parashikimet e arkëtimeve për vitin pasardhës. Sipas këtyre parashikimeve rezulton se DRT-re parashikojnë një nivel arkëtimi prej 254,302,896 mijë lekë ose 11.7 miliard lekë më pak se të ardhurat e miratuara në total nga MFE. Në nivel DRT-re, ata me parashikimin më optimist janë DRT Durrës me 10.43% rritje të arkëtimeve krahasuar me faktin e një viti më parë dhe DRT Fier me 46.4 % rritje, ndërsa parashikimi më pesimist vjen nga DRT Tiranë me +2% dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me -0.9%. Pavarësisht parashikimeve, vendimi për planin e secilës DRT është i Komitetit të Përmbushjes i cili ka bërë dhe “korrigjimet” në parashikimet e pothuaj të gjithë DRT-të (me përjashtim vetëm të propozimit të DRT Sarandë), dhe ngarkon diferencën në planin e DRT Tiranë dhe DTM si dy drejtori me peshën specifike më të lartë respektivisht 36.3% dhe 43.4%. Për sa i përket peshave specifike e të ardhurave të arkëtuara nga secila DRT, rezulton të paraqitet pothuaj në të njëjtat nivele në tre vitet e fundit, përveç DRT Fier dhe DRT Dibër duke bërë që të mos jetë faktor i vetëm përfaqësues për mundësitë në arkëtim dhe rrjedhimisht për një shpërndarje të drejtë të

	<p>planit. Numri i subjekteve që administrojnë çdo DRT duhet të ishte një faktor tjetër për tu marrë në konsideratë në metodologjinë e shpërndarjes së planit. Faktikisht ky faktor merret në konsideratë vetëm për vlerësimin e planit të DTM. Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezulton se nga DRT Tiranë transferohen për te DTM 228 subjekte me qarkullim të deklaruar => se 500 milion lekë (2018) dhe nga DTM në DRT Tiranë 192 subjekte me status aktiv. Faktikisht, për vitin 2019 grupi i transferuar në DTM ka deklaruar 40% më pak të ardhura nga viti 2018. Në fund të vitit 2019, të dy drejtoritë raportojnë mosrealizim të planit, respektivisht DTM me 98.3% dhe DRT Tiranë me 96.2%. Po ashtu, nga të dhënat rezulton se gjatë vitit 2019 ka një rritje në numrin e tatimpaguesve në rang kombëtar të regjistruar me 3113 subjekte nga të cilat 2378 janë të regjistruar në DRT Tiranë. DRT Dibër, Elbasan, Fier dhe Gjirokastrë vazhdojnë në trend rënës për sa i përket numrit të tatimpaguesve që administrojnë, megjithatë në korrelacion me arkëtimet bruto, jo për të gjitha këto drejtori ky fakt ka patur ndikim rënës në të ardhurat e arkëtuara prej tyre. Në konkluzion, kryerja e një analize më tej për shpërndarjen e planit, duke përfshirë një analizë të subjekteve sipas llojit të biznesit, sektorit të ekonomisë ku operon por edhe sipas numrit të punonjësve që çdo drejtori rajonale ka në dispozicion kundrejt të ardhurave që realizon (p.sh. DRT Sarandë krahasuar me DRT Kukës apo DRT Shkodër kundrejt DRT Korçë), do të mundësonte një pamje më të plotë për të vlerësuar nëse ka patur një shpërndarje të drejtë të planit ose jo.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”; Ligj nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.37 datë 19.12.2019 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit 2019”; Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Akti Normativ nr.2 datë 02.10.2019, “Për disa ndryshime Ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	Nuk siguron shpërndarje të drejtë e planit të të ardhurave tatimore në raport me mjedisin e biznesit të DRT-ve dhe burimeve njerëzore në dispozicion.
Rëndësia	I Lartë


B.1.3 Nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore dhe nënligjore. Analiza dhe krahasimi i tyre.

Në përfundim të periudhës ushtrimore, sipas të dhënave të Drejtorisë së Statistikave dhe Kontabilitetit, realizimi i të ardhurave paraqitet si vijon:


	Lloji i te ardhurave	PERIUDHA - 12 MUJORE 2019						
		FAKTET		PLANI ¹⁰	Diferenca PLAN- FAKT		Diferenca 2019 - 2018	
		2018	2019	2019	+ ose -	%	+ ose -	%
A	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	246,576,742	259,461,414	265,371,000	(5,909,586)	-2.23%	12,884,671	5.23%
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	157,798,662	165,294,011	170,800,000	(5,505,989)	-3.22%	7,495,350	4.75%
	<i>Nga te cilat:</i>							
1	Tatimi Vlerës së Shtuar (bruto)	50,903,912	49,456,618	57,000,000	(7,543,382)	-13.23%	(1,447,294)	-2.84%
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	36,507,129	25,947,162	38,000,000	(12,052,838)	-31.72%	(10,559,967)	-28.93%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	14,396,783	23,509,456	19,000,000	4,509,456	23.73%	9,112,673	63.30%
2	Tatim mbi Fitimin	34,413,962	36,484,399	33,500,000	2,984,399	8.91%	2,070,437	6.02%
3	Ardhura Personale	36,575,099	46,226,037	41,900,000	4,326,037	10.32%	9,650,938	26.39%
4	Taksat dhe Tarifa Nacionale	12,654,138	13,211,686	15,400,000	(2,188,314)	-14.21%	557,548	4.41%
5	Taksa Qarkullimi Rrugor	18,347,259	18,754,453	21,000,000	(2,245,547)	-10.69%	407,193	2.22%
6	Lojërat e Fatit	4,614,389	910,263	2,000,000	(1,089,737)	-54.49%	(3,704,126)	-80.27%
8	Dënimet Administrative	289,902	250,556	0	250,556		(39,346)	-13.57%
C	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	143,401,879	141,784,555	151,800,000	(10,015,445)	-6.60%	(1,617,323)	-1.13%
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	88,778,080	94,167,402	94,571,000	(403,598)	-0.43%	5,389,322	6.07%
	- Tarifa jo Tatimore	3,811,476	4,114,093	0			302,618	7.94%
E	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	232,179,959	235,951,958	246,371,000	(10,419,042)	-4.23%	3,771,999	1.62%

Të ardhurat bruto tatimore dhe nga kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën **259,461,414 mijë lekë ose 5,909,586 mijë lekë, dhe 2.23% më pak se plani i rishikuar**. Ky mosrealizim vjen kryesisht nga mosrealizimi i të ardhurave tatimore me -5,505,989 mijë lekë ose -3.22% dhe mosrealizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore me -403.6 milion lekë ose -0.43%. Krahasuar me një vit më parë të ardhurat bruto tatimore dhe nga kontributet janë rritur me 12,884,671 mijë lekë ose me 5.23% respektivisht +4.75% nga rritja e të ardhurave tatimore dhe 6.07% nga rritja e kontributeve të sigurimeve. Në mënyrë grafike realizimi i të ardhurave tatimore sipas zërave për periudhën 2017-2019 paraqitet si vijon, ku vetëm zëri i të ardhurave nga TVSH-ja rezulton me një trend rënës 2019/2018 pavarësisht parashikimeve optimiste për këtë zë:


¹⁰Plani fillestar sipas Ligjit nr.99/2018 datë 03.12.2018 i ndryshuar me Akti Normativ nr.2 datë 02.10.2019, "Për disa ndryshime Ligjin nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019".



Analizuar sipas muajve realizimet mujore paraqiten në grafikun në vijim ku duket se **trendin mujor të realizimit të të ardhurave totale e ka përcaktuar ecuria e realizimit të zërit “të ardhura personale”** me përjashtim të muajit Mars ku tatim fitimi ka dhe peshën kryesore në arkëtime, pasi kjo periudhë përkon dhe me afatet e deklarimit të tatim fitimit të vitit paraardhës.



Për sa i përket realizimit të të ardhurave tatimore sipas Drejtorive Rajonale Tatimore, DRT Sarandë rezultojn me realizimin më të lartë prej 107.33% të planit vjetor të rishikuar ndërsa DRT Dibër me realizimin më të ulët prej 94.37%. Megjithatë, këto dy drejtori zënë një peshë specifike të vogël në totalin e të ardhurave të realizuar me 2.2%. Ndërkohë, dy drejtoritë me impakt të lartë në realizimin e të ardhurave tatimore rezultojnë me mosrealizim, përkatësisht DRT Tiranë me 96.2% dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me 98.31% të planit.



(Tatimet + Rimbursime + Kontribute) sipas DRT	Plan	Fakt	%
D.R. Berat	3,976,000	3,835,215	96%
D.R. Dibra	3,626,000	3,422,034	94%
D.R. Durrësi	15,082,000	15,415,772	102%
D.R. Elbasani	6,915,000	7,016,795	101%
D.R. Fieri	9,449,000	9,237,979	98%
D.R. Gjirokastra	2,893,000	2,861,006	99%
D.R. Korca	6,140,000	5,919,050	96%
D.R. Kukesi	2,204,000	2,165,657	98%
D.R. Lezha	3,970,000	3,894,640	98%
D.R. Saranda	2,111,000	2,265,716	107%
D.R. Shkodra	6,157,000	5,992,155	97%
D.R. Tirana	100,452,000	96,635,051	96%
D.R. Tatimpaguesit e mëdhenj	96,904,000	95,265,237	98%
D.R. Vlora	5,492,000	5,535,106	101%
	265,371,000	259,461,414	98%

Nga analiza sipas llojit të të ardhurave realizimi i tyre për vitin 2019 rezulton:

- **A.Të Ardhurat Tatimore**

Për vitin 2019, të ardhurat tatimore janë programuar në masën 171.3 miliard lekë dhe rishikuar me ulje në 170.8 miliard lekë me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019. Ky rishikim të ardhurash ka prekur vetëm zërin “të ardhura nga TVSH” me -500 milion lekë. Megjithatë, pavarësisht rishikimit të ardhurat tatimore rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 165.29 miliard lekë ose **me mosrealizim prej -3.22% ose 5.5 miliard lekë më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën të ardhurat u realizuan 157.8 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 12.8 miliard lekë ose +5.23% më shumë, megjithatë me një deviacion prej -2.5% nga rritja e parashikuar.

- Analizuar sipas zërave, “**tatimi mbi të ardhurat personale**” duket të jetë zëri më performues gjatë vitit 2019 me një kontribut prej 28% në totalin e të ardhurave tatimore bruto kundrejt 23% në vitin 2018. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale prej **41.9 miliard lekë** janë marrë në konsideratë: rritja ekonomike dhe impakti i saj në nivelin e pagës mesatare; rritja e numrit të të punësuarve, bazuar në ecurinë e vitit 2018; uljen e të ardhurave nga rritja e pragut të taksimit të pagave me tarifën 23%, që vlerësohet në -320 milionë lekë në vit; uljen e normës së tatimit mbi disidentin nga 15% në 8%, përfshirë efektet pozitive që do gjenerohen nga incentiva për shpërndarjen e fitimeve të akumuluar të viteve të kaluara, që vlerësohet në 4.5 miliard lekë. Në fund të periudhës ky zë rezulton me realizim **46.22 miliard lekë ose 10.31% më shumë se plani dhe 26% më shumë se viti 2018.** Ky zë i të ardhurave është shtjelluar më hollësisht në pikën B.4 të programit të auditimit.

- Zëri “**të ardhurat nga TVSH**”, pavarësisht parashikimeve optimiste, rezultojnë me një kontribut në rënie në totalin e të ardhura tatimore me 30% kundrejt 32% në vitin 2018. Në total të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2019 janë **49.45 miliard lekë ose 7.5 miliard lekë mosrealizim ose -13.23% më pak se plani i rishikuar ose -3% më pak se TVSH e arkëtuar në vitin 2018.** Sipas relacionit të Projekt Buxhetit 2019, argumenti për parashikimin në rritje të TVSH ishte “*rritja ekonomike dhe përmirësimi të luftës ndaj informalitetit*”, logjikisht kjo e reflektuar në rritjen e numrit të deklaruesve si dhe në saktësinë e deklarimit.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion, gjatë vitit 2019 rezultojnë 61000 subjekte të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar në përputhje me Ligjin nr.92/2014 “Për tatimin

mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106, nga 58991 subjekte deklarues gjatë vitit 2018 ose rreth 2000 subjekte më shumë. Nga subjektet deklarues, vetëm 10948 prej tyre rezultojnë me TVSH të pagueshme ose rreth 350 subjekte më shumë se një vit më parë. Më hollësisht paraqitur në tabelën në vijim:

Sektori ekonomisë	Nr.	Deklarimi 2018	Debitore 2018 ¹¹	Nr.	deklarimi 2019	Debitore 2019 ¹²
në Sektorin e Ndërtimit	4006	14,443,594	1,522,555	4164	10,926,955	4,257,547
në Sektorin Prodhimit	6992	13,735,162	3,099,425	7245	14,439,670	4,562,288
në Sektorin Shërbimit	25383	20,577,505	7,036,536	26341	20,772,038	2,256,731
në Sektorin Transportit	1597	2,353,833	536,105	1656	1,452,567	359,763
në Sektorin Tregtisë	21008	27,778,943	4,871,679	21588	27,206,679	3,016,233
papërcaktuar	5	41	-	5	137	-
Total	58991	78,889,078	17,066,300	60999	74,798,047	14,452,562
Ndryshimi		-	-	+2008	(4,091,032)	(2,613,738)

Siç paraqitet dhe në tabelë, referuar deklaramëve të vitit 2019: **rubrika “TVSH e detyrueshme për tu paguar”, shumat e deklaruara rezultojnë të jenë rreth 4 miliard lekë më pak se një vit më parë pavarësisht numrit në rritje të subjekteve deklaruese.** Nisur nga ky konstatim janë analizuar të dhënat e deklaruara sipas rubrikave të deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar, ku rezultojnë ndryshime nga viti i kaluar të zërave të caktuar në bazën për llogaritjen e TVSH por dhe në peshën që zënë deklaramet sipas shkallëve tatimore. Më konkretisht:

- Është rritur deklarimi i shitjeve të tatueshme me shkallë tatimore 6%, me 96%,
- Janë rritur shitjet e përjashtuara dhe pa TVSH me 23%
- Janë rritur me 100% deklaramet për blerje investime brenda vendit pa TVSH, ndërkohë
- Janë ulur me 40% deklaramet për blerje të investimeve me TVSH 20%

Rubrika sipas Deklaratës	Viti		Ndryshimi
	2018	2019	
(9) Shitje të përjashtuara dhe pa TVSH	544,349,088,165	669,010,296,156	23%
(11) Eksporte mallrash	225,399,260,422	224,678,983,007	0%
(12) Furnizime me shkallë 0%	148,252,805,649	154,694,787,267	4%
(13) Shitje të tatueshme (me shkallë 20%)	1,587,844,250,245	1,542,917,307,134	-3%
(15) Shitje të tatueshme (me shkallë 10%)	-	8,196,524	100%
(17) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)	10,808,891,629	21,162,767,961	96%
(19) Shitje të tatueshme sipas regjimeve të agentit të udhëtimit/ të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand (20%)	1,308,854,723	565,283,957	-57%
(21) Autongarkesë TVSH-së në shitje	104,227,839,765	123,033,769,581	18%
(26) Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH	670,517,888,936	613,651,968,354	-8%
(27) Blerje investimi brenda vendit pa TVSH	47,996,471,973	96,084,889,466	100%
(28) Importe të përjashtuara të investimeve pa TVSH	12,948,048,671	11,915,067,687	-8%
(29) Import mallra të përjashtuara nga TVSH	98,665,605,659	120,856,226,362	22%
(30) Import mallra me shkallë tatimore 20%	486,516,495,751	492,697,810,736	1%
(32) Import mallra me shkallë tatimore 10%	-	8,211,975	100%

¹¹Kjo kollonë paraqet vetëm shumat debitoare për subjektet deklaruese në vitin 2018 dhe jo debitorët në total të raportuara nga DPT.

¹²Kjo kollonë paraqet vetëm shumat debitoare për subjektet deklaruese në 2019 dhe jo debitorët në total të raportuara nga DPT

(34) Import mallra me shkallë tatimore 6%	-	530,461,306	100%
(36) Importe të investimit me TVSH 20%	23,692,504,545	19,239,128,359	-19%
(38) Blerje me furnitorë vendas shkalla 20%	855,022,166,561	822,578,636,317	-4%
(40) Blerje me furnitorë vendas shkalla 10%	-	106,922,063	100%
(42) Blerje me furnitorë vendas shkalla 6%	-	5,767,893,027	100%
(44) Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%	106,161,479,413	63,412,433,340	-40%
(46) Blerje nga fermerët vendas (6%)	14,158,507,644	12,918,547,757	-9%
(48) Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)	98,831,733,326	117,132,821,129	19%

Nisur nga ndryshimet ligjore gjatë vitit 2018, me impakt në deklaratimet e vitit 2019 si: Ligji nr.40/2018 datë 09.07.2018 dhe Ligji nr.96/2018 datë 03.12.2018, neni 49 “Shkallët e reduktuara”, ku shkallët e reduktuara të TVSH-së përfshijnë dhe grupe aktiviteteve të reja si agroturizmi apo media audiovizive kërkojnë një vëmendje të vecantë nga ana e administratës tatimore së pari për sqarimin e tatimpaguesve për kriteret e përcaktuara në VKM-të përkatëse që ata duhet të plotësojnë për të përfituar nga këto shkallë të reduktuara. Gjithashtu, në Ligjin nr.92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH, nuk parashikohet shkalla e reduktuar e TVSH prej 10%, të cilën e gjejmë të deklaruar dhe aplikuar në rubrikën 15, 32 dhe 40 me një vlerë totale të tatueshme rreth 124 milionë lekë.

Për sa i përket sektorit të ekonomisë, sektori i tregtisë dhe shërbimit janë kontribuesit më të mëdhenj në arkëtimet e këtij zeri të ardhurash ndërkohë që **sektori i ndërtimit paraqet një rënie prej 24% të TVSH së pagueshme.**

- **Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” realizuar në shumën 36.48 miliard lekë me një tejkalim prej 2.98 miliard lekë ose +8.91% e planit.** Sic është evidentuar edhe më lartë, në projekt buxhet ky zë është vlerësuar me rritje 7% ose 2.2 miliard lekë më shumë se viti 2018 e bazuar kjo në (në rritjen ekonomike të parashikuar, në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut; në kontributet fiskale që do të gjenerohen nga sektori energjitik (OSHEE, KESH). Por në fakt realizimi i këtij zëri në fund të vitit 2018 është 34.4 miliard lekë ndërkohë që në buxhetin e vitit 2019 ky zë miratohet në nivelin **33.5 miliard lekë ose -2.66% më pak se realizimi i një viti më parë.** Ky zë i të ardhurave është shtjelluar më hollësisht në pikën B.3 të programit të auditimit.

- **Të ardhurat nga “Taksa Nacionale dhe të tjera” ishin parashikuar në nivelin 15.4 miliard lekë ose 21.7% më shumë se fakti i vitit 2018.**Nga evidencat e DTP rezulton se ky zë është realizuar në shumën 13.2 miliard lekë **me mosrealizim prej 2.18 miliard lekë ose -14.21% më pak se plani.**

- **Të ardhurat nga “Lojrat e fatit” ishin parashikuar në shumën 2 miliard lekë ose 56.6% më pak se fakti i vitit 2018 .**Kjo si efekt nga mbyllja e lojrave të fatit. Për vitin 2019 për këtë zë të ardhurat janë realizuar në shumën 910.2 milionë lekë,**me mosrealizim 1.09 miliard lekë ose 54.49% më pak se plani.**

- **B. Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore**
Për vitin 2019, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar **94.57 miliard lekë dhe janë realizuar 94.17 miliard lekë,** me një mosrealizim prej 403.5 milionë lekë -0.43% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ku të ardhurat nga kontributet ishin 88.78 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me **5.3 miliard lekë** ose 6.07% më shumë. Sipas relacionit të projekt buxhetit të ardhurat nga “Kontributet për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore “në vitin 2019 parashikoheshin të ishin **97.9 miliard lekë,** nga 91.5

miliard lekë që do arkëtohen në vitin 2018. Kjo mbështetur në këta faktorë: rritjen ekonomike çka do reflektohet në rritjen e numrit të punësuarve; forcimin e administrimit nëpërmjet kontrollit të nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet; ritmin e rritjes së të ardhurave nga kontributet në dy-tre vitet e fundit; efektin për rreth 1 miliard lekë nga rritja e pagës minimale nga 24 mijë lekë në 26 mijë lekë, duke filluar nga 1 janari 2019. Ky zë i të ardhurave është shtjelluar më hollësisht në pikën B.2 të programit të auditimit.

.Gjetja	Pavarësisht rritjes vjetore të të ardhurave tatimore bruto, plani i të ardhurave të buxhetuara përsëri nuk është realizuar veçanërisht në zërin e TVSH-së, edhe pse ka një rritje të numrit të deklaruesve krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat tatimore bruto janë realizuar në masën 259,461,414 mijë lekë ose 5,909,586 mijë lekë (2.23%) më pak se plani i rishikuar me Akt Normativ nr.2 datë 02.10.2019, “Për disa ndryshime Ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019.
Situata	<p>Ky mosrealizim vjen kryesisht nga mosrealizimi i të ardhurave tatimore (arkëtime) me 5,505,989 mijë lekë ose -3.22% dhe mosrealizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore me 403.6 milion lekë ose -0.43%. Krahasuar me një vit më parë të ardhurat tatimore bruto janë rritur me 12,884,671 mijë lekë ose me 5.23% respektivisht +4.75% nga rritja e të ardhurave tatimore dhe 6.07% nga rritja e kontributeve të sigurimeve. Për sa i përket realizimit të të ardhurave tatimore sipas Drejtorive Rajonale Tatimore, DRT Sarandë rezulton me realizimin më të lartë prej 107.33% të planit vjetor ndërsa DRT Dibrë me realizimin më të ulët prej 94.37% të planit të rishikuar. Megjithatë, këto dy drejtori zënë një peshë specifike të vogël në totalin e të ardhurave të realizuar me 2.2%. Ndërkohë, dy drejtoritë me impakt të lartë në realizimin e të ardhurave tatimore rezultojnë me mosrealizim, përkatësisht DRT Tiranë me 96.2% dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me 98.31% të planit.</p> <p>Analizuar sipas llojit, zëri i të ardhurave nga TVSH-ja ka patur një trend rënës në vite 2017-2019. Pavarësisht parashikimeve optimiste, të ardhurat nga TVSH-ja rezultojnë të realizuara në shumën 49.45 miliard lekë ose 7.5 miliard lekë ose 13.23% më pak se plani i rishikuar, dhe 3% më pak se TVSH e arkëtuar në vitin 2018. Planifikimi optimist, sipas relacionit të Projekt Buxhetit 2019, është bazuar në <u>“rritja ekonomike dhe përmirësimin të luftës ndaj informalitetit”, rrjedhimisht</u> kjo e reflektuar në rritjen e numrit të deklaruesve si dhe në saktësinë e deklarimit. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, gjatë vitit 2019 rezultojnë 61,000 subjekte të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar në përputhje me Ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106, nga 58991 subjekte deklarues gjatë vitit 2018 ose rreth 2,000 subjekte më shumë. Nga subjektet deklarues, vetëm 10,948 prej tyre rezultojnë me TVSH të pagueshme ose rreth 350 subjekte më shumë se një vit më parë. Për sa i përket sektorit të ekonomisë, sektori i tregtisë dhe shërbimit janë kontribuesit më të mëdhenj në arkëtimet e këtij zëri të</p>

	<p>ardhurash ndërkohë që <u>sektori i ndërtimit paraqet një rënie prej 24% të TVSH së pagueshme.</u></p> <p>Zëri i të ardhurave nga “tatimi mbi të ardhurat personale”, duket të jetë zëri më performues gjatë vitit 2019, me një kontribut prej 28% në totalin e të ardhurave tatimore bruto kundrejt 23% në vitin 2018. Në fund të periudhës ky zë rezulton me realizim 46.22 miliard lekë ose 10.31% më shumë se plani dhe 9.65 miliard lekë më shumë se arkëtimet e vitit 2018. Në këtë rritje, 7.37 miliard lekë kanë ardhur vetëm nga “tatimi mbi të ardhurat nga dividendi” si rrjedhojë e lehtësimit fiskal të parashikuar me uljen e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, aplikuar dhe në shpërndarjen e fitimeve të akumuluar të viteve të kaluara, ndryshim që e kaloi pritshmërinë prej 4.5 miliard lekë vlerësuar gjatë buxhetimit.</p> <p>-Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” janë realizuar në shumën 36.48 miliard lekë me një tejkalim prej 2.98 miliard lekë ose +8.91% e planit. Siç është evidentuar edhe më lartë, në projekt buxhet ky zë është parashikuar fillimisht me një rritje 7% ose 2.2 miliard lekë më shumë se viti 2018. Në fakt, me ligjin e buxhetit për vitin 2019 ky zë miratohet në nivelin 33.5 miliard lekë ose -2.66% më pak se realizimi i vitit 2018 që raporton 34.4 miliard lekë arkëtime, një rezervë kjo e pashoqëruar me një arsyetim faktorësh.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar</p> <p>Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”;</p> <p>Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar,</p> <p>Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.37 datë 19.12.2019 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit 2019”;</p> <p>Udhëzimi nr.32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël” i ndryshuar;</p> <p>Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”,</p> <p>Akti Normativ nr.2 datë 02.10.2019, “Për disa ndryshime Ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”;</p> <p>Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	Mosrealizim i të ardhurave tatimore mbetet i paanalizuar për faktorët ndikues në shtesë të ndryshimeve fiskale në mbyllje të vitit raportues.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.7, datë 24.07.2019 për të cilin subjekti ka observuar me dokumentin nr.6272/28 datë 30.07.2020 dhe grupi i auditimit ka reflektuar qwndrimin e tij nw Projekt Raportin e Auditimit.

Observacioni në përgjigje të Projekt Raportit të Auditimit të mbërritur me shkresën nr.333/10 datë 25.09.2020 nga znj. D I, si dhe diskutimit mbi cilësimin e përgjegjësisë në përfundime me gjetjen dhe periudhën respektive të drejtimit, në takimin ballafaqes të datës 14.10.2020, u bë dhe saktësimi i përgjegjësisë të cilësuar në Projekt Raport.

Gjetja	Disa ndryshime të legjislacionit tatimor janë bërë jo në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale të parashikuara në Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ndryshuar, duke mos i dhënë kohën e duhur për informim dhe sqarim tatimpaguesve që preken nga këto ndryshime, për të siguruar në vijim vlefshmërinë dhe saktësinë e deklarimeve.
Situata	<p>1) Deklarimet e vitit 2019 me impakt në të ardhurat e arkëtuara dhe stokun e TVSH kreditorë, janë ndikuar edhe nga ndryshimet ligjore të parashikuara në Ligjin nr.96/2018 datë 03.12.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, ndryshime këto të bëra në kundërshtim me Ligjin nr.9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ndryshuar, nenin 4/1, pika 3 “Parimet dhe rregullat fiskale” cituar: “<i>Ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal</i>”. Më konkretisht, ky ligj, në nenin 1 të tij parashikon përfshirjen në nenin 49 “Shkallët e reduktuara” të TVSH-së edhe të 1) <i>furnizimit e shërbimit të reklamave nga media audiovizive si dhe 2) për furnizimin e mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind deri në datën 31 dhjetor 2021. Nga data 1 janar 2022 shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar që aplikohet për këtë furnizim është 10 për qind.</i> Nga auditimi i deklarimeve të vitit 2019 sipas rubrikave, rezultojnë ndryshime në strukturën e deklarimeve sipas shkallëve tatimore krahasuar me deklarinat e një viti më parë. Më konkretisht: <u>është rritur deklarimi i shitjeve të tatueshme me shkallë tatimore 6% me 96%.</u> Gjithashtu, në këto deklarime u konstatuan edhe <u>deklarime në shkallën 10% në rubrikën 15, 32 dhe 40 të deklaratës, me një vlerë totale të tatueshme rreth 123 milionë lekë,</u> shkallë e cila nuk parashikohet në Ligjin nr.92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, të ndryshuar. Nisur nga problematika në lidhje me shkallën e lartë të informalitetit në deklarinat e TVSH, <u>grup tatimpaguesit të cilët ofrojnë shërbime të kombinuara me shkallë standarde dhe shkallë të reduktuar duhej të ishin vlerësuar dhe analizuar paraprakisht me një shkallë risku më të lartë, me qëllim sigurimin e saktësisë së deklarimeve sipas llojit të shërbimit (aktivitetit) të deklaruar dhe vlefshmërinë e normës së tatimit të aplikuar.</u></p> <p>2) Një tjetër ligj i miratuar në më pak se 1 muaj para fillimit të vitit të ri fiskal është Ligji nr.94/2018 datë 03.12.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”</p>

	<p>të ndryshuar”, sipas të cilit u shtua shkalla tatimore e reduktuar prej 5%, e cila hyri në fuqi më 1 Janar 2019 për disa kategori tatimpaguesish. Konkreisht, në nenin 28, janë bërë diferencime të shkallës së Tatimit mbi Fitimin për disa kategori: - 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14,000,000 lekë në vit;- 5% për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit përfshirë dhe VKM nr.730 datë 12.12.2018 e cila përcakton përkufizimet dhe kriteret e kualifikimit për përfitimin e shkallës së reduktuar. Nga auditimi i të dhënave të sistemit C@ATS rezulton se kanë përfituar nga shkalla e re tatimore 5,336 subjekte nga të cilët: 5,258 subjekte me të ardhura të deklaruara deri në 14,000,000 lekë duke gjeneruar një detyrim tatim fitimi në shumën 339,542 mijë lekë krahasuar me 766,288 mijë lekë detyrim tatim fitimi deklaruar në vitin 2018 nga 5432 subjekte të së njëjtës fashë. Pra duket se shkalla e re tatimore nuk ka nxitur rritjen e numrin e deklaruesve; 77 subjekte me të ardhura të deklaruara mbi 14,000,000 lekë kanë aplikuar shkallën tatimore 5% duke gjeneruar një detyrim tatim fitimi në shumën 128,075 mijë lekë. Sipas ndryshimeve ligjore, këto subjekte duhet të kenë në objektin e veprimtarisë së tyre prodhimin/zhvillimin e softëare-ve ose aktivitetin e “agro-turizmit” pasi të jenë të certifikuar si të tillë. Nga auditimi u konstatua se referuar <u>përshkrimit të objektit të aktivitetit, shkallën tatimore të reduktuar 5% e kanë aplikuar edhe subjekte që nuk i përkasin këtyre dy fushave por subjekteve që ushtrojnë veprimtari në bar-kafe, call-center, ndërtim, tregti etj. Gjithashtu disa nga subjektet e listuar në fushën e teknologjisë dhe informacionit në objektin e veprimtarisë kanë përshkruar në objektin e aktivitetit “tregtimin” e pajisjeve informatike dhe jo “dizenjim/prodhim”.</u></p> <p>3) Në vijim të këtij Ligji të miratuar në kundërshtim me parimet e parashikuara ligjore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nxjerr Udhëzimin nr.12 datë 15.03.2019 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, me të cilin miraton zëvendësimin e “formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin” me formularin e ri i cili parashikon rubrika të veçanta sipas shkallëve të reja tatimore në fuqi, <u>vetëm 15 ditë para afatit të deklarimit të tatimit mbi fitimin 31 Mars 2019.</u></p> <p>4) E njëjta praktikë është ndjekur edhe me Ligjin nr.84/2019 datë 18.12.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku është shtuar, që për personat juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%, ndryshim që do të japë efektet duke filluar nga 1 Janari 2020, pra vetëm 13 ditë nga data e publikimit.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar. Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;</p>

	Ligj nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438, datë 28.12.1998,“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar; Udhëzim nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Vlerësim jo i drejtë i impaktit të ndryshimeve në ligjet tatimore në programimin e të ardhurave tatimore. Mosinformim në kohë i tatimpaguesve për ndryshimet ligjore dhe kriteret për përfitim prej tyre duke shkaktuar programim jo të drejtë të të ardhurave tatimore dhe deklarime të pasakta nga ana e tatimpaguesve.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Ak-konstatimi nr.14 datë 24.07.2020, për të cilin subjekti ka observuar me dokumentin nr.6272/39 Datë 30.07.2020 dhe për të cilin audituesi është shprehur në Projekt Raportin e Auditimit.

Nw pwr gjigje tw Projekt-Raportit të Auditimit subjekti (zj.I A) ka observuar me shkresën nr.6272/52 prot, datë datë 23.09.2020 protokolluar në KLSH me nr.333/6 datë 24.09.2020, në të cilin subjekti shprehet përsëri për deklarimet të cilat kanë aplikuar shkallën tatimore 5% të sugjeruara nga audituesi për verifikim cituar ”... Ky evidentim mbetet për tu verifikuar në çdo deklaratë vjetore të tatimit mbi fitimin duke konsideruar dhe si kriter me risk.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në konkluzion të observacionit, subjekti bie dakord që këto raste kërkojnë verifikim nga administrata tatimore, dhe kjo është shprehur nga audituesi në rekomandimet e propozuara. Rastet që DKT mund të kishte verifikuar menjëherë duhej të ishin ato të cilat aktiviteti i tatimpaguesit qartazi nuk përputhet me grupin e tatimpaguesve përfitues të shkallës tatimore 5% si: call center etj. Gjithashtu, një verifikim tjetër që mund të sillej nëpërmjet observacionit mund të ishte dhe për subjektet në grupin agroturizëm e disponojnë ose licensën sipas kriterëve të VKM. Në konkluzion observacioni nuk sjell fakte të reja për të rishikuar rastet e listuara në gjetje apo për të rishikuar gjetjen në thelb. Megjithatë mbetet në përgjegjësinë e kontrollit tatimor nga zyra hartimi i kontrolleve dhe raportimi i rasteve te DRT për ndjekje të mëtejshme. Në këtë kontekst lihen dhe përgjegjësitë në vijim:

1.Titullarët e Drejtorive Rajonale Tatimore që kanë në administrim subjektet e përmendura në këtë Projekt-Raport dhe nën menaxhim strukturat përkatëse të kontrollit tatimor.

2.Zj.I A, në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor në DPT, si njësi e udhëheqjes metodologjike dhe monitoruese e strukturave të kontrollit në administratën tatimore.

B1.4 Rakordimi i të ardhurave të arkëtuara me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Sipas Udhëzimit të përhershëm nr.2 i rishikuar,pika 207. “Nëpunësi zbatues rakordon çdo muaj me strukturën përgjegjëse të thesarit në degë për të ardhurat progresive që ka realizuar njësia shpenzuese e qeverisjes së përgjithshme mbi bazën e raporteve të sistemit informatik financiar të qeverisë” dhe pikës 208“Në rastin e mosrakordimit/mospërputhjes të të dhënave të akt-rakordimit me të dhënat e sistemit informatik financiar të qeverisë, struktura përgjegjëse për thesarin bën rregullimet në sistemin financiar të shumave të të ardhurave të kaluara gabim në njësitë e qeverisjes së përgjithshme që u takon kjo shumë, dhe njofton zyrtarisht njësinë respektive të

qeverisjes së përgjithshme". Sipas pikës 209 "Në rastin e rakordimit/përputhjes së të dhënave të akt-rakordimit me të dhënat e sistemit informatik financiar të qeverisë nënshkruhet akt-rakordimi nga nëpunësi zbatues i njësisë respektive dhe nga nëpunësi i autorizuar i strukturës përgjegjëse për thesarin". Sipas pikës 217 "Kur njësitë shpenzuese janë agjentë tatimore, të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet trajtohen si të ardhura nga veprimtaria kryesore dhe derdhen 100% në buxhetin e shtetit. Kufiri i përdorimit të këtyre të ardhurave është i përcaktuar në planin e shpenzimeve të buxhetit në strukturën përkatëse". Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.37 datë 19.12.2019 pika 22 "Brenda datës 24.01.2020 degët e thesarit rakordojnë me njësitë e përgjithshme për shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2019". Në lidhje me procedurën e arkëtimit të të ardhurave tatimore, ajo kryhet në bankat e nivelit të dytë të cilat në zbatim të marrëveshjes dypalëshe me MFE ngarkojnë elektronikisht cdo ditë arkëtimet në SIFQnë emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, krahas mesazhit sëift për kontabilizimin e mjeteve monetare në llogarinë e unifikuar « Depozitë e qeverisë » (TSA-Tresury Single Account) në Bankën e Shqipërisë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr të dhënat bankare të të ardhurave tatimore cdo ditë nga SIFQ nëpërmjet IT që ngarkohen në sistemin e tyre C@TS prej nga çiftosen me deklaratat e tatimpaguesve për të përcaktuar llogarine ekonomike (kodi buxhetor). Tabela e detajuar me llogaritë ekonomike (p.sh. TVSH. Akcize, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, tatim fitimi, etj.) ngarkohet cdo ditë nga C@TS në SIFQ duke mundësuar gjenerimin e të dhënave të treguesve fiskale të konsoliduar sipas klasifikimit ekonomik (planit kontabël të llogarive ekonomike).

Gjithashtu file i ngarkuar nga bankat e nivelit të dytë në SIFQ i importohet elektronikisht degëve të Thesarit të cilat rakordojnë me postën fizike të marrë nga bankat e nivelit të dytë. Në fund të muajit Dega e Thesarit Tirane rakordon të dhënat e arkëtimeve tatimore në SIFQ me të dhënat e arketimeve të raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bazë të postës fizike që ajo ka marrë nga bankat e nivelit të dytë në Tiranë si administruese e këtyre llogarive të celura në emër të saj nga ministri përgjegjës për financat. Rakordimet ditore kryen në përgjegjësinë e Qendrës së Pagesave e cila sipas Rregullores së Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, neni 129 ka për objekt monitorimin e funksionimit të sistemit të pagesave të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim lehtësimin e procedurave të pagesës nga tatimpaguesit, lehtësimin e punës në bankatë nivelit të dytë për përgatitjen e informacionit në lidhje me këto pagesadhe përmirësimin e përpunimit të të dhënave të pagesave për qëllime të administratës tatimore. Në këtë kuadër Qendra e Pagesave monitoron shkëmbimin e informacionit lidhur me pagesat dhe problemet që mund të shfaqen me bankat e nivelit të dytë, Degën e Thesarit etj. Në fund të muajit Qendra e Pagesave konfirmon të dhënat për shpenzimet, të ardhurat dhe bankën në sektorin e Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit në MFE, i cili harton tabelën e treguesve fiskal të konsoliduar për publikim. Në mbyllje të vitit 2019, sipas shkresës nr.prot.6886 datë 21.04.2020, Drejtoria e Statistikës dhe Kontabilitetit përcjell Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës Pasqyrat Financiare të vitit 2019 shoqëruar me rakordimin me Thesarin sipas të cilit të ardhurat tatimore dhe sigurime të arkëtuara gjatë vitit 2019 janë në total **264,130,422 mijë** lekë, nga të cilat **165,294,011 mijë** lekë janë të ardhura tatimore të arkëtuara dhe **94,167,402 mijë lekë** janë të ardhura nga kontributet të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Të dhënat e përpunuara në evidencat e raportuara nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të krahasuara me raportet e Thesarit FSG të datës 31.12.2019 paraqitet:

Në mijë lekë

	Lloji i te ardhurave	Thesari				
		DPT	Llog.70	Llog.466	GJOBA/ Kamatvonesa	Diff
A	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	259,461,414	232,099,661	25,700,122	1,661,631	-
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	165,294,011	138,652,924	25,536,283	1,104,805	-
	<i>Nga te cilat:</i>					
1	Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	49,456,618	47,992,974	768,059	695,585	(0)
	- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	25,947,162	24,483,518	768,059	695,585	(0)
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	23,509,456	23,509,456			0
2	Tatim mbi Fitimin	36,484,399	12,528,533	23,886,193	69,673	0
3	Ardhura Personale	46,226,037	45,999,665	144,255	82,117	0
4	Taksat dhe Tarifa Nacionale	13,211,686	12,471,540	727,186	12,960	(0)
5	Taksa Qarkullimi Rrugor	18,754,453	18,754,453			-
6	Lojrat e Fatit	910,263	905,760	3,345	1158	-
7	Te tjera pa identifikuar	-0.02				(0)
8	Denimet Administrative	250,556		7,244	243,312	-
C	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	141,784,555	115,143,468	25,536,283	1,104,805	0
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	94,167,402	93,446,738	163,839	556,826	0
	- Tarifa jo Tatimore	4,114,093	4,114,093			-
E	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	235,951,958	208,590,205	25,700,122	1,661,631	-

Nga rakordimi me raportet e llogarive analitike të nxjerra nga sistemi i Thesarit- SIFQ me evidencat e raportuara nga DPT nuk rezultojnë diferenca.

Ndërkohë, për qëllime të raportimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit –Sektori i raportimeve financiare dhe kontabilitetit, klasifikimi i të ardhurave në të tatimore dhe jo tatimore është i ndryshëm duke sjellë kështu diferenca në raportimin e të ardhurave tatimore. Kështu, sipas DPT arkëtimet nga “gjoba të sistemit tatimor” janë klasifikuar si të ardhura tatimore në total **arkëtuar 730,008 mijë lekë**, kjo jo në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 cituar “*Llogaria 70 ”Tatime dhe taksat dhe tatimet” Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njërive të vetëqeverisjes vendore, kamatvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jotatimore”*. Ndërkohë, shifrat e raportuara nga MFE si të ardhura tatimore nuk përfshijnë vetëm gjobat por në disa zëra si psh “të ardhura nga TVSH” nuk përfshijnë as kamatvonesat:

	Lloji i te ardhurave	DPT pa gjoba/ kamatvonesa	MFE	Diff
	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	164,189,427	165,248,598	1,059,171
	<i>Nga të cilat:</i>			
1	Tatimi Vlerës së Shtuar (bruto)	48,761,033	48,761,030	3
	- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	25,251,577	25,252,030	453
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	23,509,456	23,509,000	-456
2	Tatim mbi Fitimin	36,484,399	36,574,600	159,874
3	Ardhura Personale	46,226,037	46,124,440	-19,480
4	Taksat dhe Tarifa Nacionale+Lojrat e fatit	32,876,402	33,788,528	926,025

Gjetja	Në raportimet e DPT, arkëtimet nga “gjoba të sistemit tatimor” janë klasifikuar si të ardhura tatimore në total arkëtuar 730,008 mijë lekë, kjo jo në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018
Situata	<p>Sipas Udhëzimit i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.37 datë 19.12.2019 pika 22 <i>“Brenda datës 24.01.2020 degët e thesarit rakordojnë me njësitë e përgjithshme për shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2019”, në mbyllje të vitit 2019, sipas shkresës nr.prot.6886 datë 21.04.2020, Drejtoria e Statistikës dhe Kontabilitetit përcjell Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës Pasqyrat Financiare të vitit 2019 shoqëruar me rakordimin me Thesarin sipas të cilit të ardhurat tatimore dhe sigurime të arkëtuara gjatë vitit 2019 janë në total 264,130,422.5 mijë lekë, nga të cilat 165,2694,011 mijë lekë janë të ardhura tatimore të arkëtuara dhe 94,167,402 mijë lekë janë të ardhura nga kontributet të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Nga rakordimi me raportet e llogarive <u>analitike</u> të nxjerra nga sistemi i Thesarit- SIFQ me evidencat e raportuara nga DPT nuk rezultojnë diferenca.</i></p> <p><i>Për qëllime të raportimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit –Sektori i raportimeve financiare dhe kontabilitetit, klasifikimi i të ardhurave në “tatimore” dhe “jo tatimore” është i ndryshëm duke sjellë kështu diferenca në raportimin e të ardhurave tatimore midis dy raporteve. Kështu, sipas DPT arkëtimet nga “gjoba të sistemit tatimor” janë klasifikuar si të ardhura tatimore në total arkëtuar 730,008 mijë lekë, kjo jo në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 cituar <u>“Llogaria 70 ”Tatime dhe taksat dhe tatimet” Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njërive të vetëqeverisjes vendore, kamatvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jotatimore”</u>.</i></p> <p>Ndërkohë, shifrat e raportuara nga MFE si të ardhura tatimore nuk përfshijnë vetëm gjobat por në disa zëra si psh “të ardhura nga TVSH” nuk përfshijnë as kamatvonesat.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.99/2018, datë 03.12.2018 “ Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të NJQP”</p>

	Udhëzimi nr.37 datë 19.12.2019 “Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2019”.
Ndikimi/Efekti	Unifikimi i klasifikimeve buxhetore për qëllime të raportimeve fiskale
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.7, datë 24.07.2019

B2. Auditimi i saktësisë së mbledhjes së të ardhurave për ISSH dhe FSDKSH. Rakordimi i vlerave, dërgimi i listëpagesave dhe lista e debitorëve e azhornuar. Transferimi i të ardhurave të mbledhura.

Për auditimin e kësaj çështje u shqyrtua dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit (bilanci i të ardhurave/shkresat rakorduese me ISSH & FSDKSH/ analiza vjetore e kësaj drejtorie) si dhe të dhëna të detajuara marrë nga AKSHI më lidhje me listë pagesat e deklaruara dhe të paguara dhe debitorët për kontributet me të dhëna për vitin 2019 dhe progresive). Në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Administrata Tatimore Qendrore është e ngarkuar për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar në rolin e agentit tatimor që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve.

Të ardhurat nga kontributet nënkuptojnë të ardhurat nga pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për vitin 2019 planifikimi i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është kryer në zbatim të Ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1584 prot., datë 30.01.2019, protokolluar në DPT me nr.2378 prot., datë 01.02.2019. Detajimi i planit të vitit 2019 për të ardhurat nga kontributet si pjesë përbërëse e të ardhurave tatimore paraqitet në tabelën në vijim:

Në mijë lekë

	Lloji i të ardhurave	Fakt 2017	PLANI 2018	Rritja 2018 vs. 2017	Fakt 2018	PLANI 2019	Plan2019 vs. Fakt2018		Plan2019 vs. Plan2018	
							+ /-	%	+ /-	%
1	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	228,577,581	247,013,000	8.1%	246,576,742	265,871,000	19,294,258	7.82%	18,858,000	7.63%
2	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	82,817,476	87,900,000	6.1%	88,778,080	94,571,000	5,792,920	6.53%	6,671,000	7.59%

Burimi: DAK

Për vitin 2019 plani i të ardhurave për kontributet (shoqërore + shëndetësore) është rritur me 6,671,000 në mijë lekë, ose 7.59% krahasuar me vitin 2018. Përsa i përket peshës specifike që zënë të ardhurat nga kontributet në totalin e të ardhurave të DPT, konstatohet se, për vitin 2019 të ardhurat nga kontributet zënë 35.57%, të totalit të të ardhurave të DPT.

Plani për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas DRT-ve për vitin 2019.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani Vjetor 2019 në total (sig shoq+shëndet)	Plani për sigurimet shoqërore	Plani për sigurimet shëndetësore
	DPT Kontribute sig.shoqërore dhe shëndetësore	94,571,000	81,332,000	13,239,000
1	D. R. T. Berat	2,350,000	2,021,011	328,989

2	D. R. T. Dibër	2,020,000	1,737,317	282,683
3	D. R. T. Durrës	8,080,000	6,948,449	1,131,551
4	D. R. T. Elbasan	4,257,000	3,660,829	596,171
5	D. R. T. Fier	4,850,000	4,170,755	679,245
6	D. R. T. Gjirokastrë	1,760,000	1,513,583	246,417
7	D. R. T. Korçë	3,714,000	3,193,923	520,077
8	D. R. T. Kukës	1,355,000	1,165,374	189,626
9	D. R. T. Lezhë	2,400,000	2,064,019	335,981
10	D. R. T. Sarandë	1,105,000	949,908	155,092
11	D. R. T. Shkodër	4,000,000	3,439,864	560,136
12	D. R. T. Tiranë	34,910,000	30,023,220	4,886,780
13	D. R. Tatim pagesit e mëdhenj	20,710,000	17,812,600	2,897,400
14	D. R. T. Vlorë	3,060,000	2,631,148	428,852

Burimi: DAK

Në planifikimin e të ardhurave, peshën specifike më të lartë e zë DRT Tiranë me 37% të totalit të të ardhurave dhe D. R. Tatim pagesit e mëdhenj me afro 22% të totalit.

Me vendosjen e sistemit të ri tatimor E-Tax çdo tatimpagues deklaron listë pagesën në mënyrë elektronike. Listë pagesa ka pjesë përbërëse të saj detyrimin për sigurimin shoqëror, sigurimin shëndetësor dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.

Referuar nenit 79 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, radha e pagesës së kontributeve dhe detyrimeve tatimore paraqitet si vijon:

- Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore;
- Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit;
- Kontributet e detyrueshme suplementare të sigurimeve shoqërore;
- Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit;
- tatimet; f) kamatvonesat; g) gjobat

Monitorimi i sistemit të pagesave si për detyrimet tatimore ashtu edhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është realizuar nga Qendra e Pagesave. Qendra e Pagesave raporton pagesat e arkëtuara në buxhetin e shtetit pranë Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës si dhe identifikon pagesat pezull dhe sistemimin e tyre në llogarinë e duhur të tatim pagesit. Për të verifikuar saktësinë e informacionit Qendra e Pagesave krahason ekstraktin bankar për pagesat e jashtme me të dhënat e ardhura elektronikisht nga SIFQ për ato që konsiderohen pagesa të brendshme dhe komunikon me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për saktësimin dhe sistemimin e informacionit. Gjatë vitit 2019 kanë rezultuar 190 komunikime elektronike për sistemimin e 860 rasteve të konstatuara me problematika, tipologjia e të cilave konsiston në: gabim në numrin serial me 24 karaktere; gabim në përcaktimin e periudhës; gabim në llojin e tatimit, etj. Marrëdhënia ndërmjet DPT dhe Bankave të nivelit të dytë në lidhje me korrigjimin e veprimeve të gabuara është rregulluar me marrëveshje të përbashkëta të nënshkruara nga Ministri i Financave, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Drejtorët përkatës të Bankave të Nivelit të Dytë.

Në fund të vitit 2019 llogaria 4665599 “Të ardhura në llogarinë pezull për tatime dhe sigurime” rezulton me vlerë zero, që do të thotë që të gjitha pasaktësitë e konstatuara janë sistemuar brenda vitit ushtrimor. Në rastet kur pagesa e kryer nga subjekti nuk e mbulon të gjithë detyrimin për kontribute atëherë sistemi në mënyrë automatike ka një rradhë mbulimi duke filluar me sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore dhe në fund TAP. Në përfundim të periudhës ushtrimore, sipas të dhënave të Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, realizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

	Lloji i të ardhurave	PERIUDHA - 12 MUJORE 2019						
		FAKTET		PLANI	Diferenca FAKT	PLAN-	Diferenca 2019 -	2018
		2018	2019	2019	+ ose -	%	+ ose -	
A	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	246,576,742	259,461,414	265,371,000	(5,909,586)	-2.23%	12,884,671	5.23%
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	88,778,080	94,167,402	94,571,000	(403,598)	-0.43%	5,389,322	6.07%

Burimi:DAK

Të ardhurat nga kontributet e rakorduara me llogaritë analitike rezultojnë:

Në mijë lekë

	Lloji i të ardhurave	Thesari				
		DPT	Llog.700	Llog.466	GJOBA/Kamatvonesa	Diff
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	94,167,402	93,446,738	163,839	556,826	0

Burimi:DAK

Realizimi i të ardhurave sipas DRT për vitin 2019 paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	EMERTIMI	PERIUDHA - 12 MUJORE 2019						
		FAKTET		PLANI	Diferenca PLAN - FAKT		Diferenca 2019 - 2018	
		2018	2019	2019	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
D	KONTRIBUTE GJITHSEJ	88,778,080	94,167,402	94,571,000	(403,598)	-0.43%	5,389,322	6.07%
	Nga të cilat:							
1	D.R. Tatimore Berat	2,183,134	2,263,621	2,470,000	(206,379)	-8.36%	80,487	3.69%
2	D.R. Tatimore Dibra	1,900,183	1,979,436	2,080,000	(100,564)	-4.83%	79,253	4.17%
3	D.R. Tatimore Durrësi	7,949,239	8,452,182	8,310,000	142,182	1.71%	502,943	6.33%
4	D.R. Tatimore Elbasani	3,951,136	4,181,616	4,300,000	(118,384)	-2.75%	230,480	5.83%
5	D.R. Tatimore Fieri	4,727,471	4,768,613	4,870,000	(101,387)	-2.08%	41,142	0.87%
6	D.R. Tatimore Gjirokastra	1,668,219	1,749,748	1,800,000	(50,252)	-2.79%	81,529	4.89%
7	D.R. Tatimore Korça	3,408,160	3,578,644	3,790,000	(211,356)	-5.58%	170,484	5.00%
8	D.R. Tatimore Kukësi	1,249,692	1,287,877	1,380,000	(92,123)	-6.68%	38,184	3.06%
9	D.R. Tatimore Lezha	2,149,643	2,290,582	2,400,000	(109,418)	-4.56%	140,938	6.56%
10	D.R. Tatimore Saranda	1,048,678	1,139,560	1,125,000	14,560	1.29%	90,882	8.67%
11	D.R. Tatimore Shkodra	3,764,796	3,937,217	4,090,000	(152,783)	-3.74%	172,420	4.58%
12	D.R. Tatimore Tirana	32,145,908	34,537,995	34,900,000	(362,005)	-1.04%	2,392,087	7.44%
13	D.R. Tatimore Tatimpaguesit e mëdhenj	19,719,940	20,906,359	19,956,000	950,359	4.76%	1,186,418	6.02%
14	D.R. Tatimore Vlora	2,911,879	3,093,955	3,100,000	(6,045)	-0.20%	182,075	6.25%

Burimi:DAK

Për vitin 2019, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar **94.57 miliard lekë dhe janë realizuar 94.17 miliard lekë**, me një mosrealizim prej 403.5 milionë lekë ose e shprehur në përqindje (-0.43%) më pak se planifikimi. Krahësuar me të

njëjtën periudhë të vitit 2018, ku të ardhurat nga kontributet ishin 88.78 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me **5.3 miliard lekë** ose 6.07% më shumë.

Në realizimin e të ardhurave, si edhe në procesin e planifikimit, peshën specifike më të lartë e zë DRT Tiranë me afro 37% dhe DRT Tatimpaguesit e mëdhenj me 22%, të totalit të të ardhurave. Vetëm tre DRT rezultojnë me realizim të planit të të ardhurave. Më konkretisht: DRT Durrës me tejkalim të të ardhurave me 142 milionë lekë, ose në masën 1.71%; DRT Sarandë me tejkalim të të ardhurave me 14.5 milionë lekë, ose në masën 1.29%; DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj me tejkalim të të ardhurave me 950 milionë lekë; ose në masën 4.76%. 11 DRT kanë rezultuar me mosrealizim të planit të të ardhurave në total në shumën 1,5 mld lekë, nga të cilat DRT Tiranë rezulton me mosrealizim të të ardhurave nga kontributet në shumën 362 mln lekë e ndjekur nga DRT Korçë me 211 mln lekë dhe DRT Berat me 206 mln lekë. Në raport me planet individuale të DRT-ve, DRT Berat rezulton me përqindjen më të lartë të mosrealizimit (-8.36%), e ndjekur nga DRT Kukës me -6.68%, DRT Korçë me -5.58%, DRT Dibër me -4.83% dhe DRT Lezhë me -4.56%.

Për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për mosrealizimin e të ardhurave nga kontributet mbajnë Titullarët e DRT-ve.

Udhëzimi plotësues nr.1 datë 17.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika113.
“Me implementimin e sistemit të ri informatik tatimor dhe me mbylljen e llogarive bankare në emër të drejtorive rajonale tatimore, kërkohet cdo ditë të sigurohet dërgimi elektronik në SIFQ i arkëtimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga strukturat përgjegjëse për tatimet, sipas klasifikimit ekonomik buxhetor”.

ISSH dhe FSDKSH (operojnë me llogari jashtë TSA) janë përdorues të SIFQ me akses për të regjistruar të dhënat mujore/vjetore (jo për cdo transaksion) të shpenzimeve, të ardhurave dhe bankës, të cilat përfshihen automatikisht në të dhënat e treguesve fiskale të konsoliduar pas konfirmimit për rakordim bashkëlidhur në fund të vitit dhe konfirmimit mujor me Sektorin e Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit. Mbështetur në Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit, DPT nëpërmjet Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit (DAK) dërgon të dhënat mbi të ardhurat e realizuara për kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në bazë mujore, gjithsej janë dërguar 12 shkresa për secilin institucion, si vijon:

Komunikimet e DPT me ISSH në lidhje me realizimin e treguesve për kontributet e sigurimeve shoqërore:

-Shkresa nr.4973, datë 06.03.2019 (Janar 2019); Shkresa nr.6516, datë 27.03.2019 (Janar-Shkurt 2019); Shkresa nr.7315, datë 08.04.2019 (Janar- Mars 2019); Shkresa nr.9798, datë 13.05.2019 (Janar-Prill 2019); Shkresa nr.11632, datë 11.06.2019 (Janar-Maj 2019); Shkresa nr.13732, datë 15.07.2019 (Janar-Qershor 2019); Shkresa nr.15414, datë 14.08.2019 (Janar-Korrik 2019); Shkresa nr.16813, datë 10.09.2019 (Janar-Gusht 2019); Shkresa nr.18426, datë 04.10.2019 (Janar-Shtator 2019); Shkresa nr.20416, datë 06.11.2019 (Janar-Tetor 2019); Shkresa nr.22194, datë 11.12.2019 (Janar-Nëntor 2019); Shkresa nr.643, datë 14.01.2020 (Janar-Dhjetor 2019).

Komunikimet e DPT me FSDKSH në lidhje me realizimin e treguesve për kontributet e sigurimeve shëndetësore:

-Shkresa nr.4974, datë 06.03.2019 (Janar 2019); Shkresa nr.6515, datë 27.03.2019 (Janar-Shkurt 2019); Shkresa nr.7316, datë 08.04.2019 (Janar- Mars 2019); Shkresa nr.9798, datë 13.05.2019

(Janar-Prill 2019); Shkresa nr.11632, datë 11.06.2019 (Janar-Maj 2019); Shkresa nr.13731, datë 15.07.2019 (Janar-Qershor 2019); Shkresa nr.15415, datë 14.08.2019 (Janar-Korrik 2019); Shkresa nr.16858, datë 10.09.2019 (Janar-Gusht 2019); Shkresa nr.18545, datë 07.10.2019 (Janar-Shtator 2019); Shkresa nr.20415, datë 06.11.2019 (Janar-Tetor 2019); Shkresa nr.22195, datë 11.12.2019 (Janar-Nëntor 2019); Shkresa nr.644, datë 14.01.2020 (Janar-Dhjetor 2019).

Shkresa nr.618 datë 27.01.2020 e Institutit të Sigurimeve Shoqërore drejtuar MFE : « Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga DPT për kontributet e Sigurimeve Shoqërore » përcjell rakordimin me shkresën nr.prot.643 datë 14.01.2020 lidhur me të ardhurat e realizuara për kontributet e sigurimeve shoqërore nga sistemi C@TS për periudhën Janar- Dhjetor 2019 si më poshtë:

Rakordimi për transferimet dhe arkëtimet në TSA për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore:

Nr.Llog	Emërtimi i llogarive	DPT	MFE
7500100	Sig.shoq të punësuar sektori buxhetor	11,122,212,688.00	11,122,212,688.00
7500400	Kontribute suplementare	1,327,369,496.00	1,327,369,496.00
7501100	Sig.shoq të punësuar sektori jo buxhetor	1,649,249,652.00	1,649,249,652.00
7501400	Kontribute suplementare	3,716,985.00	3,716,985.00
7502100	Sig.shoq të punësuar sektori privat	15,536,871,126.00	15,536,871,126.00
7502400	Kontribute suplementare	48,759,992.00	48,759,992.00
7510100	Sig.shoq të punëdhënës sektori buxhetor	17,674,655,596.00	17,674,655,596.00
7510400	Kontribute suplementare	10,614,899.00	10,614,899.00
7511100	Sig.shoq të punëdhënës sektori jo buxhetor	2,603,551,100.00	2,603,551,100.00
7511400	Kontribute suplementare	28.00	28.00
7512100	Sig.shoq të punëdhënës sektori privat	27,089,801,415.00	27,089,801,415.00
7512400	Kontribute suplementare	60,971,147.00	60,971,147.00
7520100	Sig.shoq të vetëpunësuar	3,410,167,509.00	3,410,167,509.00
	Total llog.sig.shoqërore+suplementar	80,537,941,633.00	80,537,941,633.00
7090101	Kamatvonesa të kontributeve sig.shoqërore	100,223,340.00	100,223,340.00
7115101	Gjoha të sigurimeve shoqërore	205,920,296.00	205,920,296.00
	Total llog.sig.shoqërore+suplementar+kamt+gjoha	80,844,085,269.00	80,844,085,269.00

Shumat e transferuara në TSA

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Gjendja në fillim Janar 2019	2,064,157,675.04
2	Tatimore (Llog.75)	80,537,941,633.00
3	Llogaria -711 (jo tatimore) gjoha	205,920,296.00
4	Llogaria 7090101- Kamatvonesa sig.shoq.	100,223,340.00
5	Totali i të ardhurave	80,844,085,269.00
	Transferuar nga TSA progresive	80,948,000,000.00
	Gjendja në fund për tu mbartur dhe transferuar	1,960,242,944.04

Me shkresën nr.1634, datë 21.02.2020, FSDKSH ka dërguar në MFE rakordimin për arkëtimet dhe transferimet e të ardhurave nga kontributet e sigurimit shëndetësor.

Rakordim për transferimet dhe arkëtimet në TSA për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

Nr.Llog	Emërtimi i llogarive	DPT	MFE
7500200	Sigurime shëndetësore, të punësuar në sektorin buxhetor	2,084,344,491.00	2,084,344,491.00
7501200	Sigurime shëndetësore, të punësuar në sektorin jo buxhetor	308,644,631.00	308,644,631.00
7502200	Sigurime shëndetësore të punësuar në sektorin privat	3,585,963,342.00	3,585,963,342.00
7510200	Sigurime shëndetësore, punëdhënës sektori buxhetor	2,084,808,382.00	2,084,808,382.00
7511200	Sigurime shëndetësore, punëdhënës sektori jo buxhetor	308,735,909.00	308,735,909.00
7512200	Sigurime shëndetësore, punëdhënës sektori privat	3,583,859,944.00	3,583,859,944.00
7520200	Sigurime shëndetësore, vetëpunësuar	952,439,216.00	952,439,216.00

	Total llog.sig.shëndetësore	12,908,795,915.00	12,908,795,915.00
7090104	Kamat vonesa të kontributeve të sig. shëndetësore	12,633,617.00	12,633,617.00
7115118	Gjoha të sigurimeve shëndetësore	30,943,583.00	30,943,583.00
	Total llog.sig.shëndetësore+kamat+gjoha	12,952,373,115.00	12,952,373,115.00

Shumat e transferuara në TSA

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Gjendja në fillim Janar 2019	218,351,010.06
2	Tatimore (Llog.75)	12,908,795,915.00
3	Llogaria -711 (jo tatimore) gjoha	30,943,583.00
4	Llogaria 7090101- Kamatvonesa sig.shoq.	12,633,617.00
5	Totali i të ardhurave	12,952,373,115.00
	Transferuar nga TSA progressive	12,220,000,000.00
	Gjendja në fund për tu mbartur dhe transferuar	950,724,125.06

Në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 “ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar pika V.1 Buxheti i sigurimeve shoqërore , pika 226, citohet se transfertat për sigurimet shoqërore të miratuara në buxhetin vjetor dhe të çelura nga MFE kryhen nga strukturat përgjegjëse për thesarin në Tiranë për tek ISSH; sipas pikës 227 llogaritë bankare që pasqyrojnë kontributet e sigurimeve shoqërore të arkëtuara nga DPT konsiderohen llogari të ardhurash të buxhetit të shtetit dhe sipas pikës 229, në Bankën e Shqipërisë funksionon një llogari speciale për menaxhimin e transaksioneve dhe pagesave të buxhetit të ISSH dhe Ministri i Financave cakton personat e autorizuar për të vepruar me këtë llogari.

Totali i debitorëve sipas formatit të deklaratës në sistemin C@TS dhe deklaratës para krijimit të sistemit C@TS, paraqitet si vijon:

Në lekë

Tatimi sipas Revenue Code	Çelja	Pagesa me Bankë	Shlyerja me kredi	Falje	Gjendja e ndryshuar	Detyrim i vitit 2019	Progresiv
Kontribute të Sigurimeve Shoqërore/Shëndetësore/TAP C@TS	10,074,792,331	2,224,539,709	74,532,522	35,921,373	7,739,798,727	4,114,103,707	11,853,902,434
Kontribute të Sigurimeve Shoqërore para C@TS	5,949,249,136	169,497,688	60,991,696	5,467,221	5,713,292,531	103,886,278	5,817,178,809
Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi para C@TS	949,050,940	14,623,957	28,694,919	1,724,062	904,008,002	40,626,616	944,634,618
Kontribute të Sigurimeve Shëndetësore para C@TS	136,343,606	371,631	235,357	90,004	135,646,614	1,657,818	137,304,431
TOTALI	17,109,436,013	2,409,032,985	164,454,494	43,202,660	14,492,745,874	4,260,274,419	18,753,020,292

Burimi: DAK

Shënim: Në totalin e debitorëve nga kontributet përfshihen: Debitorë për kontributet e sigurimeve shoqërore/shëndetësore/TAP/gjoha/kamatvonesa.

Nga informacioni i administruar nga DAK dhe sistemi C@TS, në datë 31.12.2019, debitorët nga kontributet rezultojnë në total në progresiv në shumën 18.7 mld lekë nga të cilat 4.2 mld lekë është debia e vitit 2019, pra 22% e debisë është krijuar gjatë vitit 2019.

Debitorë nga kontributet e sigurimeve sipas formës ligjore

Në lekë

Forma Ligjore	Detyrim i vitit 2019 (detyrim i ri)	TOTAL PROGRESIV
Ent publik	59,503,962	678,729,462
Ent privat	4,121,460,651	18,074,240,816
Grand Total	4,180,964,613	18,752,970,278

Burimi: DAK/përpunuar nga KLSH

Në shumën totale progresive prej 18.7 mld lekë që janë debitorët për kontributet, debia e enteve publike zë 3.6% të peshës specifike të borxhit ose e shprehur në vlerë, në shumën 678 mln lekë. Për vitin 2019, nga 4.1 mld lekë që është debia totale, entet publike zënë 1.4% të peshës specifike të borxhit ose e shprehur në vlerë, në shumën 59 mln lekë.

Në lekë

Forma Ligjore	Detyrim i vitit 2019 (detyrim i ri)	TOTAL PROGRESIV
Ent publik	59,503,962	678,729,462
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	4,800,139	96,264,340
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	2	22,263,618
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	264,573	1,327,178
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	4,164,064	61,796,282
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	14,904,025	184,404,476
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	2,369,538	88,084,256
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër	1,517,820	11,673,215
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	-	2,287,579
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	179,885	330,072
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	156,652	1,463,240
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	7,049,122	14,105,064
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	222,204	32,978,454
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	13,795,922	146,002,251
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	10,080,016	15,429,252
(blank)	-	320,185
Ent Privat	4,121,460,651	18,074,240,816
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	91,850,165	757,070,622
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	44,316,038	232,241,430
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	21,016,086	262,882,034
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	398,978,724	1,843,033,820
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	219,196,805	971,127,491
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	267,234,084	1,319,830,655
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër	59,803,077	397,838,809
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	151,227,468	724,873,464
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	26,994,693	166,622,226
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	118,532,966	499,508,940
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	86,225,372	364,471,368
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	156,638,653	821,393,331
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	1,767,323,973	7,798,813,933
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	165,244,625	1,307,742,861
(blank)	546,877,922	606,789,832
Grand Total	4,180,964,613	18,752,970,278

Shënim: Si rezultat i përpunimit të materialit shumë voluminoz disa shuma kanë dalë të paemërtuara, por ky gabim në përpunim nuk është material dhe si i tillë nuk ndikon në konkluzionet e nxjerra.

Në totalin progresiv të debisë, entet publike janë debitorë për kontribute në shumën 678,729,462 lekë, ku 85% të peshës specifike të debisë, e zënë 5 DRT në shumën 576,551,605 lekë, si vijon:

Forma Ligjore	TOTAL PROGRESIV
Ent publik	576,551,605
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	184,404,476

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	146,002,251
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	96,264,340
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	88,084,256
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	61,796,282

Në debinë e re të krijuar gjatë vitit 2019, entet publike janë debitorë në shumën 59,503,962 lekë, ku 98% të peshës specifike të debisë e zënë 8 DRT në shumën 58,680,646 lekë, si vijon:

Forma Ligjore	Detyrim i vitit 2019 (detyrim i ri)
Ent publik	58,680,646
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	14,904,025
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	13,795,922
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	10,080,016
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	7,049,122
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	4,800,139
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	4,164,064
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	2,369,538
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	1,517,820

Ente publike debitorë janë rreth 422 në shumën totale progresive prej 678,729,462 lekë, nga të cilat detyrim i vitit 2019 është 59,503,962 lekë.

Rreth 80% të debisë e përbëjnë institucionet e grupuar si vijon:

-21 Reparte Ushtarake debitorë në shumën totale progresive prej 271,682,957 lekë, prej të cilës shuma 19,075,958 lekë është detyrim i vitit 2019;

-23 Bashki janë debitorë për kontributet në shumën totale prej 96,576,747 lekë, nga të cilat detyrim të ri gjatë vitit 2019 kanë krijuar 5 Bashki (Kukës/Tepelenë/Has/Himarë/Njësia Bashkiake nr.5 TR) në shumën 8,552,391 lekë;

-105 Komuna të cilat rezultojnë debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 45,115,302 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 777,366 lekë;

- Drejtoria Vendore e ASHK TR Rurali 1, debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 35,207,836 lekë;

-Njësia e programit IADSA debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 28,400,101 lekë, prej të cilave detyrim i vitit 2019 në shumën 9,942,573 lekë;

-8 Ministri debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 23,555,682 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 6,327,257 lekë;

- Kombinati i Tekstileve të Pambukta dhe Hotel Dajti, me debi totale progresive në shumën 12.7 mln lekë;

-9 Struktura policore me debi totale progresive në shumën 9,321,733 lekë , nga të cilat detyrim i vitit 2019 në shumën 7,200,240 lekë;

- 4 institucione arsimore me debi totale në shumën 7,219,160 lekë, nga të cilat detyrim I vitit 2019 në shumën 725,942 lekë;

-6 Projekte debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 722,223 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 179,885 lekë;

-25 Qendra Shëndetësore debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 654,071 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 210,540 lekë.

Sqarojm se nj numr i konsiderueshm entesh publike kan pushuar juridikisht s funksionuari dhe pavarisht ktij fakti ende rezultojn debitor ndaj kontributeve t sigurimeve shoqrore dhe shndetsore.

50 debitorët më të mëdhenj nga entet publike paraqiten në Aneksin e këtij Raporti Perfundimtar Auditimi.

Rreth 64,000 entet private rezultojnë debitore për kontributet në shumën progresive prej 18,074,240,816 lekë, ose 96% të debisë totale prej 18,752,970,278 lekë, nga e cila 4,121,460,651 lekë është detyrim i ri i krijuar gjatë vitit 2019.

50 debitorët më të mëdhenj ente private në total kanë një debi progresive në shumën 1,675,030,783 lekë, nga e cila debi e krijuar gjatë vitit 2019 arrin në shumën 137,113,774 lekë. Nga 50 debitorët më të mëdhenj 64% të debisë e zënë 3 prej tyre në shumën 1,075,194,770 lekë (ARMO në shumën 537,989,577 lekë/ AGONSET në shumën 301,538,166 lekë/ ALSAT në shumën 235,667,027 lekë). 50 debitorët më të mëdhenj nga entet private paraqiten në Aneksin e këtij Raporti Pwrfundimtar Auditimi.

Strukturat përgjegjëse në DPT dhe DRT duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e neneve 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neneve 3;4 &14 të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk kanë realizuar mbledhjen dhe transferimin në fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor të shumës prej 18.7 mld lekë e cila nga njëra anë përbën të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në zbatim të Rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, është detyrë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve të sigurojë strategjinë menaxhuese dhe të drejtojë ATQ me qëllim mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (neni 5 i rregullores së brendshme të ATQ). Gjithashtu zv/Drejtori i Përgjithshëm i hartimit të programeve, garanton dhe merr masa që veprimtaritë e drejtorive që ka në varësi të maksimizojnë mbledhjen e të ardhurave me një kosto minimale duke përmirësuar nivelin e shërbimit ndaj tatimpaguesve (neni 93 i rregullores së brendshme të ATQ).

Struktura direkte përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve është Drejtoria e Mbledhjes me Forcë e cila ka si objekt të punës së saj udhëheqjen metodologjike dhe funksionin monitorues mbi DRT lidhur me procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, borxhit tatimor ((neni 108 i rregullores së brendshme të ATQ).

Për këtë çështje znj.D I, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ka bërë komente dhe shpjegime, me observacionin e dërguar me shkresën nr.6272/55 datë 23.09.2020 cituar si më poshtë:

“...Prioritet i vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të administrimit ka qenë vjelja e borxhit tatimor, i cili në vazhdimësi ka ardhur në zbritje dhe në këto kushte, vlerat e cituara sipas konstatimit nuk pasqyrojnë situatën reale të detyrimeve të papaguara dhe për më tepër nuk janë përgjegjësi direkte e titullarit të emëruar vetm në gjysmën e dytë të vitit kalendarik”.

Qëndrimi i Audituesit:

Në përgjigje të observacionit Tuaj, Ju bëjmë me dije se të dhënat e paraqitura në akt konstatim dhe projekt raport janë të dhëna zyrtare, të marra nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit në DPT. Për sqarim viti 2019 është celur me borxh në shumën 17.1 mld lekë, gjatë vitit është shlyer

detyrim nëpërmjet pagesave me bankë/shlyer me kredi/falur në shumën 2.6 mld lekë dhe është shtuar detyrim i ri gjatë vitit 2019 në shumën 4.2 mld lekë, duke sjell për rrjedhojë që borxhi progresiv në fund të vitit 2019 të rezultojë në shumën 18.7 mld lekë. Pra sic del nga të dhënat zyrtare të DPT-s gjatë vitit 2019 është paksuar borxhi me 2.6 mld lekë, ndërkohë që është shtruar me 4.2 mld lekë që do të thotë në shumë absolute borxhi në fund të vitit 2019 është rritur me 1.6 mld lekë krahasuar me vitin 2018. Pavarësisht përpjekjeve të bëra për shlyerje borxhi gjatë vitit 2019 në shumën 2.6 mld lekë, borxhi i krijuar rishtazi gjatë vitit 2019 mbetet në shifra shumë të larta , 4.2 mld lekë.

Në zbatim të Rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, (neni 5 i rregullores së brendshme të ATQ) është **detyrë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve** të sigurojë strategjinë menaxhuese dhe të drejtojë ATQ me qëllim mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Mungesa e një strategjie të mirëstudiuar menaxhuese ka sjell për pasojë që strukturat përgjegjëse në DPT dhe DRT të mos realizojnë mbledhjen dhe transferimin në fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor të shumës prej 18.7 mld lekë e cila nga njëra anë përbën të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte riskojnë të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e neneve 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neneve 3;4 &14 të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në konkluzion: Observacioni i paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me pretendimin se, të dhënat mbi borxhin ndaj kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nuk pasqyrojnë situatën reale të detyrimeve të papaguara, si dhe nuk mund të jetë përgjegjësia direkte e titullarit i cili është emëruar vetëm në gjysmën e dytë të vitit kalendarik, nuk merret parasysh si i pavërtetuar nga ana dokumentare dhe i pambështetur nga ana ligjore.

Në lidhje me dërgimin e listëpagesave në ISSH situata paraqitet si vijon:

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2019.

DRT	Listëpagesa Totale	Normale	Ndryshime	Pa deklaruar	Paguar plotësisht(përve TAP)	Dërguar në ISSH
DRT Berat	49,821	48,832	989	251	48,205	48,190
DRT Dibër	27,598	26,360	1,238	569	26,322	26,302
DRT DTM	12,297	10,442	1,855	28	12,192	12,149
DRT Durrës	161,878	156,628	5,250	4,115	146,045	145,989
DRT Elbasan	95,965	92,931	3,034	1,295	89,095	89,075
DRT Fier	120,336	116,483	3,853	1,517	112,454	112,428
DRT Gjirokastrë	31,422	30,615	807	414	29,828	29,823
DRT Korçë	76,561	73,092	3,469	1,370	72,045	72,036
DRT Kukës	15,034	14,333	701	400	14,126	14,121
DRT Lezhë	50,315	48,624	1,691	832	45,896	45,894
DRT Sarandë	33,182	32,378	804	425	31,496	31,486
DRT Shkodër	77,697	74,820	2,877	1,602	71,464	71,405
DRT Tiranë	571,636	549,148	22,488	16,210	515,459	515,249
DRT Vlorë	69,688	67,285	2,403	1,947	63,475	63,422
Total	1,393,430	1,341,971	51,459	30,975	1,278,102	1,277,569

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas Periudhave Tatimore për vitin 2019.

Periudha	Nr Subjekteve I	Listë pagesa Totale	Normale	Ndryshime	Pa Deklaruar	Paguar plotësisht (përveç TAP)	Dërguar në ISSH
1901	112,662	116,779	109,904	6,875	2,758	108,484	108,466
1902	112,114	114,853	109,605	5,248	2,509	106,780	106,766
1903	112,380	114,834	109,971	4,863	2,409	106,779	106,761
1904	112,885	114,696	110,325	4,371	2,560	106,190	106,169
1905	113,475	115,256	111,045	4,211	2,430	106,658	106,633
1906	114,743	116,337	112,291	4,046	2,452	107,652	107,632
1907	116,006	117,291	113,359	3,932	2,647	107,684	107,656
1908	116,084	117,308	113,534	3,774	2,550	107,481	107,454
1909	116,254	117,651	113,709	3,942	2,545	107,353	107,314
1910	115,773	116,741	112,999	3,742	2,774	105,261	105,188
1911	115,147	115,775	112,486	3,289	2,661	104,118	104,021
1912	115,423	115,909	112,743	3,166	2,680	103,662	103,509
Total		1,393,430	1,341,971	51,459	30,975	1,278,102	1,277,569

Listëpagesat e deklaruar dhe dërguar në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2019 për Sektorin Shtetëror (Buxhetorët).

DRT	Listë pagesa Totale	Normale	Ndryshime	Pa Deklaruar	Paguar plotësisht (përveç TAP)	Dërguar në ISSH
DRT Berat	1,011	951	60	4	1,011	1,011
DRT Dibër	1,070	1,010	60	11	1,066	1,060
DRT DTM	261	252	9	0	261	261
DRT Durrës	1,541	1,409	132	2	1,538	1,537
DRT Elbasan	1,655	1,499	156	0	1,629	1,629
DRT Fier	1,402	1,311	91	5	1,397	1,397
DRT Gjirokastrë	1,143	1,111	32	0	1,143	1,142
DRT Korçë	1,488	1,439	49	3	1,488	1,486
DRT Kukës	924	876	48	12	920	920
DRT Lezhë	874	818	56	5	873	873
DRT Sarandë	570	538	32	0	570	569
DRT Shkodër	1,471	1,378	93	0	1,470	1,470
DRT Tiranë	4,853	4,429	424	58	4,788	4,784
DRT Vlorë	834	790	44	0	828	827
Total	19,097	17,811	1,286	100	18,982	18,966

Listëpagesat e deklaruar dhe dërguar në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2019 për Sektorin Shtetëror (Jo- Buxhetorët).

DRT	Listë pagesa Totale	Normale	Ndryshime	Pa Deklaruar	Paguar plotësisht (përveç TAP)	Dërguar në ISSH
DRT Berat	72	72	0	0	52	52
DRT Dibër	94	88	6	0	94	94
DRT DTM	151	138	13	0	151	151
DRT Durrës	139	127	12	9	120	120
DRT Elbasan	169	150	19	0	169	169
DRT Fier	221	204	17	0	176	176
DRT Gjirokastrë	76	72	4	0	74	74
DRT Korçë	189	178	11	3	168	168
DRT Kukës	60	60	0	0	59	59
DRT Lezhë	80	72	8	0	55	55
DRT Sarandë	36	36	0	0	36	36

DRT Shkodër	133	120	13	12	108	108
DRT Tiranë	735	693	42	13	649	647
DRT Vlorë	126	122	4	0	114	114
Grand Total	2281	2132	149	37	2025	2023

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2019 për Sektorin Privat.

DRT	Listë pagesa Totale	Normale	Ndryshime	Pa Deklaruar	Paguar plotësisht (përveç TAP)	Dërguar në ISSH
DRT Berat	48,738	47,809	929	247	47,142	47,127
DRT Dibër	26,434	25,262	1,172	558	25,162	25,148
DRT DTM	11,885	10,052	1,833	28	11,780	11,737
DRT Durrës	160,198	155,092	5,106	4,104	144,387	144,332
DRT Elbasan	94,141	91,282	2,859	1,295	87,297	87,277
DRT Fier	118,713	114,968	3,745	1,512	110,881	110,855
DRT Gjirokastrë	30,203	29,432	771	414	28,611	28,607
DRT Korçë	74,884	71,475	3,409	1,364	70,389	70,382
DRT Kukës	14,050	13,397	653	388	13,147	13,142
DRT Lezhë	49,361	47,734	1,627	827	44,968	44,966
DRT Sarandë	32,576	31,804	772	425	30,890	30,881
DRT Shkodër	76,093	73,322	2,771	1,590	69,886	69,827
DRT Tiranë	566,048	544,026	22,022	16,139	510,022	509,818
DRT Vlorë	68,728	66,373	2,355	1,947	62,533	62,481
Grand Total	1,372,052	1,322,028	50,024	30,838	1,257,095	1,256,580

Shënime:

Periudha – Periudha tatimore mujore.

DRT - Drejtoria Rajonale Tatimore.

Tipi i Deklaruesit – Lloji i tatim paguesit sipas pronësisë dhe formës ligjore (Shtetëror buxhetor, shtetëtor jo buxhetor, sektori privat).

Nr i Subjekteve - Numri total i tatim paguesve që kanë deklaruar ose duhet të deklaronin një listë pagesë për periudhën në fjalë.

Listëpagesa Totale - Numri i listë pagesave total të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe ndryshime nga tatim paguesi ose ndryshime nga inspektori.

Normale – Numri i të gjithë listë pagesave të deklaruara nga tatim paguesi në versionin e parë.

Ndryshime - Numri i të gjithë listë pagesave të ndryshuara nga tatim paguesi ose inspektori në të gjitha versionet.

Pa Deklaruar - Numri total i tatimpaguesve që nuk kanë deklaruar një listë pagesë për periudhën në fjalë, por duhet ta deklaronin atë.

Paguar plotësisht (përveç TAP) - Numri i listë pagesave të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe ndryshime nga tatimpaguesi ose ndryshime nga inspektori, për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal për kodet e të ardhurave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. (Ky është numri i listëpagesave që duhet të dërgohen në ISSH).

Dërguar në ISSH - Numri i listë pagesave të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe ndryshime nga tatim paguesi ose ndryshime nga inspektori, për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal për kodet e të ardhurave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe janë dërguar në ISSH elektronikisht nëpërmjet eeb-service.

Nga auditimi për vitin 2019 rezulton se:

-Numri i listë pagesave në total të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe ndryshime nga tatim paguesi ose ndryshime nga inspektori është 1,393,430, prej të cilave paguar 1,278,102. Diferenca prej 115,328 listë pagesash janë debitorë për sigurimet, nga të cilat: 115 Sektori Buxhetor; 256 Sektori Shtetëror jo Buxhetor dhe 114,957 Sektori Privat.

-Nga 1,278,102 listë pagesa të paguar plotësisht (përvec TAP) janë dërguar në ISSH elektronikisht nëpërmjet eb-service 1,277,569, ose 533 listë pagesa më pak, prej të cilave: 16 Sektori Buxhetor; 2 Sektori Shtetëror Jo buxhetor dhe 515 Sektori Privat.

-Listë pagesa të padeklaruara (por që duhej të ishin deklaruar) 30,975, nga të cilat: 100 Sektori Buxhetor; 37 Sektori Shtetëror Jo buxhetor dhe 30,838 Sektori Privat. Krahësuar me vitin 2018 rezulton në ulje numri i listë pagesave të padeklaruara nga 34,002 në vitin 2018 në 30,975 në vitin 2019, por vërehet një rritje e numrit të listë pagesave të padeklaruara nga sektori buxhetor me 15 listë pagesa (100/2019-85/2018).

Në referencë të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPT dhe ISSH me nr.1142, datë 19.05.2017, përvec dërgimit të listë pagesave me ebservice online, bëhet edhe dërgimi periodik me kërkesë me e-mail, nga personat e kontaktit në ISSH tek personat e kontaktit në DTIK në DPT. Informacioni kërkohet dhe dërgohet 3-4 ditë pas përfundimit të periudhave 3 mujore të deklarimit (pas datës 20 të muajit pasardhës të përfundimit të cdo 3 mujori) elektronikisht dhe me e-mail.

Informacioni konsiston në të dhëna statistikore mbi numrin e tatim paguesve aktivë, mbi numrin e kontribuesve, të ndarë sipas DRT-ve, sipas llojit të biznesit, formës ligjore, për cdo muaj të 3 mujorit. Nga të dhënat e marra nga TIK rezulton se numri gjithsej i kontribuesve për sigurime shoqërore në datë 22.01.2020 është 655,092, numri i subjekteve aktive është 113,761.

Informacioni përmban edhe raport për situatën në sistemin C@TS të debitorëve për sigurimet shoqërore, i ndarë në principal, interesa dhe gjoba për pagesë dhe deklarim të vonuar vetëm për sigurimet shoqërore.

Të dhëna të detajuara, sipas DRT-ve, mbi shumën e debitorëve për sigurime shoqërore në datë 24.01.2020, pas përfundimit të 3 mujorit të fundit të vitit 2019, paraqiten si vijon:

Në lekë

DRT	Principal	Gjoba	Interesa	Debia
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	168,373,620	21,118,496	10,921,955	200,414,071
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	218,106,540	27,710,192	14,212,967	260,029,699
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	139,194,122	4,649,184	980,940	144,824,246
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	1,464,279,598	216,463,957	115,417,418	1,796,160,973
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	360,826,608	51,856,366	22,246,278	434,929,252
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	487,237,414	77,617,707	46,645,285	611,500,406
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	159,162,567	27,269,945	25,008,574	211,441,086
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	355,755,903	51,657,531	33,293,164	440,706,598
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	190,799,630	37,075,890	49,325,973	277,201,493
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	318,419,071	31,173,141	21,922,134	371,514,346
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	123,610,241	18,243,154	9,337,112	151,190,507
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	518,929,992	78,327,387	28,965,438	626,222,817
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	5,387,279,782	713,174,474	368,775,540	6,469,229,796
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	517,729,208	75,430,426	47,831,440	640,991,074
Grand Total	10,409,704,296	1,431,767,850	794,884,218	12,636,356,364

Në datë 24.01.2020 shuma debitorë vetëm për sigurime shoqërore dërguar në ISSH është 12.6 miliard lekë, nga të cilat peshën specifike më të lartë e ka DRT Tiranë me afërsisht 51% të

shumës totale të debisë, e pasuar nga DRT Durrës me 14%, DRT Fier, Vlorë dhe Shkodër me nga 5% secila dhe në total diferenca prej 20% i përket DRT të tjera.

Gjetje	Debitorë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në fund të vitit 2019 rezultojnë në shumën 18.7 mld lekë, prej së cilës 4.2 miliard lekë, ose 22% e debisë është detyrim i ri i krijuar gjatë vitit 2019.
Situata	<p>Deri në datë 31.12.2019, debitorët nga kontributet e sigurimeve rezultojnë në total në progresiv në shumën 18.7 mld lekë prej së cilës, 4.2 mld lekë ose 22% e debisë është detyrim i ri i krijuar gjatë vitit 2019. Në shumën totale progresive prej 18.7 mld lekë, debia e enteve publike zë 3.6% të peshës specifike të borxhit ose e shprehur në vlerë, rezulton në shumën 678 mln lekë. Në totalin progresiv të debisë, 678,729,462 lekë, 85% të peshës specifike, e zënë 5 DRT në shumën 576,551,605 lekë (DRT Elbasan; DRTTiranë; DRT Berat; DRT Fier; DRT Durrës). Për vitin 2019, nga 4.1 mld lekë që është debia totale, entet publike zënë 1.4% të peshës specifike të borxhit ose e shprehur në vlerë, në shumën 59 mln lekë, ku 98% të peshës specifike të debisë e zënë 8 DRT në shumën 58,680,646 lekë (DRT Elbasan; DRTTiranë; DRT Vlorë; DRT Sarandë; DRT Berat; DRT Durrës; DRT Fier; DRT Gjirokastrë). Nga auditimi rezultojnë rreth 422 ente publike debitorë për kontributet deri në fund të vitit 2019. Rreth 80% të debisë e përbëjnë institucionet e grupuar si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> -21 Reparte Ushtarake debitorë në shumën totale progresive prej 271,682,957 lekë, prej të cilës shuma 19,075,958 lekë është detyrim i vitit 2019; -23 Bashki janë debitorë për kontributet në shumën totale prej 96,576,747 lekë, nga të cilat detyrim të ri gjatë vitit 2019 kanë krijuar 5 Bashki (Kukës/Tepelenë/Has/Himarë/Njësia Bashkiake nr.5 TR) në shumën 8,552,391 lekë; -105 Komuna të cilat rezultojnë debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 45,115,302 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 777,366 lekë; - Drejtoria Vendore e ASHK TR Rurali 1, debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 35,207,836 lekë; -Njësia e programit IADSA debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 28,400,101 lekë, prej të cilave detyrim i vitit 2019 në shumën 9,942,573 lekë; -8 Ministri debitorë për kontributet në shumën totale progresive prej 23,555,682 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 6,327,257 lekë; - Kombinati i Tekstileve të Pambukta dhe Hotel Dajti, me debi totale progresive në shumën 12.7 mln lekë; -9 Struktura policore me debi totale progresive në shumën 9,321,733 lekë, nga të cilat detyrim i vitit 2019 në shumën 7,200,240 lekë; - 4 institucione arsimore me debi totale në shumën 7,219,160 lekë, nga të cilat detyrim i vitit 2019 në shumën 725,942 lekë;

	<p>-6 Projekte debitore për kontributet në shumën totale progresive prej 722,223 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 179,885 lekë;</p> <p>-25 Qendra Shëndetësore debitore për kontributet në shumën totale progresive prej 654,071 lekë nga të cilat debi e krijuar gjatë vitit 2019 në shumën 210,540 lekë;</p> <p>Rreth 64,000 entet private rezultojnë debitore për kontributet në shumën progresive prej 18,074,240,816 lekë, ose 96% të debisë totale prej 18,752,970,278 lekë, nga e cila 4,121,460,651 lekë është detyrim i ri i krijuar gjatë vitit 2019.</p> <p>50 debitorët më të mëdhenj ente private në total kanë një debi progresive në shumën 1,675,030,783 lekë, nga e cila debi e krijuar gjatë vitit 2019 arrin në shumën 137,113,774 lekë, ku 64% të debisë e zënë 3 prej tyre në shumën 1,075,194,770 lekë (ARMO në shumën 537,989,577 lekë/ AGONSET në shumën 301,538,166 lekë/ ALSAT në shumën 235,667,027 lekë).</p> <p>Në datë 24.01.2020 shuma debitore vetëm për sigurime shoqërore dërguar në ISSH në zbatim të marrëveshjes dypalëshe është 12.6 mld lekë, ose 67% e totalit të debisë, nga të cilat peshën specifike më të lartë e ka DRT Tiranë me afërsisht 51% të shumës totale të debisë, e pasuar nga DRT Durrës me 14%, DRT Fier, Vlorë dhe Shkodër me nga 5% secila dhe në total diferenca prej 20% i përket DRT të tjera.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare”;</p> <p>Marrëveshja e bashkëpunimit me nr.1142, datë 19.05.2017 ndërmjet ISSH dhe DPT, etj ;</p> <p>Rregullore e brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017;</p> <p>Akte të tjerë ligjorë, nënligjorë dhe rregullative për funksionimin dhe drejtimin e punës.</p>
Ndikimi/Efekti	Të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor.
Rëndësia	I Lartë

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.16, datë 24.07.2020.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me përcaktimet e neneve 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 3;4 &14 të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 5;93&108 të Rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, përgjegjësi menaxheriale për mosmbledhjen dhe mostransferimin në fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor të shumës 18.7 mld lekë, nga të cilat 4.2 mld lekë të krijuara gjatë vitit 2019, mbajnë:

- 1. Znj.D I, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së për periudhën 18.07.2019-31.12.2019;*
- 2. Z.E D, në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së për periudhën 04.04.2019-18.07.2019;*
- 3. Z.Xh C në cilësinë e ish zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Hartimit të Programeve; për periudhën 01.01.2019-04.04.2019;*
- 4.Znj. F L, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Menaxhimit dhe Analizës në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë.*

B3. Realizimi i të ardhurave nga tatim fitimi për vitin 2019, analiza sektoriale dhe sipas kontribuesve të mëdhenj


Në bazë të evidencave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit, rezultojnë se të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë raportuar në shumën **36,484,399 mijë lekë**. Krahësohet me planin e miratuar të të ardhurave prej 33,500,000 mijë lekë, ky zë rezultojnë me një tejkalim prej **8.91%** ose **2,984,399 mijë lekë më shumë**. Krahësohet me një vit më parë, ky zë të ardhurash ka një rritje prej 2,070,437 mijë lekë ose +6%. Sa trajtuar edhe në pikën B.1 të programit të auditimit në lidhje me programimin e të ardhurave tatimore, zëri “të ardhura nga tatimi mbi fitimin” është i vetmi zë i planifikuar në trend rënës edhe pse të ardhurat e realizuara në vitin 2018 kanë rezultuar me tejkalim dhe parashikimet e vetë DRT-ve kanë qenë shumë optimiste me një total parashikim arkëtimesh prej 34,413,963 mijë lekë ose 913,963 mijë lekë më shumë se plani miratuar nga MFE. Nisur nga specifikat e llogaritjes së detyrimit për tatimin mbi fitimin për shkak të diferencave në kohë të mbylljes së vitit kalendarik dhe financiar kundrejt afateve të raportimeve fiskale, burimi i arkëtimit në këtë zë janë:

- 1) parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimin bazuar në vlerësimet e njoftuara nga administrata tatimore
- 2) pagesat për detyrimin e lindur në momentin e deklarimit të fitimit të tatueshëm si dhe
- 3) pagesat e detyrimeve të periudhave të mëparshme (debitore).

Sipas përcaktimeve të Ligjit 8438, datë 28.12.1998 për Tatimin mbi të Ardhurat, kreu III, i ndryshuar, me Ligjin nr.177/2013, ndryshuar me Ligj nr.105/2017, dt.30.11.2017, bazuar në të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës, dorëzuar nga tatimpaguesi brenda datës 31 Mars të vitit vijues, administrata tatimore, llogarit këstet mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin për periudhën Prill –Dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën Janar –Mars të vitit të ardhshëm dhe i njofton tatimpaguesit brenda datës 30 Prill të çdo viti. Ndërkohë, këstet e paradhënies të tatimit mbi fitimin, përcaktuar si më sipër paguhen nga tatimpaguesit në bazë tremujore ose në bazë mujore. Në këtë mënyrë, burimi kryesor i të ardhurave të arkëtuara dhe

raportuara për zërin “tatimi mbi fitimin” janë parapagimet e kësteve në shumën 23,886,193 mijë lekë ose **65.5% e të ardhurave**, dhe 12,528,533 mijë lekë ose **34.3%** nga pagesat direkte të tatimit mbi fitimin dhe **0.2%** nga kamatëvonesat.

Analiza e arkëtimeve mujore në llogarinë tatim mbi fitimin, evidenton muajin Mars si muaji me arkëtimet më të larta për shkak të afateve të deklarimeve vjetore të tatim fitimit, me **5,649,877 mijë leke ose 45% e arkëtimeve vjetore, nga të cilat 1,760,821 mijë lekë (31%) nga subjekte të sektorit publik dhe 3,875,199 mijë lekë (69%) nga subjekte të sektorit privat** (pa përfshirë subjektet e lojrave të fatit). Në mënyrë grafike, arkëtimet mujore nga pagesat e tatim fitimit dhe parapagimet e kësteve, paraqiten në grafikun në vijim:



Në këtë mënyrë, me deklarimin e rezultatit financiar më 31 Mars 2019, pagesat e tatim fitimit vijnë si diferencë e vlerësimeve paraprake të DPT të parapaguara në periudhën Prill-Dhjetor 2018 dhe Janar-Mars 2019 dhe rezultatit faktit të fitimit të tatueshëm të deklaruar për vitin e mbyllur 2019, duke shpjeguar kështu vlerën e lartë të arkëtimeve në muajin Mars 2019. Theksojmë se arkëtimet gjatë periudhës Prill- Dhjetor 2019 janë realisht këste parapagimesh për rezultatet e vitit 2019 që do të raportohet në Mars 2020. Pra të ardhurat e raportuara përfshijnë këstet e parapagimit për periudhën Janar- Mars 2019 në bazë të vlerësimit të fitimit të tatueshëm të parashikuar për vitin 2019 si dhe nga këstet e parapaguara të llogaritura mbi parashikimet e fitimit të tatueshëm për vitin 2020.

Një tjetër periudhë me arkëtime më të larta se **mesatarja mujore është muaji Dhjetor 2019**. Nga analiza e të dhënave rezulton se në shumë raste këstet nuk paguhën në mënyrë të rregullt në baza mujore apo tremujore por mund të paguhën në grup në dy muajt e fund vitit Nëntor-Dhjetor duke dhënë një impakt të drejtpërdrejtë në volumin e arkëtimeve në këto dy muaj.

Gjithashtu, në bazë të ligjit për të ardhurat, nëse organet tatimore vlerësojnë se tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese tatimore do të tejkalojë me më tepër se 10% tatimin mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin mbi fitimin e vlerësuar prej tyre. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrisë të Financave. Për të testuar impaktin që rishikimet e kësteve kanë pasur në arkëtimet e fund vitit u analizuan të dhënat e deklarimeve të tatim fitimit 2019 ku rezultoi se 1,179 subjekte kanë deklaruar një fitim mbi 10% më të lartë se viti 2018, nga të cilat kemi përzgjedhur për të testuar ndryshimin e kështit të parapagimit në C@TS pas deklarimit të 31 Marsit, 700 prej tyre të cilët kanë deklaruar një tatim fitimi mbi 50% më të lartë se viti 2018. Testimi parashikon krahasimin e të dhënave me tatim fitimit të deklaruar në dy

vite 2018-2019, këstet e paguara në muajt Janar-Mars të vlerësuara nga deklaratimet e vitit 2018 si dhe këstet e parapaguara në periudhën Prill –Dhjetor 2019 si dhe rastet kur administrata tatimore ka ushtruar të drejtën për rishikim të kësteve në rritje. Nga informacioni i vënë në dispozicion konstatohet se sistemi ka gjeneruar “zero detyrim” për parapagim këstesh pas deklarimit të Marsit 2019 dhe më pas është bërë rishikimi nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor. Në vijim të ballafaqimit kjo çështje mbetet për tu verifikuar nëse ka ndodhur ose jo.

Referuar Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të NJQP”, të ardhurat njihen në momentin e arkëtimit. Ndërkohë që këto arkëtime kanë një impakt të drejtpërdrejtë nga vlerësimet e kësteve të parapagimeve, ekziston rreziku i mbivlerësimit të realizimit të raportuar konsideruar këtu dhe gjendjen kreditore për parapagimet që DPT raporton si detyrime të pagueshme në pasqyrën e pozicionit financiar. Kështu, për një pamje më reale të ecurisë së këtij zëri të ardhurash, dhe vlerësimit për saktësinë e raportimit, arkëtimet e vitit 2019 janë analizuar në referencë të periudhës tatimore për të cilën është kryer pagesa nga ku rezulton se **arkëtimet neto për periudhën 2019 janë 23,351,140 mijë lekë** dhe 13,133,260 mijë lekë janë arkëtime në referencë të viteve të mëparshme (2018 dhe debitorë) përfshirë dhe kamatëvonesat për vonesa në deklarime dhe pagesa në shumën 69,673 mijë lekë, paraqitur në tabelën në vijim:

Në mijë lekë

Periudha	4665503- Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	7001100- Tatimi mbi Fitimin nga Ndërmarrjet Sektorit Publik	7001200- Tatimi mbi Fitimin nga Subjektet e Sektorit Privat	7001300- Tatimi mbi fitimin nga Subjektet e "Lojrave te Fatit"	7090106- Kamat vonesa nga Tatim Fitimi	Total
para 2011		10	2,566		1,006	3,581
2011		24	3,497		1,468	4,989
2012			10,368		3,684	14,052
2013	1,291	3	15,186		4,735	21,215
2014	50	177	34,830	157	2,231	37,446
2015	450,501	2,535	75,900	70	3,525	532,531
2016	20,366	640	159,210	23	9,044	189,282
2017	19,524	1,150,505	307,126	43	15,946	1,493,145
2018	546,694	3,950,928	6,225,811	93,719	19,867	10,837,019
2019	22,847,767	99,020	390,828	5,356	8,169	23,351,140
Total	23,886,193	5,203,842	7,225,323	99,368	69,673	36,484,399

Referuar arkëtimeve pagesat janë kryer nga **gjithsej 16521 subjekte**.

Referuar deklarimeve për tatim fitimin, sipas të dhënave të sistemit C@TS rezultojnë 23542 tatimpagues të cilët kanë plotësuar detyrimin e dorëzimit të deklarates së tatimit mbi fitimin për vitin 2019, nga të cilët **15,757 subjekte(67%)** kanë deklaruar fitim të periudhës dhe një vlerë “detyrimi të lindur për tu paguar” në shumën 29,151,699 mijë lekë ndërkohë që parapagimet për këtë periudhë janë në shumën 22,847,767 mijë lekë. Në mënyrë të përmbledhur informacioni mbi tatimin mbi fitimin e parapaguar kundrejt atij te deklaruar paraqitet në tabelën në vijim:

Situata	Nr. Subjekteve	Shuma detyrimit në 000/lekë	Parapagimet në 000/lekë	Debi/Kredi
Deklaruar 0 tatim/ 0 pagesa	5927			
Deklaruar tatim=pagesa	274	39,487	39,554	(67)
Deklaruar 0 tatim> pagesa	1792		798,252	(798,252)
Deklaruar tatim> pagesat	5359	7,768,854	10,789,950	(3,021,096)
Deklaruar tatim< pagesat	10190	21,343,358	12,141,412	9,201,946
Total	23542	29,151,688	23,769,168	5,382,531

Për sa i përket strukturës së 23,542 tatimpaguesve që kanë plotësuar detyrimin e deklaratës së tatimit mbi fitimin konstatohet se 18 prej tyre rezultojnë me status “c ‘regjistruar”, 798 subjekte listohen me status pasiv dhe 313 subjekte kanë bërë kërkesë për c ‘regjistrim ndërkohë që të gjithë kanë deklaruar fitim të tatueshëm për vitin e mbyllur 2018¹³.

Në 000/lekë

Nr. Subjekt eve	Statusi	Të ardhurat Tatimore	Fitimi i tatueshëm neto	Tatim fitimi me shkallën tatimore 5%	Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde	Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde të tjera	Tatim Fitimi i detyrueshëm për t'u paguar
22413	Aktiv	2,416,806,111	200,239,037	454,149	28,626,243	29,916	29,066,602
18	Çregjistruar	122,819	8,120	180	678		858
313	Kërkesë për Çregjistrim	2,244,814	216,323	4,324	23,040		27,364
798	Pasiv	4,788,184	498,520	8,964	47,677	234	56,875
23542	Total	2,423,961,928	200,962,000	467,617	28,697,638	30,149	29,151,699
Viti 2018							
23466	Total	2,395,184,823	229,955,257		34,352,893	261,275	34,332,359

Krahasuar me një vit më parë detyrimi për tatim fitimin sipas deklarimeve të 23,542 subjekteve është rreth 15% më i ulët ndërkohë që të ardhurat tatimore të deklaruara janë rritur me 1%. Efekt i kësaj ulje mund të jetë shkalla tatimore prej 5%, e cila hyri në fuqi më 1 Janar 2019 sipas Ligjit nr.39/2018, datë 09.07.2018 – Për disa ndryshime dhe shtesa Dispozitat ligjore në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar. Konkretisht, në nenin28, janë bërë diferencime të shkallës së Tatimit mbi Fitimin për disa kategori:

- 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14,000,000 lekë në vit;
- 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14,000,000 lekë në vit;
- 5% për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr.38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”;
- 5% për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit. *(Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”, deri më 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfitimit të statusit “subjekt i certifikuar agroturizmi”).* Në vijim të këtij Ligji, me Udhëzimin nr.12 datë 15.03.2019 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ministria përgjegjëse për Financat miraton zëvendësimin e “formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin” me formularin e ri i cili parashikon rubrika të veçanta sipas shkallëve të reja tatimore në fuqi. Gjithashtu, me Ligjin nr.84/2019 dt.18.12.2019 është shtuar, që për personat juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%, ndryshim që do të japë efektet në vitin 2020. Nga të dhënat e sistemit C@ATS rezulton se kanë përfituar nga shkalla e re tatimore **5336 subjekte** nga të cilët:

¹³Sqarojmë se data e statusit të cilit i jemi referuar është viti 2018 dhe 2019, duke përjashtuar ndryshimet e statusit gjatëvitit 2020.

- **5,258 subjekte me të ardhura të deklaruara deri në 14,000,000 lekë** duke gjeneruar një detyrim tatim fitimi në shumën 339,542 mijë lekë. Krahasuar me një vit më parë, nga deklaratimet e subjekteve të kësaj fashe kanë rezultuar me detyrim tatim fitimi 5432 subjekte në shumën 766,288 mijë lekë. Duket se shkalla e re tatimore nuk ka nxitur numrin e deklaruesve:

Sektori	Nr. subjekteve	Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde	Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5%
në Sektorin e Ndërtimit	512	795,645	31,127,671
në Sektorin e Prodhimit	685	389,939	34,041,819
në Sektorin e Shërbimit	1739	2,274,831	183,747,528
në Sektorin e Transportit	238	69,828	11,747,615
në Sektorin e Tregtisë	2084	834,244	78,877,619
Total	5258	4,364,487	339,542,252

- Ndërsa **77 subjekte me të ardhura të deklaruara mbi 14,000,000 lekë** kanë aplikuar shkallën tatimore 5% duke gjeneruar një detyrim tatim fitimi në shumën 128,075 mijë lekë. Sipas ndryshimeve ligjore këto subjekte duhet të kenë në objektin e veprimtarisë së tyre prodhimin/zhvillimin e softëare-ve ose aktivitetin e “agro-turizmit” pasi të jenë të certifikuar sit ë tillë. Sipas përshkrimit të objektit të aktivitetit konstatohet se shkallën tatimore 5% e kanë aplikuar edhe subjekte që nuk i përkasin këtyre dy fushave si bar-kafe, call center, ndërtim, tregti etj.

Objekti/fusha e aktivitetit	Nr. i subjekteve	Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5% në lekë	Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde në lekë
IT ¹⁴	60	121,394,038	49,964,088
Agro-turizem	2	3,882,023	0
Ndërtim/Mat. ndërtimi	4	1,186,476	22,888,084
Shërbim mjekësor	1	300,000	4,297,169
Tregti	6	707,863	1,514,112
Bar kafe	1	112,485	124,601
Call Center.	1	189,996	170,042
Marketing	1	300,000	1,743,169
Montim impante	1	2,265	174,755
Total	77	128,075,146	80,876,020

Gjithashtu, disa nga subjektet e listuar në fushën e teknologjisë dhe informacionit në objektin e veprimtarisë kanë përshkruar “tregtimin” e pajisjeve informatike dhe jo “dizenjim/prodhim”. Po kështu, subjektet në sektorin e agro-turizmit duhet të jenë më parë të certifikuar si të tilla përpara se të përfitojnë nga shkalla tatimore 5%.


¹⁴ “Për aktivitetet e mëposhtme të ushtruara nga personat juridikë aplikohet shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin prej 5%:

a) Dizenjim softëare—i. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit softëare, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit softëare;b) Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softëare. Këtu përfshihet programimi i sistemeve softëare, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që softëare-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e Zgjidhjes Informatike;c) Testim softëare. Këtu përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit softëare;ç) Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ ËAN/ ËLAN/ MAN/ SAN/ CAN);d) Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;dh) Zhvillim sistemesh migrimi. Këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re;e) Përmirësim/upgrade sistemesh informatike;ë) Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet softëare” thuhet në vendim.

Sipas tatimpaguesve individual kontribuesit më të mëdhenj në arkëtimet për tatim fitimin vijnë nga sektori bankar dhe ai energjitik por ku dallojnë arkëtimet nga OSHEE (8.9%) dhe KESH sh me 7.2% të totalit të arkëtimeve. Nga analiza e arkëtimeve sipas periudhës rezulton se këto pagesa në fakt janë për llogari të periudhave para vitit 2019: detyrime debitore rreth 5 miliard kundrejt 5.8 miliard pagesa gjithsej. Në tabelën në vijim janë listuar 50 subjektet që zënë rreth 41% të totalit të arkëtimeve për tatim fitimin gjatë vitit 2019:

N r.	Subjekti	Sektori	Detyrimi Para v.2018	Detyrimi v.2019	Total	Pesha specifike
1	O G	Sektorin e Prodhimit	3,257,000	-	3,257,000	8.9%
2	K Sh.a	Sektorin e Prodhimit	1,794,269	835,610	2,629,879	7.2%
3	B.K.T	Sektorin e Shërbimit	-	1,128,534	1,128,534	3.1%
4	t i a shpk	Sektorin e Transportit	-	712,139	712,139	2.0%
5	GJ K	në Sektorin e Ndërtimit	201,697	278,864	480,561	1.3%
6	V A	Sektorin e Shërbimit	431,540	-	431,540	1.2%
7	u k t	Sektorin e Prodhimit	133,431	257,456	390,887	1.1%
8	B C	Sektorin e Shërbimit	46,070	294,270	340,340	0.9%
9	OST	Sektorin e Prodhimit	93,659	220,305	313,964	0.9%
10	A	Sektorin e Shërbimit	5,356	250,590	255,946	0.7%
11	M TCI	në Sektorin e Ndërtimit	135,547	117,718	253,264	0.7%
12	K GROUP	në Sektorin e Tregtisë	431	233,305	233,737	0.6%
13	S A	në Sektorin e Tregtisë	122,632	93,577	216,209	0.6%
14	A C	në Sektorin e Ndërtimit	77,671	90,793	168,464	0.5%
15	U B SHA	Sektorin e Shërbimit	31,960	130,596	162,556	0.4%
16	B T	Sektorin e Shërbimit	-	152,917	152,917	0.4%
17	E A	Sektorin e Prodhimit	127,993	21,331	149,324	0.4%
18	A-B	në Sektorin e Ndërtimit	6,756	142,296	149,052	0.4%
19	ITX A	në Sektorin e Tregtisë	16,924	132,079	149,003	0.4%
20	F B	Sektorin e Shërbimit	13,463	134,574	148,037	0.4%
21	K Z	në Sektorin e Tregtisë	46,468	89,418	135,886	0.4%
22	T E G	Sektorin e Shërbimit	29,075	103,500	132,575	0.4%
23	K	në Sektorin e Tregtisë	3,991	126,874	130,866	0.4%
24	Al m s	Sektorin e Shërbimit	20	128,736	128,757	0.4%
25	B P I-A	Sektorin e Shërbimit	16,237	104,023	120,259	0.3%
26	A	në Sektorin e Tregtisë	12,286	106,281	118,567	0.3%
27	C-C B	Sektorin e Prodhimit	7,875	108,000	115,875	0.3%
28	B	në Sektorin e Ndërtimit	96,799	13,656	110,455	0.3%
29	DPSHTRR	Sektorin e Transportit	21,905	87,063	108,968	0.3%
30	AD	Sektorin e Prodhimit	10	108,818	108,828	0.3%
31	A D & D.	Sektorin e Prodhimit	5,107	101,825	106,932	0.3%
32	IC A	Sektorin e Shërbimit	43,801	61,325	105,126	0.3%
33	DURRES C T	Sektorin e Transportit	26,797	77,961	104,757	0.3%
34	B A I	Sektorin e Shërbimit	49,433	54,466	103,899	0.3%
35	C,	Sektorin e Prodhimit	-	103,800	103,800	0.3%
36	A SHA	Sektorin e Prodhimit	70,020	30,100	100,120	0.3%
37	J- V R T Albania	në Sektorin e Ndërtimit	-	98,393	98,393	0.3%
38	a p durres	Sektorin e Transportit	29,719	68,400	98,119	0.3%
39	D	Sektorin e Prodhimit	36,507	60,389	96,896	0.3%
40	R I -	Sektorin e Shërbimit	-	95,338	95,338	0.3%
41	"G 2"	Sektorin e Shërbimit	19,739	74,044	93,782	0.3%
42	I SANPAOLO BANK AL.	Sektorin e Shërbimit	-	92,250	92,250	0.3%
43	"B.M" SHPK	në Sektorin e Tregtisë	27,188	60,750	87,938	0.2%
44	A	Sektorin e Transportit	50,990	36,317	87,307	0.2%
45	E-SA	Sektorin e Prodhimit	-	85,991	85,991	0.2%
46	S e r e	Sektorin e Prodhimit	-	85,276	85,276	0.2%
47	Albc	Sektorin e Prodhimit	-	82,265	82,265	0.2%
48	N	në Sektorin e Tregtisë	5,084	76,603	81,687	0.2%
49	BFI T	në Sektorin e Tregtisë	11,812	69,830	81,642	0.2%
50	"ALDOSCH"	në Sektorin e Tregtisë	44,677	35,564	80,241	0.2%
		TOTAL	7,151,939	7,654,210	14,806,148	

Sipas klasifikimit të sektorëve të ekonomisë burimi i arkëtimeve të të ardhurave nga tatimimbi fitimin rezulton të jetë sektori i prodhimit me 31% ndjekur nga sektori i shërbimit me 26% dhe sektori i tregtisë me 25%.



Referuar deklaratës së tatim fitimit 2019 të ardhurat tatimore të deklaruara rezultojnë të jenë 15% më të ulta. Ndryshimet strukturore përsa i përket numrit të subjekteve për çdo sektor nga një vit në tjetrin nuk e justifikon rënien prej 15% ndërkohë që numri i subjekteve, objekt i tatim fitimit është rritur me 3% (nga të cilët subjekte me TVSH janë rritur me 7% dhe subjektet biznes i vogël me TVSH janë rritur me 8%):

Sektori ekonomik	Nr. Tatimpagueseve 2017	Nr. Tatimpagueseve 2018	Nr. Tatimpagueseve 2019	2019/2018
në Sektorin e Ndërtimit	4,319	4,391	4,710	7%
në Sektorin e Prodhimit	11,396	11,186	11,299	1%
në Sektorin e Shërbimit	50,197	50,673	53,343	5%
në Sektorin e Transportit	5,289	5,336	5,474	3%
në Sektorin e Tregtisë	40,165	39,130	39,003	-0.3%
Total	111,366	110,716	113,829	3%
Me TVSH	37,616	51,614	55,243	7%
BV me TVSH	16,998	30,170	32,509	8%

Niveli dhe trendi i arkëtimeve krahasuar me nivelin e të ardhurave të deklaruara sipas sektorëve paraqitet në tabelën në vijim, ku dallon rënia prej rreth **-46% e kontributit të sektorit të prodhimit dhe me -17% të sektorit të ndërtimit:**

Në mijë lekë

Sektori	Të ardhurat Tatimore		Ndryshimi	Totali i tatim fitimit 2019		Ndryshimi	Arkëtimet
	2019	2018		2019	2018		
Sektori ndërtimit	263,872,565	287,126,482	-8.10%	3,953,609	4,760,855	-17.00%	4,775,806
Sektori Prodhimit	403,608,501	450,502,335	-10.40%	5,376,658	9,921,651	-45.80%	11,383,241
Sektori Shërbimit	616,629,579	528,055,028	16.80%	10,029,234	9,448,080	6.20%	9,451,956
Sektori Transportit	64,644,564	62,757,898	3.00%	1,516,807	1,545,393	-1.80%	1,791,399
Sektori Tregtisë	1,075,206,719	1,066,743,080	0.80%	8,319,097	8,656,380	-3.90%	9,081,997
Total	2,423,961,928	2,395,184,823	1.20%	29,195,405	34,332,359	-15.00%	36,484,399

Deklarimet e sektorit të prodhimit do të kërkonin një analizë më të thelluar për të shpjeguar rënien prej 45.8% ndërkohë që të ardhurat tatimore të deklaruara kanë rënë me vetëm 10%.

Renditur nga tatim fitimi i deklaruar, 40 subjektet me kontributin më të madh (36%) në sektorin e prodhimit rezultojnë të jenë të njëjtët kontribues si KESH sha, KURUM, UK Tiranë, OST, Fabrika e cimentos Fushë-Krujë ndërkohë që OSHEE, Albchrome kanë raportuar humbje tatimore krahasuar me një vit më parë:

Në mijë lekë

	Emri subjektit	Viti 2018		%	Viti 2019		+/-
		Të ardhurat tatimore	Tatim Fitimi i detyrueshë m për t'u paguar		Të ardhurat tatimore	Tatim Fitimi i detyrueshë m për t'u paguar	
1	Ko E Sh	27,348,513	2,981,244	8.7%	9,998,431	783,394	-74%
2	O ShE E	56,605,006	1,337,449	3.9%	57,938,581	-	-100%
3	b k t	44,254,431	1,224,413	3.6%	144,658,853	1,190,822	-3%
4	t i a shpk	6,415,412	610,939	1.8%	6,961,069	689,451	13%
5	R B SH.A	10,948,723	549,871	1.6%	9,687,106	372,320	-32%
6	V A	15,206,347	385,046	1.1%	14,977,886	441,342	15%
7	GJ K	6,508,835	329,297	1.0%	5,836,415	211,667	-36%
8	B C	13,990,368	327,671	1.0%	10,726,542	223,261	-32%
9	OST	8,764,141	273,004	0.8%	7,517,108	142,349	-48%
10	S T	23,741,492	259,916	0.8%	12,005,471	-	-100%
11	M TCI	6,936,199	250,951	0.7%	4,326,047	75,906	-70%
12	K GROUP	61,756,413	242,278	0.7%	65,223,010	283,661	17%
13	U K T	4,802,639	236,573	0.7%	4,407,804	153,824	-35%
14	Albc	8,016,984	202,227	0.6%	4,817,695	-	-100%
15	B	2,692,212	163,873	0.5%	413,728	-	-100%
16	J v r T	11,992,666	161,670	0.5%	4,872,148	100,013	-38%
17	i s b	4,539,034	160,693	0.5%	3,607,894	254,164	58%
18	GSA	11,382,787	153,134	0.5%	11,078,132	100,138	-35%
19	k i sh.a.	26,742,052	143,927	0.4%	25,187,100	218,566	52%
20	F B	2,485,362	138,688	0.4%	2,982,504	114,397	-18%
21	A E	2,407,511	135,608	0.4%	32,571	-	-100%
22	ITX	3,348,110	135,512	0.4%	3,549,681	152,673	13%
23	A-B	2,841,114	129,806	0.4%	4,458,880	183,646	41%
24	F-K C F	6,739,050	129,803	0.4%	6,931,255	134,085	3%
25	E A	3,421,365	127,983	0.4%	1,689,286	-	-100%
26	S A	6,603,436	127,510	0.4%	6,613,163	37,291	-71%
27	A M S	3,831,334	124,012	0.4%	4,562,988	165,915	34%
28	b a i sha	2,639,715	117,228	0.3%	3,747,045	178,201	52%
29	A SHA	6,521,050	115,845	0.3%	4,229,110	96,919	-16%
30	BFI T	4,079,312	114,903	0.3%	1,323,381	30,030	-74%
31	K	16,118,065	113,953	0.3%	16,478,731	157,623	38%
32	A C	6,716,583	112,671	0.3%	6,872,199	121,193	8%
33	A	15,448,829	108,814	0.3%	15,912,896	100,568	-8%
34	U B SHA	2,760,459	108,399	0.3%	2,948,816	120,878	12%
35	T A P	1,237,144	108,192	0.3%	880,521	18,879	-83%
36	A A Sh.a	1,965,524	105,268	0.3%	3,307	-	-100%
37	T E G	1,156,853	102,318	0.3%	1,155,442	81,845	-20%
38	R I- Shoqeri	867,503	102,012	0.3%	848,936	98,979	-3%
39	K Z	2,124,491	100,454	0.1%	2,368,802	91,560	-9%

40	a d & d	4,833,831	94,536	0.1%	4,972,879	111,615	18%
	450,790,894	12,447,694	36%	496,803,412	7,237,175		
				+10%	-58%		
	2,395,184,823	34,332,359		2,423,961,928	29,151,699		

Sipas deklarimeve të Marsit 2019 për tatim fitimin e vitit 2018, 40 subjektet deklarojnë “tatim fitimi për tu paguar” në total **12.44 miliard lekë ose 36% të totalit të deklarimeve**. Këto deklarime kanë shërbyer si bazë për llogaritjen e kështit të parapagimit të tatim-fitimit për periudhën Prill- Dhjetor 2019. Ndërkohë, nga deklaratimet për vitin 2019, pothuaj të gjitha këto subjekte deklarojnë në total **7.2 miliard lekë “tatim fitimi për tu paguar” ose 58% më pak**. Në listë vecojmë OSHE, Albc, S T, E A të cilët për vitin 2019 kanë deklaruar humbje tatimore, ku OSHE është ende debitore për tatimin mbi fitimin me 4.9 miliard lekë (më 31.12.2019) përfshirë këtu kështet e tatim fitimit dhe gjoba.

Një konkluzion më i drejtë mbi kontributin e këtyre subjekteve në realizimin e të ardhurave për zërin “tatim mbi fitimin” do të kërkonte përfshirjen në analizën e riskut dhe të shpenzimeve e deklaruar nga këto subjekte, balancat e tyre debitore dhe tepricat kreditore. Psh. si në rastin e subjektit T A P i cili ka deklaruar rreth 29% më pak të ardhura të realizuar gjatë vitit 2019 krahasuar me një vit më parë dhe shpenzime 300% më shumë.

Megjithatë, deklaratimet e subjekteve nuk kanë impakt të drejtpërdrejtë në arkëtimet e vitit dhe **top lista e më të mëdhenjve në deklarime jo domosdoshmërisht ka patur dhe kontributin më të madh në arkëtimet e vitit**. Në tabelën në vijim evidentohen top40 subjektet kontribues në arkëtime të cilat sic është trajtuar edhe më lartë përfshijnë: parapagim këstesh, tatim fitimi-principali dhe pagesa të debitoreve përfshirë gjobat).


Nr.	Subjekti	Total arkëtime		Balanca Debitore	Balanca kreditore	Deklarim i i Marsit 2019
1	Op Sh E	3,257,000	8.9%	4,931,054	-	1,337,449
2	K E S Sh.a	2,629,879	7.2%	10,153	-	-
3	B K T	1,128,534	3.1%	-	-	1,224,413
4	T I A	712,139	2.0%	-	-	610,939
5	GJ K	480,561	1.3%	-	-	329,297
6	V A	431,540	1.2%	77,448	337,694	385,046
7	U K T	390,887	1.1%	30,554	-	236,573
8	B C	340,340	0.9%	-	27,136	327,671
9	o s t	313,964	0.9%	2,612	-	273,004
10	A	255,946	0.7%	-	-	
11	M TCI	253,264	0.7%	-	21	250,951
12	K GROUP	233,737	0.6%	-	-	242,278
13	S A	216,209	0.6%	-	-	127,510
14	A C	168,464	0.5%	-	-	112,671
15	U B SHA	162,556	0.4%	-	20,869	108,399
16	B E T	152,917	0.4%	-	235	-
17	E A	149,324	0.4%	2,169	-	127,983
18	A-B	149,052	0.4%	-	12,000	129,806
19	ITX A	149,003	0.4%	-	-	135,512
20	F B	148,037	0.4%	-	22,907	138,688
21	Kid Z	135,886	0.4%	-	7	100,454
22	T E G	132,575	0.4%	-	-	102,318
23	K	130,866	0.4%	-	3,384	113,953
24	A M S	128,757	0.4%	-	-	124,012
25	B P I-A	120,259	0.3%	-	16,854	80,946

26	AGNA	118,567	0.3%	-	-	108,814
27	C-C B SH	115,875	0.3%	-	-	87,375
28	B	110,455	0.3%	-	-	
29	D. P. SH. T. RR.	108,968	0.3%	-	-	94,056
30	AD	108,828	0.3%	-	-	-
31	A D & D	106,932	0.3%	-	7,878	94,536
32	IC Albania	105,126	0.3%	-	-	67,355
33	D C T	104,757	0.3%	-	-	76,625
34	B A I	103,899	0.3%	-	29,021	
35	C, d.o.o. - Tirane	103,800	0.3%	-	-	67,844
36	A SHA	100,120	0.3%	-	25,951	-
37	r t a branch	98,393	0.3%	-	-	-
38	A P D	98,119	0.3%	34,884	3,752	69,351
39	D	96,896	0.3%	-	-	69,423
40	R I-	95,338	0.3%	-	-	
	Top 40 subjekte	13,947,771	38.2%	5,088,874	507,710	7,355,255
	Total arketime viti 2019	36,484,399				


Arkëtimet e top40 subjekteve rezultojnë të jenë 45% më të larta se detyrimi i lindur duke përjashtuar këtu arketimet e OSHE pasi ato janë pagesa borxhi tatimor. Marrë këtu në konsideratë që pothuajse të gjitha subjektet në vijim kanë deklaruar një fitim akoma edhe më të ulët, duhet që Drejtoria e Menaxhimit të riskut dhe strukturat e kontrollit tatimor të analizojnë deklaratimet historike të këtyre subjekteve por edhe situatën e tyre lidhur me gjendjen kreditore një detyrim ky korrent për administratën tatimore, trajtuar më hollësisht në vijim të këtij raporti. Sipas drejtorive rajonale, parashikimi i arkëtimeve, plani miratuar dhe realizimi i këtij zëri paraqitet në tabelën në vijim:

		Parashikimet e DRT-ve	Plan 2019	Fakt 2019	Diff + ose -	Diff. Përqindje
	Tatimi mbi FITIMIN Total	34,413,963	33,500,000	36,484,399	2,984,399	8.91%
1	D.R. Tatimore Berat	230,000	317,000	332,037	15,037	4.74%
2	D.R. Tatimore Dibra	500,000	447,000	363,357	-83,643	-18.71%
3	D.R. Tatimore Durrësi	2,000,000	1,870,000	1,992,172	122,172	6.53%
4	D.R. Tatimore Elbasani	540,000	564,000	581,277	17,277	3.06%
5	D.R. Tatimore Fieri	870,835	928,000	869,347	-58,653	-6.32%
6	D.R. Tatimore Gjirokastra	230,000	197,000	168,131	-28,869	-14.65%
7	D.R. Tatimore Korça	524,421	486,000	464,502	-21,498	-4.42%
8	D.R. Tatimore Kukës	168,500	193,000	196,207	3,207	1.66%
9	D.R. Tatimore Lezha	395,000	410,000	364,211	-45,789	-11.17%
10	D.R. Tatimore Saranda	207,683	267,000	343,573	76,573	28.68%
11	D.R. Tatimore Shkodra	585,000	446,000	425,911	-20,089	-4.50%
12	D.R. Tatimore Vlora	514,900	560,000	552,892	-7,108	-1.27%
13	D.R. Tatimore Tirana	7,728,945	8,150,000	7,779,589	-370,411	-4.54%
14	D.R. Tatimpaguesit Mëdhenj	20,488,280	18,665,000	22,051,193	3,386,193	18.14%

Peshën specifike në të ardhurat e arkëtuara dhe raportuara për zërin e “të ardhurave nga tatimi mbi fitimin” e zë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me 60% të totalit të arkëtimeve ose 22 miliard lekë nga 36.4 miliard lekë gjithsej të arkëtuara gjatë vitit 2019, ndjekur nga DRT Tiranë me 21% të totalit të arkëtimeve ose 7.7 miliard lekë dhe DRT Durrës me 5.5% të arkëtimeve ose rreth 2 miliard lekë. Kontributi i drejtorive të tjera varion nga 0.5% deri 2% të totalit të arkëtimeve. Në mënyrë grafike kontributi i cdo Drejtorie rajonale paraqitet në grafikun në vijim:



Përsa i përket realizimit të të ardhurave nga tatim fitimi kundrejt planit të miratuar, DRT Berat, Durrës Elbasan, Kukës, Sarandë dhe DMT rezultojnë me tejkalim të planit, ndërsa DRT e tjera janë të gjitha me mosrealizim vecanërisht: DRT Dibër me -18.71% mosrealizim të planit, DRT Gjirokastrë me -14.65% mosrealizim të planit, dhe DRT Lezhë me -11.17% mosrealizim të planit të miratuar. Të analizuara sipas numrit të tatimpaguesve, gjendjes së debitorëve të mbartur për secilën DRT rezultatet dhe kontributi cdo DRT paraqitet në grafikun në vijim:




DRT	Arketime	Debitorët	Kreditorët	Nr. Tatim paguesve
BERAT	0.9%	0.4%	0.8%	2.8%
DIBER	1.0%	0.9%	0.4%	1.7%
DURRES	5.5%	7.9%	4.0%	12.5%
ELBASAN	1.6%	4.2%	1.4%	5.6%
FIER	2.4%	2.5%	1.8%	7.7%
GJIROKASTER	0.5%	0.7%	0.5%	2.1%
KORCE	1.3%	1.5%	0.8%	4.2%
KUKES	0.5%	0.4%	0.3%	0.9%
LEZHE	1.0%	3.5%	0.7%	3.1%
SARANDE	0.9%	0.3%	0.5%	2.2%
SHKODER	1.2%	2.4%	0.7%	4.6%
VLORE	1.5%	2.2%	1.7%	5.0%
TOTAL	18.2%	26.9%	13.5%	52.4%

Nga DRT që rezultojnë me realizim plani konstatojmë se DRT Durrës administron numrin më të lartë të tatimpaguesve aktiv me TVSH ose **12.5%** duke kontribuar në totalin e të ardhurave nga tatim fitimi me **5.5%** të totalit të arketimeve por ndërkohë është dhe një nga DRT-të me stokun më të lartë të debitorëve për këtë zë të ardhurash ose **7.9%** e totalit. Po kështu edhe DRT Elbasan dhe Fier. Ndërkohë nga DRT-të që rezultojnë me mosrealizim plani vecojmë DRT Lezhë e cila rezulton edhe me një nivel shumë të lartë debitorësh (3.5% e totalit të stokut). Për shkak të peshës që zënë DRT Tiranë dhe ajo e Tatimpaguesve të Mëdhenj krahasuar me DRT e tjera, të dhënat dhe analiza e tyre janë paraqitur më vehte në tabelën në vijim, ku evidentohet kontributi i këtyre dy drejtorive respektivisht: -Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj realizon mbi 60% të totalit të arketimeve për zërin e të ardhurave nga tatim fitimi me 699 subjekte aktive të rregjistruar, dhe

nga -DRT Tiranë kontributi është mbi 21% e totalit të arkëtimeve ndërkohë që administron 40973 tatimpagues aktivë.

Nëse në analizën e të ardhurave të realizuara do të marrim në konsideratë dhe borxhin tatimor gjendjen kreditore të subjekteve për parapagimin e tatim fitimit, rezulton se **DRT Tiranë** raporton dhe borxhin më të lartë tatimor me **15.6 miliard lekë ose 53% të të gjithë stokut** të borxhit në rang kombëtar për këtë zë të ardhurash. Ndërkohë, për **DMT gjendja kreditore për parapagimet e kësteve të tatimfitimit rezulton të jetë 9 miliard lekë ose 64%** e totalit të gjithë gjendjes kreditore të tatim-fitimit të raportuar nga DPT.



DRT	Arkëtimet	Debitorë	Kreditorë	Nr. Tatim paguesve
TIRANE	7.7 miliard	15.6 miliard	3.2 miliard	40973
DTM	22 miliard	6.1 miliard	9 miliard	699

Gjetja	Planifikimi me rezervë i të ardhurave nga tatimi mbi fitimin nuk mbështet realisht suksesin e tejkalimit të planit buxhetor për këtë zë. Referuar deklarimeve për vitin 2019 rezulton një rënie prej 15% e vlerës totale të “tatimit për tu paguar” të deklaruar krahasuar me një vit më parë edhe pse ka një rritje prej 3% të subjekteve objekt i tatim fitimit. Referuar arkëtimeve, realizimi i këtij zëri mbështetet kryesisht në kontributin e 50 subjekteve nga të cilët janë arkëtuar 41% e totalit të arkëtimeve gjithsej për vitin 2019. Gjithashtu, nga auditimi rezulton se sektori i prodhimit paraqet një rënie prej 46% të tatimit fitimit të deklaruar.
Situata	Në bazë të evidencave të vëna në dispozicion, rezulton se të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë raportuar në shumën 36,484,399 mijë lekë ose 8.91% ose 2,984,399 mijë lekë më shumë se plani dhe 6% më shumë se viti 2018. Krahasuar me një vit më parë, detyrimi për tatim fitimin sipas deklarimeve të 23,542 subjekteve është rreth 15% më i ulët ndërkohë që të ardhurat tatimore të deklaruara janë rritur me 1%. Sipas klasifikimit të sektorëve të ekonomisë burimi i arkëtimeve të të ardhurave nga tatimi mbi fitimin rezulton të jetë sektori i prodhimit me 31% ndjekur nga sektori i shërbimit me 26% dhe sektori i tregtisë me 25%. <u>Ndryshimet strukturore për sa i përket numrit të subjekteve për çdo sektor nga një vit në tjetrin, nuk e justifikon rënien prej 15% të detyrimit të deklaruar ndërkohë që numri i</u>

	<p>subjekteve, objekt i tatim fitimit është rritur me 3%¹⁵. Rënie më të konsiderueshme të tatim fitimit të deklaruar paraqesin sektori i prodhimit me -46% dhe sektori i ndërtimit me -17%. Në gjykimin e audituesit, deklaratimet e sektorit të prodhimit do të kërkonin një analizë më të thelluar për të shpjeguar rënien prej 46% ndërkohë që të ardhurat tatimore të deklaruara kanë rënë me vetëm 10%.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se 14.8 miliard lekë ose 41% e totalit të të ardhurave nga tatim fitimi gjatë vitit 2019 vijnë nga arkëtimet e 50 tatimpaguesve (kryesisht nga sektori bankar dhe ai energjetik) ku dallojnë arkëtimet nga OSHEE me 8.9% e totalit dhe KESH sha me 7.2% . Realisht, nga auditimi sipas periudhës tatimore, pjesa më e madhe e arkëtimeve nga këto dy subjekte janë për llogari të shlyerjes së borxhit tatimor dhe jo detyrime të reja të periudhës. Referuar detyrimit faktik të lindur pas deklarimit të 31 Marsit 2019, nga auditimi rezulton se top40 subjektet deklarojnë “tatim fitimi për tu paguar” në total 12.44 miliard lekë ose 36% të totalit të shumave të deklaruara. Po sipas deklarimeve faktike, rezulton se OSHE, Albc, S T, E A, kanë deklaruar humbje tatimore. Në konkluzion, deklaratimet e subjekteve nuk kanë impakt të drejtpërdrejtë në arkëtimet e vitit raportues dhe top lista e më të mëdhenjve në deklarime jo domosdoshmërisht ka dhe kontributin më të madh në arkëtimet e vitit. Aktualisht, arkëtimet nga ky grup rezultojnë të jenë 45% më të larta se detyrimi i lindur. Sipas drejtorive rajonale, peshën specifike në të ardhurat e arkëtuara dhe raportuara për zërin e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin e zë DTM me 60% të totalit të arkëtimeve me 699 subjekte aktive të regjistruar ndjekur nga DRT Tiranë me 21% dhe DRT Durrës me 5.5% të arkëtimeve. Kontributi i drejtorive të tjera varion nga 0.5% deri 2% të totalit të arkëtimeve. Përsa i përket realizimit të të ardhurave nga tatim fitimi kundrejt planit të miratuar, DRT Berat, Durrës Elbasan, Kukës, Sarandë dhe DMT rezultojnë me tejkalim të planit, ndërsa DRT e tjera janë të gjitha me mosrealizim veçanërisht: DRT Dibër me -18.71%, DRT Gjirokastrë me -14.65%, dhe DRT Lezhë me -11.17%.</p>
Kriteri	<p>Ligji 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24 datë 0.209.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Rregullore e Brendshme “Për Funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19 datë 22.02.2017.</p> <p>Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;</p>

¹⁵Sipas DPT- Sektori i shërbimit të tatimpaguesit

Ndikimi/Efekti	Mungesë analizash mbi faktorët që ndikojnë në realizimin e planit me impakt planifikimin me rezerva
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.15, datë 24.07.2019.

Gjetja	Nga evidencat e auditimit rezulton se burimi kryesor i të ardhurave të arkëtuara dhe raportuara për zërin “tatimi mbi fitimin” janë parapagimet e kësteve në shumën 23,886,193 mijë lekë ose 65.5% e të ardhurave, dhe 12,528,533 mijë lekë ose 34.3% nga pagesat direkte të tatimit mbi fitimin dhe 0.2% nga kamatëvonesat.
Situata	<p>Arkëtimet nga parapagimet e kësteve të tatim fitimit kanë mbuluar rreth 80%¹⁶ të deklarimeve faktike për detyrimin e lindur për pagesë të tatim fitimit, por analizuar sipas situatës individuale (deklarime vs. arkëtime) rezulton se jo për të gjithë subjektet mbulimi është i njëjtë. Më konkretisht, për 10,190 subjekte parapagimet mbulojnë më pak se 60% të deklarimit faktik dhe për 5,359 subjekte parapagimet mbulojnë rreth 140% të deklarimit faktik pra rezultojnë me mbi pagesë. Në kushtet kur këto të ardhura janë “parapagime” të bazuara në përllogaritje mbi rezultatet e vitit të kaluar, rrjedhimisht jo në çdo rast përputhen me detyrimin faktik të subjektit, të lindur me deklarimin e vitit pasardhës. Diferenca në kohë e afateve të mbylljes së vitit fiskal më 31.12.2019 me afatet e deklarimit nga subjektet për rezultatet e vitit 2019 më 31 Mars 2020, sjell <u>rrezikun e mbivlerësimit të të ardhurave të raportuara</u>, e mbështetur kjo dhe me faktin që në C@TS rezulton ende një tepricë e lartë kreditore për këtë zë të ardhurash (subjektet që kanë mbi paguar). Referuar arkëtimeve pagesat për tatim fitimin janë kryer nga gjithsej 16,521 subjekte. Referuar <u>deklarimeve</u> në C@TS për tatim fitimin, konstatohet se 15,757 subjekte ose 67% nga 23,542 tatimpagues të cilët kanë plotësuar detyrimin e dorëzimit të deklaratës së tatimit ku shuma e rubrikës “detyrimi të lindur për tu paguar” është 29,151,699 mijë lekë ndërkohë që parapagimet për këtë periudhë janë në shumën 22,847,767 mijë lekë. <u>Në pamje të parë, duket se parapagimet kanë mbuluar rreth 80%¹⁷ të deklarimeve faktike, por nëse subjektet do të analizohen sipas situatës individuale (deklarime vs. arkëtime) rezulton se jo për të gjithë subjektet situata është e njëjtë. Më konkretisht, për 10190 subjekte parapagimet mbulojnë më pak se 60% të deklarimit faktik dhe për 5359 subjekte parapagimet mbulojnë rreth 140% të deklarimit faktik pra rezultojnë me mbi pagesë.</u></p> <p>Gjatë vitit ushtrimor, në zbatim të nenit 30 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, strukturat e kontrollit tatimor nga zyra, vlerësojnë nëse tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese tatimore</p>

¹⁶2270 subjekte me një vlerë detyrimi të deklaruar prej 562 milionë lekë nuk kanë bërë deklarim në vitin 2018 rrjedhimisht nuk kanë impakt në parapagimet e arkëtuara në vitin 2019, prandaj këto subjekte janë përjashtuar nga përllogaritja.

¹⁷2270 subjekte me një vlerë detyrimi të deklaruar prej 562 milionë lekë nuk kanë bërë deklarim në vitin 2018 rrjedhimisht nuk kanë impakt në parapagimet e arkëtuara në vitin 2019, prandaj këto subjekte janë përjashtuar nga përllogaritja.

	do të tejkalojë me më tepër se 10% tatimin mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore duke vendosur kështu rishikimin në rritje të këstit të parapagimit, përgjithësisht në muajt Nëntor-Dhjetor. Me qëllim auditimin e rasteve të rishikimit të kësteve, u evidentuan 1,179 subjekte që kanë deklaruar një fitim mbi 10% më të lartë se viti 2018, nga të cilat 700 subjekte kanë deklaruar një tatim fitimi mbi 50% më të lartë se viti 2018. Informacioni i vënë në dispozicion nuk ishte i plotë me datat e rishikimeve ndërkohë që për disa subjekte “kësti i rishikuar” nuk vinte nga rivlerësimi nga zyra por ishin këste të gjeneruara rishtas nga sistemi C@TS, pra një korrigjim në kohë. Për këto raste, në përgjigje të kërkesave të grupit për plotësimin e datave të rishikimeve, në observacion u vu në dispozicion informacion shtesë vetëm për 15 subjekte të cilët rezultojnë me humbje ose humbje të mbartur në deklarimin e 31 Marsit duke justifikuar kështu mos gjenerimin në kohë të këstit të ri. Megjithatë një testim i plotë i këtyre rasteve nuk u arrit deri në përfundim të auditimit dhe grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi përputhshmërinë e veprimeve në zbatim të nenit 30 të ligjit.
Kriteri	Ligji 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24 datë 0.209.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
Ndikimi/Efekti	Mungesë kontrollesh për llogaritjen dhe rishikimin e kësteve të parapagimit të tatim fitimit me impakt krijimin e tepërcave debitore dhe kreditore, mosnjohim i subjekteve dhe mosmbledhjen e të ardhurave tatimore periodike.
Rëndësia	I Lartë

B.3.1. Niveli i borxhit për këtë lloj tatimi në fund të vitit 2019. Testimi i zonave me risk lidhur me mbledhjen e të ardhurave nga ky lloj tatimi

Për vitin 2019, në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga DPT, rezultojnë se shuma e raportuar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në zërin debitor “llog.468” është 120,792,111 mijë lekë nga të cilët 29,792,227 mijë lekë debitorë për detyrimin e tatimit mbi fitimin dhe gjopa të papaguara krijuar nga mbi 18,800 subjekte kundrejt 18,097 subjekte debitore të evidentuara një vit më parë. Kjo balancë detyrimesh rezultojnë të jetë 320,426 mijë lekë ose 1% më e lartë se ajo e raportuar më 31.12.2018. Më konkretisht:

Në mijë lekë

Tatimi	kodi buxhetor llog kontabel	Celja 01.01.2019	Pagesa me Banke	Shlyerje me Kredi	Falje	Gjendja e ndryshuar	Detyrim i vitit 2019	Progresiv 31.12.2019
--------	-----------------------------	------------------	-----------------	-------------------	-------	---------------------	----------------------	----------------------

Tatimi mbi fitimin sipas Drejtorise MF	7001	30,203,618						31,637,015
Tatimi mbi fitimin sipas kontabilitetit	7001	29,471,800	3,719,154	522,249	193,512	25,036,883	4,755,343	29,792,227
Tatimi fitimi i thjeshtuar sipas kontabilitetit	7002	2,541,639	37,521	94,300	4,468	2,405,350	289,734	2,695,084
Total Kontabiliteti	7001+7002	32,013,439	3,756,676	616,550	197,981	27,442,233	5,045,079	32,487,312
Diferenca		1,809,821						850,297

Ndërkohë nga Drejtoria e Mbledhjes me Forcë raportohet se stoku i borxhit tatimor për zërin “tatimi mbi fitimin” është **31,637,015 mijë lekë** me një rritje prej 1,433 mijë lekë (+5%) nga raportimi i datës 31.12.2018. Sipas shpjegimit të Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë diferenca vjen për shkak të përfshirjes së detyrimeve për tatim fitimin e thjeshtuar në këtë zë detyrimi si dhe gjobat për mospagesë të kështit të tatim fitimit. Detajimi i debitorëve të gjeneruar nga sistemi C@TS evidenton debitorë për tatim fitimin e thjeshtuar në shumën 2,695,084 mijë lekë me një rritje prej 153,445 mijë lekë (+6%) nga raportimi i 31.12.2018.

Sipas DRT-ve stoku i borxhit për detyrimin e tatimit mbi fitimin paraqitet në tabelën në vijim, ku evidentohet se DRT me stokun më të lartë të borxhit është DRT Tiranë me 15.6 miliard lekë ose 52.6% të stokut ndjekur nga DMT me 6.1 miliard ose 20.6% e stokut, DRT Durrës me 2.3 miliard ose 7.9%:

Në mijë lekë

DRT-të	Celja	Pagesa me Banke	Shlyerje me Kredi	Falje	Gjendja e ndryshuar	Detyrim i vitit	Progresiv	%
DRT Tiranë	14,708,834	239,437	232,832	60,838	14,175,725	1,486,022	15,661,748	52.6
DRT DTM	7,229,036	3,288,422	180,735	58,822	3,701,056	2,423,605	6,124,661	20.6
DRT Durrës	2,073,727	47,761	21,767	26,273	1,977,925	380,828	2,358,754	7.9
DRT Elbasan	1,243,185	30,788	14,301	1,250	1,196,845	50,714	1,247,560	4.2
DRT Lezhë	1,034,141	23,531	5,517	773	1,004,318	45,109	1,049,428	3.5
DRT Fier	710,334	14,815	7,774	3,836	683,908	56,439	740,347	2.5
DRT Shkodër	672,472	25,776	5,986	530	640,178	67,007	707,186	2.4
DRT Vlorë	560,180	21,726	11,406	11,785	515,262	131,518	646,781	2.2
DRT Korçë	475,648	8,857	29,058	24,569	413,163	44,711	457,875	1.5
DRT Dibër	228,976	3,906	1,195	687	223,187	33,860	257,048	0.9
DRT Gjirokastrë	203,041	3,518	2,692	1,550	195,280	8,539	203,819	0.7
DRT Kukës	130,267	4,576	6,534	60	119,095	11,574	130,670	0.4
DRT Berat	122,350	3,097	763	87	118,402	10,080	128,482	0.4
DRT Sarandë	79,603	2,937	1,683	2,449	72,532	5,329	77,862	0.3
Total	29,471,800	3,719,154	522,249	193,512	25,036,883	4,755,343	29,792,227	100%
					-15%	+16%	+1%	

Nga krahasimi me një vit më parë, duket se stoku i borxhit rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mbledhet) vecanërisht nga subjektet që administrohen nga DRT Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër, Vlorë.

Në zbatim të nenit 68 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, dy janë aktet administrative tatimore të cilat prodhojnë detyrime tatimore mospagimi në afat i të cilave, inicion ndërmarrjen e masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor: *Vlerësimi tatimor: a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore (Njoftim Vlerësimi); b) në rastet kur shuma e detyrimit tatimor të vetëdeklaruar nuk paguhet, është njoftimi, që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e përcaktuar në ligjin përkatës.* Analizuar sipas burimit të detyrimit, **detyrimi “principali për tatim fitimin” (përfshirë mospagesat e kësteve të parapagimit) është rreth 21.8 miliard lekë**

ose 73% e stokut dhe rreth 7.8 miliard lekë janë gjoba për deklarime të pasakta dhe/ose të vonuara ose 27%.

Në mijë lekë

Lloji i detyrimit	Nr. subjekteve	Celja	Pagesa me Banke	Shlyerje me Kredi	Falje/Anullime	Gjendja e ndryshuar	Detyrimi i vitit	Progresiv
1101 - Tatim fitimi detyrim principal	6,579	18,181,562	3,492,385	482,489	5,702	14,200,984	3,875,686	18,076,671
1102 - Detyrim për Tatim Fitimi, detyrim principal	5,357	3,896,530	32,407	20,470	-	3,843,651	16,256	3,859,908
1130 - Gjore per deklarim te vonuar tatim fitimi	6,846	109,584	1,022	195	616	107,749	13,167	120,916
1151 - Gjore inspektori per evazion fiskal dhe fshehja detyrimi	4,023	3,938,718	135,867	10,886	156,588	3,635,375	477,664	4,113,040
1152 - Gjore per paraqitje me vonesë Vendim ortakut.	10,406	2,644,663	20,230	2,965	28,615	2,592,851	20,790	2,613,641
1153 - Gjore per paraqitje me vonesë pasqyra financiare te TF	7,545	75,355	1,866	939	190	72,359	22,815	95,174
1154 - Interes 5% te ndryshimit midis pageses dhe korigjimit te kesteve te tatim fitimit	2	-	-	-	-	-	62,462	62,462
1155 - Gjore per mospagim te kesteve te tatim fitimit	5,040	625,385	35,373	4,301	1,799	583,910	266,502	850,412
Total	45,798	29,471,800	3,719,154	522,249	193,512	25,036,883	4,755,343	29,792,227

Në kuadër të auditimit të borxhit për tatimin mbi fitimin, i është kërkuar DMF informacion mbi detajimin e detyrimit që ka rrjedhur nga rivlerësimet e kontrollit tatimor dhe sa nga mospagesa e kesteve të tatim fitimit, por përgjigjja është se: DMF në DPT nuk e disponon këtë informacion pasi nuk është në formatin e evidencave periodike të dërguara nga DRT-të.

Në gjykimin e audituesit, ky informacion duhet të disponohet dhe analizohet nga DMF në DPT në cilësinë e udhëheqëses metodologjike dhe funksionin monitorues mbi Drejtorite Rajonale Tatimore, për të vlerësuar mbledhshmërinë e borxhit duke marrë parasysh që rivlerësimet përgjithësisht kalojnë një proces të gjatë ankimimi/apelimi dhe ekziston rreziku i pavlefshmërisë/anullimit të detyrimit të lindur nga këto rivlerësime (akt-kontrolle). Për këtë janë analizuar në vijim edhe çështjet gjyqësore dhe statusi i tyre me impakt në pakësimin ose të nivelit të borxhit të raportuar.

Sipas subjekteve, 50 subjekte nga 18800 subjekte debitoare gjithsej, rezultojnë me nivelin me të lartë të borxhit për këtë lloj detyrimi, me mbi 14 miliard lekë ose 47% të totalit të detyrimit. Më hollësisht, balanca debitoare për secilin prej këtyre subjekteve paraqitet në tabelën në vijim:

Në mijë lekë

Subjekti	1101 - Tatim fitimi principal	1102 - Detyrim për Tatim Fitimi, principal	1130 - Gjore per deklarim te vonuar	1151 - Gjore inspektori per evazion fiskal	1152 - Gjore vonese Vendim ortakut.	1153 - Gjore per paraqitje me vonese PF te TF	1154 - Interes 5% nga korigjimi i kesteve te TF	1155 - Gjore per mospagim te kesteve te TF	Total Detyrimi
OSHE	4,327,543	-	20	104,227	90	30	62,244	436,901	4,931,054
"E- K"	636,834	30,398	30	616,612	560	10	-	-	1,284,444
A.R.M.O.	906,604	-	30	197,127	580	20	-	-	1,104,361
A-2013	500,970	220,728	20	42,910	560	10	-	-	765,198
F	166,796	-	20	111,450	560	10	-	-	278,837
C AC	137,014	-	3	132,820	580	20	-	-	270,438
FINTERNAT.	133,926	-	-	107,068	-	-	-	-	240,994
K	142,253	1,586	50	54,643	420	30	-	-	198,981
A SET	158,878	-	-	34,340	380	30	-	12	193,639

A P Group	122,217	-	-	64,840	20	-	-	26	187,103
G.T.I	134,711	-	30	46,981	170	30	-	4,918	186,839
R.K.L	173,530	-	20	1,110	380	20	-	6,038	181,098
S - L T	98,294	-	20	72,860	380	20	-	1,376	172,950
KCA D D	142,303	-	-	30,209	-	-	-	-	172,512
E Q	143,757	-	10	16,726	590	30	-	8	161,120
C.A.E.	146,441	-	10	1,506	-	10	-	11,433	159,400
NVL t	92,052	-	20	64,281	350	30	-	2,074	158,807
B P	123,737	-	-	27,098	10	20	-	-	150,865
S P A	126,806	-	10	18,684	30	20	-	-	145,550
N	135,057	-	20	905	30	30	-	8,966	145,009
E SHPK	131,020	-	30	-	590	30	-	466	132,136
TPD-T P&D	94,720	-	-	22,261	170	30	-	10,392	127,574
TGV - T-	63,358	-	-	61,376	140	10	-	-	124,884
T F	-	124,815	-	-	-	-	-	-	124,815
V I Ltd	114,160	-	10	5	380	30	-	8,681	123,265
B TRANS	64,256	-	30	58,509	170	30	-	8	123,004
S O S.A	77,947	-	-	35,163	-	-	-	-	113,110
O	93,263	-	30	13,769	170	30	-	4,210	111,472
T O I. T & S Comp.	96,058	-	10	14,952	420	-	-	-	111,440
A-M	105,997	-	20	-	-	20	-	4,857	110,894
"H"	89,279	1,307	30	19,222	560	10	-	-	110,408
H - X sh.p.k	106,770	-	-	-	-	-	-	-	106,770
XH L	83,536	-	10	21,837	350	10	-	-	105,742
K-2012	104,923	81	30	5	580	20	-	9	105,647
G 2012	91,186	192	20	10,157	560	10	-	-	102,126
M/L	101,118	-	-	-	-	-	-	434	101,552
B AIR	82,493	-	-	13,476	560	10	-	-	96,539
K Int.	46,263	-	20	46,199	580	20	-	2,637	95,720
G	49,981	8,706	10	34,834	210	-	-	-	93,741
E E. I	82,618	-	10	742	20	10	-	6,335	89,735
U EMg.	-	88,453	-	-	-	-	-	-	88,453
SIS	41,024	-	-	43,659	210	-	-	-	84,893
F B Srl	72,789	595	30	8,557	560	10	-	-	82,541
S	41,705	534	10	38,086	420	-	-	-	80,755
E V SHPK	47,555	-	10	32,152	10	10	-	-	79,738
P&A	78,765	50	20	-	230	10	-	-	79,075
A.K.F. P	39,788	-	-	38,631	-	-	-	-	78,419
"G"	49,864	956	10	26,996	210	-	-	-	78,036
V AL	-	-	-	77,448	-	-	-	-	77,448
E	65,598	11,248	30	-	560	10	-	-	77,446
Total Top 50	10,665,757	489,649	683	2,364,436	13,3450	680	62,244	509,799	14,106,578

Krahasuar me një vit më parë, stoku i borxhit për këto subjekte ka ndryshuar në ulje me rreth 650 milion lekë, neto i pagesave dhe detyrimit të ri për vitin 2019. Impakt më të konsiderueshëm ka patur pagesa e OSHEE prej 3.1 miliard lekë por ndërkohë ky subjekt ka rritur gjendjen debitore gjatë 2019 me rreth 1.9 miliard lekë. 27 subjekte nga ky grup rezultojnë me status “pasiv” me një total detyrimi rreth 6 miliard lekë.

Mbi masat shtrënguese të aplikuara nga DRT-të për mbledhjen e borxhit

Funksioni i mbledhjes me forcë kryhet në secilën nga 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore. Ligji nr.8438 datë 28.12.1988 “për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, dhe udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “për procedurat tatimore”, i ndryshuar parashikojnë instrumentat që DPT duhet dhe mund të përdorë për mbledhjen me forcë të borxhit tatimor. Tabela në vijim paraqet të dhënat për masat e aplikuara gjatë vitit 2019 nga DMF në DRT:

Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arketuara		% arkëtimit
		Nr.raste	Shuma	Nr.raste	Shuma	
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	11,786	8,841,108	6,033	361,624	4%

2	Urdhër bllokime të Llogarive Bankare	9,110	7,232,672	11,111	1,092,802	15%
3	Njoftim të Tatimpaguesit për vendosjen e Masave të Sigurisë	5,926	5,463,649	1,614	49,698	1%
4	Njoftim i Përgjithshëm për vendosjen e Masave të Sigurisë	4,401	1,119,065	619	57,267	5%
5	Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore	6,691	2,434,161	614	71,873	3%
6	Njoftim për vendosjen e Barres Siguruese	4,591	1,984,161	518	90,583	5%
7	Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë	463	173,579	471	11,382	7%
8	Njoftim Transferimi detyrimi tatimor Palës së Tretë	1	2,206	-	-	
9	Njoftim për transferimin e detyrimit të Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	
10	Njoftim për vendosjen e Urdhër Bllokimi në Doganë	2,219	1,507,555	289	66,665	4%
11	Urdhër Bllokimi QKB	886	1,462,863	357	37,375	3%
12	Konfiskim 50%	169	23,924	176	26,697	112%
	TOTALI	46,243	30,244,943	21,802	1,865,966	6%

Të dhënat janë paraqitur në total për masat e marra pavarësisht llojit të detyrimit, gjithsej 46,243 masa të vendosura nga të cilat 21802 kanë rezultuar me arkëtim ose 47% e tyre, por nëse do të referoheshim vlerës së arkëtuar impakti në vlerën e borxhit të mbledhur është tepër i ulët me 1,865,966 lekë nga 30,244,943 lekë gjithsej **ose vetëm 6% e borxhit të njoftuar për pagesë**. Për të vlerësuar c'pjesë e këtij borxhi të mbledhur i takon detyrimit të mospagesës së tatim fitimit, kërkesës së grupit të auditimit për informacion të detajuar për masat shtrënguese të aplikuara, DMF përgjigjet se nuk mund ta ketë informacion të detajuar specifikisht për zërin e tatim fitimit, pasi stoku i borxhit sipas llojit raportohet dhe monitorohet dhe raportohet nga DRT-të në DPT sipas evidencave standarte. Kështu, informacioni që mund të analizojmë është ai i debitorëve të gjeneruar nga C@TS sipas kodeve të detyrimit, të dhëna këto që detajojnë mënyrën e pakësimit të borxhit nëpërmjet nëpërmjet 3 burimeve: 1) **pagesave me bankë**, 2) **kompensimit** dhe 3) **faljes (përfshirë anulimet)**. Në mënyrë të detajuar pakësimet e borxhit (debitorët) për vitin 2019 paraqitet në tabelën në vijim:

Nga evidencat e vëna në dispozicion nga DMF, rezulton se janë i përgjigjur njoftimit **6,033/11,786 raste (subjekte) ose 51% e subjekteve debitoare por me një rezultat arkëtimi vetëm 4% të detyrimit** të papaguar të njoftuar ose 361,624 lekë nga të cilat, për të njëjtën arsye si më lartë, nuk mund ti analizojmë se sa nga këto i përkasin mbledhjes së të borxhit të tatim fitimit. Po ashtu në lidhje **me urdhër bllokimet e llogarive raportohen si 11,111 raste nga të cilët janë arkëtuar 15% e shumës së njoftuar** për bllokimose 1,092,802lekë ndërkohë që raportohen 9110 vendosje urdhër bllokimit. Sipas DMF numri më i lartë i rasteve të arkëtuara vjen si rezultat i arkëtimeve gjatë 2019 nga masat e lëna në periudhat e mëparshme. Në këtë mënyrë edhe pse evidencat janë paraqitur “për periudhën” dhe “progresive” nuk mund të vlerësohet impakti i mjeteve shtrënguese të një viti (periudha në auditim). Sipas C@TS pagesat me bankë gjatë vitit 2019 janë **3,719,154 lekë nga 2,447 subjekte**. Grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë se sa nga këto arkëtime kanë qenë pagesa vullnetare të subjekteve pas njoftimit të dërguar për detyrimin e papaguar apo si rezultat i zbatimit të njërës prej masave shtrënguese.

Gjetja	Niveli i borxhit për zërin “tatimi mbi fitimin” raportohet në shumën 31.6 miliard lekë ose 1% më shumë se një vit më parë. Detyrimi “principali për tatim fitimin” është rreth 21.8 miliard lekë ose 73% e stokut dhe rreth 7.8 miliard lekë janë gjoba për deklarime të pasakta dhe/ose të vonuara ose 27%. nga 18,800 subjekte debitoare gjithsej 50
---------------	---

	prej tyre rezultojnë me nivelin me të lartë të borxhit për këtë lloj detyrimi, me mbi 14 miliard lekë ose 47% të totalit të detyrimit.
Situata	<p>Për vitin 2019, në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga DPT, rezulton se shuma e raportuar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në zërin debitor “llog.468” është 120,792,111 mijë lekë nga të cilët 29,792,227 mijë lekë debitorë për detyrimin e tatimit mbi fitimin dhe gjoba të papaguara krijuar nga mbi 18,800 subjekte kundrejt 18,097 subjekte debitore të evidentuara një vit më parë. Kjo balancë detyrimesh rezulton të jetë 320,426 mijë lekë ose 1% më e lartë se ajo e raportuar më 31.12.2018. Ndërkohë nga Drejtoria e Mbledhjes me Forcë raportohet se stoku i borxhit tatimor për zërin “tatimi mbi fitimin” është 31,637,015 mijë lekë për shkak të përfshirjes së detyrimeve për tatim fitimin e thjeshtuar në këtë zë në shumën 2,695,084 mijë lekë. Sipas DRT-ve stoku i borxhit për detyrimin e tatimit mbi fitimin evidentohet me stokun më të lartë të borxhit DRT Tiranë me 15.6 miliard lekë ose 52.6% të stokut ndjekur nga DMT me 6.1 miliard ose 20.6% e stokut, DRT Durrës me 2.3 miliard ose 7.9%. DRT Elbasan me 1.2 miliard lekë ose 4.2%. Nga krahasimi me një vit më parë, duket se stoku i borxhit rritet me një ritëm më lartë sesa pakësohet (mbledhet). Analizuar sipas burimit të detyrimit, detyrimi “principali për tatim fitimin” (përfshirë mos pagesat e kësteve të parapagimit) është rreth 21.8 miliard lekë ose 73% e stokut dhe rreth 7.8 miliard lekë ose 27% janë gjoba për deklarime të pasakta dhe/ose të vonuara. Në kuadër të auditimit të borxhit për tatimin mbi fitimin, i është kërkuar DMF informacion mbi detajimin e detyrimit që ka rrjedhur nga rivlerësimet e kontrollit tatimor dhe sa nga mos pagesa e kësteve të tatim fitimit, por përgjigja është se DMF në DPT nuk e disponon këtë informacion pasi ky informacion administrohet nga DRT-të. Në gjykimin e audituesit, ky informacion duhet të disponohet dhe analizohet si bazë vlerësimi të mbledhshmërisë së borxhit. Kjo duke marrë parasysh që rivlerësimet përgjithësisht kalojnë një proces të gjatë ankimimi/apelimi dhe mbartin rrezikun e pavlefshmërisë/anulimit të detyrimit të lindur nga këto rivlerësime (akt-kontrolle). Sipas subjekteve, 50 nga 18,800 subjekte debitore gjithsej, rezultojnë me nivelin me të lartë të borxhit për këtë lloj detyrimi, me mbi 14 miliard lekë ose 47% të totalit të detyrimit. Krahasuar me një vit më parë, stoku i borxhit për top50 subjektet ka ndryshuar në ulje me vetëm 650 milion lekë. Impakt më të konsiderueshëm në këtë ulje ka patur pagesa e OSHEE prej 3.1 miliard lekë por ndërkohë ky subjekt ka rritur gjendjen debitore gjatë 2019 me rreth 1.9 miliard lekë ndërkohë 27 subjekte nga ky grup rezultojnë me status “pasiv” me një total detyrimi rreth 6 miliard lekë. Për të vlerësuar c ‘pjesë e këtij borxhi të mbledhur i takon detyrimit të mos pagesës së tatim fitimit, kërkesës së grupit të auditimit për informacion të detajuar për masat shtrënguese të aplikuara, DMF përgjigjet se nuk mund ta ketë informacion të detajuar specifikisht për zërin e tatim fitimit, pasi stoku i borxhit sipas llojit monitorohet dhe raportohet nga DRT-të në DPT sipas evidencave standarde.</p>

Gjetja	Evidencat e raportimit të borxhit janë tepër sintetike dhe mbi to nuk mund të kryhen analiza mbi ecurinë e borxhit dhe efektivitetin e masave në nivel DRT-je. Aq më tepër nuk jepet informacion për borxhin jashtë sistemit ¹⁸ , si monitorohet dhe pse shtohet. Nga DMF raportohet se numri i çështjeve në proces gjyqësore është 1525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen se aktualisht janë 416 çështje gjyqësore në proces, me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë.
Situata	Nga administrata tatimore borxhi tatimor raportohet në shumën 116,994,228 mijë lekë ose 9,293,691 mijë lekë ose 8.6% më shumë se një vit më parë. Numri i çështjeve në proces gjyqësore është 1525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë për këto çështje nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen në proces gjyqësore 416 çështje me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë. Nga evidencat e konstatohet se borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet zë 60% të stokut të borxhit. Sipas anekseve shoqëruese të Pasqyrave Financiare, gjendja e debitorëve në fund të periudhës në auditim në sistemin C@TS është 117,996,398 mijë lekë për më tepër në shumën 8,891,504 mijë lekë ose 8.1% më shumë se gjendja debitorë e raportuar më 01.01.2019. Detyrimi i ri i vitit 2019 është 20,975,210 mijë lekë, ku debinë më të lartë të krijuar sipas llojit e zë tatimi TVSH –ja masën 34.53% të totalit ose në shumën 40,399 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,077 miliard lekë; Tatimi mbi fitimin në masën 27.04% të totalit ose në shumën 31,637 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,433 miliard lekë, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 12.92% të totalit ose në shumën 15,113 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,283 miliard lekë, etj.
Kriteri	Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.39 datë 09.07.2018 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin për Tatimin mbi të ardhurat”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Manual i mbledhjes me forcë dhe rregullorja e DPT
Ndikimi/Efekti	Ineficensa në mbledhjen e borxhit tatimor me impakt duke rënduar realizimin e të ardhurave në vetëm një grup të vogël tatimpaguesish
Rëndësia	I Lartë

¹⁸Borxhi ekzistues para implementimit të sistemit C@TS në vitin 2015

Për sa më sipër nga grupi i auditimit është lënë Akt-konstatimi nr.15 datë 24.07.2020 për të cilin audituesi ka shprehur qëndrimin e tij në Projekt Raport.

Për sa i përket stokut të borxhit të lindur dhe shtuar nga gjobat, referuar neni 33/1 të Ligjit nr.8438 “Për tatimin mbi të ardhurat” ndryshuar, cituar: “*Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi. 2. Shoqëritë tregtare dhe personat fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës/vendimin e personit fizik. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo muaj vonesë. 4. Vendimi i asamblesë së ortakëve, i organit kompetent të shoqërisë/vendimi i personit fizik, sipas këtij neni, për miratimin e rezultatit dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duhet të paraqitet në organin tatimor, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe nëse rezultati për vitin ushtrimor ka qenë me humbje apo zero. Për mosdepozitimin e vendimit zbatohen penalitetet, sipas pikës 2 të këtij neni. Nga auditimi i të dhënave nga sistemi C@TS për vitin 2019 rezultojnë:*

Kodi 1153- Gjobë për paraqitje me vonese pasqyra financiare te TF në përputhje me nenin 33/1 pika 1,2 e Ligjit nr.8438 “për tatimin mbi të ardhurat” - rezultojnë 7291 subjekte debitorë nga 6380 subjekte debitorë të raportuar një vit më parë,

Kodi 1152- Gjobë për paraqitje me vonese Vendim ortakut në përputhje me nenin 33/1 pika 4,2 e Ligjit nr.8438 “për tatimin mbi të ardhurat”- rezultojnë 10001 subjekte debitorë nga 9430 subjekte debitorë të raportuar një vit më parë.

Për disa subjekte detyrimet e akumuluar ndër vite (gjoba) shkojnë deri në 810,000 lekë (10000 lekë për cdo muaj vonesë). Disa prej subjekteve debitorë vazhdojnë ende të shtojnë detyrimin me mosdorëzimin në afat të vendimit të ortakut edhe gjatë vitit 2019, pa kryer as edhe një pagesë duke e bërë këtë masë administrative joefektive. Kjo situatë është rregulluar me Ligjin nr.39/2018 datë 09.07.2018, duke filluar që nga Janari 2019, për Pasqyrat Financiare të vitit 2018 (18/A) penaliteti i vendosur për mosdorëzimin e Vendimeve të ortakëve është 10,000 lekë në vit. Disa nga këto subjekte debitorë për këtë gjobë janë listuar në tabelën në vijim:

Tabela: Debitorë-Kodi 1152- Gjobë për paraqitje me vonesë vendim ortakut

Nr .	DRT-të	Emri subjektit	Celja	Pagesa me Banke	Detyrimi i vitit	Progresiv 31.12.2019
1	DRT Durrës	K	800000	0	10000	810,000
2	DRT Tiranë	P - ALBANIA	800000	0	10000	810,000
3	DRT Kukës	U-k t	800000	0	10000	810,000
4	DRT Gjirokastrë	T 2010	800000	0	10000	810,000
5	DRT Tiranë	A	740000	0	10000	750,000
6	DRT Gjirokastrë	Me	690000	0	10000	700,000
7	DRT Durrës	X	680000	0	10000	690,000
8	DRT Fier	R K sh.p.k	630000	0	10000	640,000
9	DRT Tiranë	B E G	580000	0	10000	590,000
10	DRT Tiranë	A & G F d	580000	0	10000	590,000
11	DRT Berat	B C	580000	0	10000	590,000
12	DRT Tiranë	A	580000	0	10000	590,000
13	DRT Tiranë	S M S.p.A.	580000	0	10000	590,000

14	DRT Tiranë	M A	580000	0	10000	590,000
15	DRT Elbasan	E +	580000	0	10000	590,000
16	DRT Elbasan	E	580000	0	10000	590,000
17	DRT Elbasan	U M KME	580000	0	10000	590,000
18	DRT Dibër	S-F	580000	0	10000	590,000
19	DRT Durrës	P SHPK	580000	0	10000	590,000
20	DRT Dibër	R	580000	0	10000	590,000

Në gjykimin e audituesit, numri i rasteve dhe ndjekja e mbledhjes së këtij lloji borxhi duhet të analizohet nga Drejtoria e Kontrollit dhe Menaxhimit të Riskut në korrelacion me impaktin që dorëzimi i vendimit të ortakut ka në planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga dividendi (trajtuar më hollësisht në pikën B4 të programit të auditimit).

Kodi 1151 - Gjobë inspektori për evazion fiskal dhe fshehja detyrimi 3750 subjekte në shumën 4.1 miliard lekë krahasuar me 3720 subjekte me detyrim 3.9 miliard lekë raportuar një vit më parë. Këto gjoba janë rezultat i njoftimeve për vlersim/ akteve administrative të kontrolleve tatimore.

Kodi 1155 - Gjobë për mospagim të kësteve të tatim fitimit –dërguar kampioni për testim 250 subjekte të cilat kanë deklaruar fitim tatimor por nuk rezultojnë me pagesë kësti apo pagesë tatim fitimi. Nga të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Kontrollit konstatohet se nga 250 subjekte e përzgjedhur vetëm 81 prej tyre janë ngarkuar me gjobë për mospagesë kësti të tatim fitimit në total. Sipas Drejtorisë së Kontrollit, kjo gjobë nuk llogaritet automatikisht nga sistemi por vendoset manualisht nga inspektorët tatimorë në DRT. Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, pika 114/1. “Mospagimi i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin”, tatimpaguesi i cili nuk paguan në afat këstet paraprake të tatimit mbi fitimin ose këstet paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, detyrim ky i përcaktuar sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe nenit 15, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, dënohet me gjobë, në masën 10 për qind të shumës së këstit për t’u paguar.” Për aplikimin e dënimit duhet të mbahet parasysh se këstet e tatimit mbi fitimin janë muajore ose tremujore, kështu që dënimi llogaritet kur përfundon afati tremujor i pagesës së këstit për detyrimin e këstit ose pjesën e detyrimit të këstit të papaguar. Për një testim analitik u përzgjedhën disa subjekte për tu verifikuar rast pas rasti në Drejtoritë Rajonale nëpërmjet Drejtorisë së Kontrollit, për një shpjegim mbi arsyet e mosvendosjes së gjobës nga DRT .

Gjetja	Mungesë e kontrolleve dhe masave eficiente për monitorimin DRT-ve në aplikimin e gjobave në mënyrë të plotë dhe barabartë për të gjithë tatimpaguesit debitorë për këstet e parapagimit të tatim fitimit në kundërshtim me nenin 12 dhe 30 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.
Situata	Nga auditimi rezultojnë dhe detyrime për “Gjobë për mospagim të kësteve të tatim fitimit” ¹⁹ për të cilët u testuan 250 subjekte të cilat kanë deklaruar fitim tatimor por nuk rezultojnë të kenë paguar këstet e parapagimit të tatim fitimit. Nga të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Kontrollit konstatohet se nga 250 subjekte e përzgjedhur vetëm 81 prej tyre janë ngarkuar me gjobë për mospagesë kësti të tatim fitimit në total. Sipas Drejtorisë së Kontrollit, kjo gjobë nuk llogaritet automatikisht nga sistemi por vendoset manualisht

¹⁹ Kodi 1155

	nga inspektorët tatimore në DRT. Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, pika 114/1. “Mospagimi i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin”, tatimpaguesi i cili nuk paguan në afat këstet paraprake të tatimit mbi fitimin ose këstet paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, detyrim ky i përcaktuar sipas nenit 30, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dënohet me gjobë, në masën 10 për qind të shumës së këstit për tu paguar. Fakti që kjo gjobë ekzekutohet manualisht në përgjegjësinë e inspektorëve të kontrollit vlerësohet me një risk të lartë për sa i përket zbatueshmërisë së plotë dhe të barabartë të këtij penaliteti. Në observacionet e subjektit citohet fakti se nga DKT në DPT janë mbajtur procesverbale duke ngarkuar me përgjegjësi direkte inspektorët të cilët nuk kishin vendosur penalitet për subjektet të cilët kishin në ngarkim.
Kriteri	Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligj nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Hapësira për abuzim me gjobvënien për tatimpagues të caktuar.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Ak-konstatimi nr.15 datë 24.07.2020, për të cilin subjekti ka observuar me dokumentin nr.6272/39 Datë 30.07.2020 dhe audituesi ka shprehur qëndrimin e tij në Projekt Raport.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

1.Titullarët e Drejtorive rajonale tatimore në përgjegjësinë administrimit, monitorimit dhe vlerësimit të punës dhe përgjegjësitë të inspektorëve të kontrollit.

2.Zj.I A, Drejtore e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT në përgjegjësinë e rrjedhur nga Rregullorja për funksionimin e DPT.

• Mbi anulimet dhe faljet e detyrimeve tatimore

Në lidhje me kompensimet rezulton se 588 subjekte kanë shlyer detyrimin nëpërmjet kompesimit me gjëndjen kreditore të tatim fitimit që rezulton në C@TS për këto subjekte, në total 522,250 mijë lekë nga të cilët 420 kanë shlyer plotësisht detyrimin dhe 168 subjekte e kanë kompensuar pjesërisht atë. Nga auditimi, konstatohet se shumë nga debitorët më të mëdhenj rezultojnë të kenë gjendje kreditore nga parapagimet e kësteve të tatim fitimit. Kompensimi supozohet se bëhet automatikisht nga sistemi C@TS, por nga të dhënat evidentohen raste kur subjekti ka gjendje kreditore por kompensimi nuk kryhet dhe subjekti vazhdon me gjendje debitore dhe kreditore. Për një shpjegim të këtyre rasteve një kampion prej rreth 200 subjekte (aplikuar në përzgjedhje të

njëjtat kritere sa më lartë) i është dërguar Drejtorisë së Kontrollit për tu përcjellë²⁰ në DRT përkatëse për verifikim në C@TS por deri në përfundim të auditimit informacioni nuk u vu në dispozicion.

- 1) Për sa i përket pakësimit të borxhit nëpërmjet “faljeve”, në sistemin C@TS rezultojnë të regjistruara rreth 230 subjekte për të cilët detyrimi është fshirë në bazë të një vendimi të apelimit tatimor apo si rezultat i zbardhjes së një vendimi gjykate. Me qëllim testimit të këtyre veprime u kërkuar dokumentacion mbështetës për 25 sisteme/subjekte, për të cilat nuk u përgjigjën DRT Tiranë dhe Durrës. Për rastet për të cilat grupi mori informacion janë përmbledhur në tabelën në vijim:

TaxRegion	Taxpayer Name	Kodi-Lloji gjobës	Celja	Falje	Detyrimi i vitit	Progresi v	Dokumenti i fshirjes së borxhit
DRT Tiranë	U.P.	1151 - Gjore per evazion fisk	26,191	26,191	-	-	?
DRT Korçë	E.	1151 - Gjore per evazion fisk	23,344	23,344	11	11	rikontroll (anullim gjore nga zyra)
DRT DTM	B.T.	1151 - Gjore per evazion fiskal	21,405	21,405	-	-	Zbardhje vendim gjykatës
DRT Durrës	B.	1151 - Gjore per evazion fisk	15,506	15,506	2,722	2,722	x
DRT DTM	T.A	1151 - Gjore per evazion fisk	77,107	13,730	-	60,578	Zbardhje vendim gjykatës
DRT DTM	V. A.	1151 - Gjore per evazion fisk	204,831	10,011	-	77,448	Zbardhje vendimi gjykatës
DRT Tiranë	A.Sha	1151 - Gjore per evazion fisk	9,314	9,314	-	-	x
DRT Durrës	T. I.	1151 - Gjore per evazion fisk	9,037	8,584	18	470	x
DRT Tiranë	A.	1151 - Gjore per evazion fisk	8,034	7,485	-	549	Rikontroll
DRT DTM	K.93	1151 - Gjore per evazion fisk	4,183	4,183	-	-	Anullim sipas praktikës së rikontrollit
DRT Vlorë	M.	1101 - Tatim fitimi detyrim principal	3,153	3,153	-	-	Anullim gabim sistemi
DRT Tiranë	A.A	1151 - Gjore per evazion fisk	2,369	2,369	-	-	Zbardhje vendim gjykatës
DRT Tiranë	M. I	1151 - Gjore per evazion fisk	3,327	2,045	-	1,238	?
DRT DTM	OPH	1101 - Tatim fitimi detyrim principal	5,780	1,878	-	3,902	Anullimi i gjobave per pagese te vonuar , dale pas periudhes se lidhjes se marreveshjes me keste me , date.3.11.2017.
DRT Dibër	D. V.	1152 - Gjore per vonese Vendim ortaku.	560	560	-	-	Vendim apelimi tatimor
DRT Gjirokastrë	S.-E.	1152 - Gjore per vonese Vendim ortaku.	560	560	-	-	x
DRT Lezhë	R.-07	1152 - Gjore per vonese Vendim ortaku.	560	560	-	-	vendim apelimi tatimor
DRT Durrës	M. V.H	1155 - Gjore per mospagim te kesteve te TF	1,822	516	821	1,443	x
DRT Sarandë	R.D	1152 - Gjore per vonese Vendim ortaku.	420	420	-	-	Subjekti ka kaluar status pasiv 10.11.2015
DRT Fier	E. R	1152 - Gjore per vonese Vendim ortaku.	385	385	-	-	vendim apelimi tatimor
DRT Elbasan	K. 2002	1152 - Gjore per vonese Vendim ortaku.	370	370	10	10	vendim apelimi tatimor
DRT Shkodër	K.G.	1152 - Gjore per vonese Vendim ortaku.	310	310	-	-	vendim apelimi tatimor
DRT Sarandë	A. N.	1151 - Gjore per evazion fiskal	290	290	-	-	anullim/ sistemim gabimi 2016

²⁰E-mail datës 22.06.2020

DRT Tiranë	L.A.	1155 - Gjore per mospagim te kesteve te TF	269	257	-	-	x
DRT Lezhë	D.	1101 - Tatim fitimi detyrim principal	150	150	-	-	vendim gjykate
419,278	153,577	3,582	148,373				

Për rastet pa përgjigje të DRT Tiranë, grupi i auditimit i është drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për plotësim informacioni. Nga përgjigjet e DRT-ve rastet e faljeve/sistemimeve janë anulime pas përfundimit të procesit të apelimit apo procesit gjyqësor rezultuar me një vendim në favor të tatimpaguesit paditës. Nga rastet e testuara, grupi i auditimit ka kërkuar informacion dhe dokumentacion mbështetës për tre raste të anulimit të detyrimeve në C@TS **të cilat nuk kanë lidhje me një vendim gjyqësor**, konkretisht:

- 1) Subjekti: O.Ph.**, anulim i detyrimit për tatim fitimin – detyrim principal në shumën 1,878 mijë lekë sipas Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj “anullim i gjobave për pagesë të vonuar, dalë pas periudhës së lidhjes së marrëveshjes me këste me, date.03.11.2017”. Anullimi është bërë nga DMT me shkresën nr.3390/9 datë 03.11.2017. Ky anulim duhet të verifikohet nëse është në përputhje me Ligjin 9920 datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 77 “Marrëveshja e pagesës me këste”
- 2) Subjekti: M.** anulim i tatimit mbi fitimin- detyrim principal në shumën 3,153 mijë lekë. Sipas shpjegimit të helpdesk e-tax në DPT ky anulim me ID: SLA-XXXX, është kryer pasi detyrimi prej 3,153 lekë është një gabim i sistemit pasi është llogaritur pa marrë parasysh statusin e subjektit në periudhën për të cilin po i llogaritet ky detyrim, në këtë rast viti 2017²¹. DRT Vlorë vuri në dispozicion njoftim vlerësimet me datë 16.03.2017 dhe 17.03.2017, nga të cilat detyrimet në total nga kontrolli tatimor rezultojnë të jenë 35,433 mijë lekë. Aktualisht subjekti ka kundërshtuar aktin administrativ njoftim vlerësimi dhe raportohet nga DPT si një çështje gjyqësore në proces në shkallën e dytë të gjykimit. Në të njëjtën kohë u kërkuar detyrimet reale të subjektit ku rezultoi se në sistemin C@TS ka **“zero” detyrime**. Në këto kushte, **grupi i auditimit ka kërkuar verifikimin të rastit, statusin e subjektit, pse detyrimi prej 35,433 mijë lekë nuk është i regjistruar në C@TS ku raportohet dhe ndiqet si një detyrim i papaguar, si u autorizua fshirja në system dhe kush tjetër ka të drejtën e sistemit të situatës së një subjekti përveç inspektorit të kontrollit në DRT-në përkatëse**. Nga shpjegimi helpdesk anulimi i detyrimit prej 3,153 mijë lekë rezulton të jetë sistemim i një gabimi sistemi që ka llogaritur gjoba për periudhën në të cilën subjekti ka qene me status pasiv. Në gjykimin e audituesit, nëse është një gabim sistemi si evidentohen dhe si autorizohet sistemimi i tyre është një çështje për të cilën strukturat përgjegjëse në DPT duhet të shpjegojnë dhe të kenë të parashikuar procedura të caktuara për veprim nga palët e autorizuar. Në këtë kuadër, nga grupi i auditimit u kërkuar nga helpdesk dokumentacioni shoqërues/ autorizues për fshirjen por deri në datën e mbajtjes së këtij Akti dokumentacioni nuk u vu në dispozicion.

Subjekti: A.N., nga DRT shpjegohet se falja/anullimi i gjobës është korrigjim i hedhjes gabim në sistem në shumën 290 mijë lekë. Dokumenti i dërguar nga DRT Sarandë mban datën 03.08.2016 dhe sqaron sistemimin e detyrimit nga gjobë për kontributet e sigurimeve shoqërore në detyrim gjobe për tatim fitimin. Ky dokument nuk sqaron faljen/anullimin e gjobës 3 vjet më

²¹E-mail i helpdesk, i datës 30.06.2020: “...lidhet me procedurën e vlerësimit automatik, I cili kryhej për deklaratat e padorezuara duke marrë në konsideratë vetëm statusin e deklaratës, por nuk kontrollonte nëse statusi i tatimpaguesit ishte aktiv për të njëjtën periudhë tatimore të deklaratës së padorezuar.”

vonë. Për sqarime të mëtejshme është dërguar email DRT Sarandë datë 25.06.2020 por deri në datën e mbajtjes së këtij Akti dokumentacioni nuk është vënë në dispozicion.

Gjetja	Në sistemin C@TS gjatë vitit 2019 rezultojnë të regjistruara rreth 230 subjekte për të cilët detyrimi është anuluar në bazë të një vendimi të apelimit tatimor apo si rezultat i zbardhjes së një vendimi gjykate. Nga auditimi rezultuan problematika në 3 raste me një vlerë detyrimi të anuluar prej 5,321 mijë lekë për të cilat DPT duhet të verifikojë dhe kontrollojë vlefshmërinë e tyre.
Situata	<p>Në lidhje me kompensimet e detyrimeve, rezulton se 588 subjekte kanë shlyer detyrimin nëpërmjet <u>kompensimit</u> me gjendjen kreditore të tatim fitimit që rezulton në C@TS për këto subjekte, në total 522,250 mijë lekë nga të cilët 420 kanë shlyer plotësisht detyrimin dhe 168 subjekte e kanë kompensuar pjesërisht atë. Nga auditimi, konstatohet se shumë nga debitorët më të mëdhenj rezultojnë të kenë gjendje kreditore nga parapagimet e kësteve të tatim fitimit. Kompensimi supozohet se bëhet automatikisht nga sistemi C@TS, por nga të dhënat evidentohen raste kur subjekti ka gjendje kreditore por kompensimi nuk kryhet dhe subjekti vazhdon me gjendje debitore dhe kreditore.</p> <p>Për sa i përket pakësimit të borxhit nëpërmjet “<u>faljeve/anulimeve</u>”, në sistemin C@TS rezultojnë të regjistruara rreth 230 subjekte për të cilët detyrimi është fshirë në bazë të një vendimi të apelimit tatimor apo si rezultat i zbardhjes së një vendimi gjykate. Me qëllim testimin e këtyre veprime u kërkua dokumentacion mbështetës për 25 sisteme/subjekte, për të cilat nuk u përgjigjën DRT Tiranë dhe Durrës. Për rastet pa përgjigje të DRT Tiranë, grupi i auditimit i është drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për plotësim informacioni por deri në përfundim të këtij auditimi nuk morëm informacion. Nga përgjigjet e DRT-ve të tjera, grupi i auditimit ka kërkuar informacion dhe dokumentacion mbështetës për tre raste të anulimit të detyrimeve në C@TS të cilat nuk kanë lidhje me një vendim gjyqësor, konkretisht:</p> <p>Subjekti: O.Ph., anulim i detyrimit për tatimfitimin – detyrim principal në shumën 1,878 mijë lekë sipas Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj “anulim i gjobave për pagesë të vonuar, dalë pas periudhës së lidhjes së marrëveshjes me këste me, date.03.11.2017”. Anulimi është bërë nga DMT me shkresën nr.3390/9 datë 03.11.2017. Ky anulim duhet të verifikohet nëse është në përputhje me Ligjin 9920 datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 77 “Marrëveshja e pagesës me këste”</p> <p>Subjekti: M., anulim i tatimit mbi fitimin- detyrim principal në shumën 3,153 mijë lekë. Sipas shpjegimit të helpdesk e-tax në DPT ky anulim me ID: SLA-xxxx, është kryer pasi detyrimi prej 3,153 mijë lekë është një gabim i sistemit pasi është llogaritur pa marrë parasysh statusin e subjektit</p>

	<p>në periudhën për të cilin po i llogaritet ky detyrim, në këtë rast viti 2017²² në të cilën subjekti ka qene me status pasiv. Në gjykimin e audituesit, nëse është një gabim sistemi, mënyra se si evidentohen dhe si autorizohet sistemimi i tyre është një çështje për të cilën strukturat përgjegjëse në DPT duhet të shpjegojnë dhe të kenë të parashikuar procedura të caktuara për veprim nga palët e autorizuar në këtë rast AKSHI. Në këtë kuadër, nga grupi i auditimit u kërkua nga help desk dokumentacioni shoqërues/ autorizues për fshirjen/sistemimin por deri në përfundim të këtij auditimi dokumentacioni i kërkuar nuk u vu në dispozicion.</p> <p>Subjekti: A.N, nga DRT shpjegohet se falja/anulimi i gjobës është korrigjim i hedhjes gabim në sistem në shumën 290 mijë lekë. Dokumenti i dërguar nga DRT Sarandë mban datën 03.08.2016 dhe sqaron sistemimin e detyrimit nga gjobë për kontributet e sigurimeve shoqërore në detyrim gjore për tatim fitimit. Ky dokument nuk sqaron faljen/anulimin e gjobës 3 vjet më vonë. Për sqarime të mëtejshme është dërguar e-mail DRT Sarandë datë 25.06.2020 por deri në përfundim të auditimit dokumentacioni i kërkuar nuk është vënë në dispozicion.</p> <p>Problematikat e konstatuara në këto raste të hasura gjatë auditimit, tregojnë për mungesë të sistemeve kontrollit për veprime të kryera manualisht në sistemin C@TS, me qëllim për të siguruar vlefshmërinë, saktësinë dhe autorizimin e kryerjes së veprimeve të tilla si: regjistrimi i njoftim vlerësimit apo fshirjet e detyrimeve.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar</p> <p>Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar,</p> <p>Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.39 datë 09.07.2018 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin për Tatimin mbi të ardhurat”;</p> <p>Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	Ekziston rreziku i mosregjistrimit të të gjitha njoftim vlerësimeve apo ndryshimi i tyre i paautorizuar në sistemin C@TS
Rëndësia	I Lartë

Për sa ma sipër nga grupi i auditimit është lënë Akt-konstatimi nr.15 datë 24.07.2020, për të cilin subjekti ka observuar me dokumentin nr.6272/39prot. datë 30.07.2020, ku citojmë: *Për sa trajtohet problematika e rimbursimit të tepricës kreditore të tatim fitimit, faqe 31-32, sqarojmë:Procedurat e dhënjes se tepricës kreditore ndiqen dhe realizohen nga DRT-ja që kontrollon dhe jep rimbursimin e tepricës kreditore të tatim fitimit. Duke qënë se në konkluzion kërkoni që të investigohen menjëhere të gjitha rastet, sqarojmë se duhet të hiqet fjala “investigim” dhe të zvëndësohet me fjalën verifikim ose kontroll i procedurave të ndjekura nga DRT për dhënien e tepricës kreditore të tatim fitimit. Inspektorët e DPT nuk lejohet të kryejn*

²²E-mail i helpdesk, i datës 30.06.2020: “...lidhet me procedurën e vlerësimit automatik, i cili kryhej për deklaratat e pa dorëzuara duke mare në konsideratë vetëm statusin e deklaratës, por nuk kontrollonte nëse statusi I tatimpaguesit ishte aktiv për të njëjtën periudhe tatimore të deklaratës së pa dorëzuar.”

verifikime në tatimpaguesit, referuar pikës 16 të udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSh” i ndryshuar ku citohet “16. njësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në asnjë rast, nuk lejohet të kontrollojnë direkt tatimpaguesit. Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT do planifikojë në bazë të rekomandimeve kryerjen e verifikimit të rasteve sipas DRT-ve të rimbursimit të tepricës kreditore të tatim fitimit.

Qëndrimi i audituesit: Në gjykimin e audituesit, rasti i subjektit kërkon jo vetëm verifikim por edhe investigim për sa kohë është ekzekutuar nga helpdesk. Në të gjithë rastet e tjera fjala investigim është zëvendësuar me fjalën verifikim.

Konkluzioni: Observacioni merret parasysh.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

1. Titullarët e Drejtorive rajonale tatimore në përgjegjësinë e ekzekutimit të masave për mbledhjen me force dhe kontrollit tatimor dhe menaxhimit të strukturave administrative përkatëse.

Z.Xh.C. në cilësinë e ish nëndrejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për periudhën 01.01.2019-04.04.2019

2. Zj.I.A. në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor

3. Struktura e AKSHIT (helpdesk) në cilësinë e ekzekutuesit të veprimeve në lidhje me subjektin M.

Në vijim të takimit ballafaques, për saktësimin e përgjegjësiave u morën në konsideratë periodha kur anulimet e cituara në gjetje dhe titullarëve respektivë.

B.3.2 Niveli i proceseve gjyqësore në proces lidhur me aspekte të mbledhjes së tatimit mbi fitimin.

Nga auditimi i databazës së proceseve gjyqësore të përfunduara gjatë vitit 2019, të vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, rezultojnë **453 procese gjyqësore të përfunduara** (vendime në të dy shkallët) me një vlerë totale padie prej 6 miliard lekë nga të cilat rezultojnë të pranuar (plotësisht ose pjesërisht) **157 çështje me vlerë rreth 2 miliard lekë**, 251 çështje të rrëzuara me vlerë mbi 3 miliard lekë (përfshirë 10 çështje të pranuar në shkallën e parë e më pas rrëzuar në shkallën e dytë të gjyimit) si dhe 42 çështje të pushuara me vlerë padie 844 milion lekë.

Në mijë lekë

DRT-te	Rrëzim padie		Pranim/Pranim pjesërisht		Pushim gjykimi/kthim padie		TOTAL	
	Vlera e padise	Nr.	Vlera e padise	Nr.	Vlera e padise	Nr.	Vlera e padise	Nr.
DRT BERAT	10	1	300	2	-		310	3
DRT Diber	579	1	-		-		579	1
DRT DURRES	173,941	24	17,320	13	50	1	191,312	38
DRT Fier	95,049	10	10,530	8	-		105,579	18
DRT Gjirokastrë	700	5	15,112	8	-		15,812	13
DRT Korce	10,819	32	2,490	14	-		13,309	46
DRT Lezhe	51,986	9	1,386	6	2,968	1	56,340	16
DRT Sarandë	1,507	7	21,658	16	1,430	3	24,595	26
DRT Shkodër	12,549	8	2,310	6	3,550	7	18,409	21
DRT Tirane	1,152,070	76	155,036	58	4,067	23	1,311,173	157
DRT Vlore	21,963	28	1,979	8	832,773	6	856,714	42
DRT-Elbasan	5,219	7	1,507	6	50	1	6,776	14
DTM	1,518,413	43	1,874,425	15	-		3,392,838	58

Total	3,044,806	251	2,104,053	160	844,888	42	5,993,747	453
--------------	------------------	------------	------------------	------------	----------------	-----------	------------------	------------

Shkalla e pranimit të padive rezulton të jetë **45% e gjithë kërkesë padive** (në numër dhe vlerë) të përfunduara gjatë vitit 2019.

Për qëllim të realizimit të programit të auditimit, nga përshkrimi i çështjeve, paditë janë kundërshtime për detyrime të lindura nga aktet-administrative për njoftim vlerësimi, gjoba.

Detyrimi tatimor	Rrëzim padie		Pranim/ pjeserisht		Pushim gjykimi/ Kthim padie		Totali	
	Vlera e padisë	NR.	Vlera e padisë	NR.	Vlera e padisë	NR.	Vlera e padisë	NR.
Borxhi	2,404	1	150	1	1,200	1	3,753	3
Evazion	-	1	-	-	-	-	-	1
Gjobe	22,873	89	19,958	89	1,900	19	44,731	197
njoftim vlerësimi	2,974,350	158	2,081,493	69	841,788	21	5,897,630	248
TVSH	-	-	2,452	1	-	-	2,452	1
urdhër bllokimi	45,179	2	-	-	-	1	45,178	3
Total	3,044,806	251	2,104,053	160	844,888	42	5,993,746	453

Megjithatë një statistikë e saktë për të vlerësuar rastet e kundërshtimeve të detyrimeve të tatimit nuk është e mundur pasi mungon përshkrimi i plotë i çështjeve me referencat përkatëse si dhe një pjesë e padive përfshijnë detyrime të llojeve të ndryshme të konkluduara nga një kontroll tatimor.

Me përfundimin e çështjes gjyqësore, për rastet kur DPT është gjyqfitues, një kopje e vendimit përcillet drejtorisë së borxhit me qëllim ndjekjen e arkëtimit të detyrimit tatimor. Për rastet kur DPT rezulton të jetë humbës, vendimi i gjykatës dërgohet në Drejtorinë e Kontrollit për të bërë sistemimet përkatëse në sistem për anulimin/fshirjen e detyrimit të tatimpaguesit gjyqfitues. Me qëllim testimin e kryerjes së sistemeve përkatëse në C@TS për secilin subjekt është kërkuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor verifikimi i situatës të 27 subjekteve gjyqfitues nga ku rezultoi se datat e shkresa autorizuese për sistemin e situatës së subjektit gjyqfitues variojnë nga 2-13 muaj. Për 4 raste kemi vetëm shpjegimin “transferuar në DRT tjetër” por jo shkresën dhe konfirmimin nëse detyrimi është anuluar. Në këtë kampion rezulton një tjetër rast ku detyrimi është fshirë me shpjegimin “sipas ligjit të faljes 2017” ndërkohë që subjekti ka qënë ende në proces gjyqësor dhe vendimi është finalizuar 04/2019:

I PADITUR	OBJEKTI	VLERA E PADISE	VENDIMARRJE GJYKATA I	VENDIMARRJE GJYKATA II	Nr/Date shkrese kur është bërë sistemimi
DRT Sarandë	Pavlefshmeri Absolute e Njoftim Vlerësimit nr.3756 dt 08.04.2016 e DRT Sarandë	16,755,140 Eranda Hoxhaj	Vendimi nr.706 dt 14.11.2016, pranim padie	Vendim nr.1034 dt 04.04.2019, lenie ne fuqi	Sistemim automatik i detyrimeve bazuar ne Ligjin nr.33, date 30.03.2017 "Per Faljen e detyrimeve.."

Në zbatim të programit të auditimit u kërkuar dhe u vunë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike lista e **çështjeve gjyqësore me status “në proces”** deri më 31.12.2019. Në këtë listë rezultojnë të raportuara rreth 300 çështje gjyqësore në proces nga të cilat 98 çështje në shkallën e parë dhe 214 çështje/padi në proces gjyqësor në shkallën e dytë të gjyqimit, e një vlerë totale

padie rreth 3 miliard lekë nga të cilat 27 çështje/padi për kundërshtim të vlerësimit të tatimit mbi fitimin dhe gjoba të lidhur me të, me një vlerë totale padie rreth 1.4 miliard lekë²³.

Detyrimet e njoftim vlerësimeve regjistrohen në sistemin C@TS nga inspektorët e kontrollit për secilin subjekt. Pavarësisht se këto detyrime nuk janë arkëtuar apo garancisë bankare të vendosura mbi detyrimin e lindur, raportohen në zërin “debitorë” dhe nuk ndiqen nga Drejtoria e Mbledhjes me forcë për sa kohë detyrimet janë kundërshtuar në gjykatë. Me qëllim testimin e situatës së këtyre subjekteve në sistemin C@TS është kërkuar informacion mbi detyrimet reale të **158 subjekteve që janë ende në proces gjyqësor nga ku rezultoi se në 62 subjekte, gjendja debitoare në kohë reale (Korrik 2019) nuk pasqyron detyrimet për të cilat subjekti është ende në proces gjyqësor me një diferencë në balancën debitoare me rreth 137,564 mijë lekë**. Sipas DRT-ve numri i subjekteve me gjendje debitoare të pasaktë paraqitet në tabelën në vijim, ku DRT Korçë dhe Vlorë rezultojnë me numrin më të lartë të rasteve.

DRT-të	Nr. subjekteve	Debia sipas C@TS në lekë	Padia në lekë	Diferenca ne gjendjen debitoare në lekë
DRT Berat	4	18,662,938	21,441,831	-2,778,893
DRT Durres	3	1,003,532	4,012,671	-3,009,139
DRT Elbasan	2	573,524	2,033,787	-1,460,263
DRT Fier	5	44,870,915	86,574,768	-41,703,853
DRT Gjirokastr	3	244,747	362,266	-117,519
DRT Korçe	18	2,913,411	9,739,765	-6,826,354
DRT Lezhe	5	4,523,136	26,116,119	-21,592,983
DRT Sarande	3	42,036	704,908	-662,872
DRT Tirane	7	328,478	7,550,518	-7,222,040
DRT Vlore	11	7,162,427	58,739,012	-51,576,585
DTM	1	492,539	1,106,145	-613,606
Total	62	80,817,683	218,381,790	-137,564,107

Gjetja	Shkalla pranimit të padive nga tatimpaguesit për kundërshtimin e akteve administrative rezulton të jetë 45% e rasteve të përfunduara me një vendim të formës së prerë gjatë vitit 2019. Nga auditimi u konstatuan vonesa në regjistrimin e detyrimeve të lindura nga aktet administrative ku datat e shkresave autorizuese për sistemimin e situatës së subjektit gjyqfitues në C@TS variojnë nga 2-13 muaj.
Situata	Nga auditimi i data bazës së proceseve gjyqësore të përfunduara gjatë vitit 2019, të vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, rezultojnë 453 procese gjyqësore të përfunduara (vendime në të dy shkallët) me një vlerë totale padie prej 6 miliard lekë nga të cilat <u>rezultojnë të pranuar</u> (plotësisht ose pjesërisht) 157 çështje me vlerë rreth 2 miliard lekë , 251 çështje të rrëzuara me vlerë mbi 3 miliard lekë (përfshirë 10 çështje të pranuar në shkallën e parë e më pas rrëzuar në shkallën e dytë të gjykimit) si dhe 42 çështje të pushuara me vlerë padie 844 milion lekë. Shkalla e pranimit të padive rezulton të jetë 45% e gjithë kërkesë padive (në numër dhe vlerë) të përfunduara gjatë vitit 2019. Në zbatim të programit të auditimit, përpilimi i një statistike të saktë me qëllim vlerësimin e rasteve

²³Referuar përshkrimit të statusit në tabelën e vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore, vlera e padisë mund të përfshijë edhe zëra të tjerë të vlerësuar gjatë një kontrolli si TVSH, kontribute etj.

	të kundërshtimeve të detyrimeve të tatim fitimit nuk është e mundur pasi mungon përshkrimi i plotë i çështjeve me referencat përkatëse si dhe pothuaj të gjitha kërkesë paditë listuar në këtë data bazë përfshijnë disa lloje detyrimesh tatimore të konkluduara nga një kontroll tatimor. Për rastet kur DPT rezulton të jetë humbës, vendimi i gjykatës dërgohet në Drejtorinë e Kontrollit për të bërë sistemimet përkatëse në sistem për anulimin/fshirjen e detyrimit të tatimpaguesit gjyqfitues. Me qëllim testimin e kryerjes së sistemimeve përkatëse në C@TS për secilin subjekt është kërkuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor verifikimi i situatës të <u>27 subjekteve gjyqfitues</u> nga ku rezultoi se datat e shkresave autorizuese për sistemin e situatës së subjektit gjyqfitues variojnë nga 2-13 muaj. Për 4 raste kemi vetëm shpjegimin “transferuar në DRT tjetër” por jo shkresën dhe konfirmimin nëse detyrimi është anuluar ose jo në sistem.
Kriteri:	Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjinr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasaktësi në vlerën e borxhit të raportuar. Mungesë kontrollesh dhe rakordim të dhënash ndër departamentale.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër grupi i auditimit ka lënë Akt-konstatimin nr.15 datë 24.07.2020 ku janë ngarkuar me përgjegjësi:

1.Titullarët e Drejtorive rajonale tatimore në përgjegjësinë e regjistrimit të detyrimeve të lindura nga aktet administrative dhe menaxhimit të strukturave administrative përkatëse.

2.Zj.I.A në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor në përgjegjësitë e rrjedhura nga Rregullorja e Funksionimit të DPT.

3.Zj. I.K në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë tekniko-ligjore në përgjegjësinë e mirëmbajtjes dhe raportimit në kohë të vendimeve gjyqësore.

Gjetja	Në sistemin C@TS, detyrimet e 158 subjekteve që janë ende në proces gjyqësor u konstatuan 62 subjekte, gjendja debitore në kohë reale (Korrik 2019) e të cilëve nuk pasqyron detyrimet për të cilat subjekti është ende në proces gjyqësor²⁴.
---------------	---

²⁴ Referuar data bazës së çështjeve gjyqësore në process në shkallën e parë apo të dytë vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore në DPT.

Situata	<p>Në zbatim të programit të auditimit u kërkuan dhe u vunë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike lista e çështjeve gjyqësore me status “në proces” deri më 31.12.2019. Në këtë listë rezultojnë të raportuara rreth 300 çështje gjyqësore në proces nga të cilat 98 çështje në shkallën e parë dhe 214 çështje/padi në proces në shkallën e dytë të gjykimit, me një vlerë totale padie rreth 3 miliard lekë nga të cilat 27 çështje/padi për kundërshtim të vlerësimit të tatimit mbi fitimin dhe gjoba të lidhur me të, me një vlerë totale padie rreth 1.4 miliard lekë²⁵.</p> <p>Detyrimet e njoftim vlerësimeve regjistrohen në sistemin C@TS nga inspektorët e kontrollit për secilin subjekt. Pavarësisht se këto detyrime nuk janë arkëtuar ato nuk ndiqen nga Drejtoria e Mbledhjes me forcë për sa kohë detyrimet janë kundërshtuar në gjykatë. Me qëllim testimin e situatës së këtyre subjekteve në sistemin C@TS është kërkuar informacion mbi detyrimet reale të 158 subjekteve që janë ende në proces gjyqësor nga ku rezultoi se në 62 subjekte DRT Korçë (8 raste) dhe Vlorë(11 raste) etj.), gjendja debitore në kohë reale (Korrik 2020) nuk pasqyron detyrimet për të cilat subjekti është ende në proces gjyqësor me një diferencë në balancën debitore me rreth 137,564 mijë lekë më pak. Duke marrë në konsideratë që situata e subjekteve në sistemin C@TS është dinamike dhe e ndryshueshme në kohë, si auditues nuk mund të japim siguri për shkakun e diferencave në vlera të konstatuara. Kjo mbetet për verifikim të mëtejshëm nga DKT dhe DRT-re që administrojnë këto subjekte dhe që ndjekin rastin në gjykatë.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar,</p> <p>Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligjinr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore”;</p> <p>Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	Pasaktësi në vlerën e borxhit të raportuar. Mungesë kontrollesh dhe rakordim të dhënash ndër departamentale.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër grupi i auditimit ka lënë Akt-konstatimin nr.15 datë 24.07.2020.

²⁵Referuar përshkrimit të statusit në tabelën e vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore, vlera e padisë mund të përfshijë edhe zëra të tjerë të vlerësuar gjatë një kontrolli si TVSH, kontribute etj.

Gjetja	Konstatohen 2 raste për të cilët anulimi i detyrimeve tatimore në C@TS është shpjeguar nga DRT se është kryer në referencë të Ligjit të faljes së vitit 2017.
Situata	Nga auditimi u konstatuan dy raste të anulimit të detyrimeve, konkretisht për subjektin “M” administruar nga DRT Vlorë dhe subjekti E.H administruar nga DRT Sarandë, për të cilin detyrimi është fshirë me shpjegimin “sipas ligjit të faljes 2017” ndërkohë që këto dy subjekte kanë qenë ende në proces gjyqësor në vitin 2017. Për subjektin “E.H”, sipas data bazës së Drejtorisë Ligjore në DPT, vendimi është finalizuar në Prill 2019 sipas të cilit padia e kundërshtuar me vlerë 16,755 mijë lekë është rrezuar edhe në shkallë të II-të të gjyqimit, dhe për subjektin M, po sipas të njëjtës data bazës subjekti është ende në proces gjykimi në shkallën e II-të për kundërshtimin e dy njoftim vlerësimeve të datave 16.03.2017 dhe 17.03.2017, me vlerë totale detyrimi 35,433 mijë lekë. Sipas parashikimeve të Ligjit nr.33/2017 kriteri për fshirjen e detyrimit tatimor ishte mosha e detyrimit “krijuar para vitit 2010” dhe “dorëheqjet nga procesi i ankimimit gjyqësor/apel” për tu kualifikuar për fshirjen automatike në C@TS, kushte të cilat për subjektin M nuk rezultojnë të plotësuar.
Kriteri:	Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Veprime në kundërshtim me ligjin
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër grupi i auditimit ka lënë Akt-konstatimin nr.15 datë 24.07.2020.

Në vijim të takimit ballafaques të datës 14.10.2020, subjekti përcjell dokumentacion sqarues për rastin e subjektit M, shoqëruar me pamje nga sistemi C@TS nga të cilat rezulton se detyrimet e njoftim vlerësimit janë hedhur në sistem në vitin 2017 por më pas janë anuluar me Ligjin e faljes 33/2017. Në bazë të këtij informacioni është riformuluar gjetja sa më lartë, pasi nuk jemi më në rastin e mos shfaqjes së detyrimit por jemi në kushtet kur subjektit i janë falur detyrimet në kundërshtim me Ligjin nr.33/2017.

Për sa më sipër:

Duke qenë se veprimet në lidhje subjektin M i përkasin vitit 2017, vit jashtë periudhës së auditimit, ngarkohet titullari aktual i DPT për urdhërimin e kryerjes së verifikimeve të menjëhershme, për veprimet për zbatimin e ligjit të faljeve përfshirë gjithë strukturat sipas detyrave

të ngarkuara deri në mbërritjen e informacionit te Zyra e Projektit ngritur posacërisht për hartimin e listave për fshirjen e detyrimeve apo cdo strukturë tjetër e përfshirë dhe që do të rezultojë nga verifikimi.

B.3.3. Niveli i parapagimeve stok në fund të vitit 2019, analiza e ecuresë së këtij treguesi.

Në zbatim të Ligjit nr.8438 satë 28.12.1998, i ndryshuar, neni 30 “Parapagimet”, cituar “gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 30 shtator, për muajtkorrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor”.

Në përputhje me këtë parashikim ligjor, u audituan tepricat kreditore të raportuara nga DPT në grupin e llogarisë kontabël 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Kjo llogari është specifike në sektorin publik dhe në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurën e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të NJQP”, jepen dhe udhëzimet e regjistrimeve kontabël në këtë llogari: “...në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve”, të tilla si: • Derdhjet e ndryshme të bëra gabim dhe që duhet të rikthehen; • Depozitime të kontributeve në avancë apo ndonjë depozitim tjetër; etj.

Arkëtimet e rrjedhura sipas përcaktimeve ligjore në lidhje me parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimin regjistrohen në llogarinë analitike 4665003 “depozitime të përkohshme për tatimin mbi fitimin”. Skema e kontabilizimit, sic edhe është trajtuar në auditimin e vitit të kaluar, parashikon regjistrimin e parapagimeve të tatim fitimit në llogarinë 466 (4665003 analitike) por në ndryshim nga llogaritë e tjera të cilat axhustohen (debitohen) rast pas rasti me deklaratimet periodike të subjektit tatimpagues, kjo llogari vazhdon të paraqesë gjendjen historike të parapagimeve ndërkohë që në sistemin C@TS këto parapagime sistemohen në mënyrë dinamike me deklarin vjetor faktik të rezultatit financiar vjetor të subjektit. **Kështu, në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003 më 31.12.2019 paraqitet në shumën 92,461,447 mijë lekë.**

Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2019, pa u axhustuar me deklaratimet vjetore në 31.03.2019 për llogari të parapagimeve të bazuara në rezultatin tatimor të deklaruar për vitin 2018. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@TS por në kontabilitet kjo nuk gjen pasqyrim dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti si një zë “detyrimi” në pasivin e bilancit të DPT-së me kunderparti “llog.520 disponibilitete në thesar”.

Gjendja Llog.466 më 01.01.2019	66.5 miliard lekë
Arkëtime 2019	25.9 miliard lekë
Gjendja e llog.466 më 31.12.2019	92.5 miliard lekë
<i>Nga të cilat:</i>	
Arkëtime (Të ardhura) të raportuara për zërin “tatim mbi fitimin”	23,4 miliard lekë
Teprica kreditore sipas C@TS 31.12.2019	14.1 miliard lekë

Sic paraqitet dhe në tabelën më lartë, gjendja kreditore reale në sistemin C@TS në **31.12.2019 rezulton të jetë 14,150,843 mijë lekë tepricë që i takon rreth 12400 subjekteve kreditore**, nga

të cilët 215 subjekte, me një tepëricë kreditore rreth 141 milion lekë, rezultojnë të kenë kaluar në status “pasiv” gjatë vitit 2019.

Lloji i detyrimit të paguar	Celja	Shuma e Perdorur	Shuma e Rimbursuar	Gjendja e re	Kredia e re	Tepërica Progressive
1100 - Tatim Fitimi likuiditet	5,829,150	3,333,525	26,101	2,469,523	3,138,632	5,608,156
1101 - Tatim fitimi detyrim principal	9,120,052	1,431,668	22,983	7,665,400	706,934	8,372,335
1102 - Detyrim për Tatim Fitimi, principal	819	564	-	254	1,476	1,731
1130 - Gjore per deklarim te vonuar TF	135	10	-	125	20	145
1151 - Gjore inspektori per evazion fiskal dhe fshehja detyrimi	167,461	44,501	6	122,953	22,284	145,238
1152 - Gjore per paraqitje me vonese Vendim ortaku.	2,668	410	-	2,258	3,837	6,096
1153 - Gjore per paraqitje me vonese pasqyra financiare te TF	837	57	-	780	374	1,154
1154 - Interes 5% te ndryshimit midis pageses dhe korigjimit te kesteve te tatim fitimit	92	-	-	92	18	110
1155 - Gjore per mospagim te kesteve te tatim fitimit	6,998	1,519	-	5,479	10,396	15,875
Total	15,128,215	4,812,256	49,091	10,266,867	3,883,975	14,150,842

Krahasuar me një vit më parë, tepërica kreditore nga parapagimet e tatim fitimit ka ndryshuar me vetëm 1 miliard lekë, kjo pasi shuma e përdorur në momentin e dorëzimit të deklarates është pothuaj në të njëjtën nivel me shumën kreditore të re. Pavarësisht rezultatit faktik financiar dhe tatimor, duket se një pjesë e subjekteve rezultojnë me mbipagesë të tatimit mbi fitimin të vlerësuar paraprakisht nga administrata tatimore. Në funksion të analizës së stokut të tepëricës kreditore të parapagimeve të tatim fitimit janë krahasuar të dhënat 50 tatimpaguesve me tepëricën kreditore më të lartë:

Në mijë lekë

Emri subjektit	Celja 01.01.2019	Shuma e Perdorur	Gjendja e re	Kredia e re	Progresiv
B P Al	6,061,333	410,545	5,650,788	-	5,650,788
K I SH.A.	693,142	297,382	395,760	9,653	405,413
S - Shqipëria	39,266	33,150	6,116	336,603	342,718
V A	607,424	607,424	-	337,694	337,694
R B	1,247,903	954,996	292,907	19,816	312,723
T A	14,308	-	14,308	243,997	258,305
B O Al	-	-	-	164,107	164,107
I D S	-	-	-	102,181	102,181
PC B	77,494	-	77,494	3,680	81,174
S2 AL	-	-	-	70,043	70,043
I S B	-	-	-	62,226	62,226
Albamet	-	-	-	56,757	56,757
A H	56,063	12,004	44,059	9,688	53,747
A	45,556	-	45,556	8,177	53,733
E	34,531	1,256	33,275	16,507	49,782
H O S	35,397	-	35,397	11,799	47,196
T E 2	32,546	440	32,105	11,655	43,760
GAS E	41,037	-	41,037	-	41,037
A "N T"	36,942	-	36,942	-	36,942
T V Sh.a	37,811	33,381	4,430	30,550	34,979
S U Gr	8,139	8,139	-	33,222	33,222
A	1,351	-	1,351	29,143	30,494
T O E	-	-	-	30,277	30,277

W A Int	120	108	12	29,408	29,420
B A I	-	-	-	29,021	29,021
P R O	18,593	2,974	15,619	12,691	28,310
L S	27,601	-	27,601	-	27,601
A B , Filiali Tirane	27,484	-	27,484	-	27,484
B C	50,462	50,000	462	26,675	27,136
A SHA	95,261	83,033	12,228	13,724	25,951
D I A	25,597	-	25,597	-	25,597
P - V- K	52,956	52,956	-	24,954	24,954
E C	24,244	-	24,244	-	24,244
S AL	24,030	-	24,030	5	24,035
F B	8,857	8,857	-	22,907	22,907
R I -E	-	-	-	22,475	22,475
S	-	-	-	22,142	22,142
S M S	19,139	778	18,361	3,708	22,069
Q T U	-	-	-	21,955	21,955
H T AI	-	-	-	21,924	21,924
A	6,406	6,406	-	21,402	21,402
U B SHA	11,834	11,834	-	20,869	20,869
S D S Limited	-	-	-	20,792	20,792
N F C AI	41,508	21,337	20,171	-	20,171
S E S.p.A	15,185	-	15,185	4,704	19,889
T - A	19,184	-	19,184	-	19,184
B N T	18,836	-	18,836	-	18,836
I A	18,791	10	18,781	-	18,781
A K	13,496	7,926	5,570	12,827	18,397
A	-	-	-	18,311	18,311
Top 50	9,589,828	2,604,937	6,984,891	1,938,266	8,923,156

Në listën e kreditorëve më të mëdhenj, referuar shumës së përdorur pas deklarimit në vitin 2019 për llogari të periudhës 2018, duket se disa nga subjektet pavarësisht shumës së vogël të përdorur (rezultat i detyrimit të tatim fitimit shumë të ulët faktik kundrejt vlerësimit paraprak të administratës tatimore) përsëri kanë vijuar me parapagime në vlera të larta. Më konkretisht:

- 16 raste me një tepricë kreditorë rreth 670 milion lekë, ku subjekti ka deklaruar humbje në deklaraten e dorëzuar në muajin Mars 2019 dhe përsëri ka vazhduar me pagesë të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit për periudhën Prill- Dhjetor 2019, duke shtuar kështu tepricën kreditorë. Nga të dhënat rezulton se po këto subjekte kanë deklaruar përsëri humbje në Mars 2020, pra nuk kanë arritur të përdorin shumën e parapaguara për tatim fitimin. Për rastet e subjekteve me humbje dhe me pagese është kërkuar shpjegim nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor por deri në datën e mbajtjes së këtij akti informacioni nuk u vu në dispozicion.
- 6 subjekte me një tepricë kreditorë në total rreth 160 milionë lekë, konstatohet se nuk kanë dorëzuar deklaraten e tatimit mbi fitimin në të dy vitet 2018 dhe 2019. Subjektet në fjalë nuk rezultojnë në listën e subjekteve pasiv.
- Gjithashtu është kërkuar informacion edhe për rastet e subjekteve që kanë deklaruar humbjepor që rezultojnë me “shuma të përdorura” por deri në datën e mbajtjes së këtij akti informacioni nuk u vu në dispozicion:

NIPT	TaxpayerName	Celja	Perdorur
KxxxxxxL	B P A	6,061,333	410,545
LxxxxxxQ	Energija D.O.O	34,531	1,256
KxxxxxxG	T V Sh.a	37,811	33,381
KxxxxxxI	P R O	18,593	2,974

Sipas Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75, kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe se shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin e vlerësimit tatimor apo në deklaratën tatimore, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga personi i tatueshëm. Një gjë e tillë, bëhet në mënyrë automatike nga vetë administrata tatimore, brenda periudhës së parë vijuese tatimore që vjen pas periudhës në të cilën personi i tatueshëm rezulton me kredi tatimore. Për tatimin mbi fitimin një gjë e tillë, bëhet brenda muajit të parë që pason muajin në të cilin personi i tatueshëm rezulton me kredi tatimore. Nga të dhënat nuk rezulton që një procedurë e tillë të ndodh automatikisht. Nga 50 subjektet me teprice kreditore më të lartë në total 8.9 miliard lekë, të mbartur që nga viti 2018 dhe/ apo të krijuar rishtaz, rezultojnë me balanca debitore në total rreth 1.8 miliard lekë (pa përfshirë detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore):

TaxpayerName	Celja	Perdorur	Gjendja e re	Kredia e re	Progresiv	Balanca Debitore
B P Al	6,061,332,867	410,544,580	5,650,788,287	-	5,650,788,287	601,438,757
K I SH.A.	693,142,449	297,382,036	395,760,413	9,652,807	405,413,220	-
S - Shqiperia	39265913	33150000	6115913	336602553	342,718,466	-
V A	607,423,989	607,423,989	-	337,694,158	337,694,158	192,396,829
R B	1,247,903,302	954,996,432	292,906,870	19,816,108	312,722,978	888,155
T A	14,308,054	-	14,308,054	243,997,014	258,305,068	70,814,462
B O Al	-	-	-	164,106,754	164,106,754	-
I D S	-	-	-	102,180,518	102,180,518	-
PC B	77,494,424	-	77,494,424	3,680,046	81,174,470	-
S2 AL	0	0	0	70042801	70,042,801	10,000
I S B	-	-	-	62,225,755	62,225,755	-
Albamet	0	0	0	56757068	56,757,068	3,205,317
A H	56,062,794	12,003,547	44,059,247	9,687,822	53,747,069	1,035,986
A	45,555,874	-	45,555,874	8,176,707	53,732,581	47,003,382
E	34530591	1255728	33274863	16507419	49,782,282	-
H O S	35396709	0	35396709	11798904	47,195,613	-
T E 2	32,545,710	440,385	32,105,325	11,654,845	43,760,170	-
GAS E	41,036,991	-	41,036,991	-	41,036,991	-
A "N T"	36,941,782	-	36,941,782	-	36,941,782	20,000
T V Sh.a	37,811,116	33,381,493	4,429,623	30,549,776	34,979,399	-
S U Gr	8,138,938	8,138,938	-	33,222,478	33,222,478	-
A	1,351,425	-	1,351,425	29,142,554	30,493,979	3,279,136
T O E	-	-	-	30,277,251	30,277,251	-
W A Int	119,710	107,853	11,857	29,407,698	29,419,555	-
B A I	-	-	-	29,021,024	29,021,024	-
P R O	18,593,394	2,974,074	15,619,320	12,690,927	28,310,247	-
L S	27,600,864	-	27,600,864	-	27,600,864	570,000
A B , Filiali Tirane	27,484,353	-	27,484,353	-	27,484,353	590,000
B C	50,461,618	50,000,000	461,618	26,674,670	27,136,288	4,600,000
A SHA	95,260,877	83,033,348	12,227,529	13,723,939	25,951,468	279,137,200
D I A	25,597,264	-	25,597,264	-	25,597,264	933,359
P - V- K	52,955,598	52,955,598	-	24,953,818	24,953,818	-
E C	24,243,579	-	24,243,579	-	24,243,579	-
S AL	24,030,386	-	24,030,386	4,543	24,034,929	-
F B	8,857,410	8,857,410	-	22,906,604	22,906,604	-

R I-E	0	0	0	22474898	22,474,898	-
S	-	-	-	22,142,190	22,142,190	-
S M S	19139015	778014	18361001	3708006	22,069,007	-
Q T U	0	0	0	21955300	21,955,300	-
H T A I	-	-	-	21,923,721	21,923,721	-
A	6,406,059	6,406,059	-	21,401,943	21,401,943	-
U B SHA	11,834,473	11,834,473	-	20,868,674	20,868,674	-
S D S Limited	-	-	-	20,791,726	20,791,726	577,177,108
N F C A I	41507968	21337086	20170882	0	20,170,882	-
S E S.p.A	15184646	0	15184646	4704396	19,889,042	-
T - A	19,184,079	-	19,184,079	-	19,184,079	-
B N T	18,836,107	-	18,836,107	-	18,836,107	-
I A	18,791,126	10,000	18,781,126	-	18,781,126	5,385,706
A K	13,496,179	7,925,964	5,570,215	12,827,221	18,397,436	-
A	-	-	-	18,311,013	18,311,013	-
	9,589,827,633	2,604,937,007	6,984,890,626	1,938,265,649	8,923,156,275	1,788,485,397

Në total balanca debitore e të gjithë subjekteve kreditore për tatim fitimin rezultojn të jetë 19 miliard lekë nga të cilat 2.3 miliard lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe gjokat e lidhura me të.

Kur shuma e tepricës së kredisë tatimore është më e madhe se shuma e detyrimeve të tjera tatimore të paguara të personit të tatueshëm, diferenca e mbetur, sipas kërkesës me shkrim të personit të tatueshëm, mund të rimbursohet automatikisht për personin e tatueshëm, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së shumës së paguar më tepër apo nga data e plotësimit të kushteve ligjore për rimbursim; Kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

Nga të dhënat analitike të tepricës kreditore të tatim fitimit konstatohen diferenca në numër subjektsh dhe vlera të paguara midis të dhënave në sistemin e Thesarit dhe sistemit C@TS. Kështu, konstatohen gjithsej vetëm 6 subjekte të cilat janë rimbursuar në shumën 49,091 mijë lekë. Nga rakordimi me të dhënat e pagesave në Thesar (SIFQ) rezultojnë 7 subjekte të jenë rimbursuar për tepricat kreditore të tatim fitimit në shumën 47,568 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar diferencat për secilin subjekt midis shumës së paguar nëpërmjet Thesarit dhe shumës që figuron në sistemin C@TS, janë paraqitur në tabelën në vijim:

Subjekti	Kodi tatimit	Celja	Perdorur	Rimbursuar C@TS	Pagesat ne Thesar
SBM	1101 - Tatim fitimi detyrim principal	21,212,109	599,184	20,612,925	9,598,003
E O	1100 - Tatim Fitimi likuiditet	18,523,883	-	18,523,883	22,631,942
F A	1100 - Tatim Fitimi likuiditet	263,470	2,580	260,890	269,509
FG S	1100 - Tatim Fitimi likuiditet	7,512,101	1,739,225	5,772,876	6,159,447
A	1151 - Gjoke inspektori per evazion fiskal dhe fshehja detyrimi	6,273	-	6,273	6,273
A	1100 - Tatim Fitimi likuiditet	665,562	389,475	276,087	180,576
Lxx L.	1100 - Tatim Fitimi likuiditet	1,321,945	36,156	1,285,789	1,381,228
L.xx L.	1101 - Tatim fitimi detyrim principal	2,372,938	20,000	2,352,938	2,283,655
V.H.P	1101 - Tatim fitimi detyrim principal	4,424,620	-	-	5,057,575

	TOTAL	56,302,901	2,786,620	49,091,661	47,568,208
--	--------------	-------------------	------------------	-------------------	-------------------

Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoritë Rajonale konstatohet se:

- 1) për rastin e subjektit FG S me NIPT JxxxxxN administruar nga DRT Shkodër, ka paraqitur në datën 08.07.2019 kërkesën për rimbursimin e tepricës kreditore të periudhave 13-A, 14-A dhe 15-A në shumën 7,250,938 lekë. Në datën 17.07.2019 DRT Shkodër shprehet se ka bërë verifikimet në sistemin C@TS dhe shuma e papërdorur e tepricës kreditore është 6,159,708 lekë për periudhën 15-A, dhe urdhëron pagesën në datën 28.09.2019 për subjektin për të njëjtën shumë. Në sistemin C@TS raportohet se shuma e rimbursuar është 5,772,876 lekë.
- 2) Për rastin e subjektit “V.H.P” me NIPT LxxxxxA administruar nga DRT Tiranë, ka paraqitur në datën 15.07.2019 kërkesën për rimbursimin e tepricës kreditore të tatim fitimit të paguar për periudhën 13-A në shumën 2,326,763 lekë, për periudhën 14-A në shumën 2,680,595 lekë dhe për periudhën 15-A në shumën 50,217 lekë. Në sistemin C@TS teprica kreditore e subjektit më 01.01.2019 dhe më 31.12.2019 rezulton të jetë 4,424,620 lekë dhe zero “rimbursime”. Gjithashtu referuar periudhave, në zbatim të nenit 73 të Ligjit nr.9920 “Për procedurat Tatimore në RSH”, e drejta për të kërkuar rimbursim të shumavë paguar tepër parashkruhet pas 5 vjetësh nga data e deklaratës së parë. Në këtë mënyrë shuma e kërkuar dhe rimbursuar për periudhën 13-A është paguar në kundërshtim me parashikimin ligjor. Grupi i auditimit ka kërkuar nga Drejtoria e Kontrollit të konfirmojë situatën e subjektit, tepricën kreditore të raportuara të ndryshme nga ajo e rimbursuar, arsyen e mosazhormimit të situatës së subjektit, shumën e paguar më tepër se teprica kreditore që rezulton në sistem, si dhe rregullshmërinë e miratimit nga ana e DRT Tiranë të shumës që i përket periudhës 13-A.
- 3) Për subjektin SMB me NIPT LxxxxxV administruar nga DRT Dibër, ka paraqitur në datën 08.04.2019 kërkesën për rimbursimin e tepricës kreditore të tatim fitimit të paguar për periudhën 18-A në shumën 9,713,228 lekë. Në sistemin C@TS raportohet se shuma e rimbursuar është 20,612,925 lekë.

Gjetja	Gjendja kreditore në sistemin C@TS në 31.12.2019 është 14,150,843 mijë lekë, tepricë që i takon rreth 12,400 subjekteve. Teprica kreditore për tatim fitimin vazhdon të mbetet tepër e lartë dhe gjatë vitit 2019 edhe pse rezulton të ketë ndryshuar me vetëm 1 miliard lekë (pakësim) krahasuar me fund vitin 2018. Për tatimin mbi fitimin, kompensimi duhet të bëhet brenda muajit të parë që pason muajin në të cilin personi i tatueshëm rezulton me kredi tatimore por nga të dhënat nuk rezulton që një procedurë e tillë të ndodh automatikisht në C@TS.
Situata	Gjendja kreditore në sistemin C@TS në 31.12.2019 rezulton të jetë 14,150,843 mijë lekë tepricë që i takon rreth 12400 subjekteve kreditore , nga të cilët 215 subjekte, me një tepricë kreditore rreth 141 milion lekë, rezultojnë të kenë kaluar në status “pasiv” gjatë vitit 2019. Krahasuar me një vit më parë, teprica kreditore nga parapagimet e tatim fitimit ka ndryshuar me vetëm 1 miliard lekë. 50 tatimpaguesit me tepricën kreditore më të lartë evidentohen: B P, K Intl., S-Sh, V A, R B sha, T A etj. Në listën e kreditorëve më të mëdhenj, referuar shumës së përdorur pas deklarimit në vitin 2019 për llogari të periudhës 2018, duket se disa nga subjektet pavarësisht shumës së vogël të përdorur (rezultat i detyrimit të tatim fitimit shumë të ulët faktik kundrejt vlerësimit paraprak të

	<p>administratës tatimore) përsëri kanë vijuar me parapagime në vlera të larta. Më konkretisht:</p> <p><u>-16 raste me një tepricë kreditore rreth 670 milion lekë, ku subjekti ka deklaruar humbje në deklaratën e dorëzuar në muajin Mars 2019 dhe përsëri ka vazhduar me pagesë të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit për periudhën Prill- Dhjetor 2019, duke shtuar kështu tepricën kreditore. Nga të dhënat rezulton se po këto subjekte kanë deklaruar përsëri humbje në Mars 2020, pra nuk kanë arritur të përdorin shumat e parapaguara për tatim fitimin. Për rastet e subjekteve me humbje dhe me pagesë është kërkuar shpjegim nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor por deri në përfundim të këtij auditimi informacioni nuk u vu në dispozicion.</u></p> <p><u>-6 subjekte me një tepricë kreditore në total rreth 160 milionë lekë, konstatohet se nuk kanë dorëzuar deklaratën e tatimit mbi fitimin në të dy vitet 2018 dhe 2019. Subjektet në fjalë nuk rezultojnë as në listën e subjekteve pasiv.</u></p> <p>Sipas Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75, kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe se shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin e vlerësimit tatimor apo në deklaratën tatimore, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga personi i tatueshëm. Një gjë e tillë, bëhet në mënyrë automatike nga vetë administrata tatimore, brenda periudhës së parë vijuese tatimore që vjen pas periudhës në të cilën personi i tatueshëm rezulton me kredi tatimore. Për tatimin mbi fitimin një gjë e tillë, bëhet brenda muajit të parë që pason muajin në të cilin personi i tatueshëm rezulton me kredi tatimore. Nga të dhënat nuk rezulton që një procedurë e tillë të ndodh automatikisht. Nga 50 subjektet me tepricë kreditore më të lartë në total 8.9 miliard lekë, të mbartur që nga viti 2018 dhe/ apo të krijuar rishtas, rezultojnë me balanca debitore në total rreth 1.8 miliard lekë (pa përfshirë detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore). Në total balanca debitore e të gjithë subjekteve kreditore për tatim fitimin rezulton të jetë 19 miliard lekë nga të cilat 2.3 miliard lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe gjrobat e lidhura me të.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar</p> <p>Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”;</p> <p>Ligj nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar,</p> <p>Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.37 datë 19.12.2019 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit 2019”;</p> <p>Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar;</p>

	Udhëzim nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar; Udhëzimin nr.5 datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar; Udhëzim nr.10, datë 15.3.2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Rëndësia	I Lartë
Impakti	Rritje e detyrimeve kreditore e administratës tatimore

Për sa më sipër grupi i auditimit ka lënë Akt-konstatimin nr.15 datë 24.07.2020 ku janë ngarkuar me përgjegjësi:

1.Titullarët e Drejtorive rajonale tatimore në përgjegjësinë e regjistrimit të detyrimeve të lindura nga aktet administrative dhe menaxhimit të strukturave administrative përkatëse.

Gjetja	Nga të dhënat analitike të tepricës kreditore të tatim fitimit në C@TS, për rastet e rimbursimit konstatohen diferenca me të dhënat në SIFQ, në numër subjektsh dhe vlera të paguara. Nga këto raste, rimbursimi për subjektin “V.H.P.” me NIPT LxxxxxA, është bërë pjesërisht në kundërshtim me nenin 73 të Ligjit nr.9920 “Për procedurat Tatimore në RSH” në shumën 2,327 mijë lekë.
Situata	Nga të dhënat analitike të tepricës kreditore të tatim fitimit konstatohen diferenca në numër subjektsh dhe vlera të paguara midis të dhënave në SIFQ (Thesari) dhe sistemit C@TS. Kështu, konstatohen gjithsej vetëm 6 subjekte të cilat janë rimbursuar në shumën 49,091 mijë lekë. Nga rakordimi me të dhënat e pagesave në Thesar (SIFQ) rezultojnë 7 subjekte të jenë rimbursuar për tepricat kreditore të tatim fitimit në shumën 47,568 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se për rastin rimbursimit të subjektit “V. H.” me NIPT LxxxxxA administruar nga DRT Tiranë, ka paraqitur në datën 15.07.2019 kërkesën për rimbursimin e tepricës kreditore përfshirë këtu dhe tatim fitimin e paguar për periudhën 13-A në shumën 2,326,763 lekë. Gjithashtu referuar periudhave, në zbatim të nenit 73 të Ligjit nr.9920 “Për procedurat Tatimore në RSH”, e drejta për të kërkuar rimbursim të shumave paguar tepër parashkruhet pas 5 vjetësh nga data e deklaratës së parë. Në këtë mënyrë shuma e kërkuar dhe rimbursuar për periudhën 13-A është paguar në kundërshtim me parashikimin ligjor. Grupi i auditimit ka kërkuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor të konfirmojë situatën e subjektit, tepricën kreditore të raportuar të ndryshme nga ajo e rimbursuar, arsyen e mos azhornimit të situatës së subjektit, shumën e paguar më tepër se teprica kreditore që rezulton në sistem, si dhe rregullshmërinë e miratimit nga ana e DRT Tiranë të shumës që i përket periudhës 13-A.
Kriteri:	Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

	Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”; Ligj nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.37 datë 19.12.2019 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit 2019”; Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Udhëzim nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar; Udhëzimin nr.5 datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar; Udhëzim nr.10, datë 15.3.2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Rëndësia	I Lartë

Në lidhje me tepricën kreditore të llogarisë 4665004 “depozitime të përkohshme për TVSH”

Nga raporti i të ardhurave tatimore për periudhën Janar- Dhjetor 2019, një tjetër llogari në grupin 4665: “Depozitime të tjera (për tu sistemuar në të ardhmen)”, evidentohet dhe llogaria 4665504 “Depozitime të përkohshme për deklaraten e tatimit mbi vlerën e shtuar” e cila më 31.12.2019 rezulton me një balancë kreditore prej 768,059 mijë lekë. Ndryshe nga natyra e llogarisë 4665503 “Depozitime të përkohshme për deklaraten e tatim fitimit”, në këtë rast tepricat kreditore të akumuluar në këtë llogari vijnë si rezultat i pagesave të kryera nga subjektet ndërkohë që në sistemin C@TS nuk ekziston një detyrim. Këto shuma duhet të sistemohen në periudhat e ardhshme. Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohet se pagesat e kryera nga subjektet i referohen kryesisht periudhës tatimore viti 2019 në total 739 milion arkëtime por edhe periudhave të mëparshme tatimore nga viti 2002- 2018.

DRT-te	para .2017	v.2017	v.2018	v.2019	Total
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	123,690	8,002,190	9,730,661	567,846,784	585,641,480
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	292,974	206,238	3,556,227	57,275,454	61,184,406
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	33,862	37,955	381,511	36,175,832	36,612,229
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	7,632	5,153	632,217	21,020,469	21,661,655
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	63,460	-	241,886	12,121,716	12,401,642
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	7,820	14,494	(17,539)	11,731,561	11,732,426
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	112,810	-	17,779	8,197,945	8,272,129
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	-	-	39,985	4,470,542	4,510,527
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	482,348	5,878	399,944	5,343,624	5,990,620
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	9,428	1,343	167,703	2,621,547	2,795,307
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	14,560	29,763	35,537	3,476,119	3,548,699
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	144,006	-	4,087,084	1,223,449	5,382,536

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	66,352	1,633	126,080	3,980,503	4,141,392
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	66,132	467,824	124,429	3,538,270	4,184,403
Total	1,425,074	8,772,471	19,523,504	739,023,815	768,059,451

Nga auditimi, konstatohet se pagesat më të mëdha janë kryer nga disa subjekte në muajin Dhjetor 2019 në total 624 milionë lekë kryesisht nga subjekte të administruar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me rreth 523 milionë lekë arkëtime, DRT Tiranë dhe DRT Fier respektivisht me rreth 31 milion lekë arkëtime.

Muaji pagesës	ShumaPageses në lekë	DRT me arkëtimet me larta
Jan	10,002,923	DTM, DRT Shkoder
Feb	6,106,774	DTM
Mar	7,177,724	DTM
Apr	4,928,194	DTM, DRT Tirane
May	3,661,007	DRT Tiranë, DTM
Jun	5,019,119	DRT Lezhë, Tiranë, Shkodër
Jul	4,607,276	DRT Tiranë, Lezhë
Aug	8,484,383	DTM, DRT Tirane, Shkodër
Sep	12,099,184	DTM, DRT Shkodër, Tirane
Oct	21,551,368	DRT Tiranë, Kukës, DTM, DRT Shkodër
Nov	59,732,059	DTM, DRT Tiranë, Shkodër, Sarandë, Korçë
Dec	624,689,440	DTM, DRT Tiranë, Fier
Total	768,059,451	

Nga të dhënat e arkëtimeve sipas muajve shumat e arkëtuara nuk rezultojnë të jenë sistemuar sipas detyrimeve aktuale të lindura për subjektin që ka kryer pagesën. Përkundrazi këto pagesa konstatohen të jenë në vlera më të mëdha dhe më frekvente në muajt Tetor- Dhjetor. Nga auditimi konstatohet se e njëjta shtuatë paraqitet në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Disa nga subjektet që kanë kryer këto pagesa për një detyrim TVSH-je në fakt janë me gjendje kreditore.

Gjetja	Konstatohen arkëtime për TVSH të palidhura dhe të pa sistemuar me një detyrim tatimor, në total 768 milion lekë duke rritur kështu arkëtimet e raportuara ndërkohë dhe detyrimin kreditor të administratës tatimore ndaj këtyre tatimpaguesve.
Situata	Nga raporti i të ardhurave tatimore për periudhën Janar- Dhjetor 2019, një tjetër llogari në grupin 4665: “Depozitime të tjera (për tu sistemuar në të ardhmen)”, evidentohet dhe llogaria 4665504 “Depozitime të përkohshme për deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar” e cila më 31.12.2019 rezulton me një balancë kreditore prej 768,059 mijë lekë. Ndryshe nga natyra e llogarisë 4665503 “Depozitime të përkohshme për deklaratën e tatimit fitimit”, në këtë rast tepricat kreditore të akumuluar në këtë llogari vijnë si rezultat i pagesave të kryera nga subjektet ndërkohë që në sistemin C@TS nuk ekziston një detyrim. Këto shuma duhet të sistemohen në periudhat e ardhshme. Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohet se pagesat e kryera nga subjektet i referohen kryesisht periudhës tatimore viti 2019 në total 739 milion arkëtime por edhe periudhave të mëparshme tatimore nga viti 2002- 2018. Nga auditimi, konstatohet se pagesat më të mëdha janë kryer nga disa subjekte në muajin Dhjetor 2019 në total 624 milionë lekë, kryesisht nga subjekte të administruar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me rreth 523 milionë lekë arkëtime, DRT Tiranë dhe DRT Fier

	respektivisht me rreth 31 milion lekë arkëtime. Nga të dhënat e arkëtimeve sipas muajve, shumat e arkëtuara nuk rezultojnë të jenë sistemuar në muajt pasardhës sipas detyrimeve aktuale të lindura për subjektin që ka kryer pagesën. Këto pagesa konstatohen të jenë në vlera më të mëdha dhe më frekvente në muajt Tetor- Dhjetor. Nga auditimi konstatohet se e njëjta situatë paraqitet edhe në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjithashtu, konstatohet se disa nga subjektet që kanë kryer këto pagesa të pa lidhura me një detyrim TVSH-je të rezultojnë të jenë në listën e subjekteve me teprice kreditore.
Kriteri:	Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”; Ligj nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.37 datë 19.12.2019 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit 2019”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Rritje artificiale e të ardhurave dhe detyrimeve kreditore të administratës tatimore.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër nga grupi i auditimit është lënë Akt-konstatimi nr.15 datë 24.07.2020 për të cilin subjekti ka observuar me dokumentin nr.6272/39 prot datë 30.07.2020 si dhe onservacion nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit me dokumentin nr.6272/28prot datë 30.07.2020, për të cilët audituesi është shprehur në Projekt Raport.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

1.Zj.M. S në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit

B3.3 dhe B4.1 Vendimet teknike të lidhura me tatim fitimin, rregullshmëria e tyre dhe Vendimet teknike dhe ndryshimet ligjore të lidhura me tatimin mbi të ardhurat personale dhe rregullshmërinë e tyre

Vendimi teknik është një akt administrativ i hartuar dhe i publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, mbështetur në nenin 10 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me kërkesë të tatimpaguesit, ose, kur është e nevojshme me kërkesë të strukturave të administratës tatimore, nxjerr vendim që shpreh qëndrimin zyrtar të administratës tatimore, në zbatim të legjislacionit tatimor, për rrethana specifike të tatimpaguesit. Qëllimi i vendimit teknik, është të sqarojë zbatueshmërinë e një teksti ligjor apo të një akti nënligjor, në fushën e zbatimit të procedurave tatimore apo të administrimit të tatimeve, taksave e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore. **Vendimi teknik bëhet detyrues për tatimpaguesin**, në datën kur ai merr njoftim për të, në njërën nga format e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe zbatohet njëllëj nga strukturat e administratës tatimore qendrore, për raste të tjera, të ngjashme.

Në zbatim nenit 10 pika 3 të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka përgatitur dy komentare përmbledhës të vendimeve teknike, në lidhje me mënyrën e trajtimit tatimor të rasteve specifike, duke i grupuar ato sipas natyrës së tyre për periudhën objekt auditimi, vendimet teknike dhe shkresat sqaruese referuar Buletinit Nr.5 për Janar- Qershor 2019 dhe Buletinin Nr.6 për Korrik – Dhjetor 2019, të publikuara në muajin pasardhës në faqen zyrtare të DPT-së, përmbledhur si më poshtë vijon:

Buletini NR. 5: Vendime Teknike mbi Udhëzime Teknike. Ky Buletin ka nxjerre udhëzime teknike me qëllim sqarimin e ndarjes së përgjegjësisë tatimore midis ndërtuesit/investitorit dhe pronarit të tokës, lidhur me zbatueshmërinë për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës, lidhur me zbatueshmërinë në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës. Në zbatim të legjislacionit tatimor administrata tatimore qendrore ka trajtuar me:

a- Udhëzim Teknik 2.1: - Rasti 1: *“Sqarimin mbi zbatimin e TVSH-së në ndërtim, mbi ndarjen e përgjegjësisë tatimore midis ndërtuesit/investitorit dhe pronarit të tokës”*. -Rasti 2: *“Lidhur me zbatueshmërinë e VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për TVSH-në në RSH”, i ndryshuar, për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës.”*

b- Udhëzim teknik 2.2: Sqaruese për Drejtoritë Rajonale Tatimore për shitjen e inputeve dhe makinave bujqësore gjendje (stok) deri më 31.12.2018

c- Udhëzim teknik 2.3: Mbi procedurat e regjistrimit të fitimit të pronësisë, së pasurive të paluajtshme të konfiskuara.

d-Raste specifike të tatimpaguesve të trajtuara për probleme të hasura në praktikë. Rast 1:- *“Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në përgjigje të shkresës/kërkesës për interpretim kërkuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve është bërë trajtimi nga pikëpamja fiskale për mënyrën e faturimit të shërbimit që ofrohet nga ndërmjetësi.”*

BULETINI NR. 6: Vendime Teknike mbi Udhëzime Teknike. Ky Buletin ka nxjerre udhëzime teknike me qëllim sqarimin lidhur me procedurën që duhet të ndjekin Drejtoritë rajonale lidhur me aplikimin e nenit 38 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, dhe tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018, sqaruese lidhur me dokumentacionin që duhet të plotësohet nga Drejtoritë Rajonale Tatimore për përjashtimin nga pagimi i taksës së materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, trajtimi fiskal i faktoringut , trajtimi tatimor i shpenzimeve që lidhen me aktivet e marra me qira, trajtimi tatimor *“Për fondet e pensionit vullnetar”*. Në mënyrë te detajuar në Buletinin nr.6 administrata tatimore qendrore në zbatim të legjislacionit tatimor ka trajtuar si më poshtë:

a- Udhëzim teknik 2.1: *Sqaruese lidhur me procedurën që duhet të ndjekin Drejtoritë rajonale lidhur me aplikimin e nenit 38 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.199 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

b- Udhëzim teknik 2.2: Sqaruese lidhur me dokumentacionin që duhet të plotësohet nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, në mbështetje të Udhëzimit nr.26, datë 04.09.2008 *“Për taksat kombëtare”*, i ndryshuar.

c- Raste specifike të tatimpaguesve të trajtuara për probleme të hasura në praktikë

- Rast 1: *Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, furnizimet e qirasë financiare.*
- Rast 2 :Nga fusha e Tatimit mbi të Ardhurat :

Rasti 2.1- Trajtimin tatimor i shpenzimeve që lidhen me aktivet e marra me qira në kuptimin e nenit 22 të ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Rasti 2.2- Trajtimi tatimor “Për fondet e pensionit vullnetar”

Nga auditimi mbi zbatimin e legjislacionit tatimor dhe qëndrimit zyrtar të administratës tatimore mbi zbatueshmërinë e një teksti ligjor apo një akti nënligjor, lidhur me procedurat tatimore apo administrimi tatimeve, taksave e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për rrethana specifike të tatimpaguesit në Buletinin nr.6/2019 rezulton se:

A. Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, Botuar: Buletinin nr.6/2019 të DPT, shoqëria “C.F.F A” me NIPT LxxxxxA, me shkresën nr. 601 prot, datë 04.02.2019, protokolluar në DPT me nr. 2766 prot, datë 06.02.2019 ka bërë kërkesë për interpretim në lidhje me zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore për tatimin mbi vlerën e shtuar. Shoqëria është licensuar nga Banka e Shqipërisë me licencë nr. 34, datë 02.10.2015, si institucion financiar jo-bankë. Në përputhje me këtë licencë dhe me Ligjin nr. 9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” kjo shoqëri ofron dy produkte financiare përkatësisht qira financiare (Leasing) dhe Faktoring. Gjatë punës shoqëria ka hasur vështirësi në kuptimin dhe interpretimin të:- pikës b të nenit 53 të Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe pikës 4 të nenit 17 të UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” lidhur me furnizimin e **shërbimit të natyrës faktoring**, bazuar kjo në ligjin nr.9630, datë 30.10.2006 neni 30 “*Trajtimi fiskal i faktoringut*”. Shërbimi i faktoringut dhe zbatueshmërisë të ligjit nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Qëndrimi zyrtar i DPT mbi furnizimet e qirasë financiare. Sipas interpretimit të DPT, sqarohet se bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktohet se tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen: a) të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë; b) të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur janë të përjashtuara me ligj. Çdo institucion financiar bankar apo jo-bankar lidhur me mënyrën e zbatimit të TVSH-së për furnizimet që kryen në kuadër të aktivitetit të tij për të cilin është licencuar nga Banka e Shqipërisë, duhet të ketë parasysh dispozitat e ligjit nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lidhur me furnizimin e qirasë financiare cilësojmë se ajo është furnizim i tatueshëm për TVSH-në, kur objekti i qirasë financiare është një mall i cili nëse do të blihej ose do të vihej në dispozicion të qiramarrësit në kushte normale do të ishte i tatueshëm me TVSH, jo i përjashtuar. Për këtë, çdo pagesë e arkëtuar ose vlerë e faturuar nga qiradhënësi për qiramarrësin mbi baza mujore, përtej vlerës së pagesave periodike të qirasë në kuadër të kontratës së qirasë financiare, konsiderohet element i vlerës së tatueshme të pagesave për furnizimin e qirasë financiare dhe si element përbërës i vlerës së tatueshme të furnizimit të qirasë financiare **është e tatueshme me TVSH 20%, përveç interesit**, bazuar kjo në nenin 17 “*Qiraja financiare, rregulla për tu zbatuar*” pika 4, të Udhëzimit Nr. 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Lidhur me furnizimin e shërbimit të faktoringut **sqarohet se shërbimi i natyrës faktoring**, konsiderohet **si shërbim financiar**, bazuar kjo në ligjin nr. 9630, datë 30.10.2006 neni 30 “*Trajtimi fiskal i faktoringut*”. Shërbimi i faktoringut, përsa i përket zbatueshmërisë të ligjit nr.

92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar klasifikohet si shërbim financiar, që kanë të bëjnë me negocimin e kredive (shumave kreditore të llogarisë klientë). Operacionet e faktoringut në thelbin e tyre janë marrëdhënie, vetëm midis shoqërive tregtare. Palët pjesëmarrëse në transaksionet faktoring janë: faktori, furnizuesi, dhe debitori. Ky shërbim nuk ka të bëjë me shërbimin e mbledhjes së borxhit, për këtë, bazuar në nenin 53 shkronja ç të ligjit shërbimi faktoring është shërbim i përjashtuar nga TVSH. Për furnizimin e qirasë financiare **aplikohet TVSH në shkallën 20%**, për çdo pagesë e arkëtuar ose vlerë e faturuar nga qiradhënësi për qiramarrësin, **përveç interesit**, kurse për **furnizimin e faktoringut nuk llogaritet TVSH** dhe konsiderohet si furnizim shërbimi financiar i përjashtuar nga TVSH-ja.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:Nga auditimi rezulton se me shkresën nr. 601 prot, datë 04.02.2019, protokolluar në DPT me nr. 2766 prot, datë 06.02.2019 shoqëria “C. F. F” me NIPT LxxxxxA ka bërë kërkesë për interpretim në lidhje me zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Shoqëria “C. F. F” me NIPT LxxxxxA është licensuar nga Banka e Shqipërisë me licencë nr. 34, datë 02.10.2015, si institucion financiar jo-bankë. Në përputhje me këtë licencë dhe me Ligjin nr. 9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” kjo shoqëri **ofron dy produkte financiare** përkatësisht **qira financiare (Leasing) dhe Faktoring**. Gjatë punës shoqëria ka hasur vështirësi në kuptimin dhe interpretimin të:- pikës b të nenit 53 të Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 17 të UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Operacionet e faktoring janë operacione që kanë të bëjnë me negocimin e kredisë sipas dispozitave në ligjin nr.9630, datë 30.10.2016 “Për faktoringun”. Shërbimi i natyrës Faktoring, **konsiderohet shërbim financiar**, sipas nenit 30 të këtij ligji sipas të cilit citojmë: “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar, shërbimi faktoring trajtohet si shërbim financiar.*”

Sipas nenit 53 të ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” janë: “...b) *dhënia dhe negocimi i kredive, si edhe menaxhimi i kredive nga ana e kredidhënësit; ...ç) transaksionet, përfshirë negocimin lidhur me veprimet e këmbimit, llogaritë e depozitave, llogaritë rrjedhëse, furnizimin e likuiditeteve nëpërmjet pagesave, transfertave, marrje-dhëniet e borxhit, çeqet dhe instrumentet e tjera të negociueshme, përveç shërbimit të mbledhjes së borxhit;*

Në nenin 41 pika 1 të UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” përcaktohet se bazuar në nenin 53 të ligjit 92/2014, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit, **përjashtohen nga TVSH-ja** transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita, pavarësisht nëse këto transaksione kryhen nga një institucion financiar, ose jo. **Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit**, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, **nuk përjashtohet nga TVSH-ja**.

Sa më sipër, Udhëzimi Ministrit të Fimancave dalë në zbatim të ligjit 92/2014 përcakton se përjashtimi nga TVSH-ja zbatohet kur transaksioni i kryer është njëri nga shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë. Aplikimi i përjashtimit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me natyrën e shërbimit dhe jo me entitetin ose subjektin që ofron shërbimin dhe as personin që merr shërbimin. Identiteti i palëve është i parëndësishëm. Mënyra e ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike, manuale apo automatike, gjithashtu, është e parëndësishme në aplikimin ose jo të përjashtimit. Duke ju rikthyer trajtimit të kërkesës se insitucionit financiar jo bankar, rezulton se kjo shoqëri **aplikon dy lloj tarifash: Një tarife mujore** të përfshirë në çdo këst që nënkupton një **normë interesipër një periudhë kohore sipas marrëveshjes së palëve**, si dhe **një tarifë fikse**

(në përqindje të vlerës së financuar), pra si shume e përcaktuar për shërbimin e ofruar, e cila paguhet e plotë menjëherë pas lidhjes së kontratës së financimit vetëm në rast se klienti financohet. Në këndvështrim trajtimit fiskal të faktoringut si shërbim financiar i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, referuar nenin 53 shkronjat “b”, “ç” të ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe neni 41 pika 1 të UMF nr. 6 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në zbatim të tij, përcaktohet se përjashtohen nga TVSH-ja transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita. Çdo transaksion tjetërqë nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja.

Në konkluzion: Në arsyetimin e grupit të auditimit rezulton se përveç sa ka interpretuar DPT, me kthimin e përgjigjes për subjektin jo bankë, me shkresën nr. 2766/1 prot, datë 18.02.2019 ku çdo pagesë e arkëtuar ose vlerë e faturuar nga qiradhënësi për qiramarrësin mbi baza mujore, përtej vlerës së pagesave periodike të qirasë në kuadër të kontratës së qirasë financiare, konsiderohetelement i vlerës së tatueshme të pagesave për furnizimin e qirasë financiare dhe si element përbërës i vlerës së tatueshme të furnizimit të qirasë financiare është e tatueshme me TVSH 20%, **përveç interesit.**”, në trajtimin fiskal për shërbimin faktoring duhet arsyetohet nësellogaritët tatim mbi vlerën e shtuar për tarifat fiksesipas kontratës së lidhur mes palëve, përveç interesit. Kjo lloj tarife, pagese, komisioni nuk është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas nenit 53 të Ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe neni 41 pika 1 të UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, pasi ky shërbim nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite në këtë ligj.

Gjetja	Trajtimin fiskal për shërbimin faktoring
Situata	<p>Shoqëria “C.F.F” është licensuar si institucion financiar jo-bankë. Kjo shoqëri ofron dy produkte financiareqira financiare (Leasing) dhe Faktoring. Lidhur me furnizimin e shërbimit të faktoringut sqarohet se shërbimi i natyrës faktoring, konsiderohet si shërbim financiar, bazuar kjo në ligjin nr. 9630, datë 30.10.2006 neni 30 “<i>Trajtimi fiskal i faktoringut</i>”. Shërbimi i faktoringut, përse i përket zbatueshmërisë të ligjit nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar klasifikohet si <u>shërbim financiar</u>, që kanë të bëjnë me negocimin e kredive (shumave kreditore të llogarisë klientë).Ky shërbim nuk ka të bëjë me shërbimin e mbledhjes së borxhit, për këtë, bazuar në nenin 53 shkronja ç të ligjit shërbimi faktoring është shërbim i përjashtuar nga TVSH.</p> <p>Qëndrimi zyrtar i DPT unifikon sepër furnizimin e faktoringutnuk llogaritët TVSH pasi konsiderohet si furnizim shërbimi financiar i përjashtuar nga TVSH-ja, bie ndesh me kriteret e nenit 41 pika 1 të UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” ku përcaktohet sebazuar në nenin 53 të ligjit 92/2014, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit, përjashtohen nga TVSH-jatransaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita, pavarësisht nëse këto transaksione kryhen nga një institucion financiar, ose jo. Ky transaksion nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion</p>

	financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, dhe si i tillë nuk përjashtohet nga TVSH-ja.
Kriteri	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008, ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, neni 10, Ligji nr.9630, datë 30.10.2016 “Për faktoringun” neni 30; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”; i ndryshuar neni 53; UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” neni 41 pika 1;
Ndikimi/Efekti	Deklarime të pasakta të TVSH në mospërputhje me nenin 53 të Ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.
Rëndësia	I Lartë

Nga fusha e Tatimit mbi të Ardhurat, Botuar: Buletinin nr.6/2019 të DPT, ku është tarjtuar qëndrimi zyrtar mbi trajtimin tatimor “Për fondet e pensionit vullnetar” (Rasti 2.2)

Shoqata S Tiranë ka dërguar për trajtim fiskal në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresën nr. 1 prot, datë 30.07.2019, protokolluar në MFE me nr.14494 prot, datë 31.07.2019. Ministria e Financave dhe Ekonomisë kalon për kometencë shkresën e sipërcituar në DPT me shkresën nr.14494/1 prot, datë 03.09.2019, protokolluar në DPT me nr.16333 prot, datë 04.09.2019

Me shkresën e sipërcituar Shoqata kërkon sqarime teknike për zbatimin e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Klientët e kësaj shoqate, anëtarë të Fondeve të Investimeve kërkojnë të përfitojnë lehtësinë fiskale që mundëson ligji 8438/1998 sipas përcaktimeve në nenin 8/1, pika 12 “Të ardhura të përjashtuara”, duke pretenduar se referuar dispozitave ligjore duhet të përfitojnë përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat nga interesat **që përfitohen nga pagesa si kontribut në Fondin e Pensioneve (deri në masën e lejuar dhe përcaktuar sipas nenit 88 të Ligjit nr. 10197/2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”).**

Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 8011/1 prot, datë 16.06.2015, sipas **Shoqatës** shpreh se agjenti i mbajtjes së tatimit në burim sipas nenit 33 të ligjit 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, aplikon përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat mbi interesat e depozitave dhe dividendeve, përkundrejt paraqitjes nga ana e individëve pjesëmarrës në fondin e pensionit, të kontratës së tij me shoqërinë administruese. Sipas kësaj dispozite shoqëritë administruese të fondeve të investimeve mbajnë tatim në burim mbi interesat në përputhje me nenin 33 të ligjit 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Pra ndryshe nga skema e pensioneve shtetërore, pagesat që shoqëritë administruese i bëjnë anëtarëve të fondeve të pensioneve vullnetar **do të taten dy herë**. Kjo e bën pa interes kontributin në fondin e pensionit vullnetar. Shoqëritë administruese të fondeve kanë detyrimin dhe përgjegjësinë që të mos aplikojnë tatim në burim për të ardhurat që vijnë si rezultat i zbatimit të kontratave të anëtarëve në Fondet e Investimeve, të cilat nën cilësinë e të ardhurës personale, nëse destinohen me kërkesën e titullarit të të ardhurës për kontribute në fond pensioni vullnetar, përjashtohen nga tatimi në burim deri në limitin vjetor të përcaktuar me ligj.

Kjo shoqatë kërkon nga MFE konfirmimin dhe dhënien e procedurave për mundësimin e përjashtimit nga tatimi i kontributeve për fondet e pensionit vullnetar deri në limitin e përcaktuar nga ligji edhe për rastet kur pagesat e kontributeve bëhen nga të ardhurat nga interesat apo dividendët.

Qëndrimi zyrtar i DPT mbi fondeve të pensionit vullnetar: Veprimtaria e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar rregullohet nga ligji i posaçëm Nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për

fondet e pensionit vullnetar”, i cili krahas detyrimeve dhe përcaktimeve që duhet të përmbushin shoqëritë e administrimit të fondeve të investimit, në kreun XIII- *Tatimi*, ka parashikuar edhe trajtimin fiskal të këtyre fondeve ku në nenin 88 përcaktohet se kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi zbritet nga të ardhurat personale për efekt tatimi, si dhe **kthimi i investimit**, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensionit **nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin dhe as për shoqërinë**.

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8/1” “*Të ardhura të përjashtuara*” pika 12 dhe 13 përcakton se: “*Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar*”. Gjithashtu, Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, paragrafi 2.4, pika 11 dhe 12, përcakton se: “*Pagesa e bërë nga vetë anëtari në fondin e pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin “Për fondet e pensioneve vullnetare”, e parashikuar në kontratën që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit, është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kjo pagesë i zbritet së ardhurës personale të tatueshme përpara përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale nga agjenti i mbajtjes së tatimit. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar*”.

Në rastet kur punëdhënësi ka krijuar një fond pensioni për punëmarrësin, kontributet e paguara prej punëdhënësit në fondin e pensionit për llogari të punëmarrësit nuk janë pjesë e së ardhurës së tatueshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar. Në rastet kur një kontribues tjetër i ndryshëm nga vetë anëtari ose punëdhënësi derdh një kontribut në emër të anëtarit të fondit, ky kontribut është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale nga paga. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

Duke iu referuar dispozitave të mësipërme, të ardhurat që përjashtohen nga tatimi janë të ardhurat që përfitohen nga paga si në rastin kur kontributi derdhet nga vetë anëtari i fondit të pensionit ashtu dhe në rastin kur kontributi derdhet nga një kontribues tjetër në emër të anëtarit të fondit. Gjithashtu punëdhënësi është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale kur kontribuon në emër të punëmarrësit. **Pra, vetëm në rastet e sipër përmendura, kontributet e derdhura në Fondin e Pensionit Vullnetar janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.**

“Për sa më sipër dhe në lidhje me pyetjen, nëse individët anëtarë në Fondet e Investimeve të cilët janë ose dëshirojnë të bëhen anëtarë në Fondet e Pensioneve Vullnetare përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat nga interesat që do të paguhen si kontribut për fondin e pensionit, ju bëjmë me dije se interesat nuk janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale, por i nënshtrohen tatimit sipas legjislacionit në fuqi”.

Qëndrimi Grupit të Auditimit : Nga auditimi rezulton se me shkresën nr. 14494/1 prot, datë 03.09.2019 protokolluar në DPT me nr. 16333 prot, datë 04.09.2019 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar për trajtim fiskal shkresën me nr. 1 prot, datë 30.07.2019, protokolluar në MFE me nr. 14494 prot, datë 31.07.2019. Me shkresën e sipërcituar Shoqata S Tiranë, kërkon sqarime teknike për zbatimin e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Klientët e kësaj shoqate, anëtarë të Fondeve të Investimeve kërkojnë të përfitojnë lehtësinë fiskale që mundëson ligji 8438/1998 sipas përcaktimeve në nenin 8/1, pika 12 “*Të ardhura të përjashtuara*”, duke pretenduar se referuar dispozitave ligjore duhet të përfitojnë përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat nga interesat që përfitohen nga pagesa si

kontribut në Fondin e Pensioneve (deri në masën e lejuar dhe përcaktuar sipas nenit 88 të Ligjit nr. 10197/2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”).

Shkresa e Ministrisë së Financave nr.8011/1 prot, datë 16.06.2015, shprehet se agjenti i mbajtjes së tatimit në burim sipas nenit 33 të ligjit 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, aplikon përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat mbi interesat e depozitave dhe dividendeve, përkundrejt paraqitjes nga ana e individëve pjesëmarrës në fondin e pensionit, të kontratës së tij me shoqërinë administruese. Kjo shoqatë kërkon nga MFE konfirmimin dhe dhënien e procedurave për mundësimin e përjashtimit nga tatimi i kontributeve për fondet e pensionit vullnetar deri në limitin e përcaktuar nga ligji **edhe për rastet kur pagesat e kontributeve bëhen nga të ardhurat nga interesat apo dividendët.**

Sa më sipër në shkresën e Shoqatës, **konstatohet një paqartësi në zbatimin e dispozitave ligjore në Ligjin 8438** datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, në ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e Pensionit Vullnetar” dhe shkresës së MFE me nr. 8011/1 prot, datë 17.06.2015 dalë për zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore të ligjeve të sipërcituara, lidhur me përjashtimin e tatimit në burim të interesave të depozitave dhe dividendëve, përkundrejt paraqitjes nga ana e individëve pjesëmarrës në fondin e pensionit, të kontratës së tij me shoqërinë administruese.

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar përcakton se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emetuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji (*neni 8, pika 1, gërma “c”*) ose të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jo rezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë (*neni 8, pika 1, gërma “g”*). Pra në këtë këndvështrim në kuptim të këtij ligji interesat e përfituara janë të ardhura të tatueshme.

Ky ligj në nenin 8/1” nga të ardhurat e tatueshme ka përcaktuar kategoritë e të ardhura të përjashtuara, të cilat përsa i përket fondit të pensionit vullnetar në përcakton se kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar (neni 8/1, pika 12) dhe kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensioneve, gjatë administrimit nga shoqëria administruese (neni 8/1, pika 13)

Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nxjerrë Ministri i Financave, në zbatim të këtij ligji në pikën 2.3.4 përcakton si të ardhura të tatueshme të ardhurat nga interesat bankare, apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose nga letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emetuara para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Të ardhura nga interesat bankare konsiderohen të gjitha interesat nga llogaritë personale apo të përbashkëta të individëve, në banka ose në institucione të tjera financiare, si dhe të gjitha interesat nga depozitat personale ose të përbashkëta me afat, në formën e llogarisë me afat, certifikatës së depozitës me afat, kontratës për depozitë me afat, si dhe çdo e ardhur tjetër në formë interesi. Tatimit mbi të ardhurat i nënshtrohen të gjitha interesat e lindura dhe të paguara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, për llogaritë dhe depozitat në lekë dhe në valute. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe depozitat me afat maturimi më të gjatë se një vit. Tatimi mbi të ardhurat nga interesat në valutë konvertohet në lekë, me kursin mesatar të këmbimit të aplikuar nga vetë banka për blerjen e valutave respektive, në ditën e kryerjes së veprimit. **Moment i pagimit të interesave**

konsiderohet dita e pagimit të interesave në “cash” ose dita e maturimit apo rikapitalizimit të tyre. Bankat apo institucionet e tjera financiare do të llogarisin, deklarojnë dhe paguajnë në organin tatimor përkatës tatimin mbi interesat jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës, maturimit apo rikapitalizimit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për tatimin mbi interesat për llogaritë e mbyllura.

Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin Mbi Te Ardhurat” i ndryshuar, në zbatim të nenit 8/1 të këtij ligji, në paragrafin 2.4.11 përcakton se përjashtohen nga detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale *pagesat e kontributeve që bëhen nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe pagesat e kontributeve të bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar. Pagesa e bërë nga vetë anëtari në fondin e pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin “Për fondet e pensioneve vullnetare”, e parashikuar në kontratën që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit, është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kjo pagesë i zbritet së ardhurës personale të tatueshme përpara përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale nga agjenti i mbajtjes së tatimit.*

Kur punëdhënësi ka krijuar një fond pensioni për punëmarrësin, kontributet e paguara prej punëdhënësit në fondin e pensionit për llogari të punëmarrësit nuk janë pjesë e së ardhurës së tatueshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale. Në rastet kur një kontribues tjetër i ndryshëm nga vetë anëtari ose punëdhënësi derdh një kontribut në emër të anëtarit të fondit, ky kontribut është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale nga paga.

Sa më sipër në të dy rastet nga agjenti i mbajtjes së tatimit të të ardhurës personale të tatueshme **nuk është llogaritur dhe mbajtur tatim në burimpërpara përlllogaritjes** së tatimit mbi të ardhurat personale, për kontributin e derdhur nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar.

Ligji i posaçëm Nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, parashikon lehtësitë tatimore të kontributeve të anëtarëve të fondit të pensionitku në nenin 88 përcakton se kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi zbritet nga të ardhurat personale për efekt tatimi, si dhe kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin dhe as për shoqërinë. Në nenin 89 të këtij ligji parashikohet trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi. Sipas kësaj dispozite kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional vlerësohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250 000 lekë dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

Për sa më sipër **KLSH-it ka të njëjtën qasje me** interpretimin e DPT referuar neni 90 të këtij ligji, sipas të cilit individët anëtarë në Fondet e Investimeve të cilët janë ose dëshirojnë të bëhen anëtarë në Fondet e Pensioneve Vullnetare në trajtimin fiskal të përfitimeve të marra nga anëtari (interesi), tatohen me tatimin mbi të ardhurat personale, për çdo pagesë e marrë nga anëtari i fondit të pensionit, sipas përcaktimeve të neneve 16 e 18 të këtij ligji. Por referuar Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin Mbi Të Ardhurat” i ndryshuar, në pikën 2.3.4, KLSH **konstaton problematike e pa trajtuar** në këtë Vendim Teknik **lidhur me trajtimin fiskal të përfitimeve të marra nga anëtari, për interesat e lindura dhe të paguara** pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998. Në këndvështrim të kësaj dispozite të ardhura nga interesat bankare konsiderohen të gjitha interesat nga llogaritë personale apo të përbashkëta të individëve, në banka ose në institucione të tjera financiare, si dhe çdo e ardhur tjetër në formë interesi.

Moment i pagimit të interesave konsiderohet dita e pagimit të interesave në “cash” ose dita e maturimit apo rikapitalizimit të tyre, njësoj si veprohet nga Bankat apo institucionet e tjera financiare të cilat deklarojnë dhe paguajnë në organin tatimor tatimin mbi interesat jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës, maturimit apo rikapitalizimit.

Gjithashtu, konstatohet se shkresa e Ministrisë së Financave nr. 8011/1 prot, datë 16.06.2015, në lidhje trajtimin për mbajtjen ose jo të tatimit në burim nga agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, **nuk është në përputhje me kërkesat e të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Tatimin mbi të ardhurat” dhe Ligjit Nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, dhe si e tillë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të kërkojë revokimin e saj si dhe njoftimin e palëve të interesuara. Konkluzion:** Drejtoria Juridike, mbështetur në nenin 10 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, me kërkesë të tatimpaguesit në lidhje me trajtimin tatimor për “Furnizimet e qirasë financiare dhe shërbimit faktoring” dhe trajtimit “Për fondet e pensionit vullnetar” publikuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nuk ka shprehur plotësisht dhe në mënyrë shteruese qëndrimin zyrtar të administratës tatimore, në zbatim të legjislacionit tatimor, për rrethana specifike të tatimpaguesit.

Gjetja	Për fondet e pensionit vullnetar
Situata	Shoqata S Tiranë me shkresën nr. 1 prot, datë 30.07.2019 kërkon nga MFE dhe kjo e fundit nga DPT konfirmimin dhe dhënien e procedurave për mundësimin e përjashtimit nga tatimi i kontributeve për fondet e pensionit vullnetar deri në limitin e përcaktuar nga ligji edhe për rastet kur pagesat e <u>kontributeve bëhen nga të ardhurat nga interesat apo dividendët</u> . Autoriteti tatimor konform ligjit në qëndrimin e saj zyrtar se të ardhurat nga interesat nuk janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale, por i nënshtrohen tatimit sipas legjislacionit në fuqi . Por referuar Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin Mbi Te Ardhurat” i ndryshuar, në pikën 2.3.4, grupi auditimit konstaton problematikë të pa trajtuar në këtë Vendim Teknik lidhur me trajtimit fiskal të përfitimeve të marra nga anëtari, për interesat e lindura dhe te paguara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998.
Kriteri	Ligji i posaçëm Nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, neni 88; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8/1” “Të ardhura të përjashtuara” pika 12 dhe 13 Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, paragrafi 2.4, pika 11 dhe 12
Ndikimi/Efekti	Ekziston rreziku i mosllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat nga interesat në ditën e maturimit ose rikapitalizimit.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.13, datë 24.07.2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime znj. I.K në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë Ligjore, me observacionin me nr. prot. s'ka, datë s'ka, duke arsyetuar si më poshtë:

Audituesit Shtetërorë të Kontrollit të Lartë të Shtetit pretendojnë ndër të tjera, veprime apo mosveprime në përgjegjësi time personale, konkretisht lidhur me:

Nuk është shprehur në mënyrë të plotë dhe shteruese qëndrimi zyrtar i administratës tatimore lidhur me trajtimin e “Furnizimit të qirasë financiare” dhe trajtimi “Për fondet e pensionit vullnetar”. Qartësisht, Rregullorja e Brendshme e miratuar ka të evidentuara përgjegjësitë e çdo hallke funksionale të angazhuar në trajtimin e rasteve konkrete ligjore apo teknike, gjithsesi audituesit e KLSH-së në kundërshtim me kuadrin rregullues në fuqi, kanë evidentuar mangësi duke më vlerësuar përgjegjëse vetëm mua edhe pse qartësisht përgjegjësia për pretendimet e ngritura nuk mund të jetë personalisht e imja. Në të vetmin hap procedural që jam investuar në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, nuk kam bërë gjë tjetër veçse kam miratuar/konfirmuar nëpërmjet nënshkrimit qëndrimin që specialistët e fushës nën varësinë time kanë hartuar në trajtim të kërkesës së tatimpaguesve të interesuar, si dhe parimisht janë vlerësuar si përgjigje të drejta dhe korrekte por në dy raste “të paplota” nga ana e audituesve të KLSH-së.

2. Lidhur me trajtimin “për fondet e pensionit vullnetar” dhe pretendimin se ka “problematikë të pa trajtuar” sqaroj se, DPT nuk mund të kërkojë nga MFE revokimin e shkresës 8011/1 prot., datë 16.06.2015, por në cilësinë e strukturës kompetente që ka mbajtur një qëndrim zyrtar për rastin merr masat për zbatimin sa më korrekt të qëndrimit të dhënë.

Në konkluzion, theksoj se, në trajtimin e rasti nga ana e audituesve të KLSH-së jam ngarkuar me përgjegjësi që nuk më takojnë pasi, nuk kam kryer asnjë veprim apo mosveprim në kundërshtim me ligjin dhe nuk mund të mbajë përgjegjësi individuale për trajtimin zyrtar të rasteve konkrete nga ana e administratës tatimore.

Qëndrimi i Audituesit: Rregullore e Administratës Tatimore Qëndrore sipas nenit 63.6 në përgjegjësitë dhe detyrat funksionale përcakton se Drejtori Drejtorisë Ligjore dhe Teknike është përgjegjës për përgatitjen në kohë të qëndrimeve teknike ligjore të Administratës Tatimore lidhur me kërkesat e tatimpaguesve për situata specifike që nuk qartësohen plotësisht nga Legjislacioni Tatimor në fuqi. Pra kompetenca nuk është vetëm miratim/konfirmim por dhe mbajtje përgjegjësie për atë që konfirmon sit ë rregullt dhe në përputhje të plotë me ligjin, arsye për të cilën pretendimi juaj nuk qëndron **dhe si i tillë nuk pranohet.**

Pretendimi juaj se Lidhur me trajtimin “për fondet e pensionit vullnetar” dhe shkresës së MFE shkresës 8011/1 prot., datë 16.06.2015 të MFE qëndron, Publikimi i këtij vendimi automatikisht bën që shkresa nga pikëpamja juridikë konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm dhe si i tillë nuk ka pasoja juridike. Pretendimi juaj për revokim shkrese qëndron dhe **observacioni për këtë argument pranohet si i bazuar në ligj.**

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

1. Znj. D.I në cilësinë e Drejtor Përgjithshëm i Tatimeve;
2. Z. K.S në cilësinë e Zv/Drejtor Përgjithshëm i Tatimeve;
3. Z. X.Ç në cilësinë e ish- Zv/Drejtor Përgjithshëm i Tatimeve;
4. Z.E.D në cilësinë e ish- Drejtor Përgjithshëm i Tatimeve për periudhën 04.04.2019-18.07.2019;
5. Znj. I.K në cilësinë Drejtor i Drejtorisë Juridike

Në përgjigje të Projekt-Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 6272/55 prot, datë 23.09.2020 “Përcillet kopje e Projekt Raportit të auditimit dhe komentet” nga DP znj.**DI**, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve është gjetur përgjegjëse për qëndrimin vullnetar lidhur me fondin e pensioneve. Me shkresën nr.16333/1 Prot, datë 02.10.2019 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i është përgjigjur zyrtarisht Shoqatës S, lidhur me trajtimin fiskal të fondeve të pensionit vullnetar. Ky qëndrim ndonëse nuk është i njëjtë me qëndrimin e MFE ka mbajtur për të njëjtën problematikë, është një qëndrim korrekt dhe ligjor dhe i vlerësuar i tillë edhe nga audituesit e

KLSH-së. Fakti që ky qëndrim nuk është i njëjtë me qëndrimin e MFE nuk është përgjegjësi i administratës tatimore. Referuar edhe qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese, interpretimi i ligjit është kompetencë e instancave të ngarkuara për zbatimin e tij dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Lidhur me qëndrimin e MFE, theksojmë së, nuk është në tagrin e strukturës së vartësisë të kërkojë rishikimin e qëndrimit nga ana e strukturës eprorë. Gjithsesi nga ana e audituesve është pranuar observimi i Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, lidhur me revokimin e qëndrimeve të mëparshme që bien ndesh me këtë qëndrim.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Në këndvështrim trajtimi fiskal shkresën nr.16333/1 Prot, datë 02.10.2019 Drejtoriae Përgjithshme e Tatimeve ka dhënë përgjigje zyrtare lidhur me trajtimin fiskal të fondeve të pensionit vullnetar sipas kërkesës së Shoqatës e cila me të drejtë ka bërë një interpretim të korrekt të trajtimit të të tasksimit të interesave për fondet e pensionit vullnetar. Arsyeja e pranimit të observimit për revokimin e shkresës së MFE nuk është vetëm se kjo shkresë është lëshuar nga strukturë më e lartë në hierarki, por fakti se interpretimi bie ndesh me ligjin fiskal si procedural dhe material dhe në zbatim të Kodit të Procedurave Adminsitrativ konsiderohet akt absolutisht i pavlefshëm pasi nuk është nxjerë nga struktura kompetente e përcaktuar me ligj dhe për pasojë nga efekti juridik është nul. Kjo parregullsi është rregulluar më të drejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në unifikimin e zbatimit korrekt të ligjit sipas shkresës së sipercituar nr. 16333/1 Prot, datë 02.10.2019 me të cilën DPT dhënë përgjigje zyrtare lidhur me trajtimin fiskal të fondeve të pensionit vullnetar. Në pjesën që observuar, nuk ka pretendim për gjithë problematikën e konstatuar nga grupi i auditimit, arsye për të cilën nuk ka shkak për pranim ose jo të observacionit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt-Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.6272/53 prot, datë 23.09.2020 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga znj.I.K, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë

Qëndrimi teknik për “furnizimin e qirasë financiare” vjen ne përgjigje të kërkesës së tatimpaguesit “C.F.F.” me NIPT LXXXXXA, protokolluar në DPT me nr. 2766 prot, datë 06.02.2019.

Lidhur me trajtimin e qirasëfinanciare, nga pikëpamja fiskale, furnizimi i qirasë financiare është furnizim i tatueshëm për TVSH-në ku objekti i qirasështëmall, i cili do të blihej ose do të vihej ne dispozicion tëqiramarrësit në kushte normale do të ishte i tatueshëm jo i përjashtuar. NëUdhëzimin nr. 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar, neni 17 “Qiraja financiare, rregulla për tu zbatuar” pika 4 është shprehur qartë se

*“Çdo pagesë e arkëtuar ose vlerë e faturuar nga qiradhënësi për qiramarrësin mbi baza mujore, përtej vlerës së pagesave periodike të qirasë në kuadër të kontratës së qirasë financiare, konsiderohet element i vlerës së tatueshme të pagesave për furnizimin e qirasë financiare dhe si element përbërës i vlerës së tatueshme të furnizimit të qirasë financiare është e tatueshme me TVSH 20%, përveç interesit”. Nga ana juaj pretendohet se “nga auditimi rezulton se përveç sa ka interpretuar DPT, me kthimin e përgjigjes me shkresën Nr. 5766/1 prot, datë 18.02.2019 arsyetojmë se për faktoringun llogaritet tatim mbi vlerën e shtuar për tarifat fikse (përveç interesit) sipas kontratës së lidhur midis palëve. Kjo lloj tarife, pagese komisioni nuk është e përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas nenit 53 të ligjit 92/2014 Për Tatimin mbi Vleren e Shtuar. Shërbimi i faktoringut nuk ka qenë objekt kërkimi, por objekt kërkimi janë furnizimet e qirasë financiare. Kjo e fundit është shprehur qartë,bazuar në **nenin 17** “Qiraja financiare, rregulla për tu zbatuar”, pika 4 e udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar. Për tatimin mbi vlerën e shtuar, shërbimi faktoring trajtohet si shërbim financiar, pra është furnizim shërbimi i përjashtuar nga TVSH-ja.Veprimtaria faktoring, sipas*

përcaktimit të nenit 2 të ligjit Nr. 9630, datë 30.10.2016 “Për Faktoringun” e kryer nga subjektet e parashikuara në nenin 10, përveç sa parashikohet në këtë ligj, mbikëqyret dhe rregullohet nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit për “Për bankat në RSH” dhe aktet nënligjore, të nxjerra prej saj për këtë qëllim. Marrë në konsideratë sa u sqarua, gjykoj se, përgjigja e hartuar në vijim të kërkesës së tatimpaguesit është e plotë dhe shteruese.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Në këndvështrim trajtimit fiskal të faktoringut si shërbim financiar i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, referuar nenin 53 shkronjat “b”, “ç” të ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe neni 41 pika 1 të UMF nr. 6 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në zbatim të tij, përcaktohet se përjashtohen nga TVSH-ja transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita. Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja. Sipas kërkesës rezulton se shoqëria aplikon dy lloj tarifash: Një tarife mujore të përfshirë në çdo kësht që nënkupton një normë interesi për një periudhë kohore sipas marrëveshjes së palëve, si dhe një tarifë fikse (në përqindje të vlerës së financuar) pra si e shume e përcaktuar për shërbimin e ofruar, e cila paguhet e plotë menjëherë pas lidhjes së kontratës së financimit vetëm në rast se klienti financohet. Referuar nenin 53 shkronjat “b”, “ç” të ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe neni 41 pika 1 të UMF nr. 6 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në zbatim të tij, në këndvështrim trajtimit fiskal të faktoringut si shërbim financiar i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, përcaktohet se përjashtohen nga TVSH-ja transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita. Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja. Këtu qëndron dhe interpretimi jo i plotë dhe i qartë në lidhje me mos qartësimin në interpretim për zbatim unik të ligjit përse i përket mostrajtit nëse tarifa fikse për shërbimin financiar të ofruar nga kompania është i përjashtuar ose jo nga TVSH-ja. Përfundimisht nga auditimi rezulton se përveç sa ka interpretuar DPT, me kthimin e përgjigjes me shkresën nr.2766/1 prot, datë 18.02.2019 arsyetojmë se për shërbimin faktoring llogaritet tatim mbi vlerën e shtuar për tarifat fikse (përveç interesit) sipas kontratës së lidhur mes palëve. Kjo lloj tarife, pagese, komisioni nuk është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas nenit 53 të Ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

B4. Realizimi nga tatimi i të ardhurave personale për vitin 2019, analiza sipas llojit dhe kontribuesve. Testimi i zonave me risk lidhur me mbledhjen e të ardhurave nga ky lloj tatimi

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Në Ligjin nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Kreu II, neni 7 “Shtrirja e detyrimit”, pika 1 përcaktohet detyrimi cituar “Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu”, pika 2. “Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu, të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë”. Neni 8 “Të ardhurat e tatueshme”, germa a-h përcakton llojet e të ardhurave të tatueshme në kuptimin e këtij Ligji.

Bazuar në sa më sipër, nga auditimi, konstatohet se në planin e miratuar për vitin 2019 përcjellë nga MFE në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr.prot.1577 datë 30.01.2019, “Plani i të ardhurave për administratën tatimore për vitin 2019” protokolluar në DPT me

nr.prot.2359 datë 31.01.2019, zëri “tatimi mbi të ardhurat personale” ishte parashikuar në shumën **41.9 miliard lekë ose 15% më shumë se fakti i vitit 2018**. Nga evidencat e vëna në dispozicion nga Drejtori e Analizës dhe Kontabilitetit, në fund të periudhës ky zë rezulton me realizim **46.22 miliard lekë ose 10.3% më shumë se plani dhe 26% më shumë se viti 2018**.

	Lloji i te ardhurave	Fakt 2017	Fakt 2018	PLANI 2019	Rritja 2019 vs. 2018	FAKT 2019	Fakt 2019 vs. Plani 2019
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	145,760,105	157,798,662	171,300,000	9%	165,294,011	-4%
3	Të Ardhura Personale	32,144,054	36,575,099	41,900,000	15%	46,226,037	10%
	Pesha specifike	22%	23%	24%		28%	
	Rritja vjetore		14%			26%	

Niveli i realizimit të planit në zërin “Të ardhurat personale” mund të analizohet vetëm në nivel sintetik pasi plani i miratuar nga MFE, nuk detajohet sipas llojit të të ardhurave personale që raportohen në këtë zë, pavarësisht faktorëve që merren në konsideratë sipas specifikave të çdo lloj tatimi dhe ndryshimeve ligjore përkatëse të parashikuara që do të japin efekt gjatë vitit raportues (2019). Në mënyrë të hollësishme sipas llojit/burimit “të ardhurat personale” e raportuara për vitin 2019 dhe krahasuar me realizimin e një viti më parë paraqiten në tabelën në vijim:

Në mijë lekë

Str uk.	Lloji i të Ardhurave	FAKTET		Diferenca 2019/ 2018	
		2018	2019	+ ose -	Përqindj e
A.	TATIMI mbi të ARDHURAT PERSONALE	36,575,099	46,226,037	9,650,938	26.4%
	<i>Nga i cili:</i>				
1	Tatimi mbi page nga listepagesa	20,955,857	22,279,842	1,323,985	6.3%
1,1	Nga të punësuarit e Sektorit Publik	7,569,232	8,314,397	745,164	9.8%
1,2	Nga të punësuarit e Sektorit Privat	13,386,625	13,965,445	578,820	4.3%
2	Tatim mbi të Ardhurat nga Interesat	2,090,648	2,258,021	167,373	8.0%
3	Tatim mbi të Ardhurat nga Qeratë	3,876,027	4,048,843	172,816	4.5%
4	Tatim mbi Fituesit e Lodrave të Fatit	89,498	68,084	(21,414)	-23.9%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro 2-8 mln leke	5,797	2,450	(3,347)	-57.7%
6	Të tjera Tatime mbi të Ardhurat në Burim	5,199,261	2,931,828	(2,267,433)	-43.6%
7	Tatimi mbi të ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet	3,689,564	11,061,159	7,371,595	199.8%
8	Tatim mbi të Drejten e Autorit dhe Pronesise Intelektuale	271,595	345,697	74,102	27.3%
9	Tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave	396,852	367,001	(29,851)	-7.5%
10	Tatim, shitja e pasurisë së paluajtshme	0	2,724,467	2,724,467	100%
11	Tatim, trashëgimia dhe dhurimi	0	138,647	138,647	100%

Sic paraqitet dhe në tabelë, llojet e tatimeve të raportuara në tabelën fiskale në zërin “të ardhura personale” në shumën 46,226,037 mijë lekë janë:

-tatimi mbi page nga listë pagesat; -tatimi mbi të ardhurat nga interesat; -tatimi mbi të ardhurat nga qiratë;-tatimi mbi fituesit e lojërave të fatit;-tatim mbi ardhurat personale biznesi i vogël me xhiro 2-8 mln lekë;-të drejtën e autorit;-dividendin dhe aksionet;-mbi deklaratën individuale vjetore të të ardhurave; -të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme;- trashëgimia dhe

dhurimi, ku këto dy të fundit janë kontabilizuar dhe raportuar në evidencat e vitit 2019 si zëra më vete, duke filluar nga muaji Shkurt 2019 (muaj në të cilën paguhet deklarimi i periudhës 01-Janar), pasi në sistemin C@TS janë shtuar dy kode të reja buxhetore konkretisht: 7021100 “Tatimi nga shitja e pasurive” dhe 7021200 “tatimi mbi të ardhurat nga trashëgimia e dhurimi”. Para kësaj periudhe (Janar 2015 deri ne Dhjetor 2018) ZRPP (hipotekat) e kanë deklaruar dhe paguar këtë tatim në zërin “të tjera tatime mbi të ardhurat në burim”. Marrë në konsideratë këtë ndryshim, rënia prej 43.6% në zërin “të tjera tatimi mbi të ardhurat në burim” që paraqitet në tabelë nuk është realisht një rënie në mbledhjen e kësaj të ardhure por vjen realisht nga klasifikimi i ri në kodet buxhetore. Në fund të vitit 2019, arkëtimet nga këto dy lloj burimesh raportohen në shumën 2,863,114 mijë lekë dhe në total me zërin “ të tjera tatime mbi të ardhurat në burim” rezultojnë me një rritje prej 11% krahasuar me vitin 2018, paraqitur më hollësisht në tabelën në vijim:

Str uk.	Lloji i të Ardhurave	FAKTET		Diferenca 2019/ 2018	
		2018	2019	+ ose -	%
6	Të tjera Tatime mbi të Ardhurat në Burim	5,199,261	2,931,828		
10	Tatim, shitja e pasurise së paluajtshme		2,724,467		
11	Tatim, trashëgimia dhe dhurimi		138,647		
	Total	5,199,261	5,794,942	595,681	11%

Përveç këtij ndryshimi për shkak të detajimit në klasifikimin buxhetor, nga evidencat e raportuara për vitin 2019 konstatohet se arkëtimet në zërin **“Tatimi mbi page, listëpagesa”** dhe **“të ardhurat nga dividendi”** kanë kontributin më të madh në totalin e të ardhurave të realizuar në këtë zë, respektivisht **40% dhe 24%**, trajtuar më hollësisht në vijimtë këtij raporti.

B4.1 Në lidhje me “Tatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionet”

Sipas Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998, neni 33/1 “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit, pika 1. *Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi”* dhe pika 3. “Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit”.

Bazuar në sa më sipër, janë audituar të dhënat e vëna në dispozicion për kodin buxhetor “tatimi mbi të ardhurat nga dividendet dhe aksionet” ku arkëtimet për vitin 2019 raportohen në shumën 11,061,159 mijë lekë. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat nga dividendi kanë një rritje prej rreth 200% ose 7.3 miliard lekë. Kjo shpjeguar me ndryshimet ligjore të parashikuara me Ligjin nr.94/2018 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, sipas të cilit është bërë ndryshimi në trajtimin fiskal për të ardhurën nga dividendi, duke shtuar në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, pika 9 me këtë përmbajtje: “Norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8 % do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019”.

Sipas muajve arkëtimet më të larta rezultojnë gjatë tremujorit 3-të, periudhë kjo që përkon jo vetëm me afatet e deklarimit të vendimit të ortakut dhe pasqyrave financiare por dhe mbarimit të periudhës së lehtësimit fiskal për fitimet e pashpërndara. Analizuar sipas drejtorive rajonale, kontributi më i madh në arkëtimet e këtij lloji tati mi vjen 52% nga subjektet e administruara në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe 29% nga subjektet e administruara nga DRT Tiranë. Më hollësisht për secilën DRT paraqitur në tabelën në vijim:

Drejtoritë Rajonale	Arkëtimet në lekë	Pesha specifike
DRT DTM	5,725,391,302	52%
DRT Tiranë	3,187,643,869	29%
DRT Durrës	553,383,392	5%
DRT Fier	369,715,883	3%
DRT Korçë	216,804,320	2%
DRT Berat	110,074,627	1%
DRT Dibër	157,063,954	1%
DRT Elbasan	174,750,262	2%
DRT Shkodër	130,240,267	1%
DRT Vlorë	178,861,073	2%
DRT Gjirokastër	96,518,290	1%
DRT Kukës	50,583,746	0.5%
DRT Lezhë	86,694,752	1%
DRT Sarandë	23,433,228	0.5%
Total	11,061,158,965	

Sektori	Arkëtimet në lekë	Pesha specifike
në Sektorin e Shërbimit	4,551,510,105	41%
në Sektorin e Tregtisë	3,297,394,994	30%
në Sektorin e Ndërtimit	1,535,198,669	14%
në Sektorin e Prodhimit	1,279,708,107	11%
në Sektorin e Transportit	390,760,597	4%
Total	11,061,158,965	

Sic është trajtuar dhe në auditimin e kaluar, sipas të dhënave të C@TS, kontribuesit më të mëdhenj dhe ndërkohë përfituesit nga ky lehtësim fiskal janë rreth 30 subjekte të cilët kanë deklaruar dhe shpërndarë fitimin e viteve të kaluara (2017 e më herët) në vitin 2019 duke përfituar nga shkalla tatimore 8%. Konkretisht këto subjekte janë:

Subjekti	Type	Pagesa në lek në 2019	%
T A	BM	2,004,376,330	18.1%
B	BM	295,200,000	2.7%
B K T	BM	193,725,000	1.8%
I J - I G	BM	177,768,137	1.6%
R B S H A	BM	165,052,631	1.5%
T I A S H P K	BM	157,634,582	1.4%
"G 2"	BM	147,941,876	1.3%
A	BM	122,739,997	1.1%
"A" S H A.	BM	100,481,355	0.9%
T N	BM	88,255,342	0.8%
T	BM	85,851,660	0.8%
M	BM	75,055,732	0.7%
E-SA	BM	68,000,000	0.6%
P.	BM	63,549,207	0.6%
A-B	BM	63,200,000	0.6%
A K	BM	57,022,743	0.5%
I-T	BM	55,061,992	0.5%
"A"	BM	45,670,834	0.4%
T C T	BM	43,712,555	0.4%
E v	BM	41,100,478	0.4%
B A	BM	40,965,616	0.4%
E. H. x.	BM	40,797,580	0.4%

T D	BM	40,459,114	0.4%
S	BM	40,000,000	0.4%
C-C B	BM	38,941,079	0.4%
R Co	BM	38,303,357	0.3%
KA T	BM	38,021,682	0.3%
B.	BM	34,999,984	0.3%
I S B	BM	34,936,542	0.3%
I +	BM	33,137,376	0.3%
Total 30 subjekte		4,431,962,781	40%
Total arkëtime		11,061,158,965	

Në fakt, nga krahasimi i të dhënave me një vit më parë, mbi arkëtimet e regjistruara në kodin buxhetor **7009100** “Tatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionet”, rezulton se disa prej këtyre subjekteve kanë paguar tatimin në burim në vitin 2018 për fitimin e shpërndarë të vitit të mbyllur 2017, vit kur shkalla standarde tatimore e aplikuar për këtë lloj të ardhure ishte 15%. Megjithatë hapësira kohore Janar – Shtator 2019 e parashikuar në Ligjin nr.94/2018, u jepte mundësinë të deklaronin fitimet e pashpërndara për periudha të kaluara (viti 2017 e më herët) për të përfituar nga shkalla tatimore e re 8%, pavarësisht vonesës në deklarim.

Në lekë

Subjekti	Pagese 2019	Pagese 2018
T A	2,004,376,330	158,240,329
T I A	157,634,582	189,923,858
I S B	34,936,542	165,675,628
R B	165,052,631	137,842,105
B K T	193,725,000	161,670,000
E. H. x.	40,797,580	7,500,000
T D	40,459,114	2,344,017
B A	40,965,616	5,912,682
T N	88,255,342	20,917,950
C-C B	38,941,079	45,930,737
M	75,055,732	3,229,141
P.	63,549,207	8,855,294
A-B	63,200,000	1,500,000
"A"	45,670,834	4,356,773
E-SA	68,000,000	6,000,000
I +	33,137,376	17,520,061
R Co	38,303,357	17,619,074
KA T	38,021,682	18,000,000

Nëse do ti referoheshim periudhës për të cilin është deklaruar dividendi dhe rrjedhimisht detyrimi për tatimin në burim na rezulton se, 6302 subjekte kanë paguar dividend në referencë të periudhës tatimore vitin 2019 periudhë që në fakt deklarohet dhe duhet të paguhet deri 20 gusht 2020 pas plotësimit të detyrimit për dorëzimin e vendimit të ortakut për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimit të fitimit në përputhje me Nenin 33/1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.198, i ndryshuar. Deklarimi i dividendit dhe detyrimit për tatimin në burim bëhet nëpërmjet formularit të deklarimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat i miratuar me Udhëzimin nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

Për një vlerësim të impaktit të këtij lehtësimi fiskal në nivel grup tatimpaguesish për fitimet e pashpërndara para vitit 2018 grupi i auditimit kërkoi të dhënat e deklaratave të regjistruara në C@TS gjatë vitit 2019, për tatimin e mbajtur në burim mbi të ardhurat. Kjo deklaratë përmban 12 rubrika të dedikuara për deklarimin e të ardhurave sipas llojit. Rubrika 8 është e dedikuar për të ardhurat nga dividendi. Sipas këtyre deklaratave, periudhat tatimore për të cilat janë plotësuar deklaratat paraqiten si vijon:

Sipas kodit buxhetor 7009700			Sipas deklaratave të TMB		
Viti/periudha	Shuma arkëtuar në lekë	Nr. subjekte	Viti	(8) Dividentët Në lekë	(8 _1) TMB Dividentët Në lekë
2011	156	1			
2012	61,796	2			
2013	142,194	6			
2014	2,240,967	5	2014	39,236,375	2,298,685
2015	2,887,296	11	2015	848,779,289	110,987,491
2016	1,699,432	28	2016	4,018,553,615	453,941,593
2017	3,855,592	49	2017	4,237,566,662	487,734,326
2018	88,178,140	168	2018	8,405,643,300	681,432,771
2019	10,962,093,392	6302	2019	158,478,035,671	10,804,930,079
Total	11,061,158,965	6572	Total	176,027,814,912	12,541,324,945

Sipas deklaratave të regjistruara, shumat e deklaruara për periudhën 2018 prej 681 milion lekë janë arkëtuar vetëm 88 milionë lekë nga 168 subjekte. Për periudhat 2017 e më herët, detyrimi i deklaruar për tatimin e mbajtur në burim rezulton të jetë në shumën 1.05 miliard lekë dhe arkëtuar vetëm 10.88 milionë lekë. Ndërkohë, nga auditimi i të dhënave për debitorët për detyrimin e tatimit në burim rezulton se gjendja debitore e re e krijuar gjatë vitit 2019 (deklarime vs pagesa) për kodin 1504- “Tatim mbi të ardhurat nga dividende dhe aksione detyrim principal” është vetëm 93.64 milion lekë (progresive: 477,908,897 lekë).

Nisur nga deklaratimet e rritura me referencë periudhën 2019 duket se subjektet i janë referuar periudhës kur ata kanë bërë deklarinin dhe jo periudhës së cilës i përkasin të ardhurat nga dividendi të pashpërndara në vitin përkatës kur ka lindur detyrimi.

B4.2 Mbi saktësinë e plotësimit të deklaratës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat sipas llojit dhe shkallës tatimore të aplikuar- rubrika 8 “dividend”

Nga auditimi i të dhënave të raportuara në kodin buxhetor 7009100 në nivel subjekti, konstatohen dhe pagesa të cilat referuar periodicitetit (me bazë mujore), datat e pagesave dhe shumat e paguara (të barabarta nga muaji në muaj) nuk duken të jenë deklarime në lidhje me dividendin. Nga verifikimi i disa prej këtyre pagesave u konstatua se ato nuk janë të lidhura me të ardhurat nga dividendi por me të ardhurat nga qiraja.

Nga auditimi i të dhënave të kodit buxhetor 7009100 “Tatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionet” për periudhën Tetor- Dhjetor 2019 konstatohet se 99 subjekte kanë vijuar me pagesa edhe pas afatit të fundit të aplikimit të shkallës tatimore 8% të 30 shtatorit 2019. Duke qenë se pas kësaj date çdo subjekt që do të deklarojë dhe paguaj tatim mbi të ardhurat nga dividendi për vitet 2017 e më herët nuk është më i “favorizuar” nga shkalla tatimore 8% por duhet të aplikojë shkallën standarde të asaj periudhe 15%. Për grupin e auditimi ishte e pamundur identifikimi i të gjitha këtyre rasteve të deklaruara dhe paguara gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2019 pasi siç është trajtuar edhe më lartë, në deklarime subjekti i është referuar periudhës tatimore 2019. Kjo kërkon një verifikim rast pas rasti në sistemin C@TS nga DRT-të respektive. Megjithatë, bazuar në informacionin mbi dividendin e deklaruar nga këto subjekte konstatohet se:

- vetëm **32 nga 99 subjektet kanë deklaruar²⁶ dividend në shumën 405,946 mijë lekë** me një detyrim tatim në burim të llogaritur 58,200 mijë lekë ndërkohë që shumat e paguara nga këto subjekte janë vetëm 20,477 mijë lekë.

- **67 subjekte nuk rezultojnë të kenë deklaruar dividend** dhe shumat e paguara prej 66 milion lekë nuk janë të tatim në burim për të ardhurat nga dividendi por për të tjera të ardhura në burim.

²⁶Burimi: Drejtoria e Kontrollit Tatimor

Këto raste janë dërguar për verifikim dhe sqarim për llojin e të ardhurës për të cilin këto subjekte kanë paguar tatimin në burim dhe në disa raste rezultojnë të jenë të ardhura nga qiraja dhe jo nga dividendi.

- **3 subjekte janë ente publike buxhetore** dhe nuk janë kanë detyrim deklarimi tatim fitimi:

Subjekti	Oct	Nov	Dec	Total Pagesa	Divident Per tu shpendare	Tatim mbi Dividentin
Agjencia e Sig.të CAP	43,989	409,590		453,579	20,781,221	3,117,185
Z V A KAMEZ		161,753	20,640	182,393	1,923,222	288,481
Z V A Tepelenë			72,600	72,600	61,554.00	61,554

Këto raste janë dërguar në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor për ti përcjellë në DRT-të respektive me qëllim sistemimin e situatës së këtyre subjekteve.

- Për **30 subjekte tatimi në burim i paguar faktikisht është i ndryshëm nga ai i përlogaritur, shkalla faktike e aplikuar bazuar në pagesat faktike varion nga 0.5% deri 102%:**

Subjekti	Divident Per tu shpendare	Tatim mbi Dividentin	Total Pagesa	Shkalla tatimore faktike
Z A	192,598,824	28,889,824	888,567	0.5%
A - G	29,088,903	4,363,335	320,000	1.1%
A- I	17,142,857	2,571,429	960,000	5.6%
A C	17,000,000	2,550,000	584,000	3.4%
B. B	20,000,000	3,000,000	1,202,880	6.0%
M I A	10,861,176	1,785,235	557,624	5.1%
2AC	8,695,713	1,304,357	451,274	5.2%
M	10,000,000	1,500,000	2,002,400	20%
I C T S	9,871,219	1,480,683	1,508,587	15.3%
E	7,352,875	1,102,931	1,507,676	20.5%
IC Al	26,493,300	1,324,665	975,553	3.7%
I T	5,888,189	883,228	883,228	15%
S L v	6,536,382	980,457	510,345	7.8%
"S - AD"	5,000,000	750,000	390,000	7.8%
A I K	2,326,933	349,040	243,955	10.5%
P/G	2,000,000	300,000	200,000	10%
D.N.H	1,333,333	200,000	1,367,805	102.6%
K-T	1,000,000	150,000	175,321	17.5%
T	2,500,000	125,000	155,000	6.2%
P P.	1,680,000	252,000	123,389	7.3%
A C S	1,400,000	210,000	101,647	7.3%
H	1,425,077	213,762	87,785	6.2%
A T	563,872	84,581	367,739	65.2%
K	551,204	82,681	338,621	61.4%
I D A	553,796	83,069	83,069	15%
A	500,000	75,000	1,200,000	240%
E	450,454	67,568	412,062	91.5%
Sh "D"	200,000	30,000	606,248	303%
S SHPK	166,009	24,901	1,563,731	942%
TOTAL	383,180,116	54,733,746	19,768,506	5%

- në të dy rubrikat **evidentohen një numër i lartë pagesash periodike mujore**, me shuma të barabarta për të cilat shkalla tatimore e aplikuar është 15%, pagesa këto që nuk kanë të bëjnë me tatimin në burim për të ardhurat nga dividendi por pagesa nga të ardhura nga qiraja, rrjedhimisht një NIPT mund të rezultojë me më shumë se 12 deklarata të regjistruara

- Konstatohen të kenë deklaruar në këto rubrika dhe 25 ente publike me një vlerë detyrimi tatimi në burim nga dividendi dhe fitimi i shpërndarë prej 3.6 milion lekë, subjekte këto të cilat nuk mbartin përgjegjësinë e deklarimit të fitimit.

B4.3 Mbi saktësinë e plotësimit të deklaratës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat sipas llojit dhe shkallës tatimore të aplikuar –rubrika 9 “shpërndarja e fitimit”

Sipas Udhëzimit nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar deklarata e miratuar e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, rubrika 9 “ndarja e fitimit” nuk është rubrikë në të cilën duhet të deklarohet e ardhura nga dividendi por ndarjet e fitimit të ortakut cituar: “Rubrika [9] *Ndarjet e fitimit plotësohen me shumat e pagesave për ndarjet e fitimit që i kryhen ortakut pas miratimit të rezultatit finansiardhemiratimit të destinimit të fitimit*”.

Nga auditimi i deklaratave të regjistruara gjatë vitit 2019 konstatohet se në rubrikën nr.9 “ndarja e fitimit” totali i tatimit në burim i deklaruar është rreth 2.12 miliard lekë. Norma mesatare e aplikuar në këtë rubrikë është 8% megjithatë verifikuar në nivel deklarate **përqindjet e aplikuar variojnë nga 0% - 100% kjo duke supozuar që vjen për shkak të gabimeve në plotësimin e deklaratës (shuma e të ardhurave = shumën e tatimit)**. Referuar llojit të tatimit ndryshimet ligjore për shkallën tatimore për dividendin nuk janë të aplikueshme për zërin ‘ndarje fitimit’ për efekt deklarimi të fitimeve të periudhave para vitit 2018, lehtësi kjo e parashikuar vetëm për zërin “dividend”. Nga të dhënat rezulton se nga 848 deklarues vetëm 77 prej tyre kanë aplikuar një shkallë tatimore të ndryshme nga 8% të cilat i përkasin periudhave të cilat nuk aplikohet shkalla 8%.

Nga vetë natyra e të ardhurës që deklarohet në këtë rubrikë numri i deklarimeve për një subjekt nuk mund të jetë më shumë se 1 vetëm në rastet e saktësimeve dhe korrigjimeve të deklarimit fillestar. Ndërkohë në listën e të dhënave ashtu si edhe për rubrikën 8, konstatohen pagesa periodike mujore nga i njëjti subjekt. Po ashtu edhe në këtë rubrikë konstatohen ente publike që të kenë deklaruar shpërndarje fitimi ndërkohë që nuk mbartin përgjegjësi tatimore për tatim fitimin. Nga numri i rasteve të konstatuara, mundësia që edhe këto deklarata të jenë plotësuar gabim në lidhje me klasifikimin e të ardhurave sipas llojit është e lartë dhe për të përlllogaritur një vlerë riklasifikimi është i nevojshëm verifikimi në sistemin C@TS rast pas rasti, verifikim ky i pamundur për këtë auditim.

Mbi saktësinë e plotësimit të deklaratës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat sipas llojit dhe shkallës tatimore të aplikuar- rubrika 8 “dividend”

Gjetja	Plotësimi i deklaratës së tatimit mbi të ardhurat në burim mbart shumë gabime, jo vetëm në klasifikimin e llojit të të ardhurave në rubrikat e gabuara. Kështu janë evidentuar shumë raste të deklarimit të tatimit në burim për qiranë plotësuar në rubrikën “dividend” dhe rrjedhimisht të raportuar në kodin buxhetor të gabuar 7009100. Mungojnë sistemet e kontrollit për verifikimin e saktësisë së deklaratave lidhur me shkallën e duhur tatimore të aplikuar si dhe periudhën tatimore të cilit ky deklarim i përket.
---------------	---

<p>Situata</p>	<p>Arkëtimet për vitin 2019 të zërit “Tatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionet”, raportohen në shumën 11,061,159 mijë lekë. Krahësuar me një vit më parë, të ardhurat nga dividendi kanë një rritje prej rreth 200% ose 7.37 miliard lekë. Kjo shpjeguar me ndryshimet ligjore të parashikuara me Ligjin nr.94/2018 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, sipas të cilit është bërë ndryshimi në trajtimin fiskal për të ardhurën nga dividendi, duke shtuar në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, pika 9²⁷.</p> <p>Nga auditimi i të dhënave të raportuara në kodin buxhetor 7009100 në nivel subjekti mbi saktësinë e plotësimit të deklaratës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat sipas llojit rubrika 8 “dividend”, u konstatuan të regjistruara edhe pagesa që <u>nuk kanë lidhje me llogarinë “të ardhurat nga dividendi” por me “të ardhurat nga qiraja”</u>.</p> <p>Nga auditimi i të dhënave të kodit buxhetor 7009100, për periudhën Tetor- Dhjetor 2019 konstatohet se 99 subjekte kanë vijuar me pagesa edhe pas afatit të fundit të aplikimit të shkallës tatimore 8% të 30 shtatorit 2019. Duke qenë se pas kësaj date çdo subjekt që do të deklarojë fitime të pashpërndara dhe të padeklaruara të vitit 2017 e më herët, nuk është më i “favorizuar” për aplikimin e shkallës tatimore 8% por duhet të aplikojë shkallën standarde 15%. Për grupin e auditimi ishte e pamundur vlerësimi i përputhshmërisë së periudhës së deklaruar me shkallën tatimore të re të aplikuar për shkak të pasaktësive në plotësimin në deklaratë të periudhës tatimore pasi siç është trajtuar edhe më lartë, në deklarime subjekti i është referuar periudhës tatimore 2019. <u>Kjo kërkon një verifikim rast pas rasti në sistemin C@TS nga DRT-të respektive.</u> Referuar deklarimeve për dividendin, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -vetëm 32 nga 99 subjektet kanë deklaruar²⁸ dividend në shumën 405,946 mijë lekë me një detyrim tatim në burim të llogaritur 58,200 mijë lekë ndërkohë që shumat e paguara nga këto subjekte janë vetëm 20,477 mijë lekë; -67 subjekte nuk rezultojnë të kenë deklaruar dividend ndërkohë që shuma e paguar prej tyre është 66 milion lekë, dhe mund të jenë pagesa për të tjera të ardhura në burim por deklaruar në rubrikën e gabuar. -Konstatohen të kenë deklaruar në këto rubrika dhe 25 ente publike me një vlerë detyrimi tatimi në burim nga dividendi dhe fitimi i shpërndarë prej 3.6 milion lekë, subjekte këto të cilat nuk mbartin përgjegjësinë e deklarimit të fitimit. Këto raste janë dërguar në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor për ti përcjellë në DRT-të respektive me qëllim sistemimin e situatës së këtyre subjekteve në C@TS. <p>Në konkluzion: plotësimi i deklaratës së tatimit mbi të ardhurat në burim mbart shumë gabime jo vetëm në klasifikimin e llojit të të ardhurave por</p>
-----------------------	---

²⁷“Norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8 % do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019”.

²⁸Burimi: Drejtoria e KontrollitTatimor

	dhe në rubrikat “baza për tatimin” dhe ”shuma për tu paguar” rrjedhimisht kodi buxhetor (llogaria) 7009100- ku raportohen “të ardhura nga dividendi dhe aksionet” në gjykimin e audituesit bazuar në evidencat e auditimit, është i mbivlerësuar marrë në konsideratë klasifikimet e llojit të të ardhurave në rubrikat e gabuara. Për shkak të volumit të lartë të dhënave, për grupin e auditimit ishte e pamundur kuantifikimi i të gjitha rasteve në numër dhe vlerë, që <u>nuk i përkasin</u> tatimit mbi dividendin. Cilësia e të dhënave nuk lejon kryerjen e një analize të drejtë për vlerësimin e përputhshmërisë së aplikimit të shkallës tatimore të kufizuar në kohë “ <i>deri 30 shtator 2019</i> ” për fitime të pashpërndara deri në vitin 2017.
Kriteri	Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”; Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasaktësi në deklarime me impakt në saktësinë e klasifikimeve buxhetore të të ardhurave sipas llojit.
Rëndësia	I Lartë

Gjetja	Në deklaratën e tatimit të të ardhurave në burim mungon rubrika për “të ardhurat nga veprimet me aksionet” duke e bërë të pamundur identifikimin e kësaj lloji të ardhura dhe shkallën tatimore të aplikuar. Në lidhje me rubrikën nr.9 “ndarja e fitimit” totali i tatimit në burim i deklaruar është rreth 2.12 miliard lekë. Nga 848 deklarime të cilat i përkasin periudhave për të cilat nuk aplikohet shkalla 8%, vetëm 77 prej tyre kanë aplikuar një shkallë tatimore të ndryshme nga 8%.
Situata	Sipas Udhëzimit nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar deklarata e miratuar e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, rubrika 9 “ndarja e fitimit” nuk është rubrikë në të cilën duhet të deklarohet e ardhura nga dividendi por ndarjet e fitimit të ortakut cituar: “Rubrika [9] <i>Ndarjet e fitimit plotësohen me shumatat e pagesave për ndarjet e fitimit që i kryhen ortakut pas miratimit të rezultatit financiar dhe miratimit të destinimit të fitimit</i> ”. Nga auditimi i deklaratave të regjistruara gjatë vitit 2019 konstatohet se në rubrikën nr.9 “ndarja e fitimit” totali i tatimit në burim i deklaruar është rreth 2.12 miliard lekë. Norma mesatare e aplikuar në

	<p>këtë rubrikë është 8% megjithatë verifikuar në nivel deklarate përqindjet e aplikuara variojnë nga 0% - 100%, kjo duke supozuar që vjen për shkak të gabimeve në plotësimin e deklaratës (shuma e të ardhurave = shumën e tatimit). Referuar llojit të tatimit ndryshimet ligjore për shkallën tatimore për dividendin nuk janë të aplikueshme për zërin ‘ndarje fitimit’ për efekt deklarimi të fitimeve të periudhave para vitit 2018, lehtësi kjo e parashikuar vetëm për zërin “dividend”. Nga të dhënat rezultoi se nga 848 deklarues vetëm 77 prej tyre kanë aplikuar një shkallë tatimore të ndryshme nga 8% deklarime të cilat i përkasin periudhave të cilat nuk aplikohet shkalla 8%. Ndërkohë në listën e të dhënave ashtu si edhe për rubrikën 8, konstatohen pagesa periodike mujore nga i njëjti subjekt. Po ashtu edhe në këtë rubrikë konstatohen ente publike që të kenë deklaruar shpërndarje fitimi ndërkohë që nuk mbartin përgjegjësi tatimore për tatim fitimin. Nga numri i rasteve të konstatuara, mundësia që edhe këto deklarata të jenë plotësuar gabim në lidhje me klasifikimin e të ardhurave sipas llojit është e lartë dhe për të përlogaritur një vlerë për impaktin në saktësinë e të ardhurave të raportuara sipas kodeve buxhetore është i nevojshëm verifikimi rast pas rasti në sistemin C@TS, verifikim ky i pamundur për këtë auditim.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”; Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Pasaktësi në deklarime me impakt në saktësinë e klasifikimeve buxhetore të të ardhurave sipas llojit.</p>
Rëndësia	<p>I Lartë</p>

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.14, datë 24.07.2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, me observacionin me nr.6272prot. datë 30.7.2020 për të cilin audituesi ka shprehur qëndrimin e tij në Projekt Raport.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

- 1.Titullarët e DRT-ve strukturat e kontrollit tatimor që ata administrojnë dhe drejtojnë,
- 2.Zj.IA, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit në DPT për ngritjen e sistemeve të kontrollit në procedurat dhe detyrat që ka dhe ndjek kontrolli nga zyra.
- 3.Zj.MS në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit në përgjegjësinë e raportimit të të ardhurave tatimore.
- 4.Zj.DI në cilësinë e NA, me përgjegjësinë e ngritjen e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

B4.4 Në lidhje me “Tatimi mbi page nga listë pagesat”:

Nga evidencat e vëna në dispozicion raportohen të ardhura të arkëtuara nga “tatimi mbi pagë nga listëpagesat” në shumën **22,279,842 mijë lekë ose 6.3% më shumë se plani i miratuar** për vitin 2019. Arkëtimet e realizuara vijnë 8.3 miliard nga sektori publik dhe 13.9 miliard nga sektori privat. Të ardhurat e arkëtuara për të dy sektorët rezultojnë me rritje krahasuar me një vit më parë, respektivisht +9.8% dhe +4.3%. Analizuar në raport me numrin e punonjësve të deklaruar në Janar 2019 dhe Dhjetor 2019, rezulton se numri i punonjësve të deklaruar në total është rritur me 13259 punonjës ose 2% më shumë se fundviti 2018. Duke shmangur efektin negativ të uljes së numrit të punonjësve nga subjektet të cilat gjatë vitit 2019 janë ç’regjistruar, kanë bërë kërkesë për ç’regjistrim apo kanë kaluar në status pasiv, rritja bruto e numrit të punonjësve është +33297 ose +5% më shumë se fund viti 2018, referuar kjo deklarimit të 127840 subjekteve:

Sips statusit	Nr i punonjesve Listëpagesa 1901	Nr i punonjesve Listëpagesa 1912	Ndryshimi +/-	Nr. subjekteve
Aktiv	643,761	677,058	+33297	108,415
Çregjistruar	2,186	332	-20038	1,791
Kërkesë për Çregjistrim	14,991	5,298		7,788
Pasiv	13,902	5,411		9,846
Total	674,840	688,099	13259	127,840

Sipas sektorëve të ekonomisë, rritje në deklarimin e numrit të punonjësve evidentohet për subjektet që operojnë në sektorin e shërbimit 7%, të tregtisë me 6%, transportit me 4% dhe ndërtimit me 3%. Më konkretisht informacioni i përmbledhur në tabelën në vijim:

Statusi/ sektori	Nr. subjekteve deklaruese	Nr. i punonjesve të deklaruar		Ndryshimi %
		1901	1912	
Aktiv	108,415	643,761	677,058	5%
në Sektorin e Ndërtimit	4,489	46,768	48,266	3%
në Sektorin e Prodhimit	10,781	127,427	127,737	0.2%
në Sektorin e Shërbimit	50,787	332,345	355,579	7%
në Sektorin e Transportit	5,232	17,194	17,899	4%
në Sektorin e Tregtisë	37,113	120,022	127,564	6%
papercaktuar	13	5	13	160%
Pasiv/çregjistruar	19,425	31,079	11,041	-64%
në Sektorin e Ndërtimit	552	906	370	-59%
në Sektorin e Prodhimit	1,548	2,808	1,051	-63%
në Sektorin e Shërbimit	10,376	18,392	6,304	-66%
në Sektorin e Transportit	732	935	401	-57%
në Sektorin e Tregtisë	6,211	8,031	2,913	-64%
papercaktuar	6	7	2	-71%
Total	127,840	674,840	688,099	2%

Për një vlerësim të drejtë të impaktit të rritjes së numrit të punonjësve të deklaruar në rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi pagë duhet të merret në konsideratë dhe niveli i pagës së deklaruar. Nga auditimi i të dhënave që disponojmë rezulton se paga mesatare bruto për vitin 2019 sipas sektorëve të ekonomisë varion nga 29,670 lekë sipas deklarimeve të subjekteve që operojnë në sektorin e tregtisë deri në 49,500 lekë nga deklarimet e subjekteve që operojnë në sektorin e shërbimit ku përfshihen kryesisht edhe subjektet “ente publike”. Më hollësisht paraqitur në tabelën në vijim:

Subjektet me status Aktiv	Nr. mesatar i punonjësve të deklaruar	Paga mesatare mujore në lekë e deklaruar
në Sektorin e Ndërtimit	47517	36,997

në Sektorin e Prodhimit	127582	38,509
në Sektorin e Shërbimit	343962	49,562
në Sektorin e Transportit	17547	40,564
në Sektorin e Tregtisë	123793	29,672
papercaktuar	9	4,828
Total	660410	42,555

Me qëllim evidentimin e zonave me risk në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e deklarimeve të numrit të punonjësve dhe pagës bruto për efekt të mbledhjes së të ardhurave nga tatimi mbi pagë, të dhënat nga sistemi C@TS për subjektet me status aktiv janë analizuar edhe sipas formës ligjore, peshës specifike dhe pagën mujore mesatare të deklaruar, një përmbledhje e të cilave paraqitet në tabelën në vijim:

Subjektet aktive sipas formës ligjore	Nr.mesatar i punonjesve te deklaruar	Pesha specifike në %	Paga mesatare mujore e deklaruar në lekë
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	286,666	43%	39,675
Ent publik	151,047	23%	60,848
Person fizik	147,353	22%	11,525
Shoqëri aksionere	56,231	8.5%	73,968
Organizatë jo fitimprurëse	9,497	1.4%	56,626
Degë e shoqërive të huaja	4,023	0.6%	182,841
Ortakëri e thjeshtë	1,076	0.2%	116,544
Trup diplomatik	1,032		95,314
Organizata Fetare, humanitare dhe bamirësie	1,027	0.2%	38,212
Zyrë përfaqësimi	279		178,761
Njësi zhvillimi projektsh	238		170,070
Kursim krediti	390		78,618
SH.A pa ofertë publike	143		59,981
Organizata politike	96		57,519
Ortakëri e pakufizuar	157		50,362
Ortakëri e kufizuar	16		28,486
Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor	52		22,334
Kryefamiljar	70		13,253
Shoqëri bashkëpunimi dhe ndihme reciproke	4		12,335
Ambulant	1015	0.2%	40

Nga auditimi i grup-subjekteve me numrin më të lartë të punonjësve të deklaruar, konstatohet se:

1) 20,623 subjektet e regjistruara si “shoqëri me përgjegjësi të kufizuara-shpk” kanë deklaruar rreth 290 mijë punonjës ose 43% të numrit total të punonjësve të deklaruar nga të gjithë subjektet me status aktiv, dhe një pagë mesatare mujore më pak se 40,000 lekë (nga të cilët paga e tatueshme është vetëm 10,000 lekë).

- Në këtë grup evidentohe rreth 620 subjekte (nga të cilët 125 subjekte “biznes i madh”), të cilat deklarojnë pagë bruto “zero”,

- 194 subjekte (nga të cilat 37 subjekte “biznes i madh”) rezultojnë me deklaram 1 punonjës me pagë bruto nga 1- 29700 lekë, pra më një efekt “zero” lekë tatim.

2) grupi i subjekteve me forme ligjore “person fizik” deklaroi mesatarisht 147,353 punonjës ose 22% të totalit të punonjësve të deklaruar, me një pagë mesatare mujore 11,525 lekë pra praktikisht me zero efekt në të ardhurat personale të realizuara.

Sipas drejtorive rajonale të ardhurat të ardhurat e arkëtuar sigurisht vijnë nga DRT Tiranë dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj respektivisht me një kontribut prej 36% dhe 39%.

Ndërkohë DRT Tiranë mbart dhe 61% të debitorëve për mospagesë të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (TAP) (trajtuar më hollësisht në pikën B.2 të programit):

Në lekë

DRT	Shuma Arkëtuar (TAP)	%	Debitorët	%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	8,096,080,635	36%	574,552,626	61%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	8,708,485,416	39%	134,991	0%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	1,171,871,598	5%	123,495,916	13%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	298,010,573	1%	5,856,479	1%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	324,639,741	1%	9,409,475	1%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	621,865,028	3%	24,362,997	3%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	651,755,374	3%	27,666,868	3%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	256,664,268	1%	13,859,221	1%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	492,793,732	2%	27,142,789	3%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	227,661,167	1%	41,681,263	4%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	290,983,376	1%	19,788,608	2%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	134,804,714	1%	8,233,670	1%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	530,664,114	2%	22,018,090	2%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	453,080,151	2%	46,431,625	5%
Total	22,259,359,887		944,634,618	

Nga informacioni mbi kontrollat e ushtruar gjatë vitit në subjekte, si pjesë e planit mujor të DRT-ve, rezulton se kontrollat mbi saktësinë e deklarimit të punonjësve janë pjesë e kontroleve të përgjithshme të tatimit mbi fitimin, kontrole këto që mbulojnë të gjithë komponentët e situatës fiskale të një tatimpaguesi. Ndërkohë shkalla e informalitetit në deklarimin e punonjësve dhe pagave mbetet tepër e lartë dhe kërkon një vlerësim risku të dedikuar për profile të caktuara tatimpaguesish dhe në bazë rajoni. Në tabelën në vijim paraqitet një përmbledhje sipas DRT-ve e numrit të punonjësve të deklaruar dhe pagës mesatare të përlogaritur:

DRT	Nr. Punonjësve Periudha 1912	Paga bruto Në lekë	Paga mesatare mujore e përlogaritur Në lekë
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	17978	6,845,711,808	31,732
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	14033	6,551,740,564	38,907
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	127203	104,397,904,705	68,393
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	70105	26,866,227,052	31,936
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	33044	12,815,939,928	32,320
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	40589	14,122,993,245	28,996
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	13508	5,561,377,316	34,309
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	28703	10,848,070,027	31,495
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	8780	4,328,097,660	41,079
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	18797	7,082,479,850	31,399
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	8888	3,282,056,702	30,772
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	32121	12,454,080,166	32,310
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	249594	116,699,916,759	38,963
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	24756	9,714,197,443	32,700
Total	688099	341,570,793,225	31,732

Gjetja	Pavarësisht rritjes së të ardhurave të arkëtuara nga një vit më parë, konstatohet se niveli i pagës mesatare mujore të deklaruar mbetet në kufijtë e pagës minimale për disa sektorë të ekonomisë dhe grup tatimpaguesish. Konstatohet mungesë strategjie dhe kontrollorësh
---------------	--

	tatimore me bazë risku të dedikuara për deklarimin e punonjësve dhe pagave.
Situata	<p>Nga evidencat e vëna në dispozicion raportohen të ardhura të arkëtuara nga “tatimi mbi pagë nga listëpagesat” në shumën 22,279,842 mijë lekë ose 6.3% më shumë se viti 2018. Arkëtimet e realizuara vijnë 8.3 miliard nga sektori publik dhe 13.9 miliard nga sektori privat. Të ardhurat e arkëtuara për të dy sektorët rezultojnë me rritje krahasuar me një vit më parë, respektivisht +9.8% dhe +4.3%. Analizuar në raport me numrin e punonjësve të deklaruar në Janar 2019 dhe Dhjetor 2019, rezulton se numri i punonjësve të deklaruar në total është rritur me 13,259 punonjës ose 2% më shumë se fund viti 2018. Duke shmangur efektin negativ të uljes së numrit të punonjësve nga subjektet të cilat gjatë vitit 2019 janë çregjistruar, kanë bërë kërkesë për çregjistrim apo kanë kaluar në status pasiv, rritja bruto e numrit të punonjësve është +33,297 ose 5% më shumë se fund viti 2018, referuar kjo deklarimit të 127,840 subjekteve. Sipas sektorëve të ekonomisë, rritje në deklarimin e numrit të punonjësve evidentohet për subjektet që operojnë në sektorin e shërbimit 7%, të tregtisë me 6%, transportit me 4% dhe ndërtimit me 3%. Për një vlerësim të drejtë të impaktit të rritjes së numrit të punonjësve të deklaruar në rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi pagë duhet të merret në konsideratë dhe niveli i pagës së deklaruar. Nga auditimi i të dhënave nga auditimi, <u>rezulton se paga mesatare bruto për vitin 2019 sipas sektorëve të ekonomisë varion nga 29,670 lekë sipas deklarimeve të subjekteve që operojnë në sektorin e tregtisë deri në 49,500 lekë nga deklarimet e subjekteve që operojnë në sektorin e shërbimit ku përfshihen kryesisht edhe subjektet “ente publike”.</u></p> <p>Me qëllim evidentimin e zonave me risk në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e deklarimeve të numrit të punonjësve dhe pagës bruto për efekt të mbledhjes së të ardhurave nga tatimi mbi pagë, të dhënave nga sistemi C@TS për subjektet me status aktiv janë analizuar edhe sipas formës ligjore, peshës specifike dhe pagën mujore mesatare të deklaruar, ku konstatohet se:</p> <p>1) 20,623 subjektet e regjistruara si “shoqëri me përgjegjësi të kufizuara-shpk” kanë deklaruar rreth 290 mijë punonjës ose 43% të numrit total të punonjësve të deklaruar nga të gjithë subjektet me status aktiv, dhe një pagë mesatare mujore më pak se 40,000 lekë (nga të cilët paga e tatueshme është vetëm 10,000 lekë). Në këtë grup evidentohen rreth 620 subjekte (nga të cilët 125 subjekte “biznes i madh”), të cilat deklarojnë pagë bruto “zero” dhe 194 subjekte (nga të cilat 37 subjekte “biznes i madh”) rezultojnë me deklarim 1 punonjës me pagë bruto nga 1- 29,700 lekë, pra më një efekt “zero” lekë tatim.</p> <p>2) grupi i subjekteve “person fizik” deklaroi mesatarisht 147 mijë punonjës ose 22% të totalit të punonjësve të deklaruar, me një pagë mesatare mujore 11,525 lekë pra praktikisht me zero efekt në të ardhurat personale të realizuara.</p>

	Nga informacioni mbi kontrollet e ushtruar gjatë vitit në subjekte, si pjesë e planit mujor të DRT-ve, rezulton se kontrollet mbi saktësinë e deklarimit të punonjësve janë pjesë e kontrolleve të përgjithshme të tatimit mbi fitimin, kontrolle këto që mbulojnë të gjithë komponentët e situatës fiskale të një tatimpaguesi por jo kontrolle të dedikuara (tematik) mbi saktësinë e deklarimit të punonjësve dhe pagat nisur nga shkalla e lartë e informalitetit e cila mbetet tepër e lartë dhe kërkon një vlerësim risku të dedikuar për profile të caktuara tatimpaguesish dhe në bazë rajoni. Sipas drejtorive rajonale të ardhurat e arkëtuar sigurisht vijnë nga DRT Tiranë dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, respektivisht me një kontribut prej 36% dhe 39%, ku DRT Tiranë mbart dhe 61% të debitorëve për mospagesë të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (TAP).
Kriteri	Ligjinr.7703, datë 11.5.1993 “për sigurimet shoqërore në RSH, i ndryshuar Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiar”; Ligj nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasivitet dhe ineficencë në mbledhjen e të ardhurave nga punësimi
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër grupi i auditimit ka lënë Akt-konstatimin nr.14 datë 24.07.2020 ku për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

1. Titullarët e DRT-ve strukturat e kontrollit tatimor që ata administrojnë dhe drejtojnë,
2. Z.GD në cilësinë e Drejtorit të Menaxhimit të Riskut për hartimin e planeve të kontrollit.
3. Zj.IA në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit në DPT për ngritjen e sistemeve të kontrollit në procedurat dhe detyrat që ka dhe ndjek kontrolli nga zyra.
5. Z.XC në cilësinë e ish-nën Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për periudhën 01.01.2019-04.04.2019
- .Z.ED në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për periudhën 04.04.2019-18.07.2019
6. Zj.DI në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për periudhën 18.07.2019-31.12.2020

B4.3 Në lidhje me deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA)

Në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” përcaktohet: Kreun II i Ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar në nenin 6, citon: “Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve.”, në nenin 7 shtrirja e detyrimit përcaktohet se; 1. Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu. 2. Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu, të realizuara në

territorin e RSH. Në nenin 13 pika 4 të këtij neni citohet “Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2,000,000 (dy milionë) lekë”. Neni 4 i ligjit “Burimi i të ardhurave” rendit një sërë kategorish të ardhurash por, pa u kufizuar vetëm në to, pasi kjo hapësirë përfshihet në pikën i) “të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen”. Neni 39 “Regjistri i individëve” përcakton se; 1. Si numër identifikimi për qëllime tatimore, për tatimpaguesin që është individ, shërben numri personal i identifikimit, i marrë në përputhje me legjislacionin e fushës. 2. Administrata tatimore qendrore mban regjister të veçantë të individëve.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion kodi buxhetor për regjistrimin e pagesave nga individët që plotësojnë kushtin për raportimin e DIVA rezultojnë se janë arkëtuar 367 milionë lekë ose 7.5% më pak se viti 2018. Sipas periudhave të deklaruara tatimi i paguar i referohet periudhave 2011-2018:

Viti	ShumaPagese Kodi buxhetor #7000700 Në lekë
2011	2,563,713
2012	1,549,154
2013	733,362
2014	2,636,713
2015	4,904,468
2016	6,774,957
2017	16,360,091
2018	320,650,860
2019	6,616,080
Total	362,789,398

Sipas DRT	ShumaPagese
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	8,369,550
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	895,958
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	20,099,114
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	6,222,594
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	4,591,308
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	1,431,511
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	2,303,422
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	286,981
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	1,250,958
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	4,861,086
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	14,731,518
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	291,357,990
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	6,387,408
Total	362,789,398

Afati ligjor sipas Ligjit nr.8438 neni 13 pika 2 e tij, tatimpaguesit dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi. Nga auditimi i të dhënave për debitorët për këtë lloj tatimi, rezultojnë rreth 2400 debitorë me një detyrim të papaguar prej 196.8 milion lekë.

Lloji i detyrimit	Celja Në lekë	Detyrim i vitit Në lekë	Progresiv Në lekë
1801 - DIVA (deklarim individual) detyrim principal	102,814,115	122,453,042	184,818,020
1830 - DIVA (deklarim individual) gjobë deklarim i vonuar	8,605,075	3,106,867	11,199,464
1851 - DIVA Gjoha inspektori Evazion fiskal dhe Fshehje Detyrimi	930,609	81,170	800,659
Total	112,349,799	125,641,079	196,818,143

Vetëm gjatë vitit 2019, gjendja debitoare është rritur me 125.6 milion lekë.

Një analizë më të hollësishme për grupin e individëve që aktualisht deklarojnë të ardhura nga dypunësimi (dhe që plotësojnë kriterin 2,000,000 lekë) është e pamundur të kryhet pasi nuk disponojmë të dhëna të detajuara në këtë nivel. Vetë deklarata (DIVA) nuk parashikon deklarimin individual për cdo punëdhënës në rubrika të veçanta por si një shumë totale nga të gjithë

punësimet në rubrikën 3- “të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit” dhe rubrika 4-“tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet e punësimit”. Gjithashtu, deklarata individuale vjetore e të ardhurave, mund të plotësohet edhe nga çdo individ, i cili megjithëse nuk e ka detyrimin ligjor për këtë, për arsye se dëshiron të përfitojë, nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj, kur ky individ plotëson kushtet e përfitimit nga zbritja e shpenzimeve²⁹.

Në auditimet e mëparshme KLSH ka ngritur çështjen e diskriminit që kriteri i parashikuar për lindjen e detyrimit të deklarimit të DIVA prekte vetëm një fashë të caktuar të individëve të punësuar, sipas KLSH *“taksimi individual në gjykimin tonë nuk duhet të orientohet drejt korrigjimit të tatimeve të sanksionuara tashmë nga dispozita ligjore të veçanta duke i taksuar të ardhurat individuale për herë të dytë, por kjo mënyrë deklarimi duhet të synojë nxitjen e deklarimit të të ardhurave globale të individëve dhe shpenzimeve të zbritshme me qëllim me mbylljen e zinxhirit të të ardhurave në nivel individual global si edhe shfrytëzimin e këtij deklarimi për të rimbursuar disa nga shpenzimet e njohura nga ligji, duke bërë që ky deklarim ti shërbejë jo vetëm administratës fiskale por edhe vetë tatimpaguesve”*.

Në këtë kuadër, ky shqetësim i ngritur nga KLSH është zgjidhur ligjërisht me ndryshimet e parashikuara në Ligjin nr.84/2019 datë 18.12.2019 për një ndryshim në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998, i ndryshuar sipas të cilit bëhet ndryshimi i kriterit për lindjen e detyrimit të deklarimit vjetor individual të të ardhurave në nenin 13 pika 4 shtohet, citojmë *“Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit”*. Ky ligj nuk ka parashikuar një dispozitë kalimtare për të përcaktuar afatet e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kjo është rregulluar me Udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhura” i ndryshuar, pika 2.8.1.3 cituar *“..... Nëse individët jorezidentë realizojnë të ardhura bruto vjetore me burim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në shumën më pak se 2 milionë lekë, nuk kanë detyrim për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave. Ky përjashtim nuk zbatohet për individët rezidentë ose jorezidentë të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit. Ky parashikim zbatohet për individët të cilët kanë përfituar të ardhura nga punësimi nga më shumë se një punëdhënës duke filluar nga 1 janari 2020”*.

Ky individ i dypunësuar duhet që, brenda datës 30 prill 2021, të plotësojë deklaratën vjetore të të ardhurave në të cilën të ardhurat mujore nga paga, do të llogariten si total i të ardhurave nga paga nga të gjitha burimet e punësimit të individit.

Pika 2.8.3 Të dhënat për të ardhurat bruto Të dhënat në lidhje me të ardhurat bruto janë të përcaktuara në nenin 13/2 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Këto të dhëna, si për individët shqiptarë edhe për individët e huaj, janë pasqyruar të detajuara në deklaratat individuale vjetore të të ardhurave bashkëlidhur këtij udhëzimi.

²⁹Në këtë rast, shuma e të ardhurave bruto vjetore, nga të gjitha burimet duhet të jetë, jo më e madhe se 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit).

Deklarata DIVA është pjesë e deklaramëve elektronike dhe çdo individ të cilit i lind detyrimi i deklarimit DIVA sipas kriterit të shumës së të ardhurave të realizuara apo që dëshiron të bëjë deklarim fakultativ mund të realizojë nëpërmjet shërbimit e-file. Nëse individ ka bërë deklarime të mëparshme apo figuron në sistemin tatimor i punësuar në më shumë se një punëdhënës dhe plotëson kriterin e dyshemesë 2,000,000 aktualisht në profilin e krijuar i shfaqen deklarata për periudhën e re shfaqet e paraplotësuar edhe për vitet e mëparshme nëse individ nuk ka plotësuar DIVA për ato vite.

Ndryshimi ligjor i parashikuar dhe cituar sa më lartë, i cili duke filluar nga viti 2020 do të prekë një fashë dhe profil më të gjerë individësh duhet të trajtohet me risk të shtuar jo vetëm në lidhje me ndërgjegjësimin për deklarim por veçanërisht për kompleksitetin dhe vështirësitë në plotësimin e deklaratës specifikisht në rubrikën e të ardhurave nga dypunësimi ku individit deklarues i lind detyrimi të bëjë rillogaritjet e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Në shtesë të kësaj ky vlerësim duhet të bëhet edhe në kuadër të riskut të lartë të mbledhshmërisë që ka mbledhja e detyrimeve të këtyre të ardhurave.

Gjetja	Të ardhurat nga deklaratat individuale vjetore rezultojnë të jenë arkëtuar 367 milionë lekë ose 7.5% më pak se viti 2018 ndërkohë që gjendja debitore për këtë zë të ardhurash ka shkuar në 196 milionë lekë. Ndryshimi ligjor i hyrë në fuqi më 1 Janar 2020 dhe afat deklarimi 30 Prill 2021 mbart rrezikun e mosdeklarimit korrekt për shkak të kompleksitetit për fasha të caktuara tatimpaguesish, të përfshira rishtas në këtë detyrim deklarimi.
Situata	Nga të dhënat e vëna në dispozicion kodi buxhetor për regjistrimin e pagesave nga individët që plotësojnë kushtin për raportimin e DIVA ³⁰ rezultojnë se janë arkëtuar 367 milionë lekë ose 7.5% më pak se viti 2018. Sipas periudhave të deklaruara tatimi i paguar i referohet periudhave 2011-2018 ndërsa DRT-ta me arkëtime me të larta janë DRT Tiranë me 291 milionë ose 80% e totalit të arkëtimeve e ndjekur nga DRT Durrës me 20 milionë lekë ose 6% e arkëtimeve. Afati ligjor sipas Ligjit nr.8438 neni 13 pika 2 e tij, tatimpaguesit dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi. Nga auditimi i të dhënave për debitorët për këtë lloj tatimi, rezultojnë rreth 2400 debitorë me një detyrim të papaguar prej 196.8 milion lekë nga 112.3 milionë të raportuara në fund të vitit 2018. Vetëm gjatë vitit 2019, gjendja debitore është rritur me 125.6 milion lekë.

³⁰Në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat" përcaktohet: Kreun II i Ligjit 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar në nenin 6, citon: "Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritjet mbi të ardhurat e individëve.", Në nenin 13 pika 4 të këtij neni citohet "Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2,000,000 (dy milionë) lekë". Neni 4 i ligjit "Burimi i të ardhurave" rendit një sërë kategorish të ardhurash por, pa u kufizuar vetëm në to, pasi kjo hapësirë përfshihet në pikën i) "të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen". Neni 39 "Regjistri i individëve" përcakton se 2. Administrata tatimore qendrore mban regjistër të veçantë të individëve.

	<p>Vetë deklarata (DIVA) nuk parashikon deklarimin individual për çdo punëdhënës në rubrika të veçanta por si një shumë totale nga të gjithë punësimet në rubrikën 3- “të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit” dhe rubrika 4-“tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet e punësimit”. Gjithashtu, deklarata individuale vjetore e të ardhurave, mund të plotësohet edhe nga çdo individ, i cili megjithëse nuk e ka detyrimin ligjor për këtë, për arsye se dëshiron të përfitojë, nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj, kur ky individ plotëson kushtet e përfitimit nga zbritja e shpenzimeve³¹. Në auditimet e mëparshme KLSH ka ngritur çështjen e diskriminimit që kriteri i parashikuar për lindjen e detyrimit të deklarimit të DIVA prekte vetëm një fashë të caktuar të individëve të punësuar, por që është zgjidhur ligjërisht me ndryshimet e parashikuara në Ligjin nr.84/2019 datë 18.12.2019 për një ndryshim në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998, i ndryshuar sipas të cilit bëhet ndryshimi i kriterit për lindjen e detyrimit të deklarimit vjetor individual të të ardhurave në nenin 13 pika 4 shtohet, citojmë “Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit”. Ky ligj nuk ka parashikuar një dispozitë kalimtare për të përcaktuar afatet e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo është rregulluar me Udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhura” i ndryshuar, pika 2.8.1.3 cituar “....Ky parashikim zbatohet për individët të cilët kanë përfituar të ardhura nga punësimi nga më shumë se një punëdhënës duke filluar nga 1 janari 2020”. Ky individ i dy punësuar duhet që, brenda datës 30 prill 2021, të plotësojë deklaratën vjetore të të ardhurave në të cilën të ardhurat mujore nga paga, do të llogariten si total i të ardhurave nga paga nga të gjitha burimet e punësimit të individit.</p> <p>Ndryshimi ligjor i parashikuar dhe cituar sa më lartë, i cili duke filluar nga viti 2020 do të prekë një fashë dhe profil më të gjerë individësh duhet të trajtohet me risk të shtuar jo vetëm në lidhje me ndërjegjësimin për deklarim por veçanërisht për kompleksitetin dhe vështirësitë në plotësimin e deklaratës specifikisht në rubrikën e të ardhurave nga dypunësimi ku individit deklarues i lind detyrimi të bëjë rillogaritjet e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Në shtesë të kësaj, ky vlerësim duhet të bëhet edhe në kuadër të riskut të lartë të mbledhshmërisë që ka mbledhja e detyrimeve të këtyre lloj të ardhurave.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;</p>

³¹Në këtë rast, shuma e të ardhurave bruto vjetore, nga të gjitha burimet duhet të jetë, jo më e madhe se 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit).

	Ligj nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr.94 datë 03.12.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, Ligji nr.39 datë 09.07.2018 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin për Tatimin mbi të ardhurat”; Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Ekziston rreziku i mosplotësimit të këtij detyrimi për shkak të kompleksitetit dhe ënyrës vetëdeklaruese të tij nga shtresa të caktuara individësh të dypunësuar.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Ak-konstatimi nr.14 datë 24.07.2020, për të cilin subjekti ka observuar me dokumentin nr.6272/27 Datë 30.07.2020 si dhe me nr. 6272/18 dt 24.07.2020 me të cilin jam vënë në dijeni më datë 28.07.2019 audituesi ka shprehur qëndrimin e tij në Projekt Raport. Megjithatë me saktësimin e rekomandimit në këtë Raport Përfundimtar nuk ngarkohet me përgjegjësi DAK.

B5. Auditimi i procesit të ekzekutimit të rimbursimit të TVSH. Vlerat, përfituesit kryesor dhe zbatimi i parimit FIFO

Në zbatim të pikës B. 5 të programit të auditimit Nr. 333/1, datë 15.04.2020 për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i rimbursimit sipas sistemit C@TS
- Regjistri i rimbursimit i DRTVSH;
- Pagesat e rimbursimit nga DPThesarit;
- Lista mujore e rimbursimeve dhe evidenca statistikore mbi rimbursimin e tvsh 12 mujore të DRTVSH-se dërguar për Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit/ Sektori i Analizës dhe Statistikës në DPT
- Raport vjetor i DPT për vitin 2019.
- Raportim mbi gjendjen e stokut të rimbursimit në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit
- Shkresat e Drejtorisë së Thesarit Tiranë.
- Database të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.

Baza Ligjore

Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar
Udhëzimi Nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

Ligji Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
Udhëzimi Nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar,

VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar,

Urdhri Nr. 2 datë 13.01.2017 për miratimin e rregullores “Për rimbursimin e tvsh-së mbështetur në analizën e riskut”, të protokolluar me Nr. 939 datë 13.01.2017.

Udhëzimi Nr. 19 datë 3.11.2014 “Për zbatimin e rregjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllim të tatimit mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.

Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut.

Manualin për rimbursimin e TVSH-së.

RIMBURSIMI I TVSH-SË

Gjatë vitit 2019, janë paraqitur kërkesa për rimbursim për 1298 raste në shumën 22,727,737 mijë lekë, nga të cilat pranë DRTVSH-së janë pranuar 983 kërkesa ose kërkesa nga 714 tatimpagues me vlerë të kërkuar për rimbursim 22,707,030 mijë lekë. Krahësuar me vitin paraardhës është rritur kërkesa për rimbursim për më shumë në vlerë 237,878 mijë lekë ose 2.25% më shumë se viti 2018. Gjatë vitit kalendarik nuk janë pranuar 315 kërkesa të dërguara nga 248 tatimpagues në shumën 20,967,123 mijë lekë për mosplotësim të kriterëve ligjorë, pasi nga verifikimi në llogarinë e tatimpaguesit në sistemin tatimor C@TS kërkesa nuk ka plotësuar kriteret ligjorë. Administrata tatimore ka njoftuar tatimpaguesin nëpërmjet formatit F1 “Njoftim për mospranimin e kërkesës për rimbursim të TVSH” duke këshilluar të rregullohet kërkesa në përputhje me kriteret ligjorë dhe më tej të behet një kërkesë e re për rimbursim . Janë tërhequr nga kërkesa për rimbursim 2 kërkesa në shumën 107,929 mijë lekë. Kërkesat e rimbursimit, miratimi dhe pagesa e rimbursimit janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Situata e rimbursimit për kërkesat e vitit 2019 në (000) lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2019		Viti 2018		Viti 2017	
		Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere
1	Kerkesa	1298	22,727,737	987	22,228,422	942	29,279,100
2	Miratuar	983	22,707,030	822	16,600,343	843	21,808,157
3	Rimbursuar/Kompensuar		25,938,414		15,700,536	822	17,541,396
3.1	Me rimbursim Cash		23,509,456		14,396,783		13,872,274
3.2	Me kompensim		2,428,958		1,194,019		1,422,804
4	Pa kontrolluar ose me detyrim sigurime shoqërore			160	3,890,582	83	6,968,687
5	Refuzuar	315	20,707,123	5	207,265	13	101,611
	Terhequr kerkesa	2	107,929	-	-	3	77,999

(Burimi: Raporte statistikore DPT Punoi: KLSH)

Tatimpaguesit me peshe të konsiderueshme për shumën e rimbursuar të tatimit mbi vlerën e shtuar ose që përbëjnë 45.97 % të totalit të rimbursimit, janë kryer për T.A P me vlerë 3.6 miliard lekë ose 13.94 të e totalit, Ac në vlerë 1.6 miliard lekë ose 6.53 % të totalit, BP në vlerë 0.9 miliard lekë ose 3.76 % të totalit, AAE në vlerë 0.6 miliard lekë ose 2.31% të totalit, GEN-1 Tirana në vlerë 0.5 miliard lekë ose 1.84% të totalit, A në vlerë 0.4 miliard lekë ose 1.53% të totalit, T E vlerë 0.4 miliard lekë ose 1.41% të totalit, DC në vlerë 0.4 miliard lekë ose 1.35% të totalit

Në totalin e TVSH-së së rimbursuar gjatë vitit 2019 në shumën 25,938,414 mijë lekë, shumat më të larta të rimbursimit , ekzekutuar nga Dega e Thesarit në mënyrë analitike pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Shumat më të larta të paguara për rimbursim në 2019 (në mijë lekë)

Nr	Subjekti	Paguar Rimbursimi	Totali DPD	%
1	TA	3,616,638	25,938,414	13.94%
2	Ach	1,693,574	25,938,414	6.53%
3	B P	974,662	25,938,414	3.76%

4	G	641,205	25,938,414	2.47%
5	K I	619,835	25,938,414	2.39%
6	A A E	600,000	25,938,414	2.31%
7	G-1	478,060	25,938,414	1.84%
8	Alb	397,218	25,938,414	1.53%
9	T E	364,973	25,938,414	1.41%
10	D C A	349,617	25,938,414	1.35%
11	I M I	278,320	25,938,414	1.07%
12	A E T	272,156	25,938,414	1.05%
13	T A P	270,000	25,938,414	1.04%
14	J V R T	237,339	25,938,414	0.92%
15	B	227,038	25,938,414	0.88%
16	C A	198,232	25,938,414	0.76%
17	S2	186,239	25,938,414	0.72%
18	S	178,463	25,938,414	0.69%
19	A O	170,341	25,938,414	0.66%
20	R I E	169,234	25,938,414	0.65%
	Totali	11,923,144	25,938,414	45.97%

(Burimi: DPT)

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2019 bazuar ne Ligjin Nr. 99/2018 "Për Buxhetin E Vitit 2019", është njohur me planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, me shkresat Nr. 1586 prot; Nr. 1584 prot; Nr. 1577 protokolli, të datës 30.01.2019, protokolluar në DPT me Nr. 2379; Nr. 2378; me Nr. 2259 prot të datës 01.02.2019.

Për 12 mujorin 2019 rimbursimi për TVSH-në ishin programuar 19,000,000 mijë leke realizuar në shumën 23,509,456 mijë lekë duke rezultuar me një tejkalim për 4,509,456 mijë lekë ose 23.7% më shumë kundrejt planit të rimbursimit. Në totalin e TVSH-së së rimbursueshme 23,509,456 mijë lekë , rimbursimi i kryer nga DRTVSH-se në DPT rezulton në shumën 23,466,792 mijë lekë ose 99.82% të totalit dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore kanë rimbursuar 42,664 mijë lekë ose 0.18% te totalit te rimbursimit të dhënë. Të dhënat e mësipërme në mënyrë analitike janë pasqyruar sipas tabelës si më poshtë vijon:

Tabela : Rimbursimi TVSH 2019 (ne mije leke)

Nr	Periudha	Plani 2019	Rimbursimi DRTVSH	Rimbursimi DRT	Totali TVSH	Fakt/Plan	%	Tejkalimi
1	Janar	1,600,000	1,702,901	3,234	1,706,135	106,135	106.63%	6.63%
2	Shkurt	1,700,000	587,097	0	587,097	-1,112,903	34.54%	-65.46%
3	Mars	1,700,000	1,398,576	0	1,398,576	-301,424	82.27%	-17.73%
4	Prill	1,700,000	1,578,767	0	1,578,767	-121,233	92.87%	-7.13%
5	Maj	1,600,000	1,683,132	0	1,683,132	83,132	105.20%	5.20%
6	Qershor	1,600,000	1,645,636	0	1,645,636	45,636	102.85%	2.85%
7	Korrik	1,600,000	1,592,096	0	1,592,096	-7,904	99.51%	-0.49%
8	Gusht	1,500,000	1,677,945	0	1,677,945	177,945	111.86%	11.86%
9	Shtator	1,500,000	2,594,025	28,785	2,622,809	1,122,809	174.85%	74.85%
10	Tetor	1,500,000	1,649,159	2,214	1,651,373	151,373	110.09%	10.09%
11	Nëntor	1,500,000	1,032,611	0	1,032,611	-467,389	68.84%	-31.16%
12	Dhjetor	1,500,000	6,324,846	8,432	6,333,277	4,833,277	422.22%	322.22%
	Totali	19,000,000	23,466,792	42,664	23,509,456	4,509,456	123.73%	23.73%

Për vitin 2019 rimbursimi për TVSH-në është realizuar në shumën 23,509,456 mijë lekë. Në totalin e TVSH-së së rimbursueshme DRTVSH-se në DPT ka rimbursuar 23,466,792 mijë lekë dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore kanë rimbursuar 42,664 mijë lekë. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT ka paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën 4,509,456 mijë lekë ose ka tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim në masën 23.73 % të parashikimit vjetor të rimbursimit.

Në pagesat e shumave të rimbursura sipas sistemit SIFQ dhe fondit të shpenzimeve të miratuar për rimbursim konstatohet:

Tejkalim më të lartë të planit të shpenzimeve të fondeve të rimbursimit për më tepër pagesa në shumën 177,945 mijë lekë ose më shumë në masën 11.86% se plani muajit gusht ; me shumë pagesa në shumën 1,122,809 mijë lekë ose në masën 74.85 % të plani muajit Shtator; me më tepër në shumën 151,373 mijë lekë ose më tepër 10.09% planit muajit Tetor; më tepër pagesa në shumën 4,833,277 mijë lekë ose në masën 322.22 % të planit në muajin Dhjetor 2019.

Mos realizim më të lartë planit muajit të shpenzimeve të rimbursimit rezultojnë pagesat në muajin shkurt për më në shumën 121,233 mijë lekë ose 65.46% më pak se plani; në muajin mars për më pak në shumën 301,424 mijë lekë ose 17.73% më pak se plani; në muajin nëntor për më pak pagesa për shumën 467,389 mijë lekë ose 31.16% më pak se plani.

Në kërkesat për rimbursim të kërkuara në DRTVSH në DPT, peshën më të madhe të shumës së rimbursuar sipas DRT-re e zënë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në shumën 15,611,305 mijë ose 66.53% e totalit, DRT Tiranë në shumën 2,737,140 mijë lekë ose 11.66 % e totalit, DRT Durrës në shumën 1,736,816 mijë lekë ose 7.40% e totalit, DRT Fier në shumën 1,043,000 mijë lekë ose 4.44 % e totalit. DRTVSH raporton edhe rimbursimet për TVSH të kryera nga vetë drejtoritë rajonale. Gjatë vitit kanë kryer rimbursime Drejtoritë Rajonale Tatimore Durrës në shumën 10,645 mijë lekë, DRT Gjirokastrë në shumën 1,374 mijë lekë, nga DRT Tiranë në shumën 30,643 mijë lekë në total 42,663 mijë lekë.

Të dhënat e mësipërme të kërkesave për rimbursim të kërkuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe trajtuara nga DRTVSH-së në këtë drejtori në mënyrë analitike sipas DRT-re, janë pasqyruar sipas tabelave si më poshtë vijon:

Pagesat për rimbursimin e TVSH-së Janar-Dhjetor 2019 (në mijë lekë)

Nr	Periodha	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve		Total DPT
		Pagesa/ Aparati	Pagesa / DRT	
1	Janar	1,702,901	3,234	1,706,135
2	Shkurt	587,097	-	587,097
3	Mars	1,398,576	-	1,398,576
4	Prill	1,578,767	-	1,578,767
5	Maj	1,683,132	-	1,683,132
6	Qershor	1,645,636	-	1,645,636
7	Korrik	1,592,096	-	1,592,096
8	Gusht	1,677,945	-	1,677,945
9	Shtator	2,594,025	28,785	2,622,809
10	Tetor	1,649,159	2,214	1,651,373
11	Nëntor	1,032,611	-	1,032,611
12	Dhjetor	6,324,846	8,432	6,333,277
	Totali	23,466,792	42,664	23,509,456

(Burimi: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH)

Rimbursimet e kryera nga DRTVSH –se 2019

(në milion lekë)

DRT	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Berat	37	53	0	35	69	12	15	24	81	74	-	17	418
Diber	25	9	15	0	-	-	63	4	-	78	-	-	193
Durres	266	64	67	45	134	148	115	120	314	103	176	185	1,737
Elbasan	78	9	43	20	6	31	25	48	62	3	-	36	363
Fier	98	84	212	10	59	117	25	64	181	113	6	74	1,043
Gjirok.	2	0	2	35	23	-	5	0	22	30	7	18	145
Korça	18	26	8	6	32	46	9	30	58	4	1	18	257
Kukes	0	-	-	-	-	24	-	-	42	-	-	-	66
Lezha	5	-	-	18	5	35	-	16	8	-	2	5	94

Sarand	4	1	-	-	-	-	11	7	8	56	-	2	89
Shkodr	41	9	3	39	26	52	3	10	91	27	-	33	335
Tirana	322	116	134	343	313	115	204	202	328	240	150	269	2,737
DRTM	787	195	896	1,022	931	1,024	1,069	1,125	1,355	913	663	5,632	15,611
Vlora	20	19	19	5	85	41	49	26	44	9	28	34	378
Shuma	1,703	587	1,399	1,579	1,683	1,646	1,592	1,678	2,594	1,649	1,033	6,325	23,467

(Burimi: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH)

Rimbursimet e kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore 2019 (ne mije leke)

DRT	Janar	Shku	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Shuma
Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,213	-	8,431	10,645
Gjirokastrë	1,374	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,374
Tirana	1,859	-	-	-	-	-	-	-	28,78	-	-	-	30,643
Shuma	3,233	-	-	-	-	-	-	-	28,784	2,213	-	8,431	42,663

(Burimi: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH) në DPT)

Në përmbushje të rimbursimit të TVSh-së brenda afateve ligjore dhe alokimit të fondeve për rimbursim të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë rezultojnë se në 3- muajin I-rë shuma e fondeve të akordura është 5,000,000 mijë lekë shuma e fondeve të rimbursuara është 3,688,576 mijë lekë, duke rezultuar me mos përdorim fondi në shumën 1,311,424 mijë lekë ose 26.23% më pak se plani rimbursimeve. Në 3 muajin e II-te, III-të dhe të IV-ët rezultojnë se shuma e fondeve të rimbursuara ka qenë më e lartë se shuma e fondeve të planifikuara si më poshtë vijon:

- Shuma e fondeve të miratuara nga MFE për në periudhën Prill- Qershor rezultojnë në shumën 4,900,000 mijë lekë dhe shuma e fondeve të rimbursuara rezultojnë në shumën 4,907,535 lekë, duke rezultuar me tejkalim fondi për shumën 7,535 mijë lekë ose 0.15 % më shumë se plani. Kjo situatë rezultojnë edhe Korrik-Shtator në të cilin shuma e fondeve të planifikuara për këtë tremujor rezultojnë në shumën 4,600,000 mijë lekë dhe shuma e fondeve të rimbursuara rezultojnë në shumën 5,864,065 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim fondi në shumën në shumën 1,264,065 mijë lekë ose 27.48 % më shumë se plani. Më tej në Tetor- Dhjetor shuma e planifikuara për rimbursim rezultojnë 4,500,000 lekë dhe shuma e rimbursuar rezultojnë 9,006,616 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim fondi në shumën 4,506,616 mijë lekë ose 100.15 % më shumë se plani rimbursimit.

Për shumën e rimbursuar në total 23,466,793 mijë lekë, Drejtoria e Rimbursimit të TVSh-së referuar kategorive të tatimpaguesve ka rimbursuar eksportues 406 raste në shumën 3,695,028 mijë lekë ose 15.75% e totalit, eksportues fasonë për 270 raste në shumën 1,911,484 mijë lekë ose 8.15 % të totalit, grumbullues për 144 raste në shumën 1,404,997 mijë lekë ose 5.99% të totalit, tatimpagues për kërkesa për rimbursim mbi 150 milion dhe investitorë për kërkesa për 198 raste në shumën 12,787,742 mijë lekë ose 54.49 % të totalit dhe kategoria “Të tjerë” janë rimbursuar për 342 raste në shumën 3,667,541 mijë lekë ose 15.63% e totalit.

Plani i miratuar 3-mujor dhe rimbursimi 2019 (ne mije leke)

Miratim për Likuidim	Plani i miratuar për rimbursim	Shuma rimbursuar	Nr. subjekteve qe likuidohen	Shuma e mbetur ne fund tremujori	Exportues	Grumbull	Fason	Te tjerë	VIP me këste
Janar – Mars	5,000,000	3,688,576	292	1,311,424	700,182	560,475	552,508	520,267	1,355,144
Prill-Qershor	4,900,000	4,907,535	295	(7,535)	932,804	414,566	619,047	732,684	2,208,433
Korrik-Shtator	4,600,000	5,864,065	444	(1,264,065)	1,320,808	176,723	529,039	1,037,566	2,799,929
Tetor-Dhjetor	4,500,000	9,006,616	329	(4,506,616)	741,235	253,232	210,889	1,377,024	6,424,236
	19,000,000	23,466,792	1,360	(4,466,792)	3,695,028	1,404,997	1,911,484	3,667,541	12,787,742
METODA					FIFO	FIFO	FIFO	KESTE	KESTE

(Burimi: DPT)

Në konkluzion: Shpenzimet në pagesat e rimbursimeve kanë tejkaluar dukshëm planin e rimbursimeve për më shumë se shumën në shumën 4,466,792 mijë lekë, për pagesat e kryera për tremujorin e II-të në shumën 7,535 mijë lekë ose +0.15%, për tremujorin e III-të në shumën

1,264,065 mijë lekë të planit ose +27.48 % më shumë se plani, për tremujorin e IV-ët në shumën 4,506,616 mijë lekë ose +100.15% më shumë se plani, veprime këto në kundërshtim me nenin 14 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

TATIMPAGUES TË RIMBURSUAR ME METODËN FIFO.

KATEGORIA EKSPORTUES.

Për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit Nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, si neni 10 në VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” kategoritë e eksportuesve konsiderohen personat e tatueshëm eksportues, si dhe personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor. Në këndvështrim të kësaj dispozite për qëllime të rimbursimit të TVSH-së kategoritë e eksportuesve pas përmbushjes së kriterëve ligjore (4 kriterë) kategorizohen në 3 grupe eksportuesish, **Eksportues me risk zero**; Eksportues me vlerë eksporti 50%-70% të vlerës së shitjeve vjetore, të cilët rimbursohen brenda 30 ditëve duke ju nënshtruar më parë analizës së riskut; Eksportues të tjerë që nuk klasifikohen me risk zero ose me vlerë eksporti 50%-70% të vlerës së shitjeve vjetore, të cilët rimbursohen brenda 60 ditëve duke ju nënshtruar më parë analizës së riskut

Në kuadër të auditimit dhe zbatimit të procedurës së rimbursimit, sipas të dhënave “Raport mbi pagesat e rimbursimit 2019” të DRTVSH-se, rezulton se gjatë vitit 2019 janë rimbursuar në total 820 raste rimbursimesh në shumën e paguar 7,011,508 mijë lekë. Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2019 pagesat për rimbursim janë kryer afatit ligjor 30 ditë për kategoritë e eksportues për 406 raste paguar në shumën 3.695.029 mijë lekë për 36-456 ditë vonesë, për kategoritë riekportues të mallrave jo shqiptare ose “Fason”, ka paguar për rimbursim 270 raste në shumën 1.911.484 mijë lekë për 46-778 ditë vonesë, për këtë grumbullues - eksportuesish për 144 raste është paguar shuma 1,404,997 mijë Lekë për 50-557 ditë vonesë, veprime këto në mospërputhje me nenin 10 të VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Grafikisht mënyrë sintetike sipas vlerës paraqiten si më poshtë vijon:

Pagesat për kategorinë eksportues (në mijë lekë)

Miratim për Likuidim	Eksportues	Grumbullues	Fasonë	Totali
Janar – Mars	700,182	560,475	552,508	1,813,165
Prill-Qershor	932,804	414,566	619,047	1,966,417
Korrik-Shtator	1,320,808	176,723	529,039	2,026,570
Tetor-Dhjetor	741,235	253,232	210,889	1,205,356
Totali pagesave	3,695,028	1,404,997	1,911,484	7,011,508
Metoda	FIFO	FIFO	FIFO	

(Burimi: DPT Punoi KLSH)

Eksportues: Nga auditimi i praktikave të rimbursimit u konstatua se për kategoritë e eksportues për kërkesa në shumën 4.134.273 mijë lekë, janë paguar rimbursim 3.695.029 mijë lekë për 406 raste, jashtë afatit ligjor 30 ditë ose 36-456 ditë vonesë.

Gjatë vitit janë paguar kërkesa të miratuara vitit ushtrimor dhe kërkesa të miratuara dhe të parimbursuara të periudhave të mëparshme. Sipas viteve kalendarik rezulton se për kërkesa të parimbursuara të vitit 2018 në shumën 1,657,473 mijë lekë janë paguar për 118 raste në shumën e paguar 1,359,525 mijë lekë në shkelje të afatit ligjor 30 ditë ose për 45-466 ditë-vonesë. Kërkesa e vitit 2019 rezulton në shumën 2,476,800 mijë lekë nga e cila për 288 raste është paguar shuma 2,335,504 mijë lekë për 36-334 ditë – vonesë.

Nga verifikimi afatit të kryerjes së pagesës rezulton se pagesat për rimbursim nuk janë rimbursuar brenda 30 ditëve kalendarike ose janë rimbursuar me 36-144 dite-vonesë, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 10.2 të VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Grafikiht mënyrë sintetike sipas rasteve dhe sipas vlerës paraqiten si më poshtë vijon:

Eksportues, pagesa per rimbursim (në raste)

Viti	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Total
2018	32	13	12	21	28	8	3	1	-	-	-	-	118
Jan		1											1
Feb	1				1								2
Apr	1						1						2
May	3	2		1									6
Jun	9	1				1							11
Jul	8	1		1									10
Aug	2	5	2		1								10
Sep		1	4	3	1			1					10
Oct	7		3	9									19
Nov	1	1	3	7	7	2	1						22
Dec		1			18	5	1						25
2019	-	-	-	-	2	28	9	28	127	31	19	44	288
Jan					2	10	4	3	2			1	22
Feb						18	2	3	4	1			28
Mar							3	5	2				10
Apr								17	13				30
May									55		1	1	57
Jun									29	2	1		32
Jul									22	7	2	3	34
Aug										20	4		24
Sep										1	11	15	27
Oct												11	11
Nov												12	12
Dec												1	1
Total	32	13	12	21	30	36	12	29	127	31	19	44	406

(Burimi: DPT Punoi KLSH)

Eksportues, pagesa sipas muajve (në milion lekë)

Viti	shuma e kërkuar	shuma e paguar	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
2018	1,657	1,360	396	93	210	317	241	76	25					
Jan	4	4	-	4	-	-	-	-	-	-				
Feb	11	4	4	-	-	-	0	-	-	-				
Apr	36	25	8	-	-	-	-	-	17	-				
May	87	41	8	30	-	3	-	-	-	-				
Jun	116	86	76	8	-	-	-	2	-	-				
Jul	70	63	48	4	-	11	-	-	-	-				
Aug	101	59	5	23	29	-	2	-	-	-				

Sep	99	92	-	2	15	59	16	-	-	0				
Oct	442	390	243	-	13	134	-	-	-	-				
Nov	450	347	4	5	153	111	61	10	3	-				
Dec	241	248	-	17	-	-	162	64	4	-				
2019	2,477	2,336	0	0	0	0	22	277	59	233	1,004	237	171	333
Jan	173	154					22	78	31	11	8	0	0	6
Feb	242	237						199	12	13	10	2	0	0
Mar	62	52							16	24	12	0	0	0
Apr	349	313								185	127	0	0	0
May	416	400									398	0	2	1
Jun	389	376									308	62	6	0
Jul	203	190									140	30	14	7
Aug	180	167										142	25	0
Sep	326	318										2	125	192
Oct	77	73												73
Nov	58	53												53
Dec	2	2												2
Total	4,134	3,695	396	93	210	317	263	353	83	234	1,004	237	171	333

(Burimi: DPT Punoi: KLSH)

Për eksportuesit, për periudhën Janar –Mars 2019 për shumatat e miratuara për rimbursim, në pagesën e kërkesave për rimbursim sipas metodës FIFO nuk është zbatuar radha në kryerjen e pagesave, referuar Udhëzimit Nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Nga testimi rezultoi se është zbatuar radha e pagesave për periudhën Prill- Dhjetor 2019, më përjashtim të dy- tre pagesave që kanë pagesa pjesore me dy pagesa. Për ilustrim po paraqesim disa kërkesa të miratuara me datë miratimi dhe të paguara janar-prill 2019.

Pagesa për tvsh të miratuar (në mijë lekë)

Datë miratimi	Jan	Feb	Mar	Apr
9/18/2018	1,552			
9/19/2018	4,606			
9/20/2018		3,506		
9/25/2018	8,538			
9/26/2018		7,120		
9/28/2018		1,051		
9/29/2018	1,449			
10/1/2018		8,574		
10/5/2018		3,717		
10/8/2018		1,885		
10/10/2018		3,369		
10/11/2018	4,820			
10/16/2018		8,111		52,195
10/17/2018		30,000		
10/18/2018			6,580	
10/19/2018			3,640	
10/22/2018		3,590	3,034	

(Burimi : DRTVSH Punoi: KLSH)

Eksportues me risk zero sipas VKM 953/2014 neni 10 pika 2, konsiderohen tatimpaguesit të cilët janë personat e tatueshëm eksportues, si dhe personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv dhe plotësojnë njëkohësisht kriteret: a) Vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet; b) Kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit; c) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit,

lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë; ç) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Sipas këtij paragrafi kjo kategori eksportuesish duhet të rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së si persona me risk zero.

Në zbatim të VKM 953/2014 neni 10 pika 3, eksportues me risk zero janë personat të cilët duhet të rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së. Bazuar në evidencat e rimbursimit të dhëna nga DRTVSH, rezulton se gjatë vitit 2019 janë paguar për rimbursim 11 subjekte ose 21 raste në shumën 216,620 mijë lekë për kërkesa rimbursimi të paraqitura gjatë vitit 2019.

Për eksportuesit me risk zero, me përjashtim të kërkesave të paraqitura në muajin dhjetor, pagesat për rimbursim nuk janë rimbursuar automatikisht brenda 30 ditëve kalendarike ose janë rimbursuar me 36-144 dite-vonese, veprime këto në mospërputhje me nenin 10.2 të VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Për këtë kategori eksportuesish në pagesën e kërkesave për rimbursim sipas metodës FIFO është zbatuar radha në kryerjen e pagesave, më përjashtim të një rasti për shumën 8.258 mijë miratuar 14.11.2019 dhe sipas radhës duhet të paguhej në nëntor por në fakt është paguar në dhjetor. Të dhënat e pagesave për eksportuesit me risk zero, grafikiht paraqiten si me poshtë vijon:

Pagesa me metoden FIFO për eksportues me risk zero (në mijë lekë)

VITI	Kërkuar	Paguar	Apr	May	June	July	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
2019											
Apr	53,421	53,421					53,421				
May	45,485	41,962						41,962			
Jun	12,641	10,419						10,419			
Jul	26,158	23,499						23,499			
Aug	22,287	15,160							10,179	4,981	
Sep	46,598	46,598								26,070	20,528
Oct	6,627	6,627									6,627
Nov	17,385	17,359									17,359
Dec	1,820	1,576									1,576
Total	232,422	216,620					53,421	75,880	10,179	31,051	46,089

(Burimi: DRTVSH Punoi : KLSH)

Pagesa per tvsh të miratuar (në mijë lekë)

Data miratimit ^e	May	Jun	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Total
4/10/2019	2,492							2,492
4/12/2019	50,929							50,929
5/6/2019		3,249						3,249
5/13/2019		12,320						12,320
5/14/2019		3,452						3,452
5/20/2019		9,479						9,479
5/24/2019		13,462						13,462
6/7/2019		10,419						10,419
7/1/2019			12,097					12,097
7/11/2019			11,402					11,402
8/19/2019				10,179				10,179
8/28/2019					4,981			4,981
9/17/2019					26,070			26,070
9/30/2019						20,528		20,528
10/15/2019						6,627		6,627
11/14/2019							8,258	8,258
11/18/2019						7,750		7,750
11/20/2019							518	518
11/25/2019							833	833

12/3/2019							1,576	1,576
Total	53,421	52,381	23,499	10,179	31,051	34,905	11,185	216,620

(Burimi: DRTVSH Punoi : KLSH)

Në kërkesat e miratuara për eksportuesit me risk zero konstatohet se i njëjti tatimpagues, sipas kërkesave për rimbursim, here klasifikohet si eksportues me risk zero here si eksportues të tjerë. Kjo dukuri evidentohet në kërkesat e paraqitura nga tatimpaguesit E G me NIPT JXXXXXXK për kërkesat datë 10.04.2019; 11.05.2018; nga tatimpaguesi D F me NIPT LXXXXXXK për kërkesat me date 12.04.2019; 05.07.2019 dhe 25.09.2019, për kërkesat 07.06.2019 dhe 19.07.2019; për tatimpaguesit A S shpk me NIPT JXXXXXXV për kërkesat me date 13.05.2019; datë 17.08.2018 dhe datë 17.09.2019; për tatimpaguesin A me NIPT LXXXXXXG për kërkesat 12.04.2019 dhe 30.09.2019, për tatimpaguesin R P me NIPT LXXXXXXQ për kërkesat datë 25.11.2019 dhe 30.11.2019.

Në këndvështrim të kësaj dispozite citojmë: “neni 10 pika 2: Personat e tatueshëm, që plotësojnë kriteret sipas pikës 1, të këtij neni, rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, si persona me risk zero.” Pra akti normativ ka konsideruar me risk zero personin që nënkupton “personin juridik” dhe jo kërkesën për rimbursim siç është konceptuar dhe zbatuar nga administrata tatimore dhe për pasojë rezulton se ajo nuk ka zbatuar drejt kategorizimin e eksportuesve si persona me risk zero dhe jo kërkesa me risk zero si është aplikuar në praktikën e rimbursimit. Te dhënat e pagesave për rimbursim të kategorizuar me/pa risk zero, grafiku paraqiten si më poshtë vijon:

Pagesa për eksportues me/pa risk zero (në mijë lekë)

Subjekti	Lloji i Aktivitetit	DRT	Data e kërkesës për rimbursim	Shuma e kërkuar për rimbursim	Data e miratimit të kërkesës për rimbursim	Shuma e miratuar për rimbursim	Data e rimbursimit
A S	Eksportues Me Risk Zero	TIRANE	13/05/2019	12,320	11/06/2019	12,320	9/27/2019
A S	Eksportues	DTM	13/08/2019	9,969	12/09/2019	9,969	10/31/2019
A S	Eksportues Me Risk Zero	DTM	17/09/2019	11,816	15/10/2019	11,816	11/27/2019
A S	Eksportues Me Risk Zero	DTM	14/11/2019	8,258	11/12/2019	8,258	31/12/2019
E G	Eksportues	ELBASAN	11/05/2018	5,818	11/10/2018	4,820	25/01/2019
E G	Eksportues Me Risk Zero	ELBASAN	10/04/2019	2,492	22/05/2019	2,492	8/30/2019
D F	Eksportues Me Risk Zero	DTM	12/04/2019	50,929	22/05/2019	50,929	8/30/2019
D F	Eksportues	FIER	5/07/2019	17,932	01/08/2019	17,932	9/30/2019
D F	Eksportues Me Risk Zero	DTM	28/08/2019	12,108	16/10/2019	4,981	11/27/2019
E S	Eksport	DTM	19/07/2019	2,197	22/08/2019	2,197	9/30/2019
E S	Eksportues Me Risk Zero	TIRANE	20/05/2019	12,534	20/06/2019	9,479	9/27/2019
E S	Eksportues Me Risk Zero	TIRANE	07/06/2019	12,641	27/06/2019	10,419	9/27/2019
E S	Eksport-Fasonë	DTM	20/11/2019	6,343	12/11/2019	3,407	31/12/2019
R P	Eksportues	DURRËS	31/10/2018	745	27/11/2018	745	15/04/2019
R P	Eksportues Te Tjerë	DURRËS	2/07/2019	1,784	05/08/2019	1,784	9/30/2019
R P	Eksport Pr. Plastike	DURRËS	9/25/2019	754	24/10/2019	754	31/12/2019
R P	Eksportues Me Risk Zero	DURRËS	25/11/2019	833	12/10/2019	833	31/12/2019

(Burimi: DRTVSH Punoi: KLSH)

Në konkluzion: Për eksportuesit me risk zero, me përjashtim të kërkesave të paraqitura në muajin dhjetor, pagesat për rimbursim nuk janë rimbursuar automatikisht brenda 30 ditëve kalendarike ose janë rimbursuar me 36-144 dite-vonese, veprime këto në mospërputhje me nenin 10.2 të VKM

953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Për këtë kategori eksportuesish në pagesën e kërkesave për rimbursim sipas metodës FIFO është zbatuar radha në kryerjen e pagesave, më përjashtim të një rasti për shumën 8.258 mijë miratuar më 14.11.2019 dhe sipas radhës duhet të paguhej në nëntor por në fakt është paguar në dhjetor. Drejtoria e Rimbursimit nuk konsideron me “Risk zero” personin juridik , por kërkesën e tatimpaguesit sipas rastit, në kundërshtim me kërkesat e VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, sipas të cilit me risk zero përcakton “personin” që nënkupton personin juridik dhe jo kërkesën për rimbursim siç është konceptuar dhe zbatuar nga administrata tatimore .

Eksportues Fasone konsiderohen aktivitetet e klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv, tërësisht të destinuara për ri-eksport sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 92/2014 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH, i ndryshuar, neni 57 germa “ç” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar, në nenin 48 pika b, në zbatim të tij. VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R Sh”, i ndryshuar”, neni 10 pika 3 përcakton, citojmë : “Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t’i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Në të kundërt, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.”

Gjatë vitit 2019 **janë kryer pagesa për rimbursim:** të vitit 2016 në shumën e kërkuar 1 013 mijë lekë dhe paguar në një rast në shumën 337 mijë lekë, ose me vonese 778 dite vonese ; të vitit 2017 në shumën e kërkuar 8.447 mijë lekë dhe paguar në një rast në shumën 102 mijë lekë, ose me vonese 680 dite vonese; të vitit 2018 në shumën e kërkuar 1,034,866 mijë lekë dhe paguar në 135 raste në shumën 956,725 mijë lekë, ose me vonese 47-460 dite vonese; të vitit 2019 në shumën e kërkuar 1,031,141 mijë lekë dhe paguar në 130 raste në shumën 954,321 mijë lekë, ose me vonese 46-307 dite vonese ;

Nëse do të referohemi këtij sistemi për datën 31.12.2019 nuk sigurojmë të dhëna mbi gjendjen e shumave të miratuara, pasi në momentin e miratimit përfundimtar zbriten nga sistemi C@TS dhe kjo shumë del jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim.

Kjo drejtori nuk ka kryer raportime me bazë tremujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi sipas dokumentit standard “Shtojca 4”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues Nr.1, datë 17.09.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", pika III, paragrafi 117. E vetmja evidencë për audituesin mbetet raportimi mbi gjendjen e stokut të rimbursimit nga DRTVSH në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabiliteti në datën 31.12.2019 në shumën 11,251,390 mijë sipas shkresës Nr. 4480 prot, datë 27.02.2020.

Në këtë evidencë raportohen rimbursimet e miratuara për katër subjekte të kategorisë tatimpagues të mëdhenj, për të cilët përdoret pagesë me këste. Këto rimbursime të miratuara i përkasin viteve 2018-2019. Në stokun e raportuar nuk janë evidentuar kërkesat e pranuar por të pa miratuara për rimbursim edhe pse ato janë në tejkallim të afatit ligjor 30/60 ditë të përcaktuar me ligj për rimbursim në shumën 1,653,275 mijë lekë. Kjo bie në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, referuar nenit 75/1 pika 1, konsideron detyrim të papaguar të gjitha kërkesat që kanë kaluar afatin 30/60 ditë, afat brenda të cilit drejtoria rajonale e tatimeve verifikon situatën tatimore të tatimpaguesit, ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut dhe miraton tepricën kreditore si të rimbursueshme.

Pra sa më sipër në evidencë e kërkesave në proces paraqitur nga DPT, u grupuan vetëm kërkesat në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor, llogaritur në shumën 4,488,526 mijë lekë “Kërkesa për rimbursim me mbi 30 ditë vonese”, shumë e cila nga DPT nuk konsiderohet stok edhe pse në tejkallim të afatit ligjor, pra konsiderohen kërkesa “në proces miratimi”. Në gjykimin e KLSH-së, për të paktën 36 raste në vlerë kërkesë **1,653,275 mijë** lekë procesi i rimbursimit duhej të kishte përfunduar pasi ata janë kryesisht tatimpagues eksportues, grumbullues, eksportues fason etj. dhe shkelja e afatit të miratimit është e pajustificuar.

Në vijim u vlerësua stoku i detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-së për vitin 2019 për disa tatimpagues të mëdhenj:

Për tatimpaguesin me NIPT B P, nga auditimi rezultoi se megjithëse tatimpaguesi raportohet nga DPT si i rimbursuar plotësisht, me kërkesën nr.406 datë 09.01.2019 është e kërkuar për rimbursim shuma 752,807 mijë lekë, që i përket tepricës kreditore për periudhën maj 2018 deri nëntor 2018. Analizuar sipas periudhave tatimore, në sistemin C@TS rezulton se në periudhën tatimore qershor 2018 për shumën e rimbursueshme të aprovuar 119,096 mijë lek janë paguar 100,000 mijë dhe ka mbetur aprovuar e pa përdorur shuma 19,096 mijë lekë. E njëjta situatë paraqitet në periudhën tatimore shkurt 2019 për shumën e rimbursueshme të aprovuar 231,259 mijë lekë janë paguar 200,000 mijë dhe ka mbetur aprovuar e pa përdorur shuma 31,259 mijë lekë. Të dy rastet e testuar tregojnë se **në total për këtë kërkesë shuma 50,354 mijë lekë do të përdoret në të ardhmen nga tatimpaguesi**. Kjo vlerë përbën stok të padeklaruar pasi rimbursimi nuk është kryer në shumën e plotë të aprovuar, pra detyrimi nuk është mbyllur.

Për tatimpaguesin B P, gjatë vitit paraqet për kërkesat e pranuar dhe miratuara administrata tatimore në fund vitit raporton gjendje stoku zero lekë, pasi nga DPT konsiderohet që janë shlyer

të gjitha vlerat e dakordësuara në formën e pagesave me këste. Po sipas databazës së sjellë nga Drejtoria e Rimbursimit pranë DPT, konstatohet, se për dy kërkesa gjatë vitit 2019, vlerat e miratuara për rimbursim nuk janë paguar të plota. Nga databaza rezulton se për kërkesën e datës 01.01.2019 detyrimi i pa shlyer vlerësohet në shumën 679,110 mijë lekë dhe për kërkesën e datës 28.05.2019 detyrimi i pa shlyer vlerësohet në shumën 633,340 mijë lekë. **Detyrimi në total prej 1,312,450 mijë lekë rezulton të mos jetë raportuar në stokun e detyrimeve** nga DPT-së. Edhe nëse për këto vlera do të kishte dakordësim për tu kompensuar në një moment të mëvonshëm, KLSH gjykon se vlera duhet të ishte paraqitur në stokun e deklaruar në 31.12.2019

Për tatimpaguesin K, raportohet vetëm një kërkesë për pagesë me këste. Vlerat e miratuara për rimbursim përgjatë vitit 2019, nuk janë paguar të plota, pasi në data bazë këstet e paguara për kërkesën e datës 17.07.2018 në shumën 1,160,228 mijë lekë, e cila është miratuar në 21.01.2019 janë vetëm 649,835 mijë lekë duke rezultuar në një detyrim të mbetur në shumën 510,393 mijë lekë. Ky detyrim nuk është paraqitur në stokun e detyrimeve të raportuar nga DPT duke nënvlerësuar stokun e detyrimeve me 510,393 mijë lekë. Edhe nëse për këto vlera do të kishte dakordësim për tu kompensuar në një moment të mëvonshëm, KLSH gjykon se vlera 510,393 mijë lekë duhet të ishte paraqitur në stokun e deklaruar në 31.12.2019

Si konkluzion, pas testimin të 3 tatimpaguesve të cilët kanë nivelin më të lartë të pagesave me këste, u konstatuan vlera të pasakta të deklarimit të stokut si dhe mos deklarim i shumës së TVSH së miratuar, aprovuar për kompensim, shumë që mbetet për tu përdorur në periudhat e ardhshme. Pra bazuar sa më lart, vlera e stokut të deklaruar nga DPT në shumën 11,251,390 mijë lekë është e nënvlerësuar me të paktën 3,526,472 mijë lekë. Këto testime ndryshojnë raportimin e stokut nga organi tatimor në **shumën 14,777,862 mijë vlerësuar nga KLSH.**

Rakordimi me degën e thesarit në bazë të SIFQ

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nëpërmjet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-SË në DPT, brënda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim dhe 30 ditëve për tatimpaguesit eksportues, kryejnë procedurën e rimbursimit dhe miraton tepricën e TVSH-së sipas udhëzimi Udhëzim Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. Pas miratimit të shumës së TVSH-së për t’u rimbursuar plotësohet urdhër-pagesa për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm dhe të dhëna të tjera sipas formatit Nr. 4 të urdhërpagesës bashkëngjitur dhe së bashku me njoftimin në përputhje me formatin Nr. 3, pasi nënshkruhen nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, i dërgohen degës përkatëse të thesarit në dy kopje. Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vulolet nga dega e thesarit, i kthehet DRTVSH-së në DPT.

Drejtorja e Rimbursimit të TVSH-së ka detyrim ligjor të rakordojë me degën e thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare lidhur me TVSH-në referuar UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nenin 75 pika 2.6.

Manuali i Rimbursimit i rimbursimit të TVSH-së në paragrafin “Dërgimi i miratimit të shumës dhe urdhër pagesave në thesar për kryerjen e rimbursimit” percakton se Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së rakordon me degën e thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të thesarit) njofton zyrtarisht/elektronikisht Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT. Dega përkatëse e Thesarit, regjistron UPR-në në SIFQ dhe paguan brënda 5 ditëve nga data e paraqitjes nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme.

Nga të dhënat e sistemit SIFQ, nuk u konstatuan tejkalime në afatin 5 ditor të pagës së UPR. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të thesarit) njofton zyrtarisht/elektronikisht Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, Dega e Thesarit Tiranë me shkresat ka dërguar në DPT informacion periodik progresiv me shkresa përkatëse të cilat mbajnë numrin e protokollit të çdo institucioni. Nga auditimi rezultoi se ka informacion periodik mujor për periudhën Janar- Dhjetor 2018, me përjashtim të shkresës për periudhën Janar- Mars 2019 e cila nuk u paraqit nga si dokument.

Nga auditimi rezultoi se nga DRTVSH-se nuk u paraqit rakordim mujor për rimbursimet e tvsh-se kaluar nëpërmjet SIFQ, veprime në kundërshtim me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nenin 75 pika 2.6 dhe Manuali i Rimbursimit rimbursimit të TVSH-së në paragrafin “Dërgimi i miratimit të shumës dhe urdhër pagesave në thesar për kryerjen e rimbursimit”. DRTVSH-së me shkresën Nr. 19897 prot, datë 29.10.2019, dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit është kërkuar rakordim mujor për rimbursimet e TVSH-së, në të cilin te shtohet edhe një tabelë përmbledhëse ku të evidentohet për çdo tatimpagues shuma e rimbursimit të kryer, e cila duhet të firmoset nga Drejtori i Rimbursimit të TVSH dhe personi përgjegjës pranë drejtorisë së Thesarit. Nga DRTVSH-se, nuk u paraqit rakordim mujor për urdhër pagesat e ekzekutuara nga Dega e Thesarit në sistemin SIFQ, kjo si detyrë funksionale e pazbatuar e Drejtorit të DRTVSH.

Në lidhje me pagesat e rimbursimit, Dega e Thesarit Tiranë ka dërguar në formë shkresore pagesat progresive të rimbursimit dërguar, të evidentuara në tabelën si më poshtë vijon:

Shpenzime rimbursimi progresive viti 2019 (në mijë lekë)

Dega e Thesarit Tiranë	Protokolluar në DPT	Periudha	Llogaria ekonomike	Shpenzime faktike me thesar DRTVSH	Shpenzime të kaluara në banke	Shpenzime kaluar me banke
709, dt 31.01.2019	2491, dt 04.02.2019	Janar-Dhjetor 2018	7030100	14,244,008	599,282	13,644,725
1467, dt 27.02.2019	4631, dt 04.03.2019	Janar- Janar 2019	7030100	1,702,901	0	1,702,901
1884, dt 18.03.2019	6072, dt 21.03.2019	Janar- Shkurt 2019	7030100	2,289,999	0	2,289,999
mungon	mungon	Janar- Mars 2019	7030100	3,688,575	0	3,688,575
3311, dt 13.05.2019	10145, dt 16.05.2019	Janar - Prill 2019	7030100	5,267,343	0	5,267,343
3998, dt 11.06.2019	11751, dt 12.06.2019	Janar- Maj 2019	7030100	6,950,475	0	6,950,475
4456, dt 08.07.2019	13511, dt 14.07.2019	Janar -Qershor 2019	7030100	8,596,111	0	8,596,111
5011/1, dt 08.03.2019	17192, dt 16.09.2019	Janar-Korrik 2019	7030100	10,188,207	0	10,188,207
5435/1, dt 09.09.2019	16919, dt 16.09.2019	Janar-Gusht 2019	7030100	11,866,152	183,035	11,683,117
6208, dt 10.10.2019	19109, dt 18.10.2019	Janar -Shtator 2019	7030100	14,460,176	1,186,704	13,273,473
7268, dt 21.1.2019	21514, dt 25.11.2019	Janar-Tetor 2019	7030100	16,109,336	1,419,159	14,690,176
7748, dt 12.12.2019	22439, dt 16.12.2019	Janar-Nëntor 2018	7030100	17,141,946	0	17,141,946
231, dt 09.01.2020	417, dt 13.01.2020	Janar-Dhjetor 2018	7030100	23,466,792	0	23,466,792

(Burimi: Shkresat mujore të Degës së Thesarit Tiranë)

Grupi i auditimit të KLSH-së për vitin 2019, për shkak të mos disponimit të Akt- Rakordimit me degën e thesarit, bazuar në dokumentacion “Urdhër Pagesave” të konfirmuara të paguara nga thesari dhe database të dërguar nga KLSH për pagesat nga Dega e Thesarit Tiranë, rakordoi pagesat e kryera për çdo muaj, nga ku rezultoi se shuma e rimbursuar nga DRTVSH është 23,466,792 mijë lekë dhe shuma e rimbursuar nga DRT-re është 42,664 mijë lekë. Në total DPT ka rimbursuar nëpërmjet thesarit në total shumën 23,509,456 mijë lekë dhe rakordon me

shpenzime për rimbursim në SIFQ. Rakordimi në mënyrë sintetike u pasqyruara në tabelën si më poshtë vijon:

Rakordimi me Thesarin ne leke *(ne mije leke)*

Nr	Viti 2019	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit				DPT		Totali DPT
		MPJ/ Xhirime	Stornime	Pagesa Aparati /	Pagesa DRT /	Rimbursime Aparati	Pagesa DRT	
1	Janar	0	-	1,702,901	3,234	1,702,901	3,234	1,706,135
2	Shkurt	20,000	(12,684)	579,781	0	587,097	0	587,097
3	Mars	20,000	(295)	1,378,872	0	1,398,576	0	1,398,576
4	Prill	88,873	-	1,489,895	0	1,578,767	0	1,578,767
5	Maj	97,418	-	1,585,714	0	1,683,132	0	1,683,132
6	Qershor	0	(17,446)	1,663,082	0	1,645,636	0	1,645,636
7	Korrik	70,000	-	1,522,096	0	1,592,096	0	1,592,096
8	Gusht	65,000	(2,976)	1,615,921	0	1,677,945	0	1,677,945
9	Shtator	39,929	(64,301)	2,618,398	28,785	2,594,025	28,785	2,622,809
10	Tetor	30,000	(17,932)	1,637,091	2,214	1,649,159	2,214	1,651,373
11	Nëntor	30,000	-	1,002,611	0	1,032,611	0	1,032,611
12	Dhjetor	186,218	10,340	6,128,288	8,432	6,324,846	8,432	6,333,277
	Totali	647,437	(105,295)	22,924,651	42,664	23,466,792	42,664	23,509,456

(Burimi: DPTThesarit Punoi: KLSH)

Pas përfundimit të procesit të rimbursimit, dokumentacioni protokollohet dhe arkivohet, por nga administrata tatimore qëndrore, e cila është struktura përgjegjëse në procesin e rimbursimit. Nga auditimi rezulton se praktika të gjitha aktet e procedurës së rimbursimit arkivohen në arkivën e DPT, por kjo arkivë ka filluar procedurën e krijimit të dosjeve të rimbursimit për çdo tatimpagues, e cila duhet të vazhdojë në vijimësi.

BASHKËVEPRIMI ME DKT DHE DRT-re

Nga auditimi rezulton se në zbatim të rekomandimit të KLSH-it për bashkëpunim të DPT me AKBN, MFE dhe MIE, për riverifikim të veprimtarinë “AAE” Sh.a me NIPT LXXXXXA, (trajtuar në pikën B. 6 të programit të auditimit 3331/ prot, datë 15.04.202) rezulton se DRT Tatimpaguesi të Mëdhenj me shkresën Nr 10758/1 3 prot, date 27.01.2020, të protokolluar me Nr. 2033 Prot, datë 28.01.2020, informon për kryerjen e verifikimeve pranë shoqërisë AAE. Në përfundim të këtij verifikimi ka rezultuar se shuma prej 3,655,217 leke, bie ndesh me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.201 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar, me pikën 8/d të nenit 20, të Udhëzimit Ministrit Financave nr. 6, datë 30.01.2015 i ndryshuar “ për punime pasi leja kishte përfunduar. Rezultati pas kontrollit tatimor nga D.R.T.Mëdhenj në kushtet kur tatimpaguesi është në mungesë të Lejes së Ndërtimit të HEC-ve, konstaton paligjshmëri kreditimi vetëm për dy situacionet nr. 64 dhe nr. 65,në total 3,665,217 lekë, për të cilën shoqërisë i hiqet kreditimi TVSH-së për punime ndërtimi pasi ka mbaruar leja e ndërtimit.

Në korrespondencat shkresore midis DPT dhe AKBN-së, konstatohet se mungesa e lejes së ndërtimit tashmë dukuri vetëm jo vetëm për një tatimpagues, por për rreth 59-60 raste të tjera, të cilët identifikohen nga AKB si subjekte që nuk kanë lejë ndërtimi ose kanë kryer punime në tejkalim të afateve të tyre. Mungesa e lejes së ndërtimit ose tejkalimi i punimeve jashtë lejes së miratuar, në koncept të kreditimit të TVSH-se, kërkon mos njohjen e kreditimit të saj dhe njëkohësisht rimbursimit të kërkuat. Mënyra e kreditimit sipas tatimpaguesve dhe mos konstatimit i shkeljes nga organet tatimore, bie në kundërshtim me kërkesat ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.201 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar, dhe pika 8/d të nenit

20, të Udhëzimit Ministrit Financave nr. 6, datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Nga inspektorët e kontrollit janë kontrolluar dhe verifikuar në vitin 2019, si dhe janë pezulluar rimbursimet i TVSH-së, për KME më NIPT LXXXXXS; për H S shpk më NIPT LXXXXXT; për S H me NIPT LXXXXXA; për P E me NIPT LXXXXX1; për M H Q më NIPT KXXXXXR. Praktika e pezullimit nga administrata tatimore nuk është zgjidhja e problematikës së konstatuar, madje mund të jetë e kundërta. Organi tatimor në lidhje me ligjshmërinë e vetdeklarimit të tatimpaguesit, duhet të shprehet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 68.4 dhe 68.5 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", sipas të cilit nëse administrata tatimore konstaton se detyrimi tatimor i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, bën vlerësimin tatimor, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Ky veprim duhet të përfshijë edhe HEC-et që janë konfirmuar nga AKBN me munges leje ndërtimi ose tejkallim i saj. Rëndësi në këtë procedurë ka edhe faktori kohë, pasi këto veprime duhet të ndërmerren sipas kërkesave të nenit 73 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" pasi e drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës (ligji TVSH). Në konkluzion: DRTVSH si drejtori që ndjek procesin e rimbursimit dhe paguan shumat e miratuara për rimbursimin duhet të ndjekë zgjidhjen e problematikës duke kërkuar nga DKT në DPT dhe DRTM, vlerësim tatimor nëse organet tatimore konstatojnë paligjshmëri shumë të TVSH-së se rimbursuar shoqërisë në funksion të lejes së ndërtimit në vlerën 4,072,442 leke për këtë HEC për "AA E" Sh.a duke dhënë zgjidhje përfundimtare mbi ligjshmërinë e shumë të kredituar dhe miratuar për rimbursim.

Gjetja	Stoku i detyrimeve të prapambetura për TVSH-në
Situata	<p>Në stokun e raportuar nuk janë evidentuar kërkesat e pranuar por të pamiratuara për rimbursim edhe pse ato janë në tejkallim të afatit ligjor 30/60 ditë të përcaktuar me ligj për rimbursim. Në këndvështrim të ligjit audituesi konsideron detyrim të papaguar të gjitha kërkesat që kanë kaluar afatin 30/60 ditë, referuar nenit 75/1 pika 1 të Ligjit 9920, datë 19.05.2018 "Për procedurat tatimore në RSH".</p> <p>Regjistri rimbursimit nuk ofron të dhëna të mjaftueshme lidhur me vlerësimin e stokut, evidencat e pagesave mbahen në mënyrë manual. Kjo drejtori nuk ka kryer raportime me bazë tremujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi sipas Udhëzimit Plotësues Nr. 1, datë 17.09.2019 "<i>Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019</i>", pika III, paragrafi 117. Mos paraqitja e evidencave lidhur me raportimin e stokut, mos raportimi i stokut në MFE, beri që gjendja e stokut në 31.12.2019 të llogaritet nga grupi i auditimit, duke përdorur të dhënat e auditimit. Pas rishikimit të stokut në sipas DPT në testimin të tatimpaguesve me nivelin më të lartë të pagesave me këste, u konstatuan vlera të pasakta të deklarimit të stokut, mos raportim stoku shuma e TVSH -së miratuar që mbetet për tu përdorur nga tatimpaguesi në periudhat e ardhshme. Pra bazuar sa më lart, vlera e stokut të deklaruar nga DPT në shumën 11,251,390 mijë lekë është e nënvlerësuar me të</p>

	<p>paktën 3,526,472 mijë lekë. Këto testime devijojnë deklarinimin e stokut të organit tatimor për shkak të mos mbajtjes së evidencave të plota të raportimit të stokut dhe përafrojnë vlerën e përlogaritur drejt <u>shumës 14,777,862 mijë të vlerësuar nga KLSH-it.</u></p> <p>Pagesat e rimbursimit janë kryer në shkelje të afatit ligjor të rimbursimit prej 30/60 ditë, afat i përcaktuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 92/2014, “<i>Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R Sh</i>”, kryesisht për shkak të <u>vonesës në procedurën e miratimit të shumës nga kontrolli operacional, duke vënë në vështirësi tatimpaguesit eksportues për likuiditet e nevojshme dhe për ecurinë normale të veprimtarisë ekonomike.</u> Ndërkohë, nga administrata tatimore për kategorinë e tatimpagues të mëdhenj konsideruar të tillë referuar vlerave të larta të shpenzimeve për rimbursim <u>nuk përdoret metoda FIFO në kryerjen e pagesave.</u> Nga auditimit i pagesave me këste konstatohet se, për të njëjtën kërkesë të miratuar, këstet mujore të pagesës variojnë në vlera të ndryshme, si në rastin e tatimpaguesit T A për kërkesën e datës 21.06.2017 pagesa është kryer në datën 27.11.2019 në shumën 200.000 mijë lekë dhe në datën 31.12.2019 në shumën 240.000 mijë lekë; tatimpaguesi P Group për kërkesën e datës 27.11.2018 pagesat janë kryer në 31.12.2019 në shumën 42.646 mijë lekë dhe po në datën 31.12.2019 në shumën 10.000 mijë lekë, etj. Në muajin dhjetor rezulton se për të njëjtin tatimpagues është paguar më shumë se një këst, si në rastin e pagesave për tatimpaguesin JV R T paguar datë 31.12.2019 në shumën 157.339 mijë lekë dhe po në datën 31.12.2019 në shumën 10.000 mijë lekë, ALB paguar në datën 31.12.2019 në shumën 101.968 mijë lekë, në shumën 56.915 mijë lekë, në shumën 66.363 mijë lekë, në shumën 58.898 mijë lekë, në shumën 71.102 mijë lekë, në total pesë pagesa në shumën 355.248 mijë lekë, etj. DRTVSH, kërkesës të grupit të auditimit lidhur me përcaktimin e kësteve për tu paguar, nuk ju përgjigj me evidencë analitike, ose çdo formë tjetër lidhur me vlerën e këstit dhe të radhës së pagesës. Theksojmë se, për këto këste të maturuar për tu paguar, TVSH për rimbursim, në sistemin C@TS rezulton si e përdorur (zbritur në deklaratën e tatimpaguesit në sistemin C@TS). Pra kjo shumë tashmë është jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim për pagimin CASH të saj nëpërmjet sistemit të thesarit. Mosparaqitja e evidencave lidhur me këstet e planifikuara për pagese, bën të pamundur verifikimin e respektimit të radhës së pagesave sipas kësteve të paracaktuara për rimbursim. Sa më sipër përveç shkeljes së afatit ligjor për pagese me këste, të cilën e trajtuam më lart, rezulton se për kërkesat e miratuara në vlera të larta monetare grupit të auditimit i mungon evidenca lidhur me këstet e planifikuara për pagese, fakt që bën të pamundur verifikimin e respektimit të radhës së pagesave sipas kësteve të paracaktuara për rimbursim.</p> <p>Procedurat e rimbursimit të TVSH-së nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së janë kryer në tejkalim planit të shpenzimeve të rimbursimit duke shpenzuar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin në</p>
--	--

	shumën 4,509,456 mijë lekë ose tejkallim në masën 23.73 % të parashikimit vjetor të rimbursimit.
Kriteri	Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” nenin 14;-Udhëzimin nr. 24, datë 02..09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75/1; - Ligji 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, neni 77; -UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar; -Ligjin Nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019".
Ndikimi/Efekti	Stoku i detyrimeve të papaguara nuk është raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Midis stokut të raportuar në Drejtorinë e Kontabilitetit në DPT dhe stokut të përlogaritur nga grupi i auditimit rezulton diferencë në raportimin për më pak detyrimeve të prapambetura në shumën 5,411,190 mijë lekë.
Rëndësia	I Lartë

Gjetja	Realizimi shpenzimeve për rimbursim në raport me planifikimin mujor dhe progresiv për vitin 2019
Situata	Për kategorinë “Tatimpagues të Mëdhenj” për intervalin kohor datë së kërkese dhe datë pagese, rezulton se pagesat janë kryer në shkelje të afatit ligjor të rimbursimit prej 30/60 ditë, përcaktuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R Sh”, i ndryshuar” dhe në nenin 10.4 të VKM 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R Sh”. Për shkak të vlerave të larta të shpenzimeve për rimbursim për këtë grup tatimpaguesish nuk përdoret metoda Fifo, por pagesë më keste mujore. Në pagesat e kryera konstatohet se për të njëjtin tatimpagues keestet e pagesave mujore nuk kanë të njëjtën shumë, nuk janë mujore, madje në muajin dhjetor në pagesat në SIFQ pagesa mujore janë 2-4 herë më të larta se muajt e mëparshëm, ngjarje që do të ndodhte në rast se do të kishim një fluks të lartë të ardhurash tatimore dhe/ose një shtesë të planit të rimbursimit, rrethana të cilat nuk kanë ndodhur. Grupi i auditimit bëri disa kërkesa për të kuptuar rritjen e shpenzimeve për rimbursim në tejkallim të planit të rimbursimit,veçanërisht në muajt Shtator dhe Dhjetor, por DRTVSH-së asnjëherë nuk ju përgjigj kërkesës sonë lidhur me pagesat e kryera në tejkallim të planin e miratuar mujor/progresiv për rimbursim. Moskthimi i përgjigjes për dokumentacionin e kërkuar nga grupi i auditimit bën të pamundur verifikimin radhës së pagesave sipas kesteve të paracaktuara për rimbursim, për të mos aluduar se kjo mënyrë pagese i lihet rastësisë. Sa më sipër, përveç shkeljes së afatit ligjor për pagese me keste, të cilën e trajtuam më lart, rezulton se për kërkesat e miratuara në vlera të larta monetare dhe/ose në pritje për rimbursim /kompensuar detyrime të

	<p>ardhshme tatimore në periudha nuk ka kriter për kryerjen e pagesës me këste.</p> <p>Në mbështetje të ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe risisë për marrëveshje këste sipas VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të miratuar për rimbursim", DPT ka miratuar Urdhërin, Nr. 20, date 02.03.2020, për miratimin e formatit të projekt-marrëveshjes "Për Pagesën me Këste të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të Miratuar për Rimbursim". Për zbatimin e këtij udhëzimi rezultoi se në totalin e kërkesës së miratuar për rimbursim për shumën e mbetur për tu paguar administrata tatimore ka dërguar projekt-marrëveshje për këstet e rimbursimit dhe afatet e pagesës për tatimpaguesin "T A" me shkresën Nr. 8309 prot, datë 19.05.2020, me shkresën Nr. 8370 prot, datë 19.05.2020 ; me shkresën Nr. 8371 prot, datë 19.05.2020; me shkresën Nr. 8372 prot, datë 19.05.2020; me shkresën Nr. 4711/1 prot, datë 02.03.2020 për të cilat tatimpaguesi nuk ka kthyer përgjigje; për tatimpaguesin "B P A" me shkresën Nr. 6875/3 Prot., date 10.06.2020 të cilat rezultojnë në procedurë të pambyllur.</p> <p>- Është nënshkruar Marrëveshje për pagesë me këste me tatimpaguesin A A E me NIPT LXXXXXA, nënshkruar me date 29.05.2020, Nr. 9104 Prot., për shumën e mbetur 957,443 mijë leke, për tu rimbursuar me 5 këste, sipas plan-pagesës së miratuar për të cilën shuma e mbetur papaguar është 574,465 mijë lekë. Por për këtë tatimpagues DRT Tatimpaguesi të Mëdhenj me shkresën Nr 10758/1 3 prot, date 27.01.2020, të protokolluar me Nr. 2033 Prot, datë 28.01.2020, informon për kryerjen e verifikimeve pranë shoqërisë A A E. Në përfundim të këtij verifikimi ka rezultuar se shuma prej 3,655,217 leke, bie ndesh me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.201 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar, me pikën 8/d të nenit 20, të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 6, datë 30.01. 2015, i ndryshuar, për punime ndërtimi pasi leja kishte përfunduar. Rezultati pas kontrollit tatimor nga D.R.T.Medhenj konfirmon mungesë të Lejes së Ndërtimit të HEC-ve, dhe konstaton paligjshmëri kreditimi vetëm për dy situacionet nr. 64 dhe nr. 65, në total 3.665.217 lekë, për të cilën shoqërisë i hiqet kreditimi TVSH-së për punime ndërtimi pasi ka mbaruar leja e ndërtimit. Ndërsa për situacionet paraardhëse për të cilat është kërkuar, miratuar dhe vazhdon pagesa e rimbursimit kjo administratë nuk ka shprehur qëndrimin zyrtar mbi ligjshmërinë e kreditimit të TVSH-së në funksion të lejes së ndërtimit.</p> <p>- Në procesin e verifikimit të lejeve të ndërtimit për HEC-et, nga inspektorët e kontrollit në DRT-re janë kontrolluar dhe verifikuar dhe janë pezulluar rimbursimet i TVSH-së, për KME më NIPT LXXXXS; për H S më NIPT LXXXXT; për S H me NIPT LXXXXA; për P E me NIPT LXXXX; për M H Q më NIPT KXXXXR. Praktika e pezullimit e aplikuar nga administrata tatimore nuk është zgjidhja e problematikës së</p>
--	---

	<p>konstatuar, madje mund të jetë e kundërta. Organi tatimor ka detyrimin ligjor të shprehet mbi ligjshmërinë e kërkesës për rimbursim sipas procedurave të përcaktuara në neni 68.4 dhe 68.5 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, sipas të cilit nëse administrata tatimore konstaton se detyrimi tatimor i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, bën vlerësimin tatimor, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Ky veprim duhet të përfshijë jo vetëm rastet e sipërcituara por edhe rastet e tjera që janë konfirmuar nga AKBN me mungesë leje ndërtimi ose tejkallim i saj. Rëndësi në këtë procedurë ka edhe faktori kohë, pasi këto veprime duhet të ndërmerren sipas kërkesave të nenit 73 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” pasi e drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës (ligji TVSH).</p> <p>Për vitin 2019 rimbursimi për TVSH-në është realizuar në shumën 23,509,456 mijë lekë. Në totalin e TVSH-së së rimbursueshme DRTVSH-se në DPT ka rimbursuar 23,466,792 mijë lekë dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore kanë rimbursuar 42,664 mijë lekë. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT ka paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën 44,466,792 mijë lekë ose ka tejkalluar fondet e parashikuara për rimbursim në masën 23.73 % të parashikimit vjetor të rimbursimit. Shpenzimet për rimbursim kanë tejkalluar dukshëm planin e rimbursimeve në total+4,466,792,mijë lekë, për pagesat e kryera për tremujorin e II-të në shumën +7,535 mijë lekë ose +0.15%, për tremujorin e III-të në shumën +1,264,065 mijë lekë të planit ose +27.48 % më shumë se plani, për tremujorin e IV-ët në shumën +4,506,616 mijë lekë ose +100.15% më shumë se plani, veprime këto në kundërshtim me nenin 14 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror qe zbaton dhe administrim tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.</p>
Kriteri	<p>Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” nenin 14;</p> <p>Udhëzimin nr. 24, datë 02..09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75/1;</p> <p>Ligji 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, neni 77;</p> <p>UMF nr .6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar;</p>

	VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; -Ligjin Nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019".
Ndikimi/Efekti	Procedurat e rimbursimit të TVSH-së janë kryer në tejkalim planit të shpenzimeve të rimbursimit, nuk është dhënë zgjidhje ligjore për rimbursimin e TVSH-së për HEC-et që janë konstatuar pa leje ndërtimi për 59-60 raste të konstatuara nga AKBN me mungese leje ndërtimi, me efekt pakësimi të ardhurave tatimore në shkallë kombëtare sipas Ligjit Nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019".
Rëndësia	I Lartë

Gjetja	Mbi Procesin e Rimbursimit
Situata:	<p>Drejtorja e Rimbursimit nuk konsideron me “Risk zero” personin juridik, por kërkesën e tatimpaguesit sipas rastit, në kundërshtim me kërkesat e VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, sipas të cilit me risk zero përcakton “Personin” që nënkupton personin juridik dhe jo kërkesën për rimbursim si është konceptuar dhe zbatuar nga administrata tatimore</p> <p>Në kuadër të auditimit të procedurës së rimbursimit, bazuar në të dhënat “Raport mbi pagesat e rimbursimit 2019” të DRTVSH-se dhe pagesave në SIFQ, rezulton se gjatë vitit 2019 janë rimbursuar në total 820 raste rimbursimesh në shumën e paguar 7,011,508 mijë lekë. Pagesat për rimbursim janë kryer afatit ligjor 30 ditë, për kategoritë eksportues për 406 raste paguar në shumën 3.695.029 mijë lekë për 36-456 ditë vonesë, për kategoritë rieksportues te mallrave jo shqiptare ose “Fason” për 270 raste paguar në shumën 1.911.484 mijë lekë për 46-778 dite vonesë, për këtë grumbullues - eksportuesish për 144 raste paguar në shumën 1,404,997 mijë lekë për 50-557 ditë vonesë, veprime këto në mospërputhje me nenin 10 të VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar. Për kategorinë “Të tjerë” për intervalin kohor datës së kërkesë dhe pagesë në SIFQ, pagesat janë kryer në shkelje të afatit ligjor të rimbursimit 60 ditë, përcaktuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R Sh”, i ndryshuar” dhe në nenin 10.4 të VKM 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R Sh”, i ndryshuar”, kryesisht për shkak të përfundimit me vonesë të kontrollit tatimor nga DRT-re për miratimin e shumës për rimbursim.</p> <p>Në pagesën e kërkesave për rimbursim për intervalin kohor datë miratimi-datë pagesë për periudhën Janar –Qershor 2019, rezulton se nuk është zbatuar radha në kryerjen e pagesave, veprime në kundërshtim me metodën FIFO të Udhëzimit Nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Kjo radhe është zbatuar për periudhën Korrik- Dhjetor 2019.</p>

	Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, nuk u paraqiti rakordimi mujor me Degën e Thesarit Tiranë për rimbursimet e tvsh-se kaluar nëpërmjet SIFQ, veprime në kundërshtim me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nenin 75 pika 2.6 dhe Manuali i Rimbursimit i rimbursimit të TVSH-së në paragrafin “Dërgimi i miratimit të shumës dhe urdhër pagesave në thesar për kryerjen e rimbursimit”.
Kriteri :	Ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75/1; Udhëzimin nr. 24, datë 02..09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75/1; Ligji 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, neni 77; UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar; VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar; Rregullorja e Brendshme e Administratës Tatimore Qendrore; Rregulloren nr. 23, datë 23.03.2018 “Rimbursimin e TVSH-së”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 23, datë 23.03.2018, protokolluar me nr. 6374 prot, datë 23.03.2018, për analizën e riskut (shfuqizon Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-se, miratuar me Urdhër nr. 2, datë 13.01.2017).
Ndikimi/Efekti	Konstatohen procedurat e rimbursimit të TVSh-së janë kryer në tejkallim të afateve ligjore, duke shkelur radhën e pagesës sipas datës së miratimit dhe metodës Fifo, duke tejkalluar planin e shpenzimeve të rimbursimit, me efekt në pakësimin e të ardhurave tatimore planifikuar nga për arkëtim sipas ligjit të buxhetit për vitin 2019.
Rëndësia	I Larte

Për sa më sipër përgjegjësi menaxheriale për veprimet dhe mosveprimet mbajnë:

Znj. DI në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve për periudhën 18.07.2019-31.12.2019 për veprimet dhe mosveprimet referuar nenit 5 pika 5, të Rregullores së ATQ për tejkallimi i afateve të rimbursimit, sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe akteve ligjore dhe nenligjore shkelja, për tejkallim planit mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar referuar Ligjin Nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe shkresat e MFE

Z. Xh Ç në cilësinë e ish- Zv/Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve (dalë në pension); për periudhën 01.04.2019-04.04.2019 për tejkallimi i afateve të rimbursimit, sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe akteve ligjore dhe nenligjore shkelja e radhes sipas metodes FIFO, venë në vështirësi serioze tatimpaguesin për mungesë likuiditetesh për shërbim normal të veprimtarisë ekonomike.

Z. ED në cilësinë e ish- Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve (jashtë sistemit tatimor) për periudhën 04.04.2019-18.07.2019 bazuar në nenin 5 pika 5, të Rregullores së ATQ për tejkallimi i afateve të rimbursimit, sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”;

Znj. AG në cilësinë e ish-Drejtor Drejtorisë së Rimbursimit (jashtë sistemit tatimor) për periudhën e marrëdhënieve të punësimit, për tejkalimi i afateve të rimbursimit, sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe akteve ligjore dhe nënligjore shkelja e radhes sipas metodes FIFO, venë në vështirësi serioze tatimpaguesin për mungesë likuiditetesh për shërbim normal të veprimtarisë ekonomike.

Z. AN në cilësinë e ish-Drejtor Drejtorisë së Rimbursimit për periudhën e marrëdhënieve të punësimit në këtë drejtori (sot Drejtori i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e tatimpaguesve të Medhenj) për tejkalim i afateve të rimbursimit, sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe akteve ligjore dhe nënligjore shkelja e radhës sipas metodes FIFO, venë në vështirësi serioze tatimpaguesin për mungesë likuiditetesh për shërbim normal të veprimtarisë ekonomike.

Znj. DM në cilësinë e ish -Drejtor Drejtorisë së Rimbursimit (dale në pension) për periudhën e marrëdhënieve të punësimit, për tejkalimi i afateve të rimbursimit, sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe akteve ligjore dhe nënligjore shkelja e radhes sipas metodes FIFO, venë në vështirësi serioze tatimpaguesin për mungesë likuiditetesh për shërbim normal të veprimtarisë ekonomike.

Koment: Në evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nga z. EL në cilësinë e Drejtorit Drejtorisë së Rimbursimit (aktual), emëruar në këtë detyrë shkurt 2020, janë konstatuar mungesë e plotësisë dhe saktësisë së tyre, por këto konstatime nuk e ngarkojnë me përgjegjësi, pasi evidencat nuk janë hartuar por dërguar prej tij gjatë periudhës së auditimit në subjekt.

B.6 Aktiviteti i drejtorive në DPT, me ndikim direkt në fushën e mbledhjes së të ardhurave tatimore, përmbushja e objektivave në funksion të përmbushjes së misionit të autoritetit tatimor

B6.1 Drejtoria e Kontrollit Tatimor

Në zbatim të pikës B.6 të programit të auditimit nr. 333/1, datë 15.04.2020 për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Plan operacional vjetor për periudhën 01/01/2019 - 31/12/2019
2. Përmbushja e planit për periudhën 01/01/2019 - 30/09/2019
3. Evidenca progresive për realizimin e planit të kontrollit tatimor.
4. Evidenca mbi kontrollet e ushtruara nga sektori i kontrollit lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor nga ana e drejtorive të kontrollit tatimor

Bazuar në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore, në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij, në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në planin operacional për vitin 2019 **ka miratuar objektivat:**

- ✓ Kryerja e kontrolleve dhe verifikimeve në bazë të planit vjetor në drejtoritë rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin fiskal dhe procedurat e Manualit të Kontrollit Tatimor.
- ✓ Raportim mbi gjetjet që kanë dalë gjatë kontrolleve në lidhje me metodologjinë e kontrollit tek tatimpaguesit, mos përmbushjet apo shkeljet ligjore, ose shërbimet e ofruara për

tatimpaguesin, së bashku me rekomandimet për ndryshime të mëtejshme, duke propozuar edhe masa në rastet e shkeljeve administrative e ligjore, duke analizuar problematikat e konstatuara dhe mangësitë e inspektoreve të kontrollit, duke rekomanduar programet e trajnimit për rritjen e aftësive të inspektorëve.

✓ Monitorim mbi arritjet e drejtorive tatimore rajonale kundrejt planeve të dërguara për zbatim nga DPT, investigim ndryshimet nga plani i kontrollit, bën komente për çdo shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar këto shmangie, kur është e nevojshme. Gjithashtu ofron këshillim dhe udhëzim të specializuar për një kontroll eficient dhe efektiv të tatimpaguesit.

Në zbatim të neni 116, në zbatim të Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19 datë 22.02.2017, Urdhri nr.16, datë 02.03.2018 “Për ngritjen e komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve”, DPT ka organizuar punën vjetore duke ngritur grup pune të përhershëm të emërtuar **Komiteti i reformave**, i cili ka vendosur si më poshtë vijon:

- Miratimin e planeve operacional të administratës tatimore vitin 2019, me vendimin nr. 10, datë 01.02.2019;

- Miratimin e planit të asistencës së huaj për vitin 2019, me vendim nr. 11, datë 14.02.2019;

- Miratimin e rekomandimeve të misionit të FMN-se të muajit dhjetor 2018, miratuar me vendim nr. 12, datë 07.03.2019;

- Miratimin e indikatorëve të performancës (KPI) të administratës tatimore në nivel DRT-je dhe në nivel inspektori tatimor. Miratimin e mënyrës së pikësimit të indikatorëve të performancës (KPI), miratuar me vendim nr. 12, datë 07.03.2019;

- Miratimin e përditësimit të Manualit të Kontrollit Tatimor mbi propozimet në masën 30% të DRT-ve, duke u mbështetur në elementet e riskut, miratuar me vendim nr. 13, datë 24.06.2019; Në zbatim të sa më sipër, DPT ka organizuar punën vjetore duke ngritur grup pune të përhershëm të emërtuar **Komiteti i Përmbushjes**, i cili ka vendosur si më poshtë vijon:

- Miratim i planit të të ardhurave për DRT-re për vitin 2019, pjese përbërëse e të cilës është dhe Drejtoria e Kontrollit Tatimor, me vendimin nr. 21, datë 21.02.2019 të Komitetit të Përmbushjes,

- Planin sektorial të bareve dhe restoranteve, miratuar me vendimin nr. 22, datë 28.03.2019 të Komitetit të Përmbushjes,

Në zbatimin e planeve operacional **Komiteti i Operacional** ka vendosur:

- Miratimin e përmbushjes së planeve operacional për vitin 2018 dhe objektivat e përcaktuara të përmbushen në vitin 2019, me vendimin nr.14, datë 21.01.2019.

- Miratimin e Përmbushjes së planeve operacional të drejtorive në DPT për 3-mujorin e parë 2019 dhe objektivat e përcaktuara gjatë këtij tremujori të jenë pjesë e planeve operacional për 3-mujorin në vazhdim, me vendimin nr. 15, datë 10.05.2019.

1. PLANIFIKIMI I KONTROLLEVE TATIMORE

Miratimi për planin e kontrolleve tatimore në të gjitha DRT-re kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut të DPT, bazuar në Manualin për Menaxhimin e Riskut, Kapitulli IX, “Përzgjedhja për kontroll”, paragrafi 9.2 pika.1. Sipas kësaj dispozite DMR në DPT, sipas regjistrimit elektronik të riskut, përzgjedh për kontroll **70% të** tatimpaguesve, mbi bazën e të cilit behet detajomi mujor i planit të kontrollit, dhe dërgohet DRT-ve brenda datës 25 të çdo muaji për zbatimin e tij në muajin pasardhës. Në 70% të tatimpaguesve të përzgjedhur për kontroll të plotë në vend, përfshihen edhe rastet e kontrollit të plotë në vend të rimbursimeve, të përcaktuara nga DRTVSH në bazë të

Rregullores së Rimbursimit sipas Analizës së Riskut. Për pjesën e mbetur të tatimpaguesve të përzgjedhur për kontroll Drejtoritë Rajonale Tatimore përcjellin në DPT propozime për kontrolle tatimor brenda datës 15 të çdo muaji, të cilat përbëjnë **30% kontrolle të planifikuara**, dhe përfshihen në planin mujor në muajin pasardhës. Plani mujor i kontrollit referuar Manualit të Kontrollit Tatimor për secilën Drejtori Rajonale Tatimore hartohet si bashkëpunim ndërmjet tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe miratohet e dërgohet për zbatim nga kjo e fundit për secilën DRT.

Nga ana tjetër DRT kanë detyrim të raportojnë çdo muaj mbi kontrollet e kryera dhe fazën e kontrolleve në proces. Raportimet e detajuara mujore janë subjekti i analizave mujore të cilat raportohen tek nivelet më të larta drejtuese në DPT.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut sipas dispozitave të sipërcituara, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, ka dërguar listat e përzgjedhjes për kontroll (mujore) pranë DRT-re dhe DKT në DPT, për muajin janar me shkresë nr. 617 prot, datë 11.01.2019; muajin shkurt me shkresë me nr. 2346 prot, datë 31.01.2019; për muajin mars nr. 4474 prot, datë 28.02.2019; për muajin prill me nr. 6269 prot, date 26.03.2019; për muajin maj me nr. prot, datë(mungon shkresa përcjellëse); për muajin qershor me nr. 10930/1 prot, date 29.05.2019; për muajin korrik nr. 12788/1 prot, datë 28.06.2019; për muajin gusht me nr. prot, datë(mungon shkresa përcjellëse); për muajin shtator nr. 16817 prot, datë 10.09.2019; për muajin tetor me shkresë nr. prot, datë (mungon shkresa përcjellëse); dhe për muajin dhjetor me nr.22287 prot, datë 13.12.2019. Përveç shkresave planifikimeve mujore me miratim nga DPT bëhen te gjitha rastet e ndryshimit të planit për shkak te transferimit te subjektit ne DRT- re te tjera.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kryen kontrolle tatimore në bazë të planeve mujore për kontroll, dhe në asnjë rast nuk ka konkluduar në një Plan te Përgjithshëm Kontrolli për një vit kalendarik i cili duhet të miratohet brenda muajit dhjetor të vitit paraardhës, duke synuar përfshirjen në kontroll të tatimpaguesve me riskun më të lartë. E njëjta procedurë zbatohet dhe për drejtoritë rajonale. Këto veprime nuk janë përputhje me paragrafin 80.4.1 UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat tatimore”.

Planifikimi për kontroll kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT, e cila për 12 periudhave mujore te vitit 2019 ka miratuar çdo muaj plan mujor kontrollit të tatimpaguesve për **2,025 raste**, dërguar për zbatim në drejtoritë rajonale sipas shkresave të sipërcituara.

Në planifikimin total **2025 kontrolle, kontrolle të plota janë 1097 raste dhe vizita fiskale janë 928 raste**. Krahasuar me vitin 2018 në total rezultojnë më pak 228 kontrolle ose - 10.12% se viti 2018, nga të cilat kontrolle të plota më pak 254 raste dhe vizita fiskale më tepër 26 raste, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Evidenca e Planifikimit të Kontrolleve 2019/2018 (në raste)

Nr.	DRT	Kontrollet e planifikuara 2019			Kontrollet e planifikuara 2018		
		Gjithsej	Te plota	V. fiskale	Gjithsej	Te plota	V. Fiskale
1	Berat	61	32	29	63	27	36
2	Dibër	45	38	7	51	48	3
3	Durrës	271	130	141	239	80	159
4	Elbasan	290	71	219	140	91	49
5	Fier	111	80	31	199	101	98
6	Gjirokastrë	222	113	109	64	37	27
7	Korçë	39	24	15	117	86	31
8	Kukës	145	100	45	25	18	7
9	Lezhe	17	17	0	45	19	26
10	Sarandë	36	23	13	44	33	11
11	Shkodër	18	8	10	139	67	72

12	Vlore	109	66	43	94	48	46
13	Tirane	566	353	213	634	462	172
14	VIP	95	42	53	233	136	97
	Totali	2025	1097	928	2253	1351	902

(Burimi: DKT Punoi: KLSH)

Sipas drejtorive rajonale në totalin e kontrolleve të planifikuara numri më i lartë i kontrolleve është planifikuar në DRT Tiranë për 566 kontrolle ose 27.95% e totalit, DRT Durrës për 290 kontrolle ose 14.32% e totalit, DRTM për 271 kontrolle ose 13.38%, DRT Fier për 222 kontrolle ose 10.96 % e totalit, etj., Evidenca analitike është pasqyruar si më poshtë vijon:

Planifikimi mujor për kontrolle sipas DRT-re (në raste)

Nr.	Drt	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Total
1	Berat	7	5	4	5	5	8	6	5	6	2	8	-	61
2	Dibër	1	6	6	6	6	2	1		5		9	3	45
3	Dtm	21	9	30	25	22	15	15	27	32	30	33	12	271
4	Durrës	24	13	44	13	25	24	27	19	33	28	27	13	290
5	Elbasan	16	12	12	11	14	12	1	8	8	4	11	2	111
6	Fier	24	16	22	30	21	25	8	14	21	8	29	4	222
7	Gjirokastrë	5	3	4	5	6	1	4	3	3		5		39
8	Korçë	12	15	18	19	17	11	4	13	13	3	13	7	145
9	Kukës	2	-	2	2	3	2	-	3	-	-	3	-	17
10	Lezhë	2	2	6	4	4	3	-	2	7	1	4	1	36
11	Sarandë	3	-	2	2	-	1	3	1	4	-	1	1	18
12	Shkodër	13	6	15	10	10	12	6	7	15	4	10	1	109
13	Tiranë	63	9	87	57	60	49	37	53	60	14	56	21	566
14	Vlorë	12	3	12	8	5	9	6	2	10	5	17	6	95
	Ttotal	205	99	264	197	198	174	118	157	217	99	226	71	2025

(Burimi: DKT Punoi: KLSH)

DMR në DPT, sipas modulit të riskut, përzgjedhur për kontroll **70% të** tatimpaguesve, dhe **30% me propozim** të DRT dhe strukturave të tjera të ngarkuara me ligj, mbi bazën e të cilit bëhet detajimi mujor i planit të kontrollit. Nga auditimi rezulton se në totalin e 2025 kontrolle të miratuara rezulton se janë përzgjedhur për kontroll nga DMR në DPT **1587 raste ose 78.37%** e totalit dhe propozim të DRT-re janë miratuar për kontroll tatimor 438 raste ose 21.63% e totalit, raport i cili nuk është respektuar në miratimin e planit të kontrolleve për vitin 2019, veprime këto në mospërputhje me kërkesat e Manualin për Menaxhimin e Riskut, Kapitulli IX, “Përzgjedhja për kontroll”, paragrafi 9.2 pika.1

Plani i detajuar të kontrollit tatimor sipas DRT-re: Rezulton se gjatë vitit kalendarik janë miratuar për kontroll tatimor **486 raste** janë sipas modulit të riskut sipas regjistrat elektronik të riskut, **878 raste** për miratim TVSh të rimbursueshme, **100 kërkesa** janë miratuar për kontroll sipas planit sektorial të bareve dhe restoranteve sipas Vendimit nr. 22, datë 28.03.2019 të Komitetit të Përmbushjes, **42 raste** janë përzgjedhur për kontroll nga moduli riskut për shkak të rënies së ndjeshme të qarkullimit, **33 raste** janë përzgjedhur për rikontroll tatimor, **3 raste** janë me propozim të Komisioni për Shqyrtimin të Apelimeve Tatimore (KSHAT), **2 raste** janë OJF, **24 raste** janë miratuar për kontroll jashtë planit mujor për kërkesa për rimbursim të TVSH-së të paraqitura nga tatimpaguesi. Evidenca analitike është pasqyruar si më poshtë vijon:

Planifikim mujor i detajuar për kontrolle sipas DRT-re (në raste)

Nr.	DRT	Moduli	Rimbursim	Pa planifikuar	Projekti Bar & Restorante	Rikontroll	OJF	Prokuroria	Tatim pagues Me rënje te ndjeshme	DRT	KSHAT	Planifi kuara
1	Berat	10	29		3	6			2	11		61
2	DIBËR	16	7		2		1		2	17		45
3	DTM	59	138	1					5	66	2	271
4	Durrës	16	202	16	16	1		1	5	33		290
5	Elbasan	38	31		5	3			2	32		111
6	FIER	53	108	3	8	3			1	46		222
Nga inspektorët e kontrollit janë kontrolluar dhe verifikuar në vitin 2019, si dhe janë pezulluar rimbursimet i TVSH-së, për K M E më NIPT LXXXXX; për H S shpk më NIPT LXXXXT; për S H me NIPT LXXXXA; për Prell Energy me NIPT LXXXX; për M H Q më NIPT KXXXXR. Praktika e pezullimit nga administrata tatimore nuk është zgjidhja e problematikës së konstatuar, madje mund të jetë e kundërta. Organi tatimor në lidhje me ligjshmerinë e vetdeklarimit të tatimpaguesit, duhet të shprehet sipas procedurave të përcaktuara në neni 68.4 dhe 68.5 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", sipas të cilit nëse administrata tatimore konstaton se detyrimi tatimor i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, bën vlerësimin tatimor, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Ky veprim duhet të përfshijë edhe HEC-et që janë konfirmuar nga AKBN me mungesë leje ndërtimi ose tejkallim i saj.

Rëndësi në këtë procedurë ka edhe faktori kohë, pasi keto veprime duhet të ndërmeren sipas kërkesave të nenit 73 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" pasi e drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës (ligji TVSH).

Në konkluzion:Sa më sipër rezulton se Drejtoria së Kontrollit në DPT nuk ka përmbushur objektivin primar të programit të kontrollit tatimor për konsolidimin e nivelit aktual të të ardhurave të realizuara nga organet tatimore, duke bërë identifikimin e gabimeve në vlerësim dhe vjeljen e të ardhurave tatimore që janë pasojë e deklarimit me të vogël dhe të papaguara, dhe të sigurojë uljen në maksimum të evazionit dhe të shmangies tatimore, sipas kërkesave të Manualit të Kontrollit tatimor dhe Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr.19 datë 22.02.2017 nënen 116 të tij.

B 6.2 AKTIVITETI I DREJTORISË SË MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA (ish- Drejtoria e Mbledhjes me Forcë)

Meqënëse, më hollësisht borxhi tatimor dhe menaxhimi i tij po trajtohen në një program tjetër auditimi të KLSH-së, në vijim të parregullsive dhe pasaktësive të konstatuara në këtë auditim,

trajtuar më hollësisht në pikat B.3 dhe B.4, në këtë pikë është trajtuar çështja e saktësisimit dhe raportimit të borxhit tatimor në raport me përgjegjësitë që struktura e Mbledhjes me Forcë ka.

Objekti dhe detyrat e Drejtorisë

Sipas rregullores në fuqi, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë ka si objekt të saj udhëheqjen metodologjike dhe funksionin monitorues mbi Drejtorite Rajonale Tatimore, lidhur me procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, borxhit tatimor. Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në Drejtori të Përgjithshëm është e organizuar dhe funksionon me:

Sektorin e Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara;

Sektorin e Monitorimit të Marrëveshjeve.

Qëllimi i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë është të përmbushë objektivat e mbledhjes së detyrimeve të papaguara me koston më të ulët të mundshme, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve.

Në përgjigje të kërkesës së grupit të auditimit u vunë dispozicion Manuali i mbledhjes me forcë i cili “*trajton aspektet që duhen patur parasysh mbi mënyrat e identifikimit të rreziqeve në lidhje me trajtimin e mbledhjes së borxhit në përshtatje me sjelljen dhe llojin e detyrimit të papaguar të tatimpaguesve. Manuali synon përdorimin e metodave që do të sigurojnë pagesa vullnetare të detyrimeve të papaguara me qëllim shmangien e fillimit të zbatimit të masave shtrënguese si dhe monitorimin e ecursisë së stokut të borxhit*”. Manuali i Mbledhjes me Forcë të Detyrimeve të Papaguara mbështet në nenin 135, paragrafet “3” dhe “4”, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, ky Manual është detyrues për strukturat e Mbledhjes me Forcë në DPT dhe Drejtoritë Rajonale. Me ndryshimet strukturore përfshirë ndryshimin e emrit të kësaj drejtorie lind nevoja dhe rifreskimi i këtij Manuali të azhurnuar në vitin 2017.

Në përputhje me pikën 3.3.1 “Kërkesat për evidentim dhe analizë”, të Manualit, çdo muaj, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në Drejtoritë Rajonale duhet t’i dërgojë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT raporte, evidenca dhe analiza të cilat pasqyrojnë situatën e borxhit. Raportimet periodike mujore të Drejtorive Rajonale duhet të dërgohen në rrugë elektronike brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës dhe me postë zyrtare brenda datës 14 të çdo muaji pasardhës pranë DPT/Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë. Raportimet duhet të bëhen sipas evidencave të miratuara dhe duhet të përfshijë:

- numrin dhe vlerën e borxheve për çdo tatim (përfshi lëvizjet gjatë muajit)
- numrin e debitorëve për çdo tatim (përfshi lëvizjet gjatë muajit)
- numrin dhe rezultatet e masave shtrënguese
- numrin dhe vlerën e marrëveshjeve për pagesë me këste
- numrin dhe vlerën e borxhit sipas madhësisë
- numrin dhe vlerën e borxhit për subjektet Buxhetore

Në përgjigje të kërkesës së grupit të auditimit, u vu në dispozicion evidenca e borxhit tatimor sipas llojit, të raportuar më 31.12.2019, ku në total borxhi tatimor raportohet në shumën 116,994,228 mijë lekë ose 9,293,691 mijë lekë ose 8.6% më shumë se një vit më parë:

Lloji Tatimit	Gjendja 01.01.2019 Në mijë lekë	Gjendja 31.12.2019 Në mijë lekë
Tatim Fitimi	30,203,618	31,637,015
TVSH	39,321,591	40,398,965
Sig.Shoqerore	13,829,721	15,112,681
TAP	1,597,106	1,961,275

Te tjera	22,748,501	27,884,291
Totali	107,700,537	116,994,228

Për kërkesën e grupit të auditimit për të dhëna të detajura për zërin “Të tjera”, nuk u dergua informacion deri në datën e mbylljes së auditimit në terren, me shpjegimin se ky informacion gjendet në DRT-re përkatëse. Sipas Drejtorive Rajonale gjendja e borxhit paraqitet si vijon:

Levizja e borxhit sipas DRT gjate 201 (ne miliard)

DRT	Gjendja detyrimeve ne fillim te muajit Janar		Detyrime te shtuara		Detyrime pakesuar gjate 12 mujorit				Vlera gjithsej e detyrimeve ne fund te muajit Dhjetor		Ne Proçes Gjyqesor	
					Arketuar Gjithsej		Kthyer per Sistemim					
	Numer subjekte	Shuma	Numer subjekte	Shuma	Numer subjekte	Shuma	Numer subjekte.	Shuma	Numer subjekte	Shuma	Numer subjekte	Shuma
Berat	3,528	696	4,308	359	4,229	250	80	21	3,527	784	21	59
Diber	2,705	883	1,326	408	1,113	216	190	25	2,784	1,050	7	98
Durres	17,648	7,861	8,164	3,334	7,202	1,838	347	190	18,455	9,167	102	391
Elbasan	7,502	4,340	4,387	966	3,320	537	8	94	7,870	4,675	26	109
Fier	8,600	2,712	8,793	1,236	6,848	749	331	210	10,251	2,988	27	208
Gjirokas	3,360	967	3,687	210	4,009	250			3,038	927	18	22
Korçe	7,801	2,431	9,866	374	7,355	441			7,695	2,364	57	85
Kukes	1,613	683	2,630	251	2,318	194			1,925	740		
Lezhe	3,811	4,567	10,201	1,735	8,990	653			5,022	5,650	79	408
Sarande	3,625	800	3,972	304	3,749	278	416	21	3,432	805	19	46
Shkoder	7,964	2,243	2,164	1,202	2,593	651	1,417	234	8,690	2,560	158	305
Tirane	67,120	46,631	33,884	31,606	43,867	6,678	40	411	69,588	71,148	879	8,380
Vip	310	30,240	643	10,030	563	9,037	182	19,990	203	11,242	76	3,306
Vlore	9,323	2,648	2,895	924	3,200	677			8,799	2,895	56	302
Totali	144,910	107,701	96,920	52,941	99,356	22,449	3,011	21,198	151,279	116,994	1,525	13,719

Nga evidenca rezulton se numri i çështjeve në proces gjyqësor është 1525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen 416 çështje gjyqësore në proces, me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë.

Duke qënë se në sistemin C@TS ekziston Moduli i Menaxhimit të Mbledhjes me Force, për një verifikim të mëtejshëm grupi i auditimit kërkoi informacion mbi llojet e raporteve që gjenerohen nga ky modul, me qëllim monitorimin e mbledhjes së borxhit, ecurisë, strategjive për mbledhjen e tij. Në përgjigje të kërkesës sonë DMF në DPT sqaron se ky modul përdoret nga Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguar evidenton vlerën e detyrimeve të borxhit te papaguara vetëm sipas formatit të evidencave.

Sipas anekseve shoqëruese të Pasqyrave Financiare, gjendja e debitorëve në fund të periudhës në auditim në sistemin C@TS është 117,996,398 mijë lekë ose 8,891,504 mijë lekë ose 8.1% më shumë se gjendja debitorë e raportuar më 01.01.2019. Detyrimi i ri i vitit 2019 është 20,975,210 mijë lekë, ku debinë më të lartë të krijuar sipas llojit e zë TVSH-ja, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, taksat kombëtare dhe tatimi mbi fitimin.

Tatimi	Kodi Buxhet	Celja	Pagesa Me Bankë	Shlyerje Me Kredi	Falje	Gjendja Ndryshuar	Detyrim i Vitit 2019	Progresiv	% Ndryshimit
Global	7115	5,075,266	174,677	22,095	18,044	4,860,450	191,535	5,051,985	0.5%
Mbi tëArdhurat Personale të Biznesit të Vogel	7002	98,696	1,402	190	90	97,013	18,693	115,707	17%
mbi te ardhurat individuale	7009	112,350	18,718	18,087	4,367	71,177	125,641	196,818	75%

Lojrat e Fatit	7032	3,437,383	130	0	510	3,436,743	36,357	3,473,100	1%
Taksa e Rentës Minerare	7033	342,057	37,558	98,436	15,961	190,102	82,594	272,696	-20%
Tatimi i Thjeshtuar Fitimit	7002	2,541,639	37,521	94,300	4,468	2,405,349	289,735	2,695,084	6%
TVSH	7030	40,022,971	2,200,574	1,044,953	659,736	36,117,709	5,279,961	41,397,670	3%
Kontributet Sig.Shoq & Shënd.	7501	16,160,385	2,394,409	135,760	41,479	13,588,738	4,219,648	17,808,386	10%
Tatim në Burim	7009	4,154,915	186,256	75,297	80,914	3,812,448	554,727	4,367,175	5%
Tatimi mbi fitimin	7001	29,471,801	3,719,155	522,250	193,513	25,036,883	4,755,344	29,792,227	1%
Tarifa Kombëtare	7110	29,043	2,694	2,331	61	23,957	2,436	26,392	-9%
Taksa Kombëtare	7050	6,709,339	6,644	225,959	126	6,476,609	5,377,913	11,854,523	77%
Mbi të Ardhurat nga Punësimi	7000	949,051	14,624	28,695	1,724	904,008	40,627	944,635	-0.5%
Totali		109,104,894	8,794,363	2,268,352	1,020,992	97,021,187	20,975,210	117,996,398	8%

Sipas moshës së borxhit dhe DRT:

DRT	borxhi deri ne 3 muaj	borxhi nga 3 - 6 muaj	borxhi nga 6-12 muaj	borxhi nga 1-2 vjet	borxhi nga 2-5 vjet	borxhi mbi 5 vjet	Total
TIRANE	423,085	132,266	1,415,949	3,289,700	8,766,022	2,881,750	16,908,772
VIP	92,611	403,349	1,974,537	1,830,086	1,575,586	17,761	5,893,930
DURRES	10,734	132,449	175,617	326,751	1,278,203	798,613	2,722,367
ELBasan	2,357	10,040	46,790	331,319	198,692	779,498	1,368,696
LEZHE	527,921	21,045	94,000	91,158	199,352	157,024	1,090,500
Berat	697	886	7,740	18,769	28,050	71,847	127,989
DIBER	2,469	468	36,378	53,273	213,253	13,123	318,964
FIER	34,853	72,254	98,703	169,561	171,967	182,619	729,957
GJIROKASTER	1,345	1,940	9,947	67,884	123,501	51,780	256,397
KORCE		1,746	41,440	58,771	293,275	174,791	570,023
KUKES	25,134	11,653	33,541	51,223	61,397	24,828	207,776
SARANDE	752	303	142	13,939	59,085	3,281	77,502
SHKODER	25,614	19,341	72,641	85,997	75,214	460,091	738,898
VLORE	26,965	52,930	77,851	112,913	142,965	211,621	625,245
TOTALI	1,174,536	860,670	4,085,276	6,501,345	13,186,562	5,828,627	31,637,015
	4%	3%	13%	21%	42%	18%	

Nga tabela evidentohet se borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet zë 60% të stokut të borxhit. Gjithashtu nga grupi i auditimit është kërkuar informacion për shumën e borxhit të konsideruar të pambledhshëm, por deri në datën e këtij akti nuk u paraqit informacion.

Theksojmë se çështjet e lidhura me borxhin tatimor dhe menaxhimin e tij janë objekt i auditimit me një program të posacëm auditimi nga KLSH-it, që në këtë periudhë është në proces auditimi në DPT dhe problematikat e dalë dhe shtjelluara sa më lartë, janë shqyrtuar në kuadër të impaktit që aktiviteti i kësaj drejtorie ka në mbledhjen e të ardhurave tatimore.

Gjetja	Kontrolli tatimor
Situata	1. Nga auditimi rezulton se DRT Tatimpaguesi të Mëdhenj me shkresën Nr.10758/1 3 prot, date 27.01.2020, të protokolluar me Nr.2033 Prot, datë 28.01.2020, informon për kryerjen e verifikimeve pranë shoqërisë AA E, sipas Autorizimit për Verifikim në Vend Nr10758/3 prot, date 27. 10.2019, me objekt "Verifikimi nëse punimet e kryera janë në përputhje me afatet e lejes së ndertimit". Në përfundim të këtij verifikimi ka rezultuar se shuma prej 3,655,217 leke, bie ndesh me ligjin nr.92/2014, datë 24.07.201 "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar

	<p><i>në RSH " i ndryshuar, me pikën 8/d te nenit 20, të Udhëzimit Ministrit Financave nr. 6, datë 30.01.2015 i ndryshuar “ për punime pasi leja kishte përfunduar.</i></p> <p>Rezultati pas kontrollit tatimor nga D.R.T.Mëdhenj në kushtet kur tatimpaguesi është në mungesë të Lejes së Ndërtimit të HEC-ve, konstaton paligjshmeri kreditimi vetëm për dy situacione nr. 64 dhe nr.65, në total 3.665.217 lekë, për të cilën shoqërisë i hiqet kreditimi TVSH-së për punime ndërtimi pasi ka mbaruar leja e ndërtimit. Sa më sipër rezulton se autoriteti tatimor DRTM si autoritet tatimor që ka në juridiksion tatimpaguesin, si dhe DKT në DPT që ndjek zbatimin e planit të masave të miratuara sipas rekomandimit të lënë, nuk janë shprehur mbi ligjshmërinë shumës së TVSH-së se rimbursuar shoqërisë në funksion të lejës së ndërtimit në vlerën 4,072,442 leke për këtë HEC, duke mos dhënë zgjidhje përfundimtare mbi ligjshmërinë e shumës së kredituar dhe miratuar për rimbursim.</p> <p>Nga inspektorët e kontrollit operacional janë kontrolluar dhe verifikuar në vitin 2019, si dhe janë pezulluar rimbursimet i TVSH-së, për K M E më NIPT LXXXXS; për H S shpk më NIPT LXXXXT; për S H me NIPT LXXXXA; për P E me NIPT LXXXX; për M H Q më NIPT K86504601R. Në korespondencën shkresore midis DPT dhe AKBN-së, konstatohet se mungesa e lejes së ndërtimit tashmë dukuri vetëm jo vetëm për <u>shoqërinë A A E</u>, por për rreth 59-60 raste të tjera, të cilët identifikohen nga AKB si subjekte që nuk kanë leje ndërtimi ose kanë kryer punime në tejkalim të afateve të tyre. Mungesa e lejes së ndërtimit ose tejkalimi i punimeve jashtë lejes së miratuar, kërkon mos njohjen e kreditimit të TVSH-së dhe njekohesit rimbursimit të kërkuar. Kredimi i TVSH-së në mungesë të lejes së ndërtimit dhe mos veprimi i organeve tatimore për vlerësim tatimor, bie në kundërshtim me kërkesat ligjit nr.92/2014, datë 24.07.201 "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar, dhe pika 8/d të nenit 20, të Udhëzimit Ministrit Financave nr.6, datë 30.01. 2015 "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Rëndësi në këtë procedurë ka edhe faktori kohë, pasi keto veprime duhet të ndërmeren sipas kërkesave të nenit 73 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” pasi e drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës (ligji TVSH).</p> <p>2.Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kryen kontrolle tatimore në bazë të planeve mujore për kontroll, dhe në asnjë rast nuk ka konkluduar në një Plan të Përgjithshëm Kontrolli për një vit kalendarik i cili duhet të miratohet brenda muajit dhjetor të vitit paradhës, duke synuar përfshirjen në kontroll të tatimpaguesve me riskun më të lartë. E njëta procedurë zbatohet dhe për drejtoritë rajonale. Këto veprime nuk janë përputhje me paragrafin 80.4.1 UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për</p>
--	---

	<p>Procedurat tatimore”.DMR për vitin 2019 ka planifikuar në total 2,025 kontrolle, kontrolle të plota janë 1,097 raste dhe vizita fiskale janë 928 raste. Krahastuar me vitin 2018 në total rezultojnë më pak 228 kontrolle ose - 10.12% se viti 2018, nga të cilat kontrolle të plota më pak 254 raste dhe vizita fiskale më tepër 26 raste. Në totalin e kontrolleve të miratuara nga DMR në DPT janë përzgjedhur për kontroll 1587 raste ose 78.37% e totalit dhe propozim të DRT-re janë miratuar për kontroll tatimor 438 raste ose 21.63% e totalit, raport i cili nuk është respektuar në miratimin e planit të kontrolleve për vitin 2019, veprime këto në mospërputhje me kërkesat paragrafin 9.2 pika 1 të Manualin për Menaxhimin e Riskut, Kapitulli IX, “Përzgjedhja për kontroll”. Planet mujore kanë ndryshur në shtese/pakësim për kërkesa për rimbursim dërguar për kontroll në DRT-re nga DRTVSH-së dhe jo nga DMR, për 24 raste (shitesë), dhe heqje/anullim kontrolli 4 raste, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin e Riskut, Kapitulli IX, “Përzgjedhja për kontroll”, paragrafi 9.2 pika.1, sipas të cilit planifikimin e kontrolleve tatimore i cili duhet kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut të DPT</p> <p>3. Gjatë vitit kalendarik është kryer vlerësim për detyrime tatimore për 2,041 kontrolle në shumën 9,259,180 mijë lekë me më pak zbulim në shumën 1,332,068 mijë lekë ose rënie 13 %, krahasuar me vitin 2018 ku zbulueshmëria ishte në shumën 10,591,249 mijë lekë. Faktorët kryesore që kanë ndikuar në rënien e shkallës së vlerësimit tatimor nga kontrolli operacional është mos përzgjedhja për kontroll e tatimpaguesve që paraqesin rrezikun më të madh në të ardhurat tatimore dhe profesionalizimi jo në nivelin e duhur inspektorëve të kontrollit operacional, përgjegjësi kjo e drejtimit në DPT dhe DRT-re. Drejtoritë Rajonale Tatimore nuk kanë kryer kontrolle operationale në bazë të planit mujor të miratuar nga DMR në DPT. Nga auditimit rezultojnë se vlerësimet tatimore të kontrollit operacional vitit 2019 i përkasin 1,384 raste në vlerë 1,316,555 mijë lekë. Ndërsa rastet e tjera të nxjerrjes se detyrimeve tatimore i përkasin vitit 2017 për 18 raste në vlerë 388,883 mijë lekë, vitit 2018 i përkasin 639 raste në vlerë 7,553,742 mijë lekë. Kjo procedure kontrolli e zbatuar në DRT-re vjen në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, pika 1.6.1 në planifikim dhe ndjekjen e planit të kontrolleve.</p> <p>4. Nga rezultati i rikontrolleve tatimore të ushtruara në drejtoritë rajonale rezultojnë se nga 33 rikontrolle rezultojnë me vlerësim tatimor 18 raste në shumën 11,467 mijë lekë dhe 15 raste rezultojnë me zero vlerësim tatimor. Vlerësim më të lartë tatimor nga rikontrolli në shumën mbi 100.000 mijë lekë rezultojnë 4 subjekte. Rezultati i gjetjeve me zero vlerë ose vlera minimale nga rikontrolli tatimor, ulu ndjeshëm ose rrezon arsyet e rikontrollit tatimor të cilat ose nuk kanë qenë ekzistente para fillimit të rikontrollit dhe kjo është përgjegjësi e strukturave drejtuese që kanë miratuar rikontroll ose për shkak të shkallës së ulët profesionale të inspektorëve të kontrollit operacional.</p>
--	---

	<p>5. Në planin sektorial projekti “Bar & Restorante” nga 100 kontrolle planifikuara janë realizuar 48 kontrolle ose 48% e totalit me vleresim tatimor në shumën 26.349 mijë lekë, duke mbetur pa realizuar 52 subjekte tatimor ose 52% e kontrollve me risk të moderuar. DRT që nuk kanë realizuar rastet e kontrolleve të planifikuar janë DRT Durrës për 8 raste; DRT Fier për 1 rast; DRT Kukës për një rast; DRT Tiranë për 39 raste dhe DRT Vlorë për 3 raste. Kontrolli tatimor është i llojit “<i>Kontroll i plotë</i>” përfshin periudha tatimore për tatim fitimin, tvsh, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhurat personale, etj nga 2-5 vjet dhe ka të evidentuar për çdo rast faktoret e riskut. Nga auditimi rezulton se rezultati pas kontrollit për tvsh në shumë raste është me vleresim tatimor në shumën minimale, situatë e cila nuk është në përputhje me kriteret e vleresimit të riskut arsye për të cilën subjekti është miratuar për kontroll tatimor, si vlerat të larta të blerjeve në raport me shitjet e deklaruar sipas modulit të riskut, vlera të uleta të tatimit mbi fitimin në funksion të shpenzimeve dhe të ardhurave, vlera të uleta të vleresimit tatimor lidhur nivelin e pagave të punonjësve për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vlerësuar sipas modulit të riskut si ndjeshëm në nivelin mesatar të tregut apo afër pragut të pagës minimale të përcaktuar.</p>
Kriteri	<p>Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75/1; dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75/1; Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, neni 77; UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar; -Rregullorja e Brendshme e Administratës Tatimore Qendrore;</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Nuk është vepruar për identifikimin e gabimeve në vlerësim dhe vjeljen e të ardhurave tatimore që janë pasojë e deklarimit me të vogël dhe të papaguar, si dhe duke mos siguruar dekurajimin e evazionit dhe të shmangies tatimore, sipas kërkesave të Legjislacionit tatimor, Manualit të Kontrollit tatimor dhe Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore</p>
Rëndësia	I Lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 6272/52 prot, datë 23.09.2020 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga znj.IA, protokolluar në KLSH me nr.339/6 prot, datë 24.09.2020, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pika 5 e observacionit mbi kontrollin kryerë për 24 raste të cilat citohen si të paplanifikuara në planet mujore ju sqarojmë rast pas rasti se, 15 kontrolle janë me shkresë të dërguara nga DRTVSH-së, të cilat janë shprehur për kontroll nga zyra, të cilat nuk përfshihen në planet mujore, por janë detyra funksionale të inspektorit nga zyra në zbatim të Rregullores dhe Manualit të Kontrollit nga Zyra si dhe Manualit të Drejtorisë së Rimbursimit. Për 9 rastet e tjera sqarohet se 8 kontrolle janë me formular Nr. 4 (plan mujor i miratuar nga DMR dhe 1- kontroll është kontroll jo – rimbursim por i planifikuar në Tetor 2017). Bashkëlidhurdokumentacioni justifikues:

Oëndrimi i Grupit të auditimit: Në bazë të argumenteve dhe dokumentacionit të paraqitur të 24 rastet e sipërcituara konstatohen se janë propozime për kontroll nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, të cilat mungonin si informacion në data bazën e paraqitur prej jush, si dhe mungojnë në data bazën e kontrolleve të planifikuara nga DMR . Me paraqitjen e dokumentacioni shtese bashkëlidhur obesravecinit tuja, rezulton si më poshtë vijon:

-Me formular F.4, që korrespondon me planifikim mujor të miratuar nga DMR rezultojnë gjithsej 6 raste dhe jo 8 raste sa pretendoni ju në observacion përkatësisht L 2006; T M.A; PP; G G; D F; F P Shpk, Per subjektin T T Co me shkresën nr. 643/2 prot, datë 11.03.2019 rezulton se DKT në DPT ka dërguar Raport Kontroll Tematik mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga kjo drejtori sipas Autorizimit nr. 643, dt 10.01.2019 “Për verifikimin e detyrave të lëna nga kontrolli tatimor sipas Autorizimit nr. 8647, datë 13.04.2017 ” mbi kontrollin e ushtruar në DRT Korçë për vitin 2017 dhe 6-mujorin e parë 2018. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me kontroll tatimor, madje as rikontroll, pasi sipas këtij akti rezulton verifikim procedurash për dhe ndërprerje e rikontrollit për këtë subjekt. Tatimpaguesi “PB” shpk , me NIPT LxxxxxA, i administruar në DRT Fier, nuk rezulton i planifikuar me formular F.4, por me shkresën nr. 7117/2 prot, datë 12.04.2019 rezulton se është dërguar për “kontroll në vend” për miratimin e kërkesës për rimbursim në shumën 1.285.243 lekë për periudhën Prill-Shtator 2018.

-Përsa i përket 15 rasteve të tjera të pretenduara nga ju si kontroll nga zyra, nga DKT në DPT ato janë raportuar si kontrolle tatimore të planifikuara dhe të realizuara sipas planit mujor.

Për sa ju argumentoni rezulton se grupi i auditimit bazuar në raportimin tuaj dhe dokumentacionin justifikues ka konstatuar mospërputhje midis planifikimit dhe realizimit të kontrolleve tatimore, të monitoruar nga drejtoria juaj. Në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore Nr.19, datë 22.02.2017 në Neni 125 pika 8 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së” nuk përcaktohet se kjo drejtori dërgon drejtpërdrejt në DRT-re kërkesë për kontroll të kërkesës për rimbursim. Këto janë raste të veprimit në kundërshtim me kërkesat e rregullores dhe nuk legjitimojnë veprimin e parregullt të DRTVSH-së, dhe njëkohësisht mosveprimin tuaj në mirë funksionimin e procedurës dergimit të subjekteve për kontroll tatimor, arsye për të cilën observacioni juaj nuk është i mbështetur në rregulloren e sipërcituar **dhe si i tillë nuk pranohet.**

Pika 7 Bashkëpunimi me AKBN. Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresë Nr.06/37, datë 06.09.2019, ka kërkuar informacion mbi një listë të Hec-ve nga disa DRT. Shkresa e ardhur e cila për dijeni i drejtohet edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit është dërguar nga DKT drejtuar DRT-ve dhe për dijeni AKBN-së me Nr.16799/1, datë 27.09.2019, DPT, Lënda: “Për veprim” dhe është kërkuar (duke tërhequr vëmendjen) DRT-ve të vihet në dispozicion të AKBN-së informacioni i kërkuar mbi këto HEC-e.

Me shkresë nr Nr.06/41, datë 12.09.2019 AKBN-ja ka kërkuar informacion lidhur me shoqritë koncensionare, në ndërtimin e HEC-eve sipas listës, të cilët veprojnë në mungesë të lejes së ndërtimit, apo në tejkalim të saj. Me shkresë me Nr.17042/1, datë 27.09.2019, drejtuar DRT-ve dhe për dijeni AKBN-së, lënda: “Për veprim” nga DKT i’u është kërkuar DRT-ve të kryejnë verifikimet përkatëse për koncesionarët e listës në drejtim të kreditimit të TVSH-së në ndërtim. DKT në DPT për HEC që janë në fazë prodhimi i është drejtuar MIE-së dhe për dijeni AKBN-së me Nr.18834/1, datë 05.11.2019, për vlerësimin e investimit në zbatim të rekomandimeve të KLSH-it si dhe pas takimit të zhvilluar midis Ministrisë së Sipërmarrjes, AKBN-së dhe MIE-së të zhvilluar në DPT. Në vijim të verifikimit të shoqërive koncensionare në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe pas shkresave të AKBN-së Nr.06/37, datë

06.09.2019; 06/41 datë 12.09.2019 dërguar për ndjekje me shkresat Nr.16799/1, datë 27.09.2019 dhe Nr.17042/1, datë 27.09.2019 është nisur shkresa me Nr.17042/10, datë 04.12.2019, Lënda: “Për bashkëpunimin në verifikimin e shoqërive koncesionare”. Në këtë shkresë DKT është fokusuar: a-Tek HEC-et që kanë përfunduar ndërtimin e HEC-eve dhe kanë filluar shfrytëzimin, për të cilat do të pezullohen procedurat e rimbursimit deri në certifikimin e volumit të punimeve. b-kryerjen e rikontrollit për të gjithë shoqëritë koncesionare në fushën e HEC-ve që kanë marrë rimbursim të TVSH-së, me grupe të përbashkëta pune AKBN dhe Administratë Tatimore. c-Mosnjohjen e kreditimit dhe pezullimin e procedurave të rimbursimit për ato shoqëri koncesionare që kanë ndërtuar pa leje nga institucionet përkatëse dhe me leje pjesore. d- Për këto hapa është kërkuar nga AKBN-ja lista me shoqëritë koncesionare sipas ndarjeve më sipër. Shkresa është drejtuar AKBN-së dhe për dijeni MFE-së, MIE-së dhe Ministrit të shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Gjithashtu në vijim për çdo kontroll të HEC-et, realizimi i tyre do të bëhet me grupe të përbashkëta mes Administratës Tatimore dhe AKB për certifikimin e volumit të punimeve. DK po ndjek me DRT procesin e vlerësimit dhe kreditimit të TVSH-se edhe për ato HEC-e të cilat nuk kanë kërkuar rimbursim, por janë në informacionin e dërguar nga AKB mbi lejet e ndërtimit. Në të gjitha rastet që tatimpagusi nuk ka leje do të zbatohen procedurat ligjore mbi mosnjohjen e kreditimit të tvsh-së.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa ju keni trajtuar në observacionin tuaj në lidhje me tatimpaguesit qëndërtojnë HEC-e dhe kreditojnë dhe rimbursojnë TVSH në kushtet e mungesës së lejes së ndërtimit ose tejkalimit të saj, në bazë të neni 116 pika 6 e Rregullores së Administratës Tatimore Qëndrore në cilesinë e Drejtorit të DK në DPT keni është përgjegjësinë citojmë : “Menaxhon zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara D.R.T-ve, duke marrë prej tyre evidenca dhe raporte mujore ku përmbledhen rezultatet dhe progresi i bërë kundrejt planit. U ofron D.R.T-ve mbështetje të drejtpërdrejtë teknike, metodologjike dhe drejtuese për zgjidhjen e problemeve specifike të dala gjatë ushtrimit të kontrolleve të kryera në fusha të panjohura të veprimtarisë ekonomike, ose në ato me shkallë të lartë vështirësie”. Për rastin e investuesve në HEC-e, jo vetëm “AA E” Sh.a, me NIPT L1xxxx , rezulton se mungesa e lejeve sipas AKB konstatohet edhe 59-60 tatimpagues në të gjithë territorin e RSH, për të cilën drejtoria juaj duhet te veprojë menjëherë për zgjidhjen e paligjshmërisë së konstatuar nga organi kompetent. Argumenti juajse DK në DPT në vijim për çdo kontroll të HEC-et, do të bëhet me grupe të përbashkëta mes Administratës Tatimore dhe AKBN për certifikimin e volumit të punimeve është i drejtë. Por theksojmë se DKT duhet të veprojë sa me shpejt, pasi konstatohet se tashme ka kaluar kohë dhe ligji i procedurave tatimore lejon vlerësim të ri tatimor brenda 5 viteve nga deklarimi i subjektit. Sipas korrespondencës me AKB tashmë është fakt se janë kryer punime në mungesw të lejes së ndërtimit, për pasojë kreditim i paligjshëm nga subjekti. Jeni ju si strukturw kontrolli që menaxhoni zbatimin e planeve të kontrolleve, duhet ti klasifikoni HEC-et me risk të lartë, dhe duhet të zgjidhni pa vonesë problematikën e sipër cituar sipas nenit 116 pika 6 të Rregullores së Administratës Tatimore Qëndrore, arsye për të cilën observacioni mbetet thjesht raportues, por nuk jep strategji për zgjidhjen përfundimtare **dhe si e tillë nuk qëndron.**

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.11, datë 24.07.2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, me observacionin me nr.prot.- datë 30.07.2020 , znj. I.A në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, duke cituar si më poshtë:

Pika 1 : Lidhur me kontrollet e kryera për 24 raste të cilat ju i citoni si të paplanifikuara në planet mujore ju sqarojmë rast pas rasti DRT kanë futur në planifikim për kontroll tatimor tatimpaguesit të cilët janë dërguar për kontroll nga Zyra drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Rimbursimit shkresa

për veprim bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore Nr 19.datë 22.02.2017 Neni 125 pika 8.

Qëndrimi i Audituesit:

Në bazë të argumenteve dhe dokumentacionit të paraqitur të 24 rastet e sipërcituara konstatohen se janë propozime për kontroll nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, të cilat mungonin si informacion në data bazën e paraqitur prej jush, si dhe mungojnë në data bazën e kontrolleve të planifikuara nga DMR . Me paraqitjen e këtij dokumentacioni nga ana juaj, përditësojmë të dhënat e tabelës si më poshtë vijon:

Referuar Manualit të Kontrollit Tatimor, kapitulli II, përcaktohet se plani mujor i kontrollit për secilën Drejtori Rajonale Tatimore hartohet si bashkëpunim ndërmjet tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe miratohet e dërgohet për zbatim nga kjo e fundit për secilën DRT. Zgjedhja e tatimpaguesve, që do të kontrollohen 30% e tatimpaguesve që do të përfshihen në planin e kontrollit të çdo muaji, do të seleksionohen bazuar në propozimet e dërguara nga çdo DRT në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DPT dhe 70% e tatimpaguesve që do të përfshihen në planin e kontrolleve të çdo muaji do të seleksionohen në bazë të analizës së riskut nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT, e cila sipas nenit 94 të Rregullores se Administratës Tatimore Qendrore, është përgjegjëse për analizën e riskut për kontrollin tatimor.

Në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit ju parashtrojmë se shumica e rasteve të sipërcituara janë dërguar për kontroll nga DRTVSH në drejtoritë rajonale tatimore përkatëse, por prej jush nuk sqarohet nëse këto raste janë të përfshira në planin e kontrollit tatimor nga DMR-ut dhe pse në tërësinë e rasteve vetëm këto raste nuk janë përfshirë në planin mujor të kontrolleve. Kjo mënyrë planifikimi për kontroll, duke vënë në dijeni DMR-ut se tatimpaguesi është planifikuar për kontroll, bie ndesh me kompetencat funksionale të kësaj drejtorie.

Në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore Nr.19, datë 22.02.2017 në Neni 125 pika 8 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së” nuk përcaktohet se kjo drejtori dërgon drejtpërdrejt në DRT-re kërkesë për kontroll të kërkesës për rimbursim. Këto janë raste të veprimit në kundërshtim me kërkesat e rregullores dhe nuk legjitimojnë veprimin e parregullt të DRTVSH-së., arsye për të cilën observacioni juaj nuk është i mbështetur në rregulloren e sipërcituar **dhe si i tillë nuk pranohet.**

Pika 2: Në lidhje me konkluzionin e auditit ku është konstatuar se Drejtoritë Rajonale Tatimore nuk janë kryer kontrolle operacional në bazë të planit mujor të miratuar nga DMR në DPT. Njëkohësisht DKT në DPT nuk ka kryer kontrolle ose verifikime mbi ecurinë e planit vjetor të drejtorive (akt-konstatimi me nr.11, date 24.07.2020 faqe 9), sqaron se Drejtoria e Kontrollit në DPT, ndjek zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, dhe mbi bazën e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji, ka analizuar e përpunuar vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale si dhe ka mbajtur evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR. Të gjitha të dhëna e raportuara nga DRT-të, mbas analizimit dhe përpunimit i dërgohen Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, në DPT, ku mbi bazën e këtij raportimi realizohet performanca mujore e Drejtorive të kontrolleve në DRT. Çdo muaj hartohen evidencat mbi kontrollin e planifikuara. Janë kryer dhe analizat e punës lidhur me performancat e punës së Drejtorive të Kontrollit në DRT, për periudhën, 3, 6, 9 dhe 12 mujore ku janë trajtuar analiza të gjendjes së treguesve të tvsh-së, tatim fitimit sigurimeve

shoqërore dhe të tjera, dhe ecurisë së punës si dhe nxjerrjen e problematikave të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT-te

Qëndrimi i Audituesit: Pretendimet e ngritura në këtë rast nuk përputhen me konstatimin e grupit të auditimit për kryerjen e kontrolleve operacional jashtë planit mujor të miratuar nga DPT. Pretendimi juaj është pasqyrim i detyrave funksionale që kryen DKT dhe nuk mbështet pretendimin tuaj, përkundrazi reflekton qartë se DKT monitorimi i punës së drejtorive rajonale tatimore për kontrollin lidhur me zbatimin e planit mujor nga ana e drejtorive të kontrollit tatimor në DRT nuk ka qenë në nivelin e duhur, veprime këto në jo në përputhje me 116 pika 2 të Rregullores së Administratës Tatimore qendrore, dhe si tillë dhe ky pretendim nuk qëndron **dhe si i tillë nuk pranohet.**

Pika 3: Në lidhje mesa citohet nga auditi se “Kontrollet e muajve në vijim reduktohen duke zbritur numrin e ditëve të kontrollit në dispozicion ...” (akt-konstatimi me nr.11, date 24.07.2020 faqe 10), sqarojmë seplanifikimi i kontrolleve kryhet në bazë të orëve të lira që ka në dispozicion çdo DRT-re. Totali i orëve për kontroll të plotë në vend nuk mund të jetë me i lartë se numri i orëve të përcaktuara për çdo DRT në varësi të numrit të inspektorëve në dispozicion. Koha totale në dispozicion të Drejtorive Rajonale Tatimore, llogaritet me numrin e inspektorëve të Drejtorive Rajonale Tatimore, shumëzuar me numrin e ditëve mujore të punës Llogaritja e kohës në dispozicion për kontrollin e tatimpaguesve si për kontrollin automatik ashtu edhe për atë të propozuar nga Drejtoritë Rajonale behet në varësi të llojeve të kontrolleve, në varësi të madhësisë Kapitulli XI, “Ditët e punës të parashikuara për kontroll”, Manuali i DMR.

Qëndrimi i Audituesit: Pretendimi juaj parashtron metodën e përcaktuar në Manual për planifikim kontrolli dhe nuk paraqet asnjë argument për moszbatimin e tij. Në observacionin tuaj ju nuk e citoni përcaktimin e plotë sipas pikë 1.6.1 të Manualit ku përcaktohet se “Nëse grupi i kontrollit nuk bën kontrollet e përzgjedhura për atë muaj, kontrollet e planifikuara për atë muaj, duhet të planifikohen për muajin e ardhshëm. Kontrollet e muajve në vijim reduktohen duke zbritur numrin e ditëve të kontrollit në dispozicion, dhe për pasoje, edhe numrin e tatimpaguesve të përzgjedhur”, arsye për të cilën pretendimi juaj nuk **qëndron dhe si i tillë nuk pranohet.**

Pika 4 : Në lidhje mesa citohet nga auditi se “Në zbatim të këtij rekomandimi dhe në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.9689, datë 06.09.2019 ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore(AKBN) dhe DPT. ...” (akt-konstatimi me nr.11, date 24.07.2020 faqe 18-21), sqarojmë si më poshtë Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT (më poshtë DKT), mbështetur në Rregulloren e Brendshme të DPT, si dhe në Manualin e Kontrollit Tatimor, është një strukturë që ka rolin e udhëheqësit metodologjik. Në funksion të këtij përcaktimi, nga DKT në DPT, në ndjekje të problematikës që lidhet me verifikimin dhe kontrollin e shoqërive koncesionare, si dhe të specifikave që shoqërojnë këtë problematikë (vijimi i punës në shoqëritë koncesionare pa leje, apo në tejkallim të lejes, rimbursimi i gjendjes kreditore të TVSH-së, kontrolli apo rikontrolli tatimor në këto shoqëri koncesionare, pezullimi i procedurave të rimbursimit...etj), duke patur parasysh rolin e saj si udhëheqës metodologjik janë kryer këto veprime:

-Është kërkuar bashkëpunimi i ngushtë me AKBN-në ku me shkresën me Nr.20787, datë 12.11.2019, është kërkuar krijimi i grupeve të përbashkëta të punës për verifikimin dhe vlerësimin e investimit për HEC-et që kanë kaluar në fazën e prodhimit të energjisë për saktësimin e vlerës së punimeve faktike të realizuara. Çdo informacion i ardhur nga AKBN-ja, është përcjellë drejt drejtorive rajonale tatimore duke kërkuar dhe marrjen veprimeve konkrete sipas rasteve specifike, si p.sh mosnjohja e gjendjes kreditore të TVSH-së, të krijuar nga shoqëritë koncesionare që kanë vepruar pa leje, apo në kalim të lejes nga institucionet përkatëse, duke pezulluar procedurat e rimbursimit deri në momentin që këto shoqëri do të pajisen me lejen pranë

institucioneve përkatëse. -Për ato shoqëri koncesionare, që janë në fazën e investimit dhe që kanë marrë rimbursim të TVSH-së do të procedohet me propozim për kryerjen e rikontrollit tatimor, si dhe për ato shoqëri koncesionare që kanë filluar tashmë shfrytëzimin, pra kanë mbaruar fazën e investimit, do të pezullohen procedurat e rimbursimit deri në momentin e certifikimit të volumit të punimeve. Janë ndërmarrë takime në DPT ndërmjet Ministrisë së Sipërmarrjes, AKBN dhe MIE, me temë diskutimi problematikat që lidhen me veprimtarinë e shoqërive koncesionare në fushën e HEC-eve. Në funksion të sa thamë më sipër janë shkresat e drejtuara drejtorive rajonale me Nr.16865 datë 10.09.2019, Nr.16799/1 datë 27.09.2019, Nr.16865/2 datë 02.10.2019, Nr.18045/1 datë 14.10.2019, Nr.20375/1 datë 10.09.2019, Nr.17042/12 datë 24.12.2019, Nr.17042/1 datë 27.09.2019.

Në lidhje me shoqërinë koncesionare "AAE" Sh.a, me NIPT Lxxxxx, ju informojmë se nga DKT në DPT, janë kryer të gjitha veprimet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi si dhe me çdo bazë ligjore që rregullon veprimtarinë e administratës tatimore në përgjithësi dhe DKT në veçanti. Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, pika c, që ka të bëjë me kryerjen e rikontrollit në shoqëritë koncesionare që janë në fazën e investimit është kërkuar ngritja e grupit të punës të përbashkët midis AKBN-së dhe Administratës Tatimore në funksion të kryerjes së rikontrollit. Lidhur me rezultatet e kontrollit të kryer fillimisht në këtë shoqëri koncesionare, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT e vlerëson të kryer detyrën e saj me hapat dhe veprimet e përshkruara në paragrafin më lartë, si një udhëheqës metodologjik dhe që nuk ushtron kontrolle të drejtpërdrejta tek tatimpaguesi. Sjellim në vëmendjen tuaj, se drejtoria rajonale tatimore e juridiksionit, në rastin konkret Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, është organi kompetent për vlerësimin e detyrimeve tatimore në shoqërinë "AA E" Sh.a me NIPT Lxxxx. Nga sa më lartë, DK në DPT ka ndjekur të gjitha rekomandimet e KLSH dhe zbatueshmërinë e tyre por nuk ka kompetencë të shprehë ligjshmërinë e shumës së TVSh, për sa kohë që nuk administron tatimpaguesit, por kjo e fundit është detyrë funksionale e Drejtorive Rajonale.

Në përfundim vlerësojmë seriozisht punën e audituesve të KLSH-së lidhur me DKT në DPT, dhe rekomandimet tuaja do të shërbejnë për përsosjen dhe përmirësimin cilësor të punës së kësaj drejtorie në të ardhmen.

Qëndrimi i Audituesit: Për sa ju keni trajtuar në observacionin tuaj në lidhje me tatimpaguesit që ndërtojnë Hec-e dhe kreditojnë dhe rimbursojnë tvsh në kushtet e mungesës së lejes së ndërtimit ose tejkallimit të saj, në bazë të neni 116 pika 6 e Rregullores së Administratës Tatimore Qëndrore keni është përgjegjësia e Drejtorit të DK në DPT citojmë : "Menaxhon zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara D.R.T-ve, duke marrë prej tyre evidenca dhe raporte mujore ku përmbledhen rezultatet dhe progresi i bërë kundrejt planit. U ofron D.R.T-ve mbështetje të drejtpërdrejtë teknike, metodologjike dhe drejtuese për zgjidhjen e problemeve specifike të dala gjatë ushtrimit të kontrolleve të kryera në fusha të panjohura të veprimtarisë ekonomike, ose në ato me shkallë të lartë vështirësie". Për rastin e investuesve në HEC-e, tashme jo vetëm "A A E" Sh.a, me NIPT Lxxxx , por mungesa e lejeve sipas AKB rezulton edhe për 59-60 tatimpagues në të gjithë territorin e RSH, për të cilën drejtoria juaj duhet te veprojë menjëherë për zgjidhjen e paligjshmërisë së konstatuar nga organi kompetent.

Ju arsyetoni se DK në DPT ka ndjekur të gjitha rekomandimet e KLSH dhe zbatueshmërinë e tyre, por nuk ka kompetencë të shprehë ligjshmërinë e shumës së TVSH-së për sa kohë ajo nuk administron tatimpaguesit, pasi kjo e fundit është detyrë funksionale e drejtorive rajonale që kanë tatimpaguesin nën juridiksion . Pretendimi juaj nuk qëndron për faktin se DK në DPT kur konstaton paligjshmëri nxjerrjes së aktit në papajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit fiskal, për shkak të mosveprimit të inspektorit tatimor në kryerjes e kontrollit tatimor në përputhje me

ligjin, ka të drejtë të veprojë sipas kërkesave të nenit 85 pika c të Ligjit 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore”, duke kërkuar rikontroll tatimor sipas procedurës ligjore.

Jeni ju si strukture kontrolli që menaxhoni zbatimin e planeve të kontrolleve tatimore të dërguara DRT-re dhe duhet të zgjidhni pa vonesë problematikën e sipërcuar sipas nenit 116 pika 6 të Rregullores së Administratës Tatimore Qëndrore, arsye për të cilën kërkesa juaj nuk gjen mbështetje ligjore dhe si e tillë nuk pranohet.

Për sa konstatuar në Akt-Konstatim nr. 11 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit, përgjegjesi menaxheriale për veprimet dhe mosveprimet mbajnë:

Znj. IA në cilësinë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor si strukture kontrolli që menaxhon zbatimin e planeve të kontrolleve tatimore të dërguara DRT-re dhe mos zgjidhja e problematikës për kontrollet mbi tatimpaguesit që krditojnë tvsh ne mungesë të lejes së ndërtimit referuar informacionit të AKBN, veprime në kundërshtim nenit 116 pika 6 të Rregullores së Administratës Tatimore Qëndrore.

Znj. DI në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve; për periudhën 18.07.2019-31.12.2019 bazuar në nenin 5 pika 5, të Rregullores së ATQ për mos menaxhim dhe mos zgjidhjen e problematikës për kontrollet mbi tatimpaguesit që kreditojnë tvsh në mungesë tw lejes sw ndërtimit referuar informacionit të AKBN, veprime në kundërshtim nenit 116 pika 6 të Rregullores së Administratës Tatimore Qëndrore.

Gjetja	Evidencat e raportimit të borxhit janë tepër sintetike dhe mbi to nuk mund të kryhen analiza mbi ecurinë e borxhit dhe efektivitetin e masave në nivel DRT-je. Aq më tepër nuk jepet informacion për borxhin jashtë sistemit³³, si monitorohet dhe pse shtohet. Nga DMF raportohet se numrii çështjeve në proces gjyqësore është 1,525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen se aktualisht janë 416 çështje gjyqësore në proces, me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë.
Situata	Nga administrata tatimore borxhi tatimor raportohet në shumën 116,994,228 mijë lekë ose 9,293,691 mijë lekë ose 8.6% më shumë se një vit më parë. Numri i çështjeve në proces gjyqësore është 1525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë për këto çështje nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen në proces gjyqësore 416 çështje me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë. Nga evidencat e konstatohet se borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet zë 60% të stokut të borxhit. Sipas anekseve shoqëruese të Pasqyrave Financiare, gjendja e debitorëve në fund të periudhës në auditim në sistemin C@TS është 117,996,398 mijë lekë për më tepër në shumën 8,891,504 mijë lekë ose 8.1% më shumë se gjendja debitorë e raportuar më 01.01.2019. Detyrimi i ri i vitit 2019 është 20,975,210 mijë lekë, ku debinë më të lartë të krijuar sipas llojit e zë tatimi TVSH –ja masën 34.53% të totalit ose në shumën 40,399

³³Borxhi ekzistues para implementimit të sistemit C@TS në vitin 2015

	miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,077 miliard lekë; Tatimi mbi fitimin në masën 27.04% të totalit ose në shumën 31,637 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,433 miliard lekë, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 12.92% të totalit ose në shumën 15,113 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,283 miliard lekë, etj.
Kriteri	Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 16, neni 88-104; dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02..09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar. Rregullorja e Brendshme e Administratës Tatimore Qëndror nenet 108-113.
Ndikimi/Efekti	lidhur me procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara të evidentuara si borxhi tatimor.
Rëndësia	I Lartë

DREJTIMI C: Auditim i zbatimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare për vitin 2019.

C1. Planifikimi i buxhetit të shpenzimeve, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit, i kriterëve në celjen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimi i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiorë dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH, ndryshuar me Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”;
- Aktin Normativ nr.02, datë 02.10.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar;
- Aktin Normativ nr.11, datë 24.12.2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar;
- Projekt Ligjin “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019” dhe treguesit fiskalë të konsoliduar të vitit 2019;
- VKM nr.25, datë 17.01.2018 “Për miratimin e kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2019-2021;
- VKM nr.128, datë 27.06.2018 “Për miratimin e tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”;
- VKM nr.462, datë 22.07.2015 “Për miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”;
- VKM nr.672, datë 22.11.2017 “Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”;
- Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

- Udhëzimi nr.7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen PBA 2019-2021”,
- Udhëzimi nr.7/2, datë 09.07.2018 “Për përgatitjen PBA 2019-2021”,
- Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësive të qeverisjes qendrore”.

1. Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2019.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor. Dokumenti i PBA-së, pasqyron kërkesat buxhetore të ministrive të linjës duke paraqitur me detaje qëllimet, objektivat, produktet dhe programet të secilës Ministri për vitin 2019, 2020, 2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për planifikimin e PBA e strategjik konstatohet se Programimi Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2019-2021 është bërë në dy faza:

Programimi në fazën e I-rë të PBA 2019-2021.

Kërkesave buxhetore 2019-2021, Faza I, të programit 01140 “Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore”, janë dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 9061, datë 30.04.2018 brenda afateve ligjore. Këto kërkesa përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimin nr.07, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”-si dhe udhëzimit nr.7/1, datë 28.02.2018 “Për hartimin e PBA 2019-2021” sipas një metodologjie të re për kostimin e politikave ekzistueses dhe kostimin e politikave të reja. Tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore 2019-2021 janë miratuar me VKM 128, datë 07.03.2018 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2019-2021”, në nivel programi. Projektimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, në vlerë **2,683,000 mijë lekë**, ndërsa kërkesat shtesë të institucionit janë në vlerën **3,037 mijë lekë**.

Në mijë lekë

	Emërtimi	PBA 2019-2021 Faza e I			
		Politika ekzistuese	Politika të reja	Totali	Kërkesa shtesë
600	Paga	1,550,000	0	1,550,000	0
601	Sigurime Shoqërore	255,000	0	255,000	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	693,500	0	693,500	0
605	Transferta Korente të Huaja	1,260	0	1,260	0
606	Transferta për familjet dhe individët	240	0	240	0
I	Shpenzime Korrente	2,500,000	0	2,500,000	0
230	Kapitale të Trupëzuara	6,210	0	6,210	0
231	Kapitale të pa Trupëzuara	70,790	106,000	176,790	3,037
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm	77,000	106,000	183,000	3,037
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0
II	Shpenzime Kapitale	77,000	106,000	183,000	3,037
I+II	Totali I Shpenzimeve	2,577,000	106,000	2,683,000	3,037

Kërkesat shtesë në këtë fazë të parë të PBA-së 2019-2021, për këtë program janë 3,037 mijë lekë dhe konkretisht në llogarinë 231 “Shpenzime Kapitale të pa Trupëzuara” në vlerën 3,037 mijë lekë.

Programimi në fazën e II-të të PBA 2019-2021.

Kërkesave buxhetore 2019-2021, Faza II, të programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave Tatimore”, janë dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 18698, datë

31.08.2018 brenda afateve ligjore. Tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore 2019-2021 janë miratuar me VKM nr. 462, datë 26.07.2018 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të PBA 2019-2021”, në nivel programi. Planifikimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuar nga Ministria e Financës, në vlerë **2,535,000 mijë lekë**. Këto kërkesa janë përgatitur në zbatim të udhëzimit nr. 7/2, datë 09.07.2018. Totali i kërkesave shtesë në këtë fazë përfundimtare të PBA 2019-2021 për DPT –në është në vlerën **813,360 mijë lekë**, konkretisht në llogarinë 231 “Shpenzime Kapitale të pa Trupëzuara” në vlerën 813,360 mijë lekë.

Në mijë lekë


	Emërtimi	PBA 2019-2021 Faza e II	
		Tavanet	Kërkesa shtesë
600	Paga	1,550,000	0
601	Sigurime Shoqërore	257,000	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	543,740	0
605	Transferta Korrente të Huaja	1,260	0
I	Shpenzime Korrente	2,352,000	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	6,210	0
231	Kapitale të Trupëzuara	176,790	813,360
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm	183,000	813,360
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0
II	Shpenzime Kapitale	183,000	813,360
I+II	Totali I Shpenzimeve	2,535,000	813,360

Referuar sa më lart, në mënyrë të përmbledhur, sipas Tavanëve të miratuara me VKM, shpenzimet buxhetore të programit “**Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**”, deri në fazën e Projekt Buxhetit të vitit 2019, janë programuar si më poshtë:

Në mijë lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2018	Faza e I PBA 2019	Faza e II PBA 2019	Projekt Buxhet 2019
600	Paga	1,313,263	1,550,000	1,550,000	1,451,000
601	Sigurime Shoqërore	217,997	255,000	257,000	372,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	806,631	693,500	543,740	421,741
605	Transferta Korente të Huaja	1,187	1,260	1,260	1,260
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,509	240	0	0
I	Shpenzime Korrente	2,341,587	2,500,000	2,532,000	2,246,001
230	Kapitale të Patrupëzuara	5,160	6,210	6,210	6,210
231	Kapitale të Trupëzuara	317,847	176,790	176,790	946,790
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	323,007	183,000	183,000	953,000
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0
II	Shpenzime Kapitale	323,007	183,000	183,000	953,000
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti	0	0	0	0
I+II +III	Totali I Shpenzimeve	2,664,594	2,683,000	2,535,000	3,199,001

Në mënyrë grafike, zërat kryesorë të planifikimit të shpenzimeve buxhetore paraqiten si në vijim:



Nga auditimi konstatohet se llogaria 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” dhe llogaria 231 “Shpenzime kapitale të pa trupëzuara” kanë ndryshime të konsiderueshme midis vlerës së planifikuar në fazën e parë të PBA-së 2019-2020 dhe vlerës së planifikuar për këto zëra në Projekt Buxhet dhe Ligjin e Buxhetit për vitin 2019. Konkretisht shpenzimet në zërin “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, në fazën e parë të PBA-së 2019-2021, janë planifikuar në vlerën 176,790 mijë lekë ndërsa në Projekt Buxhet janë planifikuar në vlerën 946,790 mijë lekë, duke u **rritur më shumë në vlerën 770,000 mijë lekë ose 520% më shumë se planifikimi në fazën e parë të PBA-së**. Zëri “Mallra dhe shërbime të tjera”, në fazën e parë të PBA 2019-2021 është planifikuar në vlerën 693,500 mijë lekë, ndërsa në Projekt Buxhet është planifikuar në vlerën 421,741 mijë lekë, **duke u zvogëluar me vlerën 271,759 mijë lekë ose është ulur 39.2% krahasuar me planifikimin fillestar**.

2. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

a. Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2019. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale për programin Menaxhimi i të Ardhurave Doganore është bërë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22760, datë 27.12.2018 me subjekt “Mbi detajimin e buxhetit të vitit për vitet 2019-2021”, mbështetur në Ligjin 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Programi “Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore”, për vitin 2019, çelet për vlerën **3,199,001 mijë lekë** të ndara në:

Shpenzime Korrente në vlerën totale 2,246,001 mijë lekë;

Shpenzime Kapitale në vlerën totale 953,000 mijë lekë nga të cilat Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën 953,000 mijë lekë.

Detajimi i Shpenzimeve Korrente në vlerën 2,246,001 mijë lekë është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23016/2, datë 07.02.2019 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2019”, të ndara me artikuj:

Llogaria 600 “Paga dhe shtesa” në vlerën 1,451,000 mijë lekë;

Llogaria 601 “Sigurime shoqërore” në vlerën 372,000 mijë lekë;

Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në vlerën 421,741 mijë lekë;

Llogaria 605 “Transferta të jashtme” në vlerën 1,260 mijë lekë.

Detajimi i Shpenzimet për investime në vlerën 953,000 mijë lekë, është miratuar me shkresën nr. 22760/286 datë, 12.02.2019, të Ministres së Financave dhe Ekonomisë, nga të cilat:

Llogaria 230 “Shpenzime kapitale të pa trupëzuar” në vlerën 6,210 mijë lekë;

Llogaria 231 “Shpenzime kapitale të patrupëzuara” në vlerën 946,790 mijë lekë.

Detajimi i “Fondit të Veçantë” në vlerën 3,400 mijë lekë, në llogarinë 606 “Transferta të buxheteve familjarë & individë” është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2401/2, datë 06.03.2019, “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2019”.

b. Mbi transferimin e fondeve buxhetore në zërin “Shpenzime korrente” për vitin 2019.

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2019, me miratimin e Nëpunësit të Parë Autorizues, është bërë rishpërndarja e fondeve buxhetore në zërin shpenzime korrente në **vlerën totale për 287,849 mijë leke e cila përfaqëson 12.8% të shpenzimeve korrente** të miratuara me Ligjin e buxhetit. Numri i lartë i transferimeve buxhetore tregon për një planifikim jo të mirë të shpenzime, në pikën 75 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” citohet se “*numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit*”.

Procedurat e ndjekura për transferimin e fondeve buxhetore për shpenzimet korrente janë kryer në përputhje me Ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar si dhe udhëzimit plotësues nr.1, datë 17.01.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”. Kjo rishpërndarje e fondeve konsiston si ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente të njësisë shpenzuese ashtu edhe ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente të njësisë të ndryshme shpenzueses po brenda të njëjtit program. Në këtë mënyrë përgjatë vitit 2019:

Llogaria 600 “Paga”, është pakësuar në vlerën 94,000 mijë lekë;

Llogaria 601 “Sigurime Shoqërore”, është pakësuar në vlerën 142,000 mijë lekë;

Llogaria 602 “Mallra dhe Shërbime të tjera”, është shtuar në vlerën 204,450.68 mijë lekë;

Llogaria 606 “Transferta”, është shtuar në vlerën 38,349.32 mijë lekë.

Nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se:

b.1 Me shkresën nr. 7142/2, datë 02.05.2019, me subjekt “Mbi kërkesën për transferim fondesh në buxhetin e vitit 2019 për shpenzime korrente”, të Nëpunësit të Parë Autorizues, është miratuar transferimi i fondeve buxhetore për Aparatin e DPT-së dhe DRT-të në vlerën **200,500 mijë lekë**. Ky transferim është bërë në përgjigje të shkresës nr. 8087, datë 17.04.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me subjekt “Kërkesë për transferim fonde në shpenzime korrente”, ku citohet se kjo kërkesë konsiston në përdorimin e fondeve të planifikuara për pagat e punonjësve të Administratës Tatimore Qendrore, të pa përdorura për shkak të mosplotësimit të numrit të planifikuar të punonjësve, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore të formës së prerë. Tabela e mëposhtme pasqyron transferimin e fondeve buxhetore të miratuara për shpenzimet korrente të kërkesës së mësipërme.

Në mijë lekë

Kod Instit	Institucioni	Programi	Llogaria	Kodi i projektit	Shuma
Pakësohet					200,500
1010039	Aparati DPT	01140	6000000	91004AA	60,000
1010039	Aparati DPT	01140	6010000	91004AA	130,000
1010049	DRT Fier	01140	6000000	91004AA	3,000
1010049	DRT Fier	01140	6010000	91004AA	1,000
1010073	DRT Shkodër	01140	6000000	91004AA	5,000
1010073	DRT Shkodër	01140	6010000	91004AA	1,500
Shtohet					200,500
1010039	Aparati DPT	01140	6020000	91004AA	94,423
1010039	Aparati DPT	01140	6020000	91004AC	91,557

1010040	DRT Tiranë	01140	6000000	91004AA	9,000
1010046	DRT Dibër	01140	6000000	91004AA	2,000
1010046	DRT Dibër	01140	6010000	91004AA	300
1010076	DRT Vlorë	01140	6000000	91004AA	3,000
1010076	DRT Vlorë	01140	6010000	91004AA	200

b.2 Me shkresën nr. 15736/2, datë 11.09.2019, me subjekt “Mbi kërkesën e DPT për rialokim të shpenzimeve korrente për vitin 2019”, të Nëpunësit të Parë Autorizues, është miratuar transferimi i fondeve buxhetore për Aparatin e DPT-së dhe DRT-të në vlerën **50,000 mijë lekë**. Ky transferim është bërë në përgjigje të shkresës nr. 16205, datë 30.08.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me subjekt “Kërkesë për transferim fonde në shpenzime korrente”, ku citohet se kjo kërkesë lidhet me nevojat e detyrime parësore siç janë shpenzimet për energji elektrike, posta, etj si dhe kërkesa për ekzekutimin monetar të dëmshpërblimit e punonjësve TIK të cilët si pasojë e ristrukturimit kanë kaluar në strukturën e AKSH-it. Tabela e mëposhtme pasqyron transferimin e fondeve buxhetore të miratuara për shpenzimet korrente të kërkesës së mësipërme.

Në mijë lekë

Kod Institucionit	Institucioni	Programi	Llogaria	Kodi i projektit	Shuma
Pakësohet					50,000
1010039	Aparati DPT	01140	6000000	91004AA	40,000
1010039	Aparati DPT	01140	6010000	91004AA	10,000
Shtohet					50,000
1010039	Aparati DPT	01140	6020000	91004AA	10,620.68
1010039	Aparati DPT	01140	6020000	91004AC	730
1010039	Aparati DPT	01140	6060000	91004AA	18,510.27
1010040	DRT Tiranë	01140	6000000	91004AA	4,000
1010040	DRT Tiranë	01140	6060000	91004AA	1,819.2
1010041	DRT Nj.T.M. Tiranë	01140	6060000	91004AA	1,670.88
1010042	DRT Berat	01140	6060000	91004AA	787.68
1010046	DRT Dibër	01140	6060000	91004AA	357.6
1010047	DRT Durrës	01140	6020000	91004 AA	2,100
1010047	DRT Durrës	01140	6060000	91004AA	1,667.52
1010048	DRT Elbasan	01140	6060000	91004AA	383.76
1010076	DRT Fier	01140	6060000	91004AA	1,488.6
1010051	DRT Gjirokastrë	01140	6060000	91004AA	568.92
1010055	DRT Korçë	01140	6060000	91004AA	541.8
1010058	DRT Kukës	01140	6060000	91004AA	580.68
1010060	DRT Lezhë	01140	6020000	91004AA	1,000
1010060	DRT Lezhë	01140	6060000	91004AA	828
1010071	DRT Sarandë	01140	6060000	91004AA	777.6
1010073	DRT Shkodër	01140	6060000	91004AA	1,155.96
1010076	DRT Vlorë	01140	6060000	91004AA	410.4

b.3 Me shkresën nr. 20981/2, datë 15.11.2019, me subjekt “Miratim rialokimi fondi në shpenzimet korrente”, të Nëpunësit të Parë Autorizues, administruar në DPT me nr. 21841, datë 04.12.2018, është miratuar **transferimi i pjesshëm** i fondeve buxhetore në vlerën **2,400 mijë lekë** mes produkteve të ndryshme në zërin e shpenzimeve. Ky transferim është bërë në përgjigje të shkresës nr. 20970, datë 14.11.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me subjekt “Kërkesë për transferimin fonde në shpenzime korrente”, ku kërkohej transferimi i fondeve buxhetore në vlerë **62,900 mijë lekë** nga fondet e planifikuara për pagat e punonjësve të Administratës Tatimore Qendrore të paplotësuar për shkak të mos plotësimit të numri të punonjësve për shlyerjen e detyrimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Tabela e mëposhtme pasqyron transferimin e fondeve buxhetore të miratuara për shpenzimet korrente të kërkesës së mësipërme.

Në mijë lekë

Kod Instit	Institucioni	Programi	Llogaria	Kodi i projektit	Shuma
Pakësohet					2,400
1010051	DRT Gjirokastrë	01140	6000000	91004AA	2,400

Shtohet					2,400
1010073	DRT Shkodër	01140	6000000	91004AA	2,200
1010060	DRT Lezhë	01140	6000000	91004AA	200

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmblëdhur planin fillestar të shpenzimeve korrente me ndryshimet e pësura gjatë vitit.

Në mijë lekë

	Shpenzime Korente	Buxheti Fillestar	Rialokime	Plani i Rishikuar
600	Paga	1,451,000	-94,000	1,357,000
601	Sigurime Shoqërore	372,000	-142,000	230,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	421,741	+204,450.68	626,191.68
605	Transferta Korente të Huaja	1,260	0	1,260
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	+38,349.32	38,349.32
I	Totali i Shpenzimeve	2,246,001		2,252,801

c. Mbi transferimin e fondeve buxhetore në zërin “Shpenzime Kapitale” për vitin 2019.

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2019, me miratimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është bërë rishpërndarja e fondeve buxhetore në zërin shpenzime kapitale në vlerën totale për 25,000 mijë leke e cila përfaqëson 2.6% të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të miratuara me Ligjin e buxhetit. Transferimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm është bërë në zbatim të Ligjit 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar si dhe udhëzimit plotësues nr.1, datë 17.01.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

Nga auditimi me përzgjedhje të dokumentacionit u konstatua se:

- Me shkresën nr. 8480, datë 24.04.2019, DPT ka kërkuar rialokim në fondin e investimeve në vlerën 25,000 mijë lekë midis projekti “Blerje infrastrukture për backup side në kuadër të planit të rimëkëmbjes nga katastrofa” dhe projektit “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimit i qendëruara për DPT/DRT”.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 7796/1, datë 15.05.2019, ka miratuara transferimit e fondeve për shpenzime kapitale dhe konkretisht është pakësuar projekti 18AV808 “Blerje infrastrukture për backup site në kuadër të planit të rimëkëmbjes nga katastrofat” në vlerën 25,000 mijë lekë (llogaria 231) dhe është shtuar projekti 18AV806 “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistemi telefonik voip dhe monitorimit të qendëruar për DPT/DRT” në vlerën 25,000 mijë lekë (llogaria 231).

d. Mbi ndryshimet e planit të buxhetit të vitit 2019 me Akte Normative.

Me Akti Normativ, nr. 02, datë 02.10.2019, “Për disa ndryshime në ligjin 99/2018 “buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, fondet buxhetore për Shpenzimet Korrente nuk kanë ndryshuar, ndërsa fondet buxhetore për Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm janë pakësuar me 15,000 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 16764/1, datë 17.09.2019, DPT ka kërkuar rialokim fondesh buxhetore në shpenzimet kapitale në vlerën totale 30,000 mijë lekë midis projekteve si në tabelën më poshtë:

Në lekë

Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i projektit	Përshkrimi i projektit	Shuma
Pakësohet				30,000,000
01140	231	18AV807		30,000,000
Shtohet				30,000,000
01140	231	-	Rikonstrukcion për DRT Tiranë	10,000,000
01140	231	-	Rikonstrukcion për DPT	7,000,000
01140	231	-	Rikonstrukcion për DRT Dibër	6,000,000
01140	231	-	Blerje pajisje elektronike, kompjuterike	7,000,000

Konstatohet se kërkesat për transferim fondesh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve **nuk kanë relacion shpjegues**. Veprime të tilla bien në kundërshtim me pikën 71 të Udhëzimit nr.9,

datë 20.03.2018 Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” ku citohet se “Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat” si dhe pikën 22, g të Udhëzimit plotësues nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, ku citohet se “Shtesat në planin e miratuar të projekteve të investimeve publike në kuadër të kontratave për punime shtesë ose të ndryshme në planin e projekteve, si dhe rialokimet e fondeve ndërmjet projekteve gjatë zbatimit të buxhetit, do të behën me miratim paraprak të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, bazuar në relacionin dhe argumentet mbi domosdoshmërinë e tyre”.

Me shkresën nr. 1734/67, datë 23.10.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të Aktin Normativ nr. 2, datë 02.10.2019 ka miratuar detajimin pjesor të fondeve për shpenzime kapitale, ku sipas të cilit projekt me Kod 18AV808 “Zhvillimi dhe mbajtja në funksion e e data warehouse” është pakësuar në vlerën 30,000 mijë lekë.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 17343/130, datë 31.10.2019, në zbatim të Aktin Normativ nr.2, datë 02.10.2019 ka miratuar detajimin e fondeve për shpenzimeve kapitale, për pjesën e mbetur, ku sipas të cilit janë shtuar projektet si më poshtë:

- Projekti me kod 18AV903 “Rikonstruksion DRT Tiranë” në vlerën 5,000 mijë lekë;
- Projekti me kod 18AV904 “Rikonstruksioni DRT Dibër”, në vlerën 6,000 mijë lekë;
- Projekti me kod M100024 “Fond i ngrirë (Blerje pajisje kompjuterike)” 4,000 mijë lekë.

Pas detajimit të Aktit Normativ nr. 2, datë 02.10.2019 me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 17343/130, datë 31.10.2019, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i ka lindur e drejta të ndërmarrë angazhime buxhetore në vlerën 20,000 mijë lekë, pas datës 15 Tetor 2019. Marrja e angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor është në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 51 ku citohet se “....Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”.

Me Akti Normativ, nr. 11, datë 24.12.2019 “Për disa ndryshime ne ligjin 99/2018 “buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, buxheti i DPT-së, nuk ka pësuar ndryshime. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2019 të DPT-së.

Në mijë lekë

Shpenzime Korrente	Fakti 2018	Buxheti Fillestar	Buxheti transferimit pas të fondeve	A.N.2	A.N.11
600, Paga	1,313,263	1,451,000	1,357,000	1,357,000	1,357,000
601, Sigurime Shoqërore	217,997	372,000	230,000	230,000	230,000
602 Mallra dhe Shërbime të Tjera	806,631	421,741	626,192	626,192	626,192
605 Transferta Korente të Huaja	1,187	1,260	1,260	1,260	1,260
606 Trans per Buxh. Fam & Ind	2,509	0	34,949	34,949	34,949
Totali i Shpenzimeve Korente	2,341,587	2,246,001	2,249,401	2,249,401	2,249,401
Sh. Kapitale të Patrupëzuara të Brendshëm	5,160	6,210	6,210	6,210	6,210
Sh. Kapiate të tupëzuar të Brendshme	317,847	946,790	946,790	931,790	931,790
Shpenzime Kapitale të Huaj	0	0	0	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale	323,007	953,000	953,000	938,000	938,000
Totali i Përgjithshëm	2,664,594	3,199,001	3,202,401	3,187,401	3,187,401

C1. Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Për vitin buxhetor 2019, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatimin të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4-mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 10438, datë 20.05.2019.

- Raporti i monitorimit 8-mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 17496, datë 20.09.2019.


- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2019 është dërguar me shkresën nr. 3767, datë 18.02.2020.

Për sa i përket programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” realizimi në terma sasiorë dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit, në mënyrë të përmblodhur paraqitet si në tabelën më poshtë:

Në mijë lekë

	Shpenzime Korente	Fakti 2018	Buxheti Fillestar	A.Normativ Nr. 02	A. Normativ Nr. 11	Fakti 2019	Diferenca
		1	2	3	4	5	6=5-4
600	Paga	1,313,263	1,451,000	1,357,000	1,357,000	1,298,563	-57,437
601	Sigurime Shoqërore	217,997	372,000	230,000	230,000	215,722	-14,278
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	806,631	421,741	626,192	626,192	574,146	-52,046
605	Transferta Korente të Huaja	1,187	1,260	1,260	1,260	1,120	-140
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,509	0	34,949	34,949	31,764	-3,185
I	Totali i Shpenzimeve Korente	2,341,587	2,246,001	2,249,401	2,249,401	2,212,315	-128,086
230	Kapitale të Patrupëzuara F. B	5,160	6,210	6,210	6,210	5,553	-657
231	Kapitale të Trupëzuara F.B	317,847	946,790	931,790	931,790	743,352	-188,438
230-231	Kapitale me Financim të Huaj	0	0	0	0	0	0
II	Totali i Shpenzimeve Kapitale	323,007	953,000	938,000	938,000	748,905	-189,095
III	Shp. të ardhurat jashtë limiti	0	0	0	0	0	0
	Totali i Përgjithshëm	2,664,594	3,199,001	3,187,401	3,187,401	2,870,220	-317,181

Grafiku në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2019, të programit 0140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”.



- **Programit 01140** “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” është realizuar në masën 89.8%, pra në vlerën 2,870,220 mijë lekë, kundrejt 2,870,220 mijë lekë të planifikuar me AN, ose me një mosrealizimi në vlerën 317,181 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar. Krahasuar me planin fillestar programi 01140 është realizuar në masën 89.7%, me një mos realizim në vlerën 328,781

mijë lekë kundrejt planit fillestar. Kundrejt vitit 2018, programi 01140 është realizuar 7.2% më shumë ose realizuar më shumë në vlerën 205,626 mijë lekë.

- **Shpenzimet korrente** janë realizuar në masën 94.3%, pra në vlerën 2,121,315 mijë lekë kundrejt 2,249,401 mijë lekë të planifikuara me AN, ose me një mosrealizim në vlerën 128,086 mijë lekë krahasuar me planin e rishikuar. Krahasuar me planin fillestar shpenzimet korrente janë realizuar në masën 94.4% ose më mos realizmin në vlerën 124,686 mijë lekë. Kundrejt vitit 2018, shpenzimet korrente janë realizuar 10% më pak, ose realizuar më pak në vlerën 2220,272 mijë lekë.

- **Shpenzimet kapitale** janë realizuar në masën 79.8%, pra në vlerën 748,905 mijë lekë kundrejt 938,000 mijë lekë të planifikuara me AN, ose me një mosrealizim në vlerën 189,095 mijë lekë krahasuar me planin përfundimtar. Krahasuar me planin fillestar shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 78.6%, ose me një mosrealizimi në vlerën 204,095 mijë lekë. Kundrejt vitit 2018, shpenzimet kapitale janë realizuar për 323% më shumë ose janë realizuar më shumë në vlerën 425,898 mijë lekë.

- **Shpenzimet e Personelit** janë realizuar në masën 97.1%, pra në vlerë 1,541,285 mijë lekë kundrejt 1,578,000 mijë lekë të planifikuara me AN, ose me një mosrealizim në vlerën 72,715 mijë lekë krahasuar me planin e rishikuar. Krahasuar me planin fillestar shpenzimet e personelit janë realizuar në masën 83%, me një mosrealizimin në vlerën 308,715 mijë lekë.

- **Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime të tjera** janë realizuar në masën 92.7%, pra në vlerën 574,146 mijë lekë kundrejt 626,192 mijë lekë të planifikuara me AN, ose me një mosrealizim në vlerën 52,046 mijë lekë krahasuar me planin e rishikuar. Krahasuar me planin fillestar shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime të tjera janë realizuar më shumë në masën 26.5% ose janë realizuar më shumë në vlerën 152,405 mijë lekë. Kundrejt vitit 2018, shpenzimet korrente për mallrat dhe shërbime të tjera janë realizuar 29% më pak, ose realizuar më pak në vlerën 232,485 mijë lekë.

Tabela në vijim parqet planifikimin e Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm dhe realizimin e tyre.

Në mijë lekë

Projekti	Përshkrimi	PBA Faza I	PBA Faza II	Projekt ligj	Ligj Buxheti	Rial okim	AN. 02	Fakt
M1000255	Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020	6,210	6,210	6,210	6,210		6,210	5,553
M100448 Në PBA faza II Ndryshuar Kodin (M100500)	Sigurimi i shërbimi eficient dhe cilësor ndaj tatimpaguesit nëpërmjet fuqizimit, modernizimit dhe orientimit si duhet të strukturave përkatëse - Në projekt ligj ndryshuar përshkrimin (Përmirësimi i modulit të Menaxhimit të kontrollit të faturimit)	70,790	70,790	840,790	840,790		840,790	668,952
18AV806	Sigurimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data centër, sistemi telefonik voip dhe monitorimi i qëndrësuar DPT/DRT)	51,000	51,000	51,000	51,000	+25,000	76,000	74,400
18AV807	Zhvillimi dhe mbajtja në funksion e data çarëhouse	30,000	30,000	30,000	30,000		0	0
18AV808	Blerje infrastrukture për backup site në kuadër të "Planit të rimëkëmbjes nga katastrofat"	25,000	25,000	25,000	25,000	- 25,000	0	0
18AV903	Rikonstrukcion DRT Tiranë	-	-	-	-		5,000	0
18AV904	Rikonstrukcion DRT Dibër	-	-	-	-		6,000	0
M100024	Fondi i ngrirë (Blerje pajisje kompjuterike)	-	-	-	-		4,000	0

- Projekti i investimit me kod M100500 “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”. Nga auditimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2018, referuar regjistrin të Agjencisë së Prokurimit Publik është konstatuar se Fondi i Prokuruar pa TVSH nga Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit për projektin e investimit “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit” është 1,869,825 mijë lekë. Data e lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues “J S” me NIPT LXXXXV, është 27.11.2018 me afat 48 muaj. Referuar vlerës së fondit të prokuruar pa tvsh, konstatohet se, vlera e kontratës është 2,238,184 mijë lekë. Referuar të dhënave të SIFQ, konstatohet se, fondet për 2,238,184 mijë lekë janë angazhuar si në vijim:

Në mijë lekë

Llogaria	Vlera	Vlera	Përshkrimi	Viti
2313500	170,025		Parapagim për kontratën	2018
231500	840,790		Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit	2019
231500	716,976		Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit	2020
6025400		64,500	Mirëmbajtje e Përmirësimit të Modullit të Menaxhimit...	2020
6025400		258,000	Mirëmbajtje e Përmirësimit të Modullit të Menaxhimit...	2021
6025400		187,892	Mirëmbajtje e Përmirësimit të Modullit të Menaxhimit...	2022
Totali	1,727,791	510,392		

Nga auditimi konstatohet se Projekti me kod M100500 “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2019-2021. Referuar fazës së dytë të PBA-së 2019-2021, projekti i mësipërm megjithëse datë fillimi ka vitin 2018 (pra është projekt në vazhdim) dhe datë mbarimi vitin 2020, rezulton se fondet buxhetore janë ndarë dhe planifikuar si më poshtë:

- Detajimi i buxhetit të vitit 2018, në vlerën 259,280 mijë lekë;
- Parashikim për vitin 2019, në vlerën 70,790 mijë lekë;
- Parashikimi për vitin 2020, në vlerën 0 mijë lekë;
- Parashikimi për vitin 2021, në vlerën 0 mijë lekë.

Referua sa më lartë në PBA faza e dytë nuk është planifikuar e plotë vlera e parashikimit për vitin 2019, si dhe nuk është parashikuar vlera e këtij investimi për vitet 2020 dhe 2021.

Sipas shkresës nr. 22760/286, datë 12.02.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, projekti me Kod M100500 për vitin 2019 është çelur në vlerën 840,790 mijë lekë. Konstatohet se në listën e **Investimeve Publike 2019-2021**, të projekt buxhetit të vitit 2019, **nuk është parashikuar vlera e këtij investimi për vitin 2020** e cila referuar kontratës së lidhur për këtë projekt është **716,976 mijë lekë**. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 6,f të Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 të Ministrisë së Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, ku citohet se: “Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme përmbajnë: ...f) shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me: i. koston e plotë të projektit; ii. vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës; iii. vlerën e parashikuar për t’u financuar në vitin buxhetor; iv. vlerën e mbetur për t’u financuar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit...”

- Projekti i investimit me kod 18AV903 “**Rikonstruksioni i DRT Tiranë**”

Me shkresën nr.17343/130, datë 31.10.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me subjekt “Në zbatim të Aktit Normativ nr.2”, është miratuar detajimi i pjesë së mbetur të fondeve për shpenzime kapitale, ku është shtuar projekti me kod 18AV903 “Rikonstruksion DRT Tiranë”, në vlerën 5,000 mijë lekë. Nga auditim konstatohet se ky projekt është i ri dhe **nuk ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike**, pra nuk ka qene pjesë e planifikimeve në fazën e parë dhe në fazën e dytë të PBA-së 2019-2021 si dhe nuk rezulton të jetë në “Listën e Investimeve Publike për vitin 2019-2021” të projektbuxhetit të vitit 2019. Veprime të tilla bien

në kundërshtim me nenin 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Projekti i investimit me kod 18AV904 **“Rikonstruksioni i DRT Dibër”**

Me shkresën nr.17343/130, datë 31.10.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me subjekt “Në zbatim të Aktit Normativ nr.2”, është miratuar detajimi i pjesë së mbetur të fondeve për shpenzime kapitale, ku është shtuar projekti me kod 18AV904 “Rikonstruksion DRT Dibër”, në vlerën 6,000 mijë lekë. Nga auditim konstatohet se ky projekt është i ri dhe **nuk ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike**, pra nuk ka qene pjesë e planifikimeve në fazën e parë dhe në fazën e dytë të PBA-së 2019-2021 si dhe nuk rezulton të jetë në “Listën e Investimeve Publike për vitin 2019-2021”, të projektbuxhetit të vitit 2019. Veprime të tilla bien në kundërshtim me nenin 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Gjetja	Mos planifikimi i drejtë i shpenzimeve buxhetore.
Situata	<p>Nga auditimi është konstatuar Ekipi i Menaxhimit të programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk ka planifikuar drejt shpenzimet buxhetore. Shpenzimet për vendime gjyqësore në PBA faza e I-rë janë planifikuar në vlerën 50,964 mijë lekë, ndërsa në PBA faza II-të janë planifikuar në vlerën 50,000 mijë lekë, ndërkohë që nevojat buxhetore vetëm për një prej elementëve të shpenzimeve gjyqësore, detyrimet për vendime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna, në fund të vitit 2018 janë në vlerën 287,615 mijë lekë.</p> <p>Shpenzimet në zërin “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, në Projekt Buxhet janë planifikuar në vlerën 946,790 mijë lekë, duke u rritur më shumë në vlerën 770,000 mijë lekë ose 520% më shumë se planifikimi në fazën e parë të PBA-së. Zëri “Mallra dhe shërbime të tjera në Projekt Buxhet është planifikuar në vlerën 421,741 mijë lekë, duke u zvogëluar me vlerën 271,759 mijë lekë ose 39.2% krahasuar me planifikimin fillestar.</p> <p>Përgjatë vitit 2019, me miratimin e Nëpunësit të Parë Autorizues, është bërë rishpërndarja e fondeve buxhetore në zërin shpenzime korrente në vlerën totale për 287,849 mijë lekë e cila përfaqëson 12.8% të shpenzimeve korrente të miratuara me Ligjin e buxhetit. Referuar pikës 75 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, numri i lartë i transferimeve buxhetore tregon për një planifikim jo të mirë të shpenzime.</p> <p>-Projekti i investimit me kod M100500 “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2019-2021. Referuar fazës së dytë të PBA-së 2019-2021, projekti i mësipërm megjithëse datë fillimi ka vitin 2018 dhe datë mbarimi vitin 2020, fondet buxhetore për vitin 2020 dhe 2021 janë planifikuar në vlerën 0 lekë. Gjithashtu në listën e Investimeve Publike 2019-2021, të projekt buxhetit të vitit 2019, nuk është parashikuar vlera e këtij investimi për vitin 2020 e cila referuar kontratës së lidhur për këtë projekt është 716,976</p>

	<p>mijë lekë, jo në përputhje me e pikës 6 të Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 të Ministrisë së Financave.</p> <p>- Projektet e investimeve me kod 18AV903 “Rikonstruksioni i DRT Tiranë” dhe kod 18AV904 “Rikonstruksioni i DRT Dibër” nuk kanë kaluar procedurat e miratimit të investimeve publike, pasi nuk kanë qene pjesë e planifikimeve në fazën e parë dhe në fazën e dytë të PBA-së 2019-2021 si dhe nuk rezultojnë në “Listën e Investimeve Publike për vitin 2019-2021” të projektbuxhetit të vitit 2019, jo në përputhje me kërkesat e nenit 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.</p>
Kriteri	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
Ndikimi/Efekti	Paraqet risk për mos identifikimin e drejtë të treguesve sasiorë dhe cilësorë, mbi bazën e të cilave vlerësohen rezultatet dhe performanca e programit.
Rëndësia	I lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.2, datë 24.07.2020.

Mbi projekt raportin e Auditimit të DPT-së, në lidhje me çështjen e trajtuar më sipër është paraqitur observacioni nr. 333/5, datë 09.09.2020, nga zj.DC ku pretendohet se: Çdo shkresë e përcjellë në MFE është e shoqëruar me informacionin përkatës për çdo investim të kërkuar. DPT në aspektin buxhetor është njësi shpenzuese dhe tavanet dhe fondet buxhetore miratohen nga MFE, të cilat përcillen çdo fillimi viti për njohje dhe shpenzim. Në momentin e përcjelljes së tavanëve buxhetore DPT i është drejtuar MFE mbi pasjen e fondeve të pamjaftueshëm për “Përmirësimin e modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit”. Në lidhje me Rikonstruksionin e DRT Tiranë dhe Dibër, theksohet se procedurat e miratimit të investimeve publike nuk janë pjesë dhe detyrë e DPT-së. DPT bën kërkesa për rialokim dhe argumentimin përkatës duke e shoqëruar me fishat e investimit, procedurat e miratimit, aprovimit ose jo nuk janë pjesë apo detyrë funksionale e procedurës së DPT-së. Në lidhje me planifikimin buxhetor, së pari quhet planifikim, parashikimi i të cilit afrohet në maksimumin e mundshëm planeve dhe projekteve tona. DPT është një institucion mjaft dinamik. DPT , e fondet e alokuara ka bërë maksimumin për realizimin e tyre. Nuk mund të lihen veprime të tilla kur ky institucion menaxhon në mënyrë dinamike 14 drejtori rajonale, 1512 personel ku kërkesat janë po aq dinamike. Vendimet gjyqësore janë tërësisht të pamundura për tu planifikuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Pas shqyrtimit të observacionit grupi i auditimit sqaron zj. C se nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi për sa i përket miratimit apo jo nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të shkresave për alokimin e fondeve për shpenzime kapitale apo operative. Për sa i përket planifikimit buxhetor pavarësisht madhësisë dhe kompleksitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, planifikimet duhet të jenë sa më afër realitetit. Në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit është cituar se numri i alokimieve është tregues i performancës.

C2. Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, nënshkrimi i pasqyrave financiare nga personat e pëcaktuar në ligj. Plotësimi i pasqyrave financiare me të gjitha tabelat dhe shënimet shpjeguese.

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006 dhe ligjin nr. 10110, datë 7 2.4.2009;

-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006”;

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Urdhri i Ministrit nr.64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”.

Konstatohet se Pasqyrat Financiare të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë dërguar në degën e thesarit Tiranë me shkresën nr. 5710, datë 12.03.2020, në përputhje me pikën 117 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Pasqyrat financiare të aparatit të DPT-së përmbajnë të gjitha pasqyrat që përcaktohen në pikën 25 dhe 26 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, konkretisht nga:

- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Pasqyra e performancës financiare;
- Pasqyra e flukseve monetare;
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Shënimet shpjeguese, si dhe pasqyrat statistikore;
- Pasqyrat e investimeve dhe burimit të financimit të tyre;
- Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Të gjitha pasqyrat financiare janë të firmosura nga nëpunësi zbatues, ndërsa shënimet shpjeguese janë firmosur nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi autorizues.

Në zbatim të ligjit të buxhetit, evidentimi i veprimtarisë financiare, mbajtja e kontabilitetit dhe konsolidimi i llogarisë vjetore, realizohet në 15 njësitë e sistemit tatimor, 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku administrimi i llogarive të shpenzimeve administrative të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është detyrë funksionale e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Pasqyrat financiare të konsoliduar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe degën e thesarit Tiranë me shkresën nr.5710/1, datë 05.05.2020, në përputhje me pikën 120 të Udhëzimit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Pasqyrat financiare të konsoliduar të DPT-së përmbajnë të gjitha pasqyrat që përcaktohen në pikën 102 të Udhëzimit të MFE-së nr.8, datë 09.03.2018, konkretisht nga:

- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Pasqyra e performancës financiare;
- Pasqyra e flukseve monetare;
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Shënimet shpjeguese, si dhe pasqyrat statistikore;
- Pasqyrat e investimeve dhe burimit të financimit të tyre;
- Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Nga auditimi konstatohet se shënimet shpjeguese të pasqyrave financiarë të konsoliduara nuk janë plotësuar si dhe nuk janë firmosur nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues, në kundërshtim me pikën nr. 110 të Udhëzimit të MFE-së nr. 8, datë 09.03.2018. Pasqyrat e tjera financiare janë të firmosura nga nëpunësi zbatues.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.6 datë 24.07.2020.

C2.1.Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare duke testuar saktësinë dhe plotësinë e paraqitur në zërat e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara. Janë raportuar të gjitha shtesat apo përmirësimet e kryera gjatë vitit në aktivin e duhur.

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Gjendja e llogarive të aktiveve të Aparatit të DPT-së, për vitin 2019, krahasuar me vitin paraardhës 2018, si dhe ndryshimet në vlerë midis dy viteve (2019-2018), paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2019	Ushtrimi Paraardhës 2018	Diferenca 2019-2018
A	AKTIVET	2,130,942,097	1,111,482,817	1,019,459,281
	I. Aktivët Afat shkurtër	799,485,801	432,034,337	367,451,464
	1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	11,196,327	14,634,378	-3,438,051
520	Disponibilitete në Thesar	11,196,327	14,634,378	-3,438,051
	2.Gjendje Inventari qarkullues	61,923,192	48,709,081	13,214,110
31	Materiale	59,480,012	47,370,359	12,109,652
32	Inventar i imët	75,953	75,073	0
35	Mallra	2,367,207	1,263,649	1,103,558
	3.Llogari të Arkëtushme	321,725,032	368,690,878	-46,965,846
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	769,485	227,490	541,995
4342	Operacione me shtetin(Tëdrejta)	320,995,547	368,463,387.60	-47,507,841
4	4. Të tjera aktive afatshkurtra	404,641,249	0	404,641,249
486	Shpenzime për periudhat e ardhshme	404,641,279	0	404,641,249
	II.Aktivët Afatgjatë	1,331,456,296	679,448,481	652,007,817
20	1.Aktive Afatgjatë jo materiale	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	0	0	0
21	2.Aktive Afatgjatë materiale	612,824,929	421,528,391	191,296,448
212	Ndërtesa e Konstruksione	118,916,811	125,173,805	-6,256,994
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	353,474,396	128,340,602	225,133,794
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	59,262,245	56,681,211	2,581,035
215	Mjete Transporti	45,967,716	54,954,823	-8,987,107
218	Inventar ekonomik	35,203,762	56,377,950	-21,174,188
	4.Investime	718,631,367	257,920,090	460,711,277
230	Për Aktive Afatgjatë jo materiale	24,457,600	18,904,600	5,553,000
231	Për Aktive Afatgjatë materiale	694,173,767	239,015,490	455,158,277

Burimi: Bilanci i Aparatit të DPT-së.

Totali i Aktivit për vitin 2019 është 2,130,940,097lekë, krahasuar me vitin 2018 rezulton me rritje në vlerën1,019,459,281 lekë. Aktivet Afatshkurtra paraqiten në shumën 779,485,801lekë, duke zënë rreth 37% të totalit të aktiveve, me një rritje prej 367,451,464 lekë krahasuar me vitin 2018, ndërsa Aktivet Afatgjata paraqiten në shumën 1,331,456,296 lekë, duke zënë rreth 63% të totalit të Aktivit, me një rritje prej 652,007,817 lekë krahasuar me vitin 2018.

Tabela në vijim paraqet se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve gjatë vitit 2019. Në lekë

Aktive	Çelje e vitit ushtrimor	Kosto historike	Shtesa gjatë vitit 2019	Pakësime gjatë vitit 2018	Amortizim	Gjendje në mbyllje vitit 2019	Ndryshimi 2019-2018
AAJomateriale	18,904,600	18,904,600	5,553,000	0	0	24,457,600	5,553,000
Koncesione, patenta, licensa	18,904,600	18,904,600	5,553,000	0	0	24,457,600	5,553,000
AA Materiale	421,528,398.6	871,976,027	304,921,446	60,198,525	503,874,015	612,824,930.10	191,296,539.3
Ndërtime dhe konstruksione	125,173,804.79	144,572,338	0	0	25,655,526	118,916,811.49	-6,256,993.10
Rrugë, rrjete, vepra ujore	128,340,601.8	286,804,764	257,227,431	0	190,557,799	353,474,395.50	225,133,793.7
Instalime teknike,makineri e pajisje	56,681,209.95	153,910,990	15,390,130	2,778,590	107,260,285	59,262,245.05	2,581,034.3
Mjete transporti	54,954,823.36	121,969,774	8,568,000	28,947,926	55,622,132	45,967,715.76	-8,978,107.6
Inventar ekonomik	164,718,159	164,718,159	23,735,885	28,472,009	124,778,273	35,203,762.3	-21,174,188
Totali	440,432,990	890,880,627	310,474,446	60,198,525	503,874,015.42	637,282,530	196,849,539.3

Shënim: Të dhënat të mara nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës së DPT-së dhe përpunuar nga grupi auditimit.

Aktivët Afatgjata paraqiten në shumën 1,331,456,296 lekë dhe përbëhet nga:

-Aktive Afatgjata jo materiale përfaqësojnë vlerën neto të aktiveve afatgjata jo materiale në të cilat rezultojnë të jenë në shumën 0 lekë. Nga auditimi i Pasqyrave financiarë të vitit 2018 është konstatuar se llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2018 është në total 18,906,600 lekë dhe përfaqëson kontribut vjetor FISCALIS 2020. Te pasqyrat financiarë të vitit 2019 rezulton se llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, për vitin paraardhës, pra vitin 2018 është 0 lekë. Konstatohet se Drejtoria e Buxhetit dhe Financës gjatë hartimit të pasqyrave financiar të vitit 2019, **ka ndryshuar rezultatin e llogarive të vitit të mëparshëm, pra vitit 2018**, konkretisht:

Llogaria	Përshkrimi	Vlera sipas Pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2018, për vitin 2018	Vlera sipas Pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2019, për vitin 218
20	Aktivët Afatgjata jo materiale	19,906,600	0
203	Studime dhe kërkime	18,906,600	0
	Totali i investimeve	257,920,090	239,015,490
230	Për Aktive Afatgjata jomateriale	0	18,906,600

Ndërkohë sipas Aneksit Statistikore “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe Aneksit Statistikor “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” rezulton se llogaria 202 “Studime dhe kërkime” është çelur në fillim të vitit 2019 në vlerën 18,904,600 dhe në fund të vitit 2019 gjendja e kësaj llogarie është 24,457,600 lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk rakordon gjendja e llogarisë 202 e pasqyruar në Pasqyrat e Pozicionit Financiar me Anekset mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me kosto historike dhe me vlerë neto.

- Aktivët Afatgjata Materiale: Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata materiale në shumën 612,824,929 lekë, e cila është diferencë midis shumës së përgjithshme të aktiveve afatgjata materiale 1,116,698,946 lekë dhe amortizimit të këtyre aktiveve në shumën 503,874,017 lekë, e detajuar sipas llogarive 212,213,214,215,218.

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” në vlerën 118,916,811.49 lekë përfaqëson vlerën e ndërtesës së Aparatit të DPT dhe rezulton me ulje krahasuar me vitin e mëparshëm në shumën 6,256,994 lekë, si rezultat i amortizimit.

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 353,474,395.5 lekë përfaqëson vlerën e programe, softje, licensa informatike së Aparatit të DPT-së dhe rezulton me rritje krahasuar me

vitin e mëparshëm në shumën 225,133,794 lekë, si rezultat i shtesave në shumën 257,227,431 dhe amortizimit në shumën 32,093,637 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 59,262,245.05 lekë përfaqëson vlerën e motogjeneratorë, server, HP storage, hardware, kondicionerë, etj informatike të Aparatit të DPT dhe rezulton me rënie krahasuar me vitin e mëparshëm në shumën 2,581,035 lekë si rezultat i shtesave në shumën 15,390,130 leke, pakësimit (nxjerrje jashtë përdorimit dhe pakësim brenda sistemit) në shumën 2,778,589 lekë si dhe amortizimit në shumën 10,030,505 lekë.

Llogaria 215 “Mjete Transporti” në vlerën 45,967,715.76 lekë e cila rezulton me rënie krahasuar me vitin 2018 prej 8,987,107.24 lekë si rezultat i shtesave (brenda sistemit) së automjeteve në shumën 8,568,000 lekë, pakësim (brenda sistemit) në shumën 28,947,926 lekë dhe amortizimit në shumën 11,392,819 lekë.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 35,203,762.3 lekë rezulton me rënie krahasuar me vitin 2018 në vlerën 21,174,187.7 lekë, si rezultat i shtesave (blerje dhe shtesa brenda sistemit) në shumën 23,735,886 lekë, pakësimet (nga dalje jashtë përdorimit dhe pakësim brenda sistemit) në shumën 28,472,009 lekë dhe amortizimit në shumën 16,438,063 lekë.

Amortizimi i Aktiveve

Amortizimi është llogaritur për çdo grup veç e veç sipas klasifikimit ekonomik. Si gjendjet në fillim, hyrjet daljet dhe gjendja në fund të këtyre 2 pasqyrave, janë të barabarta me llogaritë në aktiv të bilancit, përçes llogarisë 203, e cila në aktivet e bilancit rezulton në vlerën 0 lekë.

-Gjendja në fillim, shtesat dhe pakësimet paraqiten sipas tabelës së mëposhtme: Në lekë

Nr. Llog	Teprica në fillim		Shtesa gjatë vitit		Pakësime gjatë vitit		Teprica në fund		
	Kosto historike	Amortizimi akumuluar	Kosto historike	Amortizimi	Kosto historike	Amortizimi	Kosto historike	Amortizimi akumuluar	Teprica Neto
I	18,904,600	0	5,553,000	0	0	0	24,457,600	0	24,457,600
203	19,904,600	0	5,553,000	0	0	0	24,457,600	0	24,457,600
II	871,976,027	450,447,636	304,921,446	84,452,356	60,198,525	31,025,977	1,116,698,946	503,874,015	612,824,931.1
212	144,572,338	19,398,533	0	6,256,993	0	0	144,572,338	25,655,526	118,916,811.49
213	286,804,764	158,464,162	257,227,431	32,093,637	0	0	544,032,195	190,557,799	353,474,395.5
214	153,910,990	97,229,780	15,390,130	11,702,218	2,778,589	1,671,713	166,522,530	107,260,285	59,262,245.05
215	121,969,744	67,014,951	8,568,000	14,139,708	28,947,926	25,532,527	101,589,848	55,622,132	45,967,715.76
218	160,718,159	108,340,210	23,735,886	20,259,800	28,472,009	3,821,737	159,982,035	124,778,273	35,203,862.3
	890,880,627	450,447,636	310,474,446	84,452,356	60,198,525	31,025,977	1,141,156,546	503,874,015.42	637,282,530

Shënim: Të dhënat të mara nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës së DPT-së dhe përpunuar nga grupi auditimi.

Total Amortizimi të akumuluar për Aktivet Afatgjata rezulton 530,874,015 lekë, nga të cilat amortizimi i akumuluar i AAGJ jo materiale rezultojnë në vlerën 0 lekë ndërsa amortizimi i akumuluar i AAGJ materiale rezultojnë në vlerën 530,874,015 lekë.

Nga auditimi i llogaritjes së normave të amortizimit u konstatua se pas rekomandimeve të KLSH-së, në lidhje me normat e amortizimit është zbatuar pika 36 i Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Ndërsa për **aktivet afatgjata jo material**, edhe pas rekomandimeve të KLSH-së, **nuk është llogaritur amortizimi** në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ku citohet se “...Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%...”

Procedura e inventarizimit të aktiveve të Aparatit të DPT-së, për vitin 2019

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Regjistri i aktiveve të DPT-së.

-Dokumentacioni mbi kryerjen e inventarizimit.

-Dokumentacioni shoqërues i inventarizimit.

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Udhëzimi nr.20 datë 17.11.2014 “Për një ndryshim në udhëzimin nr.30”, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Udhëzimi nr. 24, datë 07.12.2016, Për një ndryshim në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për inventarizimin e pasurisë konstatohet se:

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në bazë të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ka nxjerrë urdhrin nr. 21428, datë 22.11.2018, së nr. 21498, datë 22.10.2018 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe magazinave të saj për vitin 2019” i përbërë nga 5 anëtarë, zj. D K, zj. A B, z.A Q, z. J S, zj. R D. Në urdhër shprehimisht citohet: “Komisioni përgatit raportin informues dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm. Materiali përmbledhës së bashku me raportin informues do të dorëzohet më pas pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës brenda datës 30.12.2019”.

Nga komisioni i inventarizimit janë mbajtur 221 procesverbale mbi rezultatet e inventarizimit, nga të cilat 5 procesverbal për magazinat dhe pjesa tjetër për vlerat materiale në ngarkim të punonjësve. Gjendja fizike e magazinave më datë 30.11.2019, paraqitet si më poshtë:

Procesverbali nr.1, datë 04.12.2019 gjendja në magazinën e materialeve është 25,741,641 lekë.

Procesverbali nr.2, datë 04.12.2019 gjendja në magazinën e mjeteve kryesore është 292,170,862lekë.

Procesverbali nr. 3, datë 04.12.2019 gjendja në magazinën materiale është 9,875,021 lekë.

Procesverbali nr. 4, datë 04.12.2019 gjendja në magazinën materiale është 10,812,975 lekë.

Procesverbali nr. 5, datë 04.2.2019 gjendja në magazinë e shtyp shkrimeve është 12,367,920 lekë.

Komisioni i inventarizimit me shkresë nr.21428/1 prot, datë 20.01.2020 ka dërguar raportin përfundimtar mbi inventarizimin fizik të aseteve në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave sipas inventarit kontabël të datës 30.11.2019.

Referuar Relacionit dhe dokumentacionit mbi rezultatet e inventarizimit të DPT-së, nuk janë konstatuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël. Gjendja e tyre paraqitet në shumën 874,897,268.51 lekë, e cila në mënyrë të detajuar sipas llogarive ekonomike deri më datë 30.11.2019, paraqitet si më poshtë:

lekë

Nr. Llogarisë	Vlera Kontabël	Vlera fizike
212	144,572,341	144,572,341
213	286,804,767.96	286,804,767.96
214	151,079,436.02	151,079,436.02
215	101,589,848	101,589,848
218	157,722,562.18	157,722,562.18
32	33,052,338.35	33,052,338.35
327	75,975	75,975
TOTALI	874,897,268.51	874,897,268.51

Burimi:Raporti mbi inventarizimin e DPT-së

Nga auditimi i praktikave të inventarizimit dhe vlerësimit konstatuar se:

- Komisioni i inventarizimit e ka përfunduar detyrën e ngarkuar 20 ditë me vonesë, në tejkalim të afatit të vendosur në Urdhrin e Titullarit nr. 21428, datë 22.11.2019;

- Në raportin e hartuar si dhe në pasqyrat e inventarizimit të nënshkruara nga punonjësi përgjegjës dhe komisioni në asnjë rast nuk janë bërë shënime mbi gjendjen fizike të materialeve.

Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.21428/2, datë 17.02.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” është ngritur komisioni i vlerësimit me 5 punonjës, konkretisht: zj. D C, z. P P, zj. A S, zj. P S, z.Y T. Kryetar i këtij komisioni është caktuar nëpunësi zbatues, në përputhje me përcaktimet e pikës 99 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në urdhër shprehimisht citohet: “Komisioni në përfundim të vlerësimit përgatit materialin për nxjerrje jashtë përdorimit të vlerave materiale në magazinë dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm brenda datës 03.03.2020”.

Nga auditimi konstatohet se komisioni i vlerësimit nuk e ka finalizuar procesin brenda afateve të përcaktuara.

Procedura e asgjësimit të aktiveve të Aparatit të DPT-së, për vitin 2019

Gjatë auditimit rezultoi se, strukturat drejtuese të DPT-së, kanë vijuar procedurat për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit të mallrave të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2018.

Me shkresë nr. 21498/5, datë 27.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhër “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, i përbërë nga 5 anëtarë konkretisht: z. S B, zj. A M; z. E I, zj.FK dhe z. E B. Nga auditimi konstatohet se kryetar i komisionit të vlerësimit nuk është Nëpunësi Zbatues, zj.D C, në kundërshtim me pikën 99 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar ku citohet se “...Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë...”

Me shkresën nr. 21498/6, datë 24.04.2019 është dërguar Raporti informues mbi vlerësimin e vlerave materiale në magazinat e DPT-së, sipas të cilët është propozuar nisja e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes apo asgjësimit përfundimtar për 59 artikuj me vlerë të mbetur gjithsej 883,972 lekë. Konstatohet se në relacionin e vlerësimit nuk janë llogaritur apo trajtuar efektet ekonomike të masave që mund të ndërmerren për riaftësimin e tyre në kundërshtim me pikën 106 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Me Urdhër nr.11417, datë 07.06.2019, të Drejtores së Përgjithshme, është ngritur komisioni për asgjësimin e vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i përbërë nga 5 anëtarë, konkretisht, zj. N B, z. G Zh, zj. AM, z. AD dhe z. AQ

Sipas Procesverbalin nr.1, datë 12.06.2019, komisioni i asgjësimit ka bërë inventarizimin e aktiveve të versuara për t’u nxjerr nga përdorimi.

Sipas Procesverbalin nr.2, datë 20.06.2019, komisioni vendosi për asgjësimin nëpërmjet shkatërrimit në landfillin e Sharrës të 27 artikuj me vlerë fillestare totale 857,119 lekë, amortizim të akumuluar 363,045 lekë dhe vlerë të mbetur 494,074 lekë.

Sipas Procesverbalit nr.3, datë 20.06.2019, komisioni vendosi që për 32 artikuj me vlerë të mbetur 389,837 të vazhdojë procedurave për nxjerrjen në ankand të aktive të riciklueshme.

Sipas Procesverbalit nr.4, datë 20.06.2019, komisioni vendosi që për 11 artikuj me vlerë të mbetur 751,410 lekë të mos bëjë asgjësimin pasi këto artikuj mund të riparohen.

Nga auditimi konstatohet se komisioni i asgjësimit nëpërmjet metodës së shkatërrimit në landfillin e Sharrës ka asgjësuar 2 makina llogaritëse dhe 2 kondicionerë, në vlerën totale 86,670 lekë, trajtuar në tabelën në vazhdim, në kundërshtim me VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”.

Nr.	Kartela	Përshkrimi	Kosto	Vlera	Amortizimi i akumuluar	Vlera mbetur e
1	AQ0003	Makina llogaritëse të mëdha 1700	1,700	1,700	1,071	629
2	AQ0025	Makina llogaritëse 2500	2,500	2,500	1,575	925
3	AQ0459	Kondicioner 9000BTU 31465.4 viti 2006	31,465	34,465	20,452	11,013
4	AQ0460	Kondicioner 12 BTU 35287.2, viti 2006	35,287	211,722	137,619	74,103
TOTALI			70,952	250,387	160,717	86,670

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i asgjësimit konktretisht, zj. NB, z. GZ, zj. A M, z. AD dhe z. AQ.

Aktivet Afatgjata të pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar

Aktiveve Afatgjata në fund të vitit 2019 paraqiten në vlerën 2,026,180,548 lekë dhe përbëhet nga Aktivet Afatgjata jo materiale në vlerën 24,457,600 lekë, Aktivet Afatgjata materiale në vlerën 1,307,549,181 lekë dhe Investimet në vlerën 694,173,767 lekë. Krahasuar me vitin 2018, Aktivet Afatgjata janë rritur në vlerën 596,673,193 lekë.

-Gjendja e llogaria Aktivet Afatgjata jo materiale paraqiten në vlerën 24,457,600 lekë dhe përbëhet nga llogaria 202 “Studime e Kërkime” e cila përfaqëson pagesën vjetore për pjesëmarrje në programin Fiscalis 2020.

-Aktivet Afatgjata materiale paraqiten në vlerën 1,307,549,181 lekë, krahasuar me vitin 2018 janë rritur në vlerën 135,964,916 lekë. Aktivet Afatgjata materiale përbëhen nga “Ndërtesa e Konstruksione” në shumën 610,054,056 lekë, “Instalime dhe Rrjete” në shumën 353,535,598 lekë ku peshën kryesore e zë DPT në shumën 353,474,396 lekë (rrjetet dhe sistemet TIK), “Instalime teknike, makineri e pajisje” në shumën 84,391,988 lekë, “Mjete transporti” në shumën 117,477,749 lekë, “Inventar Ekonomik” në vlerën 141,384,197 lekë dhe “Aktive Afatgjata të Dëmtuara” në shumën 735,589 lekë.

-“Investimet” paraqiten në shumën 694,173,767 lekë dhe përbëhen nga llogaria 231 “për aktive afatgjata materiale”.

Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara zënë rreth 0.4% të totalit të Aktivit. Pesha specifike e Aktiveve të Qëndrueshme të Aparatit të DPT-së zë rreth 46.8 % të Aktiveve të Qëndrueshme të pasqyrave të konsoliduara. Tabela në vijim paraqet Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara dhe të pa trupëzuara të Aparatit të DPT-së, AQT e pasqyruara tek bilanci i konsoliduara si dhe peshën specifike që zë secili zë i Aktiveve të aparatit te Aktivet e konsoliduara.

Në lekë

Nr. Llog.	EMERTIMI	I Konsoliduar	APARATI	Pesha specifike %
	I. Aktive Afatgjata jo Materiale	24,457,600	0	0
202	Studime dhe kërkime	24,457,600	0	0
	II. Aktive Afatgjata Materiale	1,307,549,181	612,824,929	46.9
212	Ndërtime e Konstruksione	610,024,059	118,916,811	19.5
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	353,535,598	353,474,396	99.98
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	84,391,988	59,262,245	70.22
215	Mjete transporti	117,477,749	45,967,716	39.13
218	Inventar ekonomik	141,384,197	35,203,762	24.9
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	735,589	0	0
	III. Investime	694,173,767	718,631,367	103.5
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	24,457,600	-
231	Për Aktive Afatgjata materiale	694,173,767	694,173,767	100
TOTALI (I + II+III)		2,026,180,548	1,331,456,296	65.7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Si evidentohet dhe në tabelën më lartë llogaria 202 “Studime dhe kërkimi” në pasqyrat e konsoliduara ka vlerën 24,457,600 lekë, ndërsa në pasqyrat e Aparatit të DPT-së si dhe në pasqyrat e DRT-vë ka vlerë 0 lekë. Ndërsa llogaria 230 “Për aktivet afatgjata jo materiale” në pasqyrat e konsoliduara ka vlerën 0 lekë ndërsa në pasqyrat financiarë të aparatit të DPT-së rezulton në vlerën 24,457,600 lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore kanë llogaritur amortizimin e Aktiveve. Sipas Pasqyrës 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (vlera neto)” vlerat totale e amortizimit për vitin 2019 është 155,166,796 lekë. Nga auditimi konstatohet se vlera e llogarisë 20 e Pasqyrës 7/b kuadron me vlerën e llogarisë 20 të pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu totali i llogarive 21-28 i pasqyruar në pasqyrën 7/b kuadron me vlerën totale të llogarive 20-28 të pasqyrës së pozicionit financiar.

Mbi procedurën e inventarizimit të Drejtorive Rajonale Tatimore

Grupi i auditim kërkoi informacion dhe dokumentacionin shoqërues për procedurat e ndjekura nga Drejtoritë Rajonale për procedurën e inventarizimit të Aktiveve. Nga auditimi me përzgjedhje rezultoi se:

- Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për vitin 2019 nuk ka kryer inventarizimin e aktiveve në kundërshtim me pikën 74 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar ku citohet se: *“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”*.

- Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë me shkresën nr. 587/7, datë 14.02.2020 ka nxjerrë Urdhër për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve. Në pikën 2 të urdhrit të mësipërm citohet shprehimisht se: “Komisioni të bëjë verifikim faktik të aktiveve të DRT Gjirokastrë për vitin 2019”. Komisioni i inventarizimit ka mbajtur procesverbalin nr.587/7, datë 24.02.2020.

Konstatohet se pasqyrat financiar për vitin 2019 janë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 588, datë 17.02.2020 dhe janë depozituar në Degën e Thesarit Gjirokastrë më datë 14.02.2020. Sa më sipër arrihen në konkluzionin se procedura e inventarizimit të Aktiveve për vitin 2019 është kryer pas dërgimit të pasqyrave financiare.

- Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë me shkresën nr. 722, datë 03.02.2020 ka nxjerrë Urdhër për ngritjen e komisionit për kryerje e inventarizimit të aktiveve. Komisioni i inventarizimit ka mbajtur procesverbalin nr.722/1, datë 24.02.2020.

Konstatohet se pasqyrat financiar për vitin 2019 janë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 1240, datë 21.02.2020 dhe janë depozituar në Degën e Thesarit Sarandë më datë 21.02.2020. Sa më sipër arrihen në konkluzionin se procedura e inventarizimit të Aktiveve për vitin 2019 është kryer pas dërgimit të pasqyrave financiare.

Gjetja	Mos kryerja e drejtë e procedurave të inventarizimit dhe asgjësimit të aktiveve
Situata	Komisioni i inventarizimit e ka përfunduar detyrën e ngarkuar 20 ditë me vonesë, në tejkallim të afatit të vendosur në Urdhrin e Titullarit nr. 21428, datë 22.11.2019. Konstatohet se në dy Drejtori Rajonale Tatimore procedurat e inventarizimit janë kryer pas mbylljes dhe dorëzimit të pasqyrave financiare konkretisht: DRT Gjirokastrë ka nxjerrë Urdhër për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve më datë 14.02.2020, ndërkohë që pasqyrat financiare i ka depozituar në Degën e Thesarit Gjirokastrë më datë

	<p>14.02.2020, ndërsa DRT Sarandë ka përfunduar procedurën e inventarizimit të aktiveve më datë 24.02.2020, ndërkohë pasqyrat financiar i ka depozituar në Degën e Thesarit Sarandë më datë 21.02.2020.</p> <p>Për sa i përket procedurës së vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit të mallrave të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit për vitin 2018, me shkresë nr. 21498/5, datë 27.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhër “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”. Nga auditimi konstatohet se kryetar i komisionit të vlerësimit nuk është Nëpunësi Zbatues, jo në përputhje me kërkesat e pikës 99 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.</p> <p>Në relacionin e vlerësimit nuk janë llogaritur apo trajtuar efektet ekonomike të masave që mund të ndërmerren për riaftësimin e tyre në kundërshtim me pikën 106 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.</p> <p>Komisioni i asgjësimit nëpërmjet metodës së shkatërrimit në landfillin e Sharrës ka asgjësuar 4 objekte, në vlerën totale 86,670 lekë, në kundërshtim me VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”.</p>
Kriteri	VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; Udhëzimi nr.30, datë 26.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Institucioni përballet me riskun potencial të mos menaxhimit administrimit dhe humbjeve të vlerave materiale.
Rëndësia	I lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.6 datë 24.07.2020.

Mbi projekt raportin e Auditimit të DPT-së, në lidhje me çështjen e trajtuar më sipër është paraqitur observacioni nr. 333/5, datë 09.09.2020, nga zj.D C ku pretendohet se: Citimi i Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.21428/2, datë 17.02.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e DPT-së” audituesja është shprehur mbi këtë procedurë ku ka dhënë dhe gjykimin e saj mbi mos realizimin brenda afateve por ka vijuar edhe më tej duke dhënë gjykim detyrues mbi kryetarin që duhet të jetë për Komisionin e Vlerësimit zj.C. Së pari kjo është një procedura që është jashtë kompetencës dhe afatit për të cilin është ngarkuar zj.H S për auditim. Së dyti në asnjë moment nuk jam komunikuar nga audituesja dhe nuk më është kërkuar material mbi këtë proces. Së treti nga ku është marrë ky informacion kur kjo është një procedure e iniciuar në 2020? Audituesja nuk ka kërkuar arsyen e mosngritjes së komisionit të vlerësimit për vitin 2019 por ka nxjerr konkluzion aspak të bazuar për vitin 2020. Në zbatim të hierarkisë së normave ligjore ku në nivelin më të lartë hierarkike është ligji e më pas Aktet nën ligjore, kërkojmë të sqarojmë dhe të vendoset nqs për komisionin e vlerësimit duhet të zbatohet ligjin e MFK nenin 22 pika 3b apo Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Pas shqyrtimit të observacionit grupi i auditimit sqaron zj. C se nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi në lidhje me procedurat e inventarizimit, vlerësimit apo asgjësimit. Për sa i përket pretendimit se

janë shkelur kompetencat dhe afatet e auditimit, përsëri sqarojmë se ngitja e komisionit të vlerësimit është bërë sipas Urdhrit të drejtorit të Përgjithshëm nr.21428/2, datë 17.02.2020 i cili ka dalë në vazhdimësi të procedurës dhe Urdhrit nr.21428, datë 22.11.2018, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe magazinave të saj për vitin 2019”, i cili i referohet vitit 2019. Duke qenë se komisioni i vlerësimit gjatë periudhës që auditimi ishte në fazën e terrenit, nuk e kishte përfunduar procedurën, auditimi i kësaj procedure do të auditohet vitin e ardhshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon rregullshmërinë dhe zbatueshmërinë e kuadrit ligjor rregullator në fuqi dhe audituesit në asnjë moment nuk shprehin apo kanë shprehur gjykime personale si pretendohet në këtë observacion. Për sa i përket Kryetarit të komisionit të vlerësimit në pikën 99 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, i cili është në fuqi përcaktohet në mënyrë të qartë se kryetari i Komisionit të Vlerësimit është Nëpunësi Zbatues, konkretisht në pikën 99 citohet: “Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxhere ose specialistë të financës si dhe specialistë të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit”.

C2.2. Të verifikohet shuma e regjistruar nga subjekti në zërin "Të drejta të arkëtueshme" është e plotë dhe e saktë. Analiza e të drejtave sipas llojit të tatimit. Testimi i të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyrave financiare

“Llogaritë e Arkëtueshme” të pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar, paraqiten në shumën 223,113,209,932 lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 120,792,111,178 mijë lekë ose 38,2% e totalit të Aktiveve Afatshkurtra. Kjo llogari pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera, brenda dhe jashtë sistemit C@TS.

- Llogaria 423, 429 “Detyrime të personelit për paradhënie e gjoba” në shumën 804,841 lekë, e cila zë një peshë shumë të vogël në totalin e Aktiveve Afatshkurta.

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” në shumën 102,320,293,913 lekë ose 32.4% e totalit të Aktiveve Afatshkurta. Në krahasim me vitin 2018 kjo llogari është ulur në vlerën 10,229,457,463 lekë.

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në shumën 404,780,927 pasqyron shpenzimet që do të kryhen në periudhat pasardhëse dhe përbëhet nga vlera 404,641,249 lekë e pasqyruara në llogarinë 468 të pasqyrave financiare të Aparatit të DPT-s dhe vlera 139,687 lekë e cila pasqyron detyrimet e prapambetura të raportuara nga DRT Vlorë. Krahasuar me vitin 2018 llogaria 468 është rritur për vlerën 403,677,838 lekë, pasi në pasqyrat financiare të vitit 2018 janë kontabilizuar për herë të parë vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në shumën 120,792,111,178 lekë ose 38.2% e totalit të Aktiveve Afatshkurta. Në krahasim me vitin 2018, kemi rritje të debitorëve në shumën **8,641,643,705 lekë**, ku peshën me të madhe në rritjen e debitorëve e zë “taksa e rrugës” në vlerën 5,145,183,976 lekë, sigurimet shëndetësore në vlerën 1,529,638,413 lekë, “tatimin mbi vlerën e shtuar” në vlerën 1,374,698,704 lekë, “sigurimet shoqërore” në vlerën 1,301,827,451 lekë. Tabela në vijim paraqet gjendjen e debitorëve për vitin 2018 dhe vitit 2019 sipas llojit dhe periudhës së krijimit të tyre.

Në lekë

Nr Llogarise	Emertimi	Detyrime debitoare 31.12.2018	Detyrime debitoare 31.12.2019	Ndare sipas afateve të krijimit	
				Te vitit ushtrimor	Të viteve të kaluar
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	1,871,799,454	2,030,518,264	385,377,283	1,645,140,981
7001	Tatim mbi fitimin	29,474,683,962	29,795,110,553	4,755,343,975	25,039,766,558
7002	Takse e tatim mbi biznesin e vogel	2,640,398,255	2,810,854,674	308,428,092	2,502,426,582
7009	Tjera tatime	4,284,821,495	4,581,549,664	680,367,940	3,901,181,724
7030	Tatimi mbi Vleren e Shtuar(TVSH)	40,033,580,265	41,408,278,969	5,279,961,075	36,128,317,894
7031	Akciza	2,231,447,296	2,107,792,556	2,106,993,328	799,228
7032	Takse mbi sherbimet specifike (Lojra fati)	3,437,382,698	3,473,100,133	36,357,441	3,436,742,692
7033	Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	342,057,351	272,695,972	82,593,506	190,102,466
7050	Taksa e rruges	6,709,670,232	11,854,854,208	5,378,078,086	6,476,776,122
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	29,042,816	26,392,485	2,435,525	23,956,960
7115	Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdemtime	6,997,865,997	6,930,720,719	284,733,374	6,645,345
75	Sigurime shoqerore e shendetsore	13,600,538,749	15,130,177,162	3,783,375,261	11,346,801,901
	Sigurime shoqerore	12,362,522,622	13,664,350,073	3,225,227,302	10,419,122,771
75021	Kontribute shoqerore te punesuar (punemarres)	1,827,918,306	2,209,306,839	821,347,269	1,387,959,570
75121	Kontribute shoqerore punedhenes	10,534,604,316	11,435,043,234	2,403,880,033	9,031,163,201
	Sigurime shendetsore	1,238,016,127	1,485,827,089	558,147,959	927,679,130
75122	Kontribute shëndetsore te punesuar (punemarres)	559,278,499	679,792,413	275,493,362	404,299,051
75022	Kontribute shëndetsore punedhenes	678,737,628	806,034,676	282,654,597	523,380,079
	Detyrime per te tjera kontribute	0	0	0	0
	Të tjera	60,562,530	60,562,530	0	60,562,530
	Shtypshkrime	1,257,804	1,125,267	393,877	731,390
	1 % Grante	782,460	792,254	543,239	252,015
	Pulla (me çmim blerje)	434,576,110	307,582,788	157,444,039	150,138,749
	Totali	112,150,467,473	120,792,111,177	23,242,426,041	97,549,685,137

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Në zbatim të rekomandimeve të mëparshme të KLSH-së, referuar të dhënave të kontabilitetit është konstatuar se në fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në shumën 120,792,111,177 lekë, nga të cilat detyrimet e pasqyruara në sistemin C@TS janë në vlerën 117,996,397,855 lekë ndërsa detyrimet e kontabilizuara por të mbajtura jashtë sistemit C@TS janë në vlerën 2,795,713,322 lekë. Tabela e mëposhtme paraqet totalin e detyrimeve sipas llojit, të paraqitura në sistemin C@TS dhe detyrimet që mbahen jashtë sistemit.

Në lekë

Nr Llogarise	Emërtimi	Detyrime gjendje në sistemin C@TS, 31.12.2019	Detyrimet gjendje jashtë sistemit C@TS, 31.12.2019	Totali i detyrimeve
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	1,971,524,363	58,993,901	2,030,518,264
7001	Tatim mbi fitimin	29,792,227,358	2,883,175	29,795,110,553
7002	Takse e tatim mbi biznesin e vogel	2,810,790,924	63,750	2,810,854,674
7009	Tjera tatime	4,563,992,806	17,556,858	4,581,549,664
7030	Tatimi mbi Vleren e Shtuar(TVSH)	41,397,669,856	10,609,113	41,408,278,969
7031	Akciza	0	2,107,792,556	2,107,792,556
7032	Takse mbi sherbimet specifike (Lojra fati)	3,473,100,133	0	3,473,100,133
7033	Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	272,695,972	0	272,695,972
7050	Taksa e rruges	11,854,522,533	331,675	11,854,854,208
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	26,392,485	0	26,392,485
7115	Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdemtime	6,920,607,206	10,113,513	6,930,720,719
75	Sigurime shoqerore e shendetsore	14,912,874,219	217,302,943	15,130,177,162
	Sigurime shoqerore	13,465,425,659	178,924,414	13,664,350,073
75021	Kontribute shoqerore te punesuar (punemarres)	2,066,529,280	142,287,358	2,209,306,839
75121	Kontribute shoqerore punedhenes	11,398,906,379	36,136,855	11,435,043,234
	Sigurime shendetsore	1,447,448,560	38,378,529	1,485,827,089
75122	Kontribute shëndetsore te punesuar (punemarres)	645,508,956	34,283,457	679,792,413
75022	Kontribute shëndetsore punedhenes	801,939,604	4,095,072	806,034,676
	Detyrime per te tjera kontribute	0	0	0
	Të tjera	0	60,562,530	60,562,530
	Shtypshkrime	0	1,125,267	1,125,267
	1 % Grante	0	795,254	792,254
	Pulla (me çmim blerje)	0	307,582,788	307,582,788
	Totali	117,996,397,855	2,795,713,322	120,792,111,177

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Nga auditimi konstatohet gjendje e larte e detyrimeve të mbajtura jashtë sistemit C@TS, në vlerën 2,795,713,222 lekë. Llogaria 7031 “Akciza” përfaqëson vlerën më të lartë të debitorë të mbajtura jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,107,792,556 lekë ose sa 75.4% e totalit. Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit detyrimi i akcizës në shumën 2,107,792,556 lekë është raportuar nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, konkretisht subjekti ‘A’ sh.a me Nipt JxxxxxD në shumën 2.106.993.328 lekë, në DRT Tiranë dhe subjekti ‘I 99’ në shumën 799.228 lekë në DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën dhe 92,472,643,975 dhe përfaqëson shumën e arkëtimeve të papërdorura në sistemin E tax si mjete në ruajtje vetëm për tatimpaguesit, sipas llojit të deklaratës tatimore në SIFQ. Në këtë llogari kontabilizohen të ardhura për çdo lloj tatimi (deklaratë) për të cilën në momentin e procedimit të një pagese ende nuk ka një detyrim të kontabilizuar. Funksionimi i kësaj llogarie përfshin në pjesën më të madhe kontabilizimin e pagesave për kështet e tatim fitimit të cilat nuk kanë një deklaratë në sistem në momentin e pagesës pasi ajo deklarohet në 3 mujorin e parë të vitit pasardhës.

Në zbatim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, neni 30 “Parapagimet”, cituar “gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, kështet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 30 shtator, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor”.

Në përputhje me këtë parashikim ligjor, u audituan tepricat kreditore të raportuara nga DPT në grupin e llogarisë kontabël **466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”**. Kjo llogari është specifike në sektorin publik dhe në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të NJQP”, jepen dhe udhëzimet e regjistrimeve kontabël në këtë llogari: “...në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve”, të tilla si: • Derdhjet e ndryshme të bëra gabim dhe që duhet të rikthehen; • Depozitime të kontributeve në avancë apo ndonjë depozitim tjetër; etj.

Arkëtimet e rrjedhura sipas përcaktimeve ligjore në lidhje me parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimin regjistrohen në llogarinë analitike 4665003 “depozitime të përkohshme për tatimin mbi fitimin”. Skema e kontabilizimit, sic edhe është trajtuar në auditimin e vitit të kaluar, parashikon regjistrimin e parapagimeve të tatim fitimit në llogarinë 466 (4665003 analitike) por në ndryshim nga llogaritë e tjera të cilat axhustohen (debitohen) rast pas rasti me deklarimet periodike të subjektit tatimpagues, kjo llogari vazhdon të paraqesë gjendjen historike të parapagimeve ndërkohë që në sistemin C@TS këto parapagime sistemohen në mënyrë dinamike me deklarimin vjetor faktik të rezultatit financiar vjetor të subjektit. **Kështu, në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003 më 31.12.2019 paraqitet në shumën 92,461,447 mijë lekë.**

Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2019, pa u axhustuar me deklarimet vjetore në 31.03.2019 për llogari të parapagimeve të bazuara në rezultatin tatimor të deklaruar për vitin 2018. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@TS por në kontabilitet kjo nuk gjen pasqyrim dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti si një zë ‘detyrimi’ në pasivin e bilancit të DPT-së me kunderparti “llog.520 disponibilitete në thesar”.

Gjendja Llog.466 më 01.01.2019	66.5 miliard lekë
Arkëtime 2019	25.9 miliard lekë

Gjendja e llog.466 më 31.12.2019	92.5 miliard lekë
<i>Nga të cilat:</i>	
Arkëtime (Të ardhura) të raportuara për zërin “tatim mbi fitimin”	23,4 miliard lekë
Teprica kreditore sipas C@TS 31.12.2019	14.1 miliard lekë

Në konkluzion, kjo llogari paraqitet në pasqyrat financiare të DPT-së e mbivlerësuar krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme (detyrim ndaj tatimpaguesve respektive), dhe si disponibilitet në thesar, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”. Pavarësisht se kontabilizimet dhe raportimet financiare janë kryer në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit sipas pikës 49: *“Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar, gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme”, pasqyra e pozicionit financiar nuk pasqyron gjendjen reale të detyrimit dhe disponibiliteteve në Thesar e justifikuar kjo nga DPT me faktin se koha kur ndodhin sistemitet e situatës së subjekteve kundrejt parapagimeve që ata kanë kryer deri në Mars të vitit pasardhës, periudha të cilës i përket këto raportime është e rakorduar dhe mbyllur në Thesar sipas udhëzimeve përkatëse të përvitshme për mbylljen e llogarive vjetore.* Po në referencë të Udhëzimit nr.8, pika 50 e tij *“Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet), shuma e raportuar në llogarinë 520 (466) nuk paraqesin saktësisht “të ardhurat e papërdorura” pasi këstet e parapaguara përdoren në momentin e deklarimit të tatim fitimit. Në mënyrë më të detajuar kjo çështje është trajtuar në pikën B.3 të programit të auditimit.*

Gjetja	Llogaria 466 ‘Kreditorë për mjete në ruajtje’ dhe llogaria 520 ‘Disponibilitete në thesar’ nuk paraqesin pamje reale dhe të saktë								
Situata	<p>Në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003 më 31.12.2019 paraqitet në shumën 92,461,447 mijë lekë.</p> <p>Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2019, pa u axhustuar me deklaratimet vjetore në 31.03.2019 për llogari të parapagimeve të bazuara në rezultatin tatimor të deklaruar për vitin 2018. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@TS por në kontabilitet kjo nuk gjen pasqyrim dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti si një zë ‘detyrimi’ në pasivin e bilancit të DPT-së me kundër parti “llog.520 disponibilitete në thesar”.</p> <table border="1"> <tr> <td>Gjendja Llog.466 më 01.01.2019</td><td>66.5 miliard lekë</td></tr> <tr> <td>Arkëtime 2019</td><td>25.9 miliard lekë</td></tr> <tr> <td>Gjendja e llog.466 më 31.12.2019</td><td>92.5 miliard lekë</td></tr> <tr> <td><i>Nga të cilat:</i></td><td></td></tr> </table>	Gjendja Llog.466 më 01.01.2019	66.5 miliard lekë	Arkëtime 2019	25.9 miliard lekë	Gjendja e llog.466 më 31.12.2019	92.5 miliard lekë	<i>Nga të cilat:</i>	
Gjendja Llog.466 më 01.01.2019	66.5 miliard lekë								
Arkëtime 2019	25.9 miliard lekë								
Gjendja e llog.466 më 31.12.2019	92.5 miliard lekë								
<i>Nga të cilat:</i>									

	Arkëtime (Të ardhura) të raportuara për zërin “tatim mbi fitimin”	23,4 miliard lekë
	Teprica kreditore sipas C@TS 31.12.2019	14.1 miliard lekë
	Kjo llogari paraqitet në pasqyrat financiare të DPT-së e mbivlerësuar krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme (detyrim ndaj tatimpaguesve respektive), dhe si disponibilitet në thesar. veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”.	
Kriteri	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit nr. 2, datë 06.02.2012, me ndryshime dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”.	
Ndikimi/Efekti	Kjo llogari në fund të çdo periudhe nuk paraqet pamjen reale dhe të sakte të saj jo vetëm në kontabilitetin e pasqyrat financiare të DPT, por dhe në SIFQ.	
Rëndësia	I lartë	

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.6, datë 24.07.2020 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, me observacionin me nr.prot. 6272/25, datë 30.07.2020 cituar si më poshtë:

Referuar konstatimit nga grupi i audituesve lidhur me gjendjen e lartë të detyrimeve jashtë sistemit E Tax në vlerën 2.795.713.222 lekë, specifikisht për llogarinë 7301 Akciza në vlerën 2.107.792.556 leke për të cilën pretendohet se kanë kërkuar të dhena dhe shpjegime dhe nuk i është venë në dispozicion sqaroj si më poshtë:

Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit Grupit të Audituesve të lartë të KLSH-se për cdo kërkesë të paraqitur me e mail apo verbalisht , i ka kthyer përgjigje të menjëhershme pa asnjë ditë vonesë. Per sa referuar në këtë akt konstatimi kërkesa është bere në menyre elektronike nga Audituse Shteterore H. S dhe ne cc pergjegjese e grupit V.G me datë 23 korrik 2020 , vetem një dite para mbajtjes se këtij akt konstatimi, ne adresën zyrtare te e mailit M S me detyrë Drejtor Drejtorie . Po ne kete date nga e maili i znj Sallaku i ka vajtur nje njoftim (atuomatik) Audituese H S që për arsye shendetsore Znj S nuk mund ti përgjigjet ketij e maili. Në këto rrethana Grupi i audituesve ka patur mundesinë që për të marrë informacion në kohe reale ti drejtohej Specilistit te Kontabilitetit në Drejtorinë e Analizës e Kontabilitetit Znj E T me të cilën kanë patur dhe më parë shkëmbim informacioni nëpërmjet postes elektronike për te marrë shpjegimet e duhura.Shpjegimi nga Specilisti kontabilitetit E T është: Detyrimi i akcizës në shumën 2.107.792.556 leke është kontabilizuar jashtë sistemi dhe raportuar nga Drejtorite Rajonale Tatimore.Subjekti debitor është kompania A sh.a me nipt JxxxxxxD në shumën 2.106.993.328 lekë në DRT Tirane dhe subjekti I 99 në shumën 799.228 lekë në DRT Vip.

2.Referuar konstatimit tuaj (konkluzion) se Llogaria 4665503 paraqitet ne pasqyrat financiare e mbivleresuar krahasuar me situaten reale te teprices kreditore te vlefshme (detyrim ndaj tatimpaguesve) dhe si disponilitet ne thesar , veprime keto ne kundershtim me kerkesat e ligjit 9936 date 26.06.2008 Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise , i

ndryshuar dhe Udhëzimit 8 dt 09.03.2018 Per procedurat e pergatitjes , paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore te qeverisjes se pergjithshme sqaroj: "..."

Qëndrimi i Audituesit:Për sa i përket pjesës së parë të observacionit që lidhet me informacionin e detyrimit e Akcizës grupi i auditimit e pranon observacionin dhe ndryshimet do të reflektohet në projekt raport. Gjithashtu sqaron se pas dërgimit të emailit automatik nga zj. S, kërkesa i është dërguar zj. F L dhe cc K S në cilësinë e personit të kontaktit dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje. Për sugjerimit që informacion mund të ishte marr nga specialistja, rikujtojmë se sipas praktikës të vendosur nga DPT asnjë specialist nuk ka dërguar informacion për grupin e audituesve pa marrë miratimin paraprak nga drejtorët përkatës. Përsa i përket pjesës së dytë të observacionit ai është trajtuar më lartë në pikën B3.3.

Në konkluzion observacioni pranohet pjesërisht.

C2.3. Efektet në pasqyrat financiare të vitit 2019, të VKM nr.750 datë 27.11.2019 dhe shkresës së Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.21920 datë 02.12.2019

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

-Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Udhëzimi plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”;

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;

-Udhëzimi nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”;

-Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Detyrime të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore, sipas pikës 116 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, do të konsiderohen detyrimet e përcaktua nga një ligj, kontratë, marrëveshje, vendim i gjykatës i formës së prerë, që mbeten të papaguara 30 ditë pas datë së specifikuar në kontratë apo në ligj.

Raportimi i detyrimeve të prapambetura

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka raportuar çdo tremujor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura, konkretisht:

-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.7733, datë 12.04.2019 ka raportuar në MFE për detyrimet e prapambetura të krijuara deri më datë 31 Mars 2019. Nga auditimi konstatohet se shkresa për raportimit e detyrimeve të prapambetura është dërguar jashtë afatit kohor, në kundërshtim me pikën 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”. Sipas raportimeve të DPT detyrimet e prapambetura deri më 31 Mars, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Nr. rastesh	Vlerë
1	Vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga puna	197	272,635

2	Vendime gjyqësore për rimbursim subjektsh	3	107,879
Totali		200	380,514

Burimi: Shkresa e DPT-së nr. 7733, datë 12.04.2019.

-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.13509/1, datë 19.07.2019 ka raportuar në MFE në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara deri më datë 30 Qershor 2019. Nga auditimi konstatohet se shkresa për raportimit e detyrimeve të prapambetura është dërguar jashtë afatit kohor, në kundërshtim me pikën 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”. Sipas raportimeve të DPT detyrimet e prapambetura deri më 30 Qershor, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Nr. rastesh	Vlerë
1	Vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga puna	222	343,586
2	Vendime gjyqësore për rimbursim subjektsh	-	-
Totali		222	343,586

Burimi: Shkresa e DPT-së nr. 13509/1, datë 19.07.2019.

Konstatohet se nuk janë raportuar vendimet gjyqësore për rimbursimin e subjekteve, gjithashtu nuk është plotësuar Shtoja 3/1 “Skedulimi i detyrimeve të prapambetura”, në kundërshtim me pikën 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.18543, datë 07.10.2019 ka raportuar në MFE në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara deri më datë 30 Shtator 2019. Nga auditimi konstatohet se shkresa për raportimit e detyrimeve të prapambetur është dërguar brenda afatit kohor, në përputhje me pikën 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”. Sipas raportimeve të DPT detyrimet e prapambetura deri më 30 Shtator, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Nr. rastesh	Vlerë
1	Vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga puna	225	395,168
2	Vendime gjyqësore për rimbursim subjektsh	-	-
Totali		225	395,168

Burimi: Shkresa e DPT-së nr. 18543, datë 07.10.2019.

Konstatohet se nuk janë raportuar vendimet gjyqësore për rimbursimin e subjekteve gjithashtu nuk është plotësuar Shtoja 3/1 “Skedulimi i detyrimeve të prapambetura”, në kundërshtim me pikën 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.1900, datë 21.01.2020 ka raportuar në MFE në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara deri më datë 31 Dhjetor 2019. Nga auditimi konstatohet se shkresa për raportimit e detyrimeve të prapambetura është dërguar jashtë afatit kohor, në kundërshtim me pikën 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

Sipas raportimeve të DPT detyrimet e prapambetura deri më 31 Dhjetor, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nr. rastesh	Vlerë në mijë lekë
1	Vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga puna	196	404,443
2	Vendime gjyqësore për rimbursim subjektsh	5	80,089
Totali		201	484,541

Burimi: Shkresa e DPT-së nr. 1900, datë 21.01.2020.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për grupin e auditimit konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë stokun e rimbursimit të TVSH-së në kundërshtim me shtojcën 4 “Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-së” të pikës 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

Pasqyrimi në kontabilitet i detyrimeve të prapambetura

Në pikën 42 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, përcaktohet se të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore zërin e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, për të cilat do të përdoret llogaria 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme”, në varësi të natyrës së tyre.

Sipas pasqyrave financiare të Aparatit të DPT-së llogaria 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme” është në vlerën 404,641,249 lekë dhe përfaqëson vlerën e detyrimeve për vendime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna. Ndërsa llogaria 486 për pasqyrat financiare të konsoliduar të DPT ka vlerë 404,780,927 lekë, e cila përbëhet nga vlera 404,641,249 lekë e pasqyruara në llogarinë 468 pasqyrave financiare të Aparatit të DPT-s dhe vlera 139,687 lekë e cila pasqyron detyrimet e prapambetura të raportuara nga DRT Vlorë.

Nga auditimi konstatohet se **ka diferencë në vlerën 79,900 mijë lekë**, midis vlerës totale të **detyrimeve të prapambetura të raportuar nga DPT** në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe **vlerës së llogarisë 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme”**. Diferencat krijohen si pasojë e mos kontabilizimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për subjektet.

Grupi i auditimit ka kërkuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës së DPT-së, databazën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë vendim të formës së prerë për subjektet (tatimpaguesit). Në fund të vitit 2019 vlera e detyrimeve të prapambetura për këto vendime, sipas databazës së Drejtoria e Buxhetit dhe Financës është në vlerën 80,098,062 lekë, si në tabelën më poshtë

Nr.	Subjekti	Data dorëzimit të praktikës	Çelje detyrimi 2019	Tarifa përmbartimore	Likuiduar 2019	Detyrim, fund 2019
1	Gent-I Tirana	05.07.2018	30,686,415	1,472,948	10,840,000	21,319,363
2	Colacem Albania	26.12.2018	56,591,671	2,716,400	32,160,000	27,148,071
3	Colacem Albania	21.02.2019	20,823,884	-	-	20,823,884
4	L.O.R.L	17.05.2019	2,542,738	-	-	2,542,738
5	Ateani	29.08.2019	7,623,623	640,383	-	8,264,006
118,268,331		4,829,731	43,000,000	80,098,062		

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPT

Nga auditim është konstatuar se **databaza e vendimeve gjyqësore subjektet nuk është e plotë**, pasi mungojnë në të vendime gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, konkretisht:

-Vendimi gjyqësor nr. 1326, datë 29.03.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për subjektin “F K C F” shpk, me NIPT KXXXXE me objekt “Rimbursimi i akcizës për lëndën djegëse Mazut të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike për nevoja e veta të fabrikës së çimentos Fushë-Krujë, për periudhën Prill 2006-Janar 2008”, në vlerën 563,859,444 lekë;dhe

-Detyrimet që rrjedhin nga vendimi gjyqësor nr. 531, datë 21.02.2019 i Gjykatës Administrative Tiranë për subjektin “B P A” me NIPT KXXXXL në vlerën 66,393,943 lekë.

Mos përfshirja e dy vendime të mësipërme në shumën 630,253,387 lekë në databazën e DPT-së bie në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të

detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 4 ku citohet se “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë databazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrimet detyrime monetare, si dhe shumat e detyrimeve....” si dhe pikën 2 ku citohet se “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin prej tyre”. Mos njohja e detyrimeve të vendimeve të mësipërme bie në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku citohet se “.... Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: a) njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës....” në kundërshtim me pikën 32 të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si dhe në kundërshtim pikën 42 të Udhëzimit të mësipërm ku citohet: “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në varësi të natyrës së tyre: Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë: “Debitohet llogaria përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” dhe Kreditohet llogaria përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi znj.DC në cilësinë e Drejtorit të Buxhetit dhe Financës

Gjithashtu në llogarinë 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme” nuk është llogaritur stoku i rimbursimit të TVSH-së të miratuar dhe të pa kaluar në llogarinë e subjekteve. Sipas shkresës të DPT-së nr. 4480, datë 27.02.2020 **stoku i rimbursimit të TVSH-së në datën 31.12.2019 është në vlerën 11,251,390,130 lekë**, e cila në mënyrë të hollësishme paraqitet si në tabelën më poshtë:

Në lekë

Nr.	Subjekti	Lloji i aktivitetit	Stoku datë 31.12.2019
1	AA E	Investime/HEC	1,457,441,814
2	HS	Investime/HEC	251,937,062
3	T A P A	Investim	9,52,035,782
4	K M E	Investime/HEC	21,975,472
11,251,390,130			

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Mospasqyrimi i stokut të TVSH-së në llogarinë 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme bie në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Sa më sipër arrihet në konkluzionin se **vlera e paraqitur në llogarinë 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme” nuk është e saktë dhe e plotë** pasi nuk janë njohur vendime gjyqësore të formës së prerë për tatimpaguesit në vlerën 710,341,449 lekë si dhe nuk është pasqyruar stoku i rimbursimit të TVSH-së në vlerën 11,251,390,130 lekë. Sa më sipër vlera e detyrimeve të prapambetura e paraqitur në Pasqyrat financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është e nënvlerësuar.

Planifikimi i buxhetit për shpenzimet e vendimeve gjyqësore

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në zbatim të pikës nr. 4, të Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2016 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në

llogari të thesarit” duhet të mbajnë databazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës.

Planifikimi i shpenzimeve gjyqësore për vitin 2019, në mënyrë të detajuar paraqitës si në tabelën më poshtë:

Tabela: Planifikimi i shpenzimeve gjyqësore në lekë

	PBA faza I	PBA faza II	Ligj Buxheti	Planifikim përfundimtar	Realizimi
Shpenzime Gjyqësore	50,964,000	50,000,000	50,000,000	142,307,000	142,307,000

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPT

Shpenzimet për vendime gjyqësore në PBA faza e I janë planifikuar për vlerën 50,964,000 lekë, ndërsa në PBA faza II janë planifikuar për vlerën 50,000,000 lekë duke u ulur me vlerën 964,000 lekë. Me ligjin e Buxhetit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, detyrimet për shpenzimet gjyqësore janë çelur në vlerën 50,000,000 lekë. Konstatohet se planifikimi për këtë zë buxhetor nuk është bërë në përputhje me nevojat buxhetore pasi vetëm detyrimi total për vendime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna, pa përfshirë vendimet gjyqësore për subjektet, në fund të vitit 2018 është në vlerën 287,615,392 lekë.

Vendimet gjyqësore

Drejtoria Ligjore dhe Teknike ka vënë në dispozicion databazën e çështjeve gjyqësore për subjektet (tatimpaguesit), të cilat gjatë vitit 2019 kanë marrë formë të prerë dhe vendime të cilat gjatë vitit 2019 kanë qenë në proces gjykimi, të cilat në mënyrë të përmbledhur trajtohen në tabelën në poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nr. i çështjeve
1	Çështje gjyqësore në proces gjykimi	291
2	Vendime të formës së prerë	162
TOTALI		453

Burimi: Drejtoria Ligjore dhe Teknike

Siç evidentohet edhe në tabelë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore gjatë vitit 2019 në total kanë pasur 453 çështje gjyqësore, nga të cilat 291 çështje në fund të vitit rezultojnë në proces dhe 162 çështje kanë marrë vendim të formës së prerë.

Gjithashtu grupit të auditimit i është vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike databaza e punonjësve të larguar nga puna, të cilët janë ende në proces gjyqësor. Konstatohet se kjo databazë përbërë nga 187 procese gjyqësore, prej të cilëve 84 janë ish punonjës me status të nëpunësit civil dhe 103 janë ish punonjës me kod pune.

	Numri Çështjeve	Statusi i Procesit Ligjor (sa)
Ish nëpunës me status	5(shkalla I ne proces) + 47 (shkalla II ne proces) + 32 (forme e prerë) = TOTAL 84	Çështje në proces Gj.Sh.I
		Çështje në proces Apel 79 (47 ne proces + 32 forme e prerë)
		pranuar nga Gj.Sh.I 61 (26 marre forme te prerë + 35 ne proces ne shkalle te II) rëzuar nga Gj.Sh.I 17 (6 marre forme te prerë + 11 ne proces ne shkalle te II)
Ish punonjës me kod pune	30 (shkalla I ne proces prej te cilave 4 jane te pezulluara) + 51 (shkalla II ne proces) + 22 (forme e prerë) = TOTAL 103	Çështje në proces Gj.Sh.I 30 (4 pezulluar)
		Çështje të pezulluara nga Gj.Sh.I 4
		pranuar nga Gj.Sh.I 4 (ne proces ne shkalle te II) Çështje në proces Apel 73 (51 ne proces + 22 forme e prerë) pranuar pjesërisht Gj.Sh.I 59 (21 marre forme te prerë + 38 ne proces ne shkalle te II)

		rrëzuar nga Gj.Sh.I 10 (1 marre forme te prere + 9 ne proces ne shkalle te II)
Totali	187	

Burimi: Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT

Gjetja	Mos raportimi i plotë i detyrimeve të prapambetura
Situata	Nga auditimi është konstatuar se nuk janë raportuar vendimet gjyqësore për rimbursimin e subjekteve, si dhe nuk është plotësuar Shtoja 3/1 “Skedulimi i detyrimeve të prapambetura”, në referencë kjo të raportimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr.13509/1, datë 19.07.2019 dhe shkresën nr.18543, datë 07.10.2019 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura të krijuara për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2019. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë stokun e rimbursimit të TVSH-së në kundërshtim me shtojcën 4 “Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-së” të pikës 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.
Kriteri	Udhëzimi standard për zbatimin e buxhetit nr. 2, datë 06.02.2012 i ndryshuar, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.
Ndikimi/Efekti	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë gjendjen reale të detyrime të prapambetura.
Rëndësia	I lartë

Gjetja	Mosnjohja dhe mos kontabilizimi i vendimeve gjyqësore për tatimpaguesit, në pasqyrat financiare të DPT-së
Situata	Referuar databazës së vendimeve gjyqësore që kanë marrë vendim të formës së prerë për subjektet, në fund të vitit 2019, vlera e detyrimeve të prapambetura për këto vendime është 80,098 mijë lekë. Konstatohet se databaza e vendimeve gjyqësore për subjektet nuk është e plotë, pasi mungojnë në të paktën 2 vendime gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, konkretisht, vendimi gjyqësor nr.1326 datë 29.03.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për subjektin “F K C F” shpk, me NIPT KxxxxxE, në vlerën 563,859 mijë lekë dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimi gjyqësor nr.531, datë 21.02.2019 i Gjykatës Administrative Tiranë për subjektin “BPA” me NIPT KxxxxxL në vlerën 66,394 mijë lekë, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 dhe 4 të Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Nga auditimi është konstatuar se në pasqyrat financiare të vitit 2019 nuk është kontabilizuar vlera e vendimeve gjyqësore që kanë marrë vendim të formës së prerë për subjektet, kjo jo në përputhje me kërkesat e nenit 61 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Kriteri	Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi standard për zbatimin e

	buxhetit nr. 2, datë 06.02.2012 i ndryshuar, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti	Mos paraqitja e saktë e vlerës së detyrimeve.
Rëndësia	I lartë

Gjetja	Keq klasifikim i stokut të rimbursimit të TVSH-së
Situata	Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e pasqyrave financiare të konsoliduar të DPT-së paraqitet në shumën 404,781 mijë lekë dhe pasqyron vlerën e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna si dhe detyrimet e prapambetura në vlerën 140 mijë lekë të raportuara nga DRT Vlorë. Referuar pikës 42 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve duhet të paraqiten veçmas në pasqyrat në llogarinë 486 sipas llogari specifike të kontabilitetit. Nga auditimi është konstatuar se vlera e paraqitur në llogarinë 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme” nuk është e saktë dhe e plotë, pasi në të nuk janë vendimet gjyqësore të formës së prerë për tatimpaguesit si dhe stoku i rimbursimit të TVSH-së, i cili është klasifikuar në një llogari tjetër. Referuar databasës së DPT-së, në fund të vitit 2019 vlera e vendime gjyqësore për tatimpaguesit është 80,098 mijë lekë. Ndërsa sipas shkresës të DPT-së nr.4480, datë 27.02.2020, stoku i rimbursimit të TVSH-së në fund të vitit 2019 është në vlerën 11,251,390 mijë lekë.
Kriteri	Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”,
Ndikimi/Efekti	Keq klasifikim i stokut të rimbursimit të TVSH-së, nënvlerësim i detyrimeve të prapambetura dhe llogarisë 486 ‘Shpenzime për periudhat e ardhshme’.
Rëndësia	I lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.5, datë 24.07.2020 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, si më poshtë: *Detyrimet për vendime gjyqësore të subjekteve janë raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe është plotësuar skeduli i detyrimeve të prapambetura. Në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve të prapambetura dhe vendosja e tyre në zërin 486 ‘Shpenzime për periudhat e ardhshme’ saktësojmë se ky zë përdoret për detyrime që plotësojnë kushtin e njohjes. Kjo përcjell logjikën e përcaktimit të dy vendimeve gjyqësore F K C me nipt KxxxxxE me objekt ‘Rimbursimi i akcizës për djegie për lëndën mazut të përdorur për prodhimin energjisë për nevojat e vetë fabrikës së cementos’ për*

periudhën Prill 2006-2008 dhe BP A me Nipt KxxxxxL për rimbursimin e akcizës. Të dy vendimet janë ende në kërkesë për të realizuar marrëveshje ndërmjet institucioneve të cilat janë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku padia është ngritur për DPT ndërkohë që akciza ka kaluar për veprim në DPD që në vitin 2012. Këto detyrime janë detyrime fiskale dhe jo detyrime buxhetore, ku trajtimi dhe zbatimi i tyre zgjidhet në nivel fiskal detyrimi. Një nga elementët është edhe vlera e lartë e vendimeve në krahasimi me buxhetin e DPT. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës trajton në buxhetin e saj fonde në llogari për llogari të administratës tatimore. Buxheti i cili përcillet nga MFE për zbatim nuk lidhet në asnjë moment me detyrimet e lindura nga DRT të cilat janë në funksion dhe në mbështetje të tatimpaguesve. DBF nuk ka asnjë akses në sistemin C@TS sepse nuk ka për objekt tatimpaguesit. DBF ka një buxhet i cili shërben për nevojat kryesore të administratës për funksionimin dhe përkrahjen e saj dhe jo një buxhet mbi çdo arsyetim ligjor, logjik dhe ecurisë normale të buxhetit.

Qëndrimi i Audituesit: Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, në lidhje me pretendimin se detyrimet janë raportuar në MFE së bashku me skedulin, grupi i auditimit konstaton nuk ka dokumentacion bashkëlidhur për të vërtetuar këtë pretendim për raportimet e tremujorit të dytë dhe tremujorit të tretë. Për sa i përket pretendimeve për mosnjohjen dhe mos kontabilizimin e vendimeve gjyqësore sipas gjykimit tonë nuk qëndrojnë pasi, vendimet e gjykatës për të dy subjektet e mësipërme, janë vendime të formës së prerë dhe jo vendime të shkallës së parë. Në vendimet e gjykatës shprehet në mënyrë të qartë se ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ekzekutimin e tyre dhe jo ndonjë institucion tjetër. Gjithashtu në vendimet e gjykatës shprehet në mënyrë të qartë vlera që duhet ti rimburohet dhe në asnjë rresht të vendimit, gjykata nuk ka shprehur se kjo vlerë do të ekzekutohet pas arritjes së ndonjë marrëveshje me DPT, apo kjo vlerë mund të shpërbej për sistemin e gjendjes fiskale të subjekteve apo pagimin e detyrimeve të tjera. Vlera e lartë e vendimeve nuk justifikon mosnjohjen e tyre pasi aktet nënligjore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përcaktojnë rrugën që duhet të ndjekin institucionet në rastet kur vendimet kanë vlerë të larta dhe nuk mbulohen dot nga buxheti i institucioneve.

Në konkluzion observacioni nuk pranohet.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet në lidhje me mos kontabilizimin e vendimeve gjyqësore për subjektet mbajnë përgjegjësi:

Zj. D C në cilësinë e Drejtorit të Buxhetit dhe Financës.

Mbi projekt raportin e Auditimit të DPT-së, në lidhje me çështjen e trajtuar më sipër është paraqitur:

-Observacioni nr. 333/5, datë 09.09.2020, nga zj. D C ku pretendohet se: Detyrimet e 2 vendimeve gjyqësore për subjektet F K C dhe B P janë detyrime të cilat nuk mbartin detyrim buxhetor. Ky lloj detyrimin ndahet në fiskal dhe në atë monetar. Në çdo moment kur përcillen detyrime vendime të tilla, komunikohet me Drejtoritë Rajonale përkatëse ku na vendosin në dispozicion informacion fiskal të tyre. Detyrimi fiskal është një element dhe tregues i rëndësishëm pasi efekti fiskal ka një ndryshim madhor në efektin buxhetor të drejtpërdrejtë. Ku bazohet audituesja që nuk lejohen marrëveshjet midis palëve? Marrëveshjet janë të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. N.q.s do të finalizohet ky proces nëpërmjet marrëveshjes për të cilin ka shprehur vullnet përfaqësuese ligjor përmbaruesi me anë të shkresës nr. 7146, datë 27.04.2020 dhe bëhet rregullimi fiskal, detyrimi buxhetor është vetëm përmbaruesi, si do të quhet vitin që vjen- raportim gabim, i pasaktëi detyrimeve? Citimi nga ana e DFB për vlerën e lartë nuk ka qene në logjikën që meqë është vlerë e lartë ne nuk do ta njohim si detyrim por në logjikën që kur këto vendime

janë të vlerave qaq të larta dhe të papërballueshme nga fondi buxhetor i njësisë shpenzuese të DPT-së, mund të merren në ngarkim dhe për shqyrtim nga MFE. N.q.s. MFE plotëson nevojat për këto kërkesa të detyrimeve për DPT nuk ka asnjë arsye për mos realizimin e likuidimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur grupi i auditimit thekson se në asnjë moment nuk ka shprehur se Drejtoritë Rajonale Tatimore apo Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk mund të lidhë marrëveshje me subjektet. Referuar vendimit gjyqësor nr. 1326, datë 29.03.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, shkresave të Drejtorisë Rajonale Tatimpaguesve të Mëdhenj drejtuar DPT-së si dhe shkresave të Zyrës Përmbartimore private “A” rezulton se detyrimi për këtë vendim është 563,859,444 lekë, e cila është kërkuar për ekzekutim. Për vitin 2020 DPT ka raportuar në MFE detyrimin në vlerën 581,859,444 lekë për subjektin F K C nga të cilat vlera 563,859,444 lekë i përket Vendimit gjyqësor nr. 1326, datë 29.03.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe vlera 18,000,000 lekë i përket tarifës për ekzekutimin e këtij vendimi. Ky detyrim i raportuar në fillim të vitit 2020 duhet të ishte raportuar dhe njohur që në vitin 2018.

- Observacionin nr. 333/6, datë 02.09.2020 nga zj. M S në lidhje me stokun e rimbursimit të TVSH-së, ku pretendohet se: Stoku i rimbursimit për TVSH, i cili ka kaluar të gjitha fazat miratim/aprovim në sistemin E-tax, pra është zbritur nga llogaria etatimpaguesit në sistem, por ende nuk është bërë kalimi i fondeve nëpërmjet thesarit në llogarinë bankare të tatimpaguesit, gjen kontabilizimin e tij në llogarinë 467 kreditorë të tjerë e cila përfaqëson një angazhim të marrë nga AT kundrejt tatimpaguesit por ende të palikuiduara deri më 31 dhjetor të vitit 2019. Ky informacion është vënë në dispozicion grupit të audituesve ku ka dhënë dhe sqarime që llogaria 467 “Kreditorë të tjerë” ka detyrime kreditorë sipas llojit të tatimit në sistem dhe detyrimet kreditorë jashtë sistemit ku përfshihet dhe stoku i rimbursimit të TVSH i paekzekutuar në thesar deri më datë 31.12.2019, i cili i është vënë në dispozicion Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit me shkresën zyrtare nga DRTVSH nr. 4480, datë 27.02.2020. Në këto kushte nuk ka vend për kontabilizim në llogarinë 486, pasi kjo do të çonte në dublimin e vlerës apo mbivlerësimin e detyrimeve që AT i ka të tretëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të observacionit grupi i auditimit sqaron se nuk është shprehur që stoku i rimbursimit të TVSH-së është i pa kontabilizuar, por që stoku duhet të klasifikohet në llogarinë 486, pra kemi të bëjmë me keq klasifikim dhe si pasojë detyrimet e prapambetura të DPT nuk paraqesin pamjen reale. Mospasqyrimi i stokut të TVSH-së në llogarinë 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme bie në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe pikën 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, në lidhje me pretendimin se detyrimet janë raportuar në MFE së bashku me skedulën, grupi i auditimit konstaton nuk ka dokumentacion bashkëlidhur për të vërtetuar këtë pretendim për raportimet e tremujorit të dytë dhe tremujorit të tretë. Për sa i përket pretendimeve për mosnjohjen dhe mos kontabilizimin e vendimeve gjyqësore sipas gjykimit tonë nuk qëndrojnë pasi, vendimet e gjykatës për të dy subjektet e mësipërme, janë vendime të formës së prerë dhe jo vendime të shkallës së parë.

C2.4 Efektet në pasqyrat financiare të vitit 2019, të VKM nr.750 datë 27.11.2019 dhe shkresës së Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.21920 datë 02.12.2019

Në zbatim të VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyre për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë shpresën nr. 21920, datë 02.12.2019 me lëndë “Mbi prioritetet e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësive natyrore”, sipas të cilës autoritetet kontraktore ndalohet të nënshkruajnë kontrata të reja që janë në proces prokurimi apo të ndërmarrin procedura të reja prokurimi me fondeve publike si dhe përcaktohet prioriteti i radhës së pagesave.

Në zbatim të pikës së mësipërme grupi i auditimi kërkoi të dhëna mbi procedurat e prokurimit si dhe kontratat e lidhura nga DPT. Nga auditimi rezultoi se nuk ka pasur kontrata të lidhura pas datës 02.12.2019. Për sa i përket procedurave të prokurimeve rezultoi se procedura e prokurimit me nr.reference 39266-10314-2019 me objekt “Riparim i automjeteve” me fond limit 3,039,280 lekë është pezulluar për shkak të shkresës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.21920, datë 02.12.2019 dhe si pasojë nuk është lidhur kontratë me fituesin.

DREJTIMI D: Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

D.1 Programimi i nevojave, disponibiliteti i fondeve dhe regjistri i prokurimeve

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Mbi Planifikim Buxhetor dhe mbështetjen në fonde buxhetore të Investimeve

Nga informacioni i vënë në dispozicion mbi planifikimin buxhetor të investimeve kapitale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, u audituan procedurat e prokurimit në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, ku rezultoi si më poshtë:

Tabela 1: Planifikimi buxhetor për Investimet 2019 në DPT

Emri i projektit	Kodi projektit	Planifikimi PBA 2019-2021	Planifikimi Ligj buxheti	Plani i ndryshuar (konfirmuar nga MF datë 15.5.2019)	Urdhër prokurim			Organi që ka zhvilluar procedurë
					Data	Miratim thesari	Fondi limit	
Krijimi i nje mjedesi te ri dhomë serverash(data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi I qëndërzuar për DPT/DRT	18AV806	51,000,000	51,000,000	76,000,000	05.04.2019	Jo	86,499,400	AKSHI

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPT.

Sa më sipër, rezultoi se:

a- Për projektin e investimit **“Krijimi i nje mjedisi te ri dhome serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT (implementim + 24 muaj mirmbajtje)”** me kod 18AV806, planifikimi buxhetor nuk është bërë në përputhje me legjislacionin dhe nuk ka ndjekur me përpikmëri hapat për planifikim të parashikuara në legjislacion, për arsye se planifikimi në Programin Buxhetor Afatmesëm edhe në Ligj Buxheti ka qenë në vlerën 51,000,000 lekë. Plani i ndryshuar sipas kërkesës së AKSHI-t me nr. 532/5 prot., datë 26.03.2019 për rialokim fondi dhe konfirmuar nga ministria e financave me shkresën nr. 7796/1 prot., datë 15.05.2019 për rialokimin e fondit në vlerën 25,000,000 lekë. Ndërsa urdhër prokurimi në mënyrë të paargumentuar ka dalë në vlerën 86,499,400 lekë duke **vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”**, të ndryshuar, **neni 40**, në të cilin përcaktohet se: *“Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëveçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në sistemin informatikë financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë sistem angazhimin, brenda pesë ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrit të prokurimit”*. Dhe neni 69 i cili parashikon *“Çdo parregullsi, keqmenaxhim i rëndë financiar, marrje përsipër e angazhimeve jashtë fondeve të parashikuara në buxhet apo pagesa në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi përbëjnë elemente për fillimin e inspektimit financiar publik.”*

b- Gjithashtu nga auditimi konstatohet se udhri prokurimit së procedurës së mësipërme nuk është vulosur nga dega e thesarit, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, i cili përcakton se urdhëri i prokurimit në fillimin e procedurës duhet të vuloset në Thësar për të verifikuar mbulimin me fonde buxhetore të kësaj procedure në vijimësi.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor të AKSHI-t Mirlinda Karçanaj për fillimin e procedurës së prokurimit pa mbështetje në fonde buxhetore.

D.2 Verifikimi i shpenzimeve të realizuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë zhvilluar gjithsej 12 procedura prokurimi (me vlerë të lartë) me fond limit 129,352,765 lekë, nga të cilat 6 procedura me fond limit 13,687,471 lekë janë zhvilluar nga vetë DPT, 3 procedura me fond limit 29,165,894 lekë janë zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe 1 procedurë me fond limit 86,499,400 lekë është zhvilluar nga AKSHI (*bashkangjitur tabela e procedurave të realizuara*), konkretisht shkeljet kryesore si më poshtë:

1. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2019 mbi planifikimin dhe zbatimin e kontratës me objekt **“Krijimi i nje mjedisi te ri dhome serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT (implementim + 24 muaj mirmbajtje)”** me kod projekti 18AV806, zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), rezultoi se: planifikimi buxhetor për këtë projekt nuk është bërë në përputhje me legjislacionin dhe nuk ka ndjekur me përpikmëri hapat për planifikim të parashikuara në legjislacion, për arsye se planifikimi në Programin Buxhetor Afatmesëm edhe në Ligj Buxheti bashkë me rialokimin e fondeve ka qenë në vlerën 76,000,000 lekë. Ndërsa urdhër prokurimi, pa vulosur nga dega e thesarit, në mënyrë të paargumentuar ka dalë në vlerën 86,499,400 lekë duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 40 dhe Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”.

D- Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime e shërbime.

Në Drejtorinë Përgjithshme të Tatimeve, bazuar në programin e auditimit nr. 333/1, datë 15/04/2020, u auditua zbatimi i procedurave të prokurimit të kryera nga ky subjekt. Auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, u ushtrua bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik si dhe në aktet ligjore e nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit, sipas çështjeve të trajtuara. Për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 - 31.12.2019 janë zhvilluar gjithsej 12 procedura prokurimi (me vlerë të lartë) me fond limit 129,352,765 lekë.

D.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit

Në mënyrë analitike si më poshtë:

Në zbatim të pikës D të programit të auditimit “Nr.333/1 datë 15/04/2020”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistri parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike për vitin 2019.
2. Dosjet e procedurave të prokurimeve.
3. Aksesit në sistemin e prokurimeve publike në faqen e APP (<http://www.app.gov.al/>).
4. Planifikimi buxhetor i prokurimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

I. Procedura prokurimit publikme objekt “Loti 1Ruajtje objektesh të godinave ku është akomoduar administrata tatimore në Qarkun e Beratit për vitin 2019”, rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 15157 prot., datë 07.08.2019	NJHDT B H- prgj sektori	KVO me urdhrin nr. 15157 /1 prot., datë 07.08.2019 dhe urdhrin nr. 16349 prot., datë 04.09.2019
Fondi limit 2,574,378 lekë	F G- specialiste	I K – kryetar
Procedura e prokurimit – e hapur	N B- jurist, zëvendësuar me J M sipas urdhrit nr. 15536 prot., datë 16.08.2019.	O L – anëtar S B- anëtar V T - anëtar J M – anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “N” shpk	Vlera fituese 2.477.587 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 06.09.2019		Kontrata nr. 15157/37 prot., datë 23.10.2019
Marrin pjesë 3 OE S`kualifikuar 1 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 15157/17 prot., datë 15.10.2019	Vlera e kontratës 1,812,377.6lekë me tvsh dhe vlere ditore 25,185.8 lekë me tvsh
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës: nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2019	Titullar i AK – D I

Zhvillimi i procedurës: Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt “Loti 1 Ruajtje objektesh të godinave ku është akomoduar administrata tatimore në Qarkun e Beratit për vitin 2019”, rezultoi se në tender ka marrë pjesë 3 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"A S" shpk	2.476.219,38	<i>Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme:</i> - çertifikata e drejtuesit teknik z.PD është jashtë afatit 4 vjeçar, bazuar në ligjin Nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" neni 5 Certifikimi pika 5 citon: Çertifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.
2	"N" sh.p.k	2.477.587	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	"M S" sh.p.k..	2.477.587	Kualifikuar

1. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave u konstatua se komisioni i vlerësimit të ofertave ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën me vlerë më të ulët të paraqitur nga operatori ekonomik "A S" shpk me vlerë 2.476.219,38 pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas dst.

2. Nga auditimi i ofertave me vlerë të njëjtë të paraqitura nga "N" sh.p.k dhe "M S" sh.p.k rezultoi se i kanë plotësuar kriteret e kërkuara në dst dhe fituesi është shpallur me anë të shortit.

II. Procedura prokurimit publikme objekt "Loti 9 Ruajtje objektsh të godinave ku është akomoduar administrata tatimore në Qarkun e Lezhës për vitin 2019", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 15157 prot., datë 07.08.2019	NJHDT B H- prgj sektori	KVO me urdhrin nr. 15157 /1 prot., datë 07.08.2019 dhe urdhrin nr. 16349 prot., datë 04.09.2019
Fondi limit 4,254,269 lekë	F G- specialiste	I K – kryetar
Procedura e prokurimit – e hapur	N B- jurist, zëvendësuar me J M sipas urdhrin nr. 15536 prot., datë 16.08.2019.	O L – anëtar S B- anëtar V T - anëtar J M – anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "NSS" shpk	Vlera fituese 2,036,620 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 06.09.2019		Kontrata nr. 15157/1 datë 11.10.2019
Marrin pjesë 2 OE S'kualifikuar 1 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 15157/4 prot., datë 02.10.2019	Vlera e kontratës 2,036,620 me tvsh dhe vlere ditore 24,836.832 lekë me tvsh
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës: nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2019	Titullar i AK – D I

Zhvillimi i procedurës:Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Loti 9 Ruajtje objektsh të godinave ku është akomoduar administrata tatimore në Qarkun e Lezhës për vitin 2019", rezultoi se në tender ka marrë pjesë 2 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"L.X	6.819.963,15	<i>Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme:</i> - është skualifikua sepse nuk ka numrin e mjaftueshëm të automjeteve për lotin e Lezhës, nuk ka paraqitur analizen e koston sipas kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit dhe oferta e tij ekonomike është jologjore
2	N.SS	4.035.985,2	Kualifikuar dhe shpallur fitues

1. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave u konstatua se komisioni i vlerësimit të ofertave ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën me vlerë më të lartë të paraqitur nga operatori ekonomik "LX shpk me vlerë 6.819.963,15 pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas dst.
2. Nga auditimi i ofertës me vlerë më të ulët të paraqitur nga OE "NS sh.p.k rezultoi se i ka plotësuar kriteret e kërkuara në dst.

III. Procedura prokurimit publikme objekt "Loti 4 Ruajtja e objekteve në qarkun e Elbasanit (Godinat e DRT Elbasan, Agjensive tatimore Librazhd dhe Peqin)", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 15157 prot., datë 07.08.2019	NJHDT B H- prgj sektori	KVO me urdhrin nr. 15157 /1 prot., datë 07.08.2019 dhe urdhrin nr. 16349 prot., datë 04.09.2019
Fondi limit 2,203,493 lekë	F G- specialiste	I K – kryetar
Procedura e prokurimit – e hapur	N B- jurist, zevendesuar me J M sipas urdhrin nr. 15536 prot., datë 16.08.2019.	O L – anëtar S B- anëtar V Th - anëtar J M - anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "N" sh.p.k	Vlera fituese 1,813,377 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 06.09.2019		Kontrata nr. 15157/36 datë 23.10.2019
Marrin pjesë 4 OE S'kualifikuar 2 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 15157/19 prot., datë 15.10.2019	Vlera e kontratës 1,813,377.6 me tvsh dhe vlere ditore 25,185.8 lekë me tvsh
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës: nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2019	Titullar i AK – DI

Zhvillimi i procedurës: Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Loti 4 Ruajtja e objekteve në qarkun e Elbasanit (Godinat e DRT Elbasan, Agjensive tatimore Librazhd dhe Peqin)", rezultoi se në tender ka marrë pjesë 4 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"M" shpk	0	<i>Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme:</i> - nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
2	"Nazeri 2000" sh.p.k	2,120,646.5	Kualifikuar
3	"Bahiti-G" sh.p.k.	2,120,646.5	Kualifikuar
4	"Myrto Security" sh.p.k..	2,120,646.5	Kualifikuar

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave u konstatua se komisioni i vlerësimit të ofertave ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga "M" shpk pasi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Në vijim, për përzgjedhjen e fituesit u zhvillua procedura e shortit me datë 10.10.2019 në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 914 datë 29.12.2014, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 66, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 8, në të cilën përcaktohet se: "Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve".

IV. Procedura prokurimit publikme objekt "Loti 5 Ruajtja e objekteve në qarkun e Fierit (Godinat e DRT Fierit , Agjensive tatimore Mallakaster dhe Lushnjë", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 15157 prot., datë 07.08.2019	NJHDT B H- prgj sektori F G- specialiste	KVO me urdhrin nr. 15157 /1 prot., datë 07.08.2019 dhe urdhrin nr. 16349 prot., datë 04.09.2019
Fondi limit 2,748,912 lekë	N B- jurist, zevendesuar me J M sipas urdhrin nr. 15536 prot., datë 16.08.2019.	I K – kryetar O L – anëtar S B- anëtar V T - anëtar J M - anëtar
Procedura e prokurimit – e hapur		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “Nazeri 2000” sh.p.k	Vlera fituese 1,813,377 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 06.09.2019		Kontrata nr. 15157/35 datë 23.10.2019
Marrin pjesë 6 OE S`kualifikuar 4 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 15157/18 prot., datë 15.10.2019	Vlera e kontratës 1,813,377.6 me tvsh dhe vlere ditore 25,185.8 lekë me tvsh
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës: nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2019	Titullar i AK – DI

Zhvillimi i procedurës: Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt **“Loti 5 Ruajtja e objekteve në qarkun e Fierit (Godinat e DRT Fierit, Agjensive tatimore Mallakaster dhe Lushnjë”**, rezultoi se në tender ka marrë pjesë 6 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	“P” sh.p.k.	2.639.572,74	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se nuk ka paraqitur AKEP për radioalarm për rrethin Mallakastër sipas kërkesës në DST, Ofertë jo ligjore
2	“N” sh.p.k	2.645.559	Kualifikuar
3	“FS 2004” sh.p.k	2.645.559	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se nuk kishte paraqitur analizën e kostos për ofertën e paraqitur si te Shtojca 1 – Sqarime
4	“M S” sh.p.k	2.645.559	Kualifikuar
5	“B” sh.p.k	2.645.559	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se nuk ka paraqitur kërkesën e dhënë ne DST, Shtojca 7, Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, nuk ka paraqitur emrin e drejtuesit teknik, nuk ka AKEP për radioalarm për rrethet Lushnjë dhe Mallakastër sipas kërkesës në DST, vërtetimi i lëshuar nga DVP Fier rezultoi me masë administrative ndaj drejtuesit teknik, Ofertë jo ligjore
6	“E” sh.p.k.	2.646.027,72	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se nuk ka paraqitur AKEP për radioalarm për rrethin Mallakastër sipas kërkesës në DST, nuk plotëson kërkesën e dhënë nga 11 çertifikata të paraqitura vetëm 4 çertifikata janë brenda afatit 4 vjeçar sipas nenit 5 pika 5 e Ligjit 74/2014 Për SH.P.S.F, ndërkohe që duheshin 12 çertifikata të vlefshme për lotin e Fierit, Ofertë jo ligjore.

1. Nga auditimi i ofertës më të ulët rezultoi se “P” sh.p.k me vlerë 2.639.572,74 lekë është skualifikuar nga KVO me arsyetimin se nuk ka paraqitur autorizimin nga AKEP për zonën e Mallaksatrës, i cili rezultoi se nuk është paraqitur.

Në vijim, për përzgjedhjen e fituesit u zhvillua procedura e shortit me datë 10.10.2019 në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 914 datë 29.12.2014, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 8, në të cilën përcaktohet se: “Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve”.

V. Procedura prokurimit publike objekt “Loti 10 Ruajtja e objekteve në qytetin e Sarandës (Godina e DRT Sarandë)”, rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 15157 prot., datë 07.08.2019	NJHDT B H- prgj sektori	KVO me urdhrin nr. 15157 /1 prot., datë 07.08.2019 dhe urdhrin nr. 16349 prot., datë 04.09.2019
Fondi limit 989,178.89lekë	F G- specialiste	IK – kryetar
Procedura e prokurimit – e hapur	N B- jurist, zevendesuar me J M sipas urdhrin nr. 15536 prot., datë 16.08.2019.	O L – anëtar S B- anëtar V T - anëtar J M - anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: “E J” sh.p.k	Vlera fituese 952 021,40 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 06.09.2019		Kontrata nr. 15157/48 datë 07.11.2019
Marrin pjesë 4 OE S`kualifikuar 1 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 15157/43 prot., datë 30.10.2019	Vlera e kontratës 602,369.904 me tvsh dhe vlere ditore 10,385.688 lekë me tvsh
Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - po	Afati kontratës: nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2019	Titullar i AK – DI

Zhvillimi i procedurës:Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt “**Loti 10 Ruajtja e objekteve në qytetin e Sarandës (Godina e DRT Sarandë)**”, rezultoi se në tender ka marrë pjesë 4 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	“A S” sh.p.k.	872.168	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se oferta për roje ishte nën koston ligjore, pasi nuk ishin llogaritur saktë vlerat për pagën bazë për roje dhe rrjedhimisht edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe gjithashtu nuk është paraqitur fare preventivi për 1 roje në ditë. Nuk plotëson kërkesën e dhënë në DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, 3.3 Kapaciteti Teknik pika 6 pasi vërtetimi i lëshuar nga DVP Vlorë rezulton se ka detyrime të pa shlyera.Ndaj DVP Vlorë masë administrative.
2	“N” sh.p.k	952 021,40	Kualifikuar
3	“E J” sh.p.k	952 021,40	Kualifikuar
4	“M S” sh.p.k	952 021,40	Kualifikuar

1. Nga auditimi i ofertës me vlerë më të ulët të paraqitur nga OE “Anakonda Security” sh.p.k. me vlerë 872.168 lekë rezultoi se është skualifikuar me te drejtë nga gara pasi nuk ka plotësuar kriteret ligjore të kërkuara në dst. Konstatim të cilin e ka konstatuar dhe komisioni prokurimit publik me vendimin 727/2019 në datën 20.11.2019 në mbështetje edhe të përgjigjes së autoritetit kontraktor me nr.Prot., 17698 datë 24.09.2019.

1. Në vijim, për përzgjedhjen e fituesit u zhvillua procedura e shortit me datë 10.10.2019 në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 914 datë 29.12.2014, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 8, në të cilën përcaktohet

se: “Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve”.

V. Procedura prokurimit publikim i objekt “Loti 12 Ruajtja e objekteve në qarkun e Vlorës (Godina e DRT Vlorë)”, rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 15157 prot., datë 07.08.2019	NJHDT B H- prgj sektori F G- specialiste	KVO me urdhrin nr. 15157 /1 prot., datë 07.08.2019 dhe urdhrin nr. 16349 prot., datë 04.09.2019
Fondi limit 917,238.61 lekë	N B- jurist, zevendesuar me J M sipas urdhrin nr. 15536 prot., datë 16.08.2019.	I K – kryetar O L – anëtar S B- anëtar V T - anëtar J M - anëtar
Procedura e prokurimit – e hapur		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: “M S” sh.p.k	Vlera fituese 882.783,48 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 06.09.2019		Kontrata nr. 15157/49 datë 07.11.2019
Marrin pjesë 5 OE S`kualifikuar 3 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 15157/42 prot., datë 29.10.2019	Vlera e kontratës 602,369.904 me tvsh dhe vlere ditore 10,385.688 lekë me tvsh
Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - po	Afati kontratës: nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2019	Titullar i AK – D I

Zhvillimi i procedurës: Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt “**Loti 12 Ruajtja e objekteve në qarkun e Vlorës (Godina e DRT Vlorë)**”, rezultoi se në tender ka marrë pjesë 5 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	“A S” sh.p.k.	808.885,50	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se oferta për roje ishte nën koston ligjore, pasi nuk ishin llogaritur saktë vlerat për pagën bazë për roje dhe rrjedhimisht edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe gjithashtu nuk është paraqitur fare preventivi për 1 roje në ditë. Nuk plotëson kërkesën e dhënë në DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, 3.3 Kapaciteti Teknik pika 6 pasi vërtetimi i lëshuar nga DVP Vlorë rezulton se ka detyrime të pa shlyera. Ndaj DVP Vlorë masë administrative
2	“M - 2K” sh.p.k	880.705,74	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se oferta për roje ishte nën koston ligjore, pasi nuk ishin llogaritur saktë vlerat për pagën bazë për roje dhe rrjedhimisht edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe gjithashtu nuk është paraqitur fare preventivi për 1 roje në ditë.
3	“S S” sh.p.k	880.705,74	Skualifikuar për arsyet e mëposhtëme: - u skualifikua për shkak se ka 1 masë administrative. Nuk plotëson kërkesën e dhënë në DST, 3.3 Kapaciteti teknik pika 5 pasi nuk ka paraqitur dy automjete me dokumentacion të rregullt, pasi automjeti me targe AA xxx EB nuk është paguar pagesa e taksës vjetore për vitin 2019, ka mbaruar kolaudimi dhe siguracioni si dhe mungon certifikata e pronësisë, kurse për automjetin me targe AA xxx MK nuk është paguar taksa vjetore për vitin 2019 dhe ka mbaruar kolaudimi.
4	“M S” sh.p.k	882.783,48	Kualifikuar
5	“N” sh.p.k	882.783,48	Kualifikuar

1. Nga auditimi i ofertës me vlerë më të ulët të paraqitur nga OE “A S” sh.p.k. me vlerë 872.168 lekë rezultoi se është skualifikuar me te drejtë nga gara pasi nuk ka plotësuar kriteret ligjore të kërkuara në dst. Konstatim të cilin e ka konstatuar dhe komisioni prokurimit publik me vendimin

727/2019 në datën 20.11.2019 në mbështetje edhe të përgjigjes së autoritetit kontraktor me nr.Prot., 17699 datë 24.09.2019.

2. Nga auditimi i ofertave me vlerë të njëjtë të paraqitura nga “M -” sh.p.k dhe “S S” sh.p.k me vlerë 880.705,74 lekë rezultoi se janë skualifikuar me të drejtë.

3. Në vijim, për përzgjedhjen e fituesit midis “M S” sh.p.k dhe “N” sh.p. me vlerë të njëjtë të ofertës u zhvillua procedura e shortit me datë 10.10.2019 në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 914 datë 29.12.2014, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 8, në të cilën përcaktohet se: *“Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve”*.

D.4 Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit të kontratave të punës publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve

Likujdimi dhe marrja në dorëzim e kontratave të zhvilluara nga AKSHI: “Permirësimi i Modullit të Manaxhimit të Kontrollit të Faturimit” me kontratën nr. 6756 prot., datë 27.11.2018

Afati i kontratës është 24 muaj për implementimin (pra data 27.11.2020) dhe 24 muaj për mirëmbajtjen (data 27.11.2022) sipas nr. 6756 prot., datë 27.11.2018.

Personat e autorizuar për ndjekjen e kontratës janë: për AKSHI-n E K, B S dhe G H ndërsa përfaqësues nga DPT: R M, A H dhe G Ç. Për vitin 2019 janë kryer pagesat pjesore sipas kontratës si më poshtë:

1-Fatura tatimore e lëshuar nga OE “J S” shpk me nr.56585225, datë 25.02.2019 me numër serial 56585225. Likujduar me urdhër shpenzimin nr.221 datë 05.04.2019 në vlerën e faturës 112,581,175 lekë me tvsh.

- Akt marrja në dorëzim nga AKSHI me shkresën nr.934/1 prot., datë 25.02.2019 mbajtur nga përfaqësuesit e AKSHI-t G P, B S, G H dhe përfaqësues nga DPT R M, A H dhe G Ç, në të cilën shprehen se pas kryerjes së verifikimeve përkatëse konstatohet se produktet sipas listës përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat e kontratës. Fletë-hyrja me nr. 9 datë 03.04.2019.

2 - Fatura tatimore e lëshuar nga OE “J S” shpk me nr.70471290, datë 19.04.2019 me numër serial 70471290. Likujduar me urdhër shpenzimin nr.352 datë 09.05.2019 në vlerën e faturës 432,665,141 lekë me tvsh.

- Akt marrja në dorëzim nga AKSHI me shkresën nr. 2259/1 prot., datë 02.05.2019 mbajtur nga përfaqësuesit e AKSHI-t Gerald Pinci, B S, G H dhe përfaqësues nga DPT R M dhe G Ç, në të cilën shprehen se pas kryerjes së verifikimeve përkatëse konstatohet se produktet sipas listës përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat e kontratës.

3-Fatura tatimore e lëshuar nga OE “J S” shpk me nr.56585240, datë 06.08.2019 me numër serial 56585240. Likujduar me urdhër shpenzimin nr. 726 datë 13.09.2019 në vlerën e faturës 31,854,438 lekë me tvsh.

- Akt marrja në dorëzim nga AKSHI me shkresën nr.4709/1 prot., datë 04.09.2019 mbajtur nga përfaqësuesit e AKSHI-t G P, K P, G H, B D dhe përfaqësues nga DPT R M dhe G Ç, në të cilën shprehen se pas kryerjes së verifikimeve përkatëse konstatohet se produktet sipas listës përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat e kontratës.

4 - Fatura tatimore e lëshuar nga OE “J S” shpk me nr.71951828, datë 23.08.2019 me numër serial 71951828. Likujduar me urdhër shpenzimin nr.891 datë 26.11.2019 në vlerën e faturës 12,018,085 lekë me tvsh.

- Akt marrja në dorëzim nga AKSHI me shkresën nr.5072/2 prot., datë 13.09.2019 mbajtur nga përfaqësuesit e AKSHI-t G P, K P, G H, B D dhe përfaqësues nga DPT R M dhe G Ç, në të cilën shprehen se pas kryerjes së verifikimeve përkatëse konstatohet se produktet sipas listës përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat e kontratës.

5-Fatura tatimore e lëshuar nga OE “J S” shpk me nr.83883808, datë 13.11.2019 me numër serial 83883808. Likujduar me urdhër shpenzimin nr.954 datë 13.12.2019 në vlerën e faturës 79,833,322 lekë me tvsh.

- Akt marrja në dorëzim nga AKSHI me shkresën nr.7084/2 prot., datë 06.12.2019 mbajtur nga përfaqësuesit e AKSHI-t G P, K P, B D dhe përfaqësues nga DPT R M dhe G Ç, në të cilën shprehen se pas kryerjes së verifikimeve përkatëse konstatohet se produktet sipas listës përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat e kontratës. Fletëhyrja me nr.17 datë 12.12.2019.

Gjetja :	Planifikimi buxhetor për projektet nuk është bërë në përputhje me legjislacionin dhe nuk ka ndjekur me përpikmëri hapat për planifikim të parashikuara në legjislacion duke shkaktuar efekte financiare negative në buxhetin e shtetit në vlerën 10,499,400 lekë
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2019 mbi planifikimin dhe zbatimin e kontratave të zhvilluara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për llogari të DPT, u konstatua se janë shkaktuar efekte financiare negative në buxhetin e shtetit në vlerën 10,499,400 lekë, për arsye se është zhvilluar procedurë prokurimi mbi nevojat e planifikuara dhe pa fonde buxhetore, mungon planifikimi në Programin Buxhetor Afatmesëm edhe në Ligj Buxheti, si edhe urdhër prokurimet janë të pa vulosur nga dega e thesarit, konkretisht në procedurën me objekt: <i>“Krijimi i nje mjedisi te ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qëndrësuar për DPT/DRT (implementim + 24 muaj mirmbajtje)”</i> me kod projekti 18AV806 planifikuar në vlerën 76,000,000 lekë dhe prokuruar 86,499,400 lekë (vlera 10,499,400 lekë pa mbuluar me fonde buxhetore).
Kriteri:	Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 40, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76 pika 1, VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar, II. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e AKSHI-t, germa (i), dhe Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”,
Impakti:	Tejkalimi i fondeve buxhetore të parashikuara
Shkaku:	Kryerja e procedurave të prokurimit në kundërshtim me LPP dhe Ligjin e Buxhetit
Rëndësia:	E lartë

DREJTIMI E: Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi

E1. Marrëdhëniet e punës dhe pagat në institucion

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Gjatë auditimit të pagave dhe shpenzimeve për udhëtim e dieta u shqyrtuan: Struktura e miratuar nga KM; Akt emërimet; Diplomat; Listë prezencat; Listë pagesat; Urdhër shpenzimet; Urdhër shërbimet; Dokumentacioni justifikues/vërtetues dhe gjithë dokumentacioni shkresor i vënë në dispozicion grupit të auditimit nga strukturat respektive.

Pagat e punonjësve të sistemit të tatimeve mbështeten në VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” lidhja 1; lidhja 2 dhe lidhja 6/8 dhe për punonjësit me arsim të mesëm në VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore”, i ndryshuar, lidhja 1.

Grupi i auditimit për të verifikuar rregullshmërinë e kryerjes së pagesave të punonjësve në raport me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” lidhja 1; lidhja 2 dhe lidhja 6/8 dhe akteve rregullatore në fuqi, rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, përzgjedhi listë pagesat e muajve janar; dhjetor 2019. Nga testimet e kryera rezultoi se:

- Listë pagesat janë hartuar bazuar në listë prezencat të cilat rezultuan të nënshkruara nga titullarët e drejtorive;

- Shtesa për pozicion është paguar për kategoritë respektive në përputhje me përcaktimet e lidhjes nr.1 të VKM nr.187, datë 08.03.2017;

- Shtesa për kushte pune është paguar për kategoritë respektive në përputhje me përcaktimet e lidhjes nr.6/8 të VKM nr.187, datë 08.03.2017;

- Diplomat e marra jashtë vendit rezultojnë të njehsuara nga Ministria e Arsimit.

Për të testuar si është paguar paga e grupit, e cila i referohet nivelit të diplomës së arsimit universitar, grupi i auditimit kryqëzoi informacionin e marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në lidhje me nivelin e diplomave që zotërojnë punonjësit dhe që janë të administruara në dosjet personale të punonjësve në DPT (kopje të cilat u administruan nga grupi i auditimit), me listëpagesat që u morrën si kampion testimi si dhe cdo dokumentacion tjetër që i’i vu në dispozicion grupit të auditimit, si akte emërimi, shkresa informuese nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për Drejtorinë e Buxhet Financës në lidhje me vjetësinë në punë ose kualifikimet shtesë të kryera nga punonjësit e DPT gjatë kohës së ushtrimit të detyrave në DPT. Në zbatim të nenit 35, të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, në përfundim të procedurave të rekrutimit, është kompetencë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, përkatësisht përgjegjësit të sektorit të rekrutimit dhe promovimit, përgatitja e akteve të emërimit, për të gjithë punonjësit e ATQ, në bazë të kërkesave ligjore, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga shqyrtimi i akteve të emërimit në punë të punonjësve të testuar, rezultoi se, në asnjë rast, në aktet e emërimit, që i janë përcjell Drejtorisë së Buxhet Financës për pagesë, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është përcaktuar niveli i diplomës për grupet e diplomave të arsimit universitar, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.

Si pasojë e kësaj parregullsie nga testimi rezultoi se: Paga e grupit, për grupet e diplomave të arsimit universitar, për 15 punonjës punonjës efektiv në periudhat (janar & dhjetor 2019), është përlllogaritur dhe paguar në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017, sipas së cilës:

Grupi 1 i diplomës (Master Shkencor dhe të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë) paguhet në shumën 14,000 lekë;

Grupi 2 i diplomës (Master Profesional dhe të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë) paguhet në shumën 11,000 lekë;

Grupi 3 i diplomës (Bachelor dhe të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë) paguhet në shumën 10,000 lekë.

Nga 240 punonjës mesatarisht të testuar, në periudhat (janar & dhjetor 2019), për 15, ose 6% të punonjësve gjithsej, paga e grupit, për grupet e diplomave të arsimit universitar, është përlllogaritur dhe paguar në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017, pasi informacioni i dhënë nga ana e DBNJ për DBF, nuk ka rezultuar i plotë dhe i hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Të dhënat në lidhje me pagesat e grupit të diplomës për punonjësit që janë paguar në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017.

Nr	Emër/ Mbiemër	Niveli i Diplomës sipas DBNJ	Niveli më i lartë i Diplomës sipas KLSH	Data e emërimit në detyrë	Komunikimi për diplomat midis DBNJ & DBF	Paguar nga Financa (pagë grupi)	Sipas KLSH
1	H K	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	16.01.2014	1.Me shkresën nr.5768 datë 22.02.2016 DBNJ informon Sektorin e Financës se z.K është diplomuar në Master Profesional në datë 18.01.2016 dhe paga sipas arsimimit kalon nga grupi i tretë në grupin e parë. 2.DBNJ me shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë. Në këtë informacion z. K rezulton me Master Profesional.	Nga data 01.02.2016 e në vazhdim z.K rezulton i paguar me 14.000 lekë.	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
2	V J	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	10.11.2015	Nuk është përfshirë te shkresa e DBNJ nr. 7108 prot, datë 04.04.2019, informacion DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë, pasi është punonjës i strukturave të IT, të cilat në datë 21.03.2019 u shkeputën për shkak ristrukturimi nga DPT dhe kaluan pranë AKSHI.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
3	B D	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	16.01.2014	Nuk është përfshirë te shkresa e DBNJ nr. 7108 prot, datë 04.04.2019, informacion DBF	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë,

					mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë, pasi është punonjës i strukturave të IT, të cilat në datë 21.03.2019 u shkeputën për shkak ristrukturimi nga DPT dhe kaluan pranë AKSHI.		pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
4	F Z	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	30.11.2016	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë z. Z rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
5	J D	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	12.01.2017	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë znj. D rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
6	E N	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	12.01.2017	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë znj. N rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
7	A H	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	13.11.2018	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë z. H rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
8	A K	1. Bachelor 2. Master profesional	Master Profesional	27.03.2017	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë z. K rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
9	A Q.	1. Bachelor 2. Master Profesional	Master Profesional	13.06.2014	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë z. Q rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.
10	AB	Bachelor	Bachelor	28.12.2016	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë z. B rezulton me Bachelor.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 10,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që

							zotëron është Bachelor
11	A F	1. Bachelor 2. Master Profesional	Bachelor deri në datë 04.10.2019 Master Profesional datë 04.10.2019	31.01.2017	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë znj. F rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Duhej të paguhej me 10,000 lekë, deri në datë 04.10.2019 datë e dilpomimit në nivel Master Profesional. Pas datës 04.10.2019 duhej të paguhej me 11,000 lekë.
12	PH	Bachelor	Bachelor	22.12.2016	Nuk është përfshirë te shkresa e DBNJ nr. 7108 prot, datë 04.04.2019, informacion DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë, pasi në datë 27.03.2019 z.H është larguar nga detyra me kërkesën e tij.	14.000 lekë	Deri në datë 27.03.2019 duhej të paguhej me 10,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëronte punonjësi është Bachelor
13	IN	1.Bachelor 2.Master Profesional 3.Master Shkencor	Master Shkencor datë 01.10.2019.	13.11.2018	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë z. N rezulton me Master Profesional.	14.000 lekë	Nga data 13.11.2018-01.10.2019 datë e dilpomimit në nivel Master Shkencor duhej paguar me pagë grupi 11,000 lekë.
14	E B	1. Bachelor 2. Master Shkencor	Master Shkencor datë 26.09.2019.	12.07.2017	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë znj. B rezulton me Bachelor. Me shkresën nr.20969 datë 14.11.2019 DBNJ informon DBF se znj.Bakui është diplomuar në master shkencor në datë 26.09.2019 dhe paga sipas arsimimit i takon ajo e grupit të parë .	14.000 lekë	Nga data 12.07.2017-26.09.2019 datë e dilpomimit në nivel Master Shkencor duhej paguar me pagë grupi 10,000 lekë.
15	T A	1.Bachelor 2.Master Profesional	Master Profesional	-	Në shkresën nr. 7108 prot, datë 04.04.2019 me anë të së cilës DBNJ, informon DBF mbi nivelin e Diplomës, të të gjithë punonjësve aktualë deri në këtë datë z. A rezulton me diplomë Master Profesional.	10.000 lekë	Duhej të paguhej me 11,000 lekë, pasi niveli më i lartë i diplomës që zotëron është Master Profesional.

Shënim: Në një rast z.A rezulton të jenë paguar më pak se përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nga auditimi nuk rezulton që këta punonjës të jenë kompesuar për këto pagesa.

Nga dokumentacioni i administruar grupit të auditimit rezulton se Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) gjatë vitit 2019 i ka dërguar Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës (DBF) disa shkresa informuese në lidhje me arsimimin dhe vjetërsinë në punë të punonjësve dhe konkretisht:

- Me shkresën nr.2085, datë 29.01.2019 është informuar DBF në lidhje me nivelin e arsimimit për 2 punonjës dhe vjetërsinë për efekt pagese dhe 18 punonjës.

- Me shkresën nr.6690, datë 29.03.2019 është informuar DBF në lidhje me vjetërsinë për efekt pagese dhe 6 punonjës.

- Me shkresën nr.7108, datë 04.04.2019 është informuar DBF në lidhje me nivelin e arsimimit për 216 punonjës, por edhe në informacionin e përcjellë më anë të kësaj shkrese konstatohen disa parregullsi, si vijon:

- a) Në informacionin e sipërcituar nuk janë përfshirë punonjësit e emëruar në datë 13.03.2019 (A.K & A.Sh).

- b) Znj.A.F rezulton në shkresë me nivel diplome Master Profesional, ndërkohë që në datën e hartimit të shkresës zotëronte diplomë të nivelit Bachelor.

- c) 3 nga 15 punonjësit e identifikuar me pagesë në kundërshtim me VKM nr.187, datë 08.03.2017 janë larguar nga detyra përpara datës së informacionit të sipërcituar e për rrjedhojë nuk janë pjesë e këtij informacioni.

- Me shkresën nr.4765, datë 31.07.2019 është informuar DBF në lidhje me nivelin e arsimimit për 4 punonjës dhe vjetërsinë për efekt pagese dhe 9 punonjës.

- Me shkresën nr.19896, datë 29.10.2019 është informuar DBF në lidhje me nivelin e arsimimit për 3 punonjës dhe vjetërsinë për efekt pagese dhe 3 punonjës.

- Me shkresën nr.19927, datë 29.10.2019 është informuar DBF në lidhje me vjetërsinë për efekt pagese dhe 2 punonjës.

- Me shkresën nr.20969, datë 14.11.2019 është informuar DBF në lidhje me nivelin e arsimimit për 3 punonjës.

Në opinionin e grupit të auditimit parregullsitë e konstatuara në 15 raste në lidhje me pagën e grupit kanë ardhur si pasojë e :

- Moskoordinimit ndër vite të DBNJ dhe DBF (pasi emërimet startojnë që në vitin 2014). Koordinimi midis strukturave ka filluar të funksionojë në vitin 2019 komunikimet e sipërcituara (ndonëse janë evidentuar disa parregullsi), por jo në të gjitha rastet ka gjetur zbatim nga DBF;

- Informacioneve të pasakta dhënë nga DBNJ (me shkresën nr.5768, datë 22.02.2016 është informuar DBF në lidhje me nivelin e arsimimit të z.K, duke cituar diplomimin me diplomë Master Profesional dhe paga sipas arsimimit kalon nga grupi i tretë në grupin e parë. Sqarojmë se diploma Master Profesional i përket grupit 2 të diplomave);

- Vendime emërimi në detyrë me përcaktim evaziv të nivelit të arsimimit (Në vendimet e emërimit në detyrë të z.P.H, nr.2043, datë 21.12.2016; z.F.Z, nr.1325, datë 30.11.2016 dhe z.A.B nr.2059, datë 26.12.2016, citohet “Me arsim të lartë” pa specifikuar nivelin e diplomës).

- Informacionit jo të saktë dhënë nga DBNJ me shkresën nr.7108 prot, datë 04.04.2019 mbi nivelin e Diplomës (në 1 rast znj. F sipas informacionit të dhënë rezulton me Master Profesional ndërkohë që në këtë datë punonjësi rezulton me diplomë të nivelit Bachelor, si dhe mospërfshirja në këtë informacion e punonjësve të emëruar në datë 13.03.2019).

Në zbatim të nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, **është kompetencë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, përkatësisht përgjegjësit të sektorit të rekrutimit dhe promovimit, përgatitja e akteve të emërimit..., në bazë të kërkesave ligjore.**

Grupi i auditimit konstaton se në asnjë rast, në aktet e emërimit të punonjësve, që i janë përcjell Drejtorisë së Financës për pagesë, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është përcaktuar niveli i diplomës për grupet e diplomave të arsimit universitar, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e, lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”.

Në total 14 punonjës janë paguar në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 për periudhën nga data e emërimit të punonjësve deri në datë 31.12.2019, nga të cilët:

-10 punonjës të cilët zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë (që i përket grupi 1 të diplomës Master Shkencor), nga 11,000 lekë që duhej të paguheshin për grupin 2 të diplomës Master Profesional;

-4 punonjës të cilët zotërojnë diplomë të nivelit Bachelor janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë (që i përket grupi 1 të diplomës Master Shkencor), nga 10,000 lekë që duhej të paguheshin për grupin 3 të diplomës Bachelor.

Pagesa të kryera në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 për periudhën nga data e emërimit të punonjësve deri në datë 31.12.2018, të cilat kanë shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit pasi, në aktet e emërimit të punonjësve që i janë përcjell Drejtorisë së Financës për pagesë, nuk është përcaktuar niveli i diplomës për grupet e diplomave të arsimit universitar.

Në lekë

Nr	Emër/Mbiemër	Paguar me pagë grupi	Shuma e paguar	Duhej paguar sipas VKM nr.187, datë 08.03.2017	Shuma që duhej të paguhej	Paguar më shumë
1	H K	14,000	476,000	11,000	374,000	102,000
2	V J	14,000	518,000	11,000	407,000	111,000
3	B D	14,000	812,000	11,000	638,000	174,000
4	F Z	14,000	182,000	11,000	143,000	39,000
5	J D	14,000	322,000	11,000	253,000	69,000
6	E N	14,000	322,000	11,000	253,000	69,000
7	A H	14,000	14,000	11,000	11,000	3,000
8	A K	14,000	294,000	11,000	231,000	63,000
9	A Q	14,000	756,000	11,000	594,000	162,000
10	A B	14,000	336,000	10,000	240,000	96,000
11	A F	14,000	322,000	10,000	230,000	92,000
12	P H	14,000	336,000	10,000	240,000	96,000
13	I N	14,000	14,000	11,000	11,000	3,000
14	E B	14,000	238,000	10,000	170,000	68,000
	Totali					1,147,000

Burimi: DBF në DPT

Pagesat e kryera në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019, të cilat kanë shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit:

Në lekë

Nr	Emër/Mbiemër	Paguar me pagë grupi	Shuma e paguar	Duhej paguar sipas VKM nr.187, datë 08.03.2017	Shuma që duhej të paguhej	Paguar më shumë
1	H K	14,000	168,000	11,000	132,000	36,000
2	V J	14,000	42,000	11,000	33,000	9,000
3	B D	14,000	42,000	11,000	33,000	9,000
4	F Z	14,000	168,000	11,000	132,000	36,000
5	J D	14,000	168,000	11,000	132,000	36,000
6	E N	14,000	168,000	11,000	132,000	36,000
7	A H	14,000	168,000	11,000	132,000	36,000
8	A K	14,000	168,000	11,000	132,000	36,000
9	A Q	14,000	168,000	11,000	132,000	36,000
10	A B	14,000	84,000	10,000	60,000	24,000
11	A F	14,000	126,000	10,000	90,000	36,000
12	P H	14,000	42,000	10,000	30,000	12,000
13	I N	14,000	126,000	11,000	99,000	27,000
14	E B	14,000	126,000	10,000	90,000	36,000
	Totali					405,000

Burimi: DBF në DPT

Pagesa totale të përfituara në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017, nga data e emërimit në detyrë deri në 31.12.2019.

Nr	Emër/Mbiemër	Total në lekë
1	H K	138,000
2	V J	120,000
3	B D	183,000
4	F Z	75,000
5	J D	105,000
6	E N	105,000
7	A H	39,000
8	A K	99,000
9	A Q	198,000
10	A B	120,000
11	A F	128,000
12	P H	108,000
13	I N	30,000
14	E B	104,000
	Totali	1,552,000

KLSH

Pagesa në total në shumën 1,552,000 lekë (prej së cilës shuma 405,000 lekë në vitin 2019) përfituar nga 14 punonjës në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të arkëtohet.

Për vitin 2019 për sistemin e tatimeve në zbatim të VKM nr.16, datë 16.01.2019 “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, janë miratuar në total 250 punonjës me kontratë 6 mujore dhe 30 punonjës me kontratë 1 vjeçare, nga

të cilët për aparatin e DPT janë miratuar 24 punonjës me kontratë 6 mujore dhe 7 punonjës me kontratë 1 vjeçare.

Në Akt Konstatimin nr.8, është trajtuar gjerësisht pagesa e punonjësve me kontratë të përkohshme paguar në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, lidhja 1, për periudhën Janar-Qershor 2019, si vijon:

14 punonjësve me arsim të mesëm, pjesë e organikës së DPT, për të cilët, për periudhën Janar-Qershor 2019, paga bazë mujore është llogaritur në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, lidhja 1. Më konkretisht:

- Për 5 punonjës të emëruar me klasën VII, paga bazë mujore sipas listë pagesave (Janar-Qershor 2019) rezulton e paguar me 35,000 lekë, ndërkohë që sipas VKM 717 është 36,300 lekë;
- Për 2 punonjës të emëruar me klasën VI, paga bazë mujore sipas listë pagesave (Janar-Qershor 2019) rezulton e paguar me 34,500 lekë, ndërkohë që sipas VKM 717 është 35,250 lekë;
- Për 7 punonjës të emëruar me klasën IV, paga bazë mujore sipas listë pagesave (Janar-Qershor 2019) rezulton e paguar me 32,500 lekë, ndërkohë që sipas VKM 717 është 33,400 lekë.

Gjithashtu për 5 nga 7 punonjës me kontratë të përkohshme 1 vjeçare, rezulton se për periudhën Janar-Qershor 2019, paga bazë mujore është llogaritur në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, lidhja 1. Për 5 punonjës të emëruar me klasën VII, paga bazë mujore sipas listë pagesave (Janar-Qershor 2019) rezulton e paguar me 35,000 lekë, ndërkohë që sipas VKM nr.717 datë 23.06.2009 është 36,300 lekë;

Kjo parregullsi në pagesa është korrigjuar nga vetë kontrollet e brendshme të ushtruara nga DBF dhe muaji Korrik e në vazhdim pagat për këtë kategori punonjësish janë përlllogaritur në përputhje me përcaktimet e lidhjes 1 të VKM nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, por rezulton që jo të gjithë punonjësit e paguar më pak të jenë kompensuar për diferencën, si vijon:

- Nga 14 punonjës me arsim të mesëm, pjesë e organikës së DPT, të cilët për periudhën Janar-Qershor 2019, janë paguar në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar (lidhja 1), 9 prej tyre janë kompensuar për diferencën në listë pagesën e muajit dhjetor 2019, ndërkohë që për 5 punonjës nuk është kryer kompensimi, nga të cilët, 3 punonjës rezultojnë të larguar nga detyra. Pra për 2 (dy) punonjës aktualisht pjesë e organikës së aparatit të DPT (Sh.S & E.S) deri në momentin e mbajtjes së projektraportit nga DBF nuk rezulton të jetë kryer pagesa e kompesimit për sa paguar më pak në kundërshtim me përcaktimet e përcaktimet e VKM nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

- Për 5 punonjësit me kontratë të përkohshme (F.R; A.T; SJ; G.H; F.D)

deri në momentin e mbajtjes së projektraportit, nga DBF nuk rezulton të jetë kryer pagesa e kompesimit për sa paguar më pak në kundërshtim me përcaktimet e përcaktimet e VKM nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

Gjetja	Parregullsi në 15 raste në pagesën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar.
---------------	---

Situata	<p>a) Në 14 raste punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 për periudhën nga data e emërimit të tyre deri në datë 31.12.2019, <u>duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 1,552,000 lekë</u> (prej së cilës 405,000 lekë në vitin 2019). Më konkretisht: -10 punonjës të cilët zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional (H.K; V.J; B.D; F.Z; J.D; E.N; A.H; A.K; A.Q; I.N) janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë (që i përket grupi 1 të diplomës Master Shkencor), nga 11,000 lekë që duhej të pagueshin për grupin 2 të diplomës Master Profesional; -4 punonjës të cilët zotërojnë diplomë të nivelit Bachelor (A.B; P.H; A.F; E.B) janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë (që i përket grupi 1 të diplomës Master Shkencor), nga 10,000 lekë që duhej të paguheshin për grupin 3 të diplomës Bachelor.</p> <p>b) Në 1 rast punonjësi T.A i cili zotëron diplomë të nivelit Master Profesional, rezulton të jetë paguar më pak se përcaktimet e lidhjes 2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017.</p> <p>c) Në asnjë rast në aktet e emërimit të punonjësve që i janë përcjell Drejtorisë së Financës për pagesë, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është përcaktuar niveli i diplomës për grupet e diplomave të arsimit universitar, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, ku shprehimisht citohet: <u>“është kompetencë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, përkatësisht përgjegjësit të sektorit të rekrutimit dhe promovimit, përgatitja e akteve të emërimit, largimit, kontratave të punës, për të gjithë punonjësit e ATQ në bazë të kërkesave ligjore, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm”.</u></p>
Kriteri	<p>VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet emistrive të linjës,...”, lidhja 2 & lidhja 6/8 struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve.</p> <p>Rregullorja e brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.</p>
Ndikimi/Efekti	Dëm në buxhetin e shtetit.
Rëndësia	I Lartë

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.8, datë 24.07.2020.

Për këtë çështje **znj. V T** në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ka bërë komente dhe shpjegime, me observacionin me nr.prot.6272/56 datë 23.09.2020.

Observacioni është në të njëjtën linjë me atë të trajtuar në projekt raportin e auditimit gjithsesi në mënyrë të përmbledhur po paraqesim edhe njëherë pretendimet e znj T si vijon:

“....-Në akt konstatim dhe në pjesën respektive në projekt raport nuk janë përcaktuar persona përgjegjës, të ngarkuar me përgjegjësi konkrete..... Mungesa e elementit të përcaktimit të personave përgjegjës... krijon parakusht për evazivitet.

-Nxjerrja e përgjegjësive duhet trajtuar në mënyrë që të adresohet problematika tek strukturat që kanë shkaktuar drejtpërdrejt kostot e cilësuarat dëm ekonomik, me veprime dhe mosveprime.

-Nuk përcaktohet elementi konkret se në cilin dispozitë urdhëruese për DBNJ është shkelur (pavarësisht se nuk ka asnjë dispozitë ligjore që të urdhëroj strukturën e burimeve njerëzore, por vetëm me VKM nr.187 që për pjesën që po auditohet është për t'u marr në konsideratë si element i pagës vetëm nga Drejtoria e Financës.

Rekomandimi 2 i lënë për burimet njerëzore është kontradiktor duke lënë opsionale për zgjedhje nga institucioni se cila metodë duhet të zbatohet për informacionin lidhur me pagën e grupit. Kjo kundërshton faktin se aktet e emërimit janë nxjerr në kundërshtim me VKM nr.187 duke mos pasqyruar të dhëna mbi arsimimin dhe nivelin e diplomës së punonjësve.

-Znj A.Sh në datë 29.03.2019 ka depozituar me shkresën nr.6160/1 prot, datë 28.03.2019, diplomën Bachelor me listën e notave të noterizuar, pra znj. Sh është paguar sipas dokumentacionit të paraqitur deri në atë datë.

-Lidhur me z.A.K, ka depozituar në vitin 2020 vërtetimin e diplomës Master I Shkencave që mban datën 31.10.2019 dhe vërteton se është diplomuar në 25.09.2019, pra në datë 13.03.2019 apo në datë 04.04.2019 ky punonjës nuk e ka disponuar dhe as depozituar diplomën master shkencor...”

Qëndrimi i Audituesit:

Në lidhje me sa trajtuar në observacion:

Së pari, në projekt raportin e auditimit janë përcaktuar qartë përgjegjësitë si strukturë dhe si persona përgjegjës dhe konkretisht, si strukturë përgjegjëse është përcaktuar Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe si persona përgjegjës ish drejtuesit e DBNJ për periudhën 2014-2018 periudhë në të cilën janë konstatuar emërimet në punë të punonjësve të sipërcituar. Pra përgjegjësia është e qartë dhe në këto kushte nuk ka vend për evazion. Struktura që me veprimet dhe mosveprimet ka shkaktuar drejtpërdrejt kostot e cilësuarat, dëm ekonomik, është Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Së dyti ju pretendoni se në projekt raportin e auditimit nuk përcaktohet elementi konkret se në cilin dispozitë urdhëruese për DBNJ është shkelur (pavarësisht se nuk ka asnjë dispozitë ligjore që të urdhëroj strukturën e burimeve njerëzore, por vetëm me VKM nr.187 që për pjesën që po auditohet është për t'u marrë në konsideratë si element i pagës vetëm nga Drejtoria e Financës. Ju citoj edhe njëherë konstatimin e grupit të auditimit se, në asnjë rast, në aktet e emërimit të punonjësve, që i janë përcjell Drejtorisë së Financës për pagesë, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është përcaktuar niveli i diplomës për grupet e diplomave të arsimit universitar, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, ku shprehimisht citohet: “është kompetencë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, përkatësisht përgjegjësit të sektorit të rekrutimit dhe promovimit, përgatitja e akteve të emërimit, largimit, kontratave të punës, për të gjithë punonjësit e ATO në bazë të kërkesave ligjore, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm”. Pra dispozitat ligjore janë të shprehura qartë.

Së treti, ju sqaroj edhe njëherë se është detyrim i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, që në çdo rast, për emërimet e reja në punë, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm, të hartojë aktin e emërimit në bazë të kërkesave ligjore, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i VKM

nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, ...” dhe nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017. Mungesa e gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve ë punës që ndjekin dhe zbatojnë strukturat e DPT, në rastin konkret, Drejtoria e Burimeve Njerëzore si një detyrim ligjor i pazbatuar nga kjo strukturë dhe të gjitha strukturat e tjera të DPT-së, që rrjedh nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ka sjell paqartësi për drejtuesin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në lidhje me, përmbajtjen dhe formën që duhet të ketë akti i emërimit në punë të punonjësve, përgjegjësit e kësaj strukture lidhur me administrimin dhe informimin e strukturave të tjera të njësisë me të gjithë informacionin e nevojshëm për punonjësit e ATQ-së. Sqarojmë edhe njëherë se gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë.

Së fundmi, në lidhje me punonjësit A. Sh dhe A.K, grupi i auditimit vlerëson informacionin e dhënë për znj. Shtufi dhe e përjashton atë nga konstatimet, ndërkohë që për z.K konstatimi nuk lidhet me nivelin e diplomës, por me mos përfshirjen e të dhënave të punonjësit në informacionin e datës 04.04.2019, pavarësisht se emërimi daton 13.03.2019.

Në konkluzion: Observacioni në lidhje me mosngarkimin me përgjegjësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk merret parasysh si i pambështetur nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 dhe 6/8 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, përgjegjësi mbajnë ish drejtuesit e DBNJ për periudhën 2014-2018 periudhë në të cilën janë kryer emërimet në punë të punonjësve të sipërcituar. Duke qenë se është një periudhë e gjatë kohore, e shoqëruar me ndryshime të herëpashershme të stafit, i lihet në kompetencë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve përcaktimi i përgjegjësive konkrete.

Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, mbështetet në përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, shprehimisht citohet:

“Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës”.

Titullarë institucioni qendror, në kuptimin e këtij vendimi janë:

a) Për njësitë e qeverisjes qendrore: i) Për ministrinë dhe çdo institucion në varësi të saj, ministri ose i deleguari i tij.

Për vitin 2019, Ministri i Financave dhe Ekonomisë me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019 ka autorizuar Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve të miratojë kryerjen e udhëtimeve brenda vendit, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës.

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues vërtetues për shpenzimet në zërin “Udhëtim e dieta” për vitin 2019 janë konstatuar parregullsi në pagesat e kryera ndaj 2 punonjësve në 6 raste, si vijon:

-Z.K M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm në DPT (DIBA) është paguar në muajin Janar 2019, për 1 (një) ditë dietë të plotë ditore për shërbimin e kryer në datat 06-7.12.2018 në shumën 5,500 lekë. Në muajin Shkurt 2019 z.M është paguar për 2 (dy) ditë dietë të plotë ditore për shërbimin e kryer në datat 11-13.12.2018 në shumën 11,000 lekë. Në Urdhër Shërbimi citohet se z.M dërgohet me shërbim sipas planit të punës së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Në planin e punës nr.23809, datë 23.11.2018, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në pikën IV citohet se pjesëmarrës në zbatim të këtij plani do të jenë inspektorët e DIBA. Pra z.M në cilësinë e Drejtorit të DIBA nuk është autorizuar nga titullari për të shkuar me shërbim jashtë qendrës së punës.

Gjithashtu z.M është paguar për 6 (gjashtë) ditë dietë të plotë ditore në datat 07.08.2019-07.09.2019 në shumën 33,000 lekë. Në Urdhër Shërbimi citohet se z.M dërgohet me shërbim sipas planit të punës nr.14773, datë 31.07.2019 miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Në planin e punës në pikën IV citohet se pjesëmarrës në zbatim të këtij plani do të jenë inspektorët e DIBA. Pra z.M në cilësinë e Drejtorit të DIBA nuk është autorizuar nga titullari për të shkuar me shërbim jashtë qendrës së punës.

Për sa më sipër, shuma 49,500 lekë është përfituar nga z.M në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

-Z.B B, me detyrë përgjegjës sektori në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor është paguar për 4 (katër) ditë dietë të plotë ditore për datat 27-31.05.2019 në shumën 22,000 lekë. Gjithashtu z.B është paguar për 7 (shtatë) ditë dietë të plotë ditore në datat 10-14.06.2019 dhe 18-21.06.2019 në shumën 39,400 lekë. Në Urdhër Shërbimi citohet se z.B dërgohet me shërbim në Shkodër sipas Urdhrit nr.10311, datë 20.05.2019, miratuar nga zv/Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Referuar autorizimit, autorizohen të ushtrojnë kontroll inspektorët V.Dh dhe L.Gj. Pra z.B nuk është autorizuar nga titullari për të shkuar me shërbim jashtë qendrës së punës.

Për sa më sipër, shuma 61,400 lekë është përfituar nga z.B në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Në 6 raste, dy punonjës janë paguar në total në shumën 110,900 lekë në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Për vitin 2019 për udhëtim e dieta brenda vendit janë shpenzuar në total 8,419,855 lekë, prej të cilave shuma 110,900 lekë e përfituar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, ndonëse është nën pragun e materialitetit konsiderohet dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të arkëtohet (49,500 lekë nga z.M dhe 61,400 lekë nga z.B).

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues, vërtetues për shpenzimet për udhëtim e dieta grupi i auditimit konstaton mungesë standardizimi në dokumentin që autorizon shërbimet brenda vendit në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës duke vepruar jo në përputhje me përcaktimet

e Kreut V, pika 2, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

“Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij”.

Më konkretisht janë përdorur si autorizim për dërgim me shërbim jashtë qendrës së punës këto tipe dokumentesh:

-Urdhri i Titullarit për krijim komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve (Urdhri nr.8912/1, datë 27.05.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për krijimin e komisionit, për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve të DRT Dibër, ku z.G është në cilësinë e anëtarit të komisionit. Në urdhër nuk përcaktohen afatet kohore të kryerjes së kësaj detyre);

-Autorizimi për përfaqësim të çështjeve gjyqësore (Në të gjitha rastet juristët e DPT të cilët kanë marrë pjesë në seanca gjyqësore, janë pajisur nga titullari me autorizim për përfaqësim të çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit. Ky dokument edhe pse nuk ka elementët e autorizimit për shërbim në një largësi mbi 100 km (nuk është përcaktuar koha e zgjatjes së shërbimit) është konsideruar nga DBF si i tillë dhe në mbështetje të tij janë paguar shpenzimet e udhëtimit për këta punonjës);

-Shkresë e titulluar “Vizitë informues”, ose dokument i titulluar Urdhër-Shërbimi.

Në lidhje me dokumentimin e shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit, nga auditimi nuk rezultuan parregullsi në pagesat e kryera dhe dokumentacionin autorizues/vërtetues.

Gjetja	Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit.
---------------	--

Situata	<p>a) Në 6 raste, dy punonjës (K.M & B.B) janë paguar në total në shumën 110,900 lekë për shërbimet e kryera mbi 100 km jashtë qendrës së punës pa marrë më parë autorizim nga Titullari i Institucionit, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: <u>“Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës”</u>.</p> <p>b) Mungesë standardizimi në dokumentin që autorizon shërbimet brenda vendit në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës duke vepruar jo në përputhje me përcaktimet e Kreut V, pika 2, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: <u>“...Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij”</u>. Më konkretisht janë përdorur si autorizim për dërgim me shërbim jashtë qendrës së punës këto tipe dokumentesh:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Urdhri i Titullarit për krijim komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve (Urdhri nr.8912/1, datë 27.05.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për krijimin e komisionit, për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve të DRT Dibër, ku z.G është në cilësinë e anëtarit të komisionit. Në urdhër nuk përcaktohen afatet kohore të kryerjes së kësaj detyre); -Autorizimi për përfaqësim të çështjeve gjyqësore (Në të gjitha rastet juristët e DPT të cilët kanë marrë pjesë në seanca gjyqësore, janë pajisur nga titullari me autorizim për përfaqësim të çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit. Ky dokument edhe pse nuk ka elementët e autorizimit për shërbim në një largësi mbi 100 km (nuk është përcaktuar koha e zgjatjes së shërbimit) është konsideruar nga DBF si i tillë dhe në mbështetje të tij janë paguar shpenzimet e udhëtimit për këta punonjës); -Shkresë e titulluar “Vizitë informues”, ose dokument i titulluar Urdhër-Shërbimi.
Kriteri	<p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.</p> <p>VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.</p> <p>Autorizimi i Ministrit të Financave nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019.</p>
Ndikimi/Efekti	Dëm në buxhetin e shtetit.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Drejtoria e Buxhet Financës të marrë masat për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 110,900 lekë, përfituar nga punonjësit (K.M & B.B) në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.8, datë 24.07.2020.

Për përfitimin e shpenzimeve të udhëtimit në kundërshtim me përcaktimet e kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, përgjegjësi mban z. M në cilësinë e Drejtorit të DIBA.

E2. Rekrutimet, transferimet dhe largimet për periudhën nën auditim, si dhe impakti i tyre në buxhetin e shtetit. Procedurat e ndjekura në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike për plotësimin e vendeve vakante të organikës. Radha e ndjekur e rekrutimeve për punonjësit që kanë fituar konkurrimin

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Urdhërat për miratimin e Strukturës së DPT: Nr. 126 datë 02.08.2016, Nr.49 datë 27.02.2019, Nr.86 datë 03.05.2019;
- 2.Dosja e Komisioneve të Ristrukturimit, shkresa, propozime, vendime;
- 3.Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- 4.VKM Nr. nr. 125, datë 17.2.2016“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
- 5.VKM Nr.766 datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil për vitin 2019”;
- 6.Udhëzimi Nr.1 Datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit”;
- 7.Dosjet, lidhur me rekrutimet, largimet dhe transferimet për gjithë punonjësit për periudhën objekt auditimi;
- 8.Dokumentacioni bashkëlidhur në dosjet personale të punonjësve të rekrutuar, larguar dhe transferuar në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë DPD;
- 9.Vepriimtaria e Komisionit Disiplinor;

Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet shprehimisht në ligj që një vendim/akt administrativ i caktuar, që ka të bëjë me marrëdhëniet e shërbimit civil, është në kompetencën e një nëpunësi apo një trupe tjetër posaçërisht të krijuar sipas këtij ligji, siç është Komisioni i Posaçëm i ngritur në zbatim të Urdhrit nr.5151 datë 28.10.2015.

Objekti i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është të ndjekë, zbatojë dhe sigurojë procedura për rekrutim, zhvillimin profesional dhe motivimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim arritjen e objektivave të Institucionit.

Detyrat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë:

- 1.Ndjekja e procedurave të rekrutimit sipas shpalljeve të Departamentit të Administratës Publike për punonjësit e shërbimit civil dhe rekrutimin e punonjësve, të cilëve marrëdhëniet e punës u rregullohen sipas Kodit të Punës;
- 2.Ndjekja dhe garantimi i një procesi real të vlerësimit të punës së punonjësve të Administratës Tatimore Qendrore, sipas përshkrimit të punës dhe objektivave individuale dhe në grup të institucionit;
- 3.Sigurimi i ngritjes profesionale të stafit të DPT-së, nëpërmjet një procesi trajnimi dhe zhvillimi të administratës tatimore;

4.Zbatimi i procedurave ligjore në dhënien e masave disiplinore për punonjësit me shkelje të dispozitave të punës dhe atyre ligjore.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka të përcaktuar në strukturë 8 pozicione pune dhe është e organizuar në dy sektorë:

1.Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit- me 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialist, pa vakanca.

2.Sektori i Trajnimit dhe Vlerësimit- me 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist, pa vakanca.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore (Gjithsej punonjes)			Kategoria e pagës
Drejtori	V	T	III-a
Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit			
Përgjegjës Sektori.	E	P	III-a/1
Specialist	E	B	IV- a
Specialist	A	H	IV- a
Specialist	E	V	IV- a
Sektori i Vlerësimit të Punonjësve			
Përgjegjës Sektori.	I	K	III-a/1
Specialist	S	G	IV- a
Specialist	D	H	IV- a

Struktura e Administratës Tatimore Qendrore e vitit 2019 ka funksionuar me Urdhrin nr.126 datë 02.08.2016 të Kryeministrit, dhe përmban në total 1569 pozicione pune të ndara në:

a. 1159 pozicione të rregulluara nga ligji për statusin e nëpunësit civil;

b. 410 pozicione të rregulluara nga Kodi i Punës së RSH, ku prej tyre 282 pozicione i përkasin strukturave të hetimit tatimor dhe 128 pozicione i përkasin funksioneve mbështetëse.

Urdhri Nr.126 datë 02.08.2016ka funksionuar deri në 27.02.2019, ku me Urdhrin e Ri Nr.49 datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.126 datë 02.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore qendrore”, është miratuar struktura e re organizative e ATQ, ku nga 1569 punonjës, kalon në 1512.

Me shkresën Nr.4535/1 prot datë 04.03.2019Zv. Drejtor i Përgjithshëm Z. Xh.C i ka bërë kërkesë Departamentit të Administratës Publike, për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, në përputhje me pikën 1, Kreu II, të Udhëzimit Nr.1 datë 01.03.2016.

Me shkresën Nr.20337/7 prot datë 05.03.2019, në zbatim të Urdhrit të KM, në mungesë dhe me Urdhër Zv. Drejtor i Përgjithshëm Z. Xh.C i ka nisur shkresë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për miratim organigrame.

Sipas Udhëzimit Nr.1 Datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit”, Kreu II Krijimi dhe Funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit” Rasti: Ristrukturimi i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga:

- Nëpunësi më i lartë civil i institucionit mëmë nga varet institucioni që po ristrukturohet (Kryeministrisë në rastin e varësisë së Kryeministrit apo ministrisë në rastin e institucioneve në varësi të ministrave);

- Nëpunësi më i lartë civil i institucionit që po ristrukturohet;

- Një përfaqësues nga njësia përgjegjëse (DAP).

Me Urdhrin Nr.20 Datë 11.03.2019, shkresa Nr.1412/1 Prot datë 11.03.2019 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore”, nga Departamenti i Administratës Publike është krijuar Komisioni i Ristrukturimit me përbërje si në vijim:

1.Z. E K--specialist në Sektorin e Inspektimit, në Drejtorinë e Politikave të Rritjes Profesionale, Integritetit dhe Inspektimit, në Departamentin e Administratës Publike –Kryetar.

2.Znj.G P –Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë –anëtar
3.Z. Xh C –Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve –Anëtar: në përputhje me pikën 2, rasti 2, Kreu II, të Udhëzimit Nr.1 Datë 01.03.2016 përsa i përket përbërjes, por me zgjatje afati prej 1 jave më shumë sesa e përcakton Udhëzimi.

Komisioni i Ristrukturimit ka për detyrë:

- a) të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese;
- b) t'i propozojë njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike, sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013;
- c) Të vlerësojë dhe të marrë vendim për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për arsyet e parashikuara në pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe t'ia dërgojë këtë vendim njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.

Me shkresën Nr.1774/1 Prot datë 25.03.2019 DAP i është drejtuar AKSH-it (për dijeni ATQ-s) me listën me punonjësit civil që kanë ushtruar detyrat në njësinë e menaxhimit TIK, pranë ATQ, për të cilët AKSH-i duhet të filloj procedurat për vijimin e marrëdhënies në këtë të fundit, për 21 punonjës sipas ankesit nr.1.

Me shkresën Nr.7525 Prot datë 09.04.2019 Komision i Ristrukturimit ka dal me vendim propozimi për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil duke vlerësuar:

- ✓ Strukturën dhe organikën ekzistuese të ATQ
- ✓ Strukturën dhe organikën e re të ATQ
- ✓ Të dhënat e nëpunësve civil, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit (dosjet individuale)
- ✓ Kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara/prekura si pasojë e ristrukturimit, përshkrimet e punës

Grupi i auditimit konstatoi se ndryshimet midis dy strukturave janë si në vijim:

ATQ	Struktura Nr.126 datë 02.08.2016 Nr.punonjës	Struktura Nr.49 datë 27.02.2019 Nr.punonjës	Ndryshimi
DPT	279	254	Shkurtim i Drejtorisë së Informacionit dhe Komunikimit me 25 vende pune dhe 22 punonjës, duke qënë se 3 vende pune ishin vakante.
DTM	120	117	Nuk është më pjesë e strukturës Drejtoria e Analizës dhe TIK (1+2+4) dhe Sektori i Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës (1+2), duke mbetur vetëm Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave i cili shtohet me 1 punonjës. Në total shkurtim 3 vende pune.
DRT	367	362	Drejtoria e Analizës dhe TIK (1+2+14) emërtohet Drejtoria e Kontabilitetit dhe të Ardhurave (1+2+29). Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit (1+10) emërtohet Sektori i Kontabilitetit të të Ardhurave (1+4) ndërsa Sektori i Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës (1+4) emërtohet Sek.Analizës dhe Statistikës (1+5). Në total shkurtim 5 vende pune.
Durrës	107	104	Drejtoria e Analizës dhe TIK (1+2+4) me 2 sektorë, Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit (1+2) dhe Sektori i Tekn.së Info dhe Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës (1+2) kalon vetëm në 1 Sektor, Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave (1+3). Në total shkurtim 3 vende pune.
Shkodër	130	127	-Drejtoria e Hetimit Tatimor (1+2+18+30) nga 2 sektorë kalon në 3 sektorë me nr total punonjës 50. Shtim Sektori i Hetimit Tatimor është shkurtuar me 15 punonjës, dhe është shtuar Sektor i Zbatimit në organikë (1+1+29). Drejtoria e Hetimit Tatimor, në strukturën e re (1+3+18+29). Nuk ka ndryshim nr punonjës. -Nuk është më në organikë Drejtoria e Analizës dhe TIK (1+2+4) dhe Sektori i Tekn së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës (1+2). Shkurtim 4 vende pune. Mbetet vetëm Sek i Analizës dhe Kontabilitetit i cili nga 1+2 kalon në 1+3. Shtim 1 vend pune. Në total shkurtim 3 vende pune.
Elbasan	69	66	Sektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (3), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës (2), emërtohet Sektori i Analizës së Kontabilitetit (1+2). Shkurtim 3 vende pune.

Vlorë	52	50	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (3), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (2), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+3). Shkurtim 2 vende pune.
Gjirokastrë	38	36	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (2), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (2), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+2). Shkurtim 2 vende pune
Sarandë	36	34	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (2), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (2), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+2). Shkurtim 2 vende pune
Dibër	34	33	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (2), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (1), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+3). Shkurtim 1 vend pune
Fier	150	147	Drejtoria e Analizës dhe TIK (1+2+4) me 2 sektorë, Spektori i Analizës dhe Kontabilitetit (1+2) dhe Spektori i Tekn.së Info dhe Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës (1+2) kalon vetëm në 1 Sektor, Spektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave (1+3). Në total shkurtim 3 vende pune.
Kukës	34	33	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (2), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (1), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+2). Shkurtim 1 vend pune
Lezhë	44	43	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (2), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (1), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+2). Shkurtim 1 vend pune
Berat	41	40	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (2), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (1), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+2). Shkurtim 1 vend pune
Korçë	68	66	Spektori i Analizës dhe TIK me 2 zyra, zyra e Analizës dhe Kontabilitetit (3), dhe Zyra e Teknologjisë së Info, Pajisjeve Fiskale dhe Statisikës (2), emërtohet Spektori i Analizës së Kontabilitetit (1+3). Shkurtim 2 vende pune
Total	1569	1512	Koment: Shkurtim 57 vende pune

Ndërkohë sipas shkresës Nr.7525 Prot datë 09.04.2019 Komision i Ristrukturimit të ATQ ka dal me vendim propozimi për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil, për 41 punonjës, të cilat DAP i ka miratuar me shkresën Nr. 2099/1 Prot datë 15.04.2019, jo në përputhje me afatet e përcaktuara nga pika 16, Kreu II, i Udhëzimit dhe pika 17 Kreu II, i VKM Nr. nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të cilat citojnë se: *Komisioni, brenda 15 ditësh nga momenti i krijimit të tij:*

- *i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira sipas procedurave më sipër;*

- *i dërgon njësisë së burimeve njerëzore të institucionit vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo rristrukturimit sipas procedurave më sipër.*

Komisioni ka vepruar në kundërshtim me pikën 10, Kreu II, të Udhëzimit Nr.01. Datë 01.03.2016 e cila citon “10.Komisioni merr vendim për transferimin e nëpunësve apo përfundimin e marrëdhënies së tyre në shërbimin civil, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit të shpjeguar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi” dhe pikën 17 “Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi.

Referuar pikës 10, të Udhëzimit Nr.1 Datë 01.03.2016 të DAP “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit, në të përcaktohet qartë që:

“Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi.

Referuar pikës 19, të VKM Nr.125 datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përhershëm të nëpunësve civil” në të përcaktohet qartë që:

“Komisioni i ristrukturimit në vendimin e tij për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet mbi këto kritere:

- a) Vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil;
- b) Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë;
- c) Vlerësimin e fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë.

Si konkluzion: Në Drejtoritë Rajonale Tatimore konstatohen se disa prej punonjësve nuk kanë kaluar në AKSH edhe pse kanë qënë të strukturave të IT, por janë sistemuar në pozicione të tjera brenda strukturave të DRT si në vijim:

DRT	Para ristrukturimit Struktura e IT	Të larguar nga Ristrukturimi, dhe kaluar te AKSHI	Ripozicionuar në pozicione të tjera në DRT
TM	R C, D G	R C D G	
Tiranë	D F, K K E G, A V	E G, K K D Fejzaj	A V -Inspektor i dytë gjyqftues
Durrës	M B, I V	M B, I V	
Shkodër	F P M K	F P M K	
Elbasan	E L, A F F B	E L	A F -Inspektor i dytë F B -Përgjegjëse Sektori
Vlorë	G M	G M	
Gjirokastrë	N K N M	N K N M	
Sarandë	E T, A Th	E T	A Th -Inspektor i dytë
Dibër	Almir M	A M	
Fier	AT, E S K Gj	K Gj A T	E S Inspektor i dytë
Kukës	E A	E A	
Lezhë	A S	A S	
Berat	A Q	A Q	
Korcë	P P, R M, E Xh	E Xh	P R Përgjegjës Sektori R M P Inspektor i dytë
	28 total punonjës të strukturave të IT	21 kaluar në AKSH	7 ripozicionuar

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Ristrukturimit: Z. E K specialist në Sektorin e Inspektimit, në Drejtorinë e Politikave të Rritjes Profesionale, Integritetit dhe Inspektimit, në Departamentin e Administratës Publike –Kryetar, Znj.G P –Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë anëtar, Z. Xh C –Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve Anëtar.

Me Urdhrin Nr.86 datë 03.05.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.126 datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qendrore” të ndryshuar, struktura paraqitet me ndryshimet e mëposhtme:

DPT DRT	Struktura Nr.49 datë 27.02.2019 Nr.punonjës	Struktura Nr.86 Datë 03.05.2019 Nr.punonjës	Ndryshimet
DPT	254	249	-Zv. Drejtor i Përgjithshëm Territorial emërtohet Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Funksioneve Operacionale dhe ka në varësi DTM, Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë e Hetimit Tatimor, kjo e fundit e trajtuar me kod pune. -Drejtorja e Menaxhimit të Projekteve shtohet me 1 pozicion Inspektor i Parë

			-Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara -Drejtoria e Kontrollit Tatimor do të ketë në përbërje jo 3 sektorë, por 2. Sektorin e Kontrollit Tatimor dhe Sektorin e Cilësisë dhe Standartizimit të Procedurave. Shtohen 2 vende pune. -Sektorin e Transferimit të cmimit të DPT kalon në DTM -Në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, Sektorin e Përmbljes emërtohet Sektorin e Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve-nuk ka ndryshim nr -Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional shtohet me 1 specialist në Sektorin e Administratës -Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional shtohet me 4 pozicione specialist -Drejtoria Ligjore dhe Teknike shtohet me 1 pozicion Specialist në Sektorin Teknik -Qendra e Pagesave shkurtohet me 1 pozicion specialist
DTM	117	127	-Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë -Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit të të ardhurave do të ketë në përbërje 2 sektorë, analizën e Kontabilitetit (1+2) dhe analizën e Riskut 4 -Sektorin e Kontrollit Tatimor do të shtohet me 3 inspektorë. Nga 65-68 -Sektorin e Transferimit të Cmimit shtohet me 3 pozicione Inspektor i parë -Sektorin e Regjistrimit emërohet Sektorin e Regjistrimit dhe Asistencës -Sektorin e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve emërtohet Sektorin e Edukimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.
DTT	362	359	-Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë -Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk ka më në përbërje të saj Sektorin e Transferimit të Cmimit. Ky Sektor suprimohet dhe bëhet pjesë e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.
Durrës	104	104	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë. Kjo Drejtori do të ketë në përbërje 2 Sektorë: Sektorin e Marrëveshjeve (1+2) dhe Sektorin e Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara (1+11)
Shkodër	127	126	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Elbasan	66	66	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Vlorë	50	50	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Gjirokastrë	36	36	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Sarandë	34	34	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Dibër	33	33	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Fier	147	146	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Kukës	33	33	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Lezhë	43	43	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Berat	40	40	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Korcë	66	66	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, nr pozicioneve i njëjtë
Total	1512	1512	

Në mënyrë të përmblodhur:

Nr	Emertimi	Struktura 2018	Struktura 2019			Diferenca në nr punonjësish
		VKM Nr 126 datë 02.08.2016	VKM Nr. 49 datë 27.02.2019	Diferenca në nr punonjësish	VKM Nr. 86 date 03.05.2019	
1	DPT	279	254	-25	249	-5
2	DTM	120	117	-3	127	+10
3	DRT Tiranë	367	362	-5	359	-3
4	DRT Durrës	107	104	-3	104	0
5	DRT Elbasan	69	66	-3	66	0
6	DRT Fier	150	147	-3	146	-1
7	DRT Korçë	68	66	-2	66	0
8	DRT Shkodër	130	127	-3	126	-1
9	DRT Vlorë	52	50	-2	50	0

10	DRT Dibër	34	33	-1	33	0
11	DRT Kukës	34	33	-1	33	0
12	DRT Gjirokastrë	38	36	-2	36	0
13	DRT Sarandë	36	34	-2	34	0
14	DRT Lezhë	44	43	-1	43	0
15	DRT Berat	41	40	-1	40	0
	Totali Miratuar	1569	1512	-57	1512	0

Me shkresën Nr.9244 Prot datë 07.05.2019 i është dërguar për miratim organigrama e ATQ Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me shkresën Nr.9243 prot datë 07.05.2019 është bërë kërkesa për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, drejtuar DAP. Me Urdhërin Nr.32 datë 10.05.2019 është krijuar Komisioni i përbërë nga:

-znj. A N Kryetar –specialist në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kryetar

-z. A K Anëtar –Sekretar i Përgjithshëm i MFE, anëtar

-z. E D Anëtar –Drejtore i Përgjithshëm i DPT, anëtar

Midis dy strukturave nuk konstatohet ndryshim në numër punonjësish.

Për transferimet Komisioni i Ristrukturimit relatton se ka ndjekur 2 parime kryesore:

-Ripozicionimin direkt të nëpunësve civil në pozicione pune sipas strukturës së re, të cilët kanë përshkrim pune të njëjtë ose të ngjashëm me atë aktualin

-Nevojën e Institucionit

Me Urdhërin Nr.171 datë 13.05.2019 është bërë miratimi i organigramës të ATQ, në nivel qëndror për 249 punonjës dhe në nivel rajonal për 1263 punonjës (total 1512).

Me shkresën Nr.11348 prot datë 06.06.2019 Komisioni ka dal me propozim për transferimin e përhershëm të 150 punonjësve të prekur nga Ristrukturimi, për të cilat DAP ka dal me vendim me shkresën Nr. 3726/1 Prot datë 10.07.2019, jo në përputhje me afatet e përcaktuara në VKM Nr.125 datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë, kreu II, pika 17 që citon: Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe krijohet nga njësi përgjegjëse sipas rastit. Komisioni i ristrukturimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e ristrukturimit. a) I propozon me shkrim njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Këto propozime janë miratuar me nga njësi përgjegjëse DAP me shkresën nr.3726/1 prot date 10.07.2019.

Grupi auditimit konstaton se nga ana e Komisionit të Ristrukturimit dhe njësi përgjegjëse DAP janë transferuar edhe punonjës Drejtoria e të cilëve nuk ka qenë subjekt i ndryshimeve strukturore të Urdhrit nr.86 datë 03.05.2019.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Ristrukturimit: znj. AN Kryetar specialist në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, DAP, z. A K Anëtar –Sekretar i Përgjithshëm i MFE, z. E D Anëtar –ish Drejtore i Përgjithshëm i DPT

Konstatohet se në datën 16.07.2019 është caktuar Titullar i ri në DPT. Ky i fundit me shkresën nr.15635/1 prot datë 28.08.2019 ka bërë kërkesë për një ndryshim në Komisionin e Ristrukturimit nisur nga ankesat e disa prej punonjësve të prekur nga Ristrukturimi.

Me Urdhërin nr.62 datë 30.08.2019 pjesë e Komisionit të Ristrukturimit është caktuar Znj.D I, Drejtore i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve –anëtar.

Në vijimësi të ankesave ky Komision i Ri ka marr në shqyrtim ankesat dhe ka propozuar rishqyrtimin e transferimeve të përhershme lidhur me nëpunësit sipas vendimit Nr.3726/1 prot datë 10.07.2019.

Me shkresën Nr.16286/2 Prot datë 19.09.2019 është bërë propozim i anulimit të aktit të transferimit të Znj.E P, Znj.LL, Znj.I V, Znj.R M, Znj.P E, Znj.I L, dhe Znj.M T, Z. A K, Z. F P, Znj. D B, si akte të bërë jo në përputhje me dispozitat ligjore dhe urdhërin 85 datë 03.05.2019.

DAP ka miratuar propozimet e komsionit të ristrukturimit duke nxjerr shkresa për anulimin e transferimeve të tyre dhe rikthimin në pozicionet e mëparshme.

Ristrukturimi i dytë është përfunduar përtej afateve të përcaktuara ligjore, për arsye të ndërrimit të titullarit të Institucionit dhe trajtimit të ankesave të lartpërmendura.

Rregullorja e brendshme e ATQ

Administrata Tatimore Qendrore ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë me Rregulloren e miratuar me Urdhrin Nr.19 datë 22.02.2017, miratuar nga Ministri i Financave, e cila përcakton rregullat dhe detyrat për organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet, ndërmjet njësive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore. Gjithashtu kjo rregullore vendos rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore. Konstatohet se kjo rregullore i përshtatet strukturës së mëparshme të AQT dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale.

Mbi largimet nga puna

Gjatë vitit 2019 janë larguar nga puna gjithsej 126 punonjës, prej të cilëve 72 nëpunës me status të nëpunësve civil dhe 54 punonjës me kontratë, pasqyruar në mënyrë të detajuar sipas institucioneve në tabelën më poshtë. Siç evidentohet edhe në tabelë institucionet me numër më të lartë të larguarish janë DPT me 45 të larguar, Drejtoria Rajonale Tiranë me 19 të larguar, Drejtoria Rajonale Fier me 14 të larguar, Drejtoria Rajonale Shkodër me 11 të larguar dhe Drejtoria Rajonale Durrës me 8 të larguar.

Të larguarit nga puna

Degët	Largime 2019	Nr.
DPT	Status nëpunësi	27
	Kod pune	18
	Total	45
DRT Tirana	Status nëpunësi	6
	Kod pune	13
	Total	19
DTM	Status nëpunësi	4
	Kod pune	-
	Total	4
DRT Fier	Status nëpunësi	3
	Kod pune	11
	Total	14
DRT Durrës	Status nëpunësi	6
	Kod pune	2
	Total	8
DRT Shkodër	Status nëpunësi	5
	Kod pune	6
	Total	11
DRT Elbasan	Status nëpunësi	3
	Kod pune	-
	Total	3
DRT Korçë	Status nëpunësi	3
	Kod pune	-
	Total	3
DRT Vlorë	Status nëpunësi	4
	Kod pune	-
	Total	4
DRT	Status nëpunësi	2

Lezhë	Kod pune	1
	Total	3
DRT Berat	Status nëpunësi	1
	Kod pune	-
	Total	1
DRT Gjirokastër	Status nëpunësi	2
	Kod pune	-
	Total	2
DRT Sarandë	Status nëpunësi	2
	Kod pune	1
	Total	3
DRT Dibër	Status nëpunësi	3
	Kod pune	2
	Total	5
DRT Kukës	Status nëpunësi	1
	Kod pune	-
	Total	1
Totali		72+54=126

Të larguarit nga puna me Status të Nëpunësit Civil nga DPT (*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.2)

Konstatohen 27 punonjës të larguar nga të cilët:

- ✓ 2 punonjës me lirim nga detyra me VKM
- ✓ 23 punonjës larguar nga Ristrukturimi (kanë kaluar te AKSH me kod pune)
- ✓ 2 punonjës larguar me dorëheqje

Të larguarit nga puna me Status të Nëpunësit Civil nga DRT (*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.3)

Konstatohen 45 punonjës të larguar nga të cilët:

- ✓ 19 punonjës larguar me dorëheqje
- ✓ 1 punonjës largim për emërim në Institucion tjetër
- ✓ 21 punonjës larguar nga Ristrukturimi (kanë kaluar te AKSH me kod pune)
- ✓ 3 punonjës larguar me masa disiplinore
- ✓ 1 punonjës larguar nga DAP

Të larguarit nga puna me Kod pune nga DPT (*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.4)

Konstatohen 18 punonjës nga të cilët:

- ✓ 2 punonjës larguar me Urdhër Ministri
- ✓ 15 punonjës larguar me dorëheqje
- ✓ 1 punonjës larguar nga Ristrukturimi

Të larguarit nga puna me Kod pune nga DRT (*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.5)

Konstatohen 36 punonjës nga të cilët:

- ✓ 4 punonjës janë larguar me Urdhër nga MFE
- ✓ 12 punonjës janë larguar me dorëheqje
- ✓ 10 punonjës janë larguar me masa disiplinore
- ✓ 10 punonjës janë larguar nga Ristrukturimi

Të larguarit me kod pune nga strukturat e Hetimit Tatimor

Hetimi Tatimor është një strukturë, punonjësit e të cilës janë me kod pune. Vendimmarrja largimit nga puna është kompetencë e titullarit, në cilësinë e punëdhënësit, *për këtë arsye nuk janë trajtuar nga komisioni i Ristrukturimit.*

Konstatohet se janë larguar 11 punonjës. Sipas shkresave për zgjidhjen e kontratave të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, këto largime janë kryer për shkak të ndryshimeve

strukture dhe riorganizimeve të strukturave të hetimit tatimor, krahasuar me strukturën dhe organikën e mëparshme.

Grupi i auditimit nga shqyrtimi i dokumentacioneve dhe dosjeve personale konstatoi si në vijim: **Dosja e Arlind Myftarit**: mbaruar studimet për Shkenca Politike Rusi. Emëruar me vendimin Nr.641 prot datë 26.09.2016, Inspektor hetimi në Sektorin e Hetimit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, duke kaluar në vitin 2017 Inspektor Zbatimi deri në muajin maj 2019 kategoria IV-a. Përgjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore. Me shkresën nr.9592/1 prot datë 23.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është zgjidhur kontrata e punës, për arsye ristrukturimi dhe që nuk plotëson kriteret e reja të vendit të punës.

Drejtorja e Hetimit Tatimor (1+3+31+72) pranë DRT Tiranë aktualisht përbëhet nga Sektori i Hetimit Tatimor (1+30+1) dhe Sektor i Monitorimit Territorial (1+1+26+46). Sektori i zbatimit dhe sektori i analizës që ishin pjesë e strukturës së mëparshme, aktualisht janë bashkuar në 1 sektor të vetëm të emërtuar Sektori i Monitorimit Territorial, me 74 punonjës. Si rrjedhojë kjo strukturë në total nuk ka ndryshim numri.

Ky sektor ku është zyra e veprimeve në terren dhe masave administrative përbëhet nga: 24 inspektorë me kategori page IV-a dhe 44 inspektorë me kategori page IV-b.

Ndryshimet e kriterëve në Rregullore janë bërë me Urdhrin nr.65/2 datë 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Kriteret arsimore në rekrutimin e inspektorëve të zbatimit në Sektorin e Monitorimit në Terren dhe Masave Administrative kanë ndryshuar si vijon:

-Inspektor në zyrën e veprimeve në terren dhe masave administrative IV-a duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në shkenca ekonomike, juridike ose shoqërore dhe të ketë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion.

-Inspektor në zyrën e veprimeve në terren dhe masave administrative IV-b duhet të zotërojë minimalisht diplomë bachelor në shkenca ekonomike, juridike ose ekzakte.

-Inspektor zbatimi në sektorin e monitorimit në terren IV-a duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në shkencat ekonomike ose juridike dhe të ketë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion.

Për sa më sipër z. A M mund sistemohej në nivelin IV-b, edhe pse me ulje të kategorisë.

Grupi auditimit konstaton se në datë 07.08.2019 DPT ka bërë shpallje për konkurrim për pranim në strukturat e Hetimit Tatimor në Rajonin e Jugut ku si kriter është vendosur: *zotërim minimalisht i diplomës bachelor në shkenca ekonomike, juridike, shoqërore ose ekzakte, kategoria IV-b për inspektor zbatimi në Sektorin e Monitorimit në Terren.*

Konstatohet gjithashtu se pas ristrukturimit janë mbajtur në punë inspektorë të tjerë të cilët kanë patur arsimin e tij. Këto konstatime mbështeten dhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi me shkresën nr.1882/1 prot datë 12.12.2019 mbi ankesën nr 68 datë 11.06.2019 të z. AM.

Dosja e N D – me një eksperiencë 9 vjecare në strukturat tatimore. Me vendimin nr.1270 datë 21.11.2016 është emëruar Inspektor Zbatimi në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, DRT Tiranë, kategoria e pagës IV-b. *Arsimi që disponon është Dega Fizikë, diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.* Me shkresën nr.9587 datë 10.05.2019 është njoftuar për takim me punëdhënësin në lidhje me ndryshimet strukture. Me shkresën nr.9587/1 prot datë 23.05.2019 është njoftuar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për mosplotësim të kriterëve të veçanta të vendit të punës. Me shkresën nr.27635/1 prot datë 28.05.2019 është njoftuar për zgjidhje të kontratës së punës.

Me rregulloren e re miratuar në datë 14.05.2019, -Inspektor në zyrën e veprimeve në terren dhe masave administrative IV-b duhet të zotërojë minimalisht diplomë bachelor në shkencë ekonomike, juridike ose ekzakte, **kriter që z. D e plotëson.**

Si konkluzion: Grupi auditimit shprehet se largimet e punonjësve të hetimit tatimor kryer në kushtet e paligjshmërisë ose trajtimit të pabarabartë në krahasim me punonjësit e tjerë, ka sjell rritjen e çështjeve gjyqësore dhe mundësinë e rritjes së efekteve negative financiare në dëm të buxhetit të shtetit në lidhje me pagesat për largim të padrejtë nga puna, pasi 7 prej tyre janë në proces gjyqësor.

Konstatohet gjithashtu se Urdhri Nr. 65/2 datë 14.05.2019 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren – Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, në gjykimin tonë jo vetëm që nuk janë përcaktuar kriteret të duhura në lidhje me pozicionet e punës për Drejtorinë e Hetimit, por konstatohet se këto kriteret krahasuar me kriteret para daljes së këtij Urdhri, lënë hapësirë më shumë për rekrutimin e punonjësve pa kualifikimin e duhur, duke qenë se përfshijnë arsimim nga fusha të ndryshme. Psh.

Pozicioni	Kriteret e mëparshme	Urdhri Nr.65/2
Inspektor Hetimi IV-a	Master profesional ekonomik/juridik dhe 1 vit eksperiencë	Master profesional ekonomik/juridik/ inxhinierik dhe 1 vit eksperiencë
Inspektor Zbatimi IV-b	Diplomë Bachelor Ekonomik/Juridik	Diplomë bachelor ekonomik/juridik/ ekzakte/shoqërore
Inspektor Zbatimi IV-a	Diplomë Bachelor Ekonomik/Juridik dhe 1 vit eksperiencë	Diplomë Bachelor Ekonomik/Juridik dhe 1 vit eksperiencë

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. E D – ish Drejtor i Përgjithshëm i DPT

Në lidhje me largimet nga puna me komision disiplinor

Konstatohet se nuk është respektuar për të gjitha rastet neni 37 i Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë pika 3, Neni 12 Masat Disiplinore të Kontratës Individuale të punës e cila citon se:

Llojet e masave disiplinore janë:

- Vërejtje me shkrim
- Vërejtje me paralajmërim, për largim nga detyra
- Largim nga detyra

Mbajtja e procesverbaleve nuk jep argumentime të plota për gjurmë dokumentimi në lidhje me shkallën e dhënies së masës më të lartë disiplinore. Konstatohet se një prej përgjegjësive që u ngarkohet punonjësve të larguar me komision disiplinor, është shkelja që lidhet me ngarkimet në sistem të bëra me vonesë nga ana e tyre. *Sipas procesverbaleve nga të gjithë punonjësit është shprehur se kjo është detyrë e përgjegjësve të grupit. Nuk konstatohet trajtim i mtejshëm për marrje në konsideratë të këtij elementi.* Jo në të gjitha procesverbalet e mbajtura janë plotësuar elementët e nevojshëm të një procesverbali siç janë nr., data, veçanërisht në procesverbalin ku kanë firmosur vet punonjësit (procesverbal me shkrim dore). Nuk ka një format tip standard për mbajtjen e procesverbalit. Procesverbali i zbardhur konstatohet se është mbajtur në të njëjtën shkresë, si për datën e trajtimit, ashtu dhe për datën e vendimmarrjes për propozim, dhe jo në dy shkresa të ndara, ashtu siç gjykojmë që duhet të jetë, në mënyrë që të ruhet transparenca dhe saktësia. Ky numër kaq i lartë të larguarish përbën risk potencial për rritjen e detyrimeve nga vendimet gjyqësore të DPT në të ardhmen, duke qenë se një pjesë e mirë e të larguarve kanë ankimuar vendimet e largimit në gjykatë si në vijim:

Status	Kod pune
--------	----------

DRT	A T – proces shkalla II P R – proces shkalla II M S – proces shkalla I	E Sh- proces shkalla II S S – proces shkalla II K K – proces shkalla II R C – proces shkalla II
------------	--	--

Rekrutimet

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2019 janë rekrutuar gjithsej 148 punonjës, prej të cilëve 110 në pozicione pune me status nëpunësi civil dhe 38 në pozicione me kod pune. Siç evidentohet edhe në tabelën e mëposhtme degët me numrin më të lartë të rekrutuarve janë: DPT me 50 të rekrutuar dhe DRT Fier me 25 të rekrutuar, DRT Shkodër me 13 të rekrutuar dhe DRT Tirana me 10 të rekrutuar.

Tabela: Rekrutime 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Degët	Rekrutime 2019	Nr.
DPT	Status nëpunësi	33
	Kod pune	17
	Total	50
DRT Tirana	Status nëpunësi	6
	Kod pune	4
	Total	10
DTM	Status nëpunësi	7
	Kod pune	1
	Total	8
DRT Fier	Status nëpunësi	15
	Kod pune	10
	Total	25
DRT Durrës	Status nëpunësi	7
	Kod pune	-
	Total	7
DRT Shkodër	Status nëpunësi	11
	Kod pune	2
	Total	13
DRT Elbasan	Status nëpunësi	8
	Kod pune	-
	Total	8
DRT Korçë	Status nëpunësi	6
	Kod pune	-
	Total	6
DRT Vlorë	Status nëpunësi	3
	Kod pune	1
	Total	4
DRT Lezhë	Status nëpunësi	1
	Kod pune	-
	Total	1
DRT Berat	Status nëpunësi	1
	Kod pune	-
	Total	1
DRT Gjirokastrë	Status nëpunësi	2
	Kod pune	1
	Total	3
DRT Sarandë	Status nëpunësi	1
	Kod pune	1
	Total	2
DRT Dibër	Status nëpunësi	4
	Kod pune	1
	Total	5
DRT Kukës	Status nëpunësi	5
	Kod pune	-
	Total	5
Totali		110+38=148

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT

Emërimet me status nëpunësi civil në DPT(*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.6)

Konstatohen 33 punonjës nga të cilët:

- ✓ 2 punonjës janë emërimet në nivel drejtuesi
- ✓ 25 punonjës janë emërimet punonjësish ekselentë me kontratë 1 vjeçare
- ✓ 6 punonjës janë me emërim nga DAP

Emërimet me status nëpunësi civil në DRT(*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.7)

Konstatohen 77 punonjës nga të cilat:

- ✓ 55 punonjës ekselentë me kontratë 1 vit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

✓ 22 punonjës nga DAP

Emërimet me kod pune në DPT (*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.8)

Konstatohen 17 punonjës nga të cilët:

- ✓ 1 punonjës shërbimi
- ✓ 3 punonjës në pozicionin Drejtor
- ✓ 7 këshilltar
- ✓ 2 shofer
- ✓ 1 punonjës shërbimi
- ✓ 2 arkivist
- ✓ 1 arkëtar
- ✓ 1 protokollist

Emërimet me kod pune në DRT (*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.9)

Konstatohen 21 punonjës nga të cilët:

- ✓ 3 Drejtor
- ✓ 1 inspektor hetimi
- ✓ 7 inspektor zyra e veprimeve në terren
- ✓ 4 protokollist
- ✓ 1 korrier
- ✓ 2 arkëtare
- ✓ 1 sekretare
- ✓ 1 punonjës pastrimi
- ✓ 1 shofer

Siç konstatohet përgjatë vitit 2019, janë punësuar 80 studentë ekselentë në kuadër të VKM nr.766 datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019”.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve me status nëpunësi civil si më poshtë konstatohet se rekrutimi i Edvin Ceribashi është në përputhje me kriteret e shpallura nga DAP, por këto kriteret të DAP nuk përputhen me përshkrimin e punës dhe kriteret e kërkuara nga struktura tatimore për pozicionin e punës.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicion i shpallur	Kritere të posaçme në shpallje (shkollim dhe vjetërsi)	Shkollim dhe vjetërsi në dosje
	DPT			
1	I K	Përgjegjës (Sektori i Analizës së Riskut) III-a/1	Master Shkencor në shkencë ekonomike ose juridike, 3 vjet përvojë pune	Master shkencor në Financë-Kontabilitet, me përvojë mbi 3 vite
2	E C	Përgjegjës (Sektori i Administratës) Drejtoria e Administratës dhe Prokurimeve	Diplome Master shkencor në shkencat ekonomike ose juridike, 3 vjet përvojë pune në nivel ekzekutiv	Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, me përvojë mbi 3 vite
3	O L	Përgjegjës Sektori i Përbushjes, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut	Diplome Master shkencor në shkencat ekonomike, 3 vite pune	Master shkencor Financë/Kontabilitet, përvojë pune 3 vite
4	M V	Specialist Qendra e Thirrjeve	Bachelor Shkencë ekonomike ose juridike	Bachelor në Financë
5	AM	Inspektor i Parë, Sektori i Analizës së Riskut, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut	Master Shkencor në shkencë ekonomike ose juridike, 1 vit përvojë	Master Shkencor në Financë, 1 vit përvojë
	DRT			
1	S S	Inspektor i Dytë, (Sektori i Kontrollit Tatimor)	Diplomë bachelor+master shkencor ose profesional në fushën ekonomike ose inxhinieri	Master shkencor Financë
2	V B	Inspektor i Dytë, (Sektori i Kontrollit Tatimor)	Diplomë bachelor+master shkencor ose profesional në fushën ekonomike ose inxhinieri	Master shkencor Financë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

3	Xh B	Inspektor i Dytë, (Sektori i Kontrollit Tatimor)	Diplomë bachelor+master shkencor ose profesional në fushën ekonomike ose inxhinieri	Master shkencor Financë
4	B Sh	Inspektor i Dytë, (Sektori i Kontrollit Tatimor)	Diplomë bachelor+master shkencor ose profesional në fushën ekonomike ose inxhinieri	Master shkencor Administrim Biznesi
5	A C	Inspektor i Dytë, (Sektori i Kontrollit Tatimor)	Diplomë bachelor+master shkencor ose profesional në fushën ekonomike ose inxhinieri	Master Shkencor Administrim Publik
6	J P	Inspektor i Dytë (Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara)	Diplomë bachelor në fushën ekonomike ose juridike	Master Shkencor në drejtë Civile. Punësimi në datë 13 mars 2019, diplomimi në datë 26.09.2019
7	H H	Specialist (Zyra e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve)	Diplomë bachelor në fushën ekonomike ose juridike	Master i Shkencave në drejtë Civile

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve me kod pune si më poshtë konstatohet se për 9 punonjës mungon një procedurë e rregullt rekrutimi në të cilën të shpallen vendet vakante, të publikohen kërkesat e përgjithshme dhe pastaj të përzgjidhet fituesi.

Këto pozicione janë plotësuar me punonjës të propozuar nga Drejtorët rajonal, sipas rasteve. Për efekt transparence gjykojmë që edhe për këto pozicione duhet njoftim dhe shpallje, në mënyrë që të gjithë të interesuarit të kenë shanse të njëjta për njohje dhe punësim në vendin vakant.

Për 4 të rekrutuar kualifikimet dhe vjetërsia në profesion përputhen me kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të shpallura për pozicionet vakante.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicion i shpallur	Kritere të posaçme në shpallje (shkollim dhe vjetërsi)	Shkollim dhe vjetërsi në dosje
DPT				
1	I D	Arkiviste - pa shpallje	-	-
2	A B	Llogaritar/Arkëtar - pa shpallje	-	-
3	M T	Protokollist - pa shpallje	-	-
4	G H	Arkivist - pa shpallje	-	-
DRT				
1	E M	Llogaritar/Arkëtar - pa shpallje - propozim DR Rajonal	-	-
2	M B	Llogaritar/Arkëtar - pa shpallje - propozim DR Rajonal	-	-
3	E Gj	Protokollist - Arkivist - pa shpallje (lirohet nga emerimi me kontrate te perkohshme)	-	-
4	K Q	Protokollist - Arkivist - pa shpallje (lirohet nga emerimi i mëparshëm punonjëse shërbimi)	-	-
5	A P	Protokollist - Arkivist - pa shpallje	-	-
6	E D	Inspektor Zyra e Veprimeve ne Terren dhe Masave Administrative IV-B	Minimalisht diplomë bachelor në shkencat ekonomike, juridike, ose ekzakte. Nuk kërkohet përvojë	Bachelor ne Ekonomi, Kolegji Univeristar Pavaresia Vlorë
7	A X	Inspektor Zyra e Veprimeve ne Terren dhe Masave Administrative IV-B	Minimalisht diplomë bachelor në shkencat ekonomike, juridike, ose ekzakte. Nuk kërkohet përvojë	Bachelor ekonomiks Universiteti Ismail Qemali Master Profesional Finance Kontabilitet
8	I Gj	Inspektor Hetimi IV-A	1 vit pervojë pune në profesion + min diplome master profesional ne shkenca ekonomike	Bachelor në ekonomiks + master profesional +përvojë pune
9	G B	Inspektor Zyra e Veprimeve ne Terren dhe Masave Administrative IV-B	Minimalisht diplomë bachelor në shkencat ekonomike, juridike, ose ekzakte. Nuk kërkohet përvojë	Bachelor Fakulteti i Ekonomise Menaxhim Biznesi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

Mbi transferimet e përkohshme

Gjatë vitit 2019 në DPT ka pasur 3 raste transferimesh të përkohshme, të pasqyruara në ankesin nr.10 dhe 9 raste transferimesh të përkohshme të pasqyruara me detaje në aneksin nr.11.

Nga auditimit konstatohet se është tejkaluar afati parashikuar për transferimin e përkohshëm të nëpunësve civil sipas tabelës së mësipërme, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 datë 01.10.2013 “Për nëpunësin civil”, neni 48 parashikon se “*Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve*”, si në vijim.

Transferime të përkohshme 2019					Ndryshimi në kategori	
Para	Nr.	Pas	Nr.	Afati	Para	Pas
DPT	3	DRT TPM	1	07.01.2019-28.07.2019	Kategoria III-a	Kategoria III-a
		DPT	1	07.01.2019-23.04.2019	Kategoria III-b	Kategoria III-b
		KM	1	19.04.2019-12.11.2019	Kategoria IV-a	Kategoria III-b
DRT Durrës	1	DRT Tiranë	1	07.01.2019-19.04.2019	Kategoria IV-a	Kategoria IV-a
SHSHAP	2	DPT	2	22.05.2019-30.09.2019	Kategoria III-b	Kategoria III-b
				16.06.2019-24.09.2019	Kategoria IV-a	Kategoria IV-a
DRT Berat	1	DRT Berat	1	14.02.2019-28.08.2019	Kategoria IV-a	Kategoria IV-a
DRT Tiranë	1	DRT TMP	1	23.08.2019-vijon	Kategoria III-b	Kategoria III-b
DRT Vlorë	2	DRT Vlorë	2	08.04.2019-23.10.2019	Kategoria III-b	Kategoria III-b
				27.05.2019-10.09.2019	Kategoria III-b	Kategoria III-b
DRT Korçë	1	DRT Korçë	1	22.09.2019-vijon	Kategoria IV-a	Kategoria IV-a
INSTAT	1	DPT	1	03.10.2019-vijon	Kategoria III-b	Kategoria III-b
Total	12		12			

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT. (*Informacion i detajuar gjendet në Aneksin nr.10)

Delegimet

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore konstatohet se numri i urdhërave për delegim kompetencash në fund të vitit 2019 ka qënë 46 urdhëra, nga të cilat 5 në Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe 41 në Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Institucioni	Numër
DPT	5
DRT Tirana	8
DTM	2
DRT Fier	-
DRT Durrës	5
DRT Shkodër	2
DRT Elbasan	6
DRT Korçë	1
DRT Vlorë	3
DRT Lezhë	1
DRT Berat	1
DRT Gjirokastrë	2
DRT Sarandë	3
DRT Dibër	2
DRT Kukës	5
Totali	46

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT.

Numri i delegimeve ka vazhduar të jetë i lartë edhe për vitin 2019.

Nga korrespondenca e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, konstatohet se nisur nga data e delegimet, 1 delegim i takon vitit 2016, 10 delegime vitit 2017, 21 delegime vitit 2018 dhe 14 delegime vitit 2019. Delegimi kompetencave është një instrument ligjor i parashikuar për t’u përdorur për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për tu përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndëruar në një mekanizëm të përhershëm. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin përcakton madje edhe detyrat specifike të pozicioneve të nëpunësve autorizues dhe zbatues që nuk mund të delegohen. Për sa kohë ka një ligj, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015, që ndalon delegimin e detyrave të caktuara të një pozicioni pune nuk mundet këto pozicione të mbahen nga nëpunës të deleguar në periudha afatgjata apo një vjeçare, duke cënuar kështu përmbushjen e misionit të punës së këtij pozicioni. Burimet njerëzore kanë mbajtur korrespondencë të rregullt me strukturat drejtuese, duke i informuar mbi punonjësit e deleguar si në DPT ashtu dhe në DRT, duke dhënë dhe sugjerime të herëpashershme mbi ndërprerjet e tyre dhe plotësimin e vendeve vakante me gjyqfitues, jo me delegime, megjithëse konstatohet se nga ana e strukturave drejtuese masat e marra për uljen e numrit të delegimeve kanë qenë të pamjaftueshme.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. XhC për periudhën 01.01.2019-04.04.2019, z.E D për periudhën 04.04.2019-18.07.2019, Znj.DI për periudhën 18.07.2019-31.12.2019, në lidhje me mosplotësimin e strukturës së miratuar dhe DAP për mos-shpalljen e vendeve vakante.

Vendet Vakante përgjatë vitit 2019

Në tabelën e mëposhtme është bërë një pasqyrim i përmbledhur dhe i qartë i pozicioneve të punës në administratën tatimore qendrore, të ndara sipas drejtorive rajonale dhe ligjit që i trajton pozicionet në muajt janar dhe dhjetor 2019.

Vakancat në janar dhe dhjetor 2019

Degët	Vende Vakante 2019	Janar 2019	Dhjetor 2019
DPT	Status nëpunësi	34	27
	Kod pune	1	18
	Total	35	45
DRT Tirana	Status nëpunësi	10	16
	Kod pune	3	5
	Total	13	21
DTM	Status nëpunësi	6	13
	Kod pune	-	-
	Total	6	13
DRT Fier	Status nëpunësi	18	11
	Kod pune	7	-
	Total	25	11
DRT Durrës	Status nëpunësi	12	11
	Kod pune	-	2
	Total	12	13
DRT Shkodër	Status nëpunësi	12	7
	Kod pune	20	11
	Total	32	18
DRT Elbasan	Status nëpunësi	17	10
	Kod pune	-	-
	Total	17	10
DRT Korçë	Status nëpunësi	8	5
	Kod pune	-	-
	Total	8	5
DRT Vlorë	Status nëpunësi	8	7
	Kod pune	-	2
	Total	8	9
DRT Lezhë	Status nëpunësi	7	6
	Kod pune	-	1
	Total	7	7
DRT Berat	Status nëpunësi	5	4
	Kod pune	-	-
	Total	5	4
DRT Gjirokastrë	Status nëpunësi	6	3
	Kod pune	-	-
	Total	6	3
DRT Sarandë	Status nëpunësi	4	5
	Kod pune	-	-
	Total	4	5
DRT Dibër	Status nëpunësi	6	5
	Kod pune	1	-
	Total	7	5
DRT Kukës	Status nëpunësi	17	11
	Kod pune	-	-
	Total	17	11



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Totali		170+32=202	141+39=180
---------------	--	-------------------	-------------------

Sipas një ndarje më të detajuar situata paraqitet si në vijim:

Nr	Drejtoria	Drejtor i Përgjithshëm		Zv/Drejtor i Përgjithshëm		Drejtore		Përgjegjes Sektor/Zyre		Inspektor i Pare		Inspektor i Dytë		Specialist		Punonjes Administrativ/Kod Pune	
		Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan
1	DPT	1	1	1	3	16	19	34	43	52	58	2	2	66	79	72	74
		100%		33%		84%		79%		89%		100%		83%		97%	
Nr.	Rrethet	Drejtor Rajonal		Drejtor Drejtore		Përgjegjes Sektor/Zyre		Inspektor i Pare		Inspektor i Dytë		Specialiste		Punonjes Administrative/Kod Pune			
		Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan		
1	Tiranë	1	1	4	6	18	20	61	62	101	105	45	49	122	124		
		100%		67%		90%		98%		96%		92%		98%			
2	Durrës	1	1	2	5	7	10	21	21	31	36	20	25	8	9		
		100%		40%		70%		100%		86%		80%		89%			
3	DTM	1	1	3	5	12	12	65	67	7	9	11	13	13	13		
		100%		60%		0%		97%		78%		85%		100%			
4	Shkodër	1	1	3	6	9	11	15	17	19	24	14	18	32	53		
		100%		50%		82%		88%		79%		77%		60%			
5	Elbasan	1	1	2	4	4	5	8	14	18	22	13	17	6	6		
		100%		50%		80%		57%		82%		76%		100%			
6	Vlorë	1	1	-	2	4	7	6	6	13	15	13	16	5	5		
		100%		0%		57%		100%		87%		81%		0%			
7	Gjirokastrë	-	1	1	1	4	6	4	4	8	10	10	11	4	5		
		0%		100%		67%		100%		80%		91%		80%			
8	Sarandë	1	1	-	1	4	6	4	4	8	9	10	10	5	5		
		100%		0%		67%		100%		89%		100%		100%			
9	Dibër	1	1	1	1	4	6	3	3	6	8	8	10	5	5		
		100%		100%		67%		100%		75%		80%		100%			
10	Fier	1	1	5	6	12	13	19	20	22	33	15	17	50	60		
		100%		83%		92%		95%		66%		88%		83%			
11	Kukës	1	1	-	1	1	6	3	3	1	8	7	10	5	5		
		100%		0%		17%		100%		13%		70%		100%			
12	Lezhë	-	1	1	2	4	7	4	4	10	12	12	13	5	5		
		0%		50%		57%		100%		83%		92%		100%			
13	Berat	1	1	1	1	4	6	5	5	11	13	9	10	5	6		
		100%		100%		67%		100%		85%		90%		83%			
14	Korçë	-	1	3	4	5	5	13	13	18	23	14	16	6	6		
		0%		75%		100%		100%		78%		87%		100%			

Vendet e lira të punës si dhe largimet e shumta në numër të punonjësve tregojnë mangësi në procesin e planifikimit të numrit të punonjësve dhe realizimin e strukturës së miratuar si dhe mangësi në procesin e rekrutimeve në punë të punonjësve, duke mos respektuar kriteret e miratuara dhe të shpallura për cdo pozicion pune. Kjo sjell cenim të performancës së institucionit në tërësi si dhe në përmbushjen e misionit për pozicionet e punës që rezultojnë të paplotësuara me staf.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me strukturat drejtuese në lidhje me vendet vakante dhe mënyrën e plotësimit të tyre, kriteret për cdo pozicion duke sygjerruar t'i jepet prioritet plotësimit me gjyqftues.

Gjithashtu, Drejtoria e Burimeve Njerëzore me e-mail të datës 24.12.2019 ka përcjellë në rrugë elektronike pranë MFE, kalendarin e planifikimit për vitin 2020 të vendeve vakante të ATQ, ku janë përcaktuar dhe afatet e nevojshme për shpallje.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Për 2019 problematikë konstatohet fakti që nga ana e Burimeve Njerëzore është bërë hedhja në sistem e vendeve vakante, por rezulton që nuk është bërë shpallja e tyre nga ana e DAP.

Për sa më sipër mban përgjegjësi: z. XhC për periudhën 01.01.2019-04.04.2019, z.E D për periudhën 04.04.2019-18.07.2019, Znj.DI për periudhën 18.07.2019-31.12.2019, në lidhje me mosplotësimin e strukturës së miratuar dhe DAP për mos-shpalljen e vendeve vakante.

Shpallja e vendeve vakante në DAP

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka mundësuar hedhjen në sistem të vendeve vakante për pozicion Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore: *Tiranë, Vlorë, Durrës, Korçë, Dibër, Gjirokastrë, Shkodër, Elbasan, Sarandë, Lezhë, Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH, Përgjegjës në Sektorin e Çështjeve Jo-Tatimore në Drejtorinë Ligjore dhe Teknike dhe Inspektor i Parë në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.*

Nga DAP është shpallur pozicioni:

1. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë- procedurë e cila është finalizuar me fitues;
2. Drejtor Drejtorie Rajonale Tatimore Vlorë- pa fitues;
3. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë – përfunduar me fitues;
4. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë – pa fitues;
5. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës – përfunduar me fitues;
6. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan – përfunduar me fitues;
7. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë– përfunduar me fitues;
8. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër – përfunduar me fitues;
9. Inspektor i Parë në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm – përfunduar me fitues;
10. Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH – përfunduar me fitues;

Pozicioni	Data si pozicion vakant	Nr/data e shpalljes	Kritere në hedhje në sistem	Kritere në shpallje DAP	Fitues
Drejtor I DRT Tiranë III-a	23.03.2016	Nr.2455 datë 04.11.2019	Master shkencor në shkenca ekonomike, juridike, politike. 3 vite eksperience pune në nivel të ulët drejtues	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	B Sh me lëvizje paralele
Drejtor I DRT Vlorë III-a	11.03.2019	Nr.2456 datë 04.11.2019	Master shkencor në shkenca ekonomike, juridike, politike. 3 vite eksperience pune në nivel të ulët drejtues	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	pa fitues
Drejtor I DRT Korçë III-a	01.12.2016	Nr.2457 datë 04.11.2019	Master shkencor në shkenca ekonomike, juridike, politike. 3 vite eksperience pune në nivel të ulët drejtues	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	Th T me ngritje në detyrë
Drejtor I DRT Durrës III-a	30.08.2019	Nr.2458 datë 04.11.2019	Master shkencor në shkenca ekonomike, juridike, politike. 3 vite eksperience pune në nivel të ulët drejtues	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	D B me ngritje në detyrë
Drejtor I DRT Elbasan III-a	13.08.2019	Nr.2465 datë 21.11.2019	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë pune 3 vite në nivel të ulët drejtues	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	I K me ngritje në detyrë
Drejtor I DRT Dibër III-a	13.05.2019	Nr.2466 datë 21.11.2019	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë punë	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale.	A C me ngritje në detyrë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

			3 vite në nivel të ulët drejtues	Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	
Drejtor I DRT Gjirokastër III-a	02.08.2016	Nr.2467 datë 21.11.2019	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë punë 3 vite në nivel të ulët drejtues	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	Pa fitues
Drejtor I DRT Lezhë III-a	05.10.2017	Nr.2474 datë 21.11.2019	Msc në shkenca edukimi, inxhinieri, juridike, natyrore, sociale. Përvojë pune 3 vite në nivel të ulët drejtues	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë 3 vite punë në nivel të ulët drejtues	pa fitues
DPT Inspektor I Parë audit I brendshëm III-b	03.05.2019	Nr.2511 datë 16.12.2019	Shkenca ekonomike, juridike. Përvojë pune në profesion 5 vite	Shkenca ekonomike, juridike. Përvojë pune në profesion	E S lëvizje paralele
DPT Drejtoria e Rimbursimit Drejtor III-a	03.05.2019	Nr.2539 datë 17.12.2019	Shkenca ekonomike. Përvoje pune 5 vite	Shkenca ekonomike. Përvoje pune 5 vite	E LI lëvizje paralele
Drejtor I DRT Shkodër III-a	08.07.2019	datë 21.12.2019	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë pune 3 vite në nivel të ulët drejtues	Nuk ka shpallje nga DAP	
Drejtor I DRT Sarandë III-a	06.09.2019	datë 21.12.2019	Të zotërojë diplomë në shkenca ekonomike, juridike, inxhinierike, natyrore, sociale. Përvojë pune 3 vite në nivel të ulët drejtues	Nuk ka shpallje nga DAP	
DPT përgjegjës sektori III-a/I Sektori I çështjeve jotatimore	02.08.2016	Nr.2121 datë 21.11.2019	Shkenca juridike. Përvoje pune 3 vite në nivel ekzekutiv.	Nuk ka shpallje nga DAP	

Me shkresën Nr.20275 prot datë 04.11.2019 i është dërguar Departamentit të Administratës Publike përshkrimi i punës për pozicionin Drejtor Rajonal, për Drejtorinë Rajonale Tatimore, nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas kriterëve të përshkruara në kolonën hedhje në sistem.

Me shkresën nr.6597/2 prot datë 08.11.2019, nga DAP është kthyer përgjigje në lidhje me arsimimin si kriter që sygjerojnë ta zgjerojnë me “master shkencor në shkenca ekonomike/juridike/sociale/natyrore/inxhinierike” etj. Me shkresën Nr.20275.3 prot datë 13.11.2019 i është kthyer përgjigje DAP, përshkrimi i ri i miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas përshkrimit të ri, pika arsimit citon: “Të zotërojë diplomë të nivelit Master i shkencave të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në shkenca ekonomike/juridike/politike. Për sa më sipër konstatohet se përshkrimi i punës i miratuar nuk ka ndryshuar.

Konstatohet se: Për hedhjet në sistem të datës 04.11.2019 nga Burimet Njerëzore të DPT, për pozicionet Drejtor Rajonal Tiranë, Vlorë, Korçë, Durrës, kriter është shkenca ekonomike/juridike/politike ndërkohë nga DAP master shkencor në shkenca ekonomike/juridike/sociale/natyrore/inxhinierike”. Në hedhjet në sistem të datës 21.11.2019 nga Burimet Njerëzore të DPT, për pozicionet Drejtor Rajonal Elbasan, Dibër, Gjirokastër, Lezhë, kriter është shkenca ekonomike/juridike/sociale/natyrore/inxhinierike” dhe po kështu edhe në shpallje në DAP, si reflektim i shkresës nga DAP, por përshkrimi i pa miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Kjo situatë ka sjell mospërputhje mes hedhjes në sistem nga Burimet Njerëzore të DPT dhe shpalljes nga DAP. Fakti që përshkrimi i punës i miratuar është i ndryshëm nga shpallja e vendit në DAP mund të sjell favorizim për përzgjedhje të kandidatëve fitues me kriter arsimit jashtë profilit të kërkuar, miratuar dhe të gjykuar si bazë për pozicionin e Drejtorit të Drejtorive Rajonale, nga ana e vet strukturave drejtuese tatimore.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi DAP

Gjetje	Mbi Ristrukturimin e DPT-s
Situata	<p>-Struktura e Administratës Tatimore Qëndrore e vitit 2019 ka funksionuar me Urdhrin nr.126 datë 02.08.2016 të Kryeministrit, dhe përmban në total 1569 pozicione pune të ndara në: 1159 pozicione të rregulluara nga ligji për statusin e nëpunësit civil; 410 pozicione të rregulluara nga Kodi i Punës së RSH nga të cilat 282 pozicione i përkasin strukturave të hetimit tatimor dhe 128 pozicione i përkasin funksioneve mbështetëse.</p> <p>Urdhëri Nr.126 datë 02.08.2016 ka funksionuar deri në 27.02.2019, ku me Urdhërin e Ri Nr.49 datë 27.02.2019 <i>“Për disa ndryshime në Urdhërin Nr.126 datë 02.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore qëndrore”</i>, është miratuar struktura e re organizative, ku nga 1569 punonjës total, numri i miratuar i punonjësve për gjithë strukturën tatimore kalon në 1512. Sipas këtij Urdhëri, punonjësit civil që kanë ushtruar detyrat në njësinë e menaxhimit TIK, shkëputen nga strukturat tatimore dhe kalojnë në strukturat e AKSH-it me kod pune. Komision i Ristrukturimit ka dal me vendim propozimi për transferimin e përhershëm të nënpunësve civil, për 41 punonjës, miratuar nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën Nr. 2099/1 Prot datë 15.04.2019.</p> <p>Në Drejtoritë Rajonale Tatimore konstatohen se disa prej punonjësve nuk kanë kaluar në AKSH edhe pse kanë qënë të strukturave të IT-s, por janë sistemuar në pozicione të tjera brenda strukturave të DRT-ve. Nga 28 punonjës të strukturave të IT-s në Drejtori Rajonale Tatimore, 21 prej tyre kanë kaluar në strukturat e AKSH-it dhe 7 prej tyre janë ripozicionuar në pozicione të tjera brenda Drejtorive, duke ruajtur statusin e nënpunësit civil. <i>Ky është tregues i trajtimeve të favorizuara të punonjësve që janë ripozicionuar brenda strukturave tatimore dhe atyre që kanë kaluar në strukturat e AKSH-it me kod pune.</i></p> <p>Me Urdhërin Nr.86 datë 03.05.2019 <i>“Për disa ndryshime në Urdhërin Nr.126 datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qëndrore” të ndryshuar</i>, struktura ka ndryshuar sërish por pa ndryshim në numrin total të punonjësve. Nga ana e Komisionit të Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse DAP janë transferuar në pozicione të tjera edhe punonjës Drejtoria e të cilëve nuk ka qënë subjekt i ndryshimeve strukturore të Urdhërit nr.86 datë 03.05.2019.</p> <p>Këto akte të miratuara nga Komisioni i Ristrukturimit dhe DAP, janë anuluar si akte të bërë jo në përputhje me dispozitat ligjore dhe Urdhërin 85 datë 03.05.2019, mesatarisht 3 muaj më vonë, nisur nga ankimimet e punonjësve, duke u rikthyer në pozicionet e tyre të mëprashme. Situata të</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtësinë e Përgjithshme të Tatimeve”

	<p>tilla shoqërohen me problematika në kryerjen e detyrave funksionale dhe mbarëvajtjen e Institucionit.</p> <p>Ristrukturimet janë bërë jo në përputhje me afatet e përcaktuara pikën 16, Kreu II, i Udhëzimit Nr.01. Datë 01.03.2016 i ndryshuar “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimi” dhe pikën 17 Kreu II, i VKM Nr. nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me pikën 10, Kreu II, të Udhëzimit Nr.01. Datë 01.03.2016 e cila citon “Komisioni merr vendim për transferimin e nëpunësve apo përfundimin e marrëdhënies së tyre në shërbimin civil, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit” dhe pikën 17 “Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi”.</p>
Kriteri	<p>VKM Nr. nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”</p> <p>Udhëzimi Nr.1 Datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit”</p>
Ndikimi/Efekti	Ristrukturimi është tejzgjatur dhe nuk është shoqëruar me praktikën mbi të cilën ka vepruar Komisioni i Ristrukturimit në lidhje me propozimet dhe vendimmarrjen e punonjësve të transferuar/larguar.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.4, datë 24.07.2019

Gjetja	Delegimet dhe plotësimi i strukturës
Situata	<p>Përgjatë vitit 2019, në Drejtësinë e Përgjithshme të Tatimeve ka rezultuar një numër i lartë vendesh vakante. Në fund të vitit janë konstatuar 180 vende vakante, nga të cilat 141 vende vakante janë pozicione të statusit të nëpunësit civil dhe 39 pozicione me kod pune. <u>Vendet vakante nuk janë plotësuar me emërim të reja dhe janë mbuluar me urdhëra delegimi.</u> Numri i urdhërave për delegim kompetencash në fund të vitit 2019 ka qënë 46 urdhëra, nga të cilat 5 në Drejtësinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe 41 në Drejtoritë Rajonale Tatimore. Nisur nga data e delegimet, 1 delegim i takon vitit 2016, 10 delegime vitit 2017, 21 delegime vitit 2018 dhe 14 delegime vitit 2019. <u>Delegimi kompetencave është një instrument ligjor i parashikuar për t’u përdorur për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për tu përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndëruar në një mekanizëm të përhershëm.</u> <i>Vendet e lira të punës si dhe largimet e shumta në numër të punonjësve tregojnë mangësi në procesin e planifikimit të numrit të punonjësve dhe realizimin e strukturës së miratuar si dhe mangësi në procesin e rekrutimeve në punë të punonjësve, duke mos respektuar kriteret e miratuara dhe të shpallura për cdo pozicion pune. Kjo sjell cenim të performancës së institucionit në tërësi si dhe në përmbushjen e misionit për pozicionet e punës që rezultojnë të paplotësuara me staf.</i></p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

	<p>Nga ana e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë hedhur vendet vakante në sistemin HRMIS, por nuk është bërë shpallja e tyre nga ana e DAP. Këto vakanca janë që prej vitit 2016. Konstatohet se për <u>pozicionet vakante Drejtor të Drejtorive Rajonale, nuk përputhen kriteret e pozicionit të hedhura në sistem nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore me kriteret e shpallura nga ana e DAP, duke lënë në këtë mënyrë hapësira për favorizim të kandidatëve pa kualifikimin e duhur për strukturat drejtuese Tatimore.</u></p> <p>Me shkresën Nr.20275 prot datë 04.11.2019 i është dërguar Departamentit të Administratës Publike përshkrimi i punës për pozicionin Drejtor Rajonal, për Drejtoritë Rajonale Tatimore, nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përcaktuar kriter arsimor, shkenca ekonomike / juridike / politike.</p> <p>Me shkresën nr.6597/2 prot datë 08.11.2019, nga DAP është kthyer përgjigje duke sygjëruar për zgjeruar ta kriterin arsimor me “master shkencor në shkenca ekonomike / juridike / sociale / natyrore / inxhinierike”.</p> <p>Me shkresën Nr.20275/3 prot datë 13.11.2019 i është kthyer përgjigje DAP-it, përshkrimi i ri i miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas përshkrimit të ri, pika arsimit citon: “<i>Të zotërojnë diplomë të nivelit Master i shkencave të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në shkenca ekonomike/juridike/politike, pa përfshirë shkencat sociale, natyrore, inxhinierike</i>”.</p> <p><u>Ndërkohë nga DAP shpalljet janë bërë me kriterin master shkencor në shkenca ekonomike/juridike/sociale/natyrore/inxhinierike</u>. Kjo situatë ka sjell mospërputhje mes hedhjes në sistem nga Burimet Njerëzore të DPT dhe shpalljes nga DAP. Fakti që përshkrimi i punës i miratuar është i ndryshëm nga shpallja e vendit në DAP mund të sjell <u>favorizim për përzgjedhje të kandidatëve fitues me kriter arsimi jashtë profilit të kërkuar, miratuar dhe të gjykuar si bazë për pozicionin e Drejtorit të Drejtorive Rajonale, nga ana e vet strukturave drejtuese tatimore.</u></p>
Kriteri	Përshkrimet dhe kriteret e punës të miratuara nga MFE
Ndikimi/Efekti	Kriteret e hedhura në sistemin HRMIS nuk përputhen me kriteret e shpallura nga ana e DAP, siuate e cila mund të sjell rekrutimin e punonjësve pa kualifikimin e kërkuar nga ana e strukturave tatimore. Vendet vakante dhe mbulimi i tyre me urdhëra delegimi ndikon në mbarëvajtjen e punës dhe mirëfunksionimin e Institucionit
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.4, datë 24.07.2019

E3. Largimet nga puna dhe ndjekja e proceseve gjyqësore për ndërprerjet e marrëdhënieve të punës. Mënyra dhe radha e ndjekur për pagesën e punonjësve gjyqfitues me vendim gjykate të formës së prerë

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Databaza e vendimeve gjyqësore për gjyqfituesit civilë
- Databaza e pagesave të gjyqfituesve
- Dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e Komisionit të Posacëm



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

-Korrespondenca të ndryshme të strukturave drejtuese dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, Drejtorisë Ligjore dhe Teknike.

-Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

-Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Udhëzimi nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”;

-Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Bazuar në Urdhërin nr.5151 datë 28.10.2015 “Cdo institucion i administratës shtetërore ka detyrimin të krijojë dhe përditësojë databazën e të dhënave gjyqësore. Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka krijuar dhe përditësuar këtë databazë vënë në dispozicion grupit të auditimit, e cila përbëhet nga 142 ish nëpunës me status të nëpunësit civil. Gjithashtu në dispozicion të grupit të auditimit është vënë databaza e punonjësve të larguar nga puna e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e plotë, e përbërë nga ish nëpunës me status si dhe nga ish nëpunës të trajtuar me kod pune. Kjo databazë ka 238 rekorde në total. Nga auditimi konstatohet se administrata tatimore qendrore ka gjithësej 238 ish punonjës të larguar nga puna të cilët kanë fituar proceset gjyqësore për largime jo të rregullta nga puna dhe në shkelje të dispozitave ligjore, për të cilët DPT ka paguar shpenzimet gjyqësore për një pjesë dhe për pjesën tjetër ka krijuar detyrime të prapambetura në vlerat e pasqyruara në tabelën në vijim. Prej tyre 187 janë ish nëpunës me status të nëpunësit civil të cilët marrin rrogë deri në rikthimin në pozicionin e mëparshëm apo ekuivalent të punës dhe 51 janë punonjës të larguar marrëdhënia e punësimit të të cilëve ka qënë e rregulluar me kod pune.

Databaza e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për ish nëpunësit civilë, prej 142 rekordesh është e ndryshme nga ajo e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës për arsye se në të nuk gjenden nëpunësit civil që janë rikthyer në punë gjatë viteve të mëparshme dhe që vazhdojnë të jenë në databazën e DBF, pasi marrin rrogat e prapambetura.

Siç evidentohet edhe në tabelën më poshtë detyrimet e prapambetura për shpenzimet gjyqësore për ish punonjës të larguar nga puna janë:

Analiza e llogarisë “Shpenzime gjyqësore për ish punonjës”

	Numri	Detyrimi i prapambetur 01.01.2019	Detyrime të lindura gjatë 2019	Paguar 2019	Detyrimi i prapambetur 31.12.2019
Ish nëpunës me status	187	263,686,961	240,996,143	120,644,215	384,018,796
Ish punonjës me kod pune	51	18,308,352	20,606,787	18,953,818	19,961,320
Sisteme	2	473,368	492,317	503,273	462,411
Totali	240	282,468,680	262,095,247	140,101,306	404,462,621

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPT. Përpunuar nga grupi i auditimit

Gjatë vitit 2019 janë paguar nga DPT shpenzime gjyqësore për ish punonjës gjithësej në vlerën 140,101,306 lekë, prej të cilave 120,644,215 lekë kanë shkuar për ish nëpunës me status dhe 18,953,818 lekë për ish nëpunës me kod pune, vlerë e cilësuar si dëm në buxhetin e shtetit. Duke marrë në konsideratë faktin që për të njëjtin vend pune paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i ri i rekrutuar, kjo situatë paraqitet edhe më problematike dhe me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit.

Detyrimi i prapambetur për këto shpenzime në 31.12.2019 ka qënë 404,462,621 lekë, ku 384,018,796 lekë janë ndaj ish nëpunësve me status dhe 19,961,320 lekë ndaj ish nëpunësve me kod pune. Në datën 31.12.2019 ky detyrim i prapambetur u takon 196 punonjësve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

Gjithashtu grupit të auditimit i është vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike databaza e punonjësve të larguar nga puna, të cilët janë ende në proces gjyqësor. Konstatohet se kjo databazë përbëhet nga 187 procese gjyqësore, prej të cilëve 84 janë ish punonjës me status të nëpunësit civil dhe 103 janë ish punonjës me kod pune.

Gjyqet në proces dhe statusi i tyre:

	Numri Çështjeve	Statusi i Procesit Ligjor (sa)
Ish nëpunës me status	5(shkalla I ne proces) + 47 (shkalla II ne proces) + 32 (forme e prere) = TOTAL 84	Çështje në proces Gj.Sh.I
		<div>Çështje në proces Apel 79 (47 ne proces + 32 forme e prere)</div> <div> pranuar nga Gj.Sh.I 61 (26 marre forme te prere + 35 ne proces ne shkalle te II) rrëzuar nga Gj.Sh.I 17 (6 marre forme te prere + 11 ne proces ne shkalle te II) </div>
Ish punonjës me kod pune	30 (shkalla I ne proces prej te cilave 4 jane te pezulluara) + 51 (shkalla II ne proces) + 22 (forme e prere) = TOTAL 103	Çështje në proces Gj.Sh.I 30 (4 pezulluar)
		Çështje të pezulluara nga Gj.Sh.I 4
		<div>Çështje në proces Apel 73 (51 ne proces + 22 forme e prere)</div> <div> pranuar nga Gj.Sh.I 4 (ne proces ne shkalle te II) pranuar pjesërisht Gj.Sh.I 59 (21 marre forme te prere + 38 ne proces ne shkalle te II) rrëzuar nga Gj.Sh.I 10 (1 marre forme te prere + 9 ne proces ne shkalle te II) </div>
Totali	187	

Burimi: Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT

Siç evidentohet edhe në tabelë nga 84 procese gjyqësore të ish nëpunësve civil vetëm 5 procese janë në shkallën e parë të gjykimit dhe 79 prej tyre janë çështje të apeluara në gjykatën e apelit. Nga këto 79 procese gjyqësore në gjykatën e apelit rezulton që 61 prej tyre janë pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe vetëm 17 prej tyre janë rrëzuar.

Në lidhje me ish punonjësit me kod pune rezulton se janë në proces aktualisht 103 çështje gjyqësore, ku 30 prej tyre janë në proces në gjykatën e shkallës së parë, nga të cilat 4 janë pezulluar dhe 73 prej tyre janë në proces në gjykatën e apelit. Nga këto 73 çështje në process të apeluara, faktuar nga ankimet përkatëse vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, rezulton se 4 janë pranuar, 59 prej tyre janë pranuar pjesërisht nga gjykata dhe 10 prej tyre janë rrëzuar.

Sic konstatohet nga tabela e mësipërme për vitin 2019 janë 53 vendime të formës së prerë, nga të cilat 7 janë rrëzuar, sipas informacionit të dorëzuar nga Drejtoria Ligjore Teknike. Në total i bie që sipas Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, janë për tu shtuar në databazën e vendimeve gjyqësore të Financës 46 punonjës. Në databazën e Financës, për vitin 2019 janë shtuar 51 punonjës. Por konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Financës ky ndryshim/shtim i gjyqfituesve në databazë ka ardhur si rezultat i vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, që nga ana e Drejtorisë Ligjore paraqiten në proces në shkallë të parë ose të dytë.

Nga databaza e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike konstatohet se janë raportuar si vendime me formë të prerë për vitin 2019, 1 vendim i vitit 2017 dhe 2 vendime të vitit 2020. Gjithashtu ka vendime që janë të vitit 2019 por janë përcjellë nga Drejtoria Ligjore me shkresë në vitin 2020, për këtë arsye mungojnë në databazën e vitit 2019 si psh rasti i gjyqfituese A Z me vendim të formës së prerë në datën 26.09.2019, A C datë 19.11.2019, D L datë 15.07.2019. Gjithashtu konstatohet se vendimi i formës së prerë i gjyqfituesit G U, pjesë e shërbimit civil, nuk rezulton as në databazën e Financës dhe as në të Burimeve Njerëzore. Ky vendim ka marr formë të prerë në datën 26.09.2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Grupi i auditimit shprehet me rezerva për saktësinë e raportimeve në lidhje me gjyqfituesit dhe me korrespondencën apo rakordimet e brendshme midis Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, Burimeve Njerëzore dhe Financës. Mungesa e përfshirjes së vendimeve të vitit 2019 në databazë ndikon jo vetëm në mosplanifikimin e saktë të buxhetit për zërin e shpenzimeve gjyqësore të gjyqfituesve por në moskontabilizimin e detyrimeve të plota për vitin buxhetor dhe mosmarrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin e tyre, në mënyrë që të mos vazhdojë të rëndohet buxheti i shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: Znj. I K, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike.

Pagesat e vendimeve gjyqësore për vitin 2019

Përgjatë 2019 janë paguar 86 punonjës si në vijim.

Depozitim i praktikës	Paga Bruto punonjësi	Paguar neto punonjësi	Paguar Përmbarues i privat	Shpenzime gjyqësore	15% tatim ne burim	Total
01.09.2014	1,062,000	902,700			159,300	1,062,000
06.02.2015	5,564,160	4,729,536	111,283		834,624	5,675,443
14.03.2017	1,080,000	918,000	48,521		162,000	1,128,521
23.03.2017	1,063,200	903,720	56,137		159,480	1,119,337
15.06.2017	1,080,000	918,000			162,000	1,080,000
03.07.2017	84,920	84,920				84,920
18.08.2017	1,804,095	1,533,481	173,193		270,614	1,977,288
18.08.2017	963,503	818,978			144,525	963,503
22.08.2017	945,600	803,760	48,914		141,840	994,514
13.09.2017	1,029,600	875,160	46,894		154,440	1,076,494
13.09.2017	1,080,000	918,000			162,000	1,080,000
13.09.2017	1,161,818	987,545			174,273	1,161,818
18.09.2017	1,540,540	1,309,459	131,009		231,081	1,671,549
21.09.2017	860,400	731,340	82,398		129,060	942,798
29.09.2017	1,016,160	863,736	97,551		152,424	1,113,711
06.11.2017	928,800	789,480	46,947		139,320	975,747
15.11.2017	775,500	659,175	50,252		116,325	825,752
24.11.2017	881,760	749,496			132,264	881,760
01.12.2017	1,157,360	983,756			173,604	1,157,360
13.12.2017	1,043,040	886,584	100,131		156,456	1,143,171
22.12.2017	1,062,000	902,700	101,952		159,300	1,163,952
27.12.2017	945,600	803,760			141,840	945,600
04.01.2018	2,768,745	2,353,433	269,000		415,312	3,037,745
08.01.2018	236,400	200,940		43,000	35,460	279,400
16.01.2018	2,453,022	2,085,069	99,000		367,953	2,552,022
16.01.2018	3,013,695	2,561,641	289,323		452,054	3,303,018
22.01.2018	183,161	155,687		43,000	27,474	226,161
26.01.2018	385,650	385,650	36,000			421,650
31.01.2018	1,131,840	1,131,840		3,200		1,135,040
09.02.2018	1,440,000	1,224,000	138,240		216,000	1,578,240
28.02.2018	497,118	497,118	60,038	3,200		560,356
06.03.2018	1,675,916	1,424,529	204,810		251,387	1,880,726
03.04.2018	4,160,305	3,536,259	402,590		624,046	4,562,895
04.04.2018	1,553,00	1,553,100	186,372	43,000		1,782,472
13.04.2018	344,520	344,520	36,000	2,335		382,855
20.04.2018	749,100	749,100	93,392			842,492
20.04.2018	2,611,909	2,220,123	253,943		391,786	2,865,852
20.04.2018	3,388,582	2,880,294	328,804		508,288	3,717,386
20.04.2018	927,600	788,460	55,656		139,140	983,256
23.04.2018	2,192,073	1,863,262	210,439		328,811	2,402,512
23.04.2018	425,160	425,160	36,000	3,200		464,360
30.04.2018	2,150,455	1,827,887	209,684		322,568	2,360,139
30.04.2018	152,000	152,000		3,200		155,200
10.05.2018	90,930	90,930	18,000	3,200		112,130
22.05.2018	3,777,949	3,211,257	365,883		566,692	4,143,832
22.05.2018	2,861,873	2,432,592	274,740	54,700	429,281	3,191,313
22.05.2018	785,620	667,777			117,843	785,620
22.05.2018	787,891	669,707		43,500	118,184	831,391
22.05.2018	6,831,330	5,806,630	576,832		1,024,700	7,408,162
23.05.2018	1,324,800	1,126,080			198,720	1,324,800



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

28.05.2018	352,080	352,080	36,000	3,000		391,080
28.05.2018	51,480	51,480	8,400	685		60,565
05.06.2018	1,860,272	1,581,231	226,473		279,041	2,086,745
05.06.2018	439,822	439,822	36,000			475,822
04.06.2018	2,806,364	2,385,409	269,411	43,000	420,955	3,118,775
08.06.2018	3,109,540	2,643,109		3,000	466,431	3,112,540
20.06.2018	2,233,923	1,898,835	217,457		335,088	2,451,380
25.06.2018	2,593,520	2,204,492	252,178		389,028	2,845,698
28.06.2018	2,551,760	2,168,996	244,969		382,764	2,796,729
09.07.2018	2,531,571	2,151,835	246,981		379,736	2,778,552
10.07.2018	445,573	445,773	36,000	3,000		484,773
19.07.2018	132,848	132,848	26,400	3,200		162,448
23.07.2018	3,121,800	2,653,530	302,893		468,270	3,424,693
03.08.2018	1,380,000	1,380,000	165,600	3,000		1,548,600
08.08.2018	2,691,764	2,287,999	258,409	4,000	403,765	2,954,173
09.08.2018	3,141,255	2,670,067	301,560	60,000	471,188	3,502,815
09.08.2018	395,000	395,000	36,000	48,000		479,000
09.08.2018	4,157,288	3,533,695	399,100	3,000	623,593	4,559,388
10.08.2018	336,003	336,003	36,000	3,200		375,203
04.09.2018	989,100	989,100	118,692	3,200		1,110,992
07.09.2018	1,883,237	1,600,752	225,988	48,000	282,485	2,157,225
14.09.2018	310,720	310,720	36,000	1,500		348,220
18.09.2018	2,372,918	2,016,980	227,800	53,000	355,938	,653,718
01.10.2018	190,795	190,795	26,400	3,000		220,195
01.10.2018	433,400	433,400	36,000			469,400
01.10.2018	1,401,840	1,401,840	168,221	3,200		1,573,261
05.10.2018	735,215	735,215	88,226			823,441
29.10.2018	473,367	402,362			71,005	473,367
19.11.2018	384,325	384,325	36,000			420,325
18.12.2018	2,488,800	2,115,480		3,300	373,320	2,492,100
18.12.2018	3,375,000	2,868,750			506,250	3,375,000
19.12.2018	1,431,675	1,431,675	171,801	51,200		1,654,676
31.12.2018	2,307,273	1,961,182	221,498		346,091	2,528,771
06.02.2019	139,140	139,140	26,400			165,540
11.02.2019	380,926	380,926	36,000	63,000		479,926
26.03.2019	29,906	29,906				29,906
	128,137,200	112,543,083	9,758,785	652,020	17,147,417	140,101,305

Perpunuar: Grupi auditimit, Burimi DPT

Grupi auditimit konstaton se gjatë vitit 2019 janë paguar në total për vendime gjyqësore në largime të padrejta nga puna 140,101,305 lekë nga të cilat:

112,543,083 lekë janë pagesa neto për gjyqfituesit

652,020 lekë janë pagesa për shpenzime gjyqësore

9,758,785 janë pagesa për përmbaruesit privat

17,147,417 janë pagesa tatimi në burim

Në lidhje me tatimin në burim për gjyqfituesit me status nënpunësi civil konstatohet se është paguar sipas urdhër shpenzimeve:

nr.63 datë 14.02.2019 në vlerën 4,026,357 lekë

nr.175 datë 18.03.2019 në vlerën 162,000 lekë

urdhër shpenzimit nr.794 datë 15.10.2019 në vlerën 12,760,339

Pra në total janë paguar 16,948,696 lekë, referuar nenit 9, “Tarifat tatimore”, pika 2, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar” dhe pikës 8, Kapitullit 2.4 “Të ardhurat e përjashtuara” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Konstatohet se është bërë një pagesë detyrimi për gjyqfituesin z. A D në vlerën 1,324,800 lekë (punonjësi i shërbimit civil) në maj 2019, por nuk rezulton pagesë për tatimin në burim. Megjithatë në bilancin e vitit 2019 është pasqyruar si detyrim i pambyllur në vlerën 198,721, e cila mbledhur me tatimin e paguar për 2019 korrespondon me tabelën e mësipërme.

Problematikë mbetet fakti që shumica e pagesave janë kryer me përmbarues privat duke e rënduar edhe më tej buxhetin e shtetit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Si konkluzion: Largimet e padrejta nga puna dhe mosekzekutimi në kohë dhe në mënyrë vullnetare i vendimeve të formës së prerë e ka rënduar buxhetin e shtetit për vitin 2019 në vlerën 140,101,305 lekë. Ndërkohë vlera prej 404,442,528 është detyrim i prapambetur.

Radha e likuidimit të shpenzimeve gjyqësore - FIFO

Mënyra e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme është e përcaktuar në Udhëzimin nr.1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Ky udhëzim në pikën 4 përcakton se “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjate vitit buxhetor, mbajnë databazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varet” dhe në pikën 5 përcakton se “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbartuesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar.”

Nga auditimi është konstatuar se në kundërshtim me udhëzimin nr.1 datë 04.06.2014 grafiku i shlyerjes, në bazë të rradhës së paraqitjes së vendimeve gjyqësore nuk është publikuar në faqen online të DPT apo në forma të tjera për ti bërë të ditur publikut, në zbatim të detyrimit ligjor të njësisë.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financës i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit databazën e vendimeve gjyqësore dhe përlllogaritjen e detyrimit për çdo gjyqfitues.

Megjithatë nga auditimi dhe testimet e bëra në databazën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës është konstatuar se radha e shlyerjes së detyrimeve ndaj ish punonjësve sipas parimit “First In First Out” të përcaktuar në udhëzimin nr.1 datë 04.06.2014 është thyer në shumë raste të pasqyruara në mënyrë analitike.

Konstatohet se datat e depozitimit të kërkesës fillojnë që nga viti 2009 dhe janë si në vijim:

Viti i depozitimit të Kërkesës	Raste total	Raste të paguara gjatë vitit 2019
2009	3	-
2010	2	-
2011	2	-
2012	4	-
2013	7	-
2014	10	1
2015	10	1
2016	17	-
2017	69	20
2018	63	62
2019	51	3

Për sa më sipër për thyerjen e radhës ngarkohet me përgjegjësi: Znj.D C në cilësinë e Drejtorit të Financës në DPT, z.Xh C për periudhën 01.01.2019-04.04.2019, z.E D për periudhën 04.04.2019-18.07.2019, Znj.D I për periudhën 18.07.2019-31.12.2019

Gjetja	Mbi shpenzimet gjyqësore dhe radha e pagesave (FIFO)
Situata	Gjatë vitit 2019 janë paguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve shpenzime gjyqësore për ish punonjës, në vlerën 140,101 mijë lekë, vlerë e cilësuar si dëm për buxhetin e shtetit. Nga kjo vlerë: 120,644 mijë lekë për ish nëpunës me status, 18,954 mijë lekë për ish nëpunës me kod



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

pune dhe 503 mijë pagesa sistemime veprimesh. Duke marr në konsideratë faktin që për të njëjtin vend pune paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i ri i rekrutuar, kjo situatë paraqitet edhe më problematike dhe me efekte të konsiderueshme në buxhet. **Detyrimi i prapambetur në 31.12.2019 për shpenzime të gjyqfitueseve me vendim të formës së prerë për largime të padrejta nga puna është 404,442 mijë lekë nga të cilat: 384,019 mijë lekë janë ndaj ish nëpunësve me status, 19,961 mijë lekë ndaj ish nëpunësve me kod pune dhe 462 mijë lekë sistemime veprimesh. Në datën 31.12.2019 ky detyrim i prapambetur u takon 196 punonjësve.**

Shumica e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore janë kryer me përmbarues privat, në vlerën prej 9,758,785 lekë, duke e kaluar afatin për likuidimin vullnetar, dhe pa respektuar parimin “First in First out”, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit”. Ky udhëzim në pikën 4 përcakton se “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë databazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës”.

Gjithashtu në pikën 5 përcaktohet se “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar.”

Evidentohen thyerje në radhën e likuidimeve të gjyqfituesve duke qënë se janë evidentuar:

- Gjyqfitues me datë depozitimi vendimi të hershme që nuk kanë marrë asnjë pagesë në 2019, kur në databazë ka gjyqfitues me datë depozitimi të mëvonshme që kanë marrë të gjithë detyrimin e përlllogaritur për 2019.

- Gjyqfitues me datë depozitimi vendimi të hershme që kanë marrë vetëm një pjesë të detyrimit të përlllogaritur në 2019, në mënyrë të paqartë se mbi ç’kriter është përcaktuar masa e likuiduar, dhe në një kohë kur databaza vijon me gjyqfitues me datë të mëvonshme që u është likuiduar detyrimi total i përlllogaritur i 2019.

- Gjyqfitues me datë më të vonë depozitimi, që gjenden në radhë mes të palikuiduarve dhe që u është likuiduar në total detyrimi i përlllogaritur deri në 2019.

Në lidhje me raportimet e bëra nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike shprehemi me rezerva për saktësinë në lidhje me gjyqfituesit e vitit 2019 dhe me korrespondencën apo rakordimet e brendshme midis Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, Burimeve Njerëzore dhe Financës. Nga auditimi u konstatua se nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike janë raportuar si vendime me formë të prerë të vitit 2019, 1 vendim i vitit 2017 dhe 2 vendime të vitit 2020, ndërkohë 3 vendime të vitit 2019 janë përcjellë nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

	Drejtoria Ligjore dhe Teknike me shkresë në vitin 2020, për këtë arsye mungojnë në databazën e vitit 2019. Konstatohet gjithashtu se 1 vendim i formës së prerë i datës 26.09.2019, për një gjyqfitues pjesë e shërbimit civil, nuk rezulton në databazën e Financës dhe të Burimeve Njerëzore deri në momentin e auditimit, për arsye të mospërcjelljes së informacionit nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike. <i>Mungesa e raportimit në Drejtorinë e Financës dhe të Burimeve Njerëzore në momentin e daljes së vendimit të formës së prerë, ndikon jo vetëm në mosplanifikimin e saktë të buxhetit për zërin e shpenzimeve gjyqësore të gjyqfituesve por në moskontabilizimin e detyrimeve të plota për vitin buxhetor dhe mosmarrjen e masave të menjëhershme nga ana e Komisionit të posacëm për ekzekutimin e tyre, duke sjell rritjen e detyrimeve të prapambetura dhe rëndimin e buxhetit të shtetit.</i>
Kriteri	Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”; Kushtetuta e RSH, neni 18.
Ndikimi/Efekti	Cënim i të drejtës themelore të ish punonjësve për të qënë të barabartë përpara ligjit.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.5, datë 24.07.2019

Në lidhje me konstatimet dhe reflektimet e grupit auditues në Projekt Raport është dërguar osbervacion prot në KLSH me nr.333/5 datë 03.09.2020, nga znj.D C, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës si në vijim:

“Në lidhje me respektimin e rradhës dhe në vijim të observacionit të dërguar mbi akt-konstatimin për këtë problematikë – qasja e auditueses përsëri nuk ka nxjerrë se cilët janë këta gjyqfitues? Audituesja përsëri e paqartë mbi ndarjen dhe ngarkesën e përgjegjësive ka përjashtuar në mënyrë tërësisht të dukshme Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, e cila është burimi kryesor i emërimeve, vendeve vakante etj. Unë nuk kam parashtruar vetëm funksionin tim si NZ, ju kam parashtruar se si Drejtori Buxheti dhe Finance kemi dërguar informacion Drejtorit të Përgjithshëm. Si NZ kam dërguar informacion Drejtorit të Përgjithshëm. Si anëtare komisioni ju kam bërë me dije bazën ligjore dhe si funksionon një organ kolegjal. Si Drejtori Buxheti dhe Finance ju kam bërë me dije procedurën që ndiqet për të bërë likuidimin, si mundem unë të thyej rradhën kur kemi bazë ligjore? Si ka mundësi që për këtë thyerje rradhe me përjashtim të auditueses nuk kemi asnjë individë etj të paraqesë këtë ankesë në një listë me 200 vendime gjyqi cdo vit? Në cilin rast e keni konstatuar thyerjen e radhës, keni kërkuar arsyetim, apo informacion dhe nuk iu është përcjellë? Në cilin moment gjatë gjithë auditimit keni kërkuar informacion dhe iu është neglizhuar, nuk iu është dhënë? Ka qënë i paramenduar ky konkluzion? Keni pasur burime të tjera informacioni? Në vijim të parashtrimit dhe vazhdimësisë së observacionit të bërë mbi aktet e konstatimit, NZ herë del si funksion vetëm zbatues, herë del në funksion mbrojtës dhe kundërshtues, se cila duhet të jetë qasja e NZ mbetet e dyzuar pasi nëse vetëm zbaton është me përgjegjësi, por edhe kur mbron për të mos zbatuar një veprim që gjykon jo të drejtë është përsëri me përgjegjësi. Shpresoj përsëri që auditueset përkatëse të kenë ndjekur parimet themelore mbi të cilat duhet të ushtrojnë detyrat funksionale, edhe pse në projekt raport rezultojnë informacione të marra nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të pasakta dhe konkluzione jashtë afatit për të cilat janë caktuar, burimi i këtyre informacioneve lë hapsirë për qëndrime subjektive”.

Qëndrimi i audituesit: Së pari, me emailin e dates 17.06.2020 është dërguar nga Drejtoria juaj “Databaza e vendimeve gjyqësore”, (bashkëlidhur). Sipas kësaj databaze, është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

informacioni për cdo gjyqfitues, duke filluar që nga data e paraqitjes së kërkesës për ekzekutim, vlera e njohur e detyrimit, pagesat e kryera gjatë vitit 2019 dhe detyrimi i mbetur i kontabilizuar në datën 31.12.2019. Kjo databazë me 238 rekorde, e përgatitur nga vet Drejtoria juaj, e ka të gjithë informacionin mbi të cilin është audituar, konfirmuar njëkohësisht me Urdhër shpenzimet e kaluara në thesar, në lidhje me likuidimet e kryera gjatë vitit për ish-gjyqfituesit. Për sa më sipër, konkluzionet e nxjerra nuk janë në mungesë të dokumentacionit përkatës.

Së dyti, funksioni i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk ka asnjë lidhje me pagesat e kryera nga Drejtoria e Financës në lidhje me likuidimet e gjyqfituesve, si rrjedhojë, as me thyerjen e radhës. Problematikat e konstatuara për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore janë në aktin përkatës lënë pikërisht për këtë Drejtori.

Së treti, risqarojmë se: Në akt konstatim nuk jeni lënë me përgjegjësi si anëtar i Komisionit të Posacëm, as ju dhe asnjë anëtar tjetër, me përjashtim të Kryetarit të KP, i cili ka dhe funksionin e Titullarit të DPT. Pavarësisht se ju keni observuar për këtë pjesë edhe në observacionin e parë mbi akt-konstatim, nga ana jonë u sqarua kjo gjë në Projekt-Raport.

Së katërti, në projekt raport observacioni juaj në lidhje me thyerjen e radhës është marr pjesërisht në konsideratë. Sqarojmë se për aq kohë sa urdhër shpenzimet e likuidimit të ish-gjyqfituesve janë me firmën tuaj dhe të Titullarit, përgjegjësia është e të dyve. Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 3/a citon: “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga njësia shpenzuese përgjegjëse: a. me fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës për njësinë shpenzuese për shlyerjen e detyrimeve të vitit paraardhës, duke respektuar rradhën e paraqitjes në njësinë shpenzuese;”

Sipas databazës së vendimeve gjyqësore, për vitin 2019 janë bërë 89 nga 238 pagesa si në vijim:

Nr.rendor	Data e depozitimit se praktikes	Detyrim prapambetur 01.01.2019	Detyrime lindura pergjate 2019	Paguar 2019	Detyrim prapambetur 31.12.2019
1	11.05.2009	547,989	547,981		1,095,970
2	13.05.2009	6,483,814	862,196		7,346,010
3	21.05.2009	760,693	760,693		1,521,386
4	04.03.2010	488,818	488,819		977,637
5	13.07.2010	500,888	500,888		1,001,777
6	29.06.2011	879,861	879,861		1,759,722
7	08.08.2011	-	-		-
8	24.01.2012	885,865	885,865		1,771,731
9	03.07.2012	-	-		-
10	19.11.2012	842,505	822,545		1,665,049
11	26.12.2012	984,000	984,000		1,968,000
12	01.02.2013	984,000	719,215		1,703,215
13	09.04.2013	804,412	804,413		1,608,825
14	31.05.2013	268,093	-		268,093
15	10.07.2013	836,190	816,831		1,653,020
16	31.07.2013	730,223	714,333		1,444,556
17	11.11.2013	1,335,604	1,332,553		2,648,067
18	22.11.2013	479,081	576,015		1,055,096
19	11.02.2014	666,396	-		666,396
20	12.02.2014	822,000	822,000		1,644,000
21	03.03.2014	873,740	859,181		1,732,921
22	24.04.2014	600,000	540,909		1,140,909
23	09.06.2014	479,879	-		479,879
24	02.07.2014	510,420	510,420		1,020,840
25	29.07.2014	-	-		-
26	15.08.2014	898,178	939,316		1,837,493
27	01.09.2014	1,062,000	1,062,000	1,062,000	1,062,000
28	02.12.2014	454,008	454,008		908,016
29	12.01.2015	4,435,151	555,679		4,990,830
30	06.02.2015	5,675,443	-	5,675,443	
31	27.02.2015	1,076,304	1,062,358		2,138,662



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

32	27.02.2015	768,960	768,960		1,537,920
33	09.07.2015	1,118,343	1,104,479		2,222,822
34	05.10.2015	1,198,676	1,198,676		2,397,352
35	09.10.2015	1,075,797	1,062,701		2,138,498
36	10.11.2015	942,031	949,541		1,891,572
37	23.12.2015	959,568	967,228		1,926,796
38	29.12.2015	1,049,734	577,057		1,626,791
39	08.03.2016	1,032,000	1,032,000		2,064,000
40	05.04.2016	1,128,865	1,137,024		2,265,889
41	05.04.2016	933,978	922,593		1,856,571
42	06.04.2016	966,900	974,303		1,941,203
43	11.04.2016	265,172	-		265,172
44	17.05.2016	1,108,816	465,864		1,574,680
45	29.06.2016	1,114,235	1,122,874		2,237,110
46	03.08.2016	492,837	477,593		970,430
47	12.08.2016	1,101,353	1,108,725		2,210,078
48	29.08.2016	1,127,952	1,137,024		2,264,976
49	23.09.2016	913,399	921,242		1,834,641
50	31.10.2016	1,139,616	1,128,816		2,268,432
51	03.11.2016	1,183,682	1,172,973		2,356,655
52	15.11.2016	1,096,675	1,105,187		2,201,862
53	15.11.2016	1,109,404	690,326		1,799,730
54	25.11.2016	944,615	944,615		1,889,230
55	07.12.2016	1,129,356	1,137,024		2,266,380
56	04.01.2017	253,586	-		253,586
57	01.02.2017	1,092,975	1,101,650		2,194,625
58	01.02.2017	1,086,825	1,094,575		2,181,400
59	01.02.2017	1,157,760	1,183,680		2,341,440
60	01.02.2017	1,255,275	1,239,894		2,495,168
61	07.02.2017	779,498	425,180		1,204,678
62	07.02.2017	937,525	925,861		1,863,385
63	07.02.2017	913,414	921,242		1,834,656
64	07.02.2017	662,335	-		662,335
65	13.02.2017	1,337,118	448,409		1,785,527
66	14.03.2017	1,128,521	1,137,024	1,128,521	1,137,024
67	17.03.2017	1,046,243	1,054,400		2,100,643
68	17.03.2017	917,121	924,780		1,841,901
69	17.03.2017	1,099,515	1,108,725		2,208,240
70	17.03.2017	825,588	814,180		1,639,768
71	17.03.2017	1,106,347	1,106,346		2,212,693
72	23.03.2017	1,119,338	1,104,549	1,119,338	1,104,549
73	23.03.2017	1,217,419	1,211,825		2,429,243
74	23.03.2017	1,128,433	1,137,024		2,265,457
75	30.03.2017	1,128,168	1,137,024		2,265,192
76	03.04.2017	745,382	729,427		1,474,809
77	04.04.2017	980,070	967,514		1,947,584
78	18.04.2017	550,239	-		550,239
79	05.05.2017	1,115,622	1,122,874		2,238,496
80	11.05.2017	941,070	929,832		1,870,902
81	11.05.2017	1,086,579	1,094,575		2,181,154
82	11.05.2017	322,668	-		322,668
83	17.05.2017	1,049,860	1,097,875		2,147,735
84	18.05.2017	925,440	925,440		1,850,880
85	24.05.2017	987,825	995,528		1,983,353
86	13.06.2017	987,886	614,663		1,602,549
87	15.06.2017	907,658	912,706		1,820,364
88	15.06.2017	1,117,502	1,126,412		2,243,914
89	15.06.2017	1,139,616	1,125,439		2,265,055
90	15.06.2017	2,160,000	1,073,599	1,080,000	2,153,599
91	22.06.2017	937,525	927,282		1,864,807
92	03.07.2017	1,195,680	1,195,680		2,391,360
93	05.07.2017	1,128,119	1,137,024		2,265,143
94	12.07.2017	747,600	747,600		1,495,200
95	24.07.2017	1,103,599	1,112,262		2,215,861
96	02.08.2017	1,016,160	1,016,160		2,032,320
97	09.08.2017	1,097,665	1,032,567		2,130,233
98	15.08.2017	1,141,857	1,074,611		2,216,468
99	17.08.2017	1,398,949	-		1,398,949



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

100	18.08.2017	1,977,288	-	1,977,288	
101	18.08.2017	963,503	-	963,503	
102	22.08.2017	2,030,892	1,036,378	994,514	2,072,755
103	13.09.2017	2,204,935	1,065,402	1,076,494	2,193,843
104	13.09.2017	1,080,000	1,080,000	1,080,000	1,080,000
105	13.09.2017	1,161,818	-	1,161,818	
106	18.09.2017	1,671,549	-	1,671,549	
107	18.09.2017	932,004	42,364		974,368
108	21.09.2017	942,798	-	942,798	
109	29.09.2017	2,227,423	1,048,677	1,113,711	2,162,389
110	10.10.2017	1,183,680	1,183,680		2,367,360
111	10.10.2017	1,003,235	1,003,235		2,006,469
112	01.11.2017	939,316	939,316		1,878,632
113	06.11.2017	1,993,711	1,017,965	975,747	2,035,929
114	08.11.2017	1,113,711	1,049,786		2,163,497
115	15.11.2017	825,752	-	825,752	
116	20.11.2017	1,154,219	1,092,038		2,246,257
117	24.11.2017	1,763,520	881,760	881,760	1,763,520
118	01.12.2017	1,157,360	-	1,157,360	
119	12.12.2017	1,029,013	1,029,012		2,058,025
120	13.12.2017	2,286,343	1,076,986	1,143,171	2,220,158
121	13.12.2017	962,726	962,726		1,925,453
122	15.12.2017	1,124,759	1,059,080		2,183,839
123	22.12.2017	2,327,904	634,882	1,163,952	1,798,834
124	27.12.2017	1,891,200	945,600	945,600	1,891,200
125	04.01.2018	4,074,123	1,036,378	3,037,745	2,072,755
126	08.01.2018	988,600	945,600	279,400	1,654,800
127	16.01.2018	2,552,022	-	2,552,022	
128	16.01.2018	4,483,096	1,117,993	3,303,018	2,298,071
129	22.01.2018	226,161	-	226,161	
130	26.01.2018	421,650	-	421,650	
131	31.01.2018	1,135,040	-	1,135,040	
132	09.02.2018	1,578,240	-	1,578,240	
133	28.02.2018	560,356	-	560,356	
134	06.03.2018	2,725,028	-	1,880,726	844,302
135	09.03.2018	1,036,375	1,036,378		2,072,752
136	03.04.2018	5,877,043	1,235,447	4,562,895	2,549,595
137	04.04.2018	1,782,472	-	1,782,472	
138	13.04.2018	382,855	-	382,855	
139	20.04.2018	842,492	-	842,492	
140	20.04.2018	3,828,579	962,726	2,865,852	1,925,453
141	20.04.2018	5,035,216	1,248,310	3,717,386	2,566,140
142	20.04.2018	983,256	-	983,256	
143	23.04.2018	3,438,889	1,036,378	2,402,512	2,072,755
144	23.04.2018	464,360	-	464,360	
145	30.04.2018	3,451,754	1,091,616	2,360,139	2,183,231
146	30.04.2018	155,200	-	155,200	
147	10.05.2018	112,130	-	112,130	
148	22.05.2018	4,143,832	-	4,143,832	
149	22.05.2018	4,227,690	475,007	3,191,313	1,511,384
150	22.05.2018	785,620	-	785,620	
151	22.05.2018	1,716,511	885,120	831,391	1,770,240
152	22.05.2018	8,044,188	-	7,408,162	636,026
153	23.05.2018	1,324,800	1,324,800	1,324,800	1,324,800
154	28.05.2018	391,080	-	391,080	
155	28.05.2018	60,565	-	60,565	
156	05.06.2018	2,986,413	944,314	2,086,745	1,843,981
157	05.06.2018	475,822	-	475,822	
158	04.06.2018	4,607,342	-	3,118,775	1,488,567
159	08.06.2018	3,112,540	881,760	3,112,540	881,760
160	20.06.2018	3,507,186	-	2,451,380	1,055,806
161	25.06.2018	3,932,535	1,003,235	2,845,698	2,090,072
162	28.06.2018	3,763,138	966,409	2,796,729	1,932,818
163	09.07.2018	4,291,111	-	2,778,552	1,512,559
164	10.07.2018	484,773	-	484,773	
165	16.07.2018	1,129,338	1,128,996		2,258,334
166	19.07.2018	162,448	-	162,448	
167	23.07.2018	5,097,737	-	3,424,693	1,673,044
168	03.08.2018	1,548,600	-	1,548,600	
169	08.08.2018	3,916,899	962,727	2,954,173	1,925,453



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

170	09.08.2018	3,502,815	-	3,502,815	
171	09.08.2018	479,000	-	479,000	
172	09.08.2018	5,584,221	1,074,721	4,559,388	2,099,554
173	10.08.2018	375,203	-	375,203	
174	04.09.2018	1,110,992	-	1,110,992	
175	07.09.2018	3,074,753	-	2,157,225	917,528
176	14.09.2018	348,220	-	348,220	
177	18.09.2018	4,256,080	-	2,653,718	1,602,362
178	01.10.2018	220,195	-	220,195	
179	01.10.2018	438,000	146,000		584,000
180	01.10.2018	469,400	-	469,400	
181	01.10.2018	1,573,261	-	1,573,261	
182	05.10.2018	823,441	-	823,441	
183	19.11.2018	420,325	-	420,325	
184	18.12.2018	3,370,500	878,400	2,492,100	1,756,800
185	18.12.2018	4,455,000	1,080,000	3,375,000	2,160,000
186	19.12.2018	1,654,676	-	1,654,676	
187	31.12.2018	3,715,451	1,183,680	2,528,771	2,370,360
188	09.01.2019		4,808,663		4,808,663
189	17.01.2019		682,144		682,144
190	22.01.2019		760,113		760,113
191	06.02.2019		5,149,008		5,149,008
192	06.02.2019		165,540	165,540	
193	11.02.2019		479,926	479,926	
194	20.02.2019		337,909		337,909
195	04.03.2019		274,404		274,404
196	19.03.2019		3,821,457		3,821,457
197	21.03.2019		5,466,042		5,466,042
198	26.03.2019		29,906	29,906	
199	04.04.2019		4,767,058		4,767,058
200	04.04.2019		9,659,137		9,659,137
201	09.04.2019		502,244		502,244
202	12.04.2019		5,360,262		5,360,262
203	18.04.2019		3,964,657		3,964,657
204	23.04.2019		723,352		723,352
205	02.05.2019		4,770,589		4,770,589
206	03.05.2019		417,840		417,840
207	03.05.2019		790,787		790,787
208	03.05.2019		1,119,194		1,119,194
209	09.05.2019		1,174,483		1,174,483
210	16.05.2019		4,768,255		4,768,255
211	16.05.2019		12,779,665		12,779,665
212	16.05.2019		11,053,442		11,053,442
213	16.05.2019		2,477,299		2,477,299
214	29.05.2019		391,551		391,551
215	30.05.2019		994,291		994,291
216	12.06.2019		4,414,780		4,414,780
217	17.06.2019		4,590,377		4,590,377
218	20.06.2019		4,645,227		4,645,227
219	21.06.2019		655,720		655,720
220	21.06.2019		3,073,364		3,073,364
221	09.07.2019		441,600		441,600
222	13.08.2019		1,292,394		1,292,394
223	22.08.2019		4,861,250		4,861,250
224	03.09.2019		3,751,114		3,751,114
225	17.09.2019		77,750		77,750
226	17.09.2019		650,304		650,304
227	14.10.2019		1,055,040		1,055,040
228	12.11.2019		1,347,651		1,347,651
229	18.11.2019		4,639,507		4,639,507
230	18.11.2019		500,000		500,000
231	21.11.2019		443,724		443,724
232	27.11.2019		1,114,200		1,114,200
233	27.11.2019		5,464,209		5,464,209
234	12.12.2019		2,727,286		2,727,286
235	23.12.2019		3,939,545		3,939,545
236	30.12.2019		1,880,278		1,880,278
237	30.12.2019		1,636,037		1,636,037
238	30.12.2019		1,303,040		1,303,040



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Sic konstatohet nga databaza: radha e kërkesës për ekzekutim vijon që prej vitit 2009 deri në vitin 2019. Pavarësisht faktit që periudha 2009-2017 është ende pa likuiduar dhe në radhë, vijohet me pagesa të vitit 2018 dhe 2019.

Për sa më sipër observacioni i mësipërm mbetet i marr në konsideratë pjesërisht, që nga observacioni juaj i parë mbi akt-konstatimin. (trajtuar edhe në projekt raport).

Mbi veprimtarinë e komisionit të posaçëm

Në vitin 2019 Komisioni Posaçëm ka nisur veprimtarinë e tij me 126 praktika të mbartura prej vitit 2018. Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2019 kanë mbërritur në DPT edhe 22 praktika të reja të ish nëpunësve (vendime të formës së prerë).

Në bazë të ligjit nr.152/2013 datë 01.10.2013 “Për nëpunësin civil”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civil të institucionit, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet shprehimisht në ligj që një vendim apo akt administrativ i caktuar, që ka të bëjë me marrëdhëniet e shërbimit civil, është në kompetencën e një nëpunësi apo një trupe tjetër posaçërisht të krijuar sipas këtij ligji, siç është Komisioni i Posaçëm i ngritur në zbatim të Urdhërit nr.5151 datë 28.10.2015.

Në zbatim të Urdhërit nr.5151 datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil” të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike është ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Komisioni i Posaçëm ka pësuar disa ndryshime në Urdhëra. Komisioni i posaçëm ka funksionuar me Urdhërin Nr.25 datë 24.04.2017 si më poshtë:

- Zj. V V (Drejtor i Përgjithshëm, Kryetar)
- Zj. I K (Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore, Anëtar)
- Zj. V T (Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Anëtar)
- Zj.D C (Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, Anëtar)

Me Urdhërin Nr.36 datë 25.09.2018 është bërë zëvendësim si në vijim:

-Znj.V T zëvendësohet me znj. B Gj

-Znj.D C zëvendësohet me E S.

Me Urdhërin Nr.36/1 datë 01.11.2018 është bërë zëvendësim si në vijim:

-Znj.B Gj është zëvendësuar me z. I K

-Znj.E S është zëvendësuar me znj. D C

Me Urdhërin Nr.36/2 datë 19.03.2019 Z.I K është zëvendësuar me Znj.V T.

Me Urdhërin Nr.15 datë 08.04.2019 është ngritur Komisioni i Posaçëm me këtë përbërje:

- Z.E D Drejtor i Përgjithshëm
- Znj.I K Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Teknike
- Znj.V T Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore
- Znj.D C Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës

Me Urdhërin Nr.16319 prot datë 04.09.2019 me ndryshimin e Titullarit të DPT, Z.E D zëvendësohet me Znj.D I.

Me Urdhërin Nr.64 datë 14.10.2019 është ngritur një grup pune për verifikimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të regjistruara për praktikën në proces ekzekutimi të nëpunësve civil gjyqfites me përbërje si në vijim:

- E B Drejtoria e Burimeve Njerëzore
- J B Drejtoria e Buxhetit dhe Financës
- J M Drejtoria Ligjore dhe Teknike

Me shkresën Nr.5003/1 Prot datë 30.08.2019 Znj.AD është caktuar në cilësinë e përfaqësuesit të Departamentit të Administratës Publike, në Komisionin e Posaçëm, të ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

KP duhet të shqyrtojë të gjitha rastet e gjyqfituesve, të pasistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, që kanë një vendim gjyqësor të formës së prerë, deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhërit”. Urdhëri përcakton gjithashtu në Kreun IV, pika 2 se “KP thirret nga Kryetari, brenda 2 ditëve punë nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke vënë në dijeni DAP-in”. Kreu IV, pika 3 përcakton se “Shqyrtimi administrative përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës”. Kreu VI, pika 4 përcakton se “KP në përfundim të shqyrtimit administrativ, brenda 3 ditëve pune, i parashtron me shkrim gjyqfituesit alternativat, objektivisht të mundshme, për t’u punësuar në një pozicion të rregullt të njëjtës kategori dhe në pamundësi objektive, në një kategori më të ulët brenda institucionit nga ku është larguar apo në një institucion varësie”.

Konstatohet se Komisioni i Posaçëm nuk i ka shqyrtuar dosjet ekzistuese brenda 60 ditëve, siç parashikon urdhëri. Kryetari i KP nuk e ka thirrur komisionin ashtu sikurse parashikohet në dispozitat ligjore, të cituara më sipër.

Konstatohet se nga mosveprimet janë shkaktuar pasoja të konsiderueshme financiare.

Ky komision gjatë vitit 2019 ka trajtuar 39 praktika për të cilat ka bërë propozimet përkatëse.

N R	POZICIONI I MEPARSHEM	POZICIONI I PROPOZUAR	SITUATA	SHKRESAT
1	Drejtor Drejtoria, në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë, kategoria e pagës III-a/1	Drejtor Drejtoria, në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë, kategoria e pagës III-a/1	RIKTHYER	1. Nr. 3315/4 prot., datë 21.03.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.3315/5 prot., datë 2.4.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 3315/6 prot -datë 8.4.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me aktin nr 3315/7 datë 17.4.19
2	Drejtor Drejtoria, në Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës, kategoria e pagës III-a/1	Inspektor i Parë, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, kategoria e pagës III-b.	RIKTHYER	1. Nr. 3374 prot., datë 13.2.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.3374/2 prot., datë 18.2.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 3374/3 prot -datë20.2.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me aktin nr 12431/2 datë 8.7.19
3	Inspektor i Parë, në Sektorin e Verifikimit në Terren, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë, kategoria e pagës III-b	Inspektor i Dytë, në Sektorin e Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë, kategoria e pagës IV-a	DOREHEQUR NGA E DREJTA E RIKTHIMIT	1. Nr. 3375 prot., datë 13.02.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.10332 prot., datë 20.05.4.2019 - doreheqje 3. Nr. 10332/1 prot -datë 28.05.2019 njoftim (ekzekutuar)
4	Inspektor Kontrolli, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë	Inspektor i Parë, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë kategoria e pagës III-b.	RIKTHYER	1. Nr. 3371 prot., date 13.2.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.3371/1 prot., datë 15.2.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 3371/2 prot -datë20.2.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me aktin nr 4930/1 datë 11.3.19
5	Inspektor i Parë, në Sektorin e Verifikimit në Terren, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë, kategoria e pagës III-b	Inspektor i Dytë, në Sektorin e Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë, kategoria e pagës IV-a	RIKTHYER	1. Nr. 3372 prot., datë 13.2.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.3372/1 prot., datë 15.2.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 3372/2 prot -datë 20.2.2019 akt rekomandim 4. Emeruar me aktin nr 4805/1 date 18.3.19
6	Inspektor i Parë, në Sektorin e Përpunimit të Deklaratave, Vlerësimit dhe Rimbursimit, në Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore të Kontabilitetit, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, kategoria e pagës III-b	Inspektor i Parë, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, kategoria e pagës III-b.	RIKTHYER	1. Nr. 3373 prot., datë 13.2.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.3373/1 prot., datë 15.2.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 3373/2 prot -datë20.2.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me aktin nr 5148/1 datë 13.3.19



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

7	Specialist në Sektorin e Edukimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Shkodër, kategoria e pagës IV-b	Inspektor i Dytë në Zyrën e Marrëveshjeve, në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë, DRT Shkodër, kategoria e pagës IV-a	RIKTHYER	1. Nr. 3315/4 prot., datë 21.03.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.3315/5 prot., datë 2.4.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 3315/6 prot -datë 8.4.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me aktin nr 3315/7 datë 17.4.19
8	Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT, kategoria e pagës III-a	Drejtor Drejtorie, në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve, në DPT, kategoria e pagës III-a	RIKTHYER	1. Nr. 7845/1 prot., datë 15.04.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.7845/2 prot., datë 15.4.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 7845/3 prot -datë15.4.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me aktin nr. 8567/1 datë 30.4.19
9	Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse në DTM, kategoria e pagës III-a/1	Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse në DTM, kategoria e pagës III-a/1	RIKTHYER	1. Nr. 7932/1 prot., datë 15.04.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.7932/2 prot., datë 15.4.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 7932/3 prot -datë15.4.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me akt nr. 7932/5 datë 3.5.19
10	Specialiste Zyra Juridike, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse kategoria e pagës IV-a	Inspektor i Dytë në Sektori e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Vlorë, kategoria e pagës IV-a	RIKTHYER	1. Nr. 11847 prot., datë 13.06.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.11847/1 prot., datë 18.06.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr.11847/2 prot -datë 21.06.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me akt nr. 12779/1 datë 8.7.19
11	Inspektor i parë Sektori i Kontrollit Tatimor, kategoria (III-b)	Inspektor i Dytë në Sektorin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Vlorë, kategoria e pagës IV-a	RIKTHYER	1. Nr. 11849 prot., datë 13.06.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.11849/1 prot., datë 19.6.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 11849/2 prot - akt rekomandim 4. Emëruar me akt nr. 14039/1 datë 29.7.19
12	Inspektor i parë Sektori i Kontrollit Tatimor, kategoria (III-b)	Inspektor i dytë në Sektorin e Kontrollit Tatimor, kategoria e pagës IV-a.	RIKTHYER	1. Nr. 11848 prot., datë 13.06.2019 - propozim për sistemim 2. Nr.11848/1 prot., datë 19.06.2019 - shpreh pëlqimin 3. Nr. 11848/1 prot -datë 21.06.2019 akt rekomandim 4. Emëruar me akt nr. 12965/1 datë 08.07.19
13	Inspektor i parë Sektorin i Kontrollit Tatimor, kategoria (III-b)		DAP PER POZICIONIM	Nr. 11845 prot., datë 13.06.2019 DAP për sistemim, pamundësi objektive Shkresa nr. 11845/2 prot datë 01.07.2019 dokumentacion dërguar DAP
14	Inspektore e parë Kontrolli, kategoria (III-b)		DAP PER POZICIONIM	Nr. 11846 prot., datë 13.06.2019 DAP për sistemim, pamundësi objektive Shkresa nr. 11845/2 prot datë 01.07.2019 dokumentacion dërguar DAP
15	Inspektor iparë në Sektorin e Verifikimit në Terren, kategoria (III-b)		DAP PER POZICIONIM	
16	Përgjegjës i Policisë Tatimore		PENSION	
17	Inspektor i parë Kontrolli, kategoria (III-b)	Specialist Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Lezhë, kategoria e pagës IV-a	RIKTHYER	shkresa nr. 18691, 09.10.2019 propozim sistemim. Me shkresë 18691/1 Prot, datë 16.10.2019 shpreh pëlqimin për pozicionin e ofruar. Me shkresë 18691/2 Prot, datë 25.10.2019 akt rekomandimi DAP Me shkresën nr. 18691/3 Prot., datë 11.11.2019 është përcjellë akti i emërimit. Me shkresën nr. 18691/5 Prot., datë 27.11.2019 është përcjellë akti për fillimin e marrëdhënieve financiare.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

18	Përgjegjës Sektori i Verifikimit në Terren, kategoria (III-b), Kukës	Përgjegjës Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, DRT Kukës, kategoria e pagës III-b	RIKTHYER	shkresa nr. 18694, 09.10.2019 propozim sistemim me shkresën nr.18946 Prot., datë 14.10.2019 shpreh pëlqimin për pozicionin e ofruar me shkresën nr. 18946/1 Prot., datë 25.10.2019 akt rekomandim DAP për sistemim. Me shkresën nr.20688 Prot., datë 11.11.2019 është përcjellë akti i emërimit. Shkresa nr. 20688/1 Prot., datë 20.11.2019 Fillimi i marrëdhënieve Financiare
19	Inspektor i dytë Kontrolli kategoria IV-a, Lezhë	Inspektor i dytë në Sektorin e Kontabilitetit të të Ardhurave, DRT Shkodër IV-a	REFUZIM DISTANCË MBI 45 KM	shkresa nr. 18693, 09.10.2019 propozim sistemim Me shkresën nr. 2161 Prot., datë 11.10.2019 shpreh mos pëlqimin për pozicionin e ofruar, Shkresa nr. 18693/4 Prot., datë 20.11.2019 përgjigje lidhur me refuzimin. Me shkresën nr. 22004/1 Prot., datë 13.12.2019 Informacion KP lidhur me refuzimin e pozicionit të ofruar. Bërë me dije lidhur me statusin e propozimeve të ofruara gjyqituesve Drejtoria Ligjore dhe Teknike me e-maillet e datës 29.10.2019 dhe 25.11.2019.
20	Përgjegjës Sektori i Verifikimit në Terren, Gjirokastër III-b	Përgjegjës në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, kategoria e pagës III-b.	RIKTHYER	shkresa nr.18692, 09.10.2019 propozim sistemim me shkresën nr. 18692/1 Prot, datë 15.10.2019 shpreh pëlqimin për pozicionin e ofruar Me shkresën nr.18692/2 Prot., datë 26.10.2019 akt rekomanim Dap për sistemim. Me shkresën nr. 18692 Prot., datë 12.11.2019 është përcjellë akti i emërimit nga DAP. Shkresa nr.18691/4, datë 22.11.2019 Fillimi i marrëdhënieve financiare.
21	Inspektor i dytë Sektori i Verifikimit në Terren kategoria(IV-a), Lezhë	Për sistemim DAP		shkresa nr. 18682, 09.10.2019 me shkresën nr 5960/1 prot datë 23.10.2019 DAP shprehet se për Gjon Frrokun dhe Fitnete Avdiu ka vende vakante në qarkun Lezhë dhe Elbasan. Nuk ka marrje masash nga DPT
22	Inspektor i dytë Sektori i Verifikimit në Terren kategoria(IV-a), Tiranë	Specialist Sektori i Rregjistrimit në DRT Elbasan, kategoria e pagës IV-a	REFUZIM	shkresa nr. 18683, dt. 09.10.2019 propozim për sistemim me shkresën 18683/1 Prot., date 14.10.2019 mos pëlqimin për pozicionin e ofruar . Me shkresën nr. 18683/2 Prot., datë 30.10.2019 Shkrese Z.A lidhur me refuzimin 18683/3 në datë 30.10.2019 përgjigje lidhur me refuzimin, 18683/3 datë 04.11.2019 , kthim përgjigje I. Abdija lidhur me refuzimin.Përcjellë akt rekomandimi me shkresën nr. 1985 Prot., date 28.01.2020. Me shkresën nr. 1985/1 Prot., datë 10.02.2020. Përsëri refuzon duke parashtruar pretendimet e veta. Me shkresën nr.598/1 Prot., datë 11.02.2020 protokolluar me tonën nr. 1985/2 Prot., datë12.02.2020 Dap pas shqyrtimit kërkon akt rekomandimi në DRT Tiranë inspektor i dytë kategoria IV-a. Shkresa nr.1985/3 Prot., datë 02.03.2020 Informacion KP Bërë me dije lidhur me statusin e propozimeve të ofruara gjyqituesve Drejtoria Ligjore dhe Teknike me e-maillet e datës 29.10.2019 dhe 25.11.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

23	Specialist në zyrën e Asistencës dhe Rregjistrimit, Durrës	Inspektor i dytë në Sektorin e Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara, në DRT Durrës, kategoria e pagës IV-a	DORËHEQJE	shkresa nr. 18684/09.10.2019 propozim për sistemim ka marrë dëgjime verifikuar me anë të shërbimit postar, me shkresën nr. 19933 Prot., datë 17.12.2019 Akt Rekomandimi DAP. Me shkresën nr. 18684/2 Prot., datë 06.01.2020 ka paraqitur dorëheqjen nga Titulli ekzekutiv, e drejta e rikthimit në punë. Me shkresën nr. 18684/3 Prot., datë 14.01.2020 informacion KP për vijueshmërinë e procedurës. Me shkresën nr. 18684/4 Prot., datë 16.01.2020 Njoftim mbi praktikën gjyqësore, DAP, DBF, Përmbartues, Irma Kokoli për ezaurimin e praktikës për rikthim në detyrë.
24	Inspektor I dytë Kontrolli Tatimor kategoria IV-a, Elbasan	Specialist Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Elbasan, kategoria e pagës IV-a	DORËHEQUR – EMËRUAR NË NJË POZICION TJETËR KUR KA PATUR VENDE VAKANTE NË POZICION E TIJ TË MËPARSHËM	shkresa nr.18685, 09.10.2019 propozim për sistemim, Shkresa 18685/1, datë 16.10.2019 refuzim I pozicionit të ofruar. Me shkresën nr. 21425 Prot., datë 22.11.2019 akt rekomandimi DAP për pozicionin e ofruar. Me shkresën nr. 18685/2 Prot., datë 27.11.2019 kundërshton akt rekomandimin drejtuar DAP, për dëgjime i DPT. Me shkresën nr. 7128/1 Prot., datë 06.12.2019 Dap kthen përgjigje lidhur me refuzimin e pozicionit të ofruar z. M A. akt –rekomandimi me shkresën nr. 21425 Prot., datë 22.11.2019. Me shkresën nr. 7084/1 Prot., datë 26.12.2019 akt emërimi nga DAP. Shkresa nr. 23206/1 Prot., datë 09.01.2020 Fillimi i marrëdhënieve financiare. Shkresa 23206/3 Prot., datë 23.01.2020 DBF për kompetencë. Duke mos qenë dakord me pozicionin e ofruar ka paraqitur dorëheqjen me shkresën nr.4314 Prot, datë 25.02.2020 dhe me vendimin nr.73, datë 10.03.2020 është miratuar dorëheqja.
25	Drejtor Kontrolli	Përgjegjës në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DRT Vlorë kategoria e pagës III-b	RIKTHYER	Shkresa nr.18686 , 09.10.2019 propozim për sistemim Me shkresën nr.18686/1 Prot., datë 17.10.2019 ka kthyer përgjigje për pranimin e pozicionit me rezerva . Me shkresën nr.18686/2 Prot., datë 26.10.2019 I është kërkuar të shprehë qartë pëlqimin ose refuzimin Me shkresën nr. 18686/3 Prot., datë 31.10.2019 shpreh pëlqimin për pozicionin e ofruar. Me shkresën nr. 18686/4, datë 18.11.2019 akt rekomandimi DAP. Me shkresën nr. 18686/6 Prot., datë 27.11.2019 DAP përcjell emërimin e Z. K por me një gabim materiale në të. Me shkresën nr.18686/7 Prot., datë 13.12.2019 i është kthyer DAP për korrigjim akti. Shkresa e DAP Protokolluar me tonën nr. 2585 Prot., datë 04.02.2020, për vënien në dispozicion të aktit origjinal të emërimit të z. K. Me shkresën nr. 2585/3 Prot., datë 26.02.2020 i kemi përcjellë DAP aktin origjinal me nr. 6945/2 Prot., datë 26.11.2019. Ende ska Përgjigje .Prill përgjigje DAP dhe shkresa nr.7063/1 Prot., datë 04.05.2020 shkresë për fillimin e marrëdhënieve financiare
26	Inspektore e parë në Sektorin e Kontrollit, kategoria (III-b), Gjirokastrë	Inspektor I dytë në Sektorin e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, DRT Gjirokastrë, kategoria e pagës IV-a	REFUZIM PËR ULJE NË KATEGORI	shkresa nr.18687, 09.10.2019 propozim për sistemim, Shkresa 18687/1 , datë 23.10.2019 refuzim I pozicionit të ofruar. Me shkresën nr. 18687/3 Prot., datë 08.11.2019 kthim përgjigje lidhur me refuzimin. Bërë me dije lidhur me statusin e propozimeve të ofruara gjyqësuesve Drejtoria Ligjore dhe Teknike me e-maillet e datës 29.10.2019 dhe 25.11.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

27	Inspektor I dytë Sektori I Mbledhjes së Tatimeve , kategoria (IV-a)	Inspektor I dytë në Sektorin e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, DRT Lezhë	PA PËRGJIGJE	shkresa nr.18689 , 09.10.2019 propozim për sistemim,
28	Inspektor I parë Verifikimi në Terren, Elbasan III-b	Inspektor I dytë në Sektorin e Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara, në DRT Durrës kategoria e pagës IV-a.	REFUZIM PËR ULJE NË KATEGORI + DISTANCË MBI 45 KM	shkresa nr.18690, 09.10.2019 propozim për sistemim, Shkresa nr. 18690/2 refuzim I pozicionit të ofruar.Bërë me dije lidhur me statusin e propozimeve të ofruara gjyqituesve Drejtoria Ligjore dhe Teknike me e-maillet e datës 29.10.2019 dhe 25.11.2019.
29	Specialiste Zyra e Agjencisë së Sherbimeve Gramsh	Për sistemim DAP	DAP PËR POZICIONIM	shkresa nr. 18696, 09.10.2019 propozim për sistemim ME SHKRESEN NR 5960/1 PROT DATË 23.10.2019 DAP SHPREHET SE PËR GJON FRROKUN DHE FITNETE AVDIU KA VENDE VAKANTE NË QARKUN LEZHË DHE ELBASAN. NUK KA MARRJE MASASH NGA DPT
30	Inspektor I parë Sektori I Verifikimit në Terren kategoria(III-b), Durrës	Inspektor i dytë në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit të Ardhurave, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, kategoria e pagës IV-a	RIKTHYER	shkresa nr.18695, 09.10.2019 propozim për sistemim, hartuar shkresa për herë të dytë për shkak të mos dërgimit me postë shkresa nr.20797 Prot., datë 12.11.2019. Me shkresën nr. 20797/1 Prot., datë 18.11.2019 ka kthyer përgjigje duke mos qënë dakort me vendin e propozuar për shkak të kategorisë, Me shkresën nr.20797/2 Prot., datë 17.12.2019 Akt rekomandimi. Shkresa nr. 7563/4 Prot., datë 10.01.2020 e DAP protokolluar me tonën nr. 384 Prot., datë 13.01.2020 vendim emërimi. Shkresa nr 384/1 Prot., datë 21.01.2020 Fillimi i marrëdhënieve financiare Shkresa nr. 5852 Prot., datë 19.03.2020 pranon pozicionin me kusht rikthimin në kategori page III-b. Shkresa nr. 6096 Prot., datë 30.03.2020 shkresa e DAP drejtuar Z. Sh për paraqitjen në punë. Z.Sh pas komunikimit me DRT Durrës është paraqitur në punë.
31	Përgjegjës Sektori I Pajisjeve Fiskale, DPT III-A/1	Aktualisht Inspektor I dytë në Sektorin e Analizës dhe Statistikës, në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit IV-A	PAMUNDËSI SISTEMIMI	Akt rekomandimi DAP shkresa nr. 7395/5 Prot, datë 27.11.2019
32	Specialist në Sektorin e Pajisjeve Fiskale , DPT			Akt rekomandimi DAP shkresa nr. 7395/7 Prot, datë 27.11.2019
33	Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Pajisjeve Fiskale, DRT Dibër			Akt rekomandimi DAP shkresa nr. 7395/6 Prot., datë 27.11.2019
34	Inspektor I Dytë në Sektorin e Mbledhjes së Borxhit, DRT Tiranë, IV-a		PENSION	Me shkresën nr. 21642, dt. 27.11.2019 ekzekutim vendimi Me shkresën nr. 21642/1, dt.06.12.2019 "Përfundim I marrëdhënies në shërbimin civil"
35	Inspektor I Dytë në Sektorin e Përpunimit të Deklaratave dhe Rimbursimit të Ardhurave, DRT Tiranë, IV-a		PENSION	Me shkresën nr. 21644 dt. 27.11.2019 ekzekutim vendimi Me shkresën nr. 21644/1, dt.06.12.2019 "Përfundim I marrëdhënies në shërbimin civil"
36	Inspektor I Parë në Sektorin e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, III-b		PENSION	Me shkresën nr. 21641 dt. 27.11.2019 ekzekutim vendimi Me shkresën nr. 21641/1, dt.06.12.2019 "Përfundim I marrëdhënies në shërbimin civil"
37	Inspektor Personeli në Sektorin e Administratës, DRT Tiranë		PENSION	Me shkresën nr. 21640 dt. 27.11.2019 ekzekutim vendimi Me shkresën nr. 21640/1, dt.06.12.2019 "Përfundim I marrëdhënies në shërbimin civil"
38	Inspektor në Sektorin e Operacioneve të Kontrollit, DRT Lezhë, III-b		PENSION	Me shkresën nr. 21637 dt. 27.11.2019 ekzekutim vendimi Me shkresën nr. 216370/1, dt.06.12.2019 "Përfundim I marrëdhënies në shërbimin civil"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

39	Inspektor I Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren, DRT Tiranë, IV-a		PENSION	Me shkresën nr. 21643 dt. 27.11.2019 ekzekutim vendimi Me shkresën nr. 21643/1, dt.06.12.2019 "Përfundim I marrëdhënies në shërbimin civil"
----	--	--	---------	--

Grupi i auditimit konstaton se nuk është ndjekur radha e trajtimit të praktikave të gjyqfituesve për rikthim në punë. Nga 39 praktikat e shqyrtuara konstatohet se 7 prej tyre kanë dalë në pension. Nga këta janë finalizuar me rikthim në punë 14 punonjës gjatë vitit 2019 dhe 2 gjatë vitit 2020. Në total janë:

- finalizuar me rikthim në punë 16 raste nga këto praktika.
- janë dorëhequr 3 gjyqfitues
- 1 nuk ka kthyer ende përgjigje mbi pozicionin e ofruar
- 7 kanë dalë në pension
- 5 kanë refuzuar për arsye ulje në kategori/distancë mbi 45 km
- 5 punonjës kanë pamundësi sistemimi dhe KP i është drejtuar DAP për ripozicionim
- 2 janë në fazën e akt rekomandimit DAP dhe janë ende pa përgjigje.

Konstatohet se për 2 raste që Komisioni i Posaçëm është shprehur për pamundësi objektive në lidhje me sistemin dhe i është Drejtuar DAP, ky i fundit me shkresën nr 5960/1 prot date 23.10.2019 dap shprehet se DPT, nisur nga struktura ka vende vakante ku 2 gjyqfitues mund të sistemohen. Nuk ka marrje masash nga ana e DPT.

Gjatë vitit 2019 konstatohet se Komisioni i Posaçëm është thirrur vetëm 6 herë nga Kryetari, faktuar nga proces verbalet e vëna në dispozicion grupit të auditimit.

Nga auditimi konstatohet se në fund të vitit 2019 kanë mbetur ende të pa trajtuara nga Komisioni i Posaçëm edhe 142 praktika gjyqfituesish, në shkelje të çdo afati të parashikuar në Urdhërin nr.5151, datë 28.10.2015 cituar më sipër.

Në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit të Posaçëm dhe anëtarit të Komisionit, parashikuar në Urdhërin nr.5151 datë 28.10.2015, Drejtoria e Burimeve Njerëzore i ka vënë në dispozicion KP në mënyrë elektronike dhe shkresoredatabazën e ish nëpunësve civil të shoqëruar edhe me informacionin e nevojshëm në lidhje me pozicionet vakante, në të cilat ekziston mundësia për t'u sistemuar këta nëpunës.

✓ Shkresën nr 6499 prot datë 27.03.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të znj. F A (e punësuar pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Gramsh)

✓ Shkresën nr 6499 prot datë 27.03.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të znj. F A (e punësuar pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Gramsh)

✓ Shkresën nr.5523/2 prot datë 27.03.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të z. M M (nuk rezulton i punësuar)

✓ Shkresën nr.6737/1 prot datë 02.04.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të Z. Gj S (i punësuar në Drejtoria e Sigurimeve Lezhë, nr rendor 114)

✓ Shkresën nr.7282 prot datë 08.04.2010 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të z. O D (nuk rezulton i punësuar, renditur me nr 144 si gjyqfitues)

✓ Shkresën nr.7285 prot datë 08.04.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të z. D B (i punësuar në subject privat, renditur me nr 143 si gjyqfitues)

Shkresën nr.8886/1 prot datë 07.05.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të z. F M (renditur me nr 52 si gjyqfitues)

✓ Shkresën nr.9193 prot datë 07.05.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të z. M A (renditur me nr 141 si gjyqfitues)

✓ Shkresën nr.6780/2 prot datë 17.05.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të z. A Gj (renditur me nr 142 si gjyqfitues)

✓ Shkresën nr.10437 prot datë 20.05.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të z. Xh B dhe Z. R S (punësuar në subject privat)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

- ✓ Shkresën nr.12417 prot datë 24.06.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të Z. A B (renditur me nr 144)
- ✓ Shkresën nr.12418 prot datë 24.06.2019 informacion në lidhje me praktikën për ekzekutim të Z. B P (punësuar në subject privat me nr rendor 145)
- ✓ Shkresën nr.13743 prot datë 15.07.2019 informacion në lidhje me praktikën e Znj.R A
- ✓ Shkresën nr.12860 prot datë 02.07.2019 informacion në lidhje me praktikën e Z. M Xh (i papunësuar)
- ✓ Shkresën nr.18843 prot datë 04.10.2019 informacion në lidhje me praktikën e Z. N Cungu (punësuar në subjekt privat, renditur me nr 149)
- ✓ Shkresën nr.18824/1 prot datë 23.10.2019 informacion në lidhje me praktikën e Z. F I (renditur me nr 12, i papunësuar)
- ✓ Shkresën nr.20199/4 prot datë 10.12.2019 informacion në lidhje me praktikën e Znj.S N (punësuar në subjekt privat)
- ✓ Shkresën nr.23129 prot datë 27.12.2019 informacion në lidhje me praktikën e Z. N K (jo i punësuar)

Pavarësisht këtyre shkresave nga ana e Burimeve Njerëzore, dhe mundësive të sistemit të gjyqituesve, nuk janë trajtuar të gjithë rastet.

Nr	Mundesi sistemimi/ Propozim nga Burimet Njerëzore	Situata
1	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë Berat	Pa sistemim
2	Përgjegjës Sektori i Mbledhjes me forcë Berat	Pa sistemim
3	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë Kukës	Rikthyer
4	Përgjegjës Sektori i Funksioneve Mbështetëse Kukës	Pa sistemim
5	Pamundësi objektive për sistemim	-
6	Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor Sarandë	Pa sistemim
7	Përgjegjës Sektori i Mbledhjes me forcë Sarandë	Pa sistemim
8	Pamundësi objektive për sistemim	-
9	Pamundësi objektive për sistemim	-
10	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë, Lezhë	refuzim arsye distancë
11	Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit Lezhë	Pension
12	Specialist Sektori i Asistencës dhe Shërbimit, Lezhë	Rikthyer
13	Nuk ka vend vakant, DAP për sistemim	-
14	Nuk ka vend vakant, DAP për sistemim	-
15	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë, Gjirokastrë	Pa sistemim
16	Përgjegjës Sektori, propozuar Inspektor i dytë	Refuzim për ulje në kategori
17	Përgjegjës në Sektorin e Kontabilitetit dhe të Ardhurave Gjirokastrë	Rikthyer
18	Pamundësi objektive për sistemim, DAP për sistemim	-
19	Pamundësi objektive për sistemim, DAP për sistemim	-
20	Pamundësi objektive për sistemim, DAP për sistemim	-
21	Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor Sarandë, Vlorë	Rikthyer
22	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë Vlorë	Rikthyer
23	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë Vlorë	Rikthyer
24	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë Vlorë	Rikthyer
25	DAP për sistemim	-
26	DAP për sistemim	-
27	DAP për sistemim	-
28	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me forcë, Dibër	Pa sistemim
29	Akt rekomandimi DAP	ska përgjigje
30	Specialist Sektori i Regjistrimit, Korçë	Pa sistemim
31	Specialist Sektori i Asistencës dhe Shërbimit, Korçë	Pa sistemim
32	Inspektor i dytë Kontrolli Tatimor	Pa sistemim
33	Inspektor i dytë Sektori i Mbledhjes me Forcë	Pa sistemim
34	Nuk ka vende vakante	-
35	Nuk ka vende vakante	-
36	Nuk ka vende vakante	-
37	Trajtuar edhe pse ka qene me kod pune	

Sipas tabelës së mësipërme konstatohen se pavarësisht se nga Burimet Njerëzore janë bërë propozime dhe ka patur vende vakante për sistemim gjyqituesish, nga ana e Komisionit të Posaçëm nuk është vepruar dhe nuk janë ushtruar kompetencat që i atribuon Urdhëri nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, edhe pse



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

i është vënë në dispozicion informacioni i nevojshëm për këtë vendimarrje, konkretisht databaza e ish nëpunësve të larguar dhe pozicionet vakante në strukturën e Administratës Tatimore Qëndrore. Këto propozime i janë dërguar edhe strukturave drejtuese me memo të ndryshme. Mosveprimi i këtij komisioni dhe mosmarrja e masave nga ana e strukturave drejtuese në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore ka shkaktuar për disa vite dhe vazhdon të shkaktojë kosto financiare për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për pasojë ka rënduar padrejtësisht buxhetin e shtetit shqiptar.

Grupi i auditimit pavarësisht mosfunksionimit si KP, vlerëson se përgjegjësia është e strukturave drejtuese (*Titullarëve të DPT gjatë vitit 2019 .z. Xh C për periudhën 01.01.2019-04.04.2019 në cilësinë e ish Zv.Drejtorit të Përgjithshëm, z.E D, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së për periudhën 04.04.2019-18.07.2019, znj.D I, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së, nga data 18.07.2019-31.12.2019*) jo vetëm në rolin si Kryetar të KP por dhe si Drejtues të Institucionit të cilët duhet ta shohin me prioritet dhe angazhim maksimal ekzekutimin e vendimeve gjyqësore , vonesa e të cilave shkakton dëme të konsiderueshme në buxhetin e shtetit. Megjithatë merr në konsideratë edhe kohën e kufizuar të tyre në qëndrimin si Drejtues përgjatë vitit 2019.

Mbi ish nëpunësit civil që marrin dy paga mujore nga buxheti i shtetit

Gjatë auditimit ka rezultuar se:

24 prej tyre gjyqfutesve rezultojnë të punësuar në institucione të tjera buxhetore, në pozicione me kod pune apo status nëpunësi civil. Tabela identifikon rastet specifike sipas institucioneve që ish nëpunësit figurojnë të punësuar gjatë vitit 2019.

Ish nëpunës të ATQ, të cilët kanë përfutur dy paga mujore njëkohësisht.

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni/Pozicioni 2019	Situata aktuale
1	I L	Bashkia Librazhd/ Inspektor Taksash	Refuzim për arsye ulje në kategori
2	Gj S	Drejtoria Sig.Shoqerore Lezhë/ Kontabilist	Refuzim për arsye ulje në kategori
3	Li Z	Agjensia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes / Punëtor	Ka dal në pension
4	I K	Bashkia Durrës/Nëpunës taksash	Ka dhënë dorëheqje nga kthimi
5	M H	Bashkia Kukës/Drejtor Drejtorie	Rikthyer
6	I A	Bashkia Kamëz/ Nëpunës të tjerë zyre	Refuzim për arsye ulje në kategori
7	M Sh	Bashkia Kavajë/Drejtor Drejtorie	Rikthyer
8	J M	Bashkia Peqin/ Nënkyetar Bashkie	Pa trajtim
9	A M	A.SH.K. Drejtoria Vendore Gjyrokastër/Përgjegjës sektori	Rikthyer
10	A B	Rikthyer DRT Shkodër	Rikthyer
11	A G	Avokati Popullit/Specialist i marrëdhënieve me publikun	Pa trajtim
12	A GJ	Dega e Doganës Tiranë/ Doganier	Pa përgjigje për pozicionin e ofruar
13	A K	Drejtoria e Përgj. e Sherb. Trans. Rugor/ Drejtor Kabineti	Rikthyer
14	L Xh	Drejtoria e Përgj. e Shërb. Trans. Rugor/Përgjegjës Sektori	Pa trajtim
15	M Dh	Enti Kombëtar i Banesave	Pa trajtim
16	B Sh	Bashkia Peqin	Pa trajtim
17	M P	Bashkia Dropull	Praktikë e ekzekutuar, jo më pjesë e databazës
18	M S	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	Rikthyer
19	G H	DRT Fier	Pa trajtim
20	A B	Universiteti “E.Cabej”	Refuzim për arsye ulje në kategori
21	A K	Bashkia Himarë	Rikthyer
22	P Sh	Dega e Thesarit Tiranë	Pa trajtim
23	M A	Universiteti Aleksander Xhuvani	Punësim në një pozicion më të ulët pa miratim nga ana e tij, dhënie dorëheqje nga pozicioni për shkak të mospërbushjes sipas përcaktimeve të vendimit gjyqësor
24	J M	Bashkia Peqin/ Nënkyetar Bashkie	Pa trajtim

Nga këta 24 punonjës:

- 8 janë pa trajtim nga KP,
- 7 janë trajtuar dhe rikthyer,
- 1 ka dal në pension,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

- 1 ka dhënë dorëheqjen nga rikthimi,
- 1 ka dhënë dorëheqjen nga emërimi me ulje në kategori të cilin nuk e ka aporruar punonjësi sipas dispozitave ligjore,
- 1 nuk ka kthyer ende përgjigje në lidhje me pozicionin e ofruar,
- 4 kanë refuzuar pozicionin e ofruar për shkak të uljes në kategori, një ka rezultuar praktikë e ekzekutuar dhe është hequr nga databaza,
- 1 praktikë e ekzekutuar

Mbi mos nxjerrjen e akteve të rikthimit nga DAP

Nga auditimi është parë se 8 gjyqfitues të trajtuara nga Komisioni i Posaçëm dhe të finalizuar me propozimet përkatëse, rezultojnë të mos kenë marrë dënim për propozimin e KP dhe rrjedhimisht të mos kenë kthyer përgjigje për një afat përtej atij të parashikuar dhe relativisht të gjatë, që varion mbi 1 vit.

Në lidhje me këtë problematikë grupit të auditimit i është vënë në dispozicion korespondenca shkresore me DAP-in, ku në shkresën nr.8791/1 datë 10.05.2018 DPT sqaron se “Nga ana e Komisionit të Posaçëm konsiderohet i ezauruar zbatimi i dispozitivit të vendimit gjyqësor, për sa i përket të drejtës për rikthim në punë, pasi në përfundim të afateve ligjore, gjyqfituesit nuk janë shprehur në lidhje me pëlqimin apo refuzimin për risistemim në pozicionin e propozuar, apo kanë shprehur mospranim për rikthim.” DAP-i në shkresën nr.8791/2 datë 22.05.2018 për kthim përgjigje sqaron se “Në zbatim të Kodit të Proçedurës Civile dhe Kodit Civil, për gjyqfituesit që refuzojnë apo nuk kthejnë përgjigje kur propozohet sistemimi në një pozicion në të njëjtën klasë page, apo në një klasë më të lartë, DPT në cilësinë e institucionit debitor, duhet të drejtohet gjykatës kompetente duke kërkuar shuarjen e detyrimit sipas disponimit të gjykatës.”

Konstatohet se për 8 ish nëpunës, për të cilët Komisioni i Posaçëm ka bërë propozimet përkatëse brenda të njëjtës kategori, Departamenti i Administratës Publike nuk ka nxjerrë aktet e rikthimit në punë të këtyre ish nëpunësve me motivacionin se pret pëlqimin apo refuzimin e gjyqfituesit. Në Urdhërin nr.5151 datë 28.10.2015, kreu IV, pika 4, përcaktohet qartësisht se “Gjyqfituesi brenda 3 ditësh punë njofton me shkrim KP për pëlqimin apo refuzimin e alternativave të dhëna nga komisioni. Gjyqfituesi jep pëlqimin vetëm për emërimin në një pozicion të një kategorie më të ulët.”

Sa më sipër rezultojnë se për këta ish nëpunës në shkelje të proçedurës së parashikuar DAP-i nuk ka nxjerrë aktet e emërimit, duke shkaktuar kështu edhe vijim të akumulimit të detyrimeve ndaj këtyre gjyqfituesve nga DPT.

Gjithashtu Urdhëri nr.5151 datë 28.10.2015, në Kreun V, sqaron qartësisht veprimet proçedurale që duhet të ndërmarrë DAP-i në momentin e mbërritjes së rekomandimeve nga KP dhe pika 1 sqaron se DAP-i shqyrton akt rekomandimet brenda 15 ditëve punë dhe vendos pranimin ose mos pranimin sipas pikave në vijimësi të urdhërit.

Sa më poshtë, tabela e detajuar e gjyqfituesve të trajtuar nga Komisioni i Posaçëm, të finalizuar me propozime për pozicione brenda të njëjtës kategori dhe për të cilët nuk ka një vendimarrje, akt emërimi apo refuzimi nga DAP-i, situatë e konstatuar edhe në auditimin e kaluar nga KLSH, për të cilën ende nuk ka trajtim.

Ish nëpunës të trajtuar nga KP të finalizuar me propozime brenda të njëjtës kategori dhe pa akt emërimi apo refuzimi nga DAP

Nr.	Emer/Mbiemer	Vitet e trajtimit	Data e P/Verbalit	Pozicioni para largimit nga detyra	Pozicioni propozuar nga KP
1	E B	2017	31.08.2017	kategori page IV-a	kategori page IV-a
2	Q L	2017-’18	31.08.2017	kategori page IV-a	kategori page IV-a
3	S M	2017-’18	31.08.2017	kategori page IV-a	kategori page IV-a
4	B L	2017	26.07.2017	kategori page IV-a	kategori page IV-a
5	L L	2017- ’18	26.07.2017	kategori page IV-a	kategori page IV-a



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

6	L Xh	2017	26.07.2017	kategori page III-b	kategori page III-b
7	G Z	2017-'18	07.03.2018	kategori page III-b	kategori page III-b
8	A P	2017-'18	03.11.2017	kategori page IV-a	kategori page IV-a

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT.

Këto 8 raste janë të mbartura nga viti 2018.

Ndërkohë për vitin 2019 janë shtuar 2 raste të reja pa vendimmarrje nga DAP, për të cilat KP ka propozuar ripozicionim në të njëjtën kategori.

1	Aleksander Lala	Akt rekomandimi DAP shkresa nr. 7395/7 Prot, date 27.11.2019
2	Emiljan Cera	Akt rekomandimi DAP shkresa nr. 7395/6 Prot., date 27.11.2019

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT.

Grupi i auditimit gjykon se mosnxjerrja e akteve në kohë nga DAP mund të shoqërohet me problematikën që vendet që kanë qënë vakante dhe Komisioni i Posaçëm i ka propozuar për plotësim me gjyqfitues, ose të mbeten vakant për një kohë të gjatë në pritje për aktet e DAP ose plotësohen me të rekrutuar të rinj, duke bërë që trajtimi i praktikave nga ana e KP të bëhet i pavlefshëm dhe të kërkoj sërish ritrajtim.

Përvec kësaj problematikë, shqetësuese mbetet ndikimi financiar që këto mosveprime shkaktojnë në buxhetin e shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: DAP, për problematikën në lidhje me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe mosnxjerrjen e akteve për rekomandimet e KP

Gjetja	Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm
Situata	<p>Përgjatë vitit 2019 janë punësuar në DPT 14 gjyqfitues, larguar nga vendimmarrjet e gabuara të titullarëve, ndërkohë që kanë mbetur në fund të vitit 2019 ende të pa trajtuara nga Komisioni i Posaçëm edhe 142 praktika gjyqëfituesish, në shkelje të çdo afati të parashikuar në Urdhërin nr.5151, datë 28.10.2015. Në Urdhërin nr.5151, datë 28.10.2015 2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, përcaktohet se “Shqyrtimi administrativ përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës”. Mosveprimi për rikthimin në punë të punonjësve shkakton një kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit duke qënë se për të njëjtin pozicion pune paguhen dy individë ose më shumë punonjës. Është konstatuar se gjatë vitit 2019 Komisioni i Posaçëm është thirrur vetëm 6 herë nga Kryetari, dhe ka trajtuar vetëm 39 praktika ish nëpunësish dhe nuk është ndjekur radha e trajtimit të praktikave të gjyqfituesve për rikthim në punë.</p> <p>Ky impakt bëhet edhe më domethënës në kushtet kur për periudhën objekt auditimi në DPT paraqitet një numër i lartë vendesh vakante, të cilat në çdo kohë mund të përdoren për sistemimin e ish punonjësve që presin rikthimin në punë sa më shpejt, në mënyrë që të ndalohet akumulimi i shpenzimeve jo efektive.</p> <p>Nga databaza e gjyfituesve të DPT rezulton se 13 ish punonjës <u>kanë përfutur dy paga mujore njëkohësisht nga buxheti i shtetit, një në DPT dhe një nga institucionet që janë emëruar.</u> Këta nëpunës fiurojnë të punësuar gjatë vitit 2019 dhe 2020. Nga këta 13 ish punonjës: <i>1 është rikthyer në punë në DPT, 4 kanë refuzuar për arsye të propozimit me ulje në kategori</i></p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

	<p><i>nga ana e Komisionit të Posaçëm, I nuk ka kthyer ende përgjigje dhe 7 janë ende pa trajtim nga Komisioni i Posaçëm. Kjo problematikë është si rezultat i hapsirave që krijon Ligji nr.152/2013 datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”, Neni 66/1 pika 3 “Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë paguhen sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.” dhe mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë nga ana e DPT-s.</i></p> <p><i>Konstatohet se për 10 ish nëpunës, për të cilët Komisioni i Posaçëm ka bërë propozimet përkatëse brenda të njëjtës kategori, Departamenti i Administratës Publike nuk ka nxjerrë aktet e rikthimit në punë të këtyre ish nëpunësve me motivacionin se pret pëlqimin apo refuzimin e gjyqfituesit. Në Urdhërin nr.5151 datë 28.10.2015, kreu IV, pika 4, përcaktohet qartësisht se “Gjyqfituesi brenda 3 ditësh punë njofton me shkrim KP për pëlqimin apo refuzimin e alternativave të dhëna nga komisioni. Gjyqfituesi jep pëlqimin vetëm për emërimin në një pozicion të një kategorie më të ulët.” Sa më sipër rezulton se për këta ish nëpunës në shkelje të procedurës së parashikuar DAP-i nuk ka nxjerrë aktet e emërimit, duke shkaktuar rritje të akumulimit të detyrimeve ndaj këtyre gjyqfituesve nga DPT .</i></p> <p><i>Gjithashtu Urdhëri nr.5151 datë 28.10.2015, në Kreun V, sqaron qartësisht veprimet proceduriale që duhet të ndërmarrë DAP-i në momentin e mbërritjes së rekomandimeve nga KP dhe pika 1 sqaron se DAP-i shqyrton akt rekomandimet brenda 15 ditëve punë dhe vendos pranimin ose mos pranimin sipas pikave në vijimësi të urdhërit.</i></p> <p><i>Mosnxjerrja e akteve në kohë nga DAP mund të shoqërohet me problematikën që vendet që kanë qënë vakante dhe Komisioni i Posaçëm i ka propozuar për plotësim me gjyqfitues, ose të mbeten vakant për një kohë të gjatë në pritje për aktet e DAP ose plotësohen me të rekrutuar të rinj, duke bërë që trajtimi i praktikave nga ana e KP të bëhet i pavlefshëm dhe të kërkoj sërish ritrajtim.</i></p>
Situata	<p>Përgjatë vitit 2019 janë punësuar në DPT 14 gjyqfitues, larguar nga vendimmarrjet e gabuara të titullarëve, ndërkohë që kanë mbetur në fund të vitit 2019 ende të pa trajtuara nga Komisioni i Posaçëm edhe 142 praktika gjyqfituesish, në shkelje të çdo afati të parashikuar në Urdhërin nr.5151, datë 28.10.2015. Në Urdhërin nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, përcaktohet se “Shqyrtimi administrativ përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës”.</p> <p>Mosveprimi për rikthimin në punë të punonjësve shkakton një kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit duke qënë se për të njëjtin pozicion pune paguhen dy individë ose më shumë punonjës. Është konstatuar se gjatë vitit 2019 Komisioni i Posaçëm është thirrur vetëm 6 herë nga Kryetari, dhe ka trajtuar vetëm 39 praktika ish nëpunësish dhe nuk është ndjekur radha e trajtimit të praktikave të gjyqfituesve për rikthim në punë.</p> <p>Ky impakt bëhet edhe më domethënës në kushtet kur për periudhën objekt auditimi në DPT paraqitet një numër i lartë vendesh vakante, të cilat në çdo kohë mund të përdoren për sistemimin e ish punonjësve që presin rikthimin në punë sa më shpejt, në mënyrë që të ndalohet akumulimi i shpenzimeve jo efektive.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

	<p>Nga databaza e gjyftuesve të DPT rezulton se 13 ish punonjës kanë përfituar dy paga mujore njëkohësisht nga buxheti i shtetit, një në DPT dhe një nga institucionet që janë emëruar. Këta nëpunës fiurojnë të punësuar gjatë vitit 2019 dhe 2020. Nga këta 13 ish punonjës: 1 është rikthyer në punë në DPT, 4 kanë refuzuar për arsye të propozimit me ulje në kategori nga ana e Komisionit të Posacëm, 1 nuk ka kthyer ende përgjigje dhe 7 janë ende pa trajtim nga Komisioni i Posacëm. Kjo problematikë është si rezultat i hapsirave që krijon Ligji nr.152/2013 datë 01.10.2013 “Për Nënpunësin Civil”, Neni 66/1 pika 3 “Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë paguhen sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.” dhe mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë nga ana e DPT-s.</p> <p>Konstatohet se për 10 ish nëpunës, për të cilët Komisioni i Posacëm ka bërë propozimet përkatëse brenda të njëjtës kategori, Departamenti i Administratës Publike nuk ka nxjerrë aktet e rikthimit në punë të këtyre ish nëpunësve me motivacionin se pret pëlqimin apo refuzimin e gjyftuesit. Në Urdhërin nr.5151 datë 28.10.2015, kreu IV, pika 4, përcaktohet qartësisht se “Gjyftuesi brenda 3 ditësh punë njofton me shkrim KP për pëlqimin apo refuzimin e alternativave të dhëna nga komisioni. Gjyftuesi jep pëlqimin vetëm për emërimin në një pozicion të një kategorie më të ulët.” Sa më sipër rezulton se për këta ish nëpunës në shkelje të procedurës së parashikuar DAP-i nuk ka nxjerrë aktet e emërimit, duke shkaktuar rritje të akumulimit të detyrimeve ndaj këtyre gjyftuesve nga DPT.</p> <p>Gjithashtu Urdhëri nr.5151 datë 28.10.2015, në Kreun V, sqaron qartësisht veprimet procedurale që duhet të ndërmerret DAP-i në momentin e mbërritjes së rekomandimeve nga KP dhe pika 1 sqaron se DAP-i shqyrton akt rekomandimet brenda 15 ditëve punë dhe vendos pranimin ose mos pranimin sipas pikave në vijimësi të urdhërit.</p> <p>Mosnxjerrja e akteve në kohë nga DAP mund të shoqërohet me problematikën që vendet që kanë qënë vakante dhe Komisioni i Posacëm i ka propozuar për plotësim me gjyftues, ose të mbeten vakant për një kohë të gjatë në pritje për aktet e DAP ose plotësohen me të rekrutuar të rinj, duke bërë që trajtimi i praktikave nga ana e KP të bëhet i pavlefshëm dhe të kërkoj sërish ritrajtim.</p>
Kriteri	Urdhëri nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”.
Ndikimi/Efekti	Mosveprimi i këtij Komisioni dhe mosmarrja e masave të duhura nga Strukturat Drejtuese, në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore ka shkaktuar për disa vite dhe vazhdon të shkaktojë kosto financiare për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për pasojë ka rënduar padrejtësisht buxhetin e shtetit.
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.5, datë 24.07.2019

E4. Punonjësit me kontratë dhe rregullshmëria e procesit të rekrutimit

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhëri Nr. 5 datë 31.01.2019 Nr.2348 prot datë 31.01.2019, “Për detajimin e nr të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019 të administratës tatimore”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

-VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve buxhetore dhe nënpunësve të disa institucioneve buxhetore, i ndryshuar.

-Urdhërin Nr. 5/1 datë 31.01.2019, Urdhëri Nr. 5/2 datë 14.02.2019, Urdhërin Nr 5/3 datë 07.03.2019.

Nga auditimi është konstatuar se nevojat për staf ndihmës në fazën paraprake të planifikimit janë të pa argumentuara dhe mbështetura në evidencë mbështetëse nga Drejtoritë Rajonale Tatimore për të legjitimuar numrin e kërkuar të punonjësve me kontratë.

Tabela: Planifikimi punonjësve të shërbimit dhe me kontratë në vite.

	VKM nr.16 datë 16.01.2019	Nr.Faktik
Punonjës shërbimi (6muajore)	250	244
Punonjës me kontratë (1 vjeçare)	30	26

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT.

Konstatohet se :

Është miratuar Urdhëri Nr. 5 datë 31.01.2019 Nr.2348 prot datë 31.01.2019, “Për detajimin e nr të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019 të administratës tatimore, sipas të cilit pagesa do të jetë sipas përcaktimeve të VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve buxhetore dhe nënpunësve të disa institucioneve buxhetore, i ndryshuar.

Me Urdhërin Nr. 5/1 datë 31.01.2019, kontratat e punës në DRT lidhen nga Drejtorët e DRT dhe një kopje e tyre niset në DPT.

Me Urdhërin Nr. 5/2 datë 14.02.2019 është bërë ndryshim i detajimit të nr të punonjësve në administratën tatimore.

Me Urdhërin Nr 5/3 datë 07.03.2019 është bërë sërish ndryshim detajimi në nr e punonjësve.

Urdhëri Nr. 5/2 datë 14.02.2019

Institucioni	Nr miratuar total Nr. 5/2 datë 14.02.2019	Punonjës shërbimi miratuar	Punonjës me kontratë miratuar	Nr miratuar total Nr. 5/3 datë 07.03.2019	Punonjës shërbimi miratuar	Punonjës me kontratë miratuar
DPT	31	24	7	31	24	7
DRT Tirana	90	85	5	101	96	5
DTM	17	14	3	17	14	3
DRT Fier	16	14	2	16	14	2
DRT Durrës	23	20	3	23	20	3
DRT Shkodër	28	26	2	23	21	2
DRT Elbasan	11	10	1	9	8	1
DRT Korçë	9	8	1	8	7	1
DRT Vlorë	14	12	2	12	10	2
DRT Lezhë	5	5	-	5	5	0
DRT Berat	9	8	1	8	7	1
DRT Gjirokastrë	9	9	-	9	9	0
DRT Sarandë	6	5	1	6	5	1
DRT Dibër	7	5	2	7	5	2
DRT Kukës	5	5	-	5	5	0
Totali	280	250	30	280	250	30

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT. Përpunuar nga grupi auditimit

Me Urdhërin Nr.13 datë 27.03.2019 është bërë shpërndarja dhe raportimi i punonjësve të shërbimit të emëruar në DPT

Drejtoria	Nr.punonjësish
Drejtoria e Hetimit Tatimor	10
Drejtoria e Burimeve Njerëzore	1
Drejtoria e Administratës dhe Prokurimeve	2
Drejtoria e Marrëveshjeve dhe Koordinimit Ndërinstitucional	1
Total	14

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT

Për punonjësit me kontratë 6-mujore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

✓ 13 prej tyre kanë dhënë dorëheqjen pa mbaruar afati i kontratës, dhe 3 prej tyre janë zëvenduar me 3 punonjës të rinj në vazhdim.

✓ 2 punonjës janë emëruar në pozicion tjetër. 1 prej vendeve vakante është zëvendësuar me punonjës të ri.

✓ 6 punonjës janë zëvendësuar nga 6 të punonjës të rinj brenda muajit të parë të punës.

Në lidhje me punonjësit me kontratë 1-vjeçare

✓ konstatohet një punonjës që ka dhënë dorëheqjen

✓ 2 punonjës janë emëruar në pozicion tjetër pa u mbaruar kontrata 1-vjeçare.

Nga auditimi është konstatuar se nevojat për staf ndihmës në fazën paraprake të planifikimit janë të pa argumentuara dhe mbështetura në evidencë mbështetëse nga Drejtoritë Rajonale Tatimore për të legjitimuar numrin e kërkuar të punonjësve me kontratë. Nga auditimi është konstatuar se puna që kryejnë këta punonjës është e paqartë, e pa përcaktuar mirë dhe pa një përshkrim specifik për punën që duhet të kryej secili prej tyre. Për pasojë vështirësohet edhe një proces i mundshëm i vlerësimit të performancës së tyre nga eprorët përkatës.

Është konstatuar gjithashtu se për këta punonjës nuk ka një procedurë të rregullt ligjore rekrutimi dhe punësimi, që përfshin shpalljen në institucione për pozicionet me kriteret dhe afatet e aplikimit nga të interesuarit, procesin e kualifikimit dhe përzgjedhjes për vitin 2019.

Situata faktike e punonjësve të rekrutuar me kontratë të përkohshme, për vitin 2019 paraqitet si në tabelën në vijim, ku siç evidentohet nga 250 punonjës shërbimi me kontratë 6 mujore të planifikuar janë punësuar 244 dhe nga 30 punonjës me kontratë 1 vjeçare të planifikuar janë punësuar 26 punonjës.

Punonjës shërbimi dhe punonjës me kontratë 2019

Institucioni	6-mujore	1-vjeçare	Fondi i Pagave
DPT	22	7	6,869,414
DRT Tirana	95	3	18,068,827
DTM	14	3	3,387,648
DRT Fier	14	2	3,139,146
DRT Durrës	20	3	4,770,013
DRT Shkodër	21	1	4,784,055
DRT Elbasan	6	1	1,583,576
DRT Korçë	7	1	1,756,458
DRT Vlorë	10	2	2,203,344
DRT Lezhë	5	-	1,002,000
DRT Berat	6	-	1,176,591
DRT Gjirokastrë	9	-	2,134,108
DRT Sarandë	5	1	1,017,440
DRT Dibër	5	2	1,438,661
DRT Kukës	5	-	1,019,764
Totali	244	26	54,351,045

Burimi: Drejtoria e Financës Përpunuar nga grupi i auditimit

Vlera prej 54,351,045 lekë është vlerë që i ka rënduar buxhetit të shtetit për vitin 2019, nisur nga shpjegimet e mësipërme.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka marr masa për përmirësimin e situatës duke kërkuar nga Drejtoritë Rajonale Tatimore një vlerësim të performancës së këtyre punonjësve duke dërguar edhe një format tip, por vetëm një pjesë e drejtorive kanë dërguar informacionin e kërkuar. Referuar e-mailit të datës 31.05.2019, me subjekt “Për shfrytëzimin e kohës së punës nga punonjësit e shërbimit” nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është drejtuar të gjithë drejtorëve rajonale, që të marrin masa për të mbikëqyrur dhe raportuar lidhur me performancën e punët e kryera nga punonjësit e shërbimit.

Me shkresën Nr.17259 Prot datë 17.09.2019 Burimet Njerëzore ka kërkuar nga DRT kërkesa të argumentuara për nevojat për punonjës shërbimi ose me kontratë për vitin 2020. Me shkresën Nr.21943 Prot datë 05.12.2019 i është pregatitur një informacion Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me nevojat që kanë paraqitur DRT. Në informacion thjesht konstatohet një përmbledhje mbi nevojat për punonjës, me një ulje të vogël në nr, nga 250 në 238. Sipas kësaj shkrese nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

ana e Burimeve Njerëzore kërkohet që strukturat drejtuese të marrin në konsideratë edhe rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimet e kaluara në lidhje me këtë problematikë për përmirësimin e situatës. Me e-mailin e datës 09.08.2019, 03.09.2019 dhe 08.07.2020 është kërkuar përsëri vlerësim objektiv performance dhe dërgim kërkesash të argumentuara nga Drejtorët Rajonalë. me Urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, në të cilën përcaktohen qartësisht mënyrat e rekrutimit të kategorive të ndryshme të punonjësve është miratuar Rregullorja “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. Xh C për periudhën 01.01.2019-04.04.2019 në cilësinë e ish Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të DPT

Gjetja	Punonjësit me kontratë të përkohshme
Situata	<p>Për vitin 2019 është konstatuar <u>numër i lartë punonjësish shërbimi me kontratë, kërkesat në planifikim për të cilët janë të pa mbështetura në evidenca</u>. Për rekrutimin dhe emërimin e tyre nuk ka patur një procedurë që të përfshijë shpalljen në institucione për pozicionet me kriteret dhe afatet e aplikimit nga të interesuarit, procesin e kualifikimit dhe përzgjedhjes. Nga 250 punonjës shërbimi me kontratë 6 mujore të planifikuar janë punësuar 244 dhe nga 30 punonjës me kontratë 1 vjeçare të planifikuar janë punësuar 26 punonjës. <i>Vlera e fondit të buxhetit të shtetit me të cilën janë paguar punonjësit me kontratë të përkohshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për Drejtoritë Rajonale Tatimore në vitin 2019 është 54,351 mijë lekë.</i> Nga rekrutimi i punonjësve me kod pune konstatohet se për 9 punonjës në pozicionet arkëtar, protokollist, arkivist, mungon një procedurë e rregullt rekrutimi në të cilën të shpallen vendet vakante, të publikohen kërkesat e përgjithshme dhe pastaj të përzgjidhet fituesi. Këto pozicione janë plotësuar me punonjës të propozuar nga Drejtorët rajonal duke cënauar parimin e transparencës, të drejtës së barabartë të kandidatëve për aplikim dhe përzgjedhje punësimi në vendet vakante. Në lidhje me largimet nga puna përgjatë vitit 2019 janë larguar 11 punonjës nga Drejtoria e Hetimit Tatimor punonjësit e të cilës janë me kod pune. Largimet e punonjësve të Hetimit Tatimor janë kryer në kushtet e trajtimit të pabarabartë në krahasim me punonjësit e tjerë pas ndryshimeve të kriterëve në Rregulloren të bëra me Urdhërin nr.65/2 datë 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”.</p> <p>Në lidhje me largimet me Komision Disiplinor, përgjatë vitit 2019 konstatohen 13 largime nga puna nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, 3 prej të cilëve me status nëpunësi civil dhe 10 punonjës me kod pune. <i>Kjo situatë ka sjell rritjen e çështjeve gjyqësore dhe mundësinë e rritjes së efekteve negative financiare në dëm të buxhetit të shtetit në lidhje me pagesat për largim të padrejtë nga puna, pasi 7 prej tyre janë në proces gjyqësor.</i></p> <p>Nga databaza e punonjësve të larguar nga puna mbajtur nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike konstatohet se janë në proces gjyqësor 187 ish-punonjës, larguar kryesisht në vitet 2014-2019, prej të cilëve 84 me status të nëpunësit civil dhe 103 me kod pune.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Situata	<p>Për vitin 2019 është konstatuar <u>numër i lartë punonjësish shërbimi me kontratë, kërkesat në planifikim për të cilët janë të pa mbështetura në evidenca</u>. Për rekrutimin dhe emërimin e tyre nuk ka patur një procedurë që të përfshijë shpalljen në institucione për pozicionet me kriteret dhe afatet e aplikimit nga të interesuarit, procesin e kualifikimit dhe përzgjedhjes. Nga 250 punonjës shërbimi me kontratë 6 mujore të planifikuar janë punësuar 244 dhe nga 30 punonjës me kontratë 1 vjeçare të planifikuar janë punësuar 26 punonjës. <i>Vlera e fondit të buxhetit të shtetit me të cilën janë paguar punonjësit me kontratë të përkohshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për Drejtoritë Rajonale Tatimore në vitin 2019 është 54,351 mijë lekë.</i> Nga rekrutimi i punonjësve me kod pune konstatohet se për 9 punonjës në pozicionet arkëtar, protokollist, arkivist, mungon një procedurë e rregullt rekrutimi në të cilën të shpallen vendet vakante, të publikohen kërkesat e përgjithshme dhe pastaj të përzgjidhet fituesi. Këto pozicione janë plotësuar me punonjës të propozuar nga Drejtorët rajonal duke cënuar parimin e transparencës, të drejtës së barabartë të kandidatëve për aplikim dhe përzgjedhje punësimi në vendet vakante. Në lidhje me largimet nga puna përgjatë vitit 2019 janë larguar 11 punonjës nga Drejtoria e Hetimit Tatimor punonjësit e të cilës janë me kod pune. Largimet e punonjësve të Hetimit Tatimor janë kryer në kushtet e trajtimit të pabarabartë në krahasim me punonjësit e tjerë pas ndryshimeve të kriterëve në Rregullore të bëra me Urdhërin nr.65/2 datë 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”.</p> <p>Në lidhje me largimet me Komision Disiplinor, përgjatë vitit 2019 konstatohen 13 largime nga puna nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, 3 prej të cilëve me status nëpunësi civil dhe 10 punonjës me kod pune. <i>Kjo situatë ka sjell rritjen e çështjeve gjyqësore dhe mundësinë e rritjes së efekteve negative financiare në dëm të buxhetit të shtetit në lidhje me pagesat për largim të padrejtë nga puna, pasi 7 prej tyre janë në proces gjyqësor.</i></p> <p>Nga databaza e punonjësve të larguar nga puna mbajtur nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike konstatohet se janë në proces gjyqësor 187 ish-punonjës, larguar kryesisht në vitet 2014-2019, prej të cilëve 84 me status të nëpunësit civil dhe 103 me kod pune.</p>
Kriteri	Ligji nr.7961 datë12.07.1995 “Kodi punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr.60 datë 31.01.2018.
Ndikimi/Efekti	Kosto e lartë shtesë për buxhetin e shtetit për punë të pa evidentuar dhe të pa matur
Rëndësia	I Lartë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.4, datë 24.07.2019

Për problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit, ka ardhur observacion nga z.E D, në cilësinë e ish Titullarit të DPT, si në vijim:

“Jam bërë me dije për akt konstatimet tuaja në DPT më datë 03.08.2020 nëpërmjet Postës Shqiptare . Më lejoni të shpreh komentet e mia si më poshtë.

Komente mbi Akt Konstatimi Nr.4



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Si anëtar i komisionit të rishtrukturimit në ndjekje të urdhrit Nr.171, datë 13.05.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për rishtrukturimin shpjegoj se lëvizja e punonjësve me status nëpunësi civil janë kryer sipas nevojës së institucionit për përmbushjen e detyrave funksionale, një nga parimet e ndjekura për rishtrukturim. Komisioni ka të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore të respektojë procedurat si dhe t'i përgjigjet nevojës institucionale.

Referuar procesit të rishtrukturimit, kemi kërkuar të përmbushim rekomandimet e FMN për optimizimin e strukturës. I gjithë personeli i përfshirë në procesin e rishtrukturimit është angazhuar maksimalisht për të respektuar afatet kohore duke njoftuar (si dhe unë personalisht në pozicionin e titullarit të institucionit në periudhën referuese) në qasje ballë për ballë të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor për ndryshimet në strukturë si dhe për mundësinë e largimit nga puna në rast të mospërmbushjes së kriterëve. Për rregulloren e brendshme, të ndryshuar datë 14.05.2019, u ngit një grup pune për të përcaktuar kriteret e pranimit për çdo pozicion pune në strukturën e Hetimit Tatimor dhe më gjerë duke ruajtur heterogjenitetin e specifikave teknike të njëjësive monitoruese në terren. Përveç formimit Ekonomist dhe Jurist, shpesh herë, për arsye teknike nevojitej edhe njohuri në fusha të tjera.

Bazuar në afatet kohore ligjore në respektim të kodit të punës, si dhe në përputhje me rregulloren e brendshme që specifikon kriteret për çdo pozicion pune në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, përpara se të firmosja largimet nga puna, Drejtoria e Burimeve Njerëzore më ka njoftuar që janë 11 persona të cilët nuk përmbushin kriteret e nevojshme. Në këto kushte, si dhe me firma bashkëshoqëruese nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore (përkatësisht specialist, përgjegjës sektori, dhe drejtor drejtorie si konceptues, pranues dhe miratues), të cilat garantonin mbarëvajtjen procedurale të dokumentuar në protokollin e Institucionit, kam firmosur largimin e tyre nga puna sipas të gjitha procedurave ligjore në dispozicion si dhe duke respektuar afatin e njoftimit.

Më lejoni të theksoj se nga ana ime si Titullar Institucioni nuk ka pasur asnjë element diskriminimi në vlerësimin e personave të larguar, përvec respektimit të procedurave dhe akteve ligjore të miratuar. Unë deklaroj se, as nuk kam pasur lidhje, njohje apo çfarëdo lloj marrëdhënie apo tendence me personat e larguar dhe as nuk kam pretenduar të kem tilla.

Si përfundim, nuk bie dakort me përgjegjësinë e ngarkuar për largimin e personave! Zgjidhja e kontratës ka pasur të gjithë elementët e nevojshëm dhe mjaftueshëm juridik, rishtrukturim, njoftim dhe respektim i afateve. Nëse persona që janë larguar përmbushin kriteret atëherë kjo është një çështje që i takon Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të cilat kanë detyrë funksionale ndjekjen e procedurave dhe vlerësimeve!

Në këtë akt konstatim KLSH ka interpretuar se kontratat për 244 punonjës me kontratë 6-mujore dhe 26 punonjës me kontratë 1-vjecare nuk janë të argumentuara. Dëshiroj të theksoj se këto kontrata nuk janë firmosur nga unë si dhe të gjitha vendet e punës nuk janë specifikuar gjatë periudhës prill-Qershor 2019 që përkon dhe me periudhën që unë kam mbajtur postin e Dr. të përgjithshëm.

Lidhur me delegimet gjatë periudhës Prill-Qershor 2019 ju bëj me dije se nevoja kushtëzuese për përmbushjen e objektivit kryesor të administratës tatimore, siç është realizimi i të ardhurave tatimore, detyronte marrjen e këtij vendimi. Dëshiroj të kujtoj se gjatë periudhës Prill-Qershor 2019 administrata tatimore u përball me një sfidë të vërtetë në realizimin e dy planeve që krijojnë konkurrencë me njëra tjetrën, nga njëra anë realizimi i të ardhurave tatimore dhe ana tjetër filloi të realizohej plani i rimbursimit të TVSH-së. Realizimi i tyre u bë një sfidë edhe më e madhe kur faktorë të jashtëm në ambientin ekonomik dhe social ndikonin negativisht. Vetëm puna e palodhur, përkushtimi, integriteti dhe bindja se realizimi i planit ishte kusht i panegociueshëm bënë të mundur arritjen e këtij objekti.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Lidhur me rikthimet në punë të gjyqfituesve, Gjatë periudhës Prill- Qershor 2019 patëm filluar këtë proces pa shpallur vende vakante. Më shumë se 5 persona janë rikthyer në vendet e punës gjatë kësaj periudhe dhe ekzistojnë dokumente të protokolluara në Institucion për këtë. Në përfundim, dëshiroj të theksoj se shumë nga problematikat e konstatuara nga KLSH nuk janë shfaqur gjatë periudhës 04 Prill - 12 Korrik, periudhë në të cilën kam mbajtur postin e Dr. Përgjithshëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi auditimit pas shqyrtimit të observacionit sqaron se pavarësisht rolit të komponentëve të tjerë sic janë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit apo të Burimeve Njerëzore, kjo nuk ju heq përgjegjësinë që funksioni si Titullar i Institucionit ju ka dhënë për periudhën 4 prill – 12 korrik 2019. Megjithatë grupi auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionin, nisur nga koha e kufizuar e qëndrimit në rolin Tuaj si Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, veçanërisht për problematikat në lidhje me rikthimin e gjyqfituesve në punë dhe punonjësit me kontratë të përkohshme.

Për sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

Për problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit është dërguar observacion me nr 333/10 prot datë 25.09.2020, nga znj.D I, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, si në vijim:

- Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qëndrore nuk ka qenë ndryshuar, për shkak se administrata tatimore qëndrore ka qenë në proces rristurimi të plotë. Aktualisht pas implementimit të strukturës së re organizative është miratuar Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qëndrore, me Urdhër nr. 193, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

- Në momentin e marrjes së detyrës, Administrata Tatimore Qendrore ndodhej në proces rristurimi në zbatim të Urdhrit nr. 86/2019 të Kryeministrit, procedurë e Cila ka përfunduar në muajin Nëntor 2019. Referuar dhe në respektim të dispozitave ligjore, në procedurë rristurimi të një Institucioni Shtetëror prioritet kanë nëpunësit civil aktualë në marrëdhënie punësimi me institucionin, për t'u sistemuar në pozicione pune në përputhje me kushtet e kriteret e pozicionit te punës dhe më pas në përfundim, në momentin e pasqyrimit të vakancës vijohet me shqyrtimin e praktikave gjyqësore për ekzekutim.

Pra, ekzistojnë disa fakte dhe rrethana të cilat kushtëzojnë ekzekutimin e praktikave gjyqësore:

Ushtrimi i detyrave funksionale, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, në vitin kalendarik 2019, Objekt kontrolli vetëm për një periudhë 5.5 muaj

Procedura e rristurimit

Urdhërime dhe detyra të rëndësishme, të lindura dhe krijuara për shkak të situatave të krijuara në vend.

Nga vetë grupi i auditimit, konstatohet se përgjatë vitit 2019 janë trajtuar 39 praktika gjyqësore. Në shqyrtim të fakteve rezulton se, rreth 28 praktika gjyqësore edhe pse në kushtet e sipërcituara janë trajtuar në periudhën kohore të vitit 2019, në të cilën Komisioni i Posaçëm drejtohej prej titullarit aktual.

- Respektimi i rradhës së ekzekutimit ndiqet dhe zbatohet nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës. Për veprime apo mosveprime konkrete të strukturës përgjegjëse të varësisë përgjegjësia nuk mund të jetë e titullarit të institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, vlerëson miratimin e Rregullores së re edhe pse me vonesë, duke sjell dhe njëherë në vëmendje se vet procesi i Ristrukturimit të DPT ka përfunduar jashtë afateve të parashikuara ligjore. Në lidhje me pagesat e gjyqfituesve sqarojmë se urdhër shpenzimet janë me firmë të dyfishtë, nga ana e nënpunësit zbatues dhe autorizues. Konstatohet gjithashtu se nuk është bërë publik grafiku i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

pagesave, sipas paraqitjes së kërkesave për ekzekutim nga ana e gjyqfituesve, në respektim të kuadrit dhe udhëzimeve ligjore. Megjithatë grupi i auditimit vlerëson ngritjen e grupit të punës nga ana juaj për evidentimin, analizimin dhe saktësimin e dosjeve dhe praktikave të gjyqfituesve. Gjithashtu merr në konsideratë dhe faktorët kufizues në lidhje me problematikat e paraqitura në periudhën korrik-dhjetor, në cilësinë si Drejtor i Përgjithshëm i DPT. Për sa më sipër observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë.

Në lidhje me konstatimin e rekrutimit të punësimit pa plotësuar kriteret e pozicionit të punës ka ardhur observacion nga z.E C me nr 333/12 prot datë 09/10.2020, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse si në vijim:

“...Bashkëlidhur po ju dërgoj një korrespondencë me Departamentin e Administratës Publike ku evidentohen kriteret e shpallura nga DAP në lidhje vendin vakant Përgjegjës i Sektorit të Administratës në Drejtorinë e Administratës dhe Prokurimeve

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit e merr në konsideratë observacionin tuaj në lidhje me plotësimin e kriterëve të vendit të punës sipas shpalljes së kriterëve nga DAP, por sqaron se ky konstatim ka ardhur si rezultat i mospërputhjes së kriterëve të kërkuara nga ana e strukturave tatimore për këtë pozicion dhe përshkrimit të punës, problematikë e trajtuar edhe në raport në lidhje me mospërputhjen e kriterëve mes këtyre 2 komponentëve.

Për sa më sipër observacioni juaj pranohet si sqarim (pa qënë pjesë e personave të ngarkuar me përgjegjësi, por të përmendur në material për arsyen e lartpërmendur).

DREJTIMI F: Vlerësimi i funksionimit të sistemeve menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar. Përputhshmëria ligjore, analiza dhe vlerësimi i auditimit të brendshëm

F.1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit paraqitet si vijon:

1. Strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Politikat institucionale të DPT-së janë bazuar në "Strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën 2017-2021". Strategjia parashikon që në pesë vitet e ardhshme të vijoje përmirësimi i shërbimeve të ofruara ndaj tatimpaguesit duke u mbështetur në modelin e përmbushjes vullnetare. Objektivat dhe masat për zbatimin e misionit të Administratës Tatimore Qendrore, mbështeten në bindjen se përmbushja vullnetare mundësohet vetëm atëherë kur të gjitha funksionet për shërbimin ndaj tatimpaguesit, kontrollit tatimor dhe mbledhjes së detyrimeve të prapambetura do të trajtohen si një tërësi veprimesh të ndërvarura dhe të mbështetura në modelin e menaxhimit të riskut.

2. Për vitin 2019 rezulton të jetë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhrin e Titullarit të Institucionit nr.4, datë 29.01.2019, i kryesuar nga Titullari i Institucionit dhe në cilësinë e anëtarëve janë caktuar nëndrejtorët e Përgjithshëm, NZ dhe të gjithë menaxherët e nivelit të lartë drejtues si dhe Drejtori i DAB në rolin e vëzhguesit, veprim ky në përputhje me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 dhe kreut II, pika 2.2.6 të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, nënvizohet se:

“GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike”.

Dokument i GMS është plani i veprimit i MFK miratuar dhe dërguar në MFE me shkresën nr.22613/1, datë 03.02.2020.

Me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.185, datë 17.05.2019 janë ngritur grupet e menaxhimit të programeve buxhetore për MFE, pjesë e së cilës është edhe grupi i menaxhimit të programit “Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore” që i përket DPT.

3. Nga auditimi i kryer në lidhje me politikën, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet e politikës vijuese të dala në zbatim të tij, konstatohet se:

DPT ushtron veprimtarinë mbështetur në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”.

Në dokumentin Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, rregullat e përgjithshme, rregullat e administrimit, funksionet dhe detyrat e çdo hallke dhe niveli.

Referuar Manualit të MFK, struktura organizative është korniza me anë të cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Struktura duhet të jetë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësisë dhe misionin e saj, duhet të vlerësohet kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme. Për vitin 2019 rezulton që struktura organizative e DPT-së të ketë pësuar dy herë ndryshime, me Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 dhe Urdhrin nr.86, datë 03.05.2019.

Ndryshimet strukturore konsistojnë në shkurtimin me 57 të numrit të përgjithshëm të punonjësve të DPT-së, drejtori/sectorë që nuk janë pjesë e strukturës ekzistuese si dhe ndryshime në emërtime strukturash.

Duke analizuar dhe krahasuar emërtimet dhe pozicionet e rolet e vendosura në Rregulloren e Funksionimit të DPT me ato në strukturat e miratuara nga Kryeministri me Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 dhe Urdhrin nr.86, datë 03.05.2019, konstatohet mungesë harmonizimi i këtyre akteve dhe dispozitave (rregullores dhe strukturës së miratuar).

Konstatim: *Disa pozicione dhe emërtesa funksionesh dhe pozicionesh të përfshira dhe referuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 nuk përputhen ose nuk janë më pjesë e strukturës së miratuar me Urdhret e Kryeministrit nr.49, datë 27.02.2019 dhe nr.86, datë 03.05.2019. Ndryshimet strukturore nuk janë reflektuar me ndryshime të rregullores.*

Konkretisht:

<i>Emërtesa/pozicioni ose funksioni sipas Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore</i>	<i>Emërtesa/ pozicioni ose funksioni sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me Urdhrin nr.86, datë 03.05.2019 (ndryshimi i fundit i strukturës).</i>
Spektori i Përbushjes në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut	Spektori i Hartimit të Strategjisë për Trajtimin e Risqeve në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut
Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional: -Spektori i Marrëveshjeve Ndërkombëtare	Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional: -Spektori i Marrëveshjeve për eliminimin e taksimit të dyfishtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.	Kjo Drejtori nuk është më pjesë e strukturës dhe organigramës së ATQ. Në zbatim të VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar”
Drejtoria e Mbledhjes me Forcë	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara
Drejtoria e Kontrollit Tatimor: -Sektori i Transferimit të Cmimit	Drejtoria e Kontrollit Tatimor: -Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave
Drejtoria e Hetimit Tatimor me këta sektorë: -Sektori i Analizës -Sektori i Hetimit -Sektori i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave -Sektori i Zbatimit (Task Forcës) me Zyrën e Monitorimit dhe Koordinimit	Drejtoria e Hetimit Tatimor me këta sektorë: -Sektori i Hetimit Tatimor -Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës -Sektori i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave -Sektori i Monitorimit dhe Kundërvajtjeve Administrative me: a)Zyrën e Veprimeve në Terren dhe Masave Administrative b)Zyrën e Monitorimit dhe Koordinimit

Përfundimi:

Për sa më sipër, bëhet e domosdoshme rishikimi i Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore në drejtim të reflektimit në të ndryshimeve strukturore që ka pësuar DPT, miratuar nga Kryeministri me Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 dhe Urdhrin nr.86, datë 03.05.2019.

4. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ), si vijon:

Me shkresën nr.33137, datë 03.10.2016 të Ministrisë së Financave është caktuar NA për DPT znj.V V, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së për periudhën 03.10.2016-27.03.2019

Me shkresën nr.5551/1, datë 04.04.2019, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është caktuar NA për DPT, z.E D, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së për periudhën 04.04.2019-18.07.2019.

Me shkresën nr.13628/1, datë 18.07.2019, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është caktuar NA, për DPT, znj.D I, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së.

Me shkresën e MF nr.2192/1, datë 27.02.2017, është caktuar Nëpunës Zbatues për DPT, znj D C, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës. Në funksion të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nëpunësi zbatues, është niveli menaxherial në vartësi direkte të NA. Në funksionet e tij, Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Aktualisht znj. C kryen funksionet e përcaktuara më sipër dhe është në vartësi direkte të NA. Sa më sipër, janë përmbushur kërkesat e Nenit 12/1, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar.

5. Nga ana e DPT janë përgatitur Pyetëtori i Vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së (aneksi 6) i Manualit të MFK –së dhe Plani i Veprimit të MFK-së për vitin 2019 (Aneksi 8), dokumente të cilët janë përcjellë në MFE me shkresën nr.22613/1, datë 03.02.2020. Pyetëtori i Vetëvlerësimit është plotësuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me urdhrin nr.117, datë 01.04.2019 dhe elementet sipas vlerësimit paraqiten të strukturuar kundrejt modelit COSO. Nga 97 pyetje pyetëtori nuk u jep përgjigje 13 pyetjeje, ose 13.4% të pyetjeve gjithsej.

Nga auditimi rezulton se, nga ana e NA të DPT-së nuk është hartuar dhe dorëzuar brenda afateve ligjore Deklarata e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Raporti Vjetor i Cilësisë dhe Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “deklarata



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti i dërgohen Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave”.

Konstatim

Nuk janë hartuar Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 1, të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar që përcakton se nëpunësi autorizues i njësisë publike së bashku me deklaratën mbi SKB paraqet raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm.

Sa sipër nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e:

-nenit 18, pika 1, të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, Manualit të MFK, kapitulli III, pika 3.5 “Deklarata dhe Raporti Vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm”, që përcakton se:

“Çdo vit, NA i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të përgatisë një deklaratë dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te NPA në MFE. Raporti së bashku me deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të dorëzohet deri në fund të shkurtit dhe mbulon vitin e kaluar financiar (janar-dhjetor). Informacioni i dhënë në raportin vjetor duhet të jetë në përputhje me deklaratën. Në fakt, deklarata ofron një përmbledhje të konkluzioneve të raportit vjetor. Përmes raportit vjetor, subjektet e raportimit raportojnë te DH/MFK për funksionimin e sistemit të MFK-së sipas komponentëve të tij”

-detyrimet e pikës nr.17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

6. Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të DPT, parashikuar në pikën 8, neni 8, të Ligjit nr.10296 dhe nenin 3 të Rregullores “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 konstatohet se kanë gjetur zbatim detyrimet që lidhen me:

-Përgatitjen e planit strategjik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të objektivave për ATQ, dhe monitorimin e zbatimit të tij;

-Përgatitjen dhe miratimin e planit vjetor të punës dhe planit të të ardhurave tatimore për cdo DRT;

-Miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve;

-Vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, etj.. Në lidhje me strukturën është përgjegjësi menaxheriale e titullarit propozimi i një strukture të përshtatshme organizative, për vitin 2019 struktura ka pësuar dy herë ndryshime.

Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se:

Procedurat e buxhetimit kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

Nga ana e NZ të DPT është përgatitur dokumenti përfundimtar i buxhetit detyrim ky që rrjedh nga: Përcaktimet e pikës 3 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

“Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:...përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë ku punojnë”.

Nga analiza e sistemit të kontrolleve të kontabilitetit rezultoi:

Janë hartuar rregullat bazë për organizmin kontabël dhe administrimin e pasurisë. Veprimet financiare janë autorizuar sipas rregulloreve dhe veprimet janë regjistruar e dokumentuar rast pas rasti. Mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël është mbështetur mbi bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

-Me Urdhrin nr.21428, datë 22.11.2019 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të DPT dhe magazinave të saj për vitin 2019” është ngritur komisioni i inventarizimit me 5 punonjës.

-Me Urdhër të Titullarit nr.21428/2, datë 17.02.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” është ngritur komisioni i vlerësimit me 5 punonjës. Kryetar i këtij komisioni është caktuar NZ, në përputhje me përcaktimet e pikës 99 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

7. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se në DPT është hartuar regjistri i riskut duke përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të Ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, por nga analiza e regjistrit të riskut konstatohet se :

➤ Për 65 nga 72 risqe të identifikuar, ose në 90% të rasteve nuk është parashikuar ndryshimi në risk nga detyra e fundit;

➤ Në 28 nga 72 raste, ose në 39% të rasteve, niveli i risqeve pas kontrolleve ekzistuese paraqitet në nivele të pandryshueshme;

➤ Në 7 nga 72 raste, ose në 10% të rasteve, kontrollet e vendosura për reduktimin e riskut janë përshkruar gabim;

➤ Në 3 nga 72 raste, ose në 4% të rasteve, niveli i risqeve pas kontrolleve ekzistuese është shtuar në përkeqësim, gjë që kërkon një punë më të kujdesshme nga hartuesit dhe miratuesit e tij.

Më të detajuara parregullsitë e konstatuara janë trajtuar në akt konstatimin nr.9, datë 24.07.2020.

8. DPT në zbatim të detyrimeve të neneve 8 (pika 8/a), 10, 21(pika 2) dhe 27 të Ligjit nr.10296/2010, si dhe përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik të njësisë publike, ka hartuar cdo vit regjistrin e riskut si dhe plan-veprimin për arritjen e objektivave.

9. Grupi i auditimit konstaton se në institucion ka dhomë të serverave, administrimi i të dhënave kryhet nga AKSHI. Sistemi i teknologjisë së informacionit siguron një procedurë për hedhjen e të dhënave (data base) në një sistem rezervë, automatik e të sinkronizuar (backup), gjë që mundëson ruajtjen dhe administrimin e informacionit. Ka një rregullore të vecantë për mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të informacionit.

10. Nga ana e DPT zbatohen rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e aktiveve, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa “ç”, të Ligjit nr.10296/2010. Në pajtim me detyrimet e pikës nr. 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,i ndryshuar, titullari i njësisë publike ka miratuar rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar regjistri i aseteve, detyrim nga pika nr.26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr.30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, janë iniciuar procedurat e inventarizimit të pasurisë dhe të drejtave e detyrimeve 1 herë në vit, sipas urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT.

11. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 16, të Ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, ku shprehimisht përcaktohet:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”.

Grupi i auditimit sjell në vëmendje se:

Sipas cilësimeve të pikës nr.19, neni 4 të Ligjit:

“Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. “

Sipas kreut 3.3. “Aktivitetet e kontrollit” të Manualit të MFK

“ Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit (Shih Aneksin nr.4) jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione... Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Përgjegjësia për miratimin e gjurmës së auditimit i takon titullarit. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga manaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to. Gjurmët e auditimit duhet të përfshijnë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

12. U verifikua zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016), mbi përgatitjen e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës. Në DPT janë hartuar manuale që garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Auditimi i KLSH-së vëren se:

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

a. Vendosja e objektivave

Për periudhën objekt auditimi, DPT ushtron veprimtarinë mbështetur në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Për vitin 2019, janë kryer takime periodike të EMP (takime mujore dhe tre mujore) me stafin menaxherial mbi diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe janë trajtuar disa aspekte të risqeve. GMS referuar minutave të takimit rezulton se ka hartuar raportime periodike mbi menaxhimin e risqeve brenda njësisë publike. Gjithashtu në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Urdhërit nr.16, datë 02.03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve “Për ngritjen e komiteteve të menaxhimit të DPT si dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit të grupeve të përhershme të punës”, janë ngritur dhe funksionojnë tre komitete (Komiteti i Reformave; Komitetit i Përmbushjes dhe Komiteti Operacional).

b. Etika personale dhe profesionale.

DPT në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren e brendshme dhe atë të personelit. Nga ana tjetër, në lidhje me zbatimin e Parimit 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”, dhe se “Menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë” hartuar sipas standardeve ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, konstatohet se nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit e DPT, konstatohet se këto norma janë përcaktuar në Kodin e Etikës për punonjësit e Administratës Tatimore Qendror, konform përcaktimeve të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”.

c. Struktura organizative.

Për periudhën objekt auditimi institucioni ka ushtruar funksionet nëpërmjet strukturës organizative, miratuar me: Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”; Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, si dhe Urdhrin nr.171, datë 13.05.2019. Konstatohet një numër i konsiderueshëm emërimesh dhe largimesh nga detyra përgjatë periudhës së auditimit, 11 prej tyre nga Drejtoria e Hetimit, konstatuar në kushtet e trajtimit të pabarabartë kundrejt punonjësve të tjerë të mbajtur në punë.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Referuar rregullores së funksionimit të administratës tatimore qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, është detyrë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT të ndjekë, zbatojë dhe sigurojë procedura për rekrutim, zhvillimin profesional dhe motivimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim arritjen e objektivave të institucionit. Është po kjo drejtori e cila përgatit akt-emërimet, akt-largimet dhe kontratat e punës për të gjithë punonjësit e Administratës Tatimore në bazë të kërkesave ligjore në vijim të vendimeve të Departamentit të Administratës Publike dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe menaxhon procedurat e rekrutimit dhe të emërimit, të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele në përputhje me Ligjin për Statusin e Shërbimit Civil, Ligjin e Procedurave Tatimore, Kodin e Punës dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe akteve të tjera nënligjore. Manuali i MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, nr.108, datë 17.11.2016,

Në lidhje me strukturat organike ka vendosur si parakushte :

•Një procedure transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

• *Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;*

• *Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;*

• *Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;*

Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit. Nga ana e DPT nuk ka një planifikim të nevojave për punonjës me kontratë të përkohshme, nuk është realizuar një procedurë transparente për rekrutimin në punë të tyre, nuk janë hartuar kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale për kandidatët.

Punonjësit e DPT për vitin 2019 i janë nënshtruar një sërë trajnimesh si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Me vendimin nr.2, datë 08.01.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar programi vjetor me nr.327 prot datë 08.01.2019. Trajnimet menaxhohen nga Bordi i Akademisë Fiskale pranë MFE dhe i gjithë procesi kryhet nga QTATD. Trajtime janë kryer edhe nga ASPA ku çdo nëpunës civil aplikon nëpërmjet linkut që dërgon ASPA.

Në total për vitin 2019 janë trajnuar brenda vendit 1,430 punonjës nga të cilët, 470 punonjës të rinj, 210 drejtues dhe 750 punonjës ekzistues. Gjatë vitit 2019 janë kryer 23 trajtime jashtë vendit në të cilat kanë marrë pjesë 46 punonjës me një kosto 14,860 euro.

Nga ana e DPT, rezulton të jenë kryer vlerësime vjetore të punës për punonjësit me status të nëpunësit civil, punonjësit me kod pune si dhe për studentët e ekselencës (2 herë në vit) lidhur me detyrat që ata kryejnë, në përputhje me përcaktimet e rregullores së brendshme.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale DPT disponon plane të trajnimeve (sidomos për legjislacionin tatimor), dhe disponon një data base mbi trajnimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, në respektimin e kërkesave të pikës 3/1, nënçështja “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016, janë konstatuar parregullsi në drejtim të rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme. Për vitin 2019, janë punësuar në total 280 punonjës me kontratë të përkohshme në nivel DPT dhe DRT, pagesa e të cilëve në shumën totale prej 54,351,045 lekë, I ka rënduar buxhetit të shtetit, duke qenë se ka munguar evidence në lidhje me punën e tyre dhe nevojat e Institucionit për këta punonjës. Është konstatuar se puna që kryejnë këta punonjës është e paqartë, e papërcaktuar dhe pa një përshkrim specifik.

Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime të dedikuara për stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimit të fondeve publike së njësisë menaxhuese.

Vlerësimi i riskut (a bën njësia vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar në analiza etj).

-Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në DPT, janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontroleve ekzistuese dhe nevojave për kontrole të reja, është hartuar dhe është përditësuar cdo vit regjistri i risqeve, është caktuar koordinatori i risqeve si dhe është hartuar plani i veprimit për MFK.

Auditimi konstaton se:

Vlerësimi i riskut është një proces i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë nga audituesit. Për vitin 2019 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhrin e Titullarit të Institucionit nr.4, datë 29.01.2019. Për natyrën e veçantë të këtij Institucioni, koncepti i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

“Manaxhimit të Riskut” dhe vendosjes së kontrolleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e DPT.

Aktivitetet e kontrollit: *(a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të papajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet të plota, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj).*

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi lidhur me menaxhimin e aktiveve. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat. U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve dhe inventarizimin e tyre.

Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit excel dhe në programin financiar ALPHA.

“Veprimtari të kontrollit”, përkufizohen si kontrolle para faktit dhe pas faktit. Ato përfshijnë kontrollin e ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë dhe marrin parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Nga auditimi është konstatuar në disa raste mungesa e kontrolleve para faktit e cila ka sjellë shpenzime në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi në zërin paga në total në shumën 1,552,000 lekë (nga e cila 405,000 lekë në vitin 2019) dhe në zërin shpenzime udhëtim e dieta në shumën 110,900 lekë si dhe mungesa e kontrolleve pas faktit (auditimi i brendshëm) i cili nuk i ka audituar këto fusha e për rrjedhojë nuk i ka konstatuar këto parregullsi.

Informacioni dhe Komunikimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato). Titullari informohet nga drejtuesit e strukturave, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. NZ raporton periodikisht tek nëpunësi autorizues, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin në funksion të realizimit të objektivave. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme. Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka shfaqur probleme në drejtim të koordinimit midis strukturave midis strukturave.

Sistemi i IT-së është i pajisur me një sistem rezervë (backup) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ri përfitim të tyre, në rast aksidenti për shërbimet financiare.

Monitorimi (a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuar se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).

Në DPT është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e strukturave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike janë dërguar në MFE dhe në faqen zyrtare të DPT publikohet një përmbledhje vjetore e realizimit të fondeve buxhetore.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që: Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në DPT ka shfaqur probleme në drejtim të: mungesës së harmonizimit të akteve dhe dispozitave që rregullojnë kryerjen e aktivitetit të njësisë (rregullores dhe strukturës së miratuar); mos hartimit të dokumenteve që vlerësojnë cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme (Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm); mos hartimit dhe mos dokumentimit të gjurmëve të auditimit si instrumente menaxhimi. Sistemi i MFK ka shfaqur dobësi në kontrollet menaxheriale, të tilla si: pamjaftueshmëri e masave shtrënguese në mbledhjen e borxheve, si rrjedhojë e së cilës, në fund të vitit 2019, debitorët për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

sigurimet shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë në shumën 18.7 miliard lekë, nga ku 4.2 miliard lekë është borxh i ri i krijuar gjatë vitit 2019;

Pamjaftueshmëri e kontrolleve para dhe pas faktit të cilat kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zërin paga, në total, në shumën 1,552,000 lekë (nga e cila 405,000 lekë në vitin 2019) dhe në zërin shpenzime udhëtim e dieta në shumën 110,900 lekë; mungesës së transparencës në procedurat e rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme, mungesës së trajnimeve të dedikuara për stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor të cilat do të shërbejnë për rritjen e efikasitetit dhe efencës në realizimin e objektivave dhe menaxhimin e fondeve publike të njësisë.

Gjetja nr.	Problematika të shfaqura në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Situata	<p>Për periudhën objekt auditimi, sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në DPT ka shfaqur probleme në drejtim të: mungesës së harmonizimit të akteve dhe dispozitave që rregullojnë kryerjen e aktivitetit të njësisë (rregullores dhe strukturës së miratuar); moshartimit të dokumenteve që vlerësojnë cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme (Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm) në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, pika 1, të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar; moshartimit dhe mosdokumentimit të gjurmëve të auditimit si instrumente menaxhimi, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 16, të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar. Sistemi i MFK ka shfaqur dobësi në kontrollet menaxheriale, të tilla si: pamjaftueshmëri e masave shtrënguese në mbledhjen e borxheve, si rrjedhojë e së cilës, në fund të vitit 2019, debitorët për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë në shumën 18.7 miliard lekë, nga ku 4.2 miliard lekë është borxh i ri i krijuar gjatë vitit 2019;</p> <p>Pamjaftueshmëri e kontrolleve para dhe pas faktit të cilat kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zërin paga, në total, në shumën 1,552,000 lekë (nga e cila 405,000 lekë në vitin 2019) dhe në zërin shpenzime udhëtim e dieta në shumën 110,900 lekë; mungesës së transparencës në procedurat e rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme, mungesës së trajnimeve të dedikuara për stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor të cilat do të shërbejnë për rritjen e efikasitetit dhe efencës në realizimin e objektivave dhe menaxhimin e fondeve publike të njësisë.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.</p> <p>Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.</p> <p>Rregullore për Funksionimin e ATQ, miratuar me Urdhërin e Ministrisë të Financave nr.19, datë 22.02.2017.</p> <p>Urdhri i Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	Përdorimi i fondeve publike jo me ekonomi efektivitet dhe efencë.
Rëndësia	I Lartë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Për sa trajtuar më sipër u mbajt akt konstatimi nr.9, datë 24.07.2020.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4,16 & 18, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, pikës 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011, si dhe përcaktimeve të Manualit për MFK-në, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, përgjegjësi mbajnë:

- 1. Znj.D I, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së për periudhën 18.07.2019-31.12.2019;*
- 2. Z.E D, në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së për periudhën 04.04.2019-18.07.2019;*
- 3. Z.Xh C në cilësinë e ish zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Hartimit të Programeve.*

F.2 Përputhshmëria ligjore, analiza dhe vlerësimi i auditimit të brendshëm

Për auditimin e kësaj çështje u shqyrtua dokumentacioni i administruar nga DAB, si vijon: Plani strategjik, Plani vjetor 2019, Raporti vjetor i aktivitetit të DAB, 2 Dosje auditimi, shkresa dhe informacione të dhëna nga kjo drejtori.

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, duhet të kryhet në përputhje me: a) Standardet Ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të njohura dhe të zbatuara në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara nga Ministri i Financave;

a) Këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

b) Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës, Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Ministri i Financave si dhe akte të tjera për kryerjen e shërbimit të auditimit, pra zbatimi i standardeve është detyrim ligjor.

Nga auditimi i veprimtarisë së DAB është konstatuar se:

- Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara në dokumentet themeluese të njësisë, siç janë Karta e Auditimit dhe Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të ATQ, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017. Karta e Auditimit, është miratuar nga Titullari i Institucionit, me Urdhrin nr.72, dat 24.09.2020 , pas përfundimit të auditimit të ushtruar në DPT.

- Njësia e Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, është ngritur dhe funksionon në nivel Drejtorie, në zbatim të Ligjit nr.114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në aspektin organizativ dhe funksional përgjigjet përpara titullarit të institucionit. Mbështetur në strukturën organizative të DPT, DAB është krijuar dhe funksionon në përputhje me pikën 1, të nenit 10, të Ligjit nr.114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe përcaktimet e standardit 1100-Pavarësia dhe objektiviteti.

- Kuadri i Praktikave Profesionale të auditimit të brendshëm, kërkon që angazhimet e auditimit të kryhen me aftësi dhe kujdesin e duhur profesional. Në referim të këtij kriteri, struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm përbëhet nga 9 punonjës të miratuar në organikë, nga të cilët 1 drejtor drejtorie dhe 8 inspektorë/specialistë, ndërkohë që për vitin 2019 ka rezultuar në fakt me 8 punonjës. Të gjithë punonjësit e DAB janë të certifikuar “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dhe rezulton të kenë kryer trajnimet e vijueshme të detyrueshme prej 40 orësh në vit. 7 nga audituesit janë me formim në shkencat ekonomike dhe 1 në shkencat juridike. 3 auditues janë me vjetërsi në auditim deri në 5 vjet dhe 5 auditues me vjetërsi në auditim mbi 5 vjet. Pra ka gjetur zbatim standardi 1200- Aftësia dhe kujdesi i duhur profesional.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

- Grupi i standardeve 1300, mandaton drejtuesin e njësise që ai të ketë një program për vlerësimet e brendshme të cilësisë dhe të mirëmbajtje dhe përmirësorje atë vazhdimisht dhe Ligji 114/2015 në nenin 9 të tij kërkojnë që aktivitetet e auditimit të brendshëm të hartojnë dhe mirëmbajnë një program të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, duke përfshirë dhe vetëvlerësimet e brendshme si dhe shërbimet e këshillimit. Shërbimet e këshillimit inicohen nga Titllari i Institucionit i cili për vitin 2019 nuk rezulton të ketë inicuar ndonjë të tillë. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2019, DAB nuk ka hartuar dhe inicuar asnjë program për të mundësuar vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së aktivitetit të auditimit të brendshëm, nëse ai është në përputhje me Standardet dhe Kodin e Etikës, duke vepruar jo në përputhje me kriteret e standardit 1300- Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit.

-Për vitin 2019 DAB ka hartuar planin strategjik 2019-2021 dhe planin vjetor të auditimit, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm nr.21225, datë 16.10.2018.

Në zbatim të pikës c të nenit 14 të Ligjit 114/2015, është përgjegjësi e drejtuesit të njësise së auditimit të brendshëm hartimi dhe zbatimi i planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe informimi i strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësise publike.

Nga auditimi konstatohet mospërputhje midis numrit të planifikuara të angazhimeve për vitin 2019 në planin strategjik (9 angazhime auditimi) me numrin e planifikuara të angazhimeve në planin vjetor 2019 (5 angazhime auditimi).

Për vitin 2019 ishin planifikuar 5 auditime (3 të kombinuara + 2 performance), si vijon:

DRT Shkodër	Auditim i Kombinuar
DRT Vlorë	Auditim i Kombinuar
DRT Sarandë	Auditim i Kombinuar
DRT Tiranë Drejtoria e Kontrollit Tatimor	Auditim Performance
DRT Korçë Drejtoria e Kontrollit Tatimor	Auditim Performance

Nga 5 auditime të planifikuara gjatë vitit 2019 janë realizuar vetëm 3 auditime, ose 60% e objekteve të planifikuara si vijon :

Auditim i Kombinuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër;

Auditim i Kombinuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë;

Auditim performancë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DRT Korçë.

Arsyeja e mosrealizimit të auditimeve të planifikuara sipas Drejtuesit të DAB është iniciimi me urdhër të Titullarit të 4 auditimeve të tjera, si vijon:

Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT	Auditim Përputhshmërie
Drejtoria e Tatim paguseve të Mëdhenj	Auditim Përputhshmërie
Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë	Auditim Përputhshmërie
Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	Auditim Financiar

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në fund të vitit 2019 është raportuar auditim në proces dhe rezulton e evaduar brenda 3 mujorit të parë të vitit 2020. Gjatë vitit 2019 ka përfunduar dhe është evaduar raporti i auditimit të kombinuar në DRT Durrës (auditim i mbartur nga viti 2018).

Gjetjet me efekt financiar i perkasin fushës së kontrollit tatimor dhe janë në shumën 9,400,000 lekë. Në total DAB ka realizuar 1 Auditim Financiar, 3 Auditime të Kombinuara (përputhshmëri +performancë), 1 Auditim Performance dhe 3 Auditime Përputhshmërie.

Nga auditimi rezulton se ndryshimi i planit vjetor të auditimeve nuk është dokumentuar me shkresë dhe nuk është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të Ligjit 114/2015 dhe përcaktimeve të kapitulli III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016, ku përcaktohet se: “Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit”.

Për vitin 2019 konstatohet numër i ulët i auditimeve të planifikuara (5 auditime të planifikuara) në raport me ato të realizuara (8 auditime të realizuara), duke konkluduar në një planifikim me rezervë të angazhimit të burimeve njerëzore, gjithashtu konstatohet pjesëmarrje e ulët e audituesve në angazhime auditimi (7 auditues kanë realizuar 8 auditime me një koeficient 1.1 auditime për cdo auditues (3 auditues kanë kryer dy auditime dhe 4 auditues kanë kryer tre auditime).

Në raportet e auditimit janë evidentuar 159 gjetje të përkthyer në 123 rekomandime, nga të cilat 2 rekomandime për përmirësim legjislativ dhe 121 masa organizative. Nga 123 rekomandime gjithsej janë realizuar 53 rekomandime ose 43% e rekomandimeve të lëna dhe 70 rekomandime me status në proces.

Rekomandimet rezultojnë me këtë shpërndarje:

Përmirësim legjislativ	2 rekomandime
Kontrolli tatimor	65
Mbledhja e detyrimeve me forcë	20
Shërbimi tatimor	4
Hetimi tatimor	32

Veprimtaria e DAB për vitin 2019							
Nr.	Fushat e identifikuar me risk nga DAB	Gjetje nga auditimi	Efektet Financiare të gjetjeve Në 000/lekë	Statusi i rekomandimeve (sipas fushave të identikuara me risk)			
				Rekomandime të dhëna	Rekomandime të pranuar	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime në proces zbatimi
1	Kontrolli Tatimor	95	9,400	65	65	14	51
2	Mbledhje e detyrimeve të papaguar	24		20	20	14	6
3	Shërbimi Tatimor	4		4	4	2	2
4	Hetimi Tatimor	34		32	32	22	10
5	Përmirësim legjislativ	2		2	2	1	1
	Totali	159	9,400	123	123	53	70

Të dhëna të detajuara mbi veprimtarinë e DAB për vitin 2019, paraqiten në Aneksin nr.X

Nga analiza e gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në 8 auditimet e kryera konstatohet si vijon:
 -Në 6 angazhime auditimi me fokus përputhshmërinë (3 auditime të kombinuara + 3 auditime përputhshmërie) gjetjet dhe rekomandimet janë fokusuar në tërësinë e tyre në përputhshmërinë tatimore. **Mungojnë gjetjet dhe rekomandimet për sa i përket përputhshmërisë ligjore në lidhje me:**

-Emërimet dhe largimet nga puna të punonjësve; respektimin e strukturës organike të miratuar; respektimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta; ndjekja dhe raportimi i ecurisë së proceseve gjyqësore në lidhje me punonjësit e larguar nga puna, etj.

-Zbatimin e dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmërinë e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve.

-Zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, si dhe menaxhimin e konsumit të karburantit për mjetet e transportit.

-Funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, etj.

Aktiviteti i auditimit të brendshëm (AB) përmes Raporteve të Auditimit duhet të vlerësojë dhe të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit duke



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

përdorur një qasje sistematike dhe të disiplinuar (Standardi-2100). Rekomandimet e AB duhet të fokusohen në:

- Vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për të përmirësuar proceset e qeverisjes në lidhje me promovimin e etikës dhe sigurimin e performancës;
- Vlerësimin e efektivitetit dhe kontributit në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe;
- Ndihmesa për organizatën në mbajtjen e kontrolleve efektive, duke i vlerësuar dhe duke nxitur përmirësimin e tyre të vazhdueshëm.

Nga auditimi rezulton se nuk ka përpjekje për të vlerësuar komponentët e qeverisjes dhe proceset e kontrollit, duke i analizuar aktivitetet e subjekteve dhe duke i krahasuar treguesit në mënyrë specifike kundrejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të tyre të përgjithshme e strategjike.

Përsa më sipër nuk kanë gjetur zbatim të plotë kërkesat e pikës c të nenit 6 të Ligjit 114/2015 ku shprehimisht citohet: “Roli i auditimit të brendshëm është t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë: ...c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike”.

Nga analiza e dokumenteve të PRA dhe RFA u evidentua se, në asnjë rast AB nuk japin opinion mbi 5 komponentët e kontrolleve të brendshme sipas COSO-s (standardi 2400), si dhe mungon një opinion i përgjithshëm vlerësues.

Drejtuesi i auditimit të brendshëm sipas standardit 2500-Monitorimi i procesit, duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit. Ai duhet të vendosë një proces ndjekjeje, për të monitoruar dhe siguruar që aksionet e menaxhimit janë zbatuar në mënyrë efektive ose që menaxhimi i lartë ka pranuar rrezikun e mosveprimit.

Nga auditimi rezulton se nga ana e Drejtuesit të DAB nuk ka një analizë të gjendjes së rekomandimeve në proces dhe nuk është ndërmarrë asnjë nismë për rivendosjen e tyre në afat, ndonëse afatet e përcaktuara kanë përfunduar dhe rekomandimet ende janë në proces.

Informacioni mbi zbatimin e rekomandimeve është kërkuar zyrtarisht nga Drejtori i AB dhe konkretisht rezultojnë komunikime zyrtare “Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të AB” me vetëm 5 subjekte nga 8 subjekte të audituar, si vijon:

- DRT Durrës, me shkresën nr.22897, datë 24.12.2019, kthyer përgjigje me shkresën nr.17815/1, datë 31.12.2019;
- DRT Shkodër, me shkresën nr.22898, datë 24.12.2019, kthyer përgjigje me shkresën nr.11543/1, datë 31.12.2019;
- DRT Sarandë, me shkresën nr.22899, datë 24.12.2019, kthyer përgjigje me shkresën nr.10164/1, datë 30.12.2019;
- DHT në DPT, me shkresën nr.8088/7, datë 24.12.2019, kthyer përgjigje me shkresën nr.8088/8, datë 31.12.2019;
- DHTRQ Tiranë, me shkresën nr.11634/9, datë 24.12.2019, kthyer përgjigje me shkresën nr.11634/10, datë 06.01.2020.

Për 3 nga 8 subjektet e audituara, nga ana e drejtuesit të DAB nuk është kërkuar informacion në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga AB, pasi raportet përfundimtare të auditimit janë dërguar respektivisht:

- DRT Vlorë me shkresën nr.12180/6, datë 26.11.2019;
- DRT Korçë me shkresën nr.12179/7, datë 23.12.2019;
- DTM me shkresën nr.12181/10, datë 27.12.2019.

Për vitin 2019 Subjektet e audituara kanë raportuar planin e veprimit

Në 3 (tre) raste nga 8 subjekte të audituara për vitin 2019, ose në 37% të rasteve, titullarët e subjekte të audituara kanë dërguar në DPT planin e veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm, jashtë afatit 30 ditor nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës d të nenit 12 të Ligjit 114/2015, ku shprehimisht citohet: *“Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për: d) hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm ..., brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar”*.

Nga auditimi me zgjedhje i 3 dosjeve të subjekteve të audituara gjatë vitit 2019 rezulton se dosjet janë të inventarizuara dhe të plotësuara sipas kërkesave të MAB.

Veprimtaria e DAB në DPT gjatë vitit 2019 është audituar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, e cila në përfundim të auditimit, me shkresën nr.216/4, datë 03.04.2020 ka përcjellë në DPT Raportin Përfundimtar mbi Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë, me opinion: **Përputhshmëri e pjesshme** me standardet ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm. Për përmirësimin e situatës janë lënë 8 rekomandime të cilat synojnë rritjen e cilësisë së veprimtarisë audituese.

Veprimtaria e DAB për vitin 2019 është analizuar nga Komiteti i Auditimit i MFE i ngritur me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.211, datë 07.06.2019. KA me vendimin nr.7 datë 30. 01.2020 ka dhënë mendim dhe **rekomandim pozitiv** për raportin vjetor të veprimtarisë së DAB në DPT për vitin 2019.

Grupit të auditimit nuk i'u disponua kopje e procesverbalit të mbledhjes së KA datë 30.01,2020, për të konkluduar mbi mendimin dhe rekomandimin pozitiv të dhënë nga KA mbi veprimtarinë e DAB për vitin 2019.

Misioni i AB sipas nenit 5 të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, është të japë siguri të arsyeshme Titullarit të Institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Roli i Auditimit të Brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 6 të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, është t’i japë mbështetje titullarit të njësive publike në arritjen e objektivave të njësive, duke përgatitur plane strategjik dhe vjetor auditimi bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar si dhe duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve duke u fokusuar në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësive publike;
- përputhshmërinë e veprimtarisë së njësive publike me kuadrin rregullator;
- ruajtjen e aseteve;
- kryerjen e veprimtarisë së njësive me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
- duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike;
- duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna, etj.

Referuar kërkesave të standardit 2000-Menaxhimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, drejtuesi i AB duhet të menaxhojë në mënyrë efektive aktivitetin e auditimit të brendshëm, për të siguruar që ai i shton vlerë organizatës dhe se puna e auditimit plotëson qëllimet e përgjithshme dhe përgjegjësitë e përshkruara në mënyrë të detajuar në dokumentet e themelimit të aprovuar nga titullari i Institucionit.

Përsa trajtuar më sipër opinioni i grupit të auditimit në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së DAB në raport me rolin dhe misionin për të cilin është krijuar dhe funksionon vlerësohet jo në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi në fushën e auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Gjetja	Veprimtari e DAB vlerësohet jo në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi në fushën e auditimit në raport me rolin dhe misionin për të cilin është krijuar dhe funksionon kjo strukturë.
Situata	<p>Nga auditimi rezulton se, aktiviteti i auditimit të brendshëm përmes Raporteve të Auditimit nuk ka kontribuar në masën e duhur në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit, pasi rekomandimet e AB nuk janë fokusuar në: vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, në lidhje me promovimin e etikës dhe sigurimin e performancës; vlerësimin e efektivitetit dhe kontributit në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të riskut dhe ndihmën për organizatën në mbajtjen e kontrolleve efektive, duke i vlerësuar dhe duke nxitur përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe nuk ka përpjekje për të vlerësuar komponentët e qeverisjes dhe proceset e kontrollit, duke i analizuar aktivitetet e subjekteve dhe duke i krahasuar treguesit në mënyrë specifike kundrejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të tyre të përgjithshme e strategjike, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e pikës c, të nenit 6, të Ligjit 114/2015 ku shprehimisht citohet: <i>“Roli i auditimit të brendshëm është t'i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë: ...c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike”</i>.</p> <p>Gjithashtu në veprimtarinë e DAB janë evidentuar devijacione nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e auditimit, si vijon:</p> <p>a) Në raportet e auditimit mungojnë gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me: respektimin e dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës, pagave dhe shpenzimeve të personelit; ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për marrëdhëniet e punësimit; zbatimin e dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmërinë e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit /asgjësimin e aktiveve; zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla; funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, etj. Gjithashtu evidentohet mungesa në raportet e auditimit e dhënies së opinionit mbi 5 komponentët e kontrolleve të brendshme sipas modelit COSO, si dhe një opinion i përgjithshëm vlerësues mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për çdo sistem të audituar.</p> <p>b) Ndryshimi i planit vjetor të auditimeve nuk është dokumentuar me shkrim dhe nuk është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të Ligjit 114/2015 dhe përcaktimeve të kapitulli III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016.</p> <p>c) Nga ana e Drejtuesit të DAB nuk është vendosur një sistem për monitorimin dhe trajtimin e rezultateve të komunikuara menaxhimit, si dhe nuk ka një analizë të gjendjes së rekomandimeve në proces edhe pse afatet e zbatimit kanë përfunduar, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet e nenit 14 të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në të cilën përcaktohet se Drejtuesi i NJAB është përgjegjës për “veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pa zbatuar”. Nga auditimi</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

	rezulton se nga 123 rekomandime të lëna gjatë vitit 2019 janë realizuar vetëm 53 rekomandime ose 43% e rekomandimeve ndërkohë që 70 rekomandime rezultojnë ende në proces, jashtë afateve të dakordësuara.
Kriteri	Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm; Manuali i AB, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016.
Ndikimi/Efekti	Siguri jo të arsyeshme dhënë Titullarit të Institucionit, në lidhje me funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Rëndësia	I Lartë

Për sa trajtuar më sipër u mbajt akt konstatimi nr.9, datë 24.07.2020.

Për këtë çështje z.Sh P në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, ka bërë komente dhe shpjegime, me observacionin me nr.prot.6272/57 datë 24.09.2020.

Observacioni është në të njëjtën linjë me atë të trajtuar në projekt raportin e auditimit gjithsesi në mënyrë të përmbledhur po paraqesim edhe njëherë pretendimet e z.P si vijon:

“..-Ju informojmë se Karta e Auditimit është miratuar me Urdhrin nr.72, datë 24.09.2020 të Titullarit të Institucionit (bashklidhur urdhri).

-Lidhur me Programin e Sigurimit të Cilësisë, DAB ka përgatitur dhe miratuar në Mars 2020 dhe ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të AB sipas kërkesave të përcaktuara në MAB.

-Në Planin Vjetor dhe Strategjik është e mjaftueshme të vendosen si rezerve dite ne dispozicion për shërbime këshillimi por nuk mund të parashikohen si numër angazhimesh auditimi. Vetë neni i cituar nga Ju përcakton llojin e shërbimit që ofron auditimi i brendshëm dhe jo detyrimin ligjor për të planifikuar shërbime këshillimi.

- Faktori kryesor që ka ndikuar në ndryshimin e planit ndryshimet në realizimin në përbërje të numrit të auditimeve të planifikuara kanë ardhur si rezultat i kërkesave të vecanta që kanë patur titullarët e emëruar rishtazi në DPT

- Gjetjet dhe rekomandimet janë dhënë në mbazë të fushave të mbuluara me auditim. Për shkak të natyrës që ka DPT, fushat që ju përmendni për të adresuar gjetje dhe rekomandime kanë qenë jashtë fushës së auditimeve të kryera. Në situatën që është kryer auditimi, mbështetur dhe në faktorët e riskut për sistemin tatiomor, fushat me risk përfshijnë: Vlerësimi i zbatimit të ligjëshmërisë dhe përshtatshmërisë së veprimeve administrative të një procedure vlerësimi tatimore, vlerësimin dhe menaxhimin e borxhit , etj. Dhe në cdo rast gjetjet e identifikuar në sistemet e kontrollit janë identifikuar dhe raportuar po ashtu i janë dhënë rekomandimet përkatëse të auditimit për palët përgjegjëse.

-Lidhur me dhënien e opinionit, duke vlerësuar të dobishëm rekomandimin njëkohësisht sqarojmë se kjo nuk ka qenë e mundur pasi as Ligji për AB, Manuali i AB si dhe udhëzuesit e tjerë të nxjerrë në zbatim të Ligjit nuk përmbajnë kërkesën e dhënies së opinionit nga auditimi i brendshëm. Në formatin e raportimit kemi qëndruar në përputhshmëri me kërkesat e MAB dhe kriteret e përgatitjes dhe raportimit të AB.

-Të gjitha procedurat e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve janë kryer në përputhje me kërkesat e Manualit të AB seksioni 4.1.13.1 Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit dhe raportohen sipas seksionit 4.1.13.2 Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve, dhe auditimi i brendshëm nuk mund të mbajë përgjegjësi për rekomandimet e auditimit janë pranuar plotësisht por nuk janë zbatuar është tregues I qartë që problem nuk qëndron me cilesine e rekoamndimit por nivelin e ulët të ndërgjegjesimitit të strukturave të audituara për të bërë ndryshime dhe ndërmarrë veprime korrigjuese në zbatim te rekomnadimeve të auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Qëndrimi i Audituesit:

Grupi i auditimit merr në konsiderat miratimin e Kartës së Auditimit nga ana e Titullarit të Institucionit, me Urdhrin nr.72, datë 24.09.2020, si dhe hartimin, miratimin dhe dërgimin në Drejtorinë e Harmonizimit të AB të programit të Sigurimit të Cilësisë, në Mars 2020 si të mbështetura nga ana dokumentare.

Në lidhje me misionet e këshillimit grupi i auditimit vetëm ka konstatuar dhe nuk ka ngarkuar me përgjegjësi DAB, ndërkohë që përgjegjësia lidhej me mungesën e programeve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tyre.

Në lidhje me ndryshimin e planit vjetor sqarojmë edhe njëherë se është detyrim i nenit 12 të Ligjit 114/2015 miratimi i planit vjetor nga Titullari i Institucionit, që nënkupton që sa herë të ketë ndryshim plani, duhet marr miratimi i titullarit.

Në lidhje me konstatimin për mungesë gjetjesh dhe rekomandimesh në lidhje me procedurat e emrimeve, zbatimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe shpenzimet për udhëtime e dieta; ndjekja dhe raportimi i ecursisë së proceseve gjyqësore në lidhje me punonjësit e larguar nga puna, zbatimin e dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmërinë e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve, zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit, funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, etj, sqarojmë edhe njëherë se në këto fusha ndër vite KLSH ka konstatuar parregullsi. Aktualisht në auditimin e vitit 2019 vetëm në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe shpenzimet për udhëtime e dieta janë konstatuar shpenzime në kushtet e paligjshmërisë në shumën 1,662,900 lekë e cila është konsideruar dëm në buxhetin e shtetit, si dhe parregullsitë në procedurat e rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme, pagesat për vendimet gjyqësore, parregullsitë në procedurat e inventarizimit, etj., konstatime këto që duhet të shërbejnë si indicie për DAB për të ndërmarrë programe angazhimi auditimi. Në lidhje me mungesën e dhënies së opinionit mbi 5 komponentët e kontrolleve të brendshme sipas COSO-s si kërkesë kjo e standardit 2450, theksojmë edhe njëherë se, zbatimi i standardeve ndërkombëtare është detyrim ligjor që rrjedh nga zbatimi i nenit 8 të Ligjit nr.114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Në lidhje me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve theksojmë edhe njëherë se është përgjegjësi e drejtuesit të auditimit të brendshëm sipas standardit 2500-Monitorimi i procesit, të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit. Ai duhet të vendosë një proces ndjekjeje, për të monitoruar dhe siguruar që aksionet e menaxhimit janë zbatuar në mënyrë efektive ose që menaxhimi i lartë ka pranuar rrezikun e mosveprimit.

Në konkluzion: Observacioni merret parasysh pjesërisht, por opinionin e grupit të auditimit në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së DAB në raport me rolin dhe misionin për të cilin është krijuar dhe funksionon vlerësohet jo në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi në fushën e auditimit.

Përsa më sipër për veprimet dhe mosveprimet jo në përputhje të plotë me përcaktimet e Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit të AB, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 dhe Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, përgjegjësi mban Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, z.Sh P.

DREJTIMI G. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme

Për këtë pikë të programit nga grupi i auditimit është lënë Akt-verifikimi nr.1 datë 24.07.2020 protokolluar në DPT me nr.6272/21. Në vijim të fazës së raportimit sqarojmë se gjetjet dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

rekomandimi përkatës do të paraqiten në raportin e auditimit sipas programit të miratuar nr.694 datë 16.07.2020.

DREJTIMI H: Auditimi çështjeve të tjera të cilat mund të rezultojnë gjatë proces të realizimit të auditimit në subjekt

H1. Auditimi i trajtimit të dhurimit të aksioneve. Çështje për trajtim nga auditimi në Drejtorinë e Rajonale Tatimore Shkodër, përcjellë me shkresën nr.55/10prot. datë 13.05.2020 të Kryetarit të KLSH.

Në auditimin e kryer në DRT Shkodër, grupi i auditimit trajtoi edhe një ankesë të protokolluar në KLSH, me nr.138, prot, datë 27.01.2020, denoncim i bërë edhe në portalin www.shqipëriaqeduam.al dhe www.stopinformalitetit.al, për subjektet M A dhe B MG. Ankesa konsistonte në mospagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga transferimi i kuotave të aksioneve në shoqëritë e sipërcituara. Situata për të cilën është bërë ky denoncim, paraqitet si vijon:

-Shoqëria M A shpk me NUIS KxxxxxT është shoëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me vendimin nr.12679, datë 11.10.1995;

-Me vendimin nr.2, datë 29.06.2009, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë M A, ka vendosur të rrisë kapitalin nga 28,821,104 lekë në 42,871,000 lekë, rritje kjo e ardhur nga fitimi i pashpërndarë i cili është destinuar për rritje kapitali;

-Në datë 24.06.2017, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë M A, ka vendosur të rrisë përsëri kapitalin me 153,929,000 lekë, shumë kjo që përfaqëson fitimin e shoqërisë për vitin 2016, duke e çuar kapitalin e shoqërisë bëhet 196,800,000 lekë;

-Ortaku i vetëm i shoqërisë z.M B, zotëruesi 100% i kuotave në datë 07.08.2019, ka marrë vendimin për zvogëlimin e kapitalit në shumën 30,800,000 lekë. Kapitali pas zvogëlimit është 166,000,000 lekë;

-Në datë 04.09.2019, z.M B, i **dhuron të 100 kuotat me vlerë 166,000,000 lekë**, z.G B, i cili pas dhurimit bëhet ortak i vetëm i shoqërisë M A, veprim ky i regjistruar në QKB.

Gjithashtu z.M B, aksioner i shoqërisë B Mg shpk, në datë 04.09.2019, i **dhuron z.G B, kuota në masën 50% me vlerë 13,900,000 lekë.**

Duke qenë se DRT Shkodër qëndrimin e vet e mbështet në interpretimin ligjor të dhënë nga DPT, me shkresën nr.55/10, datë 13.05.2020 të KLSH –së “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet mbi “Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër” u vlerësua që kjo çështje të ndiqet dhe të trajtohet nga grupi i auditimit në DPT.

Grupi i auditimit kërkoi nga DPT informacion në lidhje me ndryshimin e pronësisë në subjektet tatimore, por informacioni i vënë në dispozicion nuk mundësonte identifikimin e rasteve të ndryshimit të pronësisë, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i pikës 3 të nenit 27/1 “Ndryshimi i pronësisë” të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

“Një person juridik, i cili është subjekt i një ndryshimi të përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të njoftojë autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga koha kur ka ndodhur ndryshimi”.

Në këto kushte grupi i auditimit morri në shqyrtim praktikën e ndjekur nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT në lidhje me interpretimin ligjor që ka kërkuar DRT Shkodër për këtë çështje.

DRT Shkodër me shkresën nr.10068/1, datë 11.11.2019, “Kërkesë për interpretim”, ka kërkuar nga DPT interpretim juridik, që lidhet me subjektin i cili do të jetë objekt vlerësimi (nëse duhet bërë vlerësim për dhuruesin apo për përfituesin e dhurimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Interpretimi i dhënë nga DPT me shkresën nr.20904/1, datë 31.12.2019, protokolluar në DRT Shkodër me nr.7, datë 06.01.2020, konsiston në:

“-Kuota dhe aksioni edhe pse janë tituj pronësie të një lloji pasurie të veçantë, në çdo rast rrjedhin nga kontribute që janë bërë për qëllim të krijimit ose zhvillimit të shoqërisë. Mbajtësi i tyre, në çdo rast, zotëron nëpërmjet tyre, në mënyrë të tërthortë të drejta mbi sende të luajtshëm apo të paluajtshëm, nga të cilat burojnë kuotat apo aksionet. Në respektim të parimit bazë ekonomik dhe tatimor, për sa kuota apo aksioni konsiderohet një titull pronësie, nga mbajtja dhe përdorimi i të cilit realizohen përfitime ekonomike, pra qëllimi i mbajtjes është për përfitime ekonomike, çdo tjetërsim i tyre, sipas rastit dhe në varësi të kushteve specifike të tjetërsimit, duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm.

- Për dhurimet e formave të tjera të ndryshme nga pasuria e paluajtshme, siç mund të jenë dhurime të aksioneve/kuotave, në dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi nuk ka përcaktime eksplicite. Për këtë, kur mungojnë përcaktimet eksplicite, duhet gjykuar në logjikën e taksimit të ndershëm, në mënyrë që të minimizohen hapësirat e shmangies duke siguruar shpërndarje korrekte të barrës tatimore mbi tatimpaguesin.

-Personit të cilit i dhurohen aksionet/kuotat, nuk bëhet përgjegjës për ndonjë tatim, por ai do të jetë subjekt i tatimit nëse i shet këto kuota dhe realizon fitim kapital prej tyre. Në rastin e dhurimit të aksioneve/kuotave, vlera nominale e aksionit/kuotës që do të përfitohet nga përfituesi i dhurimit do të jetë vlera nominale ose e blerjes së aksionit/kuotës nga dhuruesi i aksionit/kuotës dhe jo vlera e aksionit /kuotës në momentin e dhurimit”.

DPT ka kërkuar nga DRT Shkodër të analizohet personi që “dhuron” aksionet/kuotat, në drejtim të verifikimit të rritjes së kapitalit, verifikimit nëse ky kapital shtesë dhe kjo kuotë është me burim fitimin e pashpërndarë, apo ka ndodhur rritje kapitali e mëvonshme, apo kemi të bëjmë me rivlerësim aktivesh dhe rezervë kapitali. Këtë kërkesë për verifikim DPT e ka mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku tagrin për kontroll dokumentacioni dhe kontroll transaksionesh të kryera nga tatimpaguesi e ka Drejtoria Rajonale ku ai është i regjistruar.

Sipas DPT, tjetërsim i aksioneve/kuotave, sipas rastit dhe në varësi të kushteve specifike të tjetërsimit, **duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm dhe personit të cilit i dhurohen aksionet/kuotat, nuk bëhet përgjegjës për ndonjë tatim, ndërkohë që për personin që ka kryer dhurimin nuk shprehet qartazi, nëse bëhet ose jo përgjegjës për ndonjë tatim**, por shprehimisht citon:

“Kur mungojnë përcaktimet eksplicite, duhet gjykuar në logjikën e taksimit të ndershëm, në mënyrë që të minimizohen hapësirat e shmangies duke siguruar shpërndarje korrekte të barrës tatimore mbi tatimpaguesin”

Në përfundim të shkresës, DPT ka kërkuar nga DRT Shkodër të analizohet personi që “dhuron” aksionet/kuotat, **në drejtim të verifikimit të rritjes së kapitalit, verifikimit nëse ky kapital shtesë dhe kjo kuotë është me burim fitimin e pashpërndarë, apo ka ndodhur rritje kapitali e mëvonshme, apo kemi të bëjmë me rivlerësim aktivesh dhe rezervë kapitali.**

Përsa më sipër, DRT Shkodër në vijim të interpretimit të dhënë nga DPT ka kryer vlerësimin vetëm në drejtim të rritjes së kapitalit, nga ku ka rezultuar si vijon:

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “B MG”, që nga themelimi i saj në vitin 2012 e deri vitin 2019, ka shpërndarë vetëm 2 (dy) herë dividendë: Në vitin 2018 në shumën 3,000,000 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 8,000,000 lekë.

Nga të dhënat e sistemit të tatimeve rezulton se:

-Në Korrik 2018 është deklaruar shpërndarje dividendi në shumën 3,000,000 lekë, për të cilën në datë 20.08.2018, është paguar tatim në shumën 450.000 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

-Në Korrik 2019 është deklaruar shpërndarje dividendi në shumën 8,000,000 lekë, për të cilën në datë 25.08.2019, është paguar tatim në shumën 640.000 lekë.

DRT Shkodër është shprehur se nuk mund të analizonte rritjen e kapitalit të Shoqërisë M A shpk me NIPT KXXXXT, subjekt që ushtron aktivitetin në juridiksionin e Drejtorisë së Njesisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, tagrin për kontroll dokumentacioni dhe kontroll transaksionesh të kryera nga tatimpaguesi e ka Drejtoria ku ai është i regjistruar.

Grupi i auditimit konstaton se, kërkesa për interpretim e Drejtorisë Ligjore Teknike në DPT është kufizuar vetëm në drejtim të verifikimit të rritjes së kapitalit, ndërkohë që kërkesa e bërë nga DRT Shkodër është për vlerësim tatimor. Dilema e DRT Shkodër ka qenë se cili subjekt do të ishte objekt vlerësimi, dhuruesi apo përfituesi. Pra trajtimi i ndjekur nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT nuk ka rezultuar shterues, pasi nuk është kërkuar vlerësim i plotë tatimor por, interpretimi është kufizuar vetëm në drejtim të rritjes së kapitalit.

Shpjegimi i dhënë nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT është se “Kërkesa e DRT Shkodër ka qenë për një interpretim në parim, për një veprim të kryer nga ana e tatimpaguesit dhe për përmbushjen e detyrave të saj funksionale si DRT”, ndërkohë që nga sa u sqarua më sipër, rezulton se, kërkesa e DRT Shkodër ka qenë e drejtpërdrejtë.

Në lidhje me transferimin e aksioneve grupi i auditimit ndan të njëjtin opinion me DPT kur thotë se tjetërsim i aksioneve/kuotave, sipas rastit dhe në varësi të kushteve specifike të tjetërsimit, duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm duke e bazuar këtë opinion në: -Parimin bazë ekonomik dhe tatimor, për sa kuota apo aksioni konsiderohet një titull pronësie, nga mbajtja dhe përdorimi i të cilit realizohen përfitime ekonomike;

-Përcaktimet e pikës g të nenit 8 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

“Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jo rezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në faktin që, Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar në nenin 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, nuk e ka përjashtuar në mënyrë eksplicite këtë lloj të ardhure.

Grupi i auditimit, gjatë auditimit në DPT kërkoi informacion në lidhje me njoftimin e organeve tatimore nga subjektet e sipërcituara në lidhje me ndryshimin e pronësisë, kërkesë të cilën grupi e ka mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 27/1 “Ndryshimi i pronësisë” të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

“Një person juridik, i cili është subjekt i një ndryshimi të përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të njoftojë autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga koha kur ka ndodhur ndryshimi”.

dhe pikës 5 të nenit 27/1 “Ndryshimi i pronësisë” të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, shprehimisht citohet:

“Në rast të mos njoftimit të autoriteteve tatimore, personi juridik dënohet sipas penaliteteve të përcaktuara në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Në lidhje me kërkesën e grupit të auditimit për të disponuar një kopje të njoftimit zyrtar që z.M B i ka bërë ATQ në lidhje me ndryshimin e pronësisë për të dy shoqëritë ku ai ka qenë aksioner (100% te M A shpk me NIPT KXXXXT dhe 50% te shoqëria B MG shpk), Drejtoria Ligjore dhe Teknike përgjigjet se nuk ka informacion për njoftim zyrtar nga z.M B, pasi informacioni administrohet pranë DRT-ve nën juridiksionin e të cilit ndodhen subjektet dhe jo pranë DPT-së. Në vijim grupi i auditimit i'u drejtua me kërkesë zyrtare (me e mail) Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (DKT) për të konfirmuar nga DRT Shkodër dhe DTM njoftimin ose jo nga ana e z.B të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria të Tatimeve”

ndryshimit të pronësisë. Të dyja drejtoritë u përgjigjën zyrtarisht se z.B nuk ka njoftuar këto drejtori (DRT Shkodër & DTM) për ndryshim pronësie.

Si përfundim, grupi i auditimit, konstaton se, në të dy rastet e sipërcituara **tjetërsimi i aksioneve/kuotave**, nga DRT-të respektive **nuk është konsideruar si një transaksion i tatueshëm dhe** ndaj z. M B në cilësinë e dhuruesit të aksioneve **nuk është aplikuar gjobë**, për mos njoftim të administratës tatimore në lidhje me ndryshimin e pronësisë, në masën 15 për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie (15% i 179,900,000 lekë (166,000,000 lekë +13,900,000 lekë), në shumën 26,985,000 lekë.

Detyrimi për të aplikuar gjobë rrjedh nga përcaktimet e nenit nr.115/2 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ku shprehimisht citohet:

“Nëse një person juridik nuk njofton administratën tatimore lidhur me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, “Ndryshimi i pronësisë”, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ai është përgjegjës dhe dënohet si më poshtë: a) për shkeljen në rastin e pikës 3, të nenit të sipërpërmendur, 15 për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie”.

Sqarojmë se, nga ana e DPT nuk ka asnjë kërkesë drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj në lidhje me vlerësimin e shoqërisë M A shpk me NIPT KXXXXT, e cila rezulton me transferim aksionesh.

Gjetja	Trajtim jo i plotë dhe shterues nga ana e DLT në DPT i praktikës së dhurimit të aksioneve, për subjektet M A sh.p.k dhe B MG si dhe pamjaftueshmëri informacioni në lidhje me subjektet tatimore që kanë ndryshime në pronësi.
Situata:	Shoqëria M A shpk me NUIS KXXXXT është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me vendimin nr.12679, datë 11.10.1995. Ortaku i vetëm i shoqërisë z.M.B, zotëruesi 100% i kuotave në datë 04.09.2019, i dhuron të 100 kuotat me vlerë 166,000,000 lekë, z.G. B, i cili pas dhurimit bëhet ortaku i vetëm i shoqërisë M A, veprim ky i regjistruar në QKB. Gjithashtu z.M B, aksioner i shoqërisë B Mg shpk, në datë 04.09.2019, i dhuron z.G B, kuota në masën 50% me vlerë 13,900,000 lekë. Nga auditimi u konstatua: a) Trajtim jo i plotë dhe shterues nga ana e Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT i praktikës së dhurimit të aksioneve, për subjektet M A sh.p.k dhe B MG, kërkuar DRT Shkodër për këtë çështje. DRT Shkodër me shkresën nr.10068/1, datë 11.11.2019, “Kërkesë për interpretim”, ka kërkuar nga DPT interpretim juridik, nëse objekt vlerësimi do të jetë dhuruesi apo përfituesi i dhurimit. DPT me shkresën nr.20904/1, datë 31.12.2019, ka dhënë këtë interpretim: “-Kuota dhe aksioni edhe pse janë tituj pronësie të një lloji pasurie të veçantë, në çdo rast rrjedhin nga kontribute që janë bërë për qëllim të krijimit ose zhvillimit të shoqërisë. Mbajtësi i tyre, në çdo rast, zotëron nëpërmjet tyre, në mënyrë të tërthortë të drejta mbi sende të luajtshëm apo të paluajtshëm, nga të cilat burojnë kuotat apo aksionet. Në respektim të parimit bazë ekonomik dhe tatimor, për sa kuota apo aksioni konsiderohet një titull pronësie, nga mbajtja dhe përdorimi i të cilit realizohen përfitime ekonomike, pra qëllimi i mbajtjes është për përfitime ekonomike, çdo tjetërsim i tyre, sipas rastit dhe në varësi të kushteve specifike të tjetërsimit, duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm. - Për dhurimet e formave të tjera të ndryshme nga pasuria e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

	<p><i>paluajtshme, siç mund të jenë dhurime të aksioneve/kuotave, në dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi nuk ka përcaktime eksplicite. Për këtë, kur mungojnë përcaktimet eksplicite, duhet gjykuar në logjikën e taksimit të ndershëm, në mënyrë që të minimizohen hapësirat e shmangies duke siguruar shpërndarje korrekte të barrës tatimore mbi tatimpaguesin.</i></p> <p><i>-Personit të cilit i dhurohen aksionet/kuotat, nuk bëhet përgjegjës për ndonjë tatim, por ai do të jetë subjekt i tatimit nëse i shet këto kuota dhe realizon fitim kapital prej tyre. Pra sipas DPT dhurimi i aksioneve duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm, por duke qenë se ligji nuk shprehet në mënyrë eksplicite, DPT është mjaftuar me kërkesën për të analizuar personin që “dhuron” aksionet/kuotat, në drejtim të <u>verifikimit të rritjes së kapitalit</u>. Gjithashtu konstatohet se, në të dy rastet e sipërcituara tjetërsimi i aksioneve/kuotave, nga DRT-të ku ushtrojnë aktivitetin këto subjekte nuk është konsideruar si një transaksion i tatueshëm dhe ndaj z. M B në cilësinë e dhuruesit të aksioneve nuk është aplikuar gjobë, për mos njoftim të administratës tatimore në lidhje me ndryshimin e pronësisë, në masën 15 për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie (15% i 179,900,000 lekë (166,000,000 lekë +13,900,000 lekë), në shumën 26,985,000 lekë.</i></p> <p>Detyrimi për të aplikuar gjobë rrjedh nga përcaktimet e nenit nr.115/2 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ku shprehimisht citohet:</p> <p><i>“Nëse një person juridik nuk njofton administratën tatimore lidhur me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, “Ndryshimi i pronësisë”, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ai është përgjegjës dhe dënohet si më poshtë: a) për shkeljen në rastin e pikës 3, të nenit të sipërpërmendur, 15 për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie”.</i></p> <p>b) Pamjaftueshmëria e informacionit disponuar grupit të auditimit nga DPT, në lidhje me subjektet tatimore që kanë ndryshime në pronësi nuk mundësoi identifikimin e rasteve të ndryshimit të pronësisë, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i pikës 3 të nenit 27/1 “Ndryshimi i pronësisë” të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku shprehimisht citohet: “Një person juridik, i cili është <u>subjekt i një ndryshimi të përmendur në pikën 1</u>, të këtij neni, duhet të njoftojë autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga koha kur ka ndodhur ndryshimi”, si dhe nga marrëveshja e bashkëpunimit midis QKB me nr. 12420/1, datë 07.09.2017 dhe DPT me nr.19812, datë 22.08.2017.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.8438, datë 28.01.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.</p> <p>Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.</p> <p>Rregullore e brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi midis QKB me nr. 12420/1, datë 07.09.2017 dhe DPT me nr.19812, datë 22.08.2017.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Ndikimi/Efekti:	Risk potencial për krijimin e të ardhura të munguara nga moszbatimi i kuadrit ligjor në fuqi.
Rëndësia:	E lartë

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.10, datë 24.07.2020.

Për këtë çështje znj.I K në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, ka bërë komente dhe shpjegime, me observacionin me nr.prot.6272/53 datë 23.09.2020.

Observacioni është në të njëjtën linjë me atë të trajtuar në projekt raportin e auditimit gjithsesi në mënyrë të përmbledhur po paraqesim edhe njëherë pretendimet e znj.K se, “Audituesit shtetëror të KLSH e kanë ngarkuar me përgjegjësi për veprimin dhe mosveprimin në lidhje me faktin që tjetërsimi i aksioneve nuk është vlerësuar si transaksion i tatueshëm dhe për mosaplikim gjore për tatimpaguesin i cili ka ndryshuar pronësi, duke dhënë dhe referencat ligjore për strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit tatimor, si vijon:

Neni 70, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, parashikon se, Drejtoria rajonale tatimore nxjerr njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore.

Pika 5, e nenit 80, të ligjit të sipërcituar parashikon se, Kontrolllet, që kryhen nga administrata tatimore qendrore, urdhërohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve apo drejtuesit e njësive të ngjashme me të.

Neni 101, i ligjit të sipërcituar parashikon se:

1. Administrata tatimore ka të drejtë të thërrasë çdo person që ka dijeni për dokumentacionin apo procedurat tatimore, kur ajo e gjykon se prania e tij është e nevojshme për zbatimin e duhur të legjislacionit tatimor.

3. Kërkesa e administratës tatimore për t’u paraqitur bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore.

Rasti konkret i denoncuar ka qenë nën përgjegjësinë e trajtimit të DRT Shkodër dhe është kjo e fundit që ka konstatuar se, krahas saj, një vlerësim i rastit duhet të bëhet edhe nga DTM që ka nën administrim tatimpaguesin “M A” sh.p.k. Në këto kushte, zyrtarisht për trajtimin e rastit, DTM do të duhej të njoftohej nga ana e DRT Shkodër dhe jo nga Drejtori i DLT në DPT.

Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT, ka trajtuar parimisht kërkesën, jo duke e vlerësuar përgjigjen si një trajtim vetëm të rastit konkret, por ka trajtuar parimisht fenomenin duke theksuar se DRT respektive duhet të kryejë të gjitha analizat e nevojshme përfshi edhe rritjen e kapitalit për të konkluduar në një vlerësim të bazuar dhe ligjor.

Zbatimi i procedurave ligjore dhe orientimeve konkrete nuk është përgjegjësi e DLT-së por e strukturës që i zbaton ato.

Lidhur me mos aplikimin e gjobës për tatimpaguesin që ka ndryshuar pronësinë dhe nuk e ka deklaruar rregullisht atë, sqaroj se, referuar nenit 12, të ligjit të procedurave tatimore, administrata tatimore ndër të tjera udhëhiqet nga parimet kryesore si vijon:

- a) zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore;
- b) vetëvlerësimi dhe vetë deklarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit;
- c) nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore; etj.

Parimisht tatimpaguesi mbart detyrimin të vetë deklarojë dhe të vetë përmbushë detyrimet ligjore që burojnë nga kuadri ligjor rregullues në fuqi, ndërsa administrata tatimore mbart detyrimin të vlerësojë dhe të administrojë detyrimet tatimore të çdo tatimpaguesi. Kontrolllet tatimore dhe vlerësimet tatimore në të gjitha rastet bëhen vetëm nga ana e DRT së juridiksionit ku tatimpaguesi është regjistruar. DLT për sa i është kërkuar zyrtarisht ka sqaruar dhe orientuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

DRT-në kërkuese. Zbatimi i procedurave ligjore është detyrim i DRT-ve jo i strukturave monitoruese dhe mosveprimi i DRT-ve nuk mund të vlerësohet si përgjegjësi e drejtorit të DLT”.

Qëndrimi i Audituesit:

Së pari: Sqarojmë edhe njëherë se Drejtori i Drejtorisë Ligjore dhe Teknike nuk është ngarkuar me përgjegjësi për mosvlersim të tjetërsimit të aksioneve si transaksion i tatueshëm, as për mos aplikim gjobe për tatimpaguesin i cili ka ndryshuar pronësi. Mos aplikimi i gjobës, për mos njoftim të administratës tatimore në lidhje me ndryshimin e pronësisë ndaj z.B në cilësinë e dhuruesit të aksioneve *është një konstatim i grupit të auditimit për strukturat tatimore* i cili mbështetet në përcaktimet e nenit nr.115/2 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Përgjegjësia lidhet me trajtimin jo të plotë dhe shterues të kësaj praktike.

Së dyti: Në lidhje me pretendimin se Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT, ka trajtuar parimisht kërkesën, jo duke e vlerësuar përgjigjen si një trajtim vetëm të rastit konkret, por ka trajtuar parimisht fenomenin, ju sjellim në vëmendje citimin e trajtimin e praktikës: *“Në respektim të parimit bazë ekonomik dhe tatimor, për sa kuota apo aksioni konsiderohet një titull pronësie, nga mbajtja dhe përdorimi i të cilit realizohen përfitime ekonomike, pra qëllimi i mbajtjes është për përfitime ekonomike, çdo tjetërsim i tyre, sipas rastit dhe në varësi të kushteve specifike të tjetërsimit, duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm”.*

Nëse nga trajtimi në parim i këtij fenomeni ju keni dalë në përfundimin se tjetërsim i aksioneve, sipas rastit dhe në varësi të kushteve specifike të tjetërsimit, duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm, por ligji nuk shprehet në mënyrë eksplicite për të, a ka ndonjë nisëm të marrë nga DLT për diskutim për ndryshim ligjor?

Në lidhje me citimin se, *DLT për sa i është kërkuar zyrtarisht ka sqaruar dhe orientuar DRT-në kërkuese dhe zbatimi i procedurave ligjore është detyrim i DRT-ve jo i strukturave monitoruese dhe mosveprimi i DRT-ve nuk mund të vlerësohet si përgjegjësi e drejtorit të DLT”, ju rikujtojmë edhe njëherë se, me shkresën e DPT nr.20904/1, datë 31.12.2019, protokolluar në DRT Shkodër me nr.7, datë 06.01.2020, i është lënë detyrë e kufizuar DRT-s Shkodër, që konsiston në drejtim të verifikimit të rritjes së kapitalit, ndërkohë që kërkesa e bërë nga DRT Shkodër është për vlerësim tatimor. Pra DRT Shkodër ka zbatuar detyrat e lëna nga DPT, ndërkohë që DTM e cila ka në juridiksionin e saj subjektin me vlerë më të lartë të dhurimit të aksioneve nuk është bërë fare me dije për këtë praktikë. Detyrimin për njoftim në asnjë rast nuk mund ta ketë një drejtori rajonale për një tjetër. Drejtoritë Rajonale janë institucione varësie të DPT e për rrjedhojë është detyrim i strukturave në DPT të koordinojnë me DRT për të zgjidhur problematikat e hasura.*

Në konkluzion: Observacioni nuk merret parasysh.

Për veprimet dhe mosveprimet në trajtimin jo të plotë dhe shterues të kësaj praktike përgjegjësi mban znj. I K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Teknike në DPT në cilësinë e drejtuesit të strukturës që ka trajtuar këtë praktikë.

H2.Të ardhurat nga komisioni 1% përfituar si agent tatimor. Çështje për trajtim nga auditimi në Drejtorinë e Rajonale Tatimore Shkodër, përcjellë me shkresën nr.55/10prot. datë 13.05.2020 të Kryetarit të KLSH.

Sipas raportit përfundimtar të auditimit të kryer nga KLSH në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, u konstatua se mosrealizimi i të ardhurave jo- tatimore, gjatë veprimtarisë së ushtruar si agent tatimor për mbledhjen e tatimit të fitimit të thjeshtuar tatimore të realizuara për biznesin e vogël në fund të vitit 2018, 2019 nga bashki të Qarkut Shkodër, “ka ardhur si rezultat i mungesës së afateve ligjore për pagimin e detyrimeve nga institucionet e pushtetit vendor, referuar Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, neni 11/a,b, ku përcaktohet se për shërbimin e kryer Administrata Tatimore Rajonale



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

përfiton të ardhura në masën 1% të shumës së arkëtimit për llogari të qeverisjes vendore, të ardhurave tatimore nga TFTH për biznesin e vogël, të arkëtuara nga DRT. Kjo shumë (pra 1% i TFTH) derdhet nga bashkitë për llogari të DPT në buxhetin e shtetit nga të ardhurat e grumbulluara si agjent tatimor DRT nga pushteti vendor pa ndonjë afat të përcaktuar ligjor. Nisur nga fakti që grupi gjykon se kërkohet ndërhyrje në përmirësim të Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, e konkretisht pika 11-Transferimi i të ardhurave në llogari të qeverisjes vendore të shumave të arkëtuara nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në masën 100%, në mënyrë që shuma e TFTH e arkëtuar nga DRT dhe që çelet në fund të vitit nga DPT në DRT për tu shpërndarë njërive të pushtetit vendor të realizohet pasi të jetë zbritur më parë 1% i komisionit të shërbimit të kryer nga DRT (si agjent tatimor), ndërhyrje që bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kjo gjetje i kalon për trajtim të thelluar grupit të auditimit pranë kësaj drejtorie për ta sintetizuar problematikën dhe finalizuar kërkesën për përmirësim ligjor”.

Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, pika 10 citohet se: *Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohet agjent shërbimi i këtyre të fundit. Si e tillë, DRT-ja regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 “Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim” me kartela analitike për çdo bashki dhe komunë. Sipas pikës 11 “a) Administrata tatimore qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur është arkëtuar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.*

b) Administrata tatimore qendrore për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të administratës tatimore qendrore. Komisioni kalon në llogari të buxhetit të shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore, për mbulimin e kostove të “Pullave të tatimit”.

c) Për të bërë transferimin, paraprakisht, kryhet procesi i **rakordimit midis drejtorive rajonale tatimore me bashkitë dhe komunat, lidhur me shumat e arkëtuara sipas subjekteve tatimpaguese**. Në akt-rakordimin e hartuar në tri kopje, paraqitet e ndarë shuma totale e arkëtuar për bashkinë/komunën, si dhe shuma e komisionit në masën 1% e të ardhurave të arkëtuara. Drejtoritë rajonale tatimore, në bazë të akt-rakordimit dhe listës së tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët, kryen transfertën nga llogaria e drejtorive rajonale “Tatime me deklaram”, në llogarinë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në rrethin përkatës, në emër të bashkisë apo komunës. Drejtoritë rajonale tatimore dërgojnë pranë degës së thesarit të rrethit përkatës një kopje të akt-rakordimeve të mbajtura me secilën bashki/komunë. Në bazë të akt-rakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 “Transferta në institucionet nacionale” në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatik nga bashkia/komuna në drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 “Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale. (Ndryshuar me Udhëzimin nr. 13, dt. 6.5.2014).

Për vitin 2019, nga të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare të DPT (llogaria 448) rezulton se shuma e arkëtuar dhe çelur për vitin 2019 për të gjitha drejtoritë rajonale është 347,320,593 lekë nga të cilat: 344,545,994 lekë të arkëtuara dhe 2,774,599 lekë të mbartura nga viti 2018. Në përfundim të rakordimit të kryer me njësitë e qeverisjes vendore, DRT kanë transferuar tek këto

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”**

njësi shumën prej 339,887,124 lekë. Në mënyrë të detajuar sipas DRT-ve shumat e arkëtuara dhe transferuara paraqiten në tabelën në vijim:

LLog.448: Situata e Transferimeve për Pushtetin Vendor për Periudhën Janar-Dhjetor 2019 (në mijë lekë)

Nr.	DRT	Shuma e çelur ne Degën e Thesarit për pushtetin vendor nga 01 Janar deri 31/12/2019	Shuma transferuar për pushtetin vendor dhjetor 2018	Shuma e transferuar për pushtetin vendor për periudhën Janar-Dhjetor 2019	Shuma e transferuar për pushtetin vendor gjithsej deri 31 Dhjetor 2019
1	DRT Berat	7,010,649	155,033	6,855,616	7,010,649
2	DRT Dibër	5,647,135	141,045	5,506,090	5,647,135
3	DRT Durrës	50,658,882	207,744	50,451,138	50,658,882
4	DRT Elbasan	13,246,718	232,795	13,013,923	13,246,718
5	DRT Fier	18,113,217	183,339	15,697,483	15,880,822
6	DRT Gjirokastrë	3,923,593	183,733	3,739,860	3,923,593
7	DRT Korçë	8,131,199	119,982	8,011,217	8,131,199
8	DRT Kukës	2,794,181	72,642	2,721,539	2,794,181
9	DRT Lezhe	9,460,330	206,081	9,254,249	9,460,330
10	DRT Sarandë	13,792,312	312,848	13,607,615	13,920,463
11	DRT Shkodër	8,960,843	74,620	8,886,223	8,960,843
12	DRT Tirana	182,890,511	1,057,245	179,480,628	180,537,873
13	DRT Vlorë	19,714,436	56,359	19,658,077	19,714,436
14	DTM	201,988	0.0	0.0	0.0
	Totali	344,545,994	3,003,466	336,883,658	339,887,124

Shuma e komisionit 1% e përlogaritur mbi shumën e arkëtuar rezulton të jetë në rang administrate tatimore 3,398,871 lekë nga të cilat janë arkëtuar 2,916,546 lekë. Pra shuma për të cilat njësitë e qeverisjes vendore rezultojnë të jenë debitorë ndaj DPT-së është **482,325 lekë**.

Nr.	DRT	Shuma prej 1% që i takon DRT deri 31/12/2019	Vlera e arkëtuar e 1% sipas rap 12 mujor 2019	Diferenca në pagesë +/- (Në lekë)
1	DRT Berat	70,106	70,107	0
2	DRT Dibër	56,471	42,271	-14,200
3	DRT Durrës	506,589	308,079	-198,510
4	DRT Elbasan	132,467	132,466	-1
5	DRT Fier	158,808	158,810	-2
6	DRT Gjirokastrë	39,236	86,291	+47,055
7	DRT Korçë	81,312	99,447	+18,135
8	DRT Kukës	27,942	20,504	-7,438
9	DRT Lezhe	94,603	82,914	-11,689
10	DRT Sarandë	139,205	134,473	-4,732
11	DRT Shkodër	89,608	60,799	-28,809
12	DRT Tirana	1,805,379	1,564,136	-241,243
13	DRT Vlorë	197,144	156,249	-40,895
14	DRT TM	0.0	0.0	0.0
	Totali	3,398,871	2,916,546	-482,325

Nga të dhënat rezulton se për disa DRT shuma e paguar në 2019 përfshijnë dhe detyrimet e lindura për 1% komision të përlogaritur në periudhën e mëparshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Në kuadër të auditimit u kërkuar kopje të rakordimeve dhe një shpjegim nga 3 Drejtori rajonale: DRT Tiranë, Fier dhe Drejtoria e Tatim paguesve të Mëdhenj të cilat ju përcollën grupit të auditimit, nga të cilat theksohej se arsyeja e mos pagesës në kohë të komisionit 1% është për shkak të vonesave të Bashkive në autorizimin e këtyre pagesave.

Ndërkohë, theksojmë se këto të ardhura jo- tatimore nuk janë të përfshira në planin vjetor të DRT-ve pavarësisht se në raportimin vjetor ato përfshihen në evidencën e realizimit të të ardhurave. Së dyti, impakti në vlerësimin e performancës së DRT-së, në misionin e mbledhjes së të ardhurave, nga ky zë nuk rezulton të jetë material për pozicionin financiar të DPT-së dhe aq më tepër për vlerësimin e performancës së tyre.

Gjithashtu, në Udhëzim është parashikuar që në bazë të akt rakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 “Transferta në institucionet nacionale” në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatik nga bashkia/komuna në drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 “Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale. Nëse do të kryhej transferata për shumën neto (zbritur 1% komision) kompensimi ndërmjet një elementi të aktivitetit të bilancit dhe një elementi të detyrimeve, si dhe ndërmjet një të ardhure dhe një shpenzimi është i ndaluar, përveç rastit kur parashikohet ose autorizohet nga një standard kontabël.

Në këtë mënyrë nuk gjejmë arsye të moskryerjes së pagesës së komisionit 1% nga ana e njësive vendore. Për sa kohë dokumenti i akt rakordimit është një dokument i vetëm i përbashkët i shumës që DRT duhet të transferojnë në njësitë vendore dhe ajo që këto të fundit duhet ti paguajnë DRT për shërbimin si agjent tatimor, vonesat nga Bashkitë janë të pajustificuara dhe mund të rregullohen me sanksionimin e një afati të caktuar në Udhëzimin nr.32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël” pika 11 e tij “Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore”, germa a.

Gjetja	Për vitin 2019 Njësitë e Qeverisjes Vendore rezultojnë debitorë ndaj DPT-së në shumën 482,325 lekë për 1% e TFTH.
Situata	Në zbatim të Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohet agjent shërbimi i këtyre të fundit. Administrata tatimore qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur është arkëtuar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin. Administrata tatimore qendrore për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të administratës tatimore qendrore. Komisioni kalon në llogari të buxhetit të shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore, për mbulimin e kostove të “Pullave të tatimit”. Për vitin 2019, nga të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare të DPT (llogaria 448) rezulton se shuma e arkëtuar dhe çelur për vitin 2019 për të gjitha drejtoritë rajonale është 347,320,593 lekë nga të cilat: 344,545,994 lekë të arkëtuara dhe 2,774,599 lekë të mbartura nga viti 2018. Në përfundim të rakordimit të kryer me njësitë e qeverisjes vendore,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

	DRT kanë transferuar tek këto njësi shumë prej 339,887,124 lekë. Shuma e komisionit 1% e përlogaritur mbi shumën e arkëtuar rezulton të jetë në rang administrate tatimore 3,398,871 lekë nga të cilat janë arkëtuar 2,916,546 lekë. Pra shuma për të cilat njësitë e qeverisjes vendore rezultojnë të jenë debitorë ndaj DPT-së është 482,325 lekë . Sipas shpjegimit të dhënë grupit të auditimit nga 3 Drejtori rajonale: DRT Tiranë, Fier dhe Drejtoria e Tatim pagesve të Mëdhenj, arsyeja e mos pagesës në kohë të komisionit 1% është për shkak të vonesave të Bashkive në autorizimin e këtyre pagesave. Për sa kohë dokumenti i akt rakordimit është një dokument i vetëm i përbashkët i shumës që DRT duhet të transferojnë në njësitë vendore dhe ajo që këto të fundit duhet ti paguajnë DRT për shërbimin si agjent tatimor, vonesat nga Bashkitë janë të pajustificuara.
Kriteri	Udhëzimi i MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”
Efekti/Ndikimi	Mosrealizimi i të ardhurave jo- tatimore, gjatë veprimtarisë së ushtruar si agjent tatimor për mbledhjen e tatimit të fitimit të thjeshtuar.
Rëndësia	I Ulët

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.10, datë 24.07.2020.

IV. GJETJE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje 1. Kontributi i DPT në planifikimin e të ardhurave tatimore konsiston vetëm në paraqitjen e statistikave mbi të ardhurat tatimore të realizuara të cilat përgatiten në formate standarde, në nivel tepër sintetik, të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin apo mosrealizimin të ardhurave tatimore, në zbatim të misionit të saj si dhe burimeve të vëna në dispozicion.

Për Buxhetin e vitit 2019, programimi i të ardhurave tatimore bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin. Faktorët e marrë në konsideratë, krahas kuadrit makroekonomik, të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2019 janë efektet direkt të disa politikave fiskale të cilat vlerësohen rreth 4 miliard lekë ose 0.2% e të ardhurave faktike të realizuara në vitin 2018. Bazuar në këta tregues, me miratimin e Ligjit nr.99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”, plani i të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore total (bruto) është **265,871,000 mijë lekë ose 19,294,258 mijë lekë më shumë (+7.82%) se fakti i vitit 2018** ose 18,858,000 mijë lekë më shumë (+7.63%) se planifikimi i vitit 2018, nga të cilat, të ardhurat tatimore janë parashikuar të rriten me 8.56% dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve rriten me 6.53%. Ky nivel rritje, duket të jetë në pothuaj të njëjtin trend të një viti më parë ku rritja vjetore e parashikuar ishte 8.1%. Analiza e strukturës së planit të të ardhurave tatimore tregon se TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore me 30% të totalit të ardhurave tatimore; Tatimi mbi të Ardhurat Personale përbën 28% të totalit të ardhurave tatimore parashikuar me një rritje prej 5% se viti 2018 (23%) përfshirë këtu dhe impaktin e lehtësimit fiskal për të ardhurat nga dividendi me impakt në arkëtime prej rreth +4.5 miliard lekë. Një nga zërat që është parashikuar në ulje në krahasim me planin e një viti më parë por edhe me të ardhurat faktike të realizuara, është zëri “të ardhura nga tatim fitimi” me 33.5 miliard lekë krahasuar me 34.4 miliard lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

realizuar në vitin 2018. Në relacion nuk gjejmë bazë për një planifikim në ulje të këtij zëri. Ky planifikim rezulton të jetë më i ulët edhe nga parashikimet e arkëtimeve të vetë Drejtorive Tatimore Rajonale parashikuar me rreth 35 miliard lekë. Gjatë vitit 2019, ka pasur vetëm një rishikim plani buxhetor me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019 përcjellë nga MFE me shkresën nr.19183/2 datë 22.11.2019 protokolluar në DPT me nr.21474 dt.25.11.2019. Ky ndryshim konsiston në uljen e të ardhurave të tatimore në zërin “Tatimi vlerës së shtuar (bruto)” nga 57,500,000 mijë lekë në 57,000,000 mijë lekë ose 500,000 mijë lekë më pak. Edhe pse deri në këtë moment, sipas të dhënave të realizimit të të ardhurave tatimore për 9- muajorin ky zë ishte me mosrealizim 6.8 miliard lekë, po ashtu edhe të ardhurat nga taksat nacionale dhe taksat e qarkullimit rrugor raportoheshin me mosrealizim prej 3.8 miliard lekë. Në vijim, në muajin Nëntor dhe Dhjetor 2019 të ardhurat nuk janë rishikuar për të marrë parasysh ndonjë efekt negativ të mundshëm për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpallur më 27.11.2019, të ardhurat tatimore dhe kontributet gjatë këtyre dy muajve u realizuan 3.2 miliard lekë më pak se plani dhe impaktet negative të pritshme u menaxhuan me kontroll dhe limitim të shpenzimeve buxhetore referuar urdhrat të Ministres së Financave dhe Ekonomisë nr.21920 datë 03.12.2019. Gjithashtu, në të njëjtën periudhë nuk rezulton që të jetë përcjellë nga MFE ndryshime të planit të TVSH së rimbursueshme e cila në muajin dhjetor rezulton me një tejkalim prej 5 miliard lekë. Në konkluzion, në lidhje me programimin e të ardhurave tatimore vjetore, pavarësisht se ky proces është i centralizuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nuk mund të mos ketë dhe një kontribut nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si një palë aktive e procesit të planifikimit të të ardhurave tatimore dhe diskutimit të politikave fiskale që ndikojnë në to. Kontributi i DPT-së, si një strukturë e ngarkuar *për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore*, nuk mund të konsistojë vetëm në përgatitjen e evidencave statistikore të cilat përgatiten dhe paraqiten në nivel tepër sintetik. *(trajtuar më hollësisht në pikën B1 të Raportit të Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1: Komiteti i Përmbyshjes në DPT të vlerësojë hartimin e një metodologjie për analizimin e të dhënave mbi të ardhurat tatimore duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët që ndikojnë në realizimin e tyre dhe veçoritë e çdo lloji tatimi që administrojnë, kundrejt burimeve teknike dhe njerëzore që administrata tatimore disponon apo duhet të ketë.

Afati: Brenda vitit 2020

Gjetja 2. Metodologjia aktuale që DPT përdor për shpërndarjen e planit të të ardhurave, bën një ndarje mekanike të tij, bazuar vetëm në historikun e peshës specifike të secilës DRT, pa përfshirë faktorë të tillë si: struktura e tatimpaguesve sipas llojit, ndryshimet në statusin e tyre, problematikat në lidhje me mbledhjen e të ardhurave dhe borxhit tatimor që këto drejtori mbartin, në raport kjo dhe me kapacitetet në dispozicion të secilës DRT.

Nga auditimi konstatohet se për shpërndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie është zbatuar e njëjta metodologji mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT, dhe peshën specifike të secilës drejtori në totalin e të ardhurave tatimore. Paraprakisht DPT kërkon nga DRT-re të dërgojnë parashikimet e arkëtimeve për vitin pasardhës. Sipas këtyre parashikimeve rezulton se DRT-re parashikojnë një nivel arkëtimi prej 254,302,896 mijë lekë ose 11.7 miliard lekë më pak se të ardhurat e miratuara në total nga MFE. Në nivel DRT-re, ata me parashikimin më optimist janë DRT Durrës me 10.43% rritje të arkëtimeve krahasuar me faktin e një viti më parë dhe DRT Fier me 46.4 % rritje, ndërsa parashikimi më pesimist vjen nga DRT Tiranë me +2% dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me -0.9%. Pavarësisht parashikimeve, vendimi për planin e secilës DRT është i Komitetit të Përmbyshjes i cili ka bërë dhe “korrigjimet” në parashikimet e pothuaj të gjithë DRT-të (me përjashtim vetëm të propozimit të DRT Sarandë), dhe ngarkon diferencën në planin e DRT Tiranë dhe DTM si dy drejtori me peshën specifike më të lartë respektivisht 36.3% dhe 43.4%. Për sa i përket kontributit në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

arkëtimin e të ardhurave nga secila DRT, rezulton se ai paraqitet pothuaj i njëjtë për të gjitha DRT-të në të tre vitet e fundit (përveç DRT Fier dhe DRT Dibër), kjo edhe mjedisi i biznesit ka pësuar ndryshime ndër vite. Në këtë mënyrë, pesha specifike në arkëtime nuk mund të jetë një faktor i vetëm përfaqësues për mundësitë reale që ka në arkëtim çdo DRT dhe rrjedhimisht nuk mund të jetë i vetmi faktor që siguron një shpërndarje të drejtë të planit. Kështu, të paktën numri i subjekteve që administrojnë çdo DRT duhej të ishte një faktor tjetër për tu marrë në konsideratë në metodologjinë e shpërndarjes së planit. Nga të dhënat rezulton se gjatë vitit 2019 ka një rritje në numrin e tatimpaguesve në rang kombëtar të regjistruar me 3113 subjekte nga të cilat 2378 janë të regjistruar në DRT Tiranë. DRT Dibër, Elbasan, Fier dhe Gjirokastrë vazhdojnë në trend rënës për sa i përket numrit të tatimpaguesve që administrojnë, megjithatë në korrelacion me arkëtimet bruto, jo për të gjitha këto drejtori ky fakt ka patur ndikim rënës në të ardhurat e arkëtuara prej tyre. Drejtoritë që kanë ndikim më të lartë nga lëvizja e numrit të tatimpaguesve është DRT Tiranë dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM). Çdo fillim viti, DRT-re Tiranë i transferohen nga DTM subjektet të cilat nuk e përmbushin më kriterin e xhiros vjetore dhe i largohen subjektet që e plotësojnë këtë kriter. Ky transferim supozohet se duhet të japi një efekt rritës në të ardhurat e DTM. Faktikisht, nga të dhënat mbi realizimin e të ardhurave për vitin 2019 rezulton se nga DRT Tiranë transferohen për te DTM 228 subjekte me qarkullim të deklaruar => se 500 milion lekë (2018) dhe nga DTM në DRT Tiranë 192 subjekte. Faktikisht, për vitin 2019 grupi i transferuar në DTM ka deklaruar 40% më pak të ardhura nga viti 2018. Në fund të vitit 2019, të dy drejtoritë raportojnë mosrealizim të planit, respektivisht DTM me 98.3% dhe DRT Tiranë me 96.2%. Në konkluzion, kryerja e një analize më tej për shpërndarjen e planit, duke përfshirë një analizë të subjekteve sipas llojit të biznesit, sektorit të ekonomisë ku operon por edhe sipas numrit të punonjësve që çdo drejtori rajonale ka në dispozicion kundrejt të ardhurave që realizon (p.sh. DRT Sarandë krahasuar me DRT Kukës apo DRT Shkodër kundrejt DRT Korçë), do të mundësonte një pamje më të plotë për të vlerësuar nëse ka patur një shpërndarje të drejtë të planit ose jo. (Trajtuar më hollësisht në pikën B1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 2: Komiteti i Përmbushjes, në përputhje me parimet e administrimit tatimor për arrijtjen e efikasitetit dhe efektivitetit të duhur, nëpërmjet strukturave përgjegjëse në DPT, të vlerësojë metodologjinë e shpërndarjes së planit të të ardhurave tatimore dhe kontributeve për çdo Drejtori Rajonale Tatimore, me qëllim përmirësimin e saj në funksion të një shpërndarje të drejtë të planit dhe në raport me mjedisin e biznesit ku DRT-re operojnë, ndryshimet që ato pësojnë si dhe burimeve njerëzore që këto drejtori kanë në dispozicion.

Afati: Në vijimësi

Gjetja 3: Pavarësisht rritjes vjetore të të ardhurave tatimore bruto, plani i të ardhurave të buxhetuara përsëri nuk është realizuar veçanërisht në zërin e TVSH-së, edhe pse ka një rritje të numrit të deklaruesve krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat tatimore bruto janë realizuar në masën 259,461,414 mijë lekë ose 5,909,586 mijë lekë (2.23%) më pak se plani i rishikuar me Akt Normativ nr.2 datë 02.10.2019, “Për disa ndryshime Ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019. Ky mosrealizim vjen kryesisht nga mosrealizimi i të ardhurave tatimore (arkëtime) me 5,505,989 mijë lekë ose -3.22% dhe mosrealizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore me 403.6 milion lekë ose -0.43%. Krahasuar me një vit më parë të ardhurat tatimore bruto janë rritur me 12,884,671 mijë lekë ose me 5.23% respektivisht +4.75% nga rritja e të ardhurave tatimore dhe 6.07% nga rritja e kontributeve të sigurimeve. Për sa i përket realizimit të të ardhurave tatimore sipas Drejtorive Rajonale Tatimore, DRT Sarandë rezulton me realizimin më të lartë prej 107.33% të planit vjetor ndërsa DRT Dibër me realizimin më të ulët prej 94.37% të planit të rishikuar. Megjithatë, këto dy drejtori zënë një peshë specifike të vogël në totalin e të ardhurave të realizuar me 2.2%.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Ndërkohë, dy drejtoritë me impakt të lartë në realizimin e të ardhurave tatimore rezultojnë me mosrealizim, përkatësisht DRT Tiranë me 96.2% dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me 98.31% të planit.

Analizuar sipas llojit, zëri i **të ardhurave nga TVSH**-ja ka pasur një trend rënës në vite 2017-2019. Pavarësisht parashikimeve optimiste, të ardhurat nga TVSH-ja rezultojnë të realizuara në shumën 49.45 miliard lekë ose 7.5 miliard lekë ose 13.23% më pak se plani i rishikuar, dhe 3% më pak se TVSH e arkëtuar në vitin 2018. Planifikimi optimist, sipas relacionit të Projekt Buxhetit 2019, është bazuar në *“rritja ekonomike dhe përmirësimin e luftës ndaj informalitetit”*, rrjedhimisht kjo e reflektuar në rritjen e numrit të deklaruesve si dhe në saktësinë e deklarimit. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, gjatë vitit 2019 rezultojnë 61,000 subjekte të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar në përputhje me Ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106, nga 58991 subjekte deklarues gjatë vitit 2018 ose rreth 2,000 subjekte më shumë. Nga subjektet deklarues, vetëm 10,948 prej tyre rezultojnë me TVSH të pagueshme ose rreth 350 subjekte më shumë se një vit më parë. Për sa i përket sektorit të ekonomisë, sektori i tregtisë dhe shërbimit janë kontribuesit më të mëdhenj në arkëtimet e këtij zëri të ardhurash ndërkohë që sektori i ndërtimit paraqet një rënie prej 24% të TVSH së pagueshme.

Zëri i të ardhurave nga **“tatimi mbi të ardhurat personale”**, duket të jetë zëri më performues gjatë vitit 2019, me një kontribut prej 28% në totalin e të ardhurave tatimore bruto kundrejt 23% në vitin 2018. Në fund të periudhës ky zë rezulton me realizim 46.22 miliard lekë ose 10.31% më shumë se plani dhe 9.65 miliard lekë më shumë se arkëtimet e vitit 2018. Në këtë rritje, 7.37 miliard lekë kanë ardhur vetëm nga “tatimi mbi të ardhurat nga dividendi” si rrjedhojë e lehtësimit fiskal të parashikuar me uljen e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, aplikuar dhe në shpërndarjen e fitimeve të akumuluar të viteve të kaluara, ndryshim që e kaloi pritshmërinë prej 4.5 miliard lekë vlerësuar gjatë buxhetimit.

-Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” janë realizuar në shumën 36.48 miliard lekë me një tejkalim prej 2.98 miliard lekë ose +8.91% e planit. Siç është evidentuar edhe më lartë, në projekt buxhet ky zë është parashikuar fillimisht me një rritje 7% ose 2.2 miliard lekë më shumë se viti 2018. Në fakt, me ligjin e buxhetit për vitin 2019 ky zë miratohet në nivelin 33.5 miliard lekë ose -2.66% më pak se realizimi i vitit 2018 që raporton 34.4 miliard lekë arkëtime, një rezervë kjo e pashoqëruar me një arsyetim faktorësh. (*Trajtuar më hollësisht në pikën B1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 3: Në funksion të hartimit të strategjive për miradministrimin fiskal, bazë për programimin e të ardhurave tatimore, brenda kuadrit të misionit të saj, DPT të shqyrtojë mundësinë e rritjes së kapaciteteve për ngritjen e një njësie mirëfilli për përgatitjen e statistikave të plota, koherente dhe në funksion të kryerjes së analizave mbi bazë risku të të ardhurave tatimore sipas komponentëve ndikues, duke maksimizuar mundësitë raportuese që sistemi C@TS ofron.

Afati: Në vijimësi

Gjetje 4: Disa ndryshime të legjislacionit tatimor janë bërë jo në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale të parashikuara në Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ndryshuar, duke mos i dhënë kohën e duhur për informim dhe sqarim tatimpaguesve që preken nga këto ndryshime, për të siguruar në vijim vlefshmërinë dhe saktësinë e deklarimeve.

1) Deklarimet e vitit 2019 me impakt në të ardhurat e arkëtuara dhe stokun e TVSH kreditorë, janë ndikuar edhe nga ndryshimet ligjore të parashikuara në Ligjin nr.96/2018 datë 03.12.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, ndryshime këto të bëra në kundërshtim me Ligjin nr.9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

në RSH”, të ndryshuar, nenin 4/1, pika 3 “Parimet dhe rregullat fiskale” cituar: “Ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal”. Më konkretisht, ky ligj, në nenin 1 të tij parashikon përfshirjen në nenin 49 “Shkallët e reduktuara” të TVSH-së edhe të 1) furnizimit të shërbimit të reklamave nga media audiovizive si dhe 2) për furnizimin e mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind deri në datën 31 dhjetor 2021. Nga data 1 janar 2022 shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar që aplikohet për këtë furnizim është 10 për qind. Nga auditimi i deklarimeve të vitit 2019 sipas rubrikave, rezultojnë ndryshime në strukturën e deklarimeve sipas shkallëve tatimore krahasuar me deklarimet e një viti më parë. Më konkretisht: është rritur deklarimi i shitjeve të tatueshme me shkallë tatimore 6% me 96%; Gjithashtu, në këto deklarime u konstatuan edhe deklarime në shkallën 10% në rubrikën 15, 32 dhe 40 të deklarates, me një vlerë totale të tatueshme rreth 123 milionë lekë, shkallë e cila nuk parashikohet në Ligjin nr.92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, të ndryshuar. Nisur nga problematika në lidhje me shkallën e lartë të informalitetit në deklarimet e TVSH, grup tatimpaguesit të cilët ofrojnë shërbime të kombinuara me shkallë standarde dhe shkallë të reduktuar duhej të ishin vlerësuar dhe analizuar paraprakisht me një shkallë risku më të lartë, me qëllim sigurimin e saktësisë së deklarimeve sipas llojit të shërbimit (aktivitetit) të deklaruar dhe vlefshmërinë e normës së tatimit të aplikuar.

2) Një tjetër ligj i miratuar në më pak se 1 muaj para fillimit të vitit të ri fiskal është Ligji nr.94/2018 datë 03.12.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”, sipas të cilit u shtua shkalla tatimore e reduktuar prej 5%, e cila hyri në fuqi më 1 Janar 2019 për disa kategori tatimpaguesish. Konkretisht, në nenin 28, janë bërë diferencime të shkallës së Tatimit mbi Fitimin për disa kategori: - 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14,000,000 lekë në vit;- 5% për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit përfshirë dhe VKM nr.730 datë 12.12.2018 e cila përcakton përkufizimet dhe kriteret e kualifikimit për përfitimin e shkallës së reduktuar. Nga auditimi i të dhënave të sistemit C@ATS rezulton se kanë përfituar nga shkalla e re tatimore 5,336 subjekte nga të cilët: 5,258 subjekte me të ardhura të deklaruara deri në 14,000,000 lekë duke gjeneruar një detyrim tatim fitimi në shumën 339,542 mijë lekë krahasuar me 766,288 mijë lekë detyrim tatim fitimi deklaruar në vitin 2018 nga 5432 subjekte të së njëjtës fashë. Pra duket se shkalla e re tatimore nuk ka nxitur rritjen e numrit të deklaruesve; 77 subjekte me të ardhura të deklaruara mbi 14,000,000 lekë kanë aplikuar shkallën tatimore 5% duke gjeneruar një detyrim tatim fitimi në shumën 128,075 mijë lekë. Sipas ndryshimeve ligjore, këto subjekte duhet të kenë në objektin e veprimtarisë së tyre prodhimin/zhvillimin e softëare-ve ose aktivitetin e “agro-turizmit” pasi të jenë të certifikuar si të tillë. Nga auditimi u konstatua se referuar përshkrimit të objektit të aktivitetit, shkallën tatimore të reduktuar 5% e kanë aplikuar edhe subjekte që nuk i përkasin këtyre dy fushave por subjekteve që ushtrojnë veprimtari në bar-kafe, call-center, ndërtim, tregti etj. Gjithashtu disa nga subjektet e listuar në fushën e teknologjisë dhe informacionit në objektin e veprimtarisë kanë përshkruar në objektin e aktivitetit “tregtimin” e pajisjeve informatike dhe jo “dizenjim/prodhim”.

3) Në vijim të këtij Ligji të miratuar në kundërshtim me parimet e parashikuara ligjore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nxjerr Udhëzimin nr.12 datë 15.03.2019 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, me të cilin miraton zëvendësimin e “formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin” me formularin e ri i cili parashikon rubrika të veçanta sipas shkallëve të reja tatimore në fuqi, vetëm 15 ditë para afatit të deklarimit të tatimit mbi fitimin 31 Mars 2019.

4) E njëjta praktikë është ndjekur edhe me Ligjin nr.84/2019 datë 18.12.2019 “Për disa shtesa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku është shtuar, që për personat juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotivë, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%, ndryshim që do të japë efektet duke filluar nga 1 Janari 2020, pra vetëm 13 ditë nga data e publikimit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 4.1: MFE dhe DPT, të marri masa për të respektuar afatet ligjore të parashikuara në lidhje me ndryshimet në legjislacionin tatimor të cilat parashikohen se do të kenë një efekt në arkëtimin e të ardhurave buxhetore për vitin pasardhës. Këto në funksion të informimit në kohë të tatimpaguesve si dhe të një vlerësimi sa më të drejtë të impaktit të këtyre ndryshimeve në planin e të ardhurave tatimore.

Në vijim, për çdo ndryshim ligjor DPT duhet të përgatisë jo vetëm njoftimet informuese por edhe dokumente sqaruese për tatimpaguesit me qëllim zbatimin e saktë të këtyre ndryshimeve nga ana e tyre.

Afati: Në vijimësi

Rekomandimi 4.2: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT në bashkëpunim me DRT-re që administrojnë subjektet e evidentuara, të iniciohet verifikimi i grup- tatimpaguesve që kanë aplikuar shkallën e TVSH-së 10%, me qëllim vlerësimin dhe sistemimin e situatës së tyre tatimore si dhe verifikimin subjekteve që kanë aplikuar shkallën e reduktuar të tatimit mbi fitimin 5% jo në përputhje me Ligji nr.94/2018 datë 03.12.2018 dhe kriteret e përcaktuara në VKM nr.730 datë 12.12.2018.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 4.3: Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit në DPT të analizojë menjëherë deklaratimet historike të tatimpaguesve të cilët kanë aplikuar shkallët tatimore të reduktuara të TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin 5%, të hyra në fuqi më 01.01.2019 dhe përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në VKM, me qëllim përfshirjen e tyre në prioritetet e planeve të kontrollit tatimor për vlerësimin e saktësisë së deklaratimeve.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje 5. Në raportimet e DPT, arkëtimet nga “gjoba të sistemit tatimor” në total arkëtuar 730,008 mijë lekë, janë klasifikuar si të ardhura tatimore jo në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018. Sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.37 datë 19.12.2019 pika 22 “Brenda datës 24.01.2020 degët e thesarit rakordojnë me njësitë e përgjithshme për shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2019”, në mbyllje të vitit 2019, sipas shkresës nr.6886 prot., datë 21.04.2020, Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit përcjell Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës Pasqyrat Financiare të vitit 2019, shoqëruar me rakordimin me Thesarin. Nga rakordimi me raportet e llogarive analitike të nxjerra nga sistemi i Thesarit- SIFQ me evidencat e raportuara nga DPT nuk rezultojnë diferenca. Për qëllime të raportimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit –Sektori i raportimeve financiare dhe kontabilitetit, klasifikimi i të ardhurave në “tatimore” dhe “jo tatimore” është i ndryshëm nga ai i DPT, duke sjellë kështu diferenca në raportimin e të ardhurave tatimore midis dy raporteve. Kështu, sipas DPT arkëtimet nga “gjoba të sistemit tatimor” janë klasifikuar si të ardhura tatimore në total **730,008 mijë lekë**, kjo jo në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 cituar “Llogaria 70 ”Tatime dhe taksat dhe tatimet” Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, kamatëvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimore”. Ndërkohë në raportimet e MFE për treguesit fiskal, klasifikimi i kodeve buxhetore në të ardhura tatimore dhe jo tatimore



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve”

nuk përjashton vetëm gjambat (grupi 71) por edhe kamatëvonesat. (Trajtuar më hollësisht në pikën B1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 5: Strukturat përgjegjëse në MFE: Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin në bashkëpunim me Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit në DPT, të shqyrtojnë klasifikimet aktuale në raportimet e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore për qëllime të raportimit fiskal, në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore.

Afati: Në vijimësi

Gjetja 6: Planifikimi me rezervë i të ardhurave nga tatimi mbi fitimin nuk mbështet realisht suksesin e tejkalimit të planit buxhetor për këtë zë. Referuar deklarimeve për vitin 2019 rezultojnë një rënie prej 15% e vlerës totale të “tatimit për tu paguar” të deklaruar krahasuar me një vit më parë edhe pse ka një rritje prej 3% të subjekteve objekt i tatimit fitimit. Referuar arkëtimeve, realizimi i këtij zëri mbështetet kryesisht në kontributin e 50 subjekteve nga të cilët janë arkëtuar 41% e totalit të arkëtimeve gjithsej për vitin 2019. Gjithashtu, nga auditimi rezultojnë se sektori i prodhimit paraqet një rënie prej 46% të tatimit fitimit të deklaruar.

Në bazë të evidencave të vëna në dispozicion, rezultojnë se të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë raportuar në shumën **36,484,399 mijë lekë ose 8.91%** ose 2,984,399 mijë lekë më shumë se plani dhe 6% më shumë se viti 2018. Krahasuar me një vit më parë, detyrimi për tatim fitimin sipas deklarimeve të 23,542 subjekteve është rreth 15% më i ulët ndërkohë që të ardhurat tatimore të deklaruara janë rritur me 1%. Sipas klasifikimit të sektorëve të ekonomisë burimi i arkëtimeve të të ardhurave nga tatimi mbi fitimin rezultojnë të jetë sektori i prodhimit me 31% ndjekur nga sektori i shërbimit me 26% dhe sektori i tregtisë me 25%. Ndryshimet strukturore për sa i përket numrit të subjekteve për çdo sektor nga një vit në tjetrin, nuk e justifikojnë rënien prej 15% të detyrimit të deklaruar ndërkohë që numri i subjekteve, objekt i tatimit fitimit është rritur me 3%³⁴. Rënie më të konsiderueshme të tatimit fitimit të deklaruar paraqesin sektori i prodhimit me -46% dhe sektori i ndërtimit me -17%. Në gjykimin e audituesit, deklaratat e sektorit të prodhimit do të kërkonin një analizë më të thelluar për të shpjeguar rënien prej 46% ndërkohë që të ardhurat tatimore të deklaruara kanë rënë me vetëm 10%.

Nga auditimi konstatohet se 14.8 miliard lekë ose 41% e totalit të të ardhurave nga tatim fitimi gjatë vitit 2019 vijnë nga arkëtimet e 50 tatimpaguesve (kryesisht nga sektori bankar dhe ai energjetik) ku dallojnë arkëtimet nga OSHEE me 8.9% e totalit dhe KESH sha me 7.2% . Realisht, nga auditimi sipas periudhës tatimore, pjesa më e madhe e arkëtimeve nga këto dy subjekte janë për llogari të shlyerjes së borxhit tatimor dhe jo detyrime të reja të periudhës. Referuar detyrimit faktik të lindur pas deklarimit të 31 Marsit 2019, nga auditimi rezultojnë se top40 subjektet deklarojnë “tatim fitimi për tu paguar” në total 12.44 miliard lekë ose 36% të totalit të shumave të deklaruara. Po sipas deklarimeve faktike, rezultojnë se OSHEE grup, Albc, ST , E A kanë deklaruar humbje tatimore. **Në konkluzion, deklaratat e subjekteve nuk kanë impakt të drejtpërdrejtë në arkëtimet e vitit raportues dhe top lista e më të mëdhenjve në deklaratë jo domosdoshmërisht ka dhe kontributin më të madh në arkëtimet respektive të vitit.** Aktualisht, arkëtimet nga ky grup rezultojnë të jenë 45% më të larta se detyrimi i lindur. **Sipas drejtorive rajonale**, peshën specifike në të ardhurat e arkëtuara dhe raportuara për zërin e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin e zë DTM me 60% të totalit të arkëtimeve me 699 subjekte aktive të regjistruar ndjekur nga DRT Tiranë me 21% dhe DRT Durrës me 5.5% të arkëtimeve. Kontributi i drejtorive të tjera variojnë nga 0.5% deri 2% të totalit të arkëtimeve. Për sa i përket

³⁴Sipas DPT- Sektorit i shërbimit të tatimpaguesit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

realizimit të të ardhurave nga tatim fitimi kundrejt planit të miratuar, DRT Berat, Durrës Elbasan, Kukës, Sarandë dhe DMT rezultojnë me tejkalim të planit, ndërsa DRT e tjera janë të gjitha me mosrealizim veçanërisht: DRT Dibër me -18.71%, DRT Gjirokastër me -14.65%, dhe DRT Lezhë me -11.17%. (Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 6: Strukturat përgjegjëse në DPT, udhëhequr nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe strukturat e kontrollit tatimor të marrin menjëherë në analizë situatën tatimore të grup tatimpagues me impakt në të ardhurat e tatimit mbi fitimin, ndryshimet në deklaratimet historike të këtyre subjekteve por edhe situatën e tyre lidhur me gjendjen debitoare dhe kreditore të mbartur, duke i dhënë prioritet analizës dhe vlerësimit të riskut të subjekteve që operojnë në sektorin e prodhimit (energjetik) dhe atë të ndërtimit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 7: Nga evidencat e auditimit rezulton se burimi kryesor i të ardhurave të arkëtuara dhe raportuara për zërin “tatimi mbi fitimin” janë parapagimet e kësteve në shumën 23,886,193 mijë lekë ose 65.5% e të ardhurave, dhe 12,528,533 mijë lekë ose 34.3% nga pagesat direkte të tatimit mbi fitimin dhe 0.2% nga kamatëvonesat. Arkëtimet nga parapagimet e kësteve të tatim fitimit kanë mbuluar rreth 80%³⁵ të deklaratimeve faktike për detyrimin e lindur për pagesë të tatim fitimit, por analizuar sipas situatës individuale (deklarime vs. arkëtime) rezulton se jo për të gjithë subjektet mbulimi është i njëjtë. Më konkretisht, për 10,190 subjekte parapagimet mbulojnë më pak se 60% të deklarimit faktik dhe për 5,359 subjekte parapagimet mbulojnë rreth 140% të deklarimit faktik pra rezultojnë me mbi pagesë. Në kushtet kur këto të ardhura janë “parapagime” të bazuara në përllogaritje mbi rezultatet e vitit të kaluar, rrjedhimisht jo në çdo rast përputhen me detyrimin faktik të subjektit, të lindur me deklarimin e vitit pasardhës. Diferenca në kohë e afateve të mbylljes së vitit fiskal më 31.12.2019 me afatet e deklarimit nga subjektet për rezultatet e vitit 2019 më 31 Mars 2020, sjell rezikun e mbivlerësimit të të ardhurave të raportuara, e mbështetur kjo dhe me faktin që në C@TS rezulton ende një teprice e lartë kreditore për këtë zë të ardhurash (subjektet që kanë mbi paguar). Referuar arkëtimeve pagesat për tatim fitimin janë kryer nga gjithsej 16,521 subjekte. Referuar deklaratimeve në C@TS për tatim fitimin, konstatohet se 15,757 subjekte ose 67% nga 23,542 tatimpagues të cilët kanë plotësuar detyrimin e dorëzimit të deklaratës së tatimit ku shuma e rubrikës “detyrimi të lindur për tu paguar” është 29,151,699 mijë lekë ndërkohë që parapagimet për këtë periudhë janë në shumën 22,847,767 mijë lekë. Në pamje të parë, duket se parapagimet kanë mbuluar rreth 80%³⁶ të deklaratimeve faktike, por nëse subjektet do të analizohen sipas situatës individuale (deklarime vs. arkëtime) rezulton se jo për të gjithë subjektet situata është e njëjtë. Më konkretisht, për 10190 subjekte parapagimet mbulojnë më pak se 60% të deklarimit faktik dhe për 5359 subjekte parapagimet mbulojnë rreth 140% të deklarimit faktik pra rezultojnë me mbi pagesë.

Gjatë vitit ushtrimor, në zbatim të nenit 30 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, strukturat e kontrollit tatimor nga zyra, vlerësojnë nëse tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese tatimore do të tejkalojë me më tepër se 10% tatimin mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore duke vendosur kështu rishikimin në rritje të kështit të parapagimit, përgjithësisht në muajt Nëntor-Dhjetor. Me qëllim auditimin e rasteve të rishikimit të kësteve, u

³⁵2270 subjekte me një vlerë detyrimi të deklaruar prej 562 milionë lekë nuk kanë bërë deklaram ne vitin 2018 rrjedhimisht nuk kanë impakt në parapagimet e arkëtuara në vitin 2019, prandaj këto subjekte janë përjashtuar nga përllogaritja.

³⁶2270 subjekte me një vlerë detyrimi të deklaruar prej 562 milionë lekë nuk kanë bërë deklaram ne vitin 2018 rrjedhimisht nuk kanë impakt ne parapagimet e arkëtuara ne vitin 2019, prandaj keto subjekte jane perjashtuar nga përllogaritja



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

evidentuan 1,179 subjekte që kanë deklaruar një fitim mbi 10% më të lartë se viti 2018, nga të cilat 700 subjekte kanë deklaruar një tatim fitimi mbi 50% më të lartë se viti 2018.

Informacioni i vënë në dispozicion nuk ishte i plotë me datat e rishikimeve ndërkohë që për disa subjekte “kësti i rishikuar” nuk vinte nga rivlerësimi nga zyra por ishin këste të gjeneruara rishtas nga sistemi C@TS, pra një korrigjim në kohë. Për këto raste, në përgjigje të kërkesave të grupit për plotësimin e datave të rishikimeve, në observacion u vu në dispozicion informacion shtesë vetëm për 15 subjekte të cilët rezultojnë me humbje ose humbje të mbartur në deklarimin e 31 Marsit duke justifikuar kështu mos gjenerimin në kohë të këstit të ri. Megjithatë një testim i plotë i këtyre rasteve nuk u arrit deri në përfundim të auditimit dhe grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi përputhshmërinë e veprimeve në zbatim të nenit 30 të ligjit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 7.1: Drejtoria e Kontrollit Tatimor në bashkëpunim me AKSHI-n në cilësinë dhe përgjegjësinë e shërbimit TI për DPT, të verifikojë procedurat e implementuara në sistem për gjenerimin e këstit të ri të tatimit mbi fitimin, pas deklarimeve të 31 Marsit.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 7.2: Titullari i DPT të vlerësojë rregullshmërinë e procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor për rishikimin e kësteve të tatim fitimit në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Afati: Menjëherë

Gjetja 8: Mungesë e kontroleve dhe masave eficiente për monitorimin DRT-ve në aplikimin e gjobave në mënyrë të plotë dhe barabartë për të gjithë tatimpaguesit debitorë për këstet e parapagimit të tatim fitimit në kundërshtim me nenin 12 dhe 30 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezultojnë dhe detyrime për “Gjobë për mospagim të kësteve të tatim fitimit”³⁷ për të cilët u testuan 250 subjekte të cilat kanë deklaruar fitim tatimor por nuk rezultojnë të kenë paguar këstet e parapagimit të tatim fitimit. Nga të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Kontrollit konstatohet se nga 250 subjekte e përzgjedhur vetëm 81 prej tyre janë ngarkuar me gjobë për mos pagesë kësti të tatim fitimit në total. Sipas Drejtorisë së Kontrollit, kjo gjobë nuk llogaritet automatikisht nga sistemi por vendoset manualisht nga inspektorët tatimorë në DRT. Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, pika 114/1. “*Mospagimi i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin*”, tatimpaguesi i cili nuk paguan në afat këstet paraprake të tatimit mbi fitimin ose këstet paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, detyrim ky i përcaktuar sipas nenit 30, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dënohet me gjobë, në masën 10 për qind të shumës së këstit për tu paguar. Fakti që kjo gjobë ekzekutohet manualisht në përgjegjësinë e inspektorëve të kontrollit vlerësohet me një risk të lartë për sa i përket zbatueshmërisë së plotë dhe të barabartë të këtij penaliteti. Në observacionet e subjektit citohet fakti se nga DKT në DPT janë mbajtur procesverbale duke ngarkuar me përgjegjësi direkte inspektorët të cilët nuk kishin vendosur penalitet për subjektet të cilët kishin në ngarkim. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 8.1: Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT duhet menjëherë të evidentojë për çdo DRT rastet në numër dhe vlerë gjobash të pa aplikuar, duke identifikuar inspektorët përgjegjës

³⁷ Kodi 1155



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

për çdo rast si dhe të vendosi sistemet e nevojshme të kontrollit për evidentimin dhe raportimin periodik me qëllim shmangien në të ardhmen të shkeljes së konstatuar.

Afati: Menjëherë

Rekomandim 8.2: Titullari i DPT të urdhërojë ngritjen e një grupi pune për identifikimin dhe evidentimin e procedurave që ekzekutohen manualisht në sistemin C@TS, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së kontroleve të aplikacionit në formën e njoftimeve automatike sinjalizuese dhe raporteve të posaçme, plotësimin e gjurmës së auditimit si dhe çdo masë tjetër të nevojshme për sigurimin e zbatimit të ligjit në përputhje me parimet e shprehura në të “për zbatimin e njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore”;

Afati: Menjëherë

Gjetje 9: Shkalla pranimit të padive nga tatimpaguesit për kundërshtimin e akteve administrative rezulton të jetë 45% e rasteve të përfunduara me një vendim të formës së prerë gjatë vitit 2019. Nga auditimi u konstatuan vonesa në regjistrimin e detyrimeve të lindura nga aktet administrative ku datat e shkresave autorizuese për sistemimin e situatës së subjektit gjyq fitues në C@TS variojnë nga 2-13 muaj.

Nga auditimi i data bazës së proceseve gjyqësore të përfunduara gjatë vitit 2019, të vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, rezultojnë 453 procese gjyqësore të përfunduara (vendime në të dy shkallët) me një vlerë totale padie prej 6 miliard lekë nga të cilat rezultojnë të pranuar (plotësisht ose pjesërisht) 157 çështje me vlerë rreth 2 miliard lekë, 251 çështje të rrëzuara me vlerë mbi 3 miliard lekë (përfshirë 10 çështje të pranuar në shkallën e parë e më pas rrëzuar në shkallën e dytë të gjykimit) si dhe 42 çështje të pushuara me vlerë padie 844 milion lekë. Shkalla e pranimit të padive rezulton të jetë 45% e gjithë kërkesë padive (në numër dhe vlerë) të përfunduara gjatë vitit 2019. Në zbatim të programit të auditimit, përpilimi i një statistike të saktë me qëllim vlerësimin e rasteve të kundërshtimeve të detyrimeve të tatim fitimit nuk është e mundur pasi mungon përshkrimi i plotë i çështjeve me referencat përkatëse si dhe pothuaj të gjitha kërkesë paditë listuar në këtë data bazë përfshijnë disa lloje detyrimesh tatimore të konkluduara nga një kontroll tatimor. Për rastet kur DPT rezulton të jetë humbës, vendimi i gjykatës dërgohet në Drejtorinë e Kontrollit për të bërë sistemimet përkatëse në sistem për anulimin/fshirjen e detyrimit të tatimpaguesit gjyq fitues. Me qëllim testimin e kryerjes së sistemeve përkatëse në C@TS për secilin subjekt është kërkuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor verifikimi i situatës të 27 subjekteve gjyq fitues nga ku rezultoi se datat e shkresave autorizuese për sistemimin e situatës së subjektit gjyq fitues variojnë nga 2-13 muaj. Për 4 raste kemi vetëm shpjegimin “transferuar në DRT tjetër” por jo shkresën dhe konfirmimin nëse detyrimi është anuluar ose jo në sistem. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 9: DPT me strukturat e saj përgjegjëse: DKT dhe Drejtorinë tekniko-ligjore duhet menjëherë të hartojnë një procedurë për rakordimin periodik të detyrimeve të gjyq fituesve, në numër dhe vlerë detyrimi, me qëllim pasqyrimin e saktë dhe në kohë të situatës së tatimpaguesve në funksion të raportimit koherent të dhe gjendjes së debitorëve në C@TS.

Afati: Menjëherë

Gjetja 10: Në sistemin C@TS, detyrimet e 158 subjekteve që janë ende në proces gjyqësor u konstatuan 62 subjekte, gjendja debitorë në kohë reale (Korrik 2019) e të cilëve nuk pasqyron detyrimet për të cilat subjekti është ende në proces gjyqësor³⁸.

³⁸ Referuar data bazës së çështjeve gjyqësore në proces në shkallën e parë apo të dytë vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore në DPT.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Në zbatim të programit të auditimit u kërkuar dhe u vunë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike lista e çështjeve gjyqësore me status “në proces” deri më 31.12.2019. Në këtë listë rezultojnë të raportuara rreth 300 çështje gjyqësore në proces nga të cilat 98 çështje në shkallën e parë dhe 214 çështje/padi në proces në shkallën e dytë të gjykimit, me një vlerë totale padie rreth 3 miliard lekë nga të cilat 27 çështje/padi për kundërshtim të vlerësimit të tatimit mbi fitimin dhe gjoba të lidhur me të, me një vlerë totale padie rreth 1.4 miliard lekë³⁹.

Detyrimet e njoftim vlerësimeve regjistrohen në sistemin C@TS nga inspektorët e kontrollit për secilin subjekt. Pavarësisht se këto detyrime nuk janë arkëtuar ato nuk ndiqen nga Drejtoria e Mbledhjes me forcë për sa kohë detyrimet janë kundërshtuar në gjykatë. Me qëllim testimin e situatës së këtyre subjekteve në sistemin C@TS është kërkuar informacion mbi detyrimet reale të **158 subjekteve që janë ende në proces gjyqësor nga ku rezultoi se në 62 subjekte DRT Korçë (8 raste) dhe Vlorë (11 raste) etj., gjendja debitore në kohë reale (Korrik 2020) nuk pasqyron detyrimet për të cilat subjekti është ende në proces gjyqësor me një diferencë në balancën debitore me rreth 137,564 mijë lekë më pak.** Duke marrë në konsideratë që situata e subjekteve në sistemin C@TS është dinamike dhe e ndryshueshme në kohë, si auditues nuk mund të japim siguri për shkakun e diferencave në vlera të konstatuara. Kjo mbetet për verifikim të mëtejshëm nga DKT dhe DRT-re që administrojnë këto subjekte dhe që ndjekin rastin në gjykatë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 10: DPT me strukturat e saj përgjegjëse: Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike të urdhërojë menjëherë kryerjen e një verifikimi për identifikimin e plotë të numrit të subjekteve në proces gjyqësor dhe vlerën e detyrimit respektiv të regjistruar në C@TS nga inspektorët e kontrollit por të kundërshtuar nga subjekti. Për çdo pasaktësi të konstatuar të sistemohet situata e tatimpaguesit dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse.

Afati:

Menjëherë

Gjetja 11.1: Gjendja kreditore në sistemin C@TS në 31.12.2019 është 14,150,843 mijë lekë, tepricë që i takon rreth 12,400 subjekteve. Teprica kreditore për tatim fitimin vazhdon të mbetet e lartë dhe gjatë vitit 2019 edhe pse rezultojnë të ketë ndryshuar me vetëm 1 miliard lekë (pakësim) krahasuar me fund vitin 2018. Për tatimin mbi fitimin, kompensimi duhet të bëhet brenda muajit të parë që pason muajin në të cilin personi i tatueshëm rezultojnë me kredi tatimore por nga të dhënat nuk rezultojnë që një procedure e tillë të ndodh automatikisht në C@TS.

Gjendja kreditore në sistemin C@TS në 31.12.2019 rezultojnë të jetë 14,150,843 mijë lekë tepricë që i takon rreth 12,400 subjekteve kreditore, nga të cilët 215 subjekte, me një tepricë kreditore rreth 141 milion lekë, rezultojnë të kenë kaluar në status “pasiv” gjatë vitit 2019. Krahasuar me një vit më parë, teprica kreditore nga parapagimet e tatim fitimit ka ndryshuar me vetëm 1 miliard lekë. 50 tatimpaguesit me tepricën kreditore më të lartë evidentohen: B P, K Intl., S-Shqiperi, V Al, R B sha, T Al etj. Në listën e kreditorëve më të mëdhenj, referuar shumës së përdorur pas deklarimit në vitin 2019 për llogari të periudhës 2018, duket se disa nga subjektet pavarësisht shumës së vogël të përdorur (rezultat i detyrimit të tatim fitimit shumë të ulët faktik kundrejt vlerësimit paraprak të administratës tatimore) përsëri kanë vijuar me parapagime në vlera të larta. Më konkretisht:

-16 raste me një tepricë kreditore rreth 670 milion lekë, ku subjekti ka deklaruar humbje në deklaraten e dorëzuar në muajin Mars 2019 dhe përsëri ka vazhduar me pagesë të parapagimeve

³⁹Referuar përshkrimin të statusit në tabelën e vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore, vlera e padisë mund të përfshijë edhe zëra të tjerë të vlerësuar gjatë një kontrolli si TVSH, kontribute etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

të kësteve të tatim fitimit për periudhën Prill- Dhjetor 2019, duke shtuar kështu tepricën kreditore. Nga të dhënat rezultojnë se po këto subjekte kanë deklaruar përsëri humbje në Mars 2020, pra nuk kanë arritur të përdorin shumën e parapaguar për tatim fitimin. Për rastet e subjekteve me humbje dhe me pagesë është kërkuar shpjegim nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor por deri në përfundim të këtij auditimi informacioni nuk u vu në dispozicion.

-6 subjekte me një tepricë kreditore në total rreth 160 milionë lekë, konstatohet se nuk kanë dorëzuar deklaratën e tatimit mbi fitimin në të dy vitet 2018 dhe 2019. Subjektet në fjalë nuk rezultojnë as në listën e subjekteve pasiv.

Sipas Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75, kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe se shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin e vlerësimit tatimor apo në deklaratën tatimore, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga personi i tatueshëm. Një gjë e tillë, bëhet në mënyrë automatike nga vetë administrata tatimore, brenda periudhës së parë vijuese tatimore që vjen pas periudhës në të cilën personi i tatueshëm rezultojnë me kredi tatimore. Për tatimin mbi fitimin një gjë e tillë, bëhet brenda muajit të parë që pason muajin në të cilin personi i tatueshëm rezultojnë me kredi tatimore. Nga të dhënat nuk rezultojnë që një procedurë e tillë të ndodhë automatikisht. Nga 50 subjektet me tepricë kreditore më të lartë në total 8.9 miliard lekë, të mbartur që nga viti 2018 dhe/ apo të krijuar rishtas, rezultojnë me balanca debitore në total rreth 1.8 miliard lekë (pa përfshirë detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore). Në total balanca debitore e të gjithë subjekteve kreditore për tatim fitimin rezultojnë të jetë 19 miliard lekë nga të cilat 2.3 miliard lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe gjatë e lidhura me të. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Gjetja 11.2: Nga të dhënat analitike të tepricës kreditore të tatim fitimit në C@TS, për rastet e rimbursimit konstatohen diferenca me të dhënat në SIFQ, në numër subjektsh dhe vlera të paguara. Nga këto raste, rimbursimi për subjektin “V H P” me NIPT LXXXXA, është bërë pjesërisht në kundërshtim me nenin 73 të Ligjit nr.9920 “Për procedurat Tatimore në RSH” në shumën 2,327 mijë lekë.

Nga të dhënat analitike të tepricës kreditore të tatim fitimit konstatohen diferenca në numër subjektsh dhe vlera të paguara midis të dhënave në SIFQ (Thesari) dhe sistemit C@TS. Kështu, konstatohen gjithsej vetëm 6 subjekte të cilat janë rimbursuar në shumën 49,091 mijë lekë. Nga rakordimi me të dhënat e pagesave në Thesar (SIFQ) rezultojnë 7 subjekte të jenë rimbursuar për tepricat kreditore të tatim fitimit në shumën 47,568 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se për rastin rimbursimit të subjektit “V H P” me NIPT LXXXXA administruar nga DRT Tiranë, ka paraqitur në datën 15.07.2019 kërkesën për rimbursimin e tepricës kreditore përfshirë këtu dhe tatim fitimin e paguar për periudhën 13-A në shumën 2,326,763 lekë. Gjithashtu referuar periudhave, në zbatim të nenit 73 të Ligjit nr.9920 “Për procedurat Tatimore në RSH”, e drejta për të kërkuar rimbursim të shumave paguar tepër parashkruhet pas 5 vjetësh nga data e deklaratës së parë. Në këtë mënyrë shuma e kërkuar dhe rimbursuar për periudhën 13-A është paguar në kundërshtim me parashikimin ligjor. Grupi i auditimit ka kërkuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor të konfirmojë situatën e subjektit, tepricën kreditore të raportuar, si dhe rregullshmërinë e miratimit nga ana e DRT Tiranë të shumës që i përket periudhës 13-A. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 11: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me strukturat e saj përgjegjëse të kryej menjëherë verifikimin e procedurave të ndjekura për rastet e rimbursimit të shumave kreditore të tatimit mbi fitimin të evidentuara sa më lartë, me qëllim vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së shumës së rimbursuar subjektit.

Afati: Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Gjetja 12: Konstatohen arkëtime për TVSH të palidhura dhe të pa sistemuara me një detyrim tatimor, në total 768 milion lekë duke rritur kështu arkëtimet e raportuara ndërkohë dhe detyrimin kreditor të administratës tatimore ndaj këtyre tatimpaguesve.

Nga raporti i të ardhurave tatimore për periudhën Janar- Dhjetor 2019, një tjetër llogari në grupin 4665: “Depozitime të tjera (për tu sistemuar në të ardhmen)”, evidentohet dhe llogaria 4665504 “Depozitime të përkohshme për deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar” e cila më 31.12.2019 rezulton me një balancë kreditore prej 768,059 mijë lekë. Ndryshe nga natyra e llogarisë 4665503 “Depozitime të përkohshme për deklaratën e tatimit fitimit”, në këtë rast tepricat kreditore të akumuluar në këtë llogari vijnë si rezultat i pagesave të kryera nga subjektet ndërkohë që në sistemin C@TS nuk ekziston një detyrim. Këto shuma duhet të sistemohen në periudhat e ardhshme. Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohet se pagesat e kryera nga subjektet i referohen kryesisht periudhës tatimore viti 2019 në total 739 milion arkëtime por edhe periudhave të mëparshme tatimore nga viti 2002- 2018. Nga auditimi, konstatohet se pagesat më të mëdha janë kryer nga disa subjekte në muajin Dhjetor 2019 në total 624 milionë lekë, kryesisht nga subjekte të administruar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me rreth 523 milionë lekë arkëtime, DRT Tiranë dhe DRT Fier respektivisht me rreth 31 milion lekë arkëtime. Nga të dhënat e arkëtimeve sipas muajve, shumat e arkëtuara nuk rezultojnë të jenë sistemuar në muajt pasardhës sipas detyrimeve aktuale të lindura për subjektin që ka kryer pagesën. Këto pagesa konstatohen të jenë në vlera më të mëdha dhe më frekvente në muajt Tetor- Dhjetor. Nga auditimi konstatohet se e njëjta situatë paraqitet edhe në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjithashtu konstatohet se disa nga subjektet që kanë kryer këto pagesa të pa lidhura me një detyrim TVSH-je të rezultojnë të jenë në listën e subjekteve me tepricë kreditore. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 12: Nga strukturat përgjegjëse në DPT të kryhet verifikimi dhe sistemimi i shumave të paguara pa u shoqëruar me një deklaratë detyrimi tatimor dhe të pa sistemuara në periudhat pasardhëse. Drejtoria e Kontrollit Tatimor në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të hartojë një procedurë/udhëzues për rakordimin periodik të këtyre pagesave duke shmangur kështu rritjen artificiale të të ardhurave dhe detyrimit kreditor të administratës tatimore.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 13.1: Plotësimi i deklaratës së tatimit mbi të ardhurat në burim mbart shumë gabime, jo vetëm në klasifikimin e llojit të të ardhurave në rubrikat e gabuara. Kështu janë evidentuar shumë raste të deklarimit të tatimit në burim për qiranë plotësuar në rubrikën “dividend” dhe rrjedhimisht të raportuar në kodin buxhetor të gabuar 7009100.

Mungojnë sistemet e kontrollit për verifikimin e saktësisë së deklaratave lidhur me shkallën e duhur tatimore të aplikuar si dhe periudhën tatimore të cilit ky deklarim i përket.

Arkëtimet për vitin 2019 të zërit “Tatimi mbi të ardhurat nga Dividendët dhe Aksionet”, raportohen në shumën 11,061,159 mijë lekë. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat nga dividendi kanë një rritje prej rreth 200% ose 7.37 miliard lekë. Kjo shpjeguar me ndryshimet ligjore të parashikuara me Ligjin nr.94/2018 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, sipas të cilit është bërë ndryshimi në trajtimin fiskal për të ardhurën nga dividendi, duke shtuar në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, pika 9⁴⁰.

⁴⁰“Norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8 % do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Nga auditimi i të dhënave të raportuara në kodin buxhetor 7009100 në nivel subjekti mbi saktësinë e plotësimit të deklaratës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat sipas llojit rubrika 8 “dividend”, u konstatuan të regjistruara edhe pagesa që nuk kanë lidhje me llogarinë “të ardhurat nga dividendi” por me “të ardhurat nga qiraja”.

Nga auditimi i të dhënave të kodit buxhetor 7009100, për periudhën Tetor- Dhjetor 2019 konstatohet se 99 subjekte kanë vijuar me pagesa edhe pas afatit të fundit të aplikimit të shkallës tatimore 8% të 30 shtatorit 2019. Duke qenë se pas kësaj date çdo subjekt që do të deklarojë fitime të paspërndara dhe të padeklaruara të vitit 2017 e më herët, nuk është më i “favorizuar” për aplikimin e shkallës tatimore 8% por duhet të aplikojë shkallën standarde 15%. Për grupin e auditimi ishte e pamundur vlerësimi i përputhshmërisë së periudhës së deklaruar me shkallën tatimore të re të aplikuar për shkak të pasaktësive në plotësimin në deklaratë të periudhës tatimore pasi siç është trajtuar edhe më lartë, në deklarime subjekti i është referuar periudhës tatimore 2019. Kjo kërkon një verifikim rast pas rasti në sistemin C@TS nga DRT-të respektive. Referuar deklarimeve për dividendin, konstatohet se:

-vetëm **32 nga 99 subjektet** kanë deklaruar⁴¹ dividend në shumën 405,946 mijë lekë me një detyrim tatim në burim të llogaritur 58,200 mijë lekë ndërkohë që shumat e paguara nga këto subjekte janë vetëm 20,477 mijë lekë;

-67 subjekte nuk rezultojnë të kenë deklaruar dividend ndërkohë që shuma e paguar prej tyre është 66 milion lekë, dhe këto mund të jenë pagesa për të tjera të ardhura në burim por deklaruar në rubrikën e gabuar.

-Konstatohen të kenë deklaruar në këto rubrika dhe **25 ente publike** me një vlerë detyrimi tatimi në burim nga dividendi dhe fitimi i shpërndarë prej 3.6 milion lekë, subjekte këto të cilat nuk mbartin përgjegjësinë e deklarimit të fitimit. Këto raste janë dërguar në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor për ti përcjellë në DRT-të respektive me qëllim sistemimin e situatës së këtyre subjekteve në C@TS.

Në konkluzion: plotësimi i deklaratës së tatimit mbi të ardhurat në burim mbart shumë gabime jo vetëm në klasifikimin e llojit të të ardhurave por dhe në rubrikat “baza për tatimin” dhe “shuma për tu paguar” rrjedhimisht kodi buxhetor (llogaria) 7009100- ku raportohen “të ardhura nga dividendi dhe aksionet” në gjykimin e audituesit bazuar në evidencat e auditimit, është i mbivlerësuar marrë në konsideratë klasifikimet e llojit të të ardhurave në rubrikat e gabuara. Për shkak të volumit të lartë të dhënave, për grupin e auditimit ishte e pamundur kuantifikimi i të gjitha rasteve në numër dhe vlerë, që nuk i përkasin tatimit mbi dividendin. Cilësia e të dhënave nuk lejon kryerjen e një analize të drejtë për vlerësimin e përputhshmërisë së aplikimit të shkallës tatimore të kufizuar në kohë “*deri 30 shtator 2019*” për fitime të paspërndara deri në vitin 2017. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Gjetja 13.2: Në deklaratën e tatimit të të ardhurave në burim mungon rubrika për “të ardhurat nga veprimet me aksionet” duke e bërë të pamundur identifikimin e kësaj lloji të ardhura dhe shkallën tatimore të aplikuar. Në lidhje me rubrikën nr.9 “ndarja e fitimit” totali i tatimit në burim i deklaruar është rreth 2.12 miliard lekë. Nga 848 deklarime të cilat i përkasin periudhave për të cilat nuk aplikohet shkalla 8%, vetëm 77 prej tyre kanë aplikuar një shkallë tatimore të ndryshme nga 8%.

Sipas Udhëzimit nr.12 datë 15.3.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar deklarata e miratuar e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, rubrika 9 “ndarja e fitimit” nuk është rubrikë në të cilën duhet të deklarohet e ardhura nga dividendi por ndarjet e fitimit të ortakut cituar: “Rubrika [9] *Ndarjet e fitimit plotësohen me shumat e pagesave për ndarjet e fitimit që i kryhen ortakut pas miratimit të rezultatit financiar dhe miratimit të destinimit të fitimit*”. Nga auditimi i deklaratave të

⁴¹Burimi: Drejtoria e KontrollitTatimor



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

regjistruara gjatë vitit 2019 konstatohet se në rubrikën nr.9 “ndarja e fitimit” totali i tatimit në burim i deklaruar është rreth 2.12 miliard lekë. Norma mesatare e aplikuar në këtë rubrikë është 8% megjithatë verifikuar në nivel deklarate përqindjet e aplikuar variojnë nga 0% - 100%, kjo duke supozuar që vjen për shkak të gabimeve në plotësimin e deklaratës (shuma e të ardhurave = shumën e tatimit). Referuar llojit të tatimit ndryshimet ligjore për shkallën tatimore për dividendin nuk janë të aplikueshme për zërin “ndarje fitimi” për efekt deklarimi të fitimeve të periudhave para vitit 2018, lehtësi kjo e parashikuar vetëm për zërin “dividend”. Nga të dhënat rezulton se nga 848 deklarues vetëm 77 prej tyre kanë aplikuar një shkallë tatimore të ndryshme nga 8% deklarime të cilat i përkasin periudhave të cilat nuk aplikohet shkalla 8%. Ndërkohë në listën e të dhënave ashtu si edhe për rubrikën 8, konstatohen pagesa periodike mujore nga i njëjti subjekt. Po ashtu edhe në këtë rubrikë konstatohen ente publike që të kenë deklaruar shpërndarje fitimi ndërkohë që nuk mbartin përgjegjësi tatimore për tatim fitimin. Nga numri i rasteve të konstatuara, mundësia që edhe këto deklarata të jenë plotësuar gabim në lidhje me klasifikimin e të ardhurave sipas llojit është e lartë dhe për të përlogaritur një vlerë për impaktin në saktësinë e të ardhurave të raportuara sipas kodeve buxhetore është i nevojshëm verifikimi rast pas rasti në sistemin C@TS, verifikim ky i pamundur për këtë auditim. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 13: Drejtoria tekniko-ligjore të publikojë një material sqarues në vijim të Udhëzimit nr.12 datë 15.03.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar për të shpjeguar dhe ilustruar plotësimin deklarates për të ardhurat në burim. DPT në bashkëpunim me MFE të marrë në konsideratë propozimin për ndryshimin e deklarates për të ardhurat në burim për të shtuar rubrikën “ të ardhura nga veprime me aksionet” për të shmangur kështu raportime të gabuara në llogarinë 7009100.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 14: Pavarësisht rritjes së të ardhurave të arkëtuara nga një vit më parë, konstatohet se niveli i pagës mesatare mujore të deklaruar mbetet në kufijtë e pagës minimale për disa sektorë të ekonomisë dhe grup tatimpaguesish. Konstatohet mungesë strategjie dhe kontrollosh tatimore me bazë risku të dedikuara për deklarimin e punonjësve dhe pagave. Nga evidencat e vëna në dispozicion raportohen të ardhura të arkëtuara nga “tatimi mbi pagë nga listëpagesat” në shumën **22,279,842 mijë lekë ose 6.3% më shumë se viti 2018.** Arkëtimet e realizuara vijnë 8.3 miliard nga sektori publik dhe 13.9 miliard nga sektori privat. Të ardhurat e arkëtuara për të dy sektorët rezultojnë me rritje krahasuar me një vit më parë, respektivisht +9.8% dhe +4.3%. Analizuar në raport me numrin e punonjësve të deklaruar në Janar 2019 dhe Dhjetor 2019, rezulton se numri i punonjësve të deklaruar në total është rritur me 13,259 punonjës ose 2% më shumë se fund viti 2018. Duke shmangur efektin negativ të uljes së numrit të punonjësve nga subjektet të cilat gjatë vitit 2019 janë çregjistruar, kanë bërë kërkesë për çregjistrim apo kanë kaluar në status pasiv, rritja bruto e numrit të punonjësve është +33,297 ose 5% më shumë se fund viti 2018, referuar kjo deklarimit të 127,840 subjekteve. Sipas sektorëve të ekonomisë, rritje në deklarimin e numrit të punonjësve evidentohet për subjektet që operojnë në sektorin e shërbimit 7%, të tregtisë me 6%, transportit me 4% dhe ndërtimit me 3%. Për një vlerësim të drejtë të impaktit të rritjes së numrit të punonjësve të deklaruar në rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi pagë duhet të merret në konsideratë dhe niveli i pagës së deklaruar. Nga auditimi i të dhënave nga auditimi, rezulton se paga mesatare bruto për vitin 2019 sipas sektorëve të ekonomisë varion nga 29,670 lekë sipas deklarimeve të subjekteve që operojnë në sektorin e tregtisë deri në 49,500 lekë nga deklarimet e subjekteve që operojnë në sektorin e shërbimit ku përfshihen kryesisht edhe subjektet “ente publike”.

Me qëllim evidentimin e zonave me risk në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e deklarimeve të numrit të punonjësve dhe pagës bruto për efekt të mbledhjes së të ardhurave nga tatimi mbi pagë,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

të dhënat nga sistemi C@TS për subjektet me status aktiv janë analizuar edhe sipas formës ligjore, peshës specifike dhe pagën mujore mesatare të deklaruar, ku konstatohet se:

1) 20,623 subjektet e regjistruara si “shoqëri me përgjegjësi të kufizuara-shpk” kanë deklaruar rreth 290 mijë punonjës ose 43% të numrit total të punonjësve të deklaruar nga të gjithë subjektet me status aktiv, dhe një pagë mesatare mujore më pak se 40,000 lekë (nga të cilët paga e tatueshme është vetëm 10,000 lekë). Në këtë grup evidentohen rreth 620 subjekte (nga të cilët 125 subjekte “biznes i madh”), të cilat deklarojnë pagë bruto “zero” dhe 194 subjekte (nga të cilat 37 subjekte “biznes i madh”) rezultojnë me deklaram 1 punonjës me pagë bruto nga 1- 29,700 lekë, pra më një efekt “zero” lekë tatim.

2) grupi i subjekteve “person fizik” deklaror mesatarisht 147 mijë punonjës ose 22% të totalit të punonjësve të deklaruar, me një pagë mesatare mujore 11,525 lekë pra praktikisht me zero efekt në të ardhurat personale të realizuara.

Nga informacioni mbi kontrollet e ushtruar gjatë vitit në subjekte, si pjesë e planit mujor të DRT-ve, rezulton se kontrollet mbi saktësinë e deklarimit të punonjësve janë pjesë e kontrolleve të përgjithshme të tatimit mbi fitimin, kontrolle këto që mbulojnë të gjithë komponentët e situatës fiskale të një tatimpaguesi por jo kontrolle të dedikuara (tematik) mbi saktësinë e deklarimit të punonjësve dhe pagat nisur nga shkalla e lartë e informalitetit e cila mbetet tepër e lartë dhe kërkon një vlerësim risku të dedikuar për profile të caktuara tatimpaguesish dhe në bazë rajoni. Sipas drejtorive rajonale të ardhurat e arkëtuar sigurisht vijnë nga DRT Tiranë dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, respektivisht me një kontribut prej 36% dhe 39%, ku DRT Tiranë mbart dhe 61% të debitorëve për mos pagesë të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (TAP). (trajtuar më hollësisht në pikën B4.4 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 14: Strukturat përgjegjëse në DPT të analizojnë të dhënat historike të deklarimit të numrit të punonjësve dhe pagave, me qëllim identifikimin e grup-tatimpaguesve me risk për deklarime fiktive, me qëllim hartimin e strategjive dhe plane të kontrolleve tatimore të dedikuara për sektorë të caktuar të ekonomisë të karakterizuar nga një nivel i lartë i informalitetit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 15: Të ardhurat nga deklarata individuale vjetore rezultojnë të jenë arkëtuar 367 milionë lekë ose 7.5% më pak se viti 2018 ndërkohë që gjendja debitorë për këtë zë të ardhurash ka shkuar në 196 milionë lekë. Ndryshimi ligjor i hyrë në fuqi më 1 Janar 2020 dhe afat deklarimi 30 Prill 2021 mbart rrezikun e mos deklarimit korrekt për shkak të kompleksitetit për fasha të caktuara tatimpaguesish, të përfshira rishtas në këtë detyrim deklarimi.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion kodi buxhetor për regjistrimin e pagesave nga individët që plotësojnë kushtin për raportimin e DIVA⁴² rezultojnë se janë arkëtuar 367 milionë lekë ose 7.5% më pak se viti 2018. Sipas periudhave të deklaruara tatimi i paguar i referohet periudhave 2011-2018 ndërsa DRT-ta me arkëtimet me të larta janë DRT Tiranë me 291 milionë ose 80% e totalit të arkëtimeve e ndjekur nga DRT Durrës me 20 milionë lekë ose 6% e arkëtimeve. Afati ligjor sipas Ligjit nr.8438 neni 13 pika 2 e tij, tatimpaguesit dorëzojnë deklaratën vjetore të të

⁴²Në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” përcaktohet: Kreun II i Ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar në nenin 6, citon: “Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve.”, Në nenin 13 pika 4 të këtij neni citohet “Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2,000,000 (dy milionë) lekë”. Neni 4 i ligjit “Burimi i të ardhurave” rendit një sërë kategorish të ardhurash por, pa u kufizuar vetëm në to, pasi kjo hapësirë përfshihet në pikën i) “të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen”. Neni 39 “Regjistri i individëve” përcakton se 2. Administrata tatimore qendrore mban regjistr të veçantë të individëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi. Nga auditimi i të dhënave për debitorët për këtë lloj tatimi, rezultojnë rreth 2,400 debitorë me një detyrim të papaguar prej 196.8 milion lekë nga 112.3 milionë të raportuara në fund të vitit 2018. Vetëm gjatë vitit 2019, gjendja debitoare është rritur me 125.6 milion lekë.

Vetë deklarata (DIVA) nuk parashikon deklarimin individual për çdo punëdhënës në rubrika të veçanta por si një shumë totale nga të gjithë punësimet në rubrikën 3- “të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit” dhe rubrika 4-“tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet e punësimit”. Gjithashtu, deklarata individuale vjetore e të ardhurave, mund të plotësohet edhe nga çdo individ, i cili megjithëse nuk e ka detyrimin ligjor për këtë, për arsye se dëshiron të përfitojë, nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj, kur ky individ plotëson kushtet e përfitimit nga zbritja e shpenzimeve⁴³. Në auditimet e mëparshme KLSH ka ngritur çështjen e diskriminimit që kriteri i parashikuar për lindjen e detyrimit të deklarimit të DIVA prekte vetëm një fashë të caktuar të individëve të punësuar, por që është zgjidhur ligjërisht me ndryshimet e parashikuara në Ligjin nr.84/2019 datë 18.12.2019 për një ndryshim në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998, i ndryshuar sipas të cilit bëhet ndryshimi i kriterit për lindjen e detyrimit të deklarimit vjetor individual të të ardhurave në nenin 13 pika 4 shtohet, citojmë “Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit”. Ky ligj nuk ka parashikuar një dispozitë kalimtare për të përcaktuar afatet e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo është rregulluar me Udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhura” i ndryshuar, pika 2.8.1.3 cituar “....Ky parashikim zbatohet për individët të cilët kanë përfituar të ardhura nga punësimi nga më shumë se një punëdhënës duke filluar nga **1 janari 2020**”. Ky individ i dy punësuar duhet që, brenda datës **30 prill 2021**, të plotësojë deklaratën vjetore të të ardhurave në të cilën të ardhurat mujore nga paga, do të llogariten si total i të ardhurave nga paga nga të gjitha burimet e punësimit të individit.

Ndryshimi ligjor i parashikuar dhe cituar sa më lartë, i cili duke filluar nga viti 2020 do të prekë një fashë dhe profil më të gjerë individësh duhet të trajtohet me risk të shtuar jo vetëm në lidhje me ndërgjegjësimin për deklarim por veçanërisht për kompleksitetin dhe vështirësitë në plotësimin e deklaratës specifikisht në rubrikën e të ardhurave nga dypunësimi ku individit deklarues i lind detyrimi të bëjë rillogaritjet e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Në shtesë të kësaj, ky vlerësim duhet të bëhet edhe në kuadër të riskut të lartë të mbledhshmërisë që ka mbledhja e detyrimeve të këtyre llojeve të ardhurave. (Trajtuar më hollësisht në pikën B4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 15: Ndryshimi ligjor i parashikuar për deklarimin e DIVA, i cili duke filluar nga viti 2020 do të prekë një fashë dhe profil më të gjerë individësh, duhet të trajtohet me risk të shtuar jo vetëm në lidhje me ndërgjegjësimin për deklarim por veçanërisht për kompleksitetin dhe vështirësitë në plotësimin e deklaratës e cila duhet të shoqërohet me njoftime sqaruuese nga Drejtoria tekniko-ligjore, specifikisht në rubrikën e të ardhurave nga dy punësimi ku individit deklarues i lind detyrimi të bëjë vetë rillogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Brenda vitit 2020

⁴³Në këtë rast, shumën e të ardhurave bruto vjetore, nga të gjitha burimet duhet të jetë, jo më e madhe se 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Gjetja 16.1: Niveli i borxhit për zërin “tatimi mbi fitimin” raportohet në shumën 31.6 miliard lekë ose 1% më shumë se një vit më parë. Detyrimi “principali për tatim fitimin” është rreth 21.8 miliard lekë ose 73% e stokut dhe rreth 7.8 miliard lekë janë gjoba për deklarime të pasakta dhe/ose të vonuara ose 27%. nga 18,800 subjekte debitoare gjithsej 50 prej tyre rezultojnë me nivelin me të lartë të borxhit për këtë lloj detyrimi, me mbi 14 miliard lekë ose 47% të totalit të detyrimit.

Për vitin 2019, në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga DPT, rezulton se shuma e raportuar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në zërin debitor “llog.468” është 120,792,111 mijë lekë nga të cilët **29,792,227 mijë lekë debitorë** për detyrimin e tatimit mbi fitimin dhe gjoba të papaguara krijuar nga mbi 18,800 subjekte kundrejt 18,097 subjekte debitoare të evidentuara një vit më parë. Kjo balancë detyrimesh rezulton të jetë 320,426 mijë lekë ose 1% më e lartë se ajo e raportuar më 31.12.2018. Ndërkohë nga Drejtoria e Mbledhjes me Forcë raportohet se stoku i borxhit tatimor për zërin “tatimi mbi fitimin” është **31,637,015 mijë lekë** për shkak të përfshirjes së detyrimeve për tatim fitimin e thjeshtuar në këtë zë në shumën 2,695,084 mijë lekë. Sipas DRT-ve stoku i borxhit për detyrimin e tatimit mbi fitimin evidentohet me stokun më të lartë të borxhit DRT Tiranë me 15.6 miliard lekë ose 52.6% të stokut ndjekur nga DMT me 6.1 miliard ose 20.6% e stokut, DRT Durrës me 2.3 miliard ose 7.9%. DRT Elbasan me 1.2 miliard lekë ose 4.2%. Nga krahasimi me një vit më parë, duket se stoku i borxhit rritet me një ritëm më lartë sesa pakësohet (mbledhet). Analizuar sipas burimit të detyrimit, detyrimi “principali për tatim fitimin” (përfshirë mos pagesat e kësteve të parapagimit) është rreth 21.8 miliard lekë ose 73% e stokut dhe rreth 7.8 miliard lekë ose 27% janë gjoba për deklarime të pasakta dhe/ose të vonuara. Në kuadër të auditimit të borxhit për tatimin mbi fitimin, i është kërkuar DMF informacion mbi detajimin e detyrimit që ka rrjedhur nga rivlerësimet e kontrollit tatimor dhe sa nga mos pagesa e kësteve të tatim fitimit, por përgjigja është se DMF në DPT nuk e disponon këtë informacion pasi ky informacion administrohet nga DRT-të. Në gjykimin e audituesit, ky informacion duhet të disponohet dhe analizohet si bazë vlerësimi të mbledhshmërisë së borxhit. Kjo duke marrë parasysh që rivlerësimet përgjithësisht kalojnë një proces të gjatë ankimi/apeli dhe mbartin rrezikun e pavlefshmërisë/anulimit të detyrimit të lindur nga këto rivlerësime (akt-kontrolle). Sipas subjekteve, 50 nga 18,800 subjekte debitoare gjithsej, rezultojnë me nivelin me të lartë të borxhit për këtë lloj detyrimi, me mbi 14 miliard lekë ose 47% të totalit të detyrimit. Krahasuar me një vit më parë, stoku i borxhit për top50 subjektet ka ndryshuar në ulje me vetëm 650 milion lekë. Impakt më të konsiderueshëm në këtë ulje ka pasur pagesa e OSHEE prej 3.1 miliard lekë por ndërkohë ky subjekt ka rritur gjendjen debitoare gjatë 2019 me rreth 1.9 miliard lekë ndërkohë 27 subjekte nga ky grup rezultojnë me status “pasiv” me një total detyrimi rreth 6 miliard lekë. Për të vlerësuar c ‘pjesë e këtij borxhi të mbledhur i takon detyrimit të mos pagesës së tatim fitimit, kërkesës së grupit të auditimit për informacion të detajuar për masat shtrënguese të aplikuara, DMF përgjigjet se nuk mund ta ketë informacion të detajuar specifikisht për zërin e tatim fitimit, pasi stoku i borxhit sipas llojit monitorohet dhe raportohet nga DRT-të në DPT sipas evidencave standarde. (Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Gjetja 16.2: Evidencat e raportimit të borxhit janë tepër sintetike dhe mbi to nuk mund të kryhen analiza mbi ecurinë e borxhit dhe efektivitetin e masave në nivel DRT-je. Aq më tepër nuk jepet informacion për borxhin jashtë sistemit⁴⁴, si monitorohet dhe pse shtohet. Nga DMF raportohet se numri i çështjeve në proces gjyqësorë është 1525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen se aktualisht janë 416 çështje

⁴⁴Borxhi ekzistues para implementimit të sistemit C@TS në vitin 2015



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

gjyqësore në proces, me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë.

Nga administrata tatimore borxhi tatimor raportohet në shumën 116,994,228 mijë lekë ose 9,293,691 mijë lekë ose 8.6% më shumë se një vit më parë. Numri i çështjeve në proces gjyqësore është 1525 çështje me një vlerë detyrimi (padie) prej 13,718,843 mijë lekë. Ndërkohë për këto çështje nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike raportohen në proces gjyqësore 416 çështje me një vlerë totale padie/detyrim i kundërshtuar prej rreth 3,074,272 mijë lekë. Nga evidencat e konstatohet se borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet zë 60% të stokut të borxhit. Sipas anekseve shoqëruese të Pasqyrave Financiare, gjendja e debitorëve në fund të periudhës në auditim në sistemin C@TS është 117,996,398 mijë lekë për më tepër në shumën 8,891,504 mijë lekë ose 8.1% më shumë se gjendja debitorë e raportuar më 01.01.2019. Detyrimi i ri i vitit 2019 është 20,975,210 mijë lekë, ku debinë më të lartë të krijuar sipas llojit e zë tatimi TVSH –ja masën 34.53% të totalit ose në shumën 40,399 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,077 miliard lekë; Tatimi mbi fitimin në masën 27.04% të totalit ose në shumën 31,637 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,433 miliard lekë, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 12.92% të totalit ose në shumën 15,113 miliard lekë me një rritje nga fillimi i vitit në shumën 1,283 miliard lekë, etj. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 16: DPT me strukturat e saj përgjegjëse, të urdhërojë ngritjen e një grupi pune me objektiv rakordimin e të dhënave për borxhin tatimor të raportuar, konsideruar këtu të gjitha problematikat e trajtuara në këtë auditim në lidhje me saktësinë e detyrimeve të subjekteve të lindura nga aktet administrative, procedurat e anulimeve/sistemimeve, vlerën e borxhit të pritshëm nga proceset gjyqësore në proces si dhe evidencat e borxhit të cilësuar “jashtë sistemit”.

Afati: Brenda vitit

2020

Gjetje 17: Nga auditimi është konstatuar Ekipi i Menaxhimit të programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk ka planifikuar drejt shpenzimet buxhetore. Shpenzimet për vendime gjyqësore në PBA faza e I-rë janë planifikuar në vlerën 50,964 mijë lekë, ndërsa në PBA faza II-të janë planifikuar në vlerën 50,000 mijë lekë, ndërkohë që nevojat buxhetore vetëm për një prej elementëve të shpenzimeve gjyqësore, detyrimet për **vendime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna**, në fund të vitit 2018 janë në **vlerën 287,615 mijë lekë**. Shpenzimet në zërin “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, në Projekt Buxhet janë planifikuar në vlerën 946,790 mijë lekë, duke u **rritur më shumë në vlerën 770,000 mijë lekë ose 520% më shumë se planifikimi në fazën e parë të PBA-së**. Zëri “Mallra dhe shërbime të tjera në Projekt Buxhet është planifikuar në vlerën 421,741 mijë lekë, **duke u zvogëluar me vlerën 271,759 mijë lekë ose 39.2% krahasuar me planifikimin fillestar**.

Përgjatë vitit 2019, me miratimin e Nëpunësit të Parë Autorizues, është bërë rishpërndarja e fondeve buxhetore në zërin shpenzime korrente në **vlerën totale për 287,849 mijë leke e cila përfaqëson 12.8% të shpenzimeve korrente të miratuara me Ligjin e buxhetit**. Referuar pikës 75 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, numri i lartë i transferimeve buxhetore tregon për një planifikim jo të mirë të shpenzime.

-Projekti i investimit me kod M100500 “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2019-2021. Referuar fazës së dytë të PBA-së 2019-2021, projekti i mësipërm megjithëse datë fillimi ka vitin 2018 dhe datë mbarimi vitin 2020, fondet buxhetore për vitin 2020 dhe 2021 janë planifikuar në vlerën 0 lekë. Gjithashtu në listën e **Investimeve Publike 2019-2021**, të projekt buxhetit të vitit 2019, **nuk është parashikuar vlera e këtij investimi për vitin 2020** e cila referuar kontratës së lidhur për këtë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

projekt është **716,976 mijë lekë**, jo në përputhje me e pikës 6 të Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 të Ministrisë së Financave.

- Projektet e investimeve me kod 18AV903 “Rikonstruksioni i DRT Tiranë” dhe kod 18AV904 “Rikonstruksioni i DRT Dibër” **nuk kanë kaluar procedurat e miratimit të investimeve publike**, pasi nuk kanë qene pjesë e planifikimeve në fazën e parë dhe në fazën e dytë të PBA-së 2019-2021 si dhe nuk rezulton në “Listën e Investimeve Publike për vitin 2019-2021” të projektbuxhetit të vitit 2019, jo në përputhje me kërkesat e nenit 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën C1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim17: Ekipi i Menaxhimit të programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, duhet të marrin masa për identifikimin e drejtë të objektivave dhe produkteve të programit si në kuadër të buxhetimit afatmesëm ashtu dhe në atë të buxhetimit vjetor, me qëllim programimin real të shpenzimeve buxhetore sipas nevojave reale të institucionit, duke orientuar përdorimin e shpenzimet publike drejt efijencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit.

Afati: Në vijimësi

Gjetje 18: Komisioni i inventarizimit e ka përfunduar detyrën e ngarkuar 20 ditë me vonesë, në tejkalim të afatit të vendosur në Urdhrin e Titullarit nr. 21428, datë 22.11.2019. Konstatohet se në dy Drejtori Rajonale Tatimore procedurat e inventarizimit janë kryer pas mbylljes dhe dorëzimit të pasqyrave financiare konkretisht: DRT Gjirokastër ka nxjerrë Urdhër për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve më datë 14.02.2020, ndërkohë që pasqyrat financiare i ka depozituar në Degën e Thesarit Gjirokastër më datë 14.02.2020, ndërsa DRT Sarandë ka përfunduar procedurën e inventarizimit të aktiveve më datë 24.02.2020, ndërkohë pasqyrat financiar i ka depozituar në Degën e Thesarit Sarandë më datë 21.02.2020.

Për sa i përket procedurës së vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit të mallrave të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit për vitin 2018, me shkresë nr. 21498/5, datë 27.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhër “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”. Nga auditimi konstatohet se kryetar i komisionit të vlerësimit nuk është Nëpunësi Zbatues, jo në përputhje me kërkesat e pikës 99 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në relacionin e vlerësimit nuk janë llogaritur apo trajtuar efektet ekonomike të masave që mund të ndërmerren për riaftësimin e tyre në kundërshtim me pikën 106 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Komisioni i asgjësimit nëpërmjet metodës së shkatërrimit në landfillin e Sharrës ka asgjësuar 4 objekte inventari, në vlerën totale 86,670 lekë, në kundërshtim me VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën C2.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 18: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore të marrin masa që procesi i inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të bëhet sipas përcaktime ligjore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që raportohet në pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.

Afati: Në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Gjetje 19: Në lidhje me raportimin e detyrimeve të prapambetura, referuar shkresave nr. 13509/1, datë 19.07.2019 dhe nr. 18543, datë 07.10.2019, që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2019, është konstatuar se nuk janë raportuar vendimet gjyqësore për rimbursimin e subjekteve, si dhe nuk është plotësuar Shtoja 3/1 “Skedulimi i detyrimeve të prapambetura”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se DPT nuk ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë stokun e rimbursimit të TVSH-së në kundërshtim me shtojcën 4 “Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-së”, të pikës 117 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”. Referuar shkresës nr. 4480, datë 27.02.2020 që Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së i ka dërguar Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, stoku i rimbursimit të TVSH-së në fund të viti 2019 është në vlerën 11,251,390 mijë lekë.

Për sa i përket kontabilizimit të detyrimeve të prapambetura, referuar pikës 42 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve duhet të paraqiten veçmas në pasqyrat financiare në llogarinë 486 sipas llogarive specifike të kontabilitetit. Në pasqyrat financiare të konsoliduar të DPT-së, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në shumën 404,781 mijë lekë dhe pasqyron vlerën e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna si dhe detyrimet e prapambetura në vlerën 140 mijë lekë të raportuara nga DRT Vlorë. Nga auditimi është konstatuar se vlera e paraqitur në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk është e saktë dhe e plotë, pasi në të nuk mungojnë minimalisht vendimet gjyqësore të formës së prerë për tatimpaguesit të cilët nuk janë kontabilizuar si dhe stoku i rimbursimit të TVSH-së, i cili është klasifikuar në llogari 467.

Referuar data bazës të DPT-së për vendimeve gjyqësore të subjektet, në fund të vitit 2019, vlera e detyrimeve të prapambetura për këto vendime është 80,098 mijë lekë. Nga auditimi është konstatuar se kjo data bazë nuk është e plotë, pasi në të, mungojnë paktën 2 vendime gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, konkretisht, vendimi gjyqësor nr.1326 datë 29.03.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për subjektin “F K C F” shpk, me NIPT KXXXXXE, në vlerën 563,859 mijë lekë dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimi gjyqësor nr.531, datë 21.02.2019 i Gjykatës Administrative Tiranë për subjektin “B P A” me NIPT KXXXXXL në vlerën 66,394 mijë lekë, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 dhe 4 të Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Rekomandim 19.1: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa të menjëhershme për raportimin e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të detyrime të prapambetura, të cilat lidhen me detyrimet për vendime gjyqësore përfshirë detyrimet për vendimet gjyqësore për subjektet tatimpaguese, stokun e rimbursimit të TVSH-së si dhe detyrime të tjera të institucionit.

Afati: Menjëherë

Rekomandim 19.2: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat të menjëhershme për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë e data bazën e vendimeve gjyqësore për tatimpaguesit si dhe të njohë dhe kontabilizojë në pasqyrat financiare të vitit 2020, detyrimeve të prapambetura për këto vendime gjyqësore, mbi bazën e parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Afati: Në raportimin financiar për vitin 2020

Rekomandim 19.3: Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës të marrin masa për klasifikimin e stokut të rimbursimit të TVSH-së në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

llogarinë 486 “Shpenzime për periudhat e ardhshme”, me qëllim paraqitjen e saktë, të drejtë dhe të plotë të detyrimeve të prapambetura.

Afati: Në raportimin financiar për vitin 2020

Gjetje 20: Në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003, më datën 31.12.2019 paraqitet në shumën 92.5 miliard lekë, ndërsa sipas sistemit C@TS teprica kreditore më datë 31.12.2019 është në vlerën 14.1 miliard. Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2019, pa u kryqëzuar dhe sistemuar me deklaratimet vjetore të 31 Marsit 2019 për rezultatin tatimor të vitit 2018. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@TS por ky veprim nuk gjen pasqyrim në kontabilitet dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti, si një “detyrim” në pasivin e bilancit të DPT-së me kundërparti “llog.520 disponibilitete në thesar”. Në këto kushte, këto llogari paraqiten në pasqyrat financiare të DPT-së të mbivlerësuara krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme në C@TS, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 20: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë duhet të marrin masa për të përcaktuar skemën e kontabilizimit të veprime rregulluese për llogarinë 466 ‘Kreditorë për mjete në ruajtje’ dhe llogarinë 520 ‘Disponibilitete në thesar’ me qëllim paraqitjen e gjendjes reale të mjeteve disponibël në Thesar dhe detyrimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndaj tatimpaguesit kreditor për tatimin mbi fitimin e mbi paguar.

Afati: Brenda vitit 2020

Gjetje 21: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka bërë interpretim teknik lidhur me kërkesën e Shoqërisë “C F F A” licencuar si institucion financiar jo-bankë. Kjo shoqëri ofron dy produkte financiare qira financiare (Leasing) dhe Faktoring. Lidhur me furnizimin e shërbimit të faktoringut sqarohet se shërbimi i natyrës faktoring, konsiderohet si shërbim financiar, bazuar kjo në ligjin nr.9630, datë 30.10.2006 neni 30 “*Trajtimi fiskal i faktoringut*”. Shërbimi i faktoringut, për sa i përket zbatueshmërisë të ligjit nr.92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar klasifikohet si shërbim financiar, që ka të bëjnë me negocimin e kredive (shumave kreditore të llogarisë klientë). Ky shërbim nuk ka të bëjë me shërbimin e mbledhjes së borxhit. Për këtë, bazuar në nenin 53 shkronja ç të ligjit shërbimi faktoring është shërbim i përjashtuar nga TVSH. Në qëndrimin zyrtar DPT unifikon se për furnizimin e faktoringut nuk llogaritet TVSH pasi konsiderohet si furnizim shërbimi financiar i përjashtuar nga TVSH-ja. Ky interpretim bie ndesh me kriteret e nenit 41 pika 1 të UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” ku përcaktohet se bazuar në nenin 53 të ligjit 92/2014, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita, pavarësisht nëse këto transaksione kryhen nga një institucion financiar, ose jo. Përjashtimi nga TVSH për këtë transaksion nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, dhe si i tillë nuk përjashtohet nga TVSH-ja. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Rekomandimi 21: Administrata tatimore duhet të riformulojë qëndrimin e saj zyrtar, lidhur me zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore për shërbimin faktoring si shërbim i përjashtuar nga TVSH, sipas kritereve të nenit 53 Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe kritereve të nenit 41.1 të UMF nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar. Përjashtimi nga TVSH-ja zbatohet vetëm kur transaksioni i kryer është njëri nga shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë. Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në mënyrë eksplicite në nenin 53 të ligjit, siç është dhe shërbimi financiar faktoring, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja pasi ky trajtim fiskal nuk është shprehur qartë dhe në mënyrë shteruese në nenin 53 të 92/2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar”

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 22: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka bërë interpretim teknik për kërkesën e Shoqatës S Tiranë sipas shkresës nr.1 prot, datë 30.07.2019, për përjashtimin nga tatimi i kontributeve për fondet e pensionit vullnetar deri në limitin e përcaktuar nga ligji, kjo edhe për rastet kur pagesat e kontributeve bëhen nga të ardhurat nga interesat apo dividendët. DPT në qëndrimin e saj zyrtar, shprehet se të ardhurat nga interesat nuk janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale, por i nënshtrohen tatimit sipas legjislacionit në fuqi. Por referuar Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, në pikën 2.3.4, grupi auditimit konstaton problematikë të pa trajtuar në këtë Vendim Teknik lidhur me trajtimin fiskal të përfitimeve të marra nga anëtarë, për interesat e lindura dhe të paguara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 22: Administrata tatimore duhet të riformulojë qëndrimin e saj zyrtar, lidhur me zbatimin në praktikë për interesat e lindura dhe të paguara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 për të ardhurat nga interesat në momentit të pagimit të interesave në ditën e pagimit në “cash” ose në ditën e maturimit apo rikapitalizimit të tyre, njësoj si veprohet nga Bankat apo institucionet e tjera financiare, të cilat deklarojnë dhe paguajnë në organin tatimor tatimin mbi interesat jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës, maturimit apo rikapitalizimit .

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 23: Procedurat e rimbursimit të TVSH-së nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së janë kryer në tejkallim planit të shpenzimeve të rimbursimit duke shpenzuar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin në shumën 4,509,456 mijë lekë ose tejkallim në masën 23.73 % të parashikimit vjetor të rimbursimit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 23: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të analizojnë dhe raportojnë periodikisht, pranë titullarit të institucionit, gjendjen e stokut të rimbursimit, jo vetëm në zbatimin e planit të shpenzimeve të rimbursimit miratuar për vitin buxhetor por edhe pritshmërisë së kërkesës në vitin pasardhës, duke ruajtur nivelin e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar, si zë kryesor në të ardhurat e buxhetit të shtetit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 24: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, nuk u paraqit rakordimi mujor me Degën e Thesarit Tiranë për Rimbursimet e TVSH-se kaluar nëpërmjet SIFQ, veprime në kundërshtim me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

ndryshuar, nenin 75 pika 2.6 dhe **Manuali i Rimbursimit** të TVSH-së në paragrafin “*Dërgimi i miratimit të shumës dhe urdhër pagesave në thesar për kryerjen e rimbursimit. (Trajtuar më hollësisht në pikën B5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.”

Rekomandimi 24: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-se të kryejë rakordimet periodike mujore me degën e thesarit për rimbursimet e TVSH-se kaluar nëpërmjet SIFQ, duke hartuar Akt-Rakordim mujor me të dhënat analitike për pagesë për rimbursim dhe shumat përkatëse.

Afati: Në vijimësi

Gjetja 25: Drejtoria e Rimbursimit nuk konsideron me “Risk zero” personin juridik, por kërkesën e tatimpaguesit sipas rastit, në kundërshtim me kërkesat e VKM 953/2014 “*Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, sipas të cilit me risk zero përcakton “Personin” që nënkupton personin juridik dhe jo kërkesën për rimbursim si është kuptuar dhe zbatuar nga administrata tatimore*”

Rekomandimi 25: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të nenit 10.2 të VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “*Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të përkufizojë dhe qartësojë administratën tatimore në përkufizimin e “Eksportues me risk zero”, pasi në procedurën e rimbursimit rezulton se i njëjti tatimpagues gjatë vitit kalendarik për çdo kërkesë rimbursimi nuk mban të njëjtin status.*”

Afati: Menjëherë

Gjetja 26: Drejtoria e Kontrollit Tatimor miraton kontrolle tatimore bazuar në plane mujore dhe jo sipas një Plani të Përgjithshëm Kontrolli për një vit kalendarik, veprime këto jo përputhje me paragrafin 80.4.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për Procedurat tatimore*”. DKT nuk ka kryer kontrolle ose verifikime mbi ecurinë e planit vjetor të drejtorive rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Legjislacionin fiskal dhe Manualin e Kontrollit Tatimor. Planet mujore kanë ndryshuar në shtesë/pakësim për kërkesa për rimbursim miratuar për kontroll nga DRTVSH-së dhe jo nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut-ut, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin e Riskut paragrafi 9.2 pika 1. Në totalin e kontrolleve të miratuara rezulton se janë përzgjedhur për kontroll nga DMR në DPT 1587 raste ose 78.37% e totalit dhe propozim të DRT-re janë miratuar për kontroll tatimor 438 raste ose 21.63% e totalit, raport i cili nuk është respektuar në miratimin e planit të kontrolleve për vitin 2019, veprime këto në mospërputhje me kërkesat e Manualin për Menaxhimin e Riskut, Kapitulli IX, “*Përzgjedhja për kontroll*”, paragrafi 9.2 pika 1. Gjatë vitit kalendarik nga kontrolli operacional janë kryer vlerësime për detyrime tatimore për 2,041 kontrolle në shumën 9,259,180 mijë lekë duke ulur forcën zbuluese për më pak në shumën 1,332,068 mijë lekë ose rënie 13 %, krahasuar me vitin 2018 ku zbulueshmëria ishte në shumën 10,591,249 mijë lekë. Rezultati i ri kontrolleve tatimore të ushtruara nga drejtoritë rajonale në 15 raste rezultojnë me zero vlerësim tatimor, rezultat që nuk mbështet analizën e fakteve dhe arsyen e ri kontrollit. Në planin sektorial projekti “*Bar & Restorante*” nga 100 kontrolle planifikuara janë realizuar 48 kontrolle ose 48% e totalit me vlerësim tatimor në shumën 26.349 mijë lekë, duke mbetur pa realizuar 52 subjekte tatimor ose 52% e kontrolleve me risk të moderuar. Nga auditimi rezulton se rezultati pas kontrollit për TVSH-në, në shumë raste vlerësimi tatimor është në shuma minimale, e cila bie ndesh me kriteret e thyera sipas analizës së riskut nga DMR baza e përzgjedhjes se tatimpaguesit për kontroll tatimor. (Trajtuar më hollësisht në pikën B6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Rekomandim 26.1: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet strukturave të saj, të hartojë Plan të Përgjithshëm Kontrolli për një vit kalendarik, i cili të miratohet brenda muajit dhjetor të vitit paraardhës. Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT të analizojë arsyet e zhvendosjes dhe moskryerjes së kontrollit operacional sipas planin të miratuar mujor/vjetor nga DPT. Pas verifikimit në drejtoritë rajonale me grup pune të ngritur për këtë qëllim të analizojë dhe marrë masat përkatëse për drejtuesit e DRT-re dhe strukturave të kontrollit në këto drejtori për mosveprim sipas planit të miratuar, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Manualin e Kontrollit Tatimor, me planin mujor të miratuar për kontroll nga DPT dhe kërkesat e Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore neni 116.

Afati: Në vijimësi

Rekomandimi 26.2: Drejtoria e Kontrollit në DPT të rrisë forcën zbuluese duke bërë identifikimin e gabimeve në vlerësimin nga kontrolli tatimor bazuar në vetë deklarin e tatimpaguesit duke rritur forcën zbuluese në vlerësim të detyrimeve tatimore dhe arkëtimin e tyre duke kontribuar në zbatimin e drejtë të ligjit me qëllim rritjen ardhurave tatimore dhe uljen në maksimum të evazionit dhe të shmangies tatimore, sipas kërkesave të Manualit të Kontrollit tatimor dhe Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19 datë 22.02.2017 nenet 116 të tij.

Afati: Në vijimësi

Gjetje 27. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në DPT ka shfaqur probleme në drejtim të: mungesës së harmonizimit të akteve dhe dispozitave që rregullojnë kryerjen e aktivitetit të njësisë (rregullores dhe strukturës së miratuar); mos hartimit të dokumenteve që vlerësojnë cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme (Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm); mos hartimit dhe mos dokumentimit të gjurmëve të auditimit si instrumente menaxhimi. Janë konstatuar dobësi në kontrollet menaxheriale, si: pamjaftueshmëri e masave shtrënguese në mbledhjen e borxheve, si rrjedhojë e së cilës, në fund të vitit 2019, debitorët për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë në shumën 18.7 miliard lekë, nga ku 4.2 miliard lekë është borxh i ri i krijuar gjatë vitit 2019; Pamjaftueshmëri e kontrolleve para dhe pas faktit të cilat kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zërin paga, në total, në shumën 1,552,000 lekë (nga e cila 405,000 lekë në vitin 2019) dhe në zërin shpenzime udhëtim e dieta në shumën 110,900 lekë; mungesës së transparencës në procedurat e rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme, mungesës së trajnimeve të dedikuara për stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor të cilat do të shërbejnë për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në realizimin e objektivave dhe menaxhimit të fondeve publike të njësisë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën F të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 27: Titullari i Institucionit të marrë masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar, vendosjen e rregullave dhe procedurave të qarta dhe efektive, zhvillimin e dedikuar profesional të stafit menaxhues, në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe menaxhimit të sistemit buxhetor, duke synuar eliminimin e dobësive të shfaqura në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje 28: Veprimtaria e kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2019 për sa i përket rolit dhe misionit për të cilin është krijuar dhe funksionon kjo drejtori, rezulton jo në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 5 të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

sektorin publik”, ku shprehimisht citohet: *“Misioni i Auditimit të Brendshëm është të japë siguri të arsyeshme Titullarit të Institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm”*. Nga auditimi rezulton se, aktiviteti i auditimit të brendshëm përmes Raporteve të Auditimit nuk ka kontribuar efektivisht në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit, pasi rekomandimet e AB nuk janë fokusuar në: vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, në lidhje me promovimin e etikës dhe sigurimin e performancës; vlerësimin e efektivitetit dhe kontributit në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të riskut dhe ndihmën për organizatën në mbajtjen e kontrolleve efektive, duke i vlerësuar dhe duke nxitur përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe nuk ka përpjekje për të vlerësuar komponentët e qeverisjes dhe proceset e kontrollit, duke i analizuar aktivitetet e subjekteve dhe duke i krahasuar treguesit në mënyrë specifike kundrejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të tyre të përgjithshme e strategjike, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e pikës c, të nenit 6, të Ligjit 114/2015 ku shprehimisht citohet: *“Roli i auditimit të brendshëm është t'i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë: “...c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike”*.

Gjithashtu në veprimtarinë e DAB janë evidentuar deviacione nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e auditimit, si vijon:

a) Në raportet e auditimit mungojnë gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me: respektimin e dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës, pagave dhe shpenzimeve të personelit; ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për marrëdhëniet e punësimit; zbatimin e dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmërinë e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit /asgjësimin e aktiveve; zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla; funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, etj. Gjithashtu evidentohet mungesa në raportet e auditimit e dhënies së opinionit mbi 5 komponentët e kontrolleve të brendshme sipas modelit COSO, si dhe një opinion të përgjithshëm vlerësues mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për çdo sistem të audituar.

b) Ndryshimi i planit vjetor të auditimeve nuk është dokumentuar me shkrim dhe nuk është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të Ligjit 114/2015 dhe përcaktimeve të kapitulli III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016.

c) Nga ana e Drejtuesit të DAB nuk është vendosur një sistem për monitorimin dhe trajtimin e rezultateve të komunikuara menaxhimit, si dhe nuk ka një analizë të gjendjes së rekomandimeve në proces edhe pse afatet e zbatimit kanë përfunduar, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet e nenit 14 të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në të cilën përcaktohet se Drejtuesi i NJAB është përgjegjës për “veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pa zbatuar”. Nga auditimi rezulton se nga 123 rekomandime të lëna gjatë vitit 2019 janë realizuar vetëm 53 rekomandime ose 43% e rekomandimeve ndërkohë që 70 rekomandime rezultojnë ende në proces, jashtë afateve të dakortësuara. *(Trajtuar më hollësisht në pikën F të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandimi 28.1: Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masat që, nëpërmjet planifikimit vjetor dhe strategjik, të orientojë veprimtarinë e DAB në përputhje me rolin dhe misionin për të cilin është krijuar dhe funksionon kjo strukturë dhe nëpërmjet veprimtarisë audituese të vlerësojë dhe të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit duke përdorur një qasje sistematike dhe të disiplinuar.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Rekomandimi 28.2: Drejtuesi i DAB të marrë masa: a) Që planet vjetore të punës të hartohen në përputhje me planet strategjike dhe në çdo rast ndryshimet të argumentohen dhe të miratohen nga Titullari i Institucionit. b) Në përfundim të hartimit të PRA dhe RFA, audituesit të shprehin opinionin e tyre mbi 5 komponentët e kontrollit të brendshëm sipas modelit COSO, si dhe një opinion të përgjithshëm vlerësues mbi veprimtarinë e subjektit të audituar që gjenerohet nga analiza të plota dhe tërësore se si janë realizuar objektivat, si janë ndjekur e zbatuar prioritetet dhe strategjitë, si janë administruar paratë dhe aktivet. c) Të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit, të vendosë një proces ndjekjeje, për të monitoruar dhe siguruar që aksionet e menaxhimit janë zbatuar në mënyrë efektive, ose që menaxhimi i lartë ka pranuar rrezikun e mosveprimit. Të marrë në analizë gjendjen e rekomandimeve që aktualisht ndodhen në proces edhe pse afatet e zbatimit të tyre kanë përfunduar, duke i rivendosur ato në afat.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje 29: Trajtimi i praktikës së ndjekur nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT në lidhje me interpretimin ligjor që ka kërkuar DRT Shkodër, nëse dhurimi i aksioneve konsiderohet e ardhur e tatueshme nuk ka rezultuar i plotë dhe shterues. Sipas DPT dhurimi i aksioneve duhet të konsiderohet si një transaksion i tatueshëm, por duke qenë se ligji nuk shprehet në mënyrë eksplicite, DPT është mjaftuar me kërkesën e kufizuar për të analizuar personin që “dhuron” aksionet/kuotat, në drejtim të verifikimit të rritjes së kapitalit, por edhe kjo kërkesë është bërë vetëm për një subjekt, B MG (DRT Shkodër), ndërkohë që për subjektin M A sh.p.k (DTM) nuk është kërkuar asnjë lloj analize apo vlerësimi. Gjithashtu nuk rezulton që ndaj z.B, në cilësinë e dhuruesit të aksioneve të jetë aplikuar gjobë, për mos njoftim të administratës tatimore në lidhje me ndryshimin e pronësisë, e cila e përlllogaritur arrin në shumën 26,985,000 lekë. Detyrimi për të aplikuar gjobë rrjedh nga përcaktimet e nenit nr.115/2 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Në lidhje me vlerësimin e ndryshimit të pronësisë në subjektet tatimore grupi i auditimit kërkoj informacion të detajuar mbi të gjithë subjektet që kanë kryer ndryshim pronësie për vitin 2019, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i pikës 3 të nenit 27/1 “Ndryshimi i pronësisë” të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku shprehimisht citohet: “Një person juridik, i cili është subjekt i një ndryshimi të përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të njoftojë autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga koha kur ka ndodhur ndryshimi”, si dhe nga marrëveshja e bashkëpunimit midis QKB me nr.12420/1, datë 07.09.2017 dhe DPT me nr.19812, datë 22.08.2017. Informacioni i administruar nga sistemi C@TS nuk identifikonte rastet e ndryshimit të pronësisë. Referuar ligjit të procedurave tatimore, tatimpaguesi mbart detyrimin të vetë deklaroje dhe të vetë përmbushje detyrimet ligjore që burojnë nga kuadri ligjor rregullues në fuqi, ndërsa administrata tatimore mbart detyrimin të vlerësojë dhe të administrojë detyrimet tatimore të çdo tatimpaguesi. Në kushtet e mos evidentimit të këtij informacioni, administrata tatimore ekspozohet përpara riskut të mbledhjes së detyrimeve tatimore. (Trajtuar më hollësisht në pikën H të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 29: DPT të kërkojë nga QKB, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 12420/1, datë 07.09.2017 dhe nr.19812, datë 22.08.2017, për subjektet të cilët dhurojnë/tjetërsojnë aksione, që informacioni i dërguar elektronikisht nga QKB në DPT të identifikojë qartë elementët e ndryshimit të pronësisë në, ortakëri, numër aksionesh dhe vlerë, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për të shmangur riskun e krijimit të të ardhurave të munguara, në rastet kur tatimpaguesi nuk njofton administratën tatimore, në lidhje me ndryshimin e pronësisë.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Gjetje 30: Për vitin 2019, Njësitë e Qeverisjes Vendore rezultojnë debitorë ndaj DPT-së në shumën 482,325 lekë për 1% e TFTH. Sipas shpjegimit të dhënë grupit të auditimit nga 3 Drejtori rajonale: DRT Tiranë, Fier dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, arsyeja e mos pagesës në kohë të komisionit 1% është për shkak të vonesave të Bashkive në autorizimin e këtyre pagesave. Për sa kohë dokumenti i akt-rakordimit është një dokument i vetëm, i përbashkët, i kundër firmosur për shumën që DRT duhet të transferojnë në njësitë vendore si dhe shumës që këto të fundit duhet ti paguajnë DRT-ve për shërbimin si agjent tatimor, vonesat e pagesave nga Bashkitë janë të pajustificuara. *(Trajtuar më hollësisht në pikën H të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 30: DPT të propozojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë sanksionimin në germën “a” të pikës 11 “Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njërive të qeverisjes vendore”, të Udhëzimit nr.32 datë 31.12.2013 ‘Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël’, të një afati të caktuar brenda të cilit Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të derdhin në buxhetin e shtetit detyrimin për komisionin 1% të të ardhurave të grumbulluara për llogari të tyre nga DRT-të që veprojnë si agjentë tatimor.

Afati: Menjëherë

Gjetje 31: Nga auditimi rezulton se, në fund të vitit 2019, debitorët për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në fund të vitit 2019 rezultojnë në total në shumën 18.7 miliard lekë, prej të cilave 4.2 miliard lekë është debia e vitit 2019, pra 22% e debisë është krijuar gjatë vitit 2019. Në totalin e debisë prej 18,7 miliard lekë rreth 4% e zënë entet publike, me shumën 0.7 miliard lekë dhe 96% e zënë entet private, në shumën 18 miliard lekë. Ndër entet publike me gjendjen debitorë më të lartë përmendim: Repartet Ushtarake, Bashkitë, ish-Komunat, Klubet e Futbollit, etj. Strukturat përgjegjëse në DPT dhe DRT, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e neneve 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe neneve 3;4 &14 të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Përmbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”, i ndryshuar, nuk kanë realizuar mbledhjen dhe transferimin në fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor të shumës prej 18.7 miliard lekë e cila nga njëra anë përbën të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte rrezikohet të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 31.1: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me MFE të iniciojë procesin e hartimit të një strategjie të mirë studiuar, për të mundësuar arkëtimin e borxhit prej 18.7 miliard lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga rreth 422 ente publike dhe rreth 64,000 ente private, duke mbajtur parasysh faktin që, një numër i konsiderueshëm entesh publike kanë pushuar juridikisht së funksionuari (Komunat apo Reparte Ushtarake etj.) dhe ende rezultojnë debitorë ndaj kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 31.2: DPT të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me të dhënat më të fundit, të nxjerra nga sistemi C@TS, deri në datë 30.09.2020, të subjekteve buxhetore, debitorë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe t’i kërkoj që, strukturat përgjegjëse për Thesarin, në zbatim të pikës 113 të Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 20.01.2020, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, të mos autorizojnë pagesën e pagës nëse, nga ana e subjekteve debitorë, nuk është paraqitur njëkohësisht dhe pagesa për shlyerjen e detyrimeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

kontributeve, sipas një plani pagesash të shlyerjes së stokut të detyrimeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe TAP, për njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Afati: Menjëherë

Gjetja 32: Përgjatë vitit 2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka kaluar në 2 procese Ristrukturimi, të cilat kanë përfunduar jashtë afateve të përcaktuara ligjore dhe vendimmarrja për transferimet/ ri sistemimet e punonjësve nuk është kryer duke u bazuar në kritere të paracaktuara. Administrata Tatimore Qendrore ka funksionuar me Rregulloren e miratuar me Urdhrin Nr.19 datë 22.02.2017, miratuar nga Ministri i Financave, e cila përcakton rregullat dhe detyrat për organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet, ndërmjet njërive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore. Gjithashtu kjo rregullore vendos rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore. Konstatohet se kjo rregullore i përshtatet strukturave të mëparshme organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale miratuar me Urdhrin Nr.49 datë 27.02.2019 dhe Urdhrin Nr.86 datë 03.05.2019 “*Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qendrore*”.

Struktura e Administratës Tatimore Qendrore e vitit 2019 ka funksionuar me Urdhrin nr.126 datë 02.08.2016 të Kryeministrit, dhe përmban në total 1569 pozicione pune të ndara në: 1159 pozicione të rregulluara nga ligji për statusin e nëpunësit civil;

410 pozicione të rregulluara nga Kodi i Punës së RSH nga të cilat 282 pozicione i përkasin strukturave të hetimit tatimor dhe 128 pozicione i përkasin funksioneve mbështetëse.

Urdhri Nr.126 datë 02.08.2016 ka funksionuar deri në 27.02.2019, ku me Urdhrin e Ri Nr.49 datë 27.02.2019 “*Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.126 datë 02.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore qendrore*”, është miratuar struktura e re organizative, ku nga 1569 punonjës total, numri i miratuar i punonjësve për gjithë strukturën tatimore kalon në 1512. Sipas këtij Urdhri, punonjësit civil që kanë ushtruar detyrat në njësinë e menaxhimit TIK, shkëputen nga strukturat tatimore dhe kalojnë në strukturat e AKSH-it me kod pune. Komisioni i Ristrukturimit ka dalë me vendim propozimi për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil, për 41 punonjës, miratuar nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën Nr. 2099/1 Prot datë 15.04.2019.

Në Drejtoritë Rajonale Tatimore konstatohen se disa prej punonjësve nuk kanë kaluar në AKSH edhe pse kanë qenë të strukturave të IT-s, por janë sistemuar në pozicione të tjera brenda strukturave të DRT-ve. Nga 28 punonjës të strukturave të IT-s në Drejtori Rajonale Tatimore, 21 prej tyre kanë kaluar në strukturat e AKSH-it dhe 7 prej tyre janë ri pozicionuar në pozicione të tjera brenda Drejtorive, duke ruajtur statusin e nëpunësit civil. Ky është tregues i trajtimeve të favorizuara të punonjësve që janë ri pozicionuar brenda strukturave tatimore dhe atyre që kanë kaluar në strukturat e AKSH-it me kod pune.

Me Urdhrin Nr.86 datë 03.05.2019 “*Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.126 datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qendrore*” të ndryshuar, struktura ka ndryshuar sërish por pa ndryshim në numrin total të punonjësve. Nga ana e Komisionit të Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse DAP janë transferuar në pozicione të tjera edhe punonjës Drejtoria e të cilëve nuk ka qenë subjekt i ndryshimeve strukturore të Urdhrit nr.86 datë 03.05.2019.

Këto akte të miratuara nga Komisioni i Ristrukturimit dhe DAP, janë anuluar si akte të bërë jo në përputhje me dispozitat ligjore dhe Urdhrin 85 datë 03.05.2019, mesatarisht 3 muaj më vonë, nisur nga ankimet e punonjësve, duke u rikthyer në pozicionet e tyre të mëparshme. Situata të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

tilla shoqërohen me problematika në kryerjen e detyrave funksionale dhe mbarëvajtjen e Institucionit.

Ristrukturimet janë bërë jo në përputhje me afatet e përcaktuara pikën 16, Kreu II, i Udhëzimit Nr.01. Datë 01.03.2016 i ndryshuar “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo rristurimi” dhe pikën 17 Kreu II, i VKM Nr. nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me pikën 10, Kreu II, të Udhëzimit Nr.01. Datë 01.03.2016 e cila citon “Komisioni merr vendim për transferimin e nëpunësve apo përfundimin e marrëdhënies së tyre në shërbimin civil, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit” dhe pikën 17 “**Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi**”. (Trajtuar më hollësisht në pikën E2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 32.1: Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të analizojnë shkaqet e rristurimeve të shpeshta me qëllim shmangien e tyre. Të merren masa për krijimin e një strukture organizative të qëndrueshme që garanton mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë në lidhje me pozicionet e punës.

Afati: Në vijimësi

Rekomandimi 32.2: Strukturat Drejtuese të DPT marrin masa për ngritjen e një grupi pune për rishikimin e rregullores, duke reflektuar të gjitha ndryshimet strukture, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni pune.

Afati: Në vijimësi

Gjetja 33: Përgjatë vitit 2019, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ka rezultuar një numër i lartë vendesh vakante. Në fund të vitit janë konstatuar 180 vende vakante, nga të cilat 141 vende vakante janë pozicione të statusit të nëpunësit civil dhe 39 pozicione me kod pune. Vendet vakante nuk janë plotësuar me emërimet të reja dhe janë mbuluar me urdhra delegimi. Numri i urdhrave për delegim kompetencash në fund të vitit 2019 ka qenë 46 urdhra, nga të cilat 5 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe 41 në Drejtoritë Rajonale Tatimore. Nisur nga data e delegimit, 1 delegim i takon vitit 2016, 10 delegime vitit 2017, 21 delegime vitit 2018 dhe 14 delegime vitit 2019. Delegimi kompetencave është një instrument ligjor i parashikuar për t’u përdorur për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për tu përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndërruar në një mekanizëm të përhershëm. Vendet e lira të punës si dhe largimet e shumta në numër të punonjësve tregojnë mangësi në procesin e planifikimit të numrit të punonjësve dhe realizimin e strukturës së miratuar si dhe mangësi në procesin e rekrutimeve në punë të punonjësve, duke mos respektuar kriteret e miratuara dhe të shpallura për çdo pozicion pune. Kjo sjell cenim të performancës së institucionit në tërësi si dhe në përmbushjen e misionit për pozicionet e punës që rezultojnë të paplotësuara me staf.

Nga ana e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë hedhur vendet vakante në sistemin HRMIS, por nuk është bërë shpallja e tyre nga ana e DAP. Këto vakanca janë që prej vitit 2016. Konstatohet se për pozicionet vakante Drejtor të Drejtorive Rajonale, nuk përputhen kriteret e pozicionit të hedhura në sistem nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore me kriteret e shpallura nga ana e DAP, duke lënë në këtë mënyrë hapësira për favorizim të kandidatëve pa kualifikimin e duhur për strukturat drejtuese Tatimore.

Me shkresën nr.20275 prot., datë 04.11.2019 i është dërguar Departamentit të Administratës Publike përshkrimi i punës për pozicionin Drejtor Rajonal, për Drejtoritë Rajonale Tatimore,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përcaktuar kriter arsimor, shkenca ekonomike/juridike/politike.

Me shkresën nr.6597/2 prot datë 08.11.2019, nga DAP është kthyer përgjigje duke sugjeruar për zgjeruar ta kriterin arsimor me “Master shkencor në shkenca ekonomike / juridike / sociale / natyrore / inxhinierike”. Me shkresën Nr.20275/3 prot datë 13.11.2019 i është kthyer përgjigje DAP-it, përshkrimi i ri i miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas përshkrimit të ri, pika arsimit citon: *“Të zotërojë diplomë të nivelit Master i shkencave të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në shkenca ekonomike/juridike/politike, pa përfshirë shkencat sociale, natyrore, inxhinierike”*. Ndërkohë nga DAP shpalljet janë bërë me kriterin master shkencor në shkenca ekonomike/juridike/sociale/natyrore/inxhinierike”. Kjo situatë ka sjell mospërputhje mes hedhjes në sistem nga Burimet Njerëzore të DPT dhe shpalljes nga DAP. Fakti që përshkrimi i punës i miratuar është i ndryshëm nga shpallja e vendit në DAP mund të sjell favorizim për përzgjedhje të kandidatëve fitues me kriter arsimi jashtë profilit të kërkuar, miratuar dhe të gjykuar si bazë për pozicionin e Drejtorit të Drejtorive Rajonale, nga ana e vet strukturave drejtuese tatimore. (Trajtuar më hollësisht në pikën E2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 33.1: Strukturat drejtuese të DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masat për ndërprerjen e delegimeve për pozicionet vakante dhe plotësimin e pozicioneve vakante me vendime emërimi.

Afati: Në vijimësi

Rekomandimi 33.2: Strukturat drejtuese të DPT të përcjellin problematikën në DAP me qëllim shmangien e parregullsive me pasojë favorizimin e punonjësve që nuk plotësojnë kualifikimin e nevojshëm për të qenë pjesë e shërbimit civil në DPT.

Afati: Në vijimësi

Gjetja 34: Për vitin 2019 është konstatuar numër i lartë punonjësish shërbimi me kontratë, kërkesat në planifikim për të cilët janë të pa mbështetura në evidenca. Për rekrutimin dhe emërimin e tyre nuk ka patur një procedurë që të përfshijë shpalljen në institucione për pozicionet me kriteret dhe afatet e aplikimit nga të interesuarit, procesin e kualifikimit dhe përzgjedhjes. Nga 250 punonjës shërbimi me kontratë 6 mujore të planifikuar janë punësuar 244 dhe nga 30 punonjës me kontratë 1 vjeçare të planifikuar janë punësuar 26 punonjës. *Vlera e fondit të buxhetit të shtetit me të cilën janë paguar punonjësit me kontratë të përkohshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për Drejtoritë Rajonale Tatimore në vitin 2019 është 54,351 mijë lekë*. Nga rekrutimi i punonjësve me kod pune konstatohet se për 9 punonjës në pozicionet arkëtar, protokollist, arkivist, mungon një procedurë e rregullt rekrutimi në të cilën të shpallen vendet vakante, të publikohen kërkesat e përgjithshme dhe pastaj të përzgjidhet fituesi. Këto pozicione janë plotësuar me punonjës të propozuar nga Drejtorët rajonal duke cenuar parimin e transparencës, të drejtës së barabartë të kandidatëve për aplikim dhe përzgjedhje punësimi në vendet vakante. Në lidhje me largimet nga puna përgjatë vitit 2019 janë larguar 11 punonjës nga Drejtoria e Hetimit Tatimor punonjësit e të cilës janë me kod pune. Largimet e punonjësve të Hetimit Tatimor janë kryer në kushtet e trajtimit të pabarabartë në krahasim me punonjësit e tjerë pas ndryshimeve të kriterëve në Rregulloren të bëra me Urdhrin nr.65/2 datë 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve *“Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”*.

Në lidhje me largimet me Komision Disiplinor, përgjatë vitit 2019 konstatohen 13 largime nga puna nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, 3 prej të cilëve me status nëpunësi civil dhe 10 punonjës me kod pune. *Kjo situatë ka sjell rritjen e çështjeve gjyqësore dhe mundësinë e rritjes së efekteve negative financiare në dëm të buxhetit të shtetit në lidhje me pagesat për largim të padrejtë nga*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

puna, pasi 7 prej tyre janë në proces gjyqësor. Nga data baza e punonjësve të larguar nga puna mbajtur nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike konstatohet se janë në proces gjyqësor 187 ish-punonjës, larguar kryesisht në vitet 2014-2019, prej të cilëve 84 me status të nëpunësit civil dhe 103 me kod pune. (Trajtuar më hollësisht në pikën E4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 34.1: Strukturat Drejtuese dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marr masat për zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe punësimit, që përfshin shpalljen në institucione për pozicionet përkatëse, kriteret dhe afatet e aplikimit nga të interesuarit, procesin e kualifikimit, përzgjedhjes dhe shpalljen e fituesve duke i kushtuar vëmendje të veçantë dhe nevojës së argumentuar për punonjës shërbimi dhe matjes së performancës së tyre.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 34.2: Drejtoria Ligjore, të marr masa për ndjekjen e kujdesshme të proceseve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna në mënyrë që të minimizohen efektet negative në buxhet.

Afati: Në vijimësi

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Gjetja 1: Pagesat e rimbursimit janë kryer në shkelje të afatit ligjor të rimbursimit prej 30/60 ditë, afat i përcaktuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R Sh”, kryesisht për shkak të vonesës në procedurën e miratimit të shumës nga kontrolli operacional, duke vënë në vështirësi tatimpaguesit eksportues për likuiditet e nevojshme dhe për ecurinë normale të veprimtarisë ekonomike. Ndërkohë, nga administrata tatimore për kategorinë e tatimpagues të mëdhenj konsideruar të tillë referuar vlerave të larta të shpenzimeve për rimbursim nuk përdoret metoda FIFO në kryerjen e pagesave. Nga auditimi i pagesave me këste konstatohet se, për të njëjtën kërkesë të miratuar, këstet mujore të pagesës variojnë në vlera të ndryshme, si në rastin e tatimpaguesit T A P A A për kërkesën e datës 21.06.2017 pagesa është kryer në datën 27.11.2019 në shumën 200.000 mijë lekë dhe në datën 31.12.2019 në shumën 240.000 mijë lekë; tatimpaguesi P Group për kërkesën e datës 27.11.2018 pagesat janë kryer në 31.12.2019 në shumën 42,646 mijë lekë dhe po në datën 31.12.2019 në shumën 10,000 mijë lekë, etj. Në muajin dhjetor rezulton se për të njëjtin tatimpagues është paguar më shumë se një këst, si në rastin e pagesave për tatimpaguesin JV R T paguar datë 31.12.2019 në shumën 157,339 mijë lekë dhe po në datën 31.12.2019 në shumën 10.000 mijë lekë, ALBC paguar në datën 31.12.2019 në shumën 101,968 mijë lekë, në shumën 56,915 mijë lekë, në shumën 66,363 mijë lekë, në shumën 58,898 mijë lekë, në shumën 71.102 mijë lekë, në total pesë pagesa në shumën 355,248 mijë lekë, etj. DRTVSH, kërkesës të grupit të auditimit lidhur me përcaktimin e kësteve për tu paguar, nuk ju përgjigj me evidenca analitike, ose çdo formë tjetër lidhur me vlerën e këstit dhe të radhën e pagesës. Theksojmë se, për këto këste të maturuar për tu paguar, TVSH për rimbursim, në sistemin C@TS rezulton si e përdorur (zbritur në deklaratën e tatimpaguesit në sistemin C@TS). Pra kjo shumë tashmë është jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim për pagimin CASH të saj nëpërmjet sistemit të thesarit. Mosparaqitja e evidencave lidhur me këstet e planifikuara për pagesë, bën të pamundur verifikimin e respektimit të radhës së pagesave sipas kësteve të paracaktuara për rimbursim. Sa më sipër përveç shkeljes së afatit ligjor për pagesë me këste, të cilën e trajtuam më lart, rezulton se për kërkesat e miratuara në vlera të larta monetare grupit të auditimit i mungon evidenca lidhur me këstet e planifikuara për pagesë, fakt që bën të pamundur verifikimin e respektimit të radhës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

së pagesave sipas kësteve të paracaktuara për rimbursim. Në konkluzion, parimi FIFO për kategoritë e eksportuesve si më lartë, nuk është respektuar në 6-mujorin e parë të vitit 2019, procedurë kjo e përmirësuar dukshëm në 6-mujorin e dytë. Ndërsa për grupin e tatimpaguesve për “pagesa me këste” nuk ka transparencë të plotë të planit të pagesave për të vlerësuar zbatimin e radhës së pagesave të kësteve. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, deri në automatizimin e plotë të procedurës së rimbursimit, për kategorinë eksportues për kryerjen e rimbursimit të TVSH-së brenda afatit ligjor për rimbursim, të marri masa të menjëhershme për përmirësimin e Rregullores së TVSH-së me qëllim përmirësimin e procedurës së dërgimit për kontroll të kërkesave për rimbursim të vlerësuara sipas nivelit të riskut, duke u orientuar më shumë drejt kontrollit pas rimbursimit i cili të përfshijë disa periudha tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-se lidhur me këstet e planifikuara për pagesë, të mbajë një regjistër ku të evidentojë tatimpaguesit dhe këstet e rimbursimit.

Afati: Menjëherë

Gjetja 2: Nga auditimi për vlerësimin e përputhshmërisë së raportimit të detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara rishtas në lidhje me stokun e TVSH-së së miratuar për rimbursim por të papaguar, konstatohet se regjistri rimbursimit nga DRTVSH nuk ofron të dhëna të mjaftueshme lidhur me vlerësimin e këtij stoku. Evidenca e kërkesave për rimbursim, nuk përmban të dhëna të plota lidhur me datën e miratimit të kërkesës, shumën e miratuar për kompensim, shumën e urdhër pagesës për rimbursim ose komente për rastet e mosplotësimit të tyre. E njëjta situatë paraqitet edhe në evidencën e pagesave për rimbursim, në të cilën mungojnë të dhëna të domosdoshme si data e kërkesës, shumën e kërkuar, data e miratimit ose konstatohen vendosje në kolonën e gabuar të shumës së kërkuar dhe datës së kërkesës, gabime në paraqitjen e pagesave në referencë të kërkesës së gabuar dhe jo sipas përshkrimit në urdhrin për pagesë, etj. Kjo evidencë nuk ka të dhëna analitike për gjendjen e mbetur për tu paguar për çdo kërkesë. Të gjithë këta faktorë vështirësojnë verifikimin e ecursisë së çdo “kërkese të miratuar” dhe ndjekjen e radhës së pagesave sipas parimit FIFO dhe vlerësimin e plotësisë dhe saktësisë së gjendjes së këtij stoku. Nëse do të referohemi këtij sistemi për datën 31.12.2019 nuk sigurojmë të dhëna mbi gjendjen shumëve të miratuara, pasi në momentin e miratimit përfundimtar zbriten nga sistemi C@TS rezulton dhe kjo shumë del jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për rimbursim.

Kjo drejtori nuk ka kryer raportime me bazë tremujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi sipas dokumentit standard “Shtojca 4”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues Nr.1, datë 17.09.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika III, paragrafi 117. E vetmja evidencë për audituesin mbetet raportimi mbi gjendjen e stokut të rimbursimit nga DRTVSH në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabiliteti në datën 31.12.2019 në shumën 11,251,390 mijë sipas shkresës Nr. 4480 prot., datë 27.02.2020.

Në këtë evidencë raportohen rimbursimet e miratuara për katër subjekte të kategorisë tatimpagues të mëdhenj, për të cilët përdoret pagesë me këste. Këto rimbursime të miratuara i përkasin viteve 2018-2019. Në stokun e raportuar nuk janë evidentuar kërkesat e pranuar por të pa miratuara për rimbursim edhe pse ato janë në tejkalim të afatit ligjor 30/60 ditë të përcaktuar me ligj për rimbursim në shumën 1,653,275 mijë lekë. Kjo bie në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, referuar nenit 75/1 pika 1, i cili konsideron detyrim të papaguar të gjitha kërkesat që kanë kaluar afatin 30/60 ditë, afat brenda të cilit drejtoria rajonale e tatimeve verifikon situatën tatimore të tatimpaguesit, ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut dhe miraton tepricën kreditore si të rimbursueshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Nga auditimi i të dhënave për tatimpagues të cilët kanë nivelin më të lartë të pagesave me këste, u konstatuan vlera të pasakta të deklarimit të stokut si dhe mos deklarim i shumës së TVSH së miratuar, aprovuar për kompensim, shumë që mbetet për tu përdorur në periudhat e ardhshme. Bazuar sa më lart, vlera e stokut të deklaruar nga DPT në shumën 11,251,390 mijë lekë është e nënvlerësuar me të paktën 3,526,472 mijë lekë duke sjellë kështu një vlerësim të stokut të TVSH-së së rimbursueshme në datën 31.12.2019 në rreth 14,777,862 mijë lekë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, të marri masa të menjëhershme për përmirësimin e Rregullores së TVSH-së ku të pasqyrohen dhe saktësohen hapat procedural te mbajtjes së detyrimeve te papaguara dhe të krijuara rishtazi për evidentimin e stokut të TVSH-së duke përfshirë një format standard të miratuar mbi raportimin e tij, duke përfshirë të gjithë elementët e procesit të rimbursimit të TVSH-së deri në miratimin për pagesë. Deri në përmirësimin e rregullores, për të gjitha kërkesat e pranuar, DRTVSH të dërgojë çdo muaj pranë Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit në DPT, evidencë analitike mbi detyrimet e prapambetura dhe/ose të krijuara rishtazi për shumat e miratuara të papaguara plotësisht ose pjesërisht të paguara si dhe për shumën e kërkuar ende të pa miratuar nga organi tatimor për rimbursimin e kërkuar.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 3: Për subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike në ndërtimin e veprave hidroenergjetike, AKBN ka konstatuar dhe informuar DPT-në se prej saj është konstatuar se 59-60 subjekte kanë realizuar punime ndërtimi në mungese të lejes së ndërtimit ose në tejkalim të saj. Strukturat e kontrollit në DPT dhe kontrollit në DRT-re që kanë nën juridiksion territorial këto subjekte, edhe pse janë informuar nga DPT-ve me shkresa përkatëse, nuk kanë dhënë zgjidhje përfundimtare lidhur me ligjshmërinë e kreditimit dhe rimbursimit TVSH-së për punimet e kryera prej tyre ose përfitimin e padrejtë të rimbursimit, me efekt në të ardhurat tatimore në shkallë kombëtare sipas Ligjit Nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019". *(Trajtuar më hollësisht në pikën B5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1: Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT-ve mbështetur në listën e subjekteve sipas shkresave e AKBN-së, në bashkëpunim me DRT-re që kanë nën juridiksion territorial këta tatimpagues dhe vlerësojnë vete deklarimin e secilit prej tyre, të ndjekë hap pas hapi, rast për rast dhe në kohë 59-60 rastet e konfirmuara me mungesë leje ndërtimi, dhe pas kontrollit nga zyra ose në vend sipas programit, të kërkojnë prej tyre të shprehet me vlerësim tatimor sipas procedurave të përcaktuara në neni 68.4 dhe 68.5 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, në rastet kur konstaton paligjshmëri.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 3.2: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, të listojë çdo subjekt që evidentohet nga AKBN ose struktura të tjera kontrolluese me mungesë leje ndërtimit ose tejkalim i saj, dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të bëhet faktor në parandalimin rimbursimit kur konstaton thyerjen e kritereve ligjore të rimbursimit.

Afati: Menjëherë

Gjetja 4: Gjatë vitit 2019 janë paguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve shpenzime gjyqësore për ish punonjës, në vlerën 140,101 mijë lekë, vlerë e cilësuar si efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. Nga kjo vlerë: 120,644 mijë lekë për ish nëpunës me status, 18,954 mijë lekë për ish nëpunës me kod pune dhe 503 mijë pagesa sisteme veprimesh. Duke



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

marr në konsideratë faktin që për të njëjtin vend pune paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i ri i rekrutuar, kjo situatë paraqitet edhe më problematike dhe me efekte të konsiderueshme në buxhet. **Detyrimi i prapambetur në 31.12.2019 për shpenzime të gjyq fitueseve me vendim të formës së prerë për largime të padrejta nga puna është 404,442 mijë lekë nga të cilat: 384,019 mijë lekë janë ndaj ish nëpunësve me status, 19,961 mijë lekë ndaj ish nëpunësve me kod pune dhe 462 mijë lekë sisteme veprimesh.** Në datën 31.12.2019 ky detyrim i prapambetur u takon 196 punonjësve.

Shumica e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore janë kryer me përmbarues privat, në vlerën prej 9,758,785 lekë, duke e kaluar afatin për likuidimin vullnetar, dhe pa respektuar parimin FIFO “First in First out”, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit”. Ky udhëzim në pikën 4 përcakton se “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë data bazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës”. Gjithashtu në pikën 5 përcaktohet se “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen online të njësisë shpenzuese, apo në formë të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar.”

Evidentohen thyerje në radhën e likuidimeve të gjyq fituesve duke qenë se janë evidentuar:

- Gjyq fitues me datë depozitimi vendimi të hershme që nuk kanë marrë asnjë pagesë në 2019, kur në data bazë ka gjyq fitues me datë depozitimi të mëvonshme që kanë marrë të gjithë detyrimin e përlllogaritur për 2019.
- Gjyq fitues me datë depozitimi vendimi të hershme që kanë marrë vetëm një pjesë të detyrimit të përlllogaritur në 2019, në mënyrë të paqartë se mbi ç ‘kriter është përcaktuar masa e likuiduar, dhe në një kohë kur data baza vijon me gjyq fitues me datë të mëvonshme që u është likuiduar detyrimi total i përlllogaritur i 2019.
- Gjyq fitues me datë më të vonë depozitimi, që gjenden në radhë mes të pa likuiduarve dhe që u është likuiduar në total detyrimi i përlllogaritur deri në 2019.

Në lidhje me raportimet e bëra nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike shprehemi me rezervë për saktësinë në lidhje me gjyq fituesit e vitit 2019 dhe me korrespondencën apo rakordimet e brendshme midis Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, Burimeve Njerëzore dhe Financës. Nga auditimi u konstatua se nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike janë raportuar si vendime me formë të prerë të vitit 2019, 1 vendim i vitit 2017 dhe 2 vendime të vitit 2020, ndërkohë 3 vendime të vitit 2019 janë përcjellë nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike me shkresë në vitin 2020, për këtë arsye mungojnë në data bazën e vitit 2019. Konstatohet gjithashtu se 1 vendim i formës së prerë i datës 26.09.2019, për një gjyq fitues pjesë e shërbimit civil, nuk rezulton në data bazën e Financës dhe të Burimeve Njerëzore deri në momentin e auditimit, për arsye të mos përcjelljes së informacionit nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike. Mungesa e raportimit në Drejtorinë e Financës dhe të Burimeve Njerëzore në momentin e daljes së vendimit të formës së prerë, ndikon jo vetëm në mos planifikimin e saktë të buxhetit për zërin e shpenzimeve gjyqësore të gjyq fituesve por në mos kontabilizimin e detyrimeve të plota për vitin buxhetor dhe mos marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Komisionit të posaçëm për ekzekutimin e tyre, duke sjell rritjen e detyrimeve të prapambetura dhe rëndimin e buxhetit të shtetit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën E3. Të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Rekomandimi 4.1: Drejtoria Ligjore dhe Teknike, të marr masa për përgatitjen e grafikut të ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, sipas radhës së paraqitjes së kërkesave për ekzekutim. Ky grafik të miratohet nga nëpunësi Autorizues dhe të publikohet online.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 4.2: Nëpunësi Zbatues i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të marr masa në vijimësi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj ish punonjësve të larguar nga puna në përputhje me grafikun ne miratuar.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 4.3: Drejtoria Ligjore dhe Teknike të përcjell informacione të vazhdueshme në strukturat e Burimeve Njerëzore dhe Financës, në lidhje me gjyq fituesit në momentin e njohjes me vendimin e formës së prerë, me qëllim njohjen, kontabilizimin e saktë të detyrimeve, planifikimin e fondeve buxhetore për pagesat në vitin e ardhshëm dhe trajtimin në kohë të praktikave të tyre nga ana e Komisionit të Posaçëm.

Afati: Menjëherë

Gjetja 5: Përgjatë vitit 2019 janë punësuar në DPT 14 gjyq fitues, larguar nga vendimmarrjet e gabuara të titullarëve, ndërkohë që **kanë mbetur në fund të vitit 2019 ende të pa trajtuara nga Komisioni i Posaçëm edhe 142 praktika gjyq fituesish, në shkelje të çdo afati të parashikuar në Urdhrin nr.5151, datë 28.10.2015** cituar “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, përcaktohet se “Shqyrtimi administrativ përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës”. Mosveprimi për rikthimin në punë të punonjësve shkakton një kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit duke qenë se për të njëjtin pozicion pune paguhen dy individë ose më shumë punonjës. Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2019 Komisioni i Posaçëm është thirrur vetëm 6 herë nga Kryetari, dhe ka trajtuar vetëm 39 praktika ish nëpunësish dhe nuk është ndjekur radha e trajtimit të praktikave të gjyq fituesve për rikthim në punë. Ky impakt bëhet edhe më domethënës në kushtet kur për periudhën objekt auditimi në DPT paraqitet një numër i lartë vendesh vakante, të cilat në çdo kohë mund të përdoren për sistemimin e ish punonjësve që presin rikthimin në punë sa më shpejt, në mënyrë që të ndalohet akumulimi i shpenzimeve jo efektive.

Nga data baza e gjyq fituesve të DPT rezulton se 13 ish punonjës kanë përfutur dy paga mujore njëkohësisht nga buxheti i shtetit, një në DPT dhe një nga institucionet që janë emëruar. Këta nëpunës figurojnë të punësuar gjatë vitit 2019 dhe 2020. Nga këta 13 ish punonjës: *1 është rikthyer në punë në DPT, 4 kanë refuzuar për arsye të propozimit me ulje në kategori nga ana e Komisionit të Posaçëm, 1 nuk ka kthyer ende përgjigje dhe 7 janë ende pa trajtim nga Komisioni i Posaçëm*. Kjo problematikë është si rezultat i hapësirave që krijon Ligji nr.152/2013 datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”, Neni 66/1 pika 3 “Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë paguhen sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.” dhe mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë nga ana e DPT-s.

Konstatohet se për 10 ish nëpunës, për të cilët Komisioni i Posaçëm ka bërë propozimet përkatëse brenda të njëjtës kategori, Departamenti i Administratës Publike nuk ka nxjerrë aktet e rikthimit në punë të këtyre ish nëpunësve me motivacionin se pret pëlqimin apo refuzimin e gjyq fituesit. Në Urdhrin nr.5151 datë 28.10.2015, kreu IV, pika 4, përcaktohet qartësisht se “Gjyq fituesi brenda 3 ditësh punë njofton me shkrim KP për pëlqimin apo refuzimin e alternativave të dhëna nga komisioni. Gjyq fituesi jep pëlqimin vetëm për emërimin në një pozicion të një kategorie më të ulët.” Sa më sipër rezulton se për këta ish nëpunës në shkelje të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

procedurës së parashikuar DAP-i nuk ka nxjerrë aktet e emërimit, duke shkaktuar rritje të akumulimit të detyrimeve ndaj këtyre gjyq fituesve nga DPT.

Gjithashtu Urdhri nr.5151 datë 28.10.2015, në Kreun V, sqaron qartësisht veprimet proceduralë që duhet të ndërmarrë DAP-i në momentin e mbërritjes së rekomandimeve nga KP dhe pika 1 sqaron se DAP-i shqyrton akt rekomandimet brenda 15 ditëve punë dhe vendos pranimin ose mos pranimin sipas pikave në vijimësi të urdhrit. Mos nxjerrja e akteve në kohë nga DAP mund të shoqërohet me problematikën që vendet që kanë qenë vakante dhe Komisioni i Posaçëm i ka propozuar për plotësim me gjyq fitues, ose të mbeten vakant për një kohë të gjatë në pritje për aktet e DAP ose plotësohen me të rekrutuar të rinj, duke bërë që trajtimi i praktikave nga ana e KP të bëhet i pavlefshëm dhe të kërkoj sërish ri trajtim. *(Trajtuar më hollësisht në pikën E3. Të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Rekomandimi 5.1: Strukturat Drejtuese, në cilësinë e Titullarit të DPT dhe Kryetarit të Komisionit të Posaçëm, të marrin masa të menjëhershme për menaxhimin dhe funksionimin e tij, me qëllim trajtimin e menjëhershëm të 142 praktikave të gjyq fituesve, çdo vonesë e të cilës vazhdon të rëndojë buxhetin e shtetit, duke trajtuar me prioritet praktikën e gjyq fituesve që rezultojnë të punësuar në administratën shtetërore me qëllim ndërprerjen e një pagese nga buxheti i shtetit.

Rekomandimi 5.2: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike të bëjnë verifikim të vazhdueshëm në lidhje me ish-punonjës gjyq fitues të DPT që rezultojnë të punësuar në administratën publike dhe që marrin 2 paga nga buxheti i shtetit.

Rekomandimi 5.3: Strukturat Drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kërkojnë marrjen e masave nga ana e DAP, për nxjerrjen e akteve të emërimit apo refuzimit për propozimet e bëra brenda kategorive nga Komisioni i Posaçëm në lidhje me sistemin e gjyq fituesve. Nga ana e Komisionit të Posaçëm t'i kushtohet një vëmendje e veçantë ndjekjes së ekzekutimit të këtyre praktikave duke qenë se ekziston risku që me kalimin e kohës dhe ndryshimeve të strukturës, rekomandimet për sistemin e gjyq fituesve të mos jenë më të vlefshme. Në rast të tillë, këto praktika duhet të rikthehen si pjesë e data bazës së vendimeve gjyqësore dhe të ri trajtohen.

Afati: Menjëherë

Gjetje 6: Përgjatë vitit 2019 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë zhvilluar gjithsej 12 procedura prokurimi me fond limit 129,352,765 lekë, nga të cilat 6 procedura me fond limit 13,687,471 lekë janë zhvilluar nga vetë DPT ku janë audituar të 6 procedurat. Për procedurat e deleguara, janë zhvilluar 3 procedura me fond limit 29,165,894 lekë janë zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, 1 procedurë me fond limit 86,499,400 lekë është zhvilluar nga AKSHI, ku është audituar pjesa e zbatimit të kontratave dhe mbështetjen në fonde buxhetore. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2019 mbi planifikimin dhe zbatimin e kontratave të zhvilluara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për llogari të DPT, u konstatua se janë **shkaktuar efekte financiare negative në buxhetin e shtetit në vlerën 10,499,400 lekë**, për arsye se është zhvilluar procedurë prokurimi mbi nevojat e planifikuara dhe pa fonde buxhetore, mungon planifikimi në Programin Buxhetor Afatmesëm edhe në Ligj Buxheti, si edhe urdhër prokurimet janë të pa vulosura nga dega e thesarit, konkretisht në procedurën me objekt: *“Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRT (implementim + 24 muaj mirëmbajtje)”* me kod projekti 18AV806 planifikuar në vlerën 76,000,000 lekë dhe prokuruar 86,499,400 lekë (vlera 10,499,400 lekë pa mbuluar me fonde buxhetore).

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 40, ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

prokurimin publik”, i ndryshuar VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76 pika 1, VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar, II. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e AKSHI-t, germa (i), dhe Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën D. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 6: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë të gjitha masat e nevojshme për nxjerrjen e përgjegjësive, dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës, me qëllim eliminimin dhe parandalimin e problematikave në lidhje me planifikimin buxhetor dhe iniciimin e procedurave të prokurimit të pa mbështetura në fonde buxhetore të cilat kanë shkaktuar efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 7: Konstatohen 2 raste për të cilët anulimi i detyrimeve tatimore në C@TS është shpjeguar nga DRT se është kryer në referencë të Ligjit të faljes së vitit 2017.

Nga auditimi u konstatuan dy raste të anulimit të detyrimeve, konkretisht për subjektin “M” administruar nga DRT Vlorë dhe subjekti E.H administruar nga DRT Sarandë, për të cilët detyrimi është fshirë me shpjegimin “sipas ligjit të faljes 2017” ndërkohë që këto dy subjekte kanë qenë ende në proces gjyqësor në vitin 2017. Për subjektin “E.H”, sipas data bazës së Drejtorisë Ligjore në DPT, vendimi është finalizuar në Prill 2019 ku padia e kundërshtuar me vlerë 16,755 mijë lekë është rrëzuar edhe në shkallë të II-të të gjykimit, ndërsa për subjektin M shpk, po sipas të njëjtës data bazë, subjekti është ende në proces gjykimi në shkallën e II-të për kundërshtimin e dy njoftim vlerësimeve të datave 16.03.2017 dhe 17.03.2017, me vlerë totale detyrimi 35,433 mijë lekë. Sipas parashikimeve të Ligjit nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore”, kriteri për fshirjen e detyrimit tatimor ishte 1) mosha e detyrimit “krijuar para vitit 2010” dhe 2) “dorëheqja nga procesi i ankimimit gjyqësor/apel” për tu kualifikuar për fshirjen automatike në C@TS, kushte të cilat për subjektin M nuk rezultojnë të plotësuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 7: DPT me strukturat e saj përgjegjëse të urdhërojë menjëherë verifikimin e dy rasteve të detyrimeve të anuluar në sistemin C@TS në vlerë totale detyrimi të raportuar 35,433 mijë lekë, të kryera në kundërshtim me Ligjin nr.33/2017 dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse.

Afati: Menjëherë

Gjetja 8: Në sistemin C@TS gjatë vitit 2019 rezultojnë të regjistruara rreth 230 subjekte për të cilët detyrimi është anuluar në bazë të një vendimi të apelimit tatimor apo si rezultat i zbardhjes së një vendimi gjykate. Nga auditimi rezultuan problematika në 3 raste me një vlerë detyrimi të anuluar prej 5,321 mijë lekë për të cilat DPT duhet të verifikojë dhe kontrollojë vlefshmërinë e tyre.

Në lidhje me kompensimet e detyrimeve, rezulton se 588 subjekte kanë shlyer detyrimin nëpërmjet kompensimit me gjendjen kreditore të tatim fitimit që rezulton në C@TS për këto subjekte, në total 522,250 mijë lekë nga të cilët 420 kanë shlyer plotësisht detyrimin dhe 168 subjekte e kanë kompensuar pjesërisht atë. Nga auditimi, konstatohet se shumë nga debitorët më të mëdhenj rezultojnë të kenë gjendje kreditore nga parapagimet e kësteve të tatim fitimit. Kompensimi supozohet se bëhet automatikisht nga sistemi C@TS, por nga të dhënat eidentohen raste kur subjekti ka gjendje kreditore por kompensimi nuk kryhet dhe subjekti vazhdon me gjendje debitore dhe kreditore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Për sa i përket pakësimit të borxhit nëpërmjet “faljeve/anulimeve”, në sistemin C@TS rezultojnë të regjistruara rreth 230 subjekte për të cilët detyrimi është fshirë në bazë të një vendimi të apelimit tatimor apo si rezultat i zbardhjes së një vendimi gjykate. Me qëllim testimin e këtyre veprime u kërkuar dokumentacion mbështetës për 25 sisteme/subjekte, për të cilat nuk u përgjigjën DRT Tiranë dhe Durrës. Për rastet pa përgjigje të DRT Tiranë, grupi i auditimit i është drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për plotësim informacioni por deri në përfundim të këtij auditimi nuk morëm informacion. Nga përgjigjet e DRT-ve të tjera, grupi i auditimit ka kërkuar informacion dhe dokumentacion mbështetës për tre raste të anulimit të detyrimeve në C@TS të cilat nuk kanë lidhje me një vendim gjyqësor, konkretisht:

Subjekti: O Ph G, anulim i detyrimit për tatimfitimin – detyrim principal në shumën 1,878 mijë lekë sipas Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj “anulim i gjobave për pagesë të vonuar, dalë pas periudhës së lidhjes së marrëveshjes me këste me, date.03.11.2017”. Anulimi është bërë nga DMT me shkresën nr.3390/9 datë 03.11.2017. Ky anulim duhet të verifikohet nëse është në përputhje me Ligjin 9920 datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 77 “Marrëveshja e pagesës me këste”

Subjekti: M shpk, anulim i tatimit mbi fitimin- detyrim principal në shumën 3,153 mijë lekë. Sipas shpjegimit të helpdesk e-tax në DPT ky anulim me ID: SLA-XXXX, është kryer pasi detyrimi prej 3,153 mijë lekë është një gabim i sistemit pasi është llogaritur pa marrë parasysh statusin e subjektit në periudhën për të cilin po i llogaritet ky detyrim, në këtë rast viti 2017⁴⁵ në të cilën subjekti ka qene me status pasiv. Në gjykimin e audituesit, nëse është një gabim sistemi, mënyra se si evidentohen dhe si autorizohet sistemimi i tyre është një çështje për të cilën strukturat përgjegjëse në DPT duhet të shpjegojnë dhe të kenë të parashikuar procedura të caktuara për veprim nga palët e autorizuar në këtë rast AKSHI. Në këtë kuadër, nga grupi i auditimit u kërkuar nga help desk dokumentacioni shoqërues/ autorizues për fshirjen/sistemimin por deri në përfundim të këtij auditimi dokumentacioni i kërkuar nuk u vu në dispozicion.

Subjekti: A.N, nga DRT shpjegohet se falja/anulimi i gjobës është korrigjim i hedhjes gabim në sistem në shumën 290 mijë lekë. Dokumenti i dërguar nga DRT Sarandë mban datën 03.08.2016 dhe sqaron sistemimin e detyrimit nga gjobë për kontributet e sigurimeve shoqërore në detyrim gjobe për tatim fitimin. Ky dokument nuk sqaron faljen/anulimin e gjobës 3 vjet më vonë. Për sqarime të mëtejshme është dërguar e-mail DRT Sarandë datë 25.06.2020 por deri në përfundim të auditimit dokumentacioni i kërkuar nuk është vënë në dispozicion.

Problematikat e konstatuara në këto raste të hasura gjatë auditimit, tregojnë për mungesë të sistemeve kontrollit për veprime të kryera manualisht në sistemin C@TS, me qëllim për të siguruar vlefshmërinë, saktësinë dhe autorizimin e kryerjes së veprimeve të tilla si: regjistrimi i njoftim vlerësimit apo fshirjet e detyrimeve. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 8.1: Për të tre rastet e anulimit të detyrimeve tatimore të konstatuara me problematika kërkohet të verifikohen menjëherë nga strukturat përgjegjëse të kontrollit në DPT dhe DRT, vlefshmëria dhe rregullshmëria e procedurave të ndjekura për ekzekutimin e anulimit apo faljes së detyrimeve, të saktësohet situata e këtyre subjekteve në sistemin C@TS dhe të nxirren përgjegjësitë individuale përkatëse.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 8.2: DPT me strukturat e saj përgjegjëse përfshirë AKSHI-n në cilësinë dhe përgjegjësinë e Drejtorisë TI, të urdhërojë menjëherë iniciimin e vlerësimit të sistemeve të kontrollit dhe të aplikacionit dhe procedurat shoqëruese të tyre, të miratuara nga Titullari, kjo në

⁴⁵E-mail i helpdesk, i datës 30.06.2020: “...lidhet me procedurën e vlerësimit automatik, i cili kryhej për deklaratat e pa dorëzuara duke marrë në konsideratë vetëm statusin e deklaratës, por nuk kontrollonte nëse statusi i tatimpaguesit ishte aktiv për të njëjtën periudhë tatimore të deklaratës së pa dorëzuar.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

veçanti për veprimet të cilat ekzekutohen manualisht në C@TS nga inspektorët në DRT dhe nga help desk.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 8.3: Në kushtet kur shërbimi IT në lidhje me anën funksionale të sistemit C@TS menaxhohet nga AKSHI, një njësi kjo jo në varësi të DPT, dhe në kushtet ku njësia e auditit të brendshëm në DPT nuk disponon kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e auditimeve të teknologjisë dhe informacionit, DPT ti drejtohet MFE për të kërkuar kryerjen e një auditimi të sistemeve të kontrollit dhe sigurisë së sistemit C@TS.

Afati: Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetja 1. Në 14 raste punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 për periudhën nga data e emërimit të tyre deri në datë 31.12.2019, duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 1,552,000 lekë (prej së cilës 405,000 lekë në vitin 2019), pasi informacioni i dhënë nga ana e DBNJ për DBF, nuk ka rezultuar i plotë dhe i hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Më konkretisht, në aktet e emërimit të punonjësve që i janë përcjellë Drejtorisë së Financës për pagesë, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është përcaktuar niveli i diplomës për grupet e diplomave të arsimit universitar, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr.2 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nenit 35 të rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, ku shprehimisht citohet: “është kompetencë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, përkatësisht përgjegjësit të sektorit të rekrutimit dhe promovimit, përgatitja e akteve të emërimit, largimit, kontratave të punës, për të gjithë punonjësit e ATQ në bazë të kërkesave ligjore, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm”. Më në detaje: 10 punonjës të cilët zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional (H.K; V.J; B.D; F.Z; J.D; E.N; A.H; A.K; A.Q; I.N) janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë (që i përket grupit 1 të diplomës Master Shkencor), nga 11,000 lekë që duhej të paguheshin për grupin 2 të diplomës Master Profesional; dhe 4 punonjës të cilët zotërojnë diplomë të nivelit Bachelor (A.B; P.H; A.F; E.B) janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë (që i përket grupit 1 të diplomës Master Shkencor), nga 10,000 lekë që duhej të paguheshin për grupin 3 të diplomës “Bachelor”. (Trajtuar më hollësisht në pikën E1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi 1.1: DPT të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 1,552,000 lekë, sa përfituar padrejtësisht nga 14 punonjës, në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes 2 të VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, etj.”.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 1.2: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në çdo rast, për emërimet e reja në punë, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm, të hartojë aktin e emërimit në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, ...” dhe rregullatore në fuqi, neni 35 i rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19 datë 22.02.2017. Gjithashtu, DBNJ në vijimësi, rast pas rasti, për punonjësit aktualë pjesë e organikës së DPT–



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

së, duhet të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Buxhet Financës në lidhje me ndryshimin e nivelit të diplomës së tyre.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.3: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në asnjë rast, për emërimet e reja në punë, të mos procedojë me kryerjen e pagesës nëse, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk garantohet plotësia e informacionit, në zbatim të kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Afati: Në vijimësi

Gjetja 2. Nga auditimi konstatohet se në 6 raste, dy punonjës (K.M & B.B) janë paguar në total në shumën 110,900 lekë për shërbimet e kryera mbi 100 km jashtë qendrës së punës pa marrë më parë autorizim nga Titullari i Institucionit, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: “Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës”. (Trajtuar më hollësisht në pikën E1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi 2: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 110,900 lekë, përfituar nga punonjësit e sipërcituar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Afati: Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Bazuar në Kreun X “Disiplina në Shërbimin Civil”, të Ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve marrja e masave për fillimin e ecuresë disiplinore dhe dhënien e masave disiplinore sipas përgjegjësisë, për të gjithë nëpunësit që me veprimet apo mos veprimet e tyre kanë sjellë situatën e konstatuar.

F. TË TJERA

-Vendimi i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për këtë auditim së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, do t’i përcillet Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e organit epror.

-Problematikat e konstatuara në 2 procedurat e Ristrukturimit të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i përcillen Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

-Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në zbatim të programit të auditimit nr.333/1 prot., datë 15.04.2020, pika B5. “*Auditimi i procesit të ekzekutimit të rimbursimit të TVSH. Vlerat, përfituesit kryesor dhe zbatimi i parimit FIFO*”, u konstatuan vonesa në procesin e miratimit të kërkesave për rimbursim, vonesa në kryerjen e pagesave të shumave të miratuara. Gjithashtu u konstatuan pasaktësi në mbajtjen e evidencave jashtë sistemit C@TS në lidhje me detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtaz të kërkesave për rimbursim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

nga subjektet e cilësuar si “tatimpagues të mëdhenj” për shkak të vlerave të larta të kërkesave për rimbursim të paraqitura prej tyre.

Për sa më sipër, në një afat të përshtatshëm, KLSH do të zhvillojë një auditim tematik me objekt rregullshmërinë e procesit të miratimit dhe rimbursimit të TVSH-së dhe raportimit të stokut të detyrimeve të prapambetura.

-Në zbatim të pikës G. “Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme” të këtij programi auditimi miratuar me nr.333/1 datë 15.04.2020, sqarojmë se grupi i auditimit pas verifikimeve të kryera gjata periudhës auditues 15.04.2020- 24.07.2020, ka lënë në subjekt Akt-verifikimin nr.1 datë 24.07.2020 protokolluar në DPT me nr. 6272/21. Në vijim të fazës së raportimit sqarojmë se, gjetjet dhe rekomandimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2018”, do të paraqiten në raportin e auditimit sipas programit të miratuar nr.694 datë 16.07.2020.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKS

Tabela: Subjektet me të ardhura mbi 14,000,000 lekë që kanë aplikuar shkallën tatimore 5%:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

Emri i subjektit	Përshkrimi nga tatimpaguesi	DRT	Tatim fitimi me shkallen tatimore standarde	Tatim fitimi me shkallën 5%
I S	Importim, eksportim dhe tregtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve si: hardëare, softëare, netëoring dhe të gjithë periferikeve të tyre.	DTM	45,094,697	20,437,367
Ii	Dizajni softëare-i. Analiza e kërkesave të sistemit softëare, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit softëare; Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softëare. Programimi i sistemeve softëare, kodimi, instalimi, integrimi	DTM	50,865	15,252,744
I +	Tregtim i sistemeve kompjuterike për Përpunim Informacioni dhe Transmetim.Prodhim i programeve aplikative.Instalimi i sistemeve të Informacionit dhe të Nderlidhjes.Sherbim i sistemeve elektronike në cdo fushë të ekonomisë.Tregtimi i pajisjeve sisteme	DRT Tiranë	-	10,154,854
F	Programim dhe zhvillim i sistemeve dhe aplikacioneve informatike për funksionim në Cloud ose lokalisht. Importim dhe rishitje brenda dhe jashtë vendit të sistemeve, pajisjeve dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit duke kryer përmesime,	DTM	-	5,866,625
M A T	Dizenjim softëare-i. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softëare. Programimi i sistemeve softëare, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrëgjimi i gabimeve,	DRT Tiranë	-	5,214,336
S & S	Zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit.Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrëte Ethernet/LAN, sisteme sigurie Eëb-site etj.Sherbim akses interneti.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	-	4,896,233
L I S	kryerja e aktiviteteve të lidhura me prodhimin dhe zhvillimin të softëare; në mënyrë të vegante, objekti i Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet vijuese: (i) Dizenjim softëare; (ii)Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh	Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	-	4,135,059
A	Aktivitetet informatike dhe aktivitetet të lidhura me to. Konsulencë në sistemin informatik. Konsulencë në sistemin informatik. Hartimi i programeve informatike dhe konsulencë informatike. Konsulencë dhe furnizim programesh informatike.	DRT Tiranë	-	3,980,785
C - 7 - I K S	a) Prodhim, Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softëare dhe aplikativ edhe në fushën e informacionit. b) Testim softëare c) Dizenjim softëare,	DRT Tiranë	-	3,911,627
I B S	a. Dizenjim softëare-i. Ketu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit softëare, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit softëare; b. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softëare.	DRT Tiranë	878,467	3,679,157
A P	Agro - turizem. Restorant. Grumbullim, përpunim qumështi, fruta-perime, mishi. Bujtina. Investitor në ndërtim.	DRT Lezhë	-	3,438,875
S	Projektimi, realizimi, menaxhimi dhe kontrolli i sistemeve informatike dhe të programeve aplikative, si dhe ushtrimin e aktivitetit informatik dhe telematik të kryer në favor të të treteve, përpunimin e të dhënave për të tretet, realizimin e shitjes së prod.	DRT Tiranë	-	3,265,891
I	Dizenjim softëare-i. analize të sistemeve softëare, projektim i arkitekturës dhe projektim i detajuar i sistemeve softëare. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softëare. Programimi i sistemeve softëare, kodim, instalim, integrim i të gjithë komponenteve	DRT Tiranë	-	2,450,673
C P	Sherbime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Konsulencë dhe menaxhim të projekteve. Dizenjim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve. Sherbime auditimi të sistemeve, hostim infrastrukture dhe softëare,	DRT Tiranë	2,733,091	2,408,001
t BPO	Zhvillim sofëar, trajnime , konsulencë dhe marketing.	DRT Tiranë	-	2,149,292
I	Shërbime dhe konsulencë në fushën e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikacionit (TIK); Zhvillimin, përmirësimin dhe integrimin e Softëare (programeve) kompjuterike në fushat e Administrimit, Menaxhimit dhe raportimit Financiar; Implementi	DRT Tiranë	-	1,903,868



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

R S	Zhvillim Ëeb, Mobile dhe Aplikacione Core. UX Design.Migrim ne Cloud QA & Test Orchestration. Zhvillim dhe analize sistemesh Big Data .Konsultim Strategjie. Konsultim Teknologjie. Zhvillim Strategjie Digital Marketing etj.	DRT Tiranë	-	1,776,905
S.T. A2011	Sherbime prodhimi softëare per brenda dhe jashte vendit dhe ne çdo lloj fushe.	DRT Tiranë	-	1,748,746
H U B	Aktivitet per prodhimin/zhvillimin e softëare-ve. Mirembajtje dhe dhenie me qera te pajisjeve elektronike.	DRT Tiranë	-	1,695,438
AB P	Objekt i veprimtarisë ekonomike se shoqërisë Albanian Business Partner shpk janë vetëm aktivitete të teknologjisë së informacionit, që konsistojnë dhe lidhen direkt me prodhimin, tregtimin dhe eksport-importin e pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompj	DRT Tiranë	-	1,689,297
D	Objekti i Shoqërisë është të ndërmarrë cdo lloj aktiviteti tregtar i lejuar nga ligji i zbatueshëm, duke përfshirë por pa u kufizuar në, prodhimin dhe zhvillimin e softëare-ve/programeve kompjuterike (Softëare development) si dhe te shërbimeve mbështetëse	DRT Tiranë	-	1,622,320
PaSM	Zhvillim softëare-sh dhe shitje softëare-sh online, ëeb desing. Regjistrim domainesh. Ëeb hosting, Punime Grafike, Internet marketing.	DRT Tiranë	-	1,519,866
L T	Zhvillim softëare ne te gjitha platformat per ëeb, desktop, mobile etj duke perfshire proceset e analizës , dezajn, planifikim, implementim, mirembajtje. Zhvillim ose ndërmjetësim ne trajnime dhe kurse profesionale ne fushen e zhvillimit te softëare dhe TI	DRT Tiranë	-	1,310,738
H S	Te krijoje, zhvilloje dhe implementoje programe softëare, telekomunikacioni,teknologji informative te prodhuar prej saj ose personave te trete.Te realizoje zhvillimin,shitjen dhe implementimin e tyre.Import-eksport i paisjeve hardëere elektronike, lendes s	DRT Tiranë	-	1,291,258
A T I S	Objekti i veprimtarise se shoqërisë konsiston ne kryerjen e te gjitha veprimtarive te pranura dhe te ligjshme ne nivel kombëtar dhe nderkombëtar. Aktiviteti kryesor i shoqërisë do te jete: Disenjim softëare; Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh softëare; T	DRT Tiranë	-	1,280,941
ARK IT	Projektim, mbajtje, implementim, administrim dhe konsulence te sistemeve dhe te softëareve, te bazes se dhenave, te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te te dhenave dhe inerkonektivitetit ne teresi;	DRT Tiranë	-	1,254,345
T	Sherbime dhe konsulenca informatike brenda dhe jashte vendit. Tregtim, import-eksport.	DRT Tiranë	-	1,244,481
B I T	Krijim dhe Zhvillim Programesh Kompjuterike. Projektim dhe Implementim rrjetash Kompjuterike. Instalim konfigurim Data Center (Qendra te Dhenash kompjuterike). Blerje shitje me shumice dhe pakice, Programesh, Kompjuter, Pajisje te nevojshme per rrjeta.	DRT Tiranë	-	1,234,401
3i-S	Dizenjim softëare-i. Analiza e kerkesave te sistemit softëare, projektimi i arkitekture dhe projektimi i detajuar I sistemit softëare; Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh softëare. Programimi i sistemeve softëare, kodimi, instalimi, integrimi	DRT Tiranë	-	1,012,878
V A	Zhvillim Sistemesh Informatike. Programime Softëare dhe Aplikacionesh. Analizime dhe hedhje te dhenash. Dizejnim dhe perpunime grafike. Trajnime informatike.	DRT Tiranë	-	968,833
S-S	Keshillim ne lidhje me teknologjine e informacionit dhe paisjet kompjuterike, keshillim, projektim dhe instalim te programeve kompjuterike dhe bazava te te dhenave, keshillim, projektim dhe instalim te rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike dhe mirembajtje dh	DRT Tiranë	-	913,950
A SIT- A B	Aktivitete te teknologjise se informacionit; • qe konsistojne dhe lidhen direkt me prodhimin, tregtimin dhe eksport-importin e pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompjuterike hardëere dhe softëare; • Instalim, konfigurim, trajnim, testim dhe mirembajtje	DRT Tiranë	-	853,955
B B	Dizenjim softëare-i. Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh softëare. Testim softëare. Operim, menaxhimi, suporti i perdorimit dhe auditimi teknik/informatik per sistemet softëare.	DRT Tiranë	-	839,338



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

A – S	Veprimtari ndertimore per objekte civile, industriale, bujqesore, ushtarake, banesa, zyra etj per individe vendas dhe te huaj, per ndertime te ndryshme private e shteterore, per shtetin, duke organizuar edhe konsultime e veprimtari projektuese, preventivue	DRT Gjirokastër	16,834,890	794,825
K	Zhvillimi dhe shitja e programeve kompjuterike per perdorim ne fusha te ndryshme. Ofrimi i sherbimeve te ndryshme informatike ne fushen e teknologjise se informacionit. Konsulenca ne lidhje me aplikimin e teknologjise se informacionit ne fusha te ndryshme.	DRT Tiranë	-	754,240
IT	Programim, sherbime IT, Shit/blerje pajisje IT, ndermjetesim sherbime IT dhe veprimtari te tjera ne fushen e teknologjise se informacionit.	DRT Fier	-	646,382
A – DM	Aktivitetet te teknologjise se informacionit; qe konsistojne dhe lidhen direkt me prodhimin, tregtimin dhe eksport-importin e pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompjuterike hardçare dhe softçare; Instalim, konfigurim, trajnim, testim dhe mirembajtje;	DRT Tiranë	-	629,224
L	Shitje dhe prodhim programesh dhe shërbimesh informatike, konsulencë dhe trajnime. Agjensi punësimi, rekrutim, trajnim, i burimeve njerëzore. Organizim i praktikave të punës, punësim stafi për palët e treta. Import–export, tregtim me pakicë dhe shumicë	DRT Tiranë	83,018	586,019
BGP S E	Shoqeria ka per objekt konsulence inxhinjerike te teknologjise se informacionit, krijim dhe zbatim i softçare (programe) dhe platformave SAP dhe JAVA per kompani brenda dhe jashte vendit si dhe kryerjen e cdo aktiviteti te ngjashem ne funksion te objektit	DRT Tiranë	-	581,887
S T	Konsulence dhe pune informatike. Zhvillim te program eve kompjuterike per ëeb dhe mobile. Implementim, testim, design te softçare te ndryshem.	DRT Tiranë	-	541,539
C S	Sherbimet e Teknologjise se Informacionit, veçanerisht inxhinieria softçare, menaxhimi i aplikacioneve, menaxhimi dhe konsultimi dhe mbeshetja e teknologjise informative.	DRT Tiranë	-	537,333
ITA	Projektim ndertim prodhim materiale ndertimi, tregti mallra te ndryshem etj	DRT Elbasan	-	496,400
I & C D	Dizenjim softçare. Analize, projektim i arkitektures se nje sistemi softçare; Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh softçare. Programimi i sistemeve softçare, kodimi, instalimi, integrimi i te gjithe komponenteve, dokumentimi	DRT Tiranë	-	472,132
A Gj	Aktivitetet te agroturizmit dhe zhvillim rural, restoranti dhe të ngjashme; merr, trajton, ruan, magazinon, prodhon, perpunon, tregon, blen, shet ose merret me çdo menyre a mjet tjetër me produkte bujqesore. Të ushtrorë aktivitet në fushën e përpunimit, am	DRT Durrës	-	443,148
A S H	Produkte dhe sherbime programimi (programime kompjuterike)	DRT Tiranë	-	403,400
K 2010	Ne fushen e ndertimit: Studimi , projektimi, konsulenca, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit per realizmin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private	DRT Tiranë	319,766	389,386
B	Dizenjim, implementim, konsulence e sistemeve te teknologjise se informacionit dhe mirembajtja e tyre. Import - eksport pajisje dhe aksesore te sistemeve te teknologjise se nformacionit. Import - eksport programe kompjuterike (softçare).	DRT Tiranë	-	374,408
A NSI	1 Konsulenca dhe projektimi për zgjidhje të problematikave në:- softçare aplikues, menaxhues, modelues dhe trajnues;-	DRT Shkodër	-	363,100
J L	Zhvillimin e softçare, qendër telefonie (call center), intelegjenca e biznesit (business intelegence), marketing, këshillim për fushën e IT. Nënshkrim i kontratave te nën qirasë për ambientet e zyrave të saj.	DRT Tiranë	-	357,917
INGË-T	Tregti, eksport-import, furnizime, instalime dhe mirembajtje e pajisjeve elektronike, informatike, audiovizive, te aparturave teknike te telekomunikacionit, te laboratoreve didaktik, kerkimor e shkencore, mallrave industrial. Import, eksport, tregtim,	DRT Tiranë	-	339,825
M C	1.Prodhim ,zhvillim dhe mirembajtje sistemesh softçare. 2.Aktiviteti i zhvillimit te softçareve aplikative	DRT Tiranë	-	336,020
B O	Gjenerim database dhe menaxhimi i tyre nepermjet internetit	DRT Tiranë	300,882	300,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

A L	Marketing	DRT Tiranë	1,743,169	300,000
M H S	Mjek Gjinekolog	DRT Tiranë	4,297,169	300,000
I S D	Te zhvilloje aktivitet ne fushen e prodhimit dhe shitjes se softëare (programe), dizenjim dhe zhvillim, projektim i detajuar i softëare dhe bazes se te dhenave, analize, zhvillim, programim (kodim), integrim i komponenteve, trajnime, instalime, konsulenca	DRT Tiranë	-	281,910
I A	Aktivitet ne fushen e Teknologjise, Informacionit, Komunikimit, Logjistikes Kompiuterike, Dizenjove. Aktivitet ne fushen e Teknologjise se Informacionit, Teknologji e Eëb-it, Projektimi i Sistemit Informatik, Informatizim Arkivash, Ndertim Aplikacionesh	DRT Tiranë	-	267,657
D C	Disenjim softëare. Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh softëare. Testim softëare. Disenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit. Disenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise. Zhvillim sistemesh migrimi.Permiresim /upgrade sistemesh informatike.	DRT Tiranë	-	263,659
T S	Krijim, zbatim, integrim te sistemeve te Informacionit dhe te Programeve Kompjuterike. Ndertim i sistemeve te komunikimit ne rrjete, import export tregti te pajisjeve dhe programeve ne fushen e teknologjise se Informacionit, si dhe te sigurise fizike apo k	DRT Tiranë	-	259,106
X A	Kompania ka si objekt konsulence per te gjiiha llojet e sistemeve informatike per perpunimin e le dhenave dhe informacionit; blerje-shitje te projekteve, projektimin e tyre, prodhimin dhe shiijen e siseimeve dhe programeve menaxheriale per bizneset si dhe	DRT Tiranë	-	248,876
P S	Projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim softëare. Shitje license softëare dhe sherbimeve perkatese te lidhura me to. Dhenie me qira e softëareve. Softëare si sherbim. Sherbime te adoptimit dhe pershtatjes se softëareve.	DRT Tiranë	-	230,765
F1001	Specifikimi, zhvillimi, testimi, provimi, mirembajtja dhe suporti i te gjitha llojeve te programeve (softëare) dizenjimi dhe zhvillimi i perdoruesit te nderfaqeve te te gjitha llojeve te programeve(softëare) dizenjimi dhe zhvillimi i dizajnit grafik dhe pe	DRT Tiranë	-	223,664
P C	Mirembajtje dhe ndertime te programeve kompjuterike te komisionuara. Konsulence dhe perpunim i te dhenave te shoqerive te tjera dhe/ose enteve publike. Ndermjetesim tregëtare dhe marketing ne fushen e sherbimeve telematike. Dizenjim softëare-i, zhvillim	DRT Tiranë	-	221,847
O V	Shoqeria ka per objekt : Import-Eksport I peshkut, perpunim I peshkut dhe I nenprodukteve te tij. Prodhim per vete dhe te tretet i kepuceve te perfunduara dhe pjeseve te vecanta, canta , rripa dhe cdo prodhim lekure apo produkte lekure te perpunuara e	DRT Durrës	1,138,719	199,666
E Sh	Call Center.	DRT Fier	170,042	189,996
A S	Keshillime dhe sigurimi i zgjidhjeve programore-softëare, tregti me shumice e pajisjeve informatike per zyra, qera dhenie e paisjeve informatike, sherbime konsulence dhe sherbime te tjera ne fushen e teknologjise se informacionit.	DRT Tiranë	-	163,263
A F	Realizimi i veprimtarive te projektimit, realizimit, marketingut, shitjes dhe menaxhimit te sherbimit, produkteve dhe sistemeve te perpunimit te te dhenave, menaxhimit kompjuterik, per operimin dhe mirembajtjen e procedurave dhe programeve kompjuterike, pe	DRT Tiranë	-	162,963
O	Import-Export te paisjeve informatike dhe elektronike te ndryshme ne fushen e Teknologjise se Informacionit dhe komunikimit, shitje me shumice e pakice. Produkte dhe sherbime ne fushen e teknologjise se informacionit. Import-Export, blerje dhe shitje licens	DRT Tiranë	128,342	159,618
F S	Investim ligjor dhe konsultime ne fushen e krimit informatik te sigurise se sistemeve informatike. Analize e permbajtjes se informacionit te mbledhur me qellim investigimin informatik. Detektim dhe parandalim te aktiviteteteve te krimit informatik. Analizi	DRT Tiranë	90,000	141,242
A L	Tregti dhe perpunim te lendeve drusore. Transport brenda dhe jashte vendit per vete dhe per te trete. Tregtim mallrash e produktesh bujqesore e blektoriale me shumice e pakice. Tregtim i miellrave te llojeve te ndryshme. Tregtim plehrash kimike e pesticide	DRT Durrës	-	133,342



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtësinë e Përgjithshme të Tatimeve”

D H A	Konsulencë studimi i realizimeve, kerkimin e aplikuar punime inxhinierike dhe rikonstruksioni, analiza projektme, formimi dhe instruktimi, administrimi, auditimi, mirembajtja dhe asistencë në fushën e informatikës, inteligjencës artificiale, sistemeve inf	DRT Tiranë	-	125,039
F D	Bar kafe	DRT Tiranë	124,601	112,485
F R	Tregti me pakice e shumice të artikujve të ndryshëm ushqimorë cigare etj.	DRT Tiranë	18,787	90,602
D T	Tregti market	DRT Vlorë	158,729	47,578
S	Sherbime në programim kompjuteri dhe IT. Dezenjim softëare-i, zhvillim dhe mirembajtje sistemesh softëare. Testim softëare.	DRT Tiranë	-	23,902
NCI	Tregtim me shumice e pakice import eksport në teresi të mallrave industrial, ushqimorë, pije alkoolike e freskuese, e pajisjeve teknologjike, pajisjeve elektronike, elektrike, material ndertimi, hidrosanitare.	DRT Tiranë	-	20,232
E H	Punime duralumini, melamine, hekuri etj. Tregtim me pakice materiale ndertimi.	DRT Tiranë	-	13,977
2AC	Projektimi, furnizimi dhe instalimi i impianteve teknologjike dhe mekanike, impianteve të kondicionimit, ngrohjes dhe ventilit, impianteve hidrosanitare dhe mbrojtjes nga zjarri;	DRT Tiranë	174,755	2,265

Tabela: 50 debitoret më të mëdhenj nga Entet Publike për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

EMËRTIMI	DEBI TOTAL PROGRESIV në lekë	DEBI TOTAL 2019 (detyrimi) në lekë
REPARTI USHTARAK 4303	140,895,729	7,608,938
(blank)	105,708,101	1
BASHKIA KUKES	80,521,510	7,898,507
REPARTI USHTARAK 4460	52,548,922	2,764,029
REPARTI USHTARAK 4006	46,599,507	67,485
DREJTORIA VENDORE E ASHK TIRANE RURALE 1	35,207,836	-
NJESIA MBESHTETJES TEKNIKE PROG. IADSA	28,400,101	9,942,573
KOMUNA NDROQ	15,638,790	554,651
REPARTI USHTARAK NR 4443	14,728,273	7,256,852
BASHKIA TEPELENE	12,967,601	158,891
REPART USHTARAK NR.4009	10,720,419	370,357
MINISTRIA E FINANCAVE	8,547,270	118,749
ND.UJESJ.FSHAT GJIROKASTER	7,212,518	-
DREJTORIA E POLICISE ELBASAN	6,995,355	6,995,356
KOMB. TEKSTILEVE TE PAMBUKTA	6,764,489	-
HOTEL DAJTI	6,012,664	-
MINISTRIA DREJTËSISE	4,977,222	-
ZYRA VENDORE ARSIMORE MALLAKASTER	4,244,485	-
MINISTRIA E MBROJTJES	4,222,500	1,914,804
KOMUNA SHUSHICE.	4,027,894	-
APARATI I MINISTRISË SE BRENDSHME	3,749,062	3,655,426
KOMUNA MILOT	2,898,754	-
DREJT. RAJONALE PER KUFIRIN&MIGRACIONIN	2,837,388	2,837,388
KLUBI SHUMESPORTESH POGRADDEC	2,206,105	-
KOMUNA ARREN	2,133,262	-
N N H/C BANJE	1,924,025	-
ZYRA ARSIMORE LIBRAZHD	1,854,528	552,178
KOMUNA LAZARAT	1,836,070	-
ND. KOMUNALE TEPELENE	1,819,091	-
KOMUNA KOLSH	1,736,945	-
AGJENSIA KOMBETARE DUHAN CIGAREVE	1,589,498	1,549,947
INSTITUTI KERKIMEVE TE USHQIMIT	1,576,898	-
KOMUNA SURROJ	1,482,317	-
MINISTRIA E KULTURES	1,453,303	638,278
KOMUNA KODER THUMANE	1,449,545	-
NDERMARRJA ELEKTROTEKNIKE	1,414,235	-
BASHKIA KRUE	1,323,207	1
INSTITUTI I STATISTIKES	1,320,110	26,957
NDERMARJA E RRUGEVE RURALE	1,299,549	-
REPARTI USHTARAK 5001	1,265,457	184,036



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

AGJENS. SHQIPT. E BIZNES.DHE INVEST.	1,139,695	-
REPARTI USHTARAK 1109	1,119,572	-
INSPEKTORIATI SHTETEROR I ARSIMIT	1,115,147	173,764
KOMUNA "POGON"	1,079,940	-
KOMUNA SHISHTAVEC	1,056,372	-
DREJT. RAJONALE E MONUMENTEVE KULTURES	1,051,853	-
KOMUNA SHTIQEN	988,574	-
AGJENSIA KOMB.TE BURIMEVE NATYRORE	964,228	-
PARTIA SOCIALISTE KOLONJE	927,076	-
REPARTI USHTARAK 4001	807,811	497,882

Tabela: Të dhëna të detajuara mbi veprimtarinë e DAB për vitin 2019

N r	Objekti i auditimi (subjekt/fuqia)	Qellimi i auditimit	Lloji	Periodha e Audituar	Koha e realizimit të auditimit	Data e Autorizimit	Data e njoftimit për fillimin e angazhimit	Data e programit	Data e takimit fillestar	Data e Projektit Raportit	Data e Raportit Përfundimtar	Data e takimit përmbyllës	Audituesit
1	Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror Tiranë	Te ndihmoje njesine e audituar per realizimin e objektivave te veprimtarise duke permiresuar sistemet e kontrollit te brendshem dhe menaxhimin	Auditim i përputhshmërisë	12/2018 - 04/2019	12/2018 - 04/2019	07.12.2018	07.12.2018	26.12.2018	26.12.2018	13.05.2019	11.06.2019	15.04.2019	Xh.Lera & I.Gjonaj
2	Mbiveprimtarinë funksionale të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës në mbledhjen e të ardhurave.	Të ndihmojë njësinë e audituar në realizimin e objektivave të veprimtarisë, duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin.	Auditim i kombinuar	01.01.2017-31.12.2018	15.03.2019	07.12.2018	07.12.2018	24.12.2018	21.12.2018	13.05.2019	20.06.2019	01.04.2019	Klejd Kazaçi & Bardhyl Lako
3	Mbi veprimtarinë funksionale të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër në mbledhjen e të ardhurave.	Te ndihmoje njesine e audituar per realizimin e objektivave te veprimtarise duke permiresuar sistemet e kontrollit te brendshem dhe menaxhimin	Auditim i kombinuar	01.01.2017-31.12.2018	28.01.2019-18.04.2019	09.01.2019	09.01.2019	25.01.2019	23.01.2019	06.06.2019	03.08.2019	25.04.2019	Bardhok Lleshaj, Nexhmije Toçilla
4	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë Drejtoria e Kontrollit	Dhënia e një sigurie objektive dhe të arsyeshme	Performancë	01/2016 - 05/2019	06/2019 - 09/2019	20.06.2019	12/17 date 20.06.2019	12/17/1 date 08.07.2019	08.07.2019	12/17/3 dt 15.11.2019	12/17/7 dt 23.12.2019	01.11.2019	Xh.Lera & I.Gjonaj
5	Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë	Të ndihmojë njësinë e audituar në realizimin e objektivave të veprimtarisë, për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin.	Auditim i kombinuar	01.07.2016-01.06.2019	04.07.2019-04.10.2019	20.06.2019	20.06.2019	08.07.2019	26.06.2019	28.10.2019	26.11.2019	17.10.2019	Bardhyl Lako, Klejd Kazaçi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”

6	Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë	Vlerësimi i zbatimit të legjeshmerisë dhe pershtatësive se veprimeve administrative të një procedurë vlerësimi tatimor	Auditim i përputhshmërisë	01.01.2014-31.12.2018	09.01.2019-15.01.2019	08.01.2019	Data e Urdhërit 08.01.2019	08.01.2019			20.02.2020	20.01.2020	Bardhok Lleshaj, Nexhmije Toçilla
7	Mbi veprimtarinë funksionale në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT	Të ndihmojë njësinë e audituar në realizimin e objektivave të vendosura	Auditim i përputhshmërisë	01.01.2019-31.03.2019	3 dite pune	17.04.2019	17.04.2019	19.04.2019	19.04.2019	30.04.2019	20.05.2019	25.04.2019	Klejdi Kazazi, Mexhit Allushi & Bardhyl Lako
8	Vlerësim mbi funksionimin e sistemeve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DTM	Dhënia e një sigurie objektive dhe të arsyeshme	Auditim i përputhshmërisë	01.08.2015-30.04.2019	28.06.2019-18.10.2019	20.06.2019	20.06.2019	28.06.2019	24.06.2019	08.11.2019	27.12.2019	18.10.2019	M.Allushi N.Toçilla B.Lleshaj
9	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	Mbi vlerësimin e kostot shtese në financimin buxhetor për shpenzimet e kryera në artikullin 602.4 "Spënzime udhëtime e dieta nga DRTHRQ Tirane DRT Tirane për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018"	Auditim Financiar	01.01.2018-31.12.2018	19.11.2019-31.12.2019	19.11.2019	Data e Urdhërit 03.10.2019	19.11.2019	19.11.2019	23.01.2020	20.02.2020	20.01.2020	Bardhok Lleshaj,, Bardhyl Lako

				Rekomandime		Gjetjet me efekte ekonomike		Zbatimi i rekomandimeve	
Objekti i auditimit (subjekt/fushe auditimi)	Qellimi i auditimit	Lloji i auditimit	Periudha Audituar	Rekomandimi me ProjektRaport (ne numer)	Rekomandimi me Raport (ne numer)	Gjetjet me Projekt Raport (ne vlere)	Gjetjet me Raport (ne vlere)	Zbatimi i rekomandimeve (ne numer)	Zbatimi i rekomandimeve (ne vlere)
Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror Tiranë	Te ndihmojë njësinë e audituar për realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin	Auditim i përputhshmërisë	12/2018-04/2019	15	15			7	
Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	Të ndihmojë njësinë e audituar në realizimin e objektivave të veprimtarisë, duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin.	Auditim i kombinuar	01.01.2017-30.11.2018	19	20	9,400,000	9,400,000	13	
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	Te ndihmojë njësinë e audituar për realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin	Auditim i kombinuar	01.01.2017-31.12.2018	26	21			19	
Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë Drejtoria e Kontrollit	Dhënia e një sigurie objektive dhe të arsyeshme	Performance	01/2016-05/2019	11	11			Në proces	
Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë	Të ndihmojë njësinë e audituar në realizimin e objektivave të veprimtarisë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin.	Auditim i kombinuar	01.07.2016-01.06.2019	22	23			Në proces	
